

Samuel P. Huntington

**Përplasja e
qytetërimeve
dhe ribërja e rendit botëror**



Copyrighted material



© LOGOS - A

2 0 0 4



S H K U P

PRISHTINË

T I R A N Ë



Samuel P. Huntington

Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror





E përktheu nga anglishtja:
Xhevat Lloshi

Titulli i origjinalit:
Samuel P. Huntington
The Clash of Civilizations
and the Remaking of World Order
Touchstone Books, London, 1998

Samuel P. Huntington

Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror



Përmbajtja:

Parathënie	7
I. Një botë qytetërimesh	11
Kreu 1: Epoka e re në politikën botërore	13
Hyrje: Flamurët dhe identiteti kulturor	13
Botë me shumë pole dhe shumë qytetërime	16
Botë të tjera?	23
Krahasimi i botëve: realizmi, kursimtaria dhe parashikimet	36
Kreu 2: Qytetërimet në histori dhe sot	44
Natyra e qytetërimeve	44
Marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve	59
Kreu 3: Një qytetërim universal? Modernizimi dhe Perëndimorizimi	73
Qytetërimi universal: kuptimet	73
Qytetërimi universal: burimet	91
Perëndimi dhe modernizimi	95
Përgjigjet ndaj perëndimit dhe modernizimit	103
II: Zhvendosja e peshores së qytetërimeve	115
Kreu 4: Venitja e Perëndimit: fuqia, kultura dhe indigjenizimi	117
Fuqia perëndimore: mbizotërimi dhe rënia	117
Indigjenizimi: ringjallja e kulturave joperëndimore	137
La revanche de dieu	144
Kreu 5: Ekonomia, demografia dhe qytetërimet sfiduese	157
Afirmimi i azisë	158
Ringjallërimi islamik	170
Sfidat që ndryshojnë	191
III. Rendi që po përftohet i qytetërimeve	195
Kreu 6: Rikonfigurimi kulturor i politikës globale	197
Hulumtimi për grupimet: politikën e identitetit	197
Kultura dhe bashkëpunimi ekonomik	207

Struktura e qytetërimeve	215
Vendet e përçara: dështimi i zhvendosjeve kulturore	223
Kreu 7: Shtetet bërthamë, rrathët bashkëqendrorë dhe rendi qytetërimor...	253
Qytetërimet dhe rendi	253
Lidhja e perëndimit	256
Rusia dhe shtetet e jashtme të afërta me të	270
Kina e madhe dhe sfera e saj e bashkëlulëzimit	279
Islami: vetëdija pa kohezion	291
IV: Përplasjet e qytetërimeve	301
Kreu 8: Perëndimi dhe të tjerët: çështjet ndërqytetërimore	303
Universalizmi perëndimor	303
Përhapja e armëve	309
Të drejtat e njeriut dhe demokracia	322
Imigrimi	333
Kreu 9: Politika globale e qytetërimeve	349
Shteti bërthamë dhe konfliktet në vijën e shkëputjes	349
Islami dhe perëndimi	353
Azia, Kina dhe Amerika	370
Qytetërimet dhe shtetet bërthamë: rreshtimet që përftohen	410
Kreu 10: Nga luftërat e tranzicionit te luftërat në vijën e shkëputjes	424
Luftërat e tranzicionit: afganistani dhe gjiri	424
Karakteristikat e luftërave në vijën e shkëputjes	435
Denduria: kufijtë e përgjakur të islamit	440
Shkaqet: historia, demografia, politika	449
Kreu 11: Dinamika e luftërave në vijën e shkëputjes	461
Identiteti: rritja e vetëdijes së qytetërimit	461
Grupimi sipas qytetërimit: vendet me afëri dhe diasporat	472
Ndërprerja e luftërave në vijën e shkëputjes	508
V. E ardhmja e qytetërimeve	523
Kreu 12: Perëndimi, qytetërimet dhe qytetërimi	525
Përtëritja e perëndimit?	525
Perëndimi në botë	539
Lufta qytetërimore dhe rendi	547
Përbashkësitë e qytetërimeve	558
Shënimet	566
Treguesi	632

Lista e ilustrimeve:

Tabelat:

Tabela 2.1: Përdorimi i termave “Bota e lirë” dhe “Perëndimi”	71
Tabela 3.1: Folësit e gjuhëve më të mëdha	81
Tabela 3.2: Folësit e gjuhëve kryesore kineze e perëndimore	82
Tabela 3.3: Përpjesëtimi i popullsisë botërore që u përket traditave kryesore fetare	89
Tabela 4.1: Territori nën sundimin politik të qytetërimeve, 1900-1993	123
Tabela 4.2: Popullsitë e vendeve që u përkasin qytetërimeve kryesore të botës, 1993.....	124
Tabela 4.3: Përpjesët e popullsisë së botës nën sundimin politik të qytetërimeve, 1900-2025	125
Tabela 4.4: Përpjesët e prodhimit industrial botëror sipas qytetërimit ose vendit, 1750-1980	128
Tabela 4.5: Përpjesët në prodhimin e përgjithshëm ekonomik botëror sipas qytetërimeve, 1950-1992.....	129
Tabela 4.6: Përpjesët sipas qytetërimit të efektivave ushtarake totale të botës	131
Tabela 5.1: Kulmi i lakores së rinisë në vendet myslimane	188
Tabela 8.1: Transferimet e armëve nga kina, me përzgjedhje, më 1980-1991.....	316
Tabela 8.2: Popullsia e SHBA sipas racës dhe etnisë	348
Tabela 10.1: Konfliktet etnopolitike, 1993-1994.....	445
Tabela 10.2: Konfliktet etnike, 1993.....	446

Tabela 10.3: Militarizmi i vendeve myslimane e të krishtera	447
Tabela 10.4: Shkaqet e mundshme të kahjes myslimane për konflikt	457

Skicat e grafikët:

Skica 2.1: Qytetërimet e gjysmërruzullit lindor	61
Skica 3.1: Përgjigjet alternative kundrejt ndikimit të perëndimit	109
Skica 3.2: Modernizimi dhe ringjallja kulturore	111
Skica 5.1: Sfida ekonomike: Azia dhe Perëndimi	160
Skica 5.2: Sfida demografike: islami, rusia dhe perëndimi	187
Skica 5.3: Kulmi i lakores së rinisë sipas rajonit	190
Figura 9.1: Politika globale e qytetërimeve: rreshtimet që po përftohen	423
Grafiku 10.1: Sri Lanka: sipëria e të rinjve sinhalezë dhe tamilë	451
Skica 11.1: Struktura e një lufte të ndërlikuar në vijën e shkëputjes.....	477

Hartat:

Harta 1.1: Perëndimi dhe pjesa tjetër: 1920	19
Harta 1.2: Bota e Luftës së ftohtë: vitet 1960	19
Harta 1.3: Bota e qytetërimeve: pas vitit 1990	19
Harta 7.1: Kufiri Lindor i qytetërimit Perëndimor	262
Harta 7.2: Ukraina: një vend i çarë	276
Harta 8.1: Shtetet e bashkuara: një vend i çarë?	347

Parathënie

Në verën e vitit 1993 revista *Foreign Affairs* botoi artikullin tim me titullin “Përplasja e qytetërimeve?” Ky artikull, sipas redaktorëve të *Foreign Affairs*, gjatë tre vjetëve ndezi më shumë diskutime se cilido artikull tjetër i botuar që nga vitet 1940. Është e natyrshme që ka ngjallur më shumë debate gjatë tre vjetëve, sesa gjithçka tjetër që kisha shkruar më parë. Përgjigje e komente për të kanë ardhur nga çdo kontinent dhe nga dhjetëra vende. Njerëzve u bëri përshtypje në mënyra të ndryshme: i tërhoqi, i zemëroi, i trembi e i trazoi argumenti im, se përmasa qendrore dhe më e rrezikshme e politikës globale që po shfaqet, do të jetë konflikti ndërmjet grupeve të qytetërimeve të ndryshme. Pavarësisht se çfarë ndikimi tjetër pati, ky artikull u preku një damar njerëzve nga cilido qytetërim.

Duke i parë interesimin, keqpërdorimin dhe kundërshtitë rreth artikullit, e quajta të nevojshme që t'i hulumtoja më tej çështjet e ngritura aty. Një rrugë e dobishme për ta parashtruar një çështje është ta paraqesësh në trajtën e hipotezës. Artikulli, i cili në titull kishte një pikëpyetje, që përgjithësisht nuk e vunë re, ishte një përpjekje për të bërë pikërisht këtë gjë. Ky libër që keni përpara, synon të japë një përgjigje më të plotë, më të thellë dhe më gjerë të dokumentuar për pyetjen e artikullit. Këtu jam përpjekur t'i përpunoj, t'i lëmoj, t'i plotësoj dhe, sipas rastit, t'i përcaktoj temat e

parashtruara në artikull, si dhe të shtjelloj shumë ide e të trajtoj mjaft pika, që kishin mbetur pa u prekur ose ishin kaluar shkarazi në artikullin e përmendur. Ndër këto janë: nocioni i qytetërimeve; çështja e një qytetërimi universal; marrëdhënia ndërmjet fuqisë e kulturës; zhvendosja e peshores së fuqisë ndërmjet qytetërimeve; indigjenizimi kulturor në shoqëritë joperëndimore; struktura politike e qytetërimeve; konfliktet e përfuara nga universalizmi Perëndimor, militantizmi mysliman dhe ngulmimi kinez; baraspeshimi dhe nxjerrja në krye e përgjigjeve ndaj ngritjes së fuqisë kineze; shkaqet e dinamika e luftërave në vijën e shkëputjes, si dhe e ardhmja e Perëndimit dhe e një bote qytetërimesh. Një nga temat kryesore, që mungonte në artikull, lidhet me ndikimin thelbësor të rritjes së popullsisë mbi paqëndrueshmërinë dhe peshoren e fuqisë. Një temë tjetër e rëndësishme, që mungonte në artikull, është përmbledhur në titullin e librit dhe në fjalinë përmbyllëse: “përplasjet e qytetërimeve janë kërcënimi më i madh për paqen botërore, ndërsa një rend ndërkombëtar, i mbështetur në qytetërimet, është garancia më e sigurtë kundër luftës botërore.”

Ky libër nuk synon të jetë një vepër në fushën e shkencave shoqërore. Në vend të kësaj, ai ka për qëllim të jetë një interpretim i evoluimit të politikës globale pas Luftës së ftohtë. Ai synon të paraqesë një kornizë, një paradigmë, për ta vështruar politikën globale në mënyrë që të jetë kuptimplote për studiuesit dhe e dobishme për hartuesit e politikës. Prova e domethënies dhe e dobisë nuk gjendet duke parë nëse ka përfshirë gjithçka ndodh në politikën globale. Është e qartë që këtë nuk e arrin. Prova është a jep, kundrejt cilësdo paradigmë tjetër, një thjerrëz më domethënëse dhe më të dobishme, përmes së cilës mund të vështrohen zhvillimet ndërkombëtare. Për më tepër, dihet se asnjë paradigmë nuk është e

vlefshme përjetësisht. Ndërsa një qëndrim nga pikëpamja e qytetërimit mund të jetë i dobishëm për të kuptuar politikën globale në fund të shekullit të njëzetë dhe në fillim të shekullit të njëzetënjëtë, kjo nuk do të thotë se do të kishte qenë po njësoj i vlefshëm në mes të shekullit të njëzetë, ose se do të jetë i dobishëm në mes të shekullit XXI.

Idetë që kanë dalë në artikull e në këtë libër i kam shprehur për herë të parë në Ligjëratat Bradley në Institutin Amerikan të Sipërmarrjeve në Uashington në tetor 1992, ndërsa pastaj janë parashtruar në një material të përgatitur për projektin e Institutit Olin me temë “Mjedisi i sigurisë në ndryshim dhe interesat kombëtarë të Amerikës”, i cili u mundësua nga Fondacioni Smith Richardson. Pas botimit të artikullit m’u desh të merrja pjesë në një numër pa fund seminaresh e mbledhjesh, që përqendroheshin te “përplasja” me grupet akademike, shtetërore, të biznesit e të tjera nëpër mbarë Shtetet e Bashkuara. Veç kësaj, pata fatin që munda të merrja pjesë në diskutimin e artikullit e të tezave të tij në shumë vende të tjera, ndër to në Argjentinë, Belgjikë, Kinë, Francë, Gjermani, Britani e Madhe, Kore, Japoni, Luksemburg, Rusi, Arabi Saudite, Singapor, Afrikë të Jugut, Spanjë, Suedi, Zvicër dhe Tajvan. Këto diskutime më vunë përballë gjithë qytetërimeve kryesore, me përjashtim të hinduizmit, dhe kam përfituar jashtëzakonisht nga thellimet e perspektivat që kanë paraqitur pjesëmarrësit e këtyre diskutimeve. Më 1994 e 1995 mbajta një seminar në Harvard për natyrën e botës pas Luftës së ftohtë dhe komentet gjithnjë të forta e nganjëherë mjaft kritike të studentëve pjesëmarrës të seminarit shërbyen si nxitje plotësuese. Puna ime për këtë libër ka përfituar mjaft edhe nga mjedisi kolegjal e mbështetës i Institutit të Harvardit John M. Olin për studimet strategjike dhe i Qendrës së Punëve Ndërkombëtare.

Dorëshkrimin e kanë lexuar tërësisht Michael C. Desch, Robert O. Keohane, Fareed Zakaria dhe R. Scott Zimmerman, kurse komentet e tyre sollën përmirësime të ndjeshme si të lëndës, edhe të organizimit të saj. Gjatë gjithë kohës që shkruhej ky libër, Scott Zimmerman-i më ka dhënë gjithashtu ndihmën e domosdoshme për punën kërkimore; pa ndihmën e tij energjike, të specializuar dhe të përkushtuar, ky libër kurrë nuk do të ishte kryer. Ndhmësit tanë studentë, Peter Jun dhe Christina Briggs, gjithashtu kanë marrë pjesë me zell. Grace de Magistris radhiti pjesët e para të dorëshkrimit dhe Carol Edwards-i e ribëri dorëshkrimin me përkushtim të madh dhe frytshmëri të habitshme aq shumë herë, sa duhet t'i dijë pjesë të mëdha të tij pothuaj përmendsh. Denis Shannon dhe Lynn Cox në Georges Borchardt dhe Robert Asahina, Robert Bender e Johanna Li në Simon & Schuster e kanë përcjellë me profesionalizëm dorëshkrimin nëpër procesin e botimit. U jam thellësisht mirënjohës gjithë këtyre njerëzve për ndihmën që dhanë për ta nxjerrë librin në dritë. Ata e kanë bërë të dalë shumë më i mirë sesa do të ndodhte përndryshe, kurse mangësitë që kanë mbetur janë për shkakun tim.

Puna për këtë libër m'u bë e mundur me mbështetjen financiare të Fondacionit John M. Olin dhe të Fondacionit Smith Richardson. Pa ndihmën e tyre, përfundimi i librit do të ishte shtyrë për mjaft vite dhe prandaj e çmoj shumë mbështetjen e tyre bujare për këtë përpjekje. Ndërsa fondacionet e tjera janë përqendruar gjithnjë e më shumë te çështjet e brendshme, Olim dhe Richardson meritojnë një vlerësim fisnik, sepse e kanë ruajtur interesin e tyre dhe mbështetjen për punën në fushën e luftës, paqes e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare.

S. P. H.

I. Një botë qytetërimesh

Kreu 1: Epoka e re në politikën botërore

Hyrje: Flamurët dhe identiteti kulturor

Më 3 janar 1992 në sallën e një ndërtese qeveritare në Moskë u mbajt një takim ndërmjet studiuesve rusë e amerikanë. Vetëm dy javë më parë kishte pushuar së ekzistuari Bashkimi Sovjetik dhe kishte dalë si vend i pavarur Federata Ruse. Si rrjedhim, shtatorja e Leninit, që më parë zbukuronte kreun e sallës, ishte hequr dhe ishte zëvendësuar me flamurin e Federatës Ruse, që tashti ishte shpalosur në murin ballor. Siç e vuri në dukje një amerikan, i vetmi problem që se flamuri ishte varur kokëteposhtë. Pasi kjo iu vu në dukje mikpritësve rusë, ata e ndreqën gabimin menjëherë dhe pa zhurmë, gjatë pushimit të parë.

Vitet pas Luftës së ftohtë qenë dëshmitare të fillimit të ndryshimeve të befasishme në identitetet e popujve e të simboleve të këtyre identiteteve. Politika globale nisi të riformësohej duke iu përshtatur vijave kulturore. Flamurët kokëteposhtë ishin shenjë e tranzicionit, por gjithnjë e më shumë flamurët po valëviten lart e drejt, kurse rusët e popujt e tjerë po mobilizohen dhe po

marshojnë të rreshtuar prapa tyre e prapa simboleve të tjera të identiteteve të reja kulturore.

Më 18 prill 1994 u mbledhën dy mijë veta në Sarajevë, duke valëvitur flamurët e Arabisë Saudite dhe të Turqisë. Duke ngritur lart këta flamurë, në vend të atyre të OKB-së, të NATO-s ose të Amerikës, këta banorë të Sarajevës e njëjtësonin veten me shokët e tyre myslimanë dhe i tregonin gjithë botës se kush ishin miqtë tyre të vërtetë e ata jo aq të vërtetë.

Më 16 tetor 1994 marshuan në Los Anxheles 70.000 njerëz nën një “det flamurësh të Meksikës”, duke protestuar kundër Propozimit 187, i cili me referendum do t’u hiqte shumë përfitime nga shteti imigrantëve ilegalë e fëmijëve të tyre. Vëzhguesit shtruan pyetjen përse ata “dalin në rrugë me flamurin e Meksikës dhe kërkojnë që shteti amerikan t’u japë arsimin falas. Do të duhej që të valëvisnin flamurin amerikan.” Dy javë më pas edhe më shumë protestues marshuan në rrugë, duke mbajtur një flamur amerikan kokëposhtë. Kjo mënyrë e shpalosjes së flamurëve i siguroi fitoren Propozimit 187, i cili u miratua me 59 për qind të votuesve të Kalifornisë.

Në botën pas Luftës së ftohtë flamurët kanë peshë e po ashtu kanë peshë simbolet e tjera të identitetit kulturor, duke përfshirë kryqet, gjysmëhënat, madje edhe mbulesat e kokës, për shkak se kultura ka vlerë dhe identiteti kulturor është gjëja më me rëndësi për shumicën e njerëzve. Njerëzit po zbulojnë identitetet e tyre të reja që janë shpesh ato të vjetrat dhe po marshojnë nën flamurë të rinj por shpesh të vjetër, që çojnë drejt luftërave me armiq të rinj por shpesh të vjetër.

Një *Weltanschauung* (botëvështrim) i zymtë për këtë epokë të re është shprehur mirë nga një demagog nacionalist venecian në romanin e Michael Dibdin-it *Laguna e vdekur*: “Nuk mund të ketë miq të vërtetë pa

armiq të vërtetë. Nëse nuk e urrejmë atë çka nuk jemi, nuk mund ta duam atë çka jemi. Këto janë ato të vërteta të vjetra, që po i zbulojmë me dhimbje pas më shumë se një shekulli të hipokrizisë sentimentale. Ata që i mohojnë këto, mohojnë familjen e tyre, trashëgiminë, kulturën, të drejtat e tyre të lindura, mohojnë vetveten! Këtyre njerëzve nuk do t'ua falin lehtë.” E vërteta e hidhur në këto të vërteta të vjetra nuk mund të shpërfilllet nga pushtetarët dhe studiuesit. Për njerëzit që kërkojnë identitetin dhe e rishpikin përkatësinë etnike, armiqtë janë të qenësishëm dhe armiqësitë më të rrezikshme të mundshme përftohen përgjatë vijave të shkëputjes, ndërmjet qytetërimeve kryesore të botës.

Tema qendrore e këtij libri është se kultura dhe identitetet kulturore, të cilat në nivelin më të gjerë janë identitete të qytetërimeve, janë ato që u japin trajtë modeleve të kohezionit, shpërbërjes dhe konfliktit në botën pas Luftës së ftohtë. Pesë pjesët e këtij libri trajtojnë këto rrjedhime prej mendimit kryesor:

Pjesa I: Për herë të parë në histori politika shfaqet me shumë pole dhe me shumë qytetërime; modernizimi dallohet prej perëndimorizimit dhe nuk është duke sjellë as qytetërim universal në çfarëdo kuptimi qoftë, as perëndimorizimin e shoqërive joperëndimore.

Pjesa II: Peshorja e fuqisë ndërmjet qytetërimeve po zhvendoset: Perëndimit po i bie ndikimi relativ; qytetërimet aziatike janë duke e zgjeruar fuqinë e tyre ekonomike, ushtarake dhe politike; Islami po përjeton një shpërthim demografik me pasoja destabilizuese për vendet myslimane dhe fqinjët e tyre, kurse qytetërimet joperëndimore përgjithësisht po e riafirmojnë vlerën e kulturës së vet.

Pjesa III: Po përftohet një rend botëror, i mbështetur në qytetërimet: shoqëritë që kanë afëri kulturore, bashkëpunojnë mes tyre; përpjekjet për t'i

zhvendosur shoqëritë nga një qytetërim në tjetrin nuk kanë sukses, ndërsa vendet grumbullohen rreth shteteve udhëheqëse ose bërthamë të qytetërimit të tyre.

Pjesa IV: Mëtimet universaliste të Perëndimit gjithnjë e më shumë po e fusin në konflikt me qytetërimet e tjera, në formën më të rëndë me Islamin dhe Kinën; në nivel lokal luftërat në vijën e shkëputjes, më së shumti ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve, shkaktojnë 'tubimin sipas vendit me lidhje afërie', kërcënimin e një përshkallëzimi më të gjerë dhe, si rrjedhim, përpjekjet e shteteve bërthamë për t'i ndaluar këto luftëra.

Pjesa V: Mbijetesa e Perëndimit varet nga riafirmimi prej amerikanëve i identitetit të tyre Perëndimor dhe nga pranimi prej Perëndimorëve se qytetërimi i tyre është unik por jo universal, dhe se duhet të bashkohen për përtëritjen e mbrojtjen e tij ndaj sfidave prej shoqërive joperëndimore. Shmangia e një lufte globale të qytetërimeve varet nga udhëheqësit e botës, që të pranojnë dhe të bashkëpunojnë për të ruajtur natyrën me shumë qytetërimet të politikës globale.

Botë me shumë pole dhe shumë qytetërimet

Në botën pas Luftës së ftohtë për herë të parë në histori politika globale u bë shumëpolëshe dhe me shumë qytetërimet. Gjatë pjesës më të madhe të ekzistencës së njeriut, kontaktet ndërmjet qytetërimeve kanë qenë të rralla ose nuk ka pasur fare. Pastaj, me fillimin e epokës së re, rreth vitit 1500 e.r., politika globale mori dy përmasa. Për afër 400 vjet shtetet kombe të Perëndimit: Britania, Franca, Spanja, Austria, Prusia, Gjermania,

Shtetet e Bashkuara dhe të tjerat, ndërtuan një sistem ndërkombëtar shumëpolësh brenda qytetërimit Perëndimor dhe bashkëvepruan, rivalizuan e luftuan me njëra-tjetrën. Në të njëjtën kohë shtetet Perëndimore edhe u zgjeruan, pushtuan, kolonizuan ose ndikuan në mënyrë vendimtare mbi cilindo qytetërim tjetër (Harta 1.1). Gjatë Luftës së ftohtë politika globale u bë dypolëshe dhe bota ishte e ndarë në tri pjesë. Një grup i shoqërive kryesisht të pasura e demokratike, të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara, ishte i përfshirë në një luftë të gjithanshme ideologjike, politike e ekonomike dhe, herë pas here, në garën ushtarake me grupin e shoqërive komuniste në një farë mase më të varfra, të lidhura dhe të udhëhequra nga Bashkimi Sovjetik. Pjesa më e madhe e këtij konflikti ndodhi jashtë të dy kampeve, në Botën e Tretë, të përbërë nga shtete që shpesh ishin të varfra, u mungonte qëndrueshmëria politike, e kishin fituar pavarësinë kohët e fundit dhe mëtonin se ishin të paangazhuara. (Harta 1.2).

Nga fundi i viteve 1980 bota komuniste u shemb dhe sistemi ndërkombëtar i Luftës së ftohtë i kaloi historisë. Në botën pas Luftës së ftohtë dallimet më të rëndësishme ndërmjet popujve nuk janë ideologjike, politike ose ekonomike. Ato janë kulturore. Popujt dhe shtetet po përpiqen t'i përgjigjen pyetjes më themelore, me të cilën mund të ballafaqohen njerëzit: Kush jemi ne? Dhe ata po i përgjigjen kësaj pyetjeje në mënyrën tradicionale, me të cilën i janë përgjigjur njerëzit, duke iu drejtuar gjërave që kanë më shumë vlerë për ta. Njerëzit e përcaktojnë veten nga pikëpamja e paraardhësve, besimit, gjuhës, historisë, vlerave, zakoneve dhe institucioneve. Ata njëjtësohen me grupet kulturore: fiset, grupet etnike, bashkësitë fetare, kombet dhe, në nivelin më të gjerë, me qytetërimet. Njerëzit e përdorin

politikën jo thjesht për të përmbushur interesat e tyre, por edhe për të përcaktuar identitetin e tyre. Ne mund ta dimë se kush jemi, vetëm kur e dimë se kush nuk jemi dhe shpesh vetëm kur e dimë se kundër kujt jemi.

Shtetet-kombe mbeten aktorët kryesorë në punët e botës. Mënyra e sjelljes së tyre formësohet si edhe në të kaluarën duke synuar pushtetin e pasurinë, por merr trajtë gjithashtu nga parapëlqimet kulturore, nga përbashkësitë dhe dallimet. Grupimet më të rëndësishme të shteteve nuk janë më tre blloqet e Luftës së ftohtë, por më tepër shtatë ose tetë qytetërimet më të mëdha të botës (Harta 1.3). Shoqëritë joperëndimore, sidomos në Azinë Lindore, po zhvillojnë pasurinë e tyre ekonomike dhe po krijojnë bazat për forcimin e fuqisë ushtarake e të ndikimit politik. Ndërkohë që rriten fuqia dhe vetëbesimi i tyre, shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më tepër ngulitin vlerat e veta kulturore dhe hedhin poshtë ato “të imponuara” nga Perëndimi. Henri Kisingeri kishte vënë në dukje se “sistemi ndërkombëtar i shekullit të njëzetënjëtë ...do të përmbajë të paktën gjashtë fuqi të mëdha: Shtetet e Bashkuara, Europën, Kinën, Japoninë, Rusinë e, ka gjasa, edhe Indinë.”¹ Gjashtë fuqitë kryesore të Kisingerit u përkasin pesë qytetërimeve shumë të ndryshme dhe, përveç kësaj, ka shtete të rëndësishme islamike, pozita strategjike e të cilave, popullsia e madhe në numër dhe/ose burimet e naftës i bëjnë të kenë ndikim në punët e botës. Në këtë botë të re, politika lokale është politikë e etnicitetit; politika globale është politikë e qytetërimeve. Rivaliteti ndërmjet superfuqive është zëvendësuar nga përplasja e qytetërimeve.


Harta 1.1: Perëndimi dhe pjesa tjetër: 1920

Perëndimi dhe pjesa tjetër: 1920



Harta 1.2: Bota e Luftës së ftohtë: vitet 1960


Bota e Luftës së ftohtë: vitet 1960



Harta 1.3:

Bota e qytetërimeve: pas vitit 1990

Bota e qytetërimeve: pas vitit 1990



Në këtë botë të re konfliktet më të rëndësishme, të kudogjendura dhe më të rrezikshme nuk do të jenë ndërmjet klasave shoqërore, të pasurve e të varfërve, ose midis grupeve të tjera të përcaktuara nga ana ekonomike, por ndërmjet popujve që u përkasin tërësive kulturore të ndryshme. Luftërat ndërfisnore dhe konfliktet etnike do të ndodhin brenda qytetërimeve. Dhuna ndërmjet shteteve e grupeve qytetërimesh të ndryshme, megjithatë, bart me vete mundësinë e shkallëzimit, pasi shtetet dhe grupet e tjera prej këtyre qytetërimeve tubohen për të mbështetur “vendet në afëri me to”.² Përleshjet e përgjakshme të fiseve në Somali nuk përbëjnë ndonjë kërcënim për të kaluar në konflikt më të gjerë. Përleshjet e përgjakshme të fiseve në Ruandë kanë pasoja për Ugandën, Zairen e Burundin, por nuk shkojnë më tutje. Përplasjet e përgjakshme të

qytetërimeve në Bosnjë, Kaukaz, në Azinë Qendrore ose në Kashmir mund të bëheshin luftëra më të mëdha. Gjatë konflikteve në Jugosllavi Rusia u dha mbështetje diplomatike serbëve, kurse Arabia Saudite, Turqia, Irani dhe Libia u dhanë fonde e armë bosnjakëve jo për arsye të ideologjisë, a të pushtetit politik ose të interesit ekonomik, por për shkak të afërisë kulturore. Siç ka vënë në dukje Vaclav Haveli, “Konfliktet kulturore janë duke u shtuar dhe sot janë më të rrezikshme sesa kanë qenë në çfarëdo periudhë tjetër të historisë”, ndërsa Jacques Delors-i (Zhak Delor) ishte i një mendjeje, se “Konfliktet e ardhshme do të ndizen nga faktorët kulturorë dhe jo nga ekonomia ose ideologjia.”³ Kurse konfliktet kulturore më të rrezikshme janë ato që ndodhin përgjatë vijave të shkëputjes ndërmjet qytetërimeve.

Në botën pas Luftës së ftohtë kultura është forcë njëkohësisht si ndarëse, ashtu edhe bashkuese. Njerëzit e përçarë nga ideologjia, por të bashkuar prej kulturës, lidhen bashkë, ashtu siç bënë dy Gjermanitë dhe ashtu si kanë nisur të bëjnë dy Koretë e disa Kinat. Shoqëritë e bashkuara nga ideologjia a nga rrethanat historike, por të përçara nga qytetërimi, ose copëtohen, siç ndodhi me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë e Bosnjën, ose vuajnë nga tensione të fuqishme, siç është rasti me Ukrainën, Nigerinë, Sudanin, Indinë, Sri Lankën dhe shumë vende të tjera. Shtetet me afëri kulturore bashkëpunojnë ekonomikisht e politikisht. Organizatat ndërkombëtare të mbështetura në shtetet me përbashkësi kulturore, si Bashkimi Europian, kanë shumë më tepër sukses, sesa ato që përpiqen t'i sipërkalojnë kulturat. Për dyzet e pesë vjet Perdja e hekurt ka qenë vija ndarëse qendrore në

³ Termi ‘shkëputje’ në këtë libër është përdorur nga autori në kuptimin gjeologjik: shkëputje tektonike, hedhje. (Shën. i përkth.)

Europë. Kjo vijë është zhvendosur disa qindra kilometra më në lindje. Tashti ajo është vija që ndan popujt e krishterimit perëndimor, nga njëra anë, prej popujve myslimanë e ortodoksë, nga ana tjetër.

Parimet filozofike, që qëndrojnë në themel të vlerave, të marrëdhënieve shoqërore, zakoneve dhe botëvështrimit të përgjithshëm rreth jetës, dallohen thellë ndërmjet qytetërimeve. Rigjallërimi i fesë në pjesën më të madhe të botës po i përforcon këto dallime kulturore. Kulturat mund të ndryshojnë, ndërsa natyra e ndikimit të tyre mbi politikën dhe ekonominë mund të jetë me variacione prej një periudhe në tjetrën. Megjithatë, dallimet kryesore në zhvillimin politik dhe ekonomik në mes të qytetërimeve duket se i kanë rrënjët në kulturat e tyre të ndryshme. Suksesi ekonomik i Azisë Lindore e ka burimin te kultura e Azisë Lindore, po ashtu si vështirësitë që kanë këto shoqëri për arritjen e sistemeve politike të qëndrueshme dhe demokratike. Kultura islamike shpjegon në masë të ndjeshme përse nuk ka arritur të shfaqet demokracia në pjesën më të madhe të botës islame. Zhvillimet në shoqëritë paskomuniste të Europës Lindore dhe në ish Bashkimin Sovjetik përcaktohen nga identitetet e tyre qytetërimore. Ato me trashëgimi perëndimore të krishterë po përparojnë drejt zhvillimit ekonomik dhe politikës demokratike; në shtetet ortodokse perspektiva për zhvillimin politik dhe ekonomik është e pasigurtë; perspektivat në republikat islamike janë të zbehta.

Perëndimi është e do të mbetet për vitet e ardhshme qytetërimi më i fuqishëm i botës. Megjithatë, fuqia e tij është duke rënë, krahasuar me qytetërimet e tjera. Meqë Perëndimi përpiqet t'i mbajë vlerat dhe t'i mbrojë interesat e vet, shoqëritë joperëndimore ndodhen përballë nevojës që të gjejnë zgjidhje. Disa përpiqen ta imitojnë Perëndimin dhe t'i bashkangjiten ose të "bëhen

një” me të. Shoqëritë e tjera konfuciane dhe islamike përpiqen të rrisin fuqinë ekonomike e ushtarake, në mënyrë që t’i bëjnë qëndresë dhe të arrijnë ‘baraspeshën’ me Perëndimin. Kështu, një bosht qendror i politikës botërore pas Luftës së ftohtë është bashkëveprimi i fuqisë dhe kulturës perëndimore me fuqinë dhe kulturën e qytetërimeve joperëndimore.

Shkurt, bota pas Luftës së ftohtë është bota e shtatë ose tetë qytetërimeve kryesore. Përbashkësitë dhe dallimet kulturore u japin formën interesave, antagonizmave dhe grupimeve të shteteve. Vendet më të rëndësishme në botë vijnë më së shumti prej qytetërimesh të ndryshme. Konfliktet lokale, të cilat ka më shumë të ngjarë të shkallëzohen e të kthehen në luftëra më të gjera, janë ato ndërmjet grupeve e shteteve prej qytetërimesh të ndryshme. Modelet mbizotëruese të zhvillimit politik dhe ekonomik ndryshojnë nga njëri qytetërim në tjetrin. Çështjet kyçe në rendin e ditës ndërkombëtar përfshijnë dallimet mes qytetërimeve. Nga qytetërimi Perëndimor, mbisundues për një kohë të gjatë, fuqia është duke kaluar te qytetërimet joperëndimore. Politika globale është bërë shumëpolëshe dhe shumëqytetërimore.

Botë të tjera?

Hartat dhe paradigmat. Kjo tablo e politikës në botën pas Luftës së ftohtë, e formësuar nga faktorët kulturorë dhe duke përfshirë ndërveprimet midis shteteve e grupeve prej qytetërimesh të ndryshme, është shumë e thjeshtësuar. Shumë gjëra ajo i lë jashtë, disa i shtrembëron dhe të tjerat i errëson. Megjithatë, po të

mendojmë seriozisht për botën dhe po të veprojmë efektivisht në të, janë të domosdoshme një farë harte e thjeshtësuar e realitetit, një lloj teorie, koncepti, modeli, paradigme. Siç ka thënë William James-i (Uiljam Xhejms), pa konstrukte të tilla mendore do të ketë vetëm “një pështjellim të madh e të zhurmshëm.” Në veprën klasike *The Structure of Scientific Revolution* (Struktura e revolucionit shkencor) Thomas Kuhn-i (Tomas Kun) ka treguar se përparimi intelektual e shkencor përbëhet nga zëvendësimi i një paradigme, e cila ishte bërë gjithnjë e më shumë e paaftë t’i shpjegonte faktet e reja ose të zbuluara sërish, me një paradigmë të re, e cila i trajton këto fakte në mënyrë më të kënaqshme. “Që të pranohet si paradigmë, - ka shkruar Kuni, - një teori duhet të duket më e mirë se rivalët e tjera, por ajo nuk ka nevojë, dhe në të vërtetë asnjëherë nuk e arrin, që t’i shpjegojë të gjitha faktet me të cilat mund të ballafaqohet.”⁴ Edhe John Lewis Gaddis-i (Xhon Luis Gadis) me mençuri ka vënë në dukje: “Përgjithësisht, për të gjetur rrugën në një terren të panjohur kërkohet ndonjë hartë. Hartografia, ashtu si vetë njohja, detyrimisht është një farë thjeshtësimi, i cili na mundëson të shohim se ku jemi dhe ku mund të shkojmë.” Imazhi i garës së superfuqive gjatë Luftës së ftohtë, siç e vë në dukje ai, që një model i tillë, të cilin i pari Harri Trumani e përcaktoi si “një ushtrim në gjeopolitikën hartografike, që e përshkruante peizazhin ndërkombëtar në mënyrën që ta kuptonte kushdo, dhe kështu përgatiti rrugën për strategjinë e ndërlikuar të frenimit, e cila e ndoqi pas pak kohësh.” Botëvështrimet dhe teoritë shkakësore janë udhërrëfyese të domosdoshme për politikën ndërkombëtare.⁵

Për dyzet vjet studiuesit dhe vepruesit në marrëdhëniet ndërkombëtare kanë menduar e vepruar sipas koncepteve të paradigmës së çështjeve botërore të

Luftës së ftohtë, tepër të thjeshtësuar por shumë të dobishme. Kjo paradigmë nuk mund të përfshinte gjithçka ndodhte në politikën ndërkombëtare. Po të përdorim termin e Kunit, pati shumë anomali dhe në disa periudha kohore paradigma i verboi studiuesit e burrat e shtetit aq sa të mos shihnin ndodhitë e mëdha, siç ishte përçarja kino-sovjetike. Megjithatë, si model i thjeshtë i politikës globale për shumë dukuri nga më të rëndësishmet, ajo vlente më tepër se cilado prej rivaleve të saj, ishte një pikënisje e qenësishme për të menduar rreth çështjeve ndërkombëtare, madje u pranua pothuaj universalisht dhe formësoi të menduarit mbi politikën botërore për dy brezni me radhë.

Paradigmat ose hartat e thjeshtësuara janë të pazëvendësueshme për të menduarit dhe veprimin e njeriut. Nga njëra anë, teoritë ose modelet mund t'i formulojmë të shprehura hapur dhe t'i përdorim me vetëdije për të na udhëhequr sjelljen. Anasjelltas, edhe mund ta mohojmë nevojën për udhërrëfyes të tillë e të pranojmë, se do të veprojmë vetëm sipas konceptit të fakteve përkatëse 'objektive', duke u marrë me secilin rast 'sipas meritave të tij'. Mirëpo, nëse bëjmë kështu, do të zhgënjehemi. Arsyeja është se në thellësi të mendjes sonë fshihen paramendime, anësi e paragjykime, të cilat përcaktojnë sesi e perceptojmë realitetin, çfarë faktesh vështrojmë dhe si i gjykojmë rëndësinë e meritat e tyre. Ne kemi nevojë për modele të hapura ose të nënkuptuara që të jemi të aftë:

1. të gjejmë rregullsitë dhe të bëjmë përgjithësime rreth realitetit;
2. të kuptojmë marrëdhëniet shkakësore ndërmjet dukurive;
3. t'u dalim përpara dhe, nëse kemi fat, t'i parashikojmë zhvillimet e ardhshme;

4. të dallojmë çka është e rëndësishme prej asaj që është e parëndësishme; dhe

5. të tregojmë cilat rrugë duhet të ndjekim për të arritur synimet tona.

Çfarëdo modeli ose harte përbën një abstraktim dhe për disa synime del më me dobi, sesa për disa të tjera. Harta e rrugës na tregon sesi të udhëtojmë nga pika A në B, por nuk është e shumë e dobishme nëse jemi duke drejtuar një aeroplan e në këtë rast do të na duhej një hartë, që paraqet aeroportet, pikat e radiosinjaleve, korridoret e fluturimit dhe topografinë. Megjithatë, pa asnjë hartë është e qartë se do ta humbisnim rrugën. Sa më e hollësishme është harta, aq më të plotë e pasqyron realitetin. Një hartë tepër e hollësishme, megjithatë, për shumë qëllime nuk do të ishte e dobishme. Nëse dëshirojmë të shkojmë nga një qytet i madh në tjetrin me autostradë, nuk kemi nevojë e madje mund të na ngatërrojnë një hartë, e cila përmban shumë informacione pa lidhje me udhëtimin automobilistik e në të cilën autostradat kryesore humbasin brenda masës së ndërlikuar të rrugëve dytësore. Nga ana tjetër, një hartë që ka vetëm autostradën, do të linte jashtë mjaft gjëra të realitetit dhe do ta kufizonte aftësinë tonë për të gjetur rrugë të tjera, në rast se rruga kryesore do të bllokohej prej një aksidenti të rëndë. Shkurt, na nevojitet një hartë që edhe e paraqet realitetin, edhe e thjeshtëson në mënyrën që u shërben më mirë synimeve tona. Nga fundi i Luftës së ftohtë kishin dalë një varg hartash dhe paradigماش të politikës botërore.

Një botë: euforia dhe harmonia. Një paradigmë e parashtruar gjerësisht ka qenë e mbështetur në mendimin, se me përfundimin e Luftës së ftohtë merrte fund edhe konflikti i madh në politikën globale dhe do të përftohej një botë relativisht e harmonishme.

Formulimi më i diskutuar i këtij modeli ka qenë teza e “fundit të historisë”, e paraqitur prej Fransis Fukujamës.⁵ “Ne ndoshta jemi të pranishëm, - ka theksuar Fukujama, - në fundin e historisë si të tillë: domethënë, të pikës së fundit të evoluimit ideologjik të njerëzimit dhe në universalizimin e demokracisë liberale Perëndimore si forma përfundimtare e qeverisjes njerëzore.” Për të qenë më të përpiktë, ka thënë ai, disa konflikte edhe mund të ndodhin në disa vende të Botës së Tretë, por konflikti global ka marrë fund dhe jo vetëm në Europë. “Pikërisht në botën joeuropiane” kanë ndodhur ndryshimet më të mëdha, sidomos në Kinë e në Bashkimin Sovjetik. Luftës së ideve i ka ardhur fundi. Ithtarë të marksizëm-leninizmit mund të ketë ende “në vende si Managua, Pheniani dhe Kembrixhi, Masaçusetsi”, por ka ngadhënjyer demokracia liberale e përbotshme. E ardhmja nuk do t’u përkushtohet më betejave ngazëllyese rreth ideve, por më tepër zgjidhjeve të problemeve ekonomike e teknike të kësaj bote tokësore. Dhe ai ka ardhur në përfundimin mjaft të pikëlluar, se gjithçka do të jetë mjaft e mërzitshme.⁶

Shpresa se do të vinte harmonia ka qenë shumë e përhapur. Udhëheqësit politikë dhe intelektualë kanë përpunuar pikëpamje të ngjashme me këtë. Muri i Berlinit u rrëzua, regjimet komuniste u shembën, Kombet e Bashkuara morën rëndësi tjetër, ish rivalët e Luftës së ftohtë hynë në “partneritet” dhe në “ujdinë e madhe”, rendin e ditës do ta përbënin paqeruajtja dhe paqebërja. Presidenti i shtetit kryesor të botës shpalli “rendin e ri botëror”; rektori i një universiteti, që

⁵ Një drejtim tjetër paralel, që mbështetet jo te fundi i Luftës së ftohtë, por te prijet ekonomike e shoqërore afatgjata, të cilat përftojnë një “qytetërim universal”, diskutohet në kreun 5.

mbahet si më i pari i botës, nuk pranoi të emërohej një profesor i studimeve për sigurinë, sepse ishte zhdukur nevoja për këtë. “Alilluja! Nuk do ta studiojmë më luftën, sepse nuk do të ketë më luftë.”

Momenti i euforisë në përfundimin e Luftës së ftohtë lindi iluzionin e harmonisë, i cili shpejt doli se ishte pikërisht iluzion. Në fillim të viteve 1990 bota u bë e ndryshme, por jo edhe domosdo më paqësore. Ndryshimi ishte i pashmangshëm, por përparimi nuk qe i tillë. Iluzione të ngjashme për harmoninë patën lulëzuar, për periudha të shkurtra, pas përfundimit të secilit konflikt të madh të shekullit të njëzetë. Lufta e Parë Botërore ishte “lufta që u jepte fund luftërave” dhe që do ta bënte botën të sigurtë për demokracinë. Lufta e Dytë Botërore, siç e ka shprehur Franklin Ruzvelti, do t’u “jepte fund sistemit të veprimeve të njëanshme, aleancave përjashtuese, ekuilibrit të forcave dhe të gjitha mënyrave të tjera, të cilat ishin përdorur gjatë shekujve e gjithmonë kishin dështuar”. Në vend të kësaj, do të kemi “një organizatë universale” të “shteteve paqedashëse” dhe fillimet e “strukturës së përhershme të paqes.”⁷ Mirëpo Lufta e Parë solli komunizmin, fashizmin dhe prirja prej një shekulli drejt demokracisë u kthye mbrapsht. Lufta e Dytë Botërore përftoi Luftën e ftohtë, e cila ishte vërtet globale. Me mbarimin e Luftës së ftohtë iluzioni i harmonisë pas pak kohësh u prish prej shumëfishimit të konflikteve etnike dhe “spastrimit etnik”, prej rënies së ligjit e të rendit, me shfaqjen e modeleve të reja të aleancave dhe të konflikteve mes shteteve, me ringjalljen e lëvizjeve neokomuniste e neofashiste, me fuqizimin e fundamentalizmit fetar, me fundin e “diplomacisë së buzëqeshjeve” dhe të “politikës së *po-së*” në marrëdhëniet e Ruisë me Perëndimin, me paaftësinë e Kombeve të Bashkuara dhe të Shteteve të Bashkuara për të ndalur konfliktet e

përgjakshme lokale, si dhe me ngulmimin gjithnjë në rritje të Kinës për t'u afirmuar. Në pesë vitet pas rënies së Murit të Berlinit, fjala "gjenocid" është dëgjuar më shpesh sesa në cilindo pesëvjetësh të kohës së Luftës së ftohtë. Paradigma e botës së harmonishme është qartas tepër e shkëputur nga realiteti dhe nuk ka si të jetë një udhërrëfyes i dobishëm për botën pas Luftës së ftohtë.

Dy botë: Ne dhe Ata. Ndërsa shpresat për një botë shfaqen me përfundimin e konflikteve të mëdha, prireja për të menduar sipas konceptit të dy botëve na del e përsëritur gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Njerëzit gjithmonë joshen t'i ndajnë njerëzit në Ne dhe Ata; në ata brenda grupit dhe në të tjerët; në qytetërimin tonë dhe të atyre barbarëve. Studiuesit e kanë analizuar botën duke përdorur konceptet Orienti dhe Oksidenti, Veriu dhe Jugu, qendra dhe periferia. Tradicionalisht myslimanët e kanë ndarë botën në *Dar al-Islam* dhe *Dar al-Harab*, në banesën e paqes dhe banesën e luftës. Kjo ndarje u pasqyrua, dhe në një farë kuptimi u përmbys, me përfundimin e Luftës së ftohtë, nga studiuesit amerikanë, të cilët e ndanë botën në "zonat e paqes" dhe në "zonat e trazirave". Të parat përfshinin Perëndimin e Japoninë me afërsisht 15 për qind të popullsisë së botës, të dytat të gjitha vendet e tjera.⁸

Varësisht nga mënyra sesi përcaktohen pjesët, tabloja e botës prej dy pjesësh deri diku mund të përputhet me realitetin. Ndarja më e zakonshme, e cila del me emra të ndryshëm, është ndërmjet vendeve të pasura (moderne, të zhvilluara) dhe të varfra (tradicionale, të pazhvilluara ose në zhvillim). Historikisht me këtë ndarje ekonomike bashkëlidhet ndarja kulturore në mes Perëndimit e Lindjes, ku theksi bie më pak te mirëqenia ekonomike dhe më shumë te ndryshimet në filozofinë, vlerat e mënyrën e jetesës, që janë në themel të tyre.⁹ Secili nga këto imazhe pasqyron

disa elementë, por përsëri vuan prej kufizimeve. Shtetet e pasura moderne zotërojnë karakteristika të përbashkëta, që i dallojnë prej shteteve të varfra tradicionale, të cilat po ashtu kanë tipare të përbashkëta. Dallimet e mirëqenies mund të çojnë në konflikte mes shoqërive, por dëshmitë tregojnë se kjo ndodh para së gjithash kur shoqëritë e pasura e më të fuqishme përpiqen t'i pushtojnë e t'i kolonizojnë shoqëritë e varfra dhe më tradicionale. Perëndimi e ka bërë këtë gjatë katërqind vjetëve, por pastaj disa prej kolonive ngritën krye e nisën luftërat për çlirim kundër fuqive kolonialiste, të cilat ndoshta e humbën dëshirën për perandori. Në botën e sotme u bë shkolonizimi dhe luftërat koloniale për çlirim janë zëvendësuar prej konflikteve ndërmjet popujve të çliruar.

Në një rrafsh më të përgjithshëm, ka pak gjasa të ndodhin konflikte ndërmjet të pasurve e të varfërve, me përjashtim të rrethanave të posaçme, pasi shteteve të varfra u mungojnë uniteti politik, fuqia ekonomike dhe aftësitë ushtarake për t'iu kundërvënë shteteve të pasura. Zhvillimi ekonomik në Azi dhe në Amerikën Latine po e megjullon ndarjen e thjeshtë më dysh mes atyre që kanë dhe atyre që nuk kanë. Shtetet e pasura mund të bëjnë luftëra tregtare ndërmjet tyre; shtetet e varfra mund të bëjnë luftëra të dhunshme me njëri-tjetrin, por një luftë klasore ndërkombëtare mes Jugut të varfër dhe Veriut të pasur është pothuaj po aq larg realitetit, sa edhe një botë e harmonishme e lumtur.

Bigëzimi kulturor i ndarjes së botës është edhe më pak i dobishëm. Deri diku Perëndimi është një tërësi. Megjithatë, çfarë kanë të përbashkët shoqëritë joperëndimore tjetër, veç faktit se janë joperëndimore? Qytetërimet japonez, kinez, hindu, mysliman dhe afrikan kanë pak gjëra të përbashkëta nga ana fetare, e strukturës shoqërore, e institucioneve dhe e vlerave mbizotëruese.

Uniteti i joperëndimit dhe dihotomia Lindje-Perëndim janë mite të krijuara nga Perëndimi. Këto mite vuajnë nga cenet e Orientalizmit, të cilat me të drejtë i ka kritikuar Eduard Saidi, sepse nxitin “dallimet ndërmjet asaj që është e familjes sonë (Europës, Perëndimit, “ne”) dhe të huajës (Orientit, Lindjes, “atyre”), si dhe sepse e nënkuptojnë epërsinë e brendshme të së parës kundrejt së dytës.¹⁰ Gjatë Luftës së ftohtë bota ishte në masë të ndjeshme e polarizuar sipas spektrit ideologjik. Mirëpo nuk ka ndonjë spektër kulturor të vetëm. Polarizimi kulturor i “Lindjes” dhe “Perëndimit” pjesërisht është një pasojë tjetër e praktikës universale por fatkeqe për ta quajtur qytetërimin europian si qytetërim Perëndimor. Në vend të “Lindja dhe Perëndimi” është më e përshtatshme të flitet për “Perëndimi dhe pjesa tjetër”, që së paku nënkupton ekzistencën e shumë joperëndimeve. Bota është shumë më e ndërlikuar dhe për shumicën e qëllimeve nuk mund të përfytyrohet me dobi si thjesht e ndarë ekonomikisht ndërmjet Veriut e Jugut, ose kulturalisht ndërmjet Lindjes e Perëndimit.

184 shtete, pak a shumë. Një hartë e tretë e botës pas Luftës së ftohtë rrjedh nga çka shpesh quhet teoria “realiste” e marrëdhënieve ndërkombëtare. Sipas kësaj teorie, shtetet janë aktorët parësorë, madje në të vërtetë të vetmit me rëndësi në punët e botës, ndërsa marrëdhëniet ndërmjet shteteve janë në anarki, kështu që për të garantuar sigurinë dhe mbijetesën e tyre, shtetet kurdoherë përpiqen ta rrisin sa më shumë fuqinë e vet. Nëse një shtet vëren se shteti tjetër po e shton fuqinë e, rrjedhimisht, po bëhet kërcënim i mundshëm për të, atëherë përpiqet ta mbrojë sigurinë me rritjen e fuqisë së vet dhe/ose hyn në aleanca me shtete të tjera. Interesat e veprimet e pak a shumë 184 shteteve të botës pas Luftës së ftohtë mund të parashikohen sipas këtyre pohimeve.¹¹

Kjo tablo “realiste” e botës është një pikënisje shumë e vlefshme për të analizuar çështjet ndërkombëtare dhe shpjegon mjaft nga qëndrimet shtetërore. Shtetet janë dhe do të mbeten entitete mbizotëruese në punët e botës. Ato mbajnë ushtri, bëjnë diplomaci, bisedojnë për marrëveshjet, zhvillojnë luftërat, kontrollojnë organizatat ndërkombëtare, ndikojnë dhe në masë të ndjeshme përcaktojnë prodhimin e tregtinë. Qeveritë e shteteve i japin përparësi arritjes së sigurisë së jashtme të shteteve të tyre (ndonëse shpesh mund t’i japin përparësi arritjes së sigurisë si qeveri kundër kërcënimit të brendshëm). Kudo e kurdo kjo paradigmë e shtetit të përqendruar na jep një udhërrëfyes për politikën globale dhe një tablo më realiste sesa paradigmat e një apo dy botëve.

Megjithatë, edhe kjo vuan nga kufizime të rënda.

Kjo e quan se të gjitha shtetet në të njëjtën mënyrë i perceptojnë interesat e vet dhe në të njëjtën mënyrë veprojnë. Pohimi i thjeshtë i saj se fuqia përbën gjithçka, është pikënisja për të kuptuar funksionimin e shtetit, por nuk na shpie shumë larg. Shtetet i përcaktojnë interesat e tyre nga pikëpamja e fuqisë, por edhe nga shumë anë të tjera veç kësaj. Natyrisht, shtetet shpesh përpiqen ta baraspeshojnë fuqinë, por nëse kjo do të ishte gjithçka bëjnë, atëherë shtetet e Europës Perëndimore do të ishin me Bashkimin Sovjetik kundër Shteteve të Bashkuara nga fundi i viteve 1940. Shtetet reagojnë para së gjithash kundër kërcënimeve që ndiejnë dhe shtetet europiane perëndimore në atë kohë e shihnin se kërcënimi politik, ideologjik e ushtarak u vinte nga Lindja. I shihnin interesat e vet në një mënyrë, që nuk mund të parashikohej prej teorisë realiste klasike. Vlerat, kultura dhe institucionet ndikojnë fort mbi mënyrën sesi shtetet i përcaktojnë interesat e vet. Gjithashtu interesat e shteteve formësohen jo vetëm nga vlerat e institucionet

e brendshme, por edhe nga normat e institucionet ndërkombëtare. Mbi përkujdesin e tyre parësor për sigurimin dhe përtej tij, tipa të ndryshëm shtetesh i përcaktojnë interesat në mënyra të ndryshme. Shtetet me kulturë dhe institucione të ngjashme do të shohin interesin e përbashkët. Shtetet demokratike kanë gjëra të përbashkëta me shtetet e tjera demokratike, kështu që nuk luftojnë kundër njëri-tjetrit. Kanadaja nuk ka përse të lidhet me një fuqi tjetër për të parandaluar sulmin nga Shtetet e Bashkuara.

Në nivelin bazë, pohimet e paradigmës etatiste kanë qenë të vërteta përgjatë historisë. Kështu, sot nuk na ndihmojnë të kuptojmë sesi politika globale pas Luftës së ftohtë ndryshon nga politika globale gjatë dhe para Luftës së ftohtë. E megjithatë, ka dallime të qarta dhe shtetet nga një periudhë historike në tjetrën i ndjekin ndryshe interesat e vet. Në botën pas Luftës së ftohtë shtetet gjithnjë e më tepër po i përcaktojnë interesat nga pikëpamja e qytetërimit. Ato bashkëpunojnë dhe bëjnë aleanca me shtetet që kanë kulturë të ngjashme ose të njëjtë, si dhe janë më shpesh në konflikt me shtete që kanë kulturë të ndryshme prej tyre. Shtetet i përcaktojnë kërcënimet në bazë të synimeve të shteteve të tjera dhe këto synime, si edhe mënyra e perceptimit të tyre, formësohen fuqishëm prej këndvështrimit kulturor. Publiku dhe burrat e shtetit ka pak të ngjarë që ta shohin se kërcënimet u vijnë prej njerëzish, të cilët e ndiejnë se i kuptojnë dhe mund t'u besojnë për arsye të gjuhës, fesë, vlerave, institucioneve e kulturës së përbashkët. Ka më shumë të ngjarë që kërcënimet t'u vijnë prej shteteve, shoqëritë e të cilave kanë kultura të ndryshme e, rrjedhimisht, nuk i kuptojnë dhe e ndiejnë se nuk mund t'u zënë besë. Sot kur Bashkimi Sovjetik marksist-leninist nuk përbën më rrezik për Botën e Lirë dhe Shtetet e Bashkuara nuk përbëjnë më kërcënim

ballafaques për botën komuniste, vendet nga të dyja botët përherë e më shumë po i shohin se kërcënimet u vijnë prej shoqërive të ndryshme nga ana kulturore.

Ndërkohë që shtetet mbeten aktorët kryesorë në punët ndërkombëtare, ato edhe pësojnë humbje nga sovraniteti, funksionet e fuqia. Institucionet ndërkombëtare tani kanë marrë të drejtën të gjykojnë dhe t'u vënë kufizime shteteve për çka bëjnë brenda territoreve të veta. Në disa raste, më së shumti në Europë, institucionet ndërkombëtare kanë marrë funksione të rëndësishme, të cilat më parë kryheshin prej shteteve, si dhe janë krijuar burokraci ndërkombëtare të fuqishme, që veprojnë drejtpërdrejt me qytetarët e veçantë. Globalisht ka pasur prirje që qeveritë e shteteve ta humbasin pushtetin edhe nëpërmjet kalimit të tij te organizmat nënshtetërorë, te autoritetet rajonale, krahinore dhe vendore. Në shumë shtete, duke përfshirë edhe disa nga bota e zhvilluar, ka lëvizje rajonale, që kërkojnë autonomi të gjerë ose shkëputjen. Qeveritë e shteteve e kanë humbur mjaft aftësinë për të kontrolluar qarkullimin e parave që hyjnë e dalin prej vendit dhe kanë vështirësi në rritje për të kontrolluar rrjedhat e ideve, të teknologjisë, mallrave e njerëzve. Kufijtë e shteteve, shkurt, janë bërë gjithnjë e më të depërtueshëm. Të gjitha këto zhvillime i kanë shtyrë mjaft njerëz që të shprehen se hap pas hapi ka ardhur fundi i shtetit të fortë “si bilë bilaroje”, i cili qëllimisht ka qenë normë prej Traktatit të Vestfalisë më 1648,¹² dhe po përftohet një rend ndërkombëtar i larmishëm, i ndërlikuar e shumëshresor, që i ngjet më shumë atij të kohëve të Mesjetës.

Kaosi i mirëfilltë. Dobësimi i shteteve dhe shfaqja e “shteteve të dështuara” japin ndihmesë për imazhin e katërt të botës në anarki. Kjo paradigmë thekson: rënien e autoritetit qeveritar; shpërbërjen e shteteve;

përforcimin e konflikteve fisnore, etnike dhe fetare; shfaqjen e mafies kriminale ndërkombëtare; shumëfishimin e refugjatëve deri në dhjetëra miliona; përhapjen e armëve bërthamore dhe të armëve të tjera të shkatërrimit në masë; përhapjen e terrorizmit; mbizotërimin e masakrave dhe të spastrimeve etnike. Kjo tablo e botës në kaos është parashtruar bindshëm e përmbledhtas në titujt e dy punimeve zbhiruese, të botuara më 1993: *Out of Control* (Jashtë kontrollit) e Zbigniew Brzezinski-t (Zbignjev Bërzhezinski) dhe *Pandaemonium* (Katrahura) e Patrick Moynihan-it (Patrik Mojnihanit).¹³

Sikurse paradigma e shteteve, edhe paradigma e kaosit është afër realitetit. Ajo jep një paraqitje grafike e të përpiktë për shumicën e gjërave që ndodhin në botë dhe, ndryshe nga paradigma e shteteve, nxjerr në dukje ndryshimet domethënëse të ndodhura në politikën botërore me përfundimin e Luftës së ftohtë. Që në fillim të vitit 1993, për shembull, kanë ndodhur 48 luftëra etnike në mbarë botën, kurse në ish Bashkimin Sovjetik janë shfaqur 164 “mëtime territoriale-etnike e konflikte lidhur me kufijtë”, prej të cilave 30 janë shoqëruar me ndonjë formë konflikti të armatosur.¹⁴ E megjithatë, kjo madje vuan më shumë se paradigma e shteteve, ngaqë është tepër afër realitetit. Bota mund të jetë në kaos, por nuk është totalisht pa asnjë rend. Një imazh i anarkisë universale dhe të padallimtë jep pak çelësa për të kuptuar botën, për t'i vënë në rend ngjarjet e për të vlerësuar rëndësinë e tyre, për të parashikuar prirjet mes anarkisë, për të bërë dallimin ndërmjet tipave të kaosit dhe të shkaqeve e të pasojave të ndryshme të mundshme prej tyre, si dhe për të përpunuar orientime për hartuesit e politikave qeveritare.

Krahasimi i botëve: realizmi, kursimtaria dhe parashikimet

Secila nga këto katër paradigma na jep një ndërthurje paksa të ndryshme të realizmit me kursimtarinë. Secila gjithashtu ka mangësitë e kufizimet e veta. Logjikisht këto do të kapërceheshin nëpërmjet ndërthurjes së paradigmave dhe duke pohuar, për shembull, se bota është përfshirë në procesin e njëkohshëm të copëzimit e të integritimit.¹⁵ Të dyja prirjet ekzistojnë vërtet dhe një model më i ndërlikuar do të ishte më afër realitetit sesa një më i thjeshtë. E megjithatë, kjo e flizon kursimtarinë për realizmin dhe nëse shkohet tepër larg, çon deri te hedhja poshtë e të gjitha paradigmave ose teorive. Veç kësaj, duke përqafuar dy prirje njëherësh të kundërta, modeli i copëzim-integritimit nuk ia del mbanë të paraqesë se në çfarë rrethanash do të mbizotëronte njëra prirje e në cilat do të mbisundonte tjetra. Kërkesa është të përpunohet një paradigmë, e cila të merrte para sysh ngjarjet më vendimtare dhe, në krahasim me paradigmat e tjera në nivel të ngjashëm abstraktimi intelektual, ajo të bënte që prirjet të kuptoheshin më qartë.

Këto katër paradigma po ashtu janë të papërputhshme njëra me tjetrën. Bota nuk mund të jetë edhe një, edhe themelisht e ndarë mes Lindjes e Perëndimit, apo Veriut e Jugut. As shteti komb nuk mund të jetë gur themeli i punëve ndërkombëtare, nëse është duke u copëzuar dhe gërryhet prej shtimit të konflikteve civile. Bota është ose një, ose dy, ose 184 shtete, ose me gjasë një numër pothuaj i pafund fisesh, grupesh etnike e kombësish.

Vështirimi i botës duke u kufizuar në shtatë apo tetë qytetërime i mënjanon mjaft nga këto vështirësi. Ai nuk e flijon realitetin për hir të kursimtarisë, ashtu siç bën paradigma e një apo dy botëve; e ndërkaq as nuk e flijon kursimtarinë për realitetin, ashtu siç bëjnë paradigma e kaosit dhe etatiste. Ai jep një kornizë të kapshme e të arsyeshme për të kuptuar botën, duke dalluar ndërmjet konflikteve të shumta atë çka është e rëndësishme prej asaj që është e parëndësishme, duke parashikuar zhvillimet e ardhshme e duke dhënë orientimet për hartuesit e politikave. Gjithashtu, ai mbështetet në elementë të paradigmave të tjera dhe i përfshin ato. Është me to më i përputhshëm, sesa janë ato me njëra-tjetrën. Për shembull, sipas qëndrimit të mbështetur të qytetërimit, do të pohojmë:

- Forcat e integritetit në botë janë reale dhe pikërisht ato janë duke përftuar kundërforcat e vetëpohimit kulturor e të vetëdijes qytetërimore.

- Bota në një farë kuptimi është më dysh, por ndarja qendrore është në mes Perëndimit si qytetërimi deri më sot mbizotërues, e gjithë të tjerëve, të cilët megjithatë kanë pak gjë, në mos asgjë, të përbashkët midis tyre. Bota, shkurt, është e ndarë ndërmjet “një” Perëndimi dhe “shumë” joperëndimi.

- Shtetet kombe janë dhe do të mbeten aktorët më të rëndësishëm në punët e botës, por interesat, rreshtimet dhe konfliktet e tyre gjithnjë e më tepër formësohen prej faktorëve kulturorë e të qytetërimit.

- Bota është me të vërtetë anarkike, e stërmbushur me konflikte fisnore e kombëtare, por konfliktet që paraqesin rrezikun më të madh për stabilitetin janë ato mes shteteve ose grupeve prej qytetërimesh të ndryshme.

Paradigma qytetërimore, kështu, parashton një hartë relativisht të thjeshtë, ndonëse jo tepër të thjeshtë, për të kuptuar çka po ndodh në botë me mbylljen e shekullit të njëzetë. Ndërkaq, asnjë paradigmë nuk mund të jetë e mirë përgjithmonë. Modeli i Luftës së ftohtë i politikës botërore ishte i dobishëm dhe i përshtatshëm gjatë dyzet vjetëve, por u vjetrua në fund të viteve 1980, e po ashtu do të pësojë të njëjtin fat paradigma qytetërimore në një moment të caktuar. Për periudhën bashkëkohëse, sidoqoftë, ajo na jep një udhërrëfyes të vlefshëm për të dalluar çka është më me rëndësi prej asaj që ka më pak rëndësi. Pothuaj më pak se gjysma e dyzet e tetë konflikteve në botë në fillim të vitit 1993, për shembull, ishin mes grupeve prej qytetërimesh të ndryshme. Këndvështrimi qytetërimor do t'i shtynte sekretarin e përgjithshëm të OKB-së dhe sekretarin e shtetit të SHBA që t'i përqendronin përpjekjet për arritjen e paqes te këto konflikte, të cilat kanë gjasa më të mëdha sesa të tjerat të përshkallëzohen drejt luftërave më të gjera.

Paradigmat gjithashtu përftojnë parashikime, ndërsa prova vendimtare për vlefshmërinë dhe dobinë e një paradigme është përmasa në të cilën parashikimet e përfutuara prej saj dalin se janë më të përpikta se ato prej paradigmave të tjera. Paradigma etatiste, për shembull, e bëri John Mearsheimer-in (Xhon Mearz-hajmer) të parashikonte se “gjendja ndërmjet Ukrainës dhe Ruisë është pjekur për shpërthimin e garës së sigurisë ndërmjet tyre. Fuqitë e mëdha, që kanë kufi të përbashkët të gjatë e të pambrojtur, si ai ndërmjet Ruisë e Ukrainës, të shtyrë prej frikës së sigurisë, shpesh kalojnë në garë. Rusia dhe Ukraina mund ta tejkalojnë këtë ecuri dinamike e të mësojnë sesi të jetojnë së bashku në harmoni, por do të ishte diçka e pazakontë nëse do të

vepronin kështu.”¹⁶ Kurse nga ana tjetër, një qasje qytetërimore e vë theksin te lidhjet e ngushta kulturore, personale e historike ndërmjet Rosisë e Ukrainës, dhe te përzierja e rusëve e ukrainasve në të dy vendet, si dhe përqendrohet te vija e shkëputjes, që ndan Ukrainën lindore ortodokse prej Ukrainës perëndimore uniate, çka përbën një fakt qendror me qëndrueshmëri të gjatë, të cilin, duke iu përmbajtur konceptit “realist” për shtetet si tërësi të bashkuara dhe të vetënjëjtësuar, Mearz-hajmeri e shpërfill plotësisht. Ndërsa qasja etatiste nxjerr në dukje mundësinë e luftës ruso-ukrainase, qasja qytetërimore e zvogëlon këtë dhe në vend të saj vë në pah mundësinë e ndarjes më dysh të Ukrainës, ndarje për të cilën faktorët kulturorë do ta bënin dikë të parashikonte se mund të ishte edhe më e dhunshme sesa ndarja e Çekosllovakisë, por shumë më pak e përgjakshme sesa copëtimi i Jugosllavisë. Këto parashikime të ndryshme, nga ana e vet, sjellin përparësi të ndryshme politike. Parashikimet etatiste të Mearz-hajmerit për një luftë të mundshme dhe për pushtimin e Ukrainës prej Rosisë, e kanë bërë që të shprehet në përkrahje të Ukrainës për të zotëruar armë bërthamore. Qasja qytetërimore do të nxiste bashkëpunimin mes Rosisë e Ukrainës, do të kërkonte prej Ukrainës që të hiqte dorë nga armët bërthamore, do të përkrahte ndihmën thelbësore ekonomike dhe masa të tjera, që të mbështetej Ukraina për të ruajtur unitetin e pavarësinë dhe të nxitej planifikimi i gatishmërisë për rastin e jashtëzakonshëm të një copëtimi të mundshëm të Ukrainës.

Shumë zhvillime të rëndësishme pas përfundimit të Luftës së ftohtë përputheshin me paradigmën qytetërimore e mund të ishin parashikuar prej saj. Këtu bëjnë pjesë: shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe e Jugosllavisë; luftërat që po ndodhin në territoret e tyre të

mëparshme; rritja e fundamentalizmit fetar në mbarë botën; luftërat brenda Ruisë, Turqisë e Meksikës për identitetin e tyre; fuqizimi i konfliktit tregtar mes Shteteve të Bashkuara e Japonisë; qëndresa e shteteve islamike ndaj tryznisë Perëndimore mbi Irakun e Libinë; përpjekjet e shteteve islamike e konfuciane për të pasur armë bërthamore dhe mjetet për përdorimin e tyre; roli i vijuar i Kinës si fuqi e madhe “e jashtme”; konsolidimi i regjimeve të reja demokratike në disa shtete dhe mosarritja në disa të tjera, si dhe rritja e garës së armatimeve në Azinë Lindore.

Vlerën e paradigmës qytetërimore për botën që po përftohet e ilustrojnë ngjarjet në përputhje me këtë paradigmë, të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës prej gjashtë muajsh më 1993:

- vazhdimi dhe ashpërsimi i luftimeve ndërmjet kroatëve, myslimanëve e serbëve në ish Jugosllavinë;
- dështimi i Perëndimit, që nuk arriti t’u jepte mbështetje të ndjeshme myslimanëve të Bosnjës ose të dënonte krimet e kroatëve po në të njëjtën mënyrë si u denoncuan mizoritë serbe;
- mospranimi i Ruisë që të bashkohej me anëtarët e tjerë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për t’i detyruar serbët në Kroaci të bënin paqe me qeverinë kroate, si dhe oferta nga Irani e shtetet e tjera myslimane për të dërguar 18.000 trupa për mbrojtjen e myslimanëve të Bosnjës;
- përforcimi i luftës mes armenëve e azerëve, kërkesat e Turqisë e të Iranit që armenët të tërhiqeshin prej pushtimeve të tyre, dërgimi i trupave turke pranë kufirit me Azerbajxhanin dhe i trupave iraniane përgjatë kufirit, si dhe paralajmërimi nga Rusia se veprimi i Iranit

ndihmonte “shkallëzimin e konfliktit” dhe e shtynte konfliktin në kufijtë e rrezikshëm të ndërkombëtarizimit;

- vijimi i luftimeve në Azinë Qendrore mes trupave ruse dhe guerilasve *muxhabidinë*;

- ballafaqimi në Konferencën për të drejtat e njeriut në Vjenë mes Perëndimit, të udhëhequr prej sekretarit amerikan të shtetit, Uorren Kristofer, që denoncoi “relativizmin kulturor”, dhe një koalicioni shtetesh islamike e konfuciane, që hidhnin poshtë “Universalizmin Perëndimor”;

- ripërqendrimi në mënyrë paralele i planifikuesve ushtarakë rusë dhe atyre të NATO-s lidhur me “kërcënimin nga Jugu”;

- votimi, pothuaj hapur sipas vijave qytetërimore, që vendosi të bëheshin Lojërat Olimpike të vitit 2000 në Sidnej dhe jo në Pekin;

- shitja e pjesëve përbërëse të raketave Pakistanit nga Kina, vendosja si rrjedhim e sanksioneve ekonomike të SHBA kundër Kinës dhe ballafaqimi ndërmjet Kinës e Shteteve të Bashkuara rreth mëtimit për dërgimin e teknologjisë bërthamore në Iran;

- shkelja e moratoriumit dhe provat e armëve bërthamore nga Kina, me gjithë protestat e fuqishme të SHBA, si dhe mospranimi i Koresë Veriore për të marrë pjesë më tej në bisedimet për programin e saj të armëve bërthamore;

- zbulimi se Departamenti i mbrojtjes i SHBA po ndiqte një “politikë të dyfishtë frenimi”, të drejtuar si kundër Iranit, edhe kundër Irakut;

- shpallja nga Departamenti i mbrojtjes i SHBA e një strategjie të re të përgatitjes për “dy konflikte të mëdha rajonale”, njëri kundër Koresë së Veriut, tjetri kundër Iranit ose Irakut;

- thirrja e presidentit të Iranit për aleancë me Kinën dhe Indinë, në mënyrë që “ne të kemi fjalën e fundit në ngjarjet ndërkombëtare”;

- legjislacioni i ri në Gjermani, që shkurton rëndë pranimin e refugjatëve;

- marrëveshja ndërmjet presidentit rus Boris Jelcin dhe presidentit të Ukrainës, Leonid Kravçuk, për të rregulluar çështjen e flotës së Detit të Zi e të çështjeve të tjera;

- bombardimi i Bagdatit nga Shtetet e Bashkuara, mbështetja në të vërtetë e njëzëshme nga qeveritë Perëndimore dhe dënimi i tij pothuajse nga të gjitha qeveritë myslimane si një shembull tjetër i “standardit të dyfishtë” të Perëndimit;

- renditja e Sudanit nga Shtetet e Bashkuara si shtet terrorist dhe akuzat sheikut Omar Abdurrahman e pasuesve të tij si komplotues që “të imponojnë një luftë terrorizmi urban kundër Shteteve të Bashkuara”;

- përmirësimi i perspektivave për pranimin përfundimisht të Polonisë, Hungarisë, Republikës Çeke dhe Sllovakisë në NATO;

- zgjedhjet parlamentare në Rusi më 1993, të cilat treguan se Rusia ishte vërtet një vend “i përçarë”, me popullsinë dhe elitën të pasigurtë nëse duhej të bashkoheshin me Perëndimin, apo t’i kundërviheshin.

Një listë e krahasueshme e ngjarjeve, që të tregonte vlefshmërinë e paradigmes qytetërore, do të mund të hartohej për pothuaj cilëndo periudhë tjetër gjashtëmujore në fillim të viteve 1990.

Në vitet e para të Luftës së ftohtë burri i shtetit kanadez Lester Pearson (Pirson) ka vënë në dukje si parashikim ringjalljen dhe fuqinë jetësore të shoqërive joperëndimore. “Do të ishte absurde, - ka paralajmëruar

ai, - të përfytyrohet se këto shoqëri të reja politike, që po lindin në Lindje, do të jenë kopje e atyre, me të cilat ne jemi mësuar në Perëndim. Ringjallja e këtyre qytetërimeve të lashta do të marrë forma të reja.” Duke vënë në dukje se marrëdhëniet ndërkombëtare “për shekuj me radhë” kanë qenë marrëdhënie mes shteteve të Europës, ai argumentonte se “problemet më të mëdha nuk shfaqen më ndërmjet kombeve brenda të njëjtit qytetërim, por ndërmjet vetë qytetërimeve.”¹⁷ Dypolarësia e zgjatur e Luftës së ftohtë i vonoi ato zhvillime, të cilat Pirsoni i shquante se po vinin. Fundi i Luftës së ftohtë i çliroi forcat kulturore e qytetërimore, të cilat ai i kishte identifikuar në vitet 1950, dhe rolin e ri të këtyre faktorëve në politikën globale e kanë pranuar e ndriçuar një rreth i gjerë studiuesish e vëzhguesish.¹⁸ Fernand Braudel-i (Fernand Brodel) me mençuri ka paralajmëruar se “përsa i përket çdokujt, që është i interesuar për botën bashkëkohore, madje edhe më shumë lidhur me cilindo që dëshiron të veprojë brenda saj, ia vlen të dijë sesi t’i gjejë në hartën e botës cilat qytetërimë ekzistojnë sot, të jetë në gjendje të përcaktojë kufijtë, qendrat dhe periferitë e tyre, provincat e ajrin që thithet aty, format e përgjithshme e të veçanta që ekzistojnë e që shoqërohen me to. Përndryshe, lidhur me perspektivën, çfarë gabimesh katastrofike nuk do të ndodhnin!”¹⁹

Kreu 2: Qytetërimet në histori dhe sot

Natyra e qytetërimeve

Historia e njerëzimit është histori e qytetërimeve. Është e pamundur të mendohet për zhvillimin e njerëzimit nga çfarëdo pikëvështrimi tjetër. Historia shtrihet përgjatë breznive të qytetërimeve nga të lashtat të shumerëve e të egjiptianëve, te ato klasike e mezoamerikane dhe deri te qytetërimet e krishtera e islamike, si dhe përmes shfaqjeve të njëpasnjëshme të qytetërimeve kineze e hindu. Përgjatë gjithë historisë qytetërimet u kanë dhënë njerëzve mundësinë më të gjerë për identifikim. Si rrjedhim, shkaqet, dalja, ngritja, ndërveprimet, arritjet, perëndimi e rënia e qytetërimeve janë hulumtuar gjerë e gjatë nga historianë të shquar, sociologë dhe antropologë, e ndër ta bëjnë pjesë Max Weber, Emile Durkheim, Oswald Spengler, Pitirim Sorokin, Arnold Toynbee, Alfred Weber, A. L. Kroeber, Philip Bagby, Carroll Quigley, Rushton Coulborn, Christopher Dawson, S. N. Eisenstadt, Fernand Braudel, William H. McNeill, Adda Bozeman, Immanuel Wallerstein dhe Felipe Fernandez-Armesto.¹ Këta dhe autorë të tjerë kanë krijuar një literaturë të vëllimshme,

diturore e të stërholluar, që i kushtohet analizës krahasuese të qytetërimeve. Në këtë literaturë ka mjaft dallime nga ana e perspektivës, metodologjisë, vatrëzimit dhe koncepteve. E megjithatë, ka një pajtim të gjerë lidhur me pikat qendrore, që kanë të bëjnë me natyrën, identitetin dhe dinamikën e qytetërimeve.

Së pari, ka dallim ndërmjet qytetërimit në njëjës dhe qytetërimeve në shumës. Ideja e qytetërimit u përpunua prej mendimtarëve francezë të shekullit të tetëmbëdhjetë si e kundërta e konceptit “barbarizëm”. Shoqëria e qytetëruar ndryshonte prej shoqërisë primitive, sepse ishte e ngulur, urbane dhe e shkolluar. Të ishe i qytetëruar ishte mirë, të ishe i paqytetëruar ishte keq. Koncepti i qytetërimit dha një standard, sipas të cilit mund të gjykoreshin shoqëritë dhe gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë europianët i kushtuan mjaft energji intelektuale, diplomatike e politike përpunimit të kriterit, sipas të cilit shoqëritë joeuropiane do të gjykoreshin “të qytetëruara” në shkallë të mjaftueshme, që të pranoheshin si anëtare të sistemit ndërkombëtar të sunduar prej europianëve. Në të njëjtën kohë, megjithatë, njerëzit gjithnjë e më tepër flisnin për qytetërimet në shumës. Kjo do të thoshte “hiqej dorë prej qytetërimit të përkufizuar si një ideal, ose më mirë si ideal” dhe nga pohimi, se kishte një standard të vetëm për çka quhej e qytetëruar, “e kufizuar” sipas shprehjes së Brodelit, duke bërë një kapërcim të “pak popuj ose grupe të privileguara, të ‘elita’ e njerëzimit.” Në vend të një, dilnin shumë qytetërime, çdonjëri ishte i qytetëruar në mënyrën e vet. Shkurt, qytetërimi në numrin njëjës “humbi diçka prej hijeshisë” dhe qytetërimi në kuptimin shumës do të ishte në të vërtetë mjaft i paqytetëruar në kuptimin e numrit njëjës.²

Tema e këtij libri janë qytetërimet në shumës. Megjithatë, përsëri dallimi mes njëjësit e shumësit

mbetet me peshë dhe ideja e qytetërimit në numrin njëjës është rishfaqur me argumentin se ka një qytetërim universal të botës. Ky argument nuk mund të qëndrojë, por është me dobi të hulumtohet, siç do të bëhet në kreun e fundit të këtij libri, nëse qytetërimet po bëhen apo nuk po bëhen më të qytetëruara.

E dyta, jashtë Gjermanisë qytetërimi është një tërësi kulturore. Mendimtarët gjermanë të shekullit të nëntëmbëdhjetë bënë dallim të prerë ndërmjet qytetërimit, i cili përfshinte mekanikën, teknologjinë dhe faktorët materialë, prej kulturës, e cila përfshinte vlerat, idealet dhe cilësitë e larta intelektuale artistike e morale të shoqërisë. Ky dallim ka vijuar në të menduarit gjerman, por nuk është pranuar gjetiu. Disa antropologë madje e kanë përmbysur marrëdhënien dhe i konceptonin kulturat si karakteristike të shoqërive primitive, të pandryshueshme, jurbane, kurse qytetërimet quatin shoqëritë më komplekse, më të zhvilluara, urbane dhe dinamike. Këto përpjekje për të bërë dallim midis kulturës e qytetërimit, megjithatë, nuk kanë gjetur përkrahje dhe jashtë Gjermanisë ka një pajtim mbizotërues me Brodelin, se është “zhgënjyese të kërkosh sipas mënyrës gjermane që ta ndash *kulturën* prej themelit të saj, *qytetërimit*.”⁵

Që të dyja, qytetërimi dhe kultura, kanë të bëjnë me mënyrën e përgjithshme të jetesës së një populli dhe qytetërimi është kultura e marrë më gjerë. Të dyja përfshijnë “vlerat, normat, institucionet dhe mënyrat e të menduarit, të cilave u kanë dhënë rëndësinë parësore breznitë e njëpasnjëshme në një shoqëri të caktuar.”⁴ Për Brodelin qytetërimi “është një hapësirë, ‘zonë kulturore’, ”koleksion karakteristikash e dukurish kulturore.” Wallerstein-i (Valershtajn) e përkufizon si “një vargëzim i caktuar botëvështrimesh, zakonesh, strukturash dhe kulture (si të kulturës materiale, edhe të

kulturës së lartë), që përbën një farë tërësie historike e që bashkëjeton (ndonëse jo gjithmonë njëkohësisht) me variantet e tjera të kësaj dukurie.” Sipas Dawson-it (Dousonit), një qytetërim është produkt i një “procesi origjinal të veçantë krijimtarië kulturore, që është vepra e një populli të caktuar”, ndërsa për Durkheim-in (Durkhajm) dhe Mauss-in (Maus) është “një lloj mjedisi moral, që rrethon një numër të caktuar kombesh, e secila kulturë kombëtare është vetëm formë e veçantë e së tërës.” Për Spengler-in (Shpengler) qytetërimi është “*caku* i pashmangshëm i kulturës... gjendjet më artificiale dhe të jashtme të së cilës është i aftë t’i arrijë një lloj i njerëzimit të zhvilluar... një përfundim, gjëja e bërë që pason gjënë që është duke u bërë.” Kultura është në të vërtetë tema e përbashkët në të gjitha përkufizimet e qytetërimit.⁵

Elementët kulturorë kyç, që përcaktojnë një qytetërim, janë paraqitur në trajtën klasike prej athinasve, kur i siguruan spartanët se nuk do t’i tradhtonin te persët:

Sepse ka shumë arsye të forta që na ndalojnë ta bëjmë një gjë të tillë, madje edhe po të anonim nga kjo gjë. E para dhe kryesorja janë paraqitjet dhe vendbanimet e hyjnive, të djegura e të kthyera në rrënoja: për këtë ne duhet të hakmerremi me gjithë fuqinë tonë dhe jo të bëjmë marrëveshje me njerëzit që kanë kryer punë të tilla. E dyta, raca greke duke qenë me po atë gjak dhe po atë gjuhë e duke i pasur të përbashkët tempujt e hyjnive e flijimet, si edhe zakonet tona të ngjashme, nuk do të ishte mirë për athinasit t’i tradhtonin të gjitha këto.

Gjaku, gjuha, feja, mënyra e jetesës ishin ato gjëra, që grekët i kishin të përbashkëta dhe çka i dallonin nga persët e jogrekët e tjerë.⁶ Prej gjithë elementëve objektivë që përcaktojnë qytetërimin, megjithatë,

zakonisht më i rëndësishmi është besimi, siç e theksonin athinasit. Deri në një shkallë mjaft të madhe, qytetërimet kryesore në historinë e njerëzimit janë njëjtësuar me fetë e mëdha botërore, kurse njerëzit që kanë të njëjtën etni e gjuhë, por ndryshojnë nga feja, mund ta masakrojnë njëri-tjetrin, ashtu siç ka ndodhur në Liban, në ish Jugosllavinë e në Nënkontinentin indian.⁷

Ka një përkim domethënës mes ndarjes së njerëzve në qytetërimet sipas karakteristikave kulturore dhe ndarjes së tyre në raca sipas tipareve fizike. Mirëpo qytetërimi dhe raca nuk janë e njëjta gjë. Njerëzit e së njëjtës racë mund të jenë të përçarë thellë prej qytetërimit. Në veçanti fetë e mëdha misionare, krishterimi e islamizmi, përfshijnë shoqëri nga raca të ndryshme. Dallimet vendimtare ndërmjet grupeve njerëzore kanë të bëjnë me vlerat e tyre, me besimet, institucionet e strukturat shoqërore, jo me përmasat e tyre fizike, me format e kokës e ngjyrat e lëkurës.

E treta, qytetërimet janë gjithëpërfshirëse, domethënë asnjë ndër njësitë e tyre përbërëse nuk mund të kuptohet plotësisht pa iu referuar qytetërimit përfshirës. Qytetërimet, siç e ka argumentuar Toynbee (Toinbi), “përfshijnë pa qenë të përfshirë prej të tjerëve.” Qytetërimi është ‘totalitet’. Siç e thotë Melkoja, qytetërimet:

kanë një shkallë të caktuar integrimi. Pjesët e tyre përcaktohen nga marrëdhëniet me njëra-tjetrën dhe me tërësinë. Nëse qytetërimi është i përbërë prej shtetesh, këto shtete do të kenë më shumë marrëdhënie me njëri-tjetrin, sesa kanë me shtetet jashtë atij qytetërimi. Ato mund të luftojnë më shumë e mund të hyjnë më shpesh në marrëdhënie diplomatike. Ato do të jenë më të ndërvarura ekonomikisht. Do të kenë rryma estetike e filozofike mbizotëruese në të gjitha.⁸

Qytetërimi është tërësia më e gjerë kulturore. Fshatrat, fetë, grupet etnike, kombësitë, grupet fetare – të gjitha kanë kultura të dalluara në nivele të ndryshme heterogjeniteti kulturor. Kultura e një fshati në Italinë jugore mund të jetë e ndryshme nga e një fshati në Italinë veriore, por që të dy kanë të përbashkët kulturën italiane, e cila i dallon prej fshatrave gjermane. Bashkësitë europiane, nga ana e tyre, kanë të përbashkëta tipare që i dallojnë prej bashkësive kineze ose hindu. Kinezët, hindutë dhe perëndimorët, megjithatë, nuk janë pjesë e ndonjë tërësie kulturore më të gjerë. Ata përbëjnë qytetërimet. Kështu, qytetërimi është grupimi kulturor më i lartë i njerëzve dhe niveli më i gjerë i njëjtësimit kulturor që kanë njerëzit deri në rrafshin që i dallon qeniet njerëzore prej llojeve të tjera të krijesave. Ai përcaktohet si nga elementë objektivë të përbashkët, siç janë: gjuha, historia, feja, zakonet, institucionet, ashtu dhe nga vetënjëjtësimi subjektiv i njerëzve. Njerëzit kanë shkallë të ndryshme njëjtësimi: sipas shkallëzimeve të ndryshme të gjerësisë së hapësirës, një banor i Romës mund ta përcaktojë veten kështu: si roman, si italian, si katolik, si të krishterë, si europian, si perëndimor. Qytetërimi të cilit i përket është niveli më i lartë i njëjtësimit, me të cilin ai e identifikon fort veten. Qytetërimet janë “ne-ja” më e madhe, brenda së cilës e ndiejmë veten kulturalisht në shtëpinë tonë, të dalluar prej gjithë “atyre” të tjerëve. Qytetërimet mund të përfshijnë një numër të madh njerëzish, si në rastin e qytetërimit kinez, ose një numër shumë të vogël njerëzish, si në rastin e karaibasve anglishtfolës. Përgjatë historisë ka pasur mjaft grupe të vogla njerëzish me kulture të dalluar dhe që u ka munguar çfarëdo njëjtësim më i gjerë kulturor. Janë bërë dallime nga pikëpamja e përmasave dhe e rëndësisë mes qytetërimeve kryesore e periferike (Bagby), ose ndërmjet qytetërimeve të mëdha

dhe qytetërimeve të ndërprera ose të dështuara (Toynbee). Ky libër merret me ato që përgjithësisht quhen qytetërimet kryesore në historinë e njerëzimit.

Qytetërimet nuk kanë kufij të qartë dhe as fillime e mbarime të prera. Njerëzit mund t'i ripërcaktojnë identitetet e tyre dhe e bëjnë këtë, si rrjedhim, përbërja e format e qytetërimeve ndryshojnë gjatë kohës. Kulturat e popujve ndërveprojnë dhe mbivihen. Gjithashtu, shkalla në të cilën qytetërimet janë të ngjashme ose ndryshojnë me njëri-tjetrin shfaq mjaft ndryshime. E megjithatë qytetërimet janë tërësi domethënëse dhe ndonëse vijat midis tyre rrallë janë të prera, ato janë reale.

E katërta, qytetërimet vdesin, por gjithashtu janë shumë jetëgjata: ato zhvillohen, përshtaten dhe janë shoqërimet njerëzore më të qëndrueshme, “realitete me *longue duree* të jashtëzakonshme.” “Thelbi i tyre unik e i veçantë” është “vazhdimësia e tyre e gjatë historike. Qytetërimi në të vërtetë është rrëfenja më e gjatë ndër të gjitha.” Perandoritë ngrihen e bien, qeveritë vijnë e shkojnë, kurse qytetërimet mbeten e “mbijetojnë përtej përmbysjeve të mëdha politike, shoqërore, ekonomike e madje ideologjike.”⁹ Siç ka ardhur në përfundim Bozemani, “Historia ndërkombëtare dokumenton drejt tezën se sistemet politike janë mjete kalimtare në sipërfaqe të qytetërimit dhe fati i secilës bashkësi të lidhur gjuhësisht e moralisht në një, varet në fund të fundit nga mbijetesa e disa ideve parësore strukturuese, rreth të cilave breznitë e njëpasnjëshme janë bashkërritur e të cilat kështu simbolizojnë vazhdimësinë e shoqërisë.”¹⁰ Në të vërtetë të gjitha qytetërimet kryesore në botë në shekullin e njëzetë ose kanë ekzistuar për një mijëvjeçar, ose, si në Amerikën Latine, janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të një qytetërimi tjetër jetëgjatë.

Ndërkohë që qytetërimet jetojnë gjatë, ato edhe zhvillohen. Ato janë dinamike, ngrihen e bien, bashkohen e ndahen, dhe ashtu siç e di çdo studiues i historisë, edhe zhduken e varrosen në pluhurin e kohës. Fazat e evoluimit të tyre mund të përcaktohen në mënyra të ndryshme. Quigley (Kuigli) i sheh qytetërimet në lëvizje përmes shtatë fazave: përzierja, mugullimi, zgjerimi, epoka e konfliktit, perandoria universale, rënia dhe pushtimi. Melkoja ka përgjithësuar një model të ndërrimit prej një sistemi feudal të kristalizuar te sistemi sistemi feudal në tranzicion dhe te sistemi shtetëror i kristalizuar, e më tej te sistemi shtetëror në tranzicion drejt sistemit perandorak të kristalizuar. Toinbi e sheh qytetërimin që ngrihet si përgjigje ndaj sfidave dhe pastaj kalon përmes periudhës së rritjes, që përfshin sundimin duke u shtuar mbi mjedisin e vet, të përfutur prej një pakice krijuese, të pasuar prej një periudhe trazirash, prej ngritjes së shtetit universal e pastaj shpërbërja. Megjithëse kanë ndryshime thelbësore, të gjitha këto teori i shohin qytetërimet në evoluim përmes një etape trazirash ose konflikti drejt një gjendje rënieje dhe shpërbërjeje.¹¹

E pesta, meqë qytetërimet janë tërësi kulturore e jo politike, si të tilla nuk mbajnë rendin, nuk vendosin drejtësi, nuk mbledhin taksa, nuk bëjnë luftëra, nuk bisedojnë për marrëveshje, pra nuk bëjnë asgjë nga ato punë, që i bëjnë qeveritë. Përbërja politike e qytetërimeve ndryshon si ndërmjet qytetërimeve, ashtu edhe përgjatë kohës brenda një qytetërimi. Kështu, një qytetërim mund të përmbajë një apo më shumë njësi politike. Këto njësi mund të jenë shtete, perandori, federata, konfederata, shtete, kombe, shtete shumëkombëshe, e të gjitha mund të kenë forma të ndryshme qeverisjeje. Me zhvillimin e një qytetërimi ndodhin në rrugë normale ndryshime në numrin dhe në

natyrën e njësisve të tyre përbërëse politike. Në njërin skaj, një qytetërim dhe një tërësi politike mund të përkojnë. Kina, siç e ka komentuar Lucian Pye (Lusjen Pai), është “një qytetërim që mëton të jetë shtet.”¹² Japonia është një qytetërim që është një shtet. Shumica e qytetërimeve, megjithatë, përmbajnë më shumë se një shtet ose entitete politike të tjera. Në botën e sotme shumica e qytetërimeve përfshijnë dy ose më shumë shtete.

Së fundi, studiuesit në përgjithësi pajtohen në përcaktimin e qytetërimeve kryesore gjatë historisë dhe atyre që ekzistojnë në botën e sotme. Ata shpesh kanë mendime të ndryshme, megjithatë, rreth numrit total të qytetërimeve që kanë ekzistuar në histori, Kuigli pranon 16 raste të pastërta historike e ka mjaft gjasa edhe tetë të tjera shtesë. Toinbi në fillim e rriti numrin në njëzet e një, pastaj në njëzet e tre; Shpengleri veçon tetë kultura kryesore. McNeill-i (Maknil) diskuton për nëntë qytetërim gjatë gjithë historisë; Bagby (Bagbi) gjithashtu pranon nëntë qytetërim ose njëmbëdhjetë, nëse Japonia dhe Ortodoksia do të veçohen prej Kinës e Perëndimit. Brodeli ka veçuar nëntë qytetërim të mëdha bashkëkohore dhe Rostovaniij shtatë.¹³ Ndryshimet ndërmjet tyre pjesërisht varen nga gjykimi, nëse grupe të tilla kulturore si kinezët dhe indianët kanë pasur një qytetërim të vetëm përgjatë historisë, apo dy e më shumë qytetërim të lidhura ngushtë njëri me tjetrin, ndër të cilët njëri ka qenë pinjoll i tjetrit. Me gjithë këto ndryshime, nuk vihet në dyshim identiteti i qytetërimeve kryesore. Pas shqyrtimit të literaturës, Melkoja ka ardhur në përfundimin se ndeshet një “Përputhje e arsyeshme” që ekzistojnë së paku dymbëdhjetë qytetërim kryesore, shtatë prej të cilave nuk jetojnë më (i Mesopotamisë, i Egjiptit, i Kretës, i Klasiku, Bizantini, Mezoamerikani, i Andeve) dhe pesë që vijojnë të jetojnë (kinezi, japonezi,

indiani, islamiku e Perëndimori).¹⁴ Këtyre pesë qytetërimeve do të ishte e dobishme t'u shtoheshin në botën bashkëkohore qytetërimi ortodoks, latinoamerikan dhe, ndoshta, qytetërimi afrikan.

Rrjedhimisht, qytetërimet kryesore të sotme janë:

Sinik. Të gjithë studiuesit pranojnë ose një qytetërim kinez të vetëm e të dalluar, që daton së paku prej vitit 1500 para e.r. e ndoshta edhe një mijë vjet më herët, ose dy qytetërime kineze, që kanë zëvendësuar njëri-tjetrin në shekujt e parë të erës së re. Në artikullin tim të botuar në *Foreign Affairs*, e kam quajtur konfucian këtë qytetërim. Megjithatë, është më e drejtë të përdoret termi sinik. Ndërsa konfucianizmi është përbërësi kryesor i qytetërimit kinez, qytetërimi kinez është më shumë sesa konfucianizmi dhe gjithashtu del përtej Kinës si tërësi politike. Termi "sinik", që është përdorur prej mjaft studiuesish, e përcakton me përpikëri kulturën e përbashkët të Kinës e të bashkësive kineze në Azinë Juglindore e kudo gjetkë jashtë Kinës, ashtu si dhe kulturat e Vietnamit e të Koresë të lidhura me të.

Japonez. Disa studiues i ndërthurin kulturën kineze dhe japoneze nën emërtimin e një qytetërimi të vetëm të Lindjes së Largët. Shumica megjithatë, nuk bëjnë kështu dhe e quajnë Japoninë si qytetërim të dalluar, i cili ka qenë pinjoll i qytetërimit kinez, që u shfaq gjatë periudhës mes viteve 100 e.r. dhe 400.

Hindu. Një ose më shumë qytetërime të njëpasnjëshme, që pranohet përgjithësisht se kanë ekzistuar në Nënkontinentin indian të paktën që prej vitit 1500 para e.r. Këto përgjithësisht quhen indiani, indiku ose hindu, ndërsa termi i fundit parapëlqehet për qytetërimin e kohëve me të reja. Në një formë apo në një tjetër hinduizmi ka qenë me rol qendror për kulturën e Nënkontinentit që nga mijëvjeçari i dytë para e.r. "(Ai) është më shumë se një fe ose sistem shoqëror; është

bërthama e qytetërimit indian.”¹⁵ Këtë rol e ka vijuar gjatë kohëve të reja, madje edhe pse India ka një bashkësi të madhe myslimane, si dhe disa pakica kulturore më të vogla. Ashtu si termi sinik, edhe ‘hindu’ gjithashtu e ndan emrin e qytetërimit prej emrit të shtetit bërthamë, që është i dëshirueshëm kur, si në këto raste, kultura e qytetërimit shtrihet përtej shtetit.

Islamik. Të gjithë studiuesit kryesorë e pranojnë ekzistencën e një qytetërimi të veçantë islamik. Zanafillën e ka në Gadishullin e Arabisë në shekullin e shtatë të e.r. Islami u përhap me shpejtësi në Afrikën e Veriut e në Gadishullin Iberik, e gjithashtu drejt lindjes në Azinë Qendrore, në Nënkontinent e në Azinë Juglindore. Si rrjedhim, brenda Islamit ka mjaft kultura ose nënqytetërimë të ndryshme, ndër to arab, turk, persian e malajas.

Ortodoks. Disa studiues dallojnë një qytetërim të veçantë ortodoks, me qendrën në Rusi e të veçuar prej Krishterimit perëndimor për shkak të prejardhjes bizantine, të besimit të dalluar, të 200 vjetëve të sundimit tartar, të despotizmit burokratik dhe të ndikimit të kufizuar prej Rilindjes, Reformacionit, Iluminizmit e rrjedhave të tjera nga përvoja e Perëndimit qendror.

Perëndimor. Qytetërimi perëndimor zakonisht mendohet se do të jetë shfaqur rreth viteve 700 ose 800. Përgjithësisht studiuesit e shohin se ka tre përbërës kryesorë: në Europë, në Amerikën Veriore dhe në Amerikën Latine.

Latino-amerikan. Megjithatë, Amerika Latine ka identitet të veçantë, që e dallon nga Perëndimi. Edhe pse është degëzim i qytetërimit europian, Amerika Latine është zhvilluar në rrugë të ndryshme prej Europës dhe Amerikës Veriore. Ajo ka pasur një kulturë korporatiste, autoritare, të cilën Europa e ka pasur në shkallë shumë të vogël dhe Amerika Veriore nuk e ka pasur fare.

Europa dhe Amerika Veriore të dyja i kanë ndier pasojat e Reformacionit dhe i kanë ndërthurur kulturën katolike e protestante. Qytetërimi latinoamerikan përfshin kulturat vendëse, që nuk kanë ekzistuar në Europë, ndërsa praktikisht janë zhdukur në Amerikën Veriore dhe ndryshojnë sipas rëndësisë nga Meksika, Amerika Qendrore, Peruja e Bolivia, në njërin anë, dhe deri te Argjentina e Kili, në anën tjetër. Evoluimi politik latinoamerikan dhe zhvillimi ekonomik janë dalluar prerazi nga modelet mbizotëruese në shtetet e Atlantikut Verior. Subjektivisht vetë latinoamerikanët janë të ndërlidhur me vetënjëjtësimin e tyre. Disa thonë: “Po, ne jemi pjesë e Perëndimit.” Të tjerët mëtojnë: “Jo, ne kemi kulturën tonë të veçantë.” Dhe me trajtimin e dallimeve të tyre kulturore merret një literaturë e gjerë nga amerikanët veriorë e latinë.¹⁶ Amerika Latine mund të quhet ose një nënqytetërim brenda qytetërimit Perëndimor, ose qytetërim i veçantë, i lidhur ngushtë me Perëndimin dhe i ndarë nga pikëpyetja, nëse i takon apo jo Perëndimit. Përcaktimi i dytë është më i përshtatshëm e më praktik për analizën që përqendrohet te ndërlikimet politike ndërkombëtare të qytetërimeve, duke përfshirë marrëdhëniet mes Amerikës Latine, në njërin anë, dhe Amerikës Veriore e Europës, në anën tjetër.

Si rrjedhim, Perëndimi përfshin Europën, Amerikën Veriore, plus shtete të tjera me banorë të ardhur prej Europës, siç janë Australia e Zelanda e Re. Marrëdhëniet mes dy përbërësve kryesorë të Perëndimit, megjithatë, kanë ndryshuar gjatë kohës. Për pjesën më të madhe të historisë së tyre amerikanët e kanë përcaktuar shoqërinë e vet në kundërvënie me Europën. Amerika ishte vendi i lirisë, barazisë, mundësive, së ardhmes. Europa përfaqësonte shtypjen, konfliktet e klasave, hierarkinë, prapambetjen. Madje është pohuar se Amerika ka qenë qytetërim i veçantë. Vënia e një kundërtie mes Amerikës

dhe Europës ishte, në masë të ndjeshme, rrjedhim i faktit që së paku deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë Amerika kishte vetëm kontakte të kufizuara me qytetërimet joperëndimore. Por pasi Shtetet e Bashkuara dolën në skenën botërore, u zhvillua ndjenja e një identiteti më të gjerë me Europën.¹⁷ Ndërsa gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë Amerika e ka quajtur veten të ndryshme dhe të kundërvënë Europës, në shekullin e njëzetë e ka përcaktuar veten si pjesë të një tërësie më të gjerë, e në të vërtetë si udhëheqëse të saj, të Perëndimit, i cili e përfshin Europën.

Termi “Perëndimi” sot përdoret universalisht për të shënuar atë, që dikur quhej Krishterimi Perëndimor. Si rrjedhim, Perëndimi është qytetërimi i vetëm i përcaktuar nga drejtimi i gjilpërës së busullës dhe jo me emrin e një populli të caktuar, të një feje ose zone gjeografike.¹⁸ Ky përcaktim e nxjerr qytetërimin jashtë kontekstit të tij historik, gjeografik e kulturor. Historikisht qytetërimi Perëndimor është qytetërim evropian. Në epokën moderne qytetërimi Perëndimor është euroamerikan ose qytetërimi Atlantik Verior. Europa, Amerika dhe Atlantiku Verior mund të gjenden në hartë. Perëndimi nuk gjendet. Emërtimi “Perëndim” ka sjellë gjithashtu lindjen e konceptit të “Perëndimorizimit” dhe ka nxitur ngatërrimin gabues të

¹⁷ Përdorimi i termave “Lindje” dhe “Perëndim” është etnocentrik e sjell ngatërrime. “Veriu” dhe “Jugu” janë pranuar përgjithësisht si pika referimi për polet. “Lindja” dhe “Perëndimi” nuk kanë pika të tilla referimi. Pyetja shtrohet: Lindja dhe Perëndimi kundrejt cilës pikë? Gjithçka varet nga pika ku ndodhet dikush. Ka gjasa që në zanafillë “Lindja” e “Perëndimi” shënonin pjesën lindore dhe pjesën perëndimore të Eurazisë. Mirëpo nga pikëpamja e një amerikani, Lindja e Largët është sot në Perëndimin e Largët. Gjatë pjesës më të madhe të historisë së Kinës, Perëndimi do të thoshte India, ndërsa “Në Japoni ‘Perëndimi’ zakonisht do të thoshte Kina.” William E. Naff, “Reflections on the Question of ‘East and West’ from the Point of View of Japan,” *Comparative Civilizations Review*, 13-14 (vjeshtë 1985 e pranverë 1986), 228.

perëndimorizimit me modernizimin: është më e lehtë të përfytyrohet se Japonia po “perëndimorizohet” sesa po “euroamerikanizohet”. Qytetërimi euroamerikan, megjithatë, universalisht pranohet si qytetërimi Perëndimor dhe këtu do të përdoret ky term, me gjithë mangësitë e mëdha.

Afrikan (i mundshëm). Shumica e studiuesve kryesorë të qytetërimit, me përjashtim të Brodelit, nuk e pranojnë një qytetërim afrikan të veçantë. Veriu i kontinentit afrikan dhe bregdeti i tij lindor i takojnë qytetërimit islamik. Historikisht Etiopia ka qenë qytetërim më vete. Tjetërkund imperializmi dhe kolonizimi evropian ka sjellë elementë të qytetërimit Perëndimor. Në Afrikën e Jugut kolonët holandezë e pastaj anglezë krijuan një kulturë europiane të shumëcopëzuar.¹⁸ Çka është më me rëndësi, imperializmi amerikan e solli krishterimin në pjesën më të madhe të kontinentit në jug të Saharës. Përmes Afrikës identitetet fisnore janë mbizotëruese e të fuqishme, por afrikanët gjithashtu po zhvillojnë gjithnjë e më tepër ndjenjën e identitetit afrikan dhe mund të përfytyrohet që Afrika nën Saharën mund të ngjizet si një qytetërim i dallueshëm, ndoshta duke pasur Afrikën e Jugut si shtetin bërthamë.

Feja është një tipar qendror përcaktues i qytetërimeve dhe, ashtu siç ka thënë Kristofer Dousoni: “fetë e mëdha janë themelet, mbi të cilat qëndrojnë qytetërimet e mëdha.”¹⁹ Nga pesë “fetë botërore” të Weber-it (Weber), “katër: krishterimi, islamizmi, hinduizmi e konfucianizmi janë të lidhura me qytetërimet kryesore. E pesta, budizmi, nuk është i lidhur. Pse ndodh kështu me këtë rast? Ashtu si islamizmi e krishterimi, edhe budizmi u përça që herët në dy ndarje kryesore dhe, ashtu si krishterimi, nuk pati jetë më tej në vendlindjen e tij. Duke nisur nga shekulli i parë i e.r., budizmi mahajana u eksportua në Kinë e më

pas në Kore, në Vietnam e në Japoni. Në këto shoqëri budizmi u përshtat në mënyra të ndryshme, u asimilua në kulturën vendëse (në Kinë, për shembull, në konfucianizmin e taoizmin) dhe u shtyp. Kështu, ndërkohë që budizmi mbetet përbërës i rëndësishëm i kulturave të tyre, këto shoqëri nuk përbëjnë dhe nuk do ta përcaktonin veten pjesë të qytetërimit budist. Çka mund të përcaktohet me të drejtë si qytetërim budist theravada, përsëri ndeshet në Sri Lankë, Birmani, Tailandë, Laos dhe Kamboxhia. Për më tepër, popullsitë e Tibetit, Mongolisë e Bhutanit historikisht e kanë përfshirë veten në variantin lamaist të budizmit mahajana dhe këto shoqëri përbëjnë zonën e dytë të qytetërimit budist. Mirëpo mbi të gjitha, shuarja e njëmendtë e budizmit në Indi e përshtatja dhe përfshirja e tij në kulturat ekzistuese në Kinë e në Japoni do të thotë se budizmi, edhe pse është një fe kryesore, nuk ka qenë bazë e një qytetërimi kryesor.^{20*}

* Po për qytetërimin çifut? Shumica e studiuesve të qytetërimit pothuaj nuk e përmendin. Nga pikëpamja e numrit të njerëzve, është e qartë se judaizmi nuk llyu ndër qytetërimet kryesore, Toimbi e përcaktoi si qytetërim të penguar, i cili u zhvillua nga një qytetërim më i hershëm siriak. Historikisht ka lidhje me krishterimin e islamizmin dhe për disa shekuj çifutët kanë ruajtur identitetin e tyre brenda qytetërimeve Perëndimor, ortodoks e islamik. Me krijimin e Izraelit, çifutët kanë të gjitha pajimet objektive të një qytetërimi: fenë, gjuhën, zakonet, letërsinë, institucionet dhe një atdhe territorial e politik. Por si është puna me identifikimin subjektiv? Çifutët që jetojnë në kultura të tjera janë shpërndarë në një shkallëzim, që shtrihet nga njëjtësimi i plotë me judaizmin e Izraelin e deri te judaizmi sa për emër dhe njëjtësimi i plotë me qytetërimin ku jetojnë, ndonëse ky njëjtësim i fundit ndeshet kryesisht te çifutët që jetojnë në Perëndim. Shih Mordecai M. Kaplan, *Judaism as a Civilization* (Philadelphia: Reconstructionist Press, 1981; botuar së pari më 1934), sidomos f. 173-208.

Marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve


Takimet: qytetërimet para vitit 1500 e.r. Marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve kanë kaluar përmes dy fazave dhe sot janë në të tretën. Pasi u shfaqën qytetërimet së pari prej më shumë se tre mijë vjetësh, kontaktet mes tyre, me disa përjashtime, ose nuk ekzistonin fare, ose ishin të kufizuara, apo të herëpashershme dhe intensive. Natyra e këtyre kontakteve shprehet mirë prej fjalës me të cilën i përcaktojnë historianët: “takime.”²¹ Qytetërimet kanë qenë të ndara në kohë dhe në hapësirë. Vetëm një numër i vogël ka ekzistuar në çfarëdo kohe dhe, siç e kanë trajtuar Benjamin Schwartz-i (Shvarc) e Shmuel Eisenstadt-i (Ajzenshtadt), ka një dallim domethënës ndërmjet qytetërimeve të Epokës Boshtore dhe qytetërimeve të Epokës Paraboshtore nga pikëpamja nëse e pranonin ose jo dallimin ndërmjet “rendit transcendental dhe rendit tokësor.” Qytetërimet e Epokës Boshtore, ndryshe nga paraardhësit e tyre, kishin mite transcendente të përhapura prej një klase intelektuale të veçantë: “profetët dhe priftërinjtë çifutë, filozofët e sofistët grekë, të diturit kinezë, brahminët hindu, sangat budistë dhe ulematë islamë.”²² Disa rajone kanë kaluar dy ose tri brezni qytetërimesh me lidhje afërie, duke ndodhur vdekja e njërit qytetërim dhe ndërkoha e pasuar prej ngritjes së një breznie tjetër pasardhëse. Skica 2.1 është një skemë e thjeshtësuar (e marrë nga Carroll Quigley) e marrëdhënieve mes qytetërimeve kryesore euroaziatike përgjatë kohës.

Qytetërimet kanë qenë gjithashtu të ndara gjeografikisht. Deri në vitin 1500 qytetërimi i Andeve dhe ai Mezoamerikan nuk kishin kontakte me qytetërimet e tjera ose me njëri-tjetrin. Qytetërimet e

hershme në luginën e Nilit, Tigrin e Eufratit, Indin e Lumit të Verdhë gjithashtu nuk kanë bashkëvepruar. Me kohë kontaktet mes qytetërimeve u shumëfishuan në Mesdheun lindor, në Azinë jugperëndimore dhe në Indinë veriore. Komunikimet e marrëdhëniet tregtare, megjithatë, ishin të kufizuara prej largësisë që i ndante qytetërimet dhe nga mjetet e kufizuara të transportit për t'i kapërcyer largësitë. Ndërsa kishte një farë tregtie nëpër det në Mesdhe e në Oqeanin Indian, "Jo anijet me vela që përshkonin oqeanet, por kuajt që përshkonin stepat ishin mjetet mbizotëruese të lëvizjes, me anë të të cilave qytetërimet e ndara të botës, siç ka qenë përpara vitit 1500, lidheshin së bashku, në atë shkallë të vogël që i mbajtën kontaktet me njëri-tjetrin."²³

Idetë dhe teknologjia kanë kaluar prej një qytetërimi te tjetri, por shpesh kjo ka dashur shekuj të tërë. Ndoshta përhapja kulturore më e rëndësishme, e shkaktuar jo si pasojë pushtimesh, ka qenë përhapja e budizmit në Kinë, që ndodhi rreth 600 vjet pas lindjes së tij në Indinë Veriore. Shtypshkrimi u zbulua në Kinë në shekullin e tetë e.r. dhe shkronjat e lëvizshme në shekullin e njëmbëdhjetë, por kjo teknologji arriti deri në Europë vetëm në shekullin e pesëmbëdhjetë. Letra nisi të përdorej në Kinë në shekullin e dytë e.r., arriti në Japoni në shekullin e shtatë dhe u përhap drejt perëndimit në Azinë Qendrore në shekullin e tetë, në Afrikën Veriore në të dhjetin, në Spanjë në të dymbëdhjetin dhe në Europën veriore në të trembëdhjetin. Një shpikje tjetër kineze, baruti, i prodhuar në shekullin e nëntë, u përhap te arabët disa qindra vjet më vonë dhe arriti në Europë në shekullin e katëmbëdhjetë.²⁴

Skica 2.1: Qytetërimet e gjysmërruzullit lindor



Burimi: Carroll Quigley, *The Evolution of Civilizations: An Introduction to Historical Analysis* (Indianapolis: Liberty Press, bot. 2, 1979), f. 83.

Kontaktet më dramatike e domethënëse mes qytetërimeve ndodhnin kur njerëzit e një qytetërimi pushtonin dhe i shfarosnin ose i vinin nën zgjedhë njerëzit e një qytetërimi tjetër. Këto kontakte si rregull ishin jo vetëm të dhunshme, por edhe të shkurtra, ndodhnin vetëm herë pas here. Duke nisur nga shekulli i shtatë e.r., mes Islamit e Perëndimit dhe Islamit e Indisë u vendosën kontakte ndërqytetërimore pak a shumë të qëndrueshme e disa herë të dendura. Shumica e ndërveprimeve tregtare, kulturore e ushtarake megjithatë ndodhnin brenda qytetërimeve. Ndërkohë që India e

Kina, për shembull, sipas rastit pushtoheshin e nënshtroheshin nga popuj të tjerë (mogulët, mongolët), të dy qytetërimet gjithashtu kanë patur periudha të gjata “shtetesh në gjendje lufte” brenda qytetërimeve të tyre. Po kështu, grekët kanë luftuar me njëri-tjetrin dhe kanë bërë tregti me njëri-tjetrin shumë më shpesh sesa me persët ose jogrekë të tjerë.

Ndikimi: ngritja e Perëndimit. Krishterimi Perëndimor nisi të shfaqej si qytetërim i dallueshëm në shekullin e tetë e të nëntë. Për qindra vjet me radhë, megjithatë, ai ka qenë prapa qytetërimeve të tjera për nivelin e qytetërimit të vet.. Kina nën sundimin e dinastive Tang, Sung dhe Ming, bota islamike nga shekulli i tetë deri në të dymbëdhjetin e Bizanti nga shekulli i tetë deri në të njëmbëdhjetin ishin shumë më përpara se Europa nga pasuria, territori, fuqia ushtarake dhe arritjet artistike, letrare e shkencore.²⁵ Kultura europiane nisi të zhvillohej ndërmjet shekullit të njëmbëdhjetë e të trembëdhjetë, e ndihmuar prej “përvetësimit të zellshëm e sistematik të elementëve të përshtatshëm prej qytetërimeve më të larta të Islamit e të Bizantit, së bashku me përshtatjen e kësaj trashëgimie ndaj kushteve të veçanta e interesave të Perëndimit.” Gjatë së njëjtës periudhë Hungaria, Polonia, Skandinavia dhe bregdeti baltik u kthyen në krishterimin Perëndimor, që u pasua nga e drejta romake dhe aspektet e tjera të qytetërimit Perëndimor, kurse kufiri lindor i qytetërimit Perëndimor u vendos atje, ku do të mbetej më pas pa ndonjë ndryshim të ndjeshëm. Gjatë shekullit të dymbëdhjetë e të trembëdhjetë Perëndimorët bënë luftëra për ta shtrirë sundimin e tyre në Spanjë dhe ia arritën të vendosnin një zotërim të vërtetë mbi Mesdheun. Megjithatë, në periudhën pasuese ngritja e fuqisë turke solli shembjen e “perandorisë së parë përtej detit të Europës

Perëndimore.”²⁶ Ndërkaq, aty nga viti 1500 rilindja e kulturës europiane kishte marrë udhë të mbarë dhe pluralizmi shoqëror, tregtia në zgjerim e arritjet teknologjike hodhën bazën e një epoke të re në politikën globale.

Takimet e herëpashershme ose të kufizuara ndërmjet qytetërimeve i hapën rrugën ndikimit me një drejtim, të qëndrueshëm e nënshtres, të Perëndimit mbi gjithë qytetërimet e tjera. Fundi i shekullit të pesëmbëdhjetë u bë dëshmitar i ripushtimit përfundimtar të Gadishullit Iberik duke ua marrë maurëve, si dhe i fillimeve të depërtimit të portugezëve në Azi e të spanjollëve në Amerikë. Gjatë dyqind e pesëdhjetë vjetëve të mëpastajmë gjithë Gjysmërruzulli Perëndimor dhe pjesë të mëdha të Azisë ranë nën sundimin ose ndikimin e Europës. Në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë ndodhi tërheqja e sundimit të drejtpërdrejtë europian së pari prej Shteteve të Bashkuara, pastaj prej Haitit, e atëherë pjesa më e madhe e Amerikës Latine ngriti krye kundër sundimit europian dhe fitoi pavarësinë. Në pjesën e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë përsëri imperializmi Perëndimor i përtërirë e zgjeroi sundimin Perëndimor pothuaj mbi gjithë Afrikën, e përforcoi sundimin e Europës mbi Nënkontinent e gjetkë në Azi, kurse nga fillimi i shekullit të njëzetë faktikisht nënshtroi gjithë Lindjen e Mesme, me përjashtim të Turqisë, nën sundimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Perëndimit. Europeanët ose kolonitë e mëparshme europiane (në të dyja Amerikat) më 1800 zotëronin 35 për qind të sipërfaqes tokësore, 67 për qind më 1878 dhe 84 për qind më 1914. Nga viti 1920 përqindja u bë edhe më e madhe me copëtimin e Perandorisë Osmane ndërmjet Britanisë, Francës e Italisë. Më 1800 Perandoria Britanike përfshinte 1,5 milion milje katrore dhe 20 milionë

njerëz. Nga viti 1900 Perandoria viktoriane, mbi të cilën dielli nuk perëndonte asnjëherë, përfshinte 11 milionë milje katrore dhe 390 milionë njerëz.²⁷ Gjatë ekspansionit europian qytetërimi i Andeve dhe ai Mezoamerikan në të vërtetë u shfarosën, qytetërimi indian e ai islamik përgjatë Afrikës u mposhtën dhe u arrit depërtimi në Kinë, e cila iu nënshtrua ndikimit Perëndimor. Vetëm qytetërimet rus, japonez e etiopian, që të tre të qeverisur prej autoritetesh perandorake të centralizuara, qenë në gjendje t'i bënin ballë sulmit nga Perëndimi dhe të ruanin ekzistencën kuptimplote të pavarur. Për katërqind vjet marrëdhëniet ndërqytetërimore kishin një drejtim: nënshtrimin e shoqërive të tjera nga ana e qytetërimit Perëndimor.

Shkaqet e këtij zhvillimi dramatik e të pashembullt ishin: struktura shoqërore dhe marrëdhëniet e klasave në Perëndim, ngritja e qyteteve dhe e tregtisë, ndarja relative e pushtetit në shoqëritë Perëndimore ndërmjet monarkëve, shtresave të shoqërisë dhe autoriteve shekullare e fetare, ndjenja në rritje e vetëdijes kombëtare mes popujve të Perëndimit, si dhe zhvillimi i burokracive shtetërore. Mirëpo burimi i drejtpërdrejtë i zgjerimit të Perëndimit ka qenë teknologjia: zbulimi i mjeteve për lundrime në oqeanë për të shkuar në vendet e popujve të largët dhe zhvillimi i aftësive ushtarake për t'i pushtuar ato vende. Siç ka vënë në dukje Geoffrey Parker (Xhefri Parker), “Në një shkallë të madhe ngritja e Perëndimit varej nga ushtrimi i forcës, nga fakti se peshorja ushtarake ndërmjet europianëve e kundërshtarëve të tyre gjithnjë e më tepër anonte nga ana e të parëve; ...çelësi i suksesit të Perëndimorëve për të krijuar perandoritë e para të mirëfillta globale ndërmjet viteve 1500 e 1750 ishin pikërisht përmirësimet në aftësinë për të zhvilluar luftë, që kanë marrë emërtimin ‘revolucionit ushtarak.’” Zgjerimi i Perëndimit

u lehtësua gjithashtu prej epërsisë në organizimin, disiplinën dhe stërvitjen e trupave, e më pas nga epërsia në armatime, transport e logjistikë, si dhe në shërbimet mjekësore, që të gjitha rrjedhojë e rolit të tij udhëheqës në Revolucionin Industrial.²⁸ Perëndimi ngadhënjeu botën jo përmes epërsisë së ideve të tij ose të vlerave apo fesë (në të cilën ishin kthyer shumë pak njerëz të qytetërimeve të tjera), por për shkak të epërsisë në zbatimin e dhunës së organizuar. Perëndimorët shpesh e harrojnë këtë fakt; joperëndimorët asnjëherë nuk e harrojnë.

Aty nga viti 1910 bota ishte shumë më tepër e njësuar, sesa në çdo periudhë tjetër të historisë njerëzore. Përpjesa e tregtisë ndërkombëtare në prodhimin e përgjithshëm botëror ishte më e madhe sesa kurrë më parë, ndërsa do t'i afrohej kësaj gjendjeje vetëm në vitet 1970 e 1980. Investimet ndërkombëtare si përqindje të investimeve totale ishin më të larta se kurdoherë më parë.²⁹ Qytetërim donte të thoshte qytetërimi Perëndimor. E drejta ndërkombëtare ishte e drejta Perëndimore, që vinte nga tradita e Grotiusit. Sistemi ndërkombëtar ishte sistemi Perëndimor i Vestfalisë i shteteve kombe sovrane, por “të qytetëruara”, dhe i territoreve koloniale që i kishin në sundim.

Përftimi i këtij sistemi ndërkombëtar të përcaktuar nga Perëndimi ka qenë zhvillimi i dytë kryesor në politikën globale në shekujt pas vitit 1500. Përveç ndërveprimit sipas mënyrës sundim-nënshtim me shoqëritë joperëndimore, shoqëritë Perëndimore gjithashtu bashkëvepronin njëra me tjetrën mbi baza më të barabarta. Këto ndërveprime ndërmjet tërësive politike brenda të njëjtit qytetërim u ngjasonin atyre, që kishin ndodhur brenda qytetërimeve kinez, indian e grek. Ato bazoheshin në homogjenitetin kulturor, i cili

nënkuptonte “gjuhën, të drejtën, fenë, praktikat administrative, bujqësinë, pronësinë e tokës dhe, ndoshta, farefisninë.” Popujt e Europës kishin “një kulturë të përbashkët dhe mbanin marrëdhënie të gjera nëpërmjet rrjetit të gjallë të tregtisë, lëvizjes së pandërprerë të njerëzve e ndërthurjes me krushqi të habitshme ndërmjet familjeve sunduese.” Ata në të vërtetë gjithashtu luftonin pa fund kundër njëri-tjetrit; paqja ndërmjet shteteve europiane ka qenë përjashtim dhe jo rregull.³⁰ Ndonëse për pjesën më të madhe të kësaj periudhe Perandoria Osmane kishte nën sundim deri në një të katërtën e asaj që përfytyrohej zakonisht si Europa, kjo perandori nuk quhej anëtare e sistemit ndërkombëtar europian.

Gjatë 150 vjetëve në politikën ndërqytetërore të Perëndimit kanë mbisunduar përçarja e madhe fetare dhe luftërat fetare e dinastike. Për një shekull e gjysmë pas Traktatit të Vestfalisë konfliktet brenda botës Perëndimore kanë qenë kryesisht ndërmjet princave: perandorëve, monarkëve absolutë dhe monarkëve kushtetues, që përpiqeshin t’i zgjeronin burokracitë e tyre, ushtritë, fuqinë ekonomike tregtare dhe, ajo që ishte më e rëndësishmja, territoret mbi të cilat sundonin. Gjatë këtij procesi ata krijuan shtete kombe dhe duke nisur me Revolucionin Francez vijat kryesore të konflikteve kanë qenë ndërmjet kombeve e jo më ndërmjet princave. Më 1793, siç e ka shprehur R.R. Palmeri, “Luftërat e mbretërve kishin marrë fund; kishin filluar luftërat ndërmjet popujve.”³¹ Ky model i shekullit të nëntëmbëdhjetë ka vijuar deri në Luftën e Parë Botërore.

Më 1917, si pasojë e Revolucionit Rus, konflikti ndërmjet shteteve kombe u zëvendësua me konfliktin e ideologjive, në fillim ndërmjet fashizmit, komunizmit e demokracisë liberale, kurse më pastaj ndërmjet këtyre dy

të fundit. Gjatë Luftës së ftohtë këto ideologji mishëroheshin te dy superfuqitë dhe secila e njëjtësonte veten më tepër sipas ideologjisë e asnjëra nuk ishte shtet komb në kuptimin tradicional evropian. Ardhja në pushtet e marksizmit në fillim në Rusi e pastaj në Kinë e Vietnam përbënte fazën kalimtare nga sistemi ndërkombëtar evropian te një sistem shumëqytetërimor pasevropian. Marksizmi ishte produkt i qytetërimit evropian, por as nuk zuri rrënjë dhe as nuk pati sukses atje. Në vend të kësaj e importuan në shoqëritë joperëndimore elitat revolucionare e në modernizim e sipër; Lenini, Maoja e Ho Shi Mini e përshtatën për synimet e tyre dhe e përdorën për t'iu kundërvënë fuqisë Perëndimore, për të mobilizuar popujt e tyre dhe për të afirmuar identitetin kombëtar e pavarësinë e vendeve të veta kundrejt Perëndimit. Shembja e kësaj ideologjie në Bashkimin Sovjetik dhe përshtatja e saj me ndryshime të ndjeshme në Kinë e në Vietnam, megjithatë, nuk do të thotë se doemos këto shoqëri do të importojnë ideologjinë tjetër Perëndimore të demokracisë liberale. Perëndimorët që mendojnë se do ta përqafojnë, ka gjasa të çuditen nga fryma krijuese, epshmëria dhe individualiteti i kulturave joperëndimore.

Ndërveprimet: një sistem shumëqytetërimor. Marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve në shekullin e njëzetë kështu, prej fazës me sundimin e ndikimit në një drejtim të një qytetërimi mbi gjithë të tjerët, kanë kaluar te ndërveprimet e dendura, të qëndrueshme dhe me shumë drejtime ndërmjet gjithë qytetërimeve. Nisën të zhdukeshin dy karakteristikat thelbësore të epokës së mëparshme të marrëdhënieve ndërqytetërimore.

Së pari, sipas shprehjeve të parapëlqyera të historianëve, “zgjerimi i Perëndimit” ka marrë fund dhe ka nisur “revolta kundër Perëndimit”. Fuqia e

Perëndimorëve ka rënë me hope, me ndërprerje e me prapakthime në të mirë të fuqisë së qytetërimeve të tjera. Harta e botës më 1990 i ngjante fare pak hartës së botës më 1920. Peshorja e fuqisë ekonomike e ushtarake dhe e ndikimit politik ishte zhvendosur (gjë që do ta gjurmojmë me hollësi më të mëdha në kreun e fundit). Perëndimi vijoi të ushtronte ndikim të ndjeshëm mbi shoqëritë e tjera, por gjithnjë e më shumë marrëdhëniet ndërmjet perëndimit e qytetërimeve të tjera u nënshtroheshin reagimeve të Perëndimit kundrejt zhvillimeve të atyre qytetërimeve. Shoqëritë joperëndimore jo vetëm nuk ishin më thjesht objekte të historisë, të cilën e bënte Perëndimi, por edhe gjithnjë e më shumë po bëheshin forca lëvizëse e formësuese e historisë së tyre dhe të historisë së Perëndimit.

Së dyti, si pasojë e këtyre zhvillimeve sistemi ndërkombëtar u zgjerua përtej Perëndimit e u bë shumëqytetërimor. Njëkohësisht, u shua konflikti ndërmjet shteteve Perëndimore, i cili kishte sunduar mbi këtë sistem për shekuj me radhë. Nga fundi i shekullit të njëzetë Perëndimi kishte dalë prej “fazës kontradiktore” të zhvillimit si qytetërim dhe po shkonte drejt fazës së “gjendjes universale”. Aty nga fundi i shekullit kjo fazë ende ishte e papërfunduar, pasi shtetet kombe të Perëndimit tuboheshin në dy shtete gjysmuniversale në Europë e në Amerikën e Veriut. Këto dy tërësi dhe njësitë e tyre përbërëse, megjithatë, janë të lidhura prej një rrjeti jashtëzakonisht të ndërlikuar lidhjesh institucionale zyrtare e jozyrtare. Shtetet universale të qytetërimeve të mëparshme ishin perandori. Megjithatë, ngaqë forma politike e qytetërimit Perëndimor është demokracia, shteti universal që po përftohet i qytetërimit Perëndimor nuk është perandori, por më tepër një përbërje federatash, konfederatash dhe organizatash e regjimesh ndërkombëtare.

Ideologjitë e mëdha politike të shekullit të njëzetë përfshijnë liberalizmin, socializmin, anarkizmin, fashizmin dhe demokracinë kristiane. Të gjitha kanë një gjë të përbashkët: janë produkte të qytetërimit Perëndimor. Asnjë qytetërim tjetër nuk ka prodhuar ndonjë ideologji politike të rëndësishme. Perëndimi, përkundrazi, asnjëherë nuk ka prodhuar ndonjë fe kryesore. Fetë e mëdha të botës janë që të gjitha prodhim i qytetërimeve joperëndimore dhe, në shumicën e rasteve, si kohë janë përpara qytetërimit Perëndimor. Ndërkohë që bota po del prej fazës Perëndimore, ideologjitë tipike për qytetërimin e vonë Perëndimor janë në rënie, ndërsa vendin e tyre e zënë format fetare dhe format e tjera me bazë kulturore për identitetin dhe anësinë. Shkëputjes së bërë në Vestfali midis fesë e politikës ndërkombëtare, një prodhim karakteristik i qytetërimit Perëndimor, po i vjen fundi dhe feja, siç na e shpreh Eduard Mortimeri, “gjithnjë e më tepër ka gjasa të ndërhyjë në punët ndërkombëtare.”³² Përplasja ndërqytetërimore e ideve politike, pjellë e Perëndimit, po zëvendësohet prej përplasjes ndërqytetërimore të kulturës e fesë.

Gjeografia politike globale, rrjedhimisht, prej një bote më 1920 ka kaluar te tri botë në vitet 1960 dhe te më shumë se gjysmë duzine botësh në vitet 1990. Krahas kësaj, perandoritë globale Perëndimore të viteve 1920 u rrudhën te “Bota e lirë” mjaft më e kufizuar e viteve 1960 (që përfshinte shumë shtete joperëndimore të kundërvëna komunizmit) dhe më pas te “Perëndimi” edhe më i kufizuar i viteve 1990. Kjo zhvendosje semantikisht është pasqyruar ndërmjet viteve 1988 e 1993 te rënia nga përdorimi i termit ideologjik “Bota e lirë” dhe te shtimi i përdorimit të termit qytetërimor “Perëndimi” (shih Tabelën 2.1). Kjo duket gjithashtu te shtimi i referimeve për Islamin si dukuri kulturore-

politike, për “Kinën e Madhe”, Rusinë e “shtetet e afërta rrethuese”, si dhe për Bashkimin Europian, që të gjithë terma me përmbajtje qytetërimore. Marrëdhëniet ndërqytetërimore në këtë fazë të tretë janë shumë më të dendura e të shpeshta sesa kanë qenë në fazën e parë, si dhe shumë më të barabarta e të anasjella sesa kishin qenë në fazën e dytë. Gjithashtu, ndryshe nga Lufta e ftohtë, nuk mbisundon një çarje e vetme, por ka shumë çarje ndërmjet Perëndimit e qytetërimeve të tjera dhe mes shumë qytetërimeve joperëndimore.

Siç e ka trajtuar Hedley Bull-i (Hedli Bull), një sistem ndërkombëtar ekziston, kur “dy ose më shumë shtete kanë kontakt të mjaftë ndërmjet tyre dhe kanë ndikim të mjaftë mbi vendimet e njëri-tjetrit, duke bërë, të paktën deri në një farë shkalle, që të sillen si pjesë të një të tërë.” Mirëpo një shoqëri ndërkombëtare ekziston vetëm kur shtetet në sistemin ndërkombëtar kanë “interesa të përbashkët dhe vlera të përbashkëta,” “e vështrojnë veten të lidhura prej një tufe të përbashkët rregullash,” “kanë të njëjtin funksionim të institucioneve të përbashkëta,” dhe kanë “një kulturë ose qytetërim të përbashkët.”³³ Ashtu si paraardhësit e tij: shumerë, grekë, helenë, kinezë, indianë e islamikë, sistemi ndërkombëtar europian i shekujve nga i shtatëmbëdhjeti deri te i nëntëmbëdhjeti ka qenë gjithashtu shoqëri ndërkombëtare. Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë e të njëzetë sistemi ndërkombëtar europian u zgjerua dhe në të vërtetë përfshiu të gjitha shoqëritë në qytetërimet e tjera. Disa institucione e praktika europiane gjithashtu u eksportuan në këto vende. Po përsëri këtyre shoqërive u mungon kultura e përbashkët, që është nënshtresa e shoqërisë ndërkombëtare europiane. Me termat e teorisë britanike të marrëdhënieve ndërkombëtare, bota rrjedhimisht është një sistem ndërkombëtar i zhvilluar

mirë, por në rastin më të mirë është vetëm një shoqëri ndërkombëtare mjaft primitive.

Tabela 2.1:
Përdorimi i termave “Bota e lirë” dhe “Perëndimi”

	Numri i përmendjeve		% e ndryshimit në përmendjet
	1988	1993	
New York Times			
Bota e Lirë	71	44	- 38
Perëndimi	46	144	+ 213
Washington Post			
Bota e Lirë	112	67	- 40
Perëndimi	36	87	+ 142
Congressional Record			
Bota e Lirë	356	114	- 68
Perëndimi	7	10	+ 43

Burimi: *Lexis/Nexis*. Numrat e përmendjeve janë numrat e artikujve për këta terma ose që përmbajnë termat “bota e lirë” ose “Perëndimi”. Përmendjet për “Perëndimin” janë shqyrtuar për të parë përshtatjen e kontekstit, në mënyrë që të dalë e sigurtë se termi e përmend “Perëndimin” si qytetërim ose si tërësi politike.

Secili qytetërim e sheh veten si qendër të botës dhe e shkruan historinë e vet si dramën qendrore të historisë njerëzore. Ndoshta kjo ka qenë për Perëndimin edhe më e vërtetë sesa për kulturat e tjera. Këto pikëpamje njëqytetërimore, megjithatë, e kanë humbur gjithnjë e më shumë peshën dhe dobinë në botën shumëqytetërimore. Prej kohësh këtë të vërtetë të zakonshme e kanë pranuar studiuesit e qytetërimeve. Më

1918 Shpengleri ka denoncuar vështrimin dritëshkurtër të historisë, që mbizotëronte në Perëndim me ndarjen e prerë në fazat: e lashtë, mesjetare dhe e re lidhur vetëm me Perëndimin. Ai ka thënë, se është e nevojshme të zëvendësohet ky “qëndrim ptolemeik ndaj historisë” me një qëndrim kopernikan dhe në vend të “trillimit të zbrazët për një histori *vijëzore*, të vihet drama e një *numri* kulturash të fuqishme.”³⁴ Pak dhjetëvjeçarë më vonë Toinbi ka qortuar rëndë “ngushtësinë dhe arrogancën” e Perëndimit, të shfaqur në “iluzionet egocentrike” se bota rrotullohej rreth tij, se kishte një “Lindje të pandryshueshme” dhe se “përparimi” ishte i pashmangshëm. Ashtu si Shpengleri, ai nuk e përdorte hamendësimin për unitetin e historisë, hamendësimin se ka “vetëm një lumë qytetërimi, ai yni, dhe se gjithë të tjerët janë ose dikues të tij, ose humbasin në rërat e shkretëtirës.”³⁵ Pesëdhjetë vjet pas Toinbit, Brodeli po ashtu shtronte nevojën që të luftohej për një perspektivë më të gjerë dhe për të kuptuar “konfliktet e mëdha kulturore në botë dhe shumësinë e qytetërimeve të saj.”³⁶ Megjithatë iluzionet e paragjykimet, për të cilat kishin paralajmëruar këta studiues, vazhdojnë të jetojnë dhe nga fundi i shekullit të njëzetë lulëzuan më tej në vetëmburrjen e përhapur gjerësisht e mendjengushtë, se qytetërimi evropian i Perëndimit sot është qytetërimi universal i botës.

Kreu 3: Një qytetërim universal? Modernizimi dhe Perëndimorizimi

Qytetërimi universal: kuptimet

Disa njerëz shprehen se kjo epokë është dëshmitare e ngjizjes së atij, që V.S. Naipauli e ka quajtur “qytetërim universal.”¹ Çfarë kuptohet me këtë term? Ideja e tij nënkupton përgjithësisht përbashkimin kulturor të njerëzimit dhe pranimin gjithnjë e më shumë të vlerave, besimeve, orientimeve, praktikave e institucioneve të përbashkëta nga popujt në mbarë botën. Në mënyrë më të zbërthyer, kjo ide mund të ketë kuptimin e disa gjërave, që janë të thella por pa peshë, disa që janë me peshë por jo të thella dhe disa që janë pa peshë e të sipërfaqshme.

E para, qeniet njerëzore në të vërtetë në të gjitha shoqëritë kanë të përbashkëta disa vlera themelore, si vrasja është gjë e keqe, dhe disa institucione themelore, si ndonjë formë e familjes. Shumica e popujve në shumicën e shoqërive kanë një “ndjenjë morale” të ngjashme, një moralitet minimal “të hollë” të koncepteve bazë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar.² Nëse kjo është çka nënkuptohet me qytetërimin

universal, kemi diçka të thellë e me rëndësi të madhe, por përsëri diçka që nuk është as e re dhe as me peshë për këtë rast. Nëse njerëzit kanë pasur gjatë gjithë historisë disa vlera themelore dhe institucione të përbashkëta, kjo mund të shpjegojë disa konstante të sjelljes së njeriut, por nuk mund ta ndriçojë ose ta shpjegojë historinë, e cila përbëhet prej ndryshimesh të sjelljes njerëzore. Për më tepër, nëse ekziston një qytetërim universal i përbashkët për gjithë njerëzimin, çfarë termi do të përdornim atëherë për të përcaktuar grupimet kryesore kulturore të njerëzimit, përveç nocionit të racës njerëzore? Njerëzimi ndahet në nëngrupe: fise, kombe dhe tërësi më të gjera kulturore, që zakonisht quhen qytetërim. Nëse termi qytetërim lartësohet e kufizohet për gjithçka është e përbashkët për njerëzimin si tërësi, atëherë ose na duhet të shpikim një term tjetër për të shënuar grupimet më të gjera të njerëzve, me përjashtim të njerëzimit si tërësi, ose na duhet të pranojmë se këto grupime të gjera, por jo përfshirëse të gjithë njerëzimit, do të avullohen. Për shembull, Vaclav Haveli është shprehur se “ne sot jetojmë në një qytetërim të vetëm global” dhe se kjo “nuk është gjë tjetër, veçse një tis i hollë” që “mbulon ose fsheh larminë e pafund të kulturave, popujve, feve botërore, traditave historike dhe qëndrimeve të formuara historikisht e të gjitha këto, në një farë kuptimi, shtrihen ‘poshtë’ tij.”³ Megjithatë, arrihet vetëm te një pështjellim semantik, nëse e kufizojmë “qytetërimin” me nivelin global dhe i shënojmë si “kultura” ose si “nënqytetërim” tërësitë më të gjera kulturore, të cilat historikisht kurdoherë janë quajtur qytetërim.

³ Hayward Alker-i ka vënë drejt në dukje, se në artikullin tim të botuar në *Foreign Affairs* “e kam hedhur poshtë prerazi” idenë e qytetërimin botëror,

E dyta, termi “qytetërim universal” mund të përdoret për të shënuar çka kanë të përbashkët shoqëritë e qytetëruara, si qytetet e shkollimin, të cilat i dallojnë prej shoqërive primitive e barbarëve. Natyrisht, ky ishte kuptimi i veçantë i termit në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe nga kjo anë po përftohet një qytetërim universal, madje për tmerrin e antropologëve të ndryshëm dhe të të tjerëve, që e shohin me frikë zhdukjen e popujve primitivë. Qytetërimi në këtë kuptim hap pas hapi është zgjeruar gjatë mbarë historisë së njerëzimit dhe përhapja e qytetërimit në numrin njëjës ka qenë mjaft e pajtueshme me ekzistencën e shumë qytetërimeve në numrin shumës.

E treta, termi “qytetërimi universal” mund të shënojë gjykimet, vlerat dhe doktrinën, të cilave u përmbahen shumë njerëz në qytetërimin Perëndimor, si dhe disa njerëz në qytetërimet e tjera. Kjo mund të quhet Kultura e Davosit. Çdo vit rreth një mijë biznesmenë, bankierë, zyrtarë qeveritarë, intelektualë dhe gazetarë nga disa dhjetëra vende mbledhen në Forumin Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës. Pothuaj të gjithë këta njerëz kanë grada universitare në shkencat fizike, shoqërore, në biznes ose drejtësi, punojnë me fjalët dhe/ose shifrat, e njohin mjaft rrjedhshëm anglishten, janë të punësuar nga qeveritë, korporatat e institucionet akademike me lidhje të gjera ndërkombëtare, si dhe udhëtojnë shpesh jashtë vendeve

pasi e kam përkufizuar qytetërimin si “grupimin më të lartë kulturor të njerëzve dhe nivelin më të gjerë të identitetit kulturor të njerëzve, përtej të cilit mbetet ajo që i dallon njerëzit prej llojeve të tjera.” Natyrisht, kjo është mënyra sesi është përdorur termi prej shumicës së studiuesve të qytetërimit. Megjithatë, në këtë krye e kam bërë më të çlirët përkufizimin, për të dhënë mundësinë që popujt në mbarë botën të njëjtësohen me një kulturë globale të dalluar, e cila plotëson ose zëvendëson qytetërimet në kuptimin Perëndimor, islamik ose sinik.

të tyre. Përgjithësisht ata kanë të përbashkët besimin te individualizmi, ekonomia e tregut dhe demokracia liberale, gjëra që janë të përbashkëta edhe për njerëzit e qytetërimit Perëndimor. Njerëzit e Davosit në të vërtetë kontrollojnë gjithë institucionet ndërkombëtare, mjaft nga qeveritë e botës dhe bërthamën qendrore të aftësive ekonomike e ushtarake të botës. Rrjedhimisht, Kultura e Davosit është jashtëzakonisht e rëndësishme. Mirëpo në shkallë botërore, sa njerëz e kanë të përbashkët këtë kulturë? Jashtë Perëndimit ka gjasa që ta kenë më pak sesa 50 milion njerëz, ose 1 për qind e popullsisë së botës, e ndoshta më pak sesa një e dhjeta e 1 për qindëshit të popullsisë së botës. Është tepër larg për të qenë kulturë universale dhe udhëheqësit, që e kanë të përbashkët Kulturën e Davosit, jo doemos e kanë dorën të fortë mbi pushtetin në shoqëritë e tyre. Kjo “kulturë e përbashkët intelektuale ekziston”, siç e ka vënë në dukje Hedley Bull-i (Hedli Bulli), “vetëm në nivelin e elitës: rrënjët e saj janë të cekëta në mjaft shoqëri ... [dhe] është e dyshimtë që, madje në nivelin diplomatik, ajo përfshin çka quhet kultura e përbashkët morale ose tufa e vlerave të përbashkëta, të dallueshme prej një kulture intelektuale të përbashkët.”⁴

E katërta, është parashtruar ideja se përhapja e modeleve të konsumit dhe të kulturës popullore Perëndimore rreth e rrotull botës po krijon qytetërimin universal. Ky argument nuk është as i thellë dhe as me shumë peshë. Trillet kulturore janë bartur nga njëri qytetërim te tjetri përgjatë historisë. Risitë e një qytetërimi rregullisht merren edhe nga qytetërimet e tjera. Megjithatë, këto janë ose teknika, të cilat nuk japin rrjedhime kulturore domethënëse, ose trille, që vijnë e shkojnë pa e ndryshuar kulturën nënshtresë të qytetërimit marrës. Importime të tilla “ngecin” në qytetërimin marrës ose sepse janë ekzotike, ose sepse

hyjnë me imponim. Në shekujt e mëparshëm botën Perëndimore herë pas here e rrëmbente entuziazmi për sende të ndryshme nga kultura kineze ose hindu. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë importimet kulturore prej Perëndimit u bënë të zakonshme në Kinë e Indi, sepse dukej që pasqyronin pushtetin e Perëndimit. Argumentimi sot, se përhapja e kulturës pop dhe e mallrave të konsumit në mbarë botën përfaqëson ngadhënjimin e qytetërimit Perëndimor, e banalizon kulturën Perëndimore. Thelbi i qytetërimit Perëndimor është Magna Carta dhe jo Magna Mac. Fakti që joperëndimorët mund të kafshojnë këtë të dytën, nuk ka si pasojë që do të pranojnë të parën.

E po ashtu nuk ka rrjedhoja për qëndrimin e tyre kundrejt Perëndimit. Diku në Lindjen e Mesme një gjysmë duzine të rinjsh fare mirë mund të vishen me xhinse, të pijnë kokakola, të dëgjojnë muzikën rep dhe, ndërsa përkulen në drejtim të Mekës, montojnë pjesët e një bombe për të hedhur në erë një aeroplan amerikan të linjave ajrore. Gjatë viteve 1970 e 1980 amerikanët kanë përdorur me miliona automobila, televizorë, kamera dhe pajisje elektronike japoneze pa u “japonizuar”, madje kanë marrë një qëndrim më të ndjeshëm kundërshtues kundrejt Japonisë. Vetëm arroganca naive mund t'i bëjë Perëndimorët të mendojnë se joperëndimorët do të “perëndimorizohen” duke blerë mallra Perëndimore. E në të vërtetë, çfarë i thuhet botës lidhur me Perëndimin, kur perëndimorët e njëjtësojnë qytetërimin e tyre me pijet e gazuara, me pantallonat e çngjyrosura dhe ushqimet e yndyrshme?

Një variant tjetër pak më i stërholluar i argumentimit për kulturën popullore universale përqendrohet jo te mallrat e konsumit përgjithësisht, por te mjetet e komunikimit masiv, te Hollivudi e jo te kokakola. Mbajtja në duar globalisht nga amerikanët e

filmit, televizionit dhe industrisë së videove madje e kapërcen mbizotërimin e tyre në industrinë e aviacionit. Tetëdhjetë e tetë nga njëqind filma që u panë më shumë në mbarë botën më 1993 ishin amerikane dhe dy organizata amerikane e dy europiane sundojnë grumbullimin e përhapjen e lajmeve në shkallë globale.⁵ Kjo gjendje pasqyron dy dukuri. E para është natyra universale e interesimit të njeriut për dashurinë, seksin, dhunën, të fshehtën, heroizmin e pasurinë, si dhe aftësia e shoqërive, para së gjithash amerikane, që rendin pas fitimeve për t'i shfrytëzuar këta interesa në dobi të vet. Mirëpo ka pak ose nuk ka fare dëshmi për të mbështetur mendimin, se zhvillimi i komunikimeve globale gjithëpërfshirëse po sjell konvergjinë e ndjeshëm të qëndrimeve e të besimeve. Siç ka thënë Michael Vlahos-i (Majkëll Vllahos), "Argëtimi nuk është i barabartë me kthimin në një kulturë të caktuar." E dyta, njerëzit i interpretojnë komunikimet sipas vlerave e perspektivave të veta të mëparshme. "Po ato imazhe pamore të transmetuara njëkohësisht brenda dhomave të banimit në mbarë botën, - ka vënë në dukje Kishore Mahbubani, - ngjallin perceptime të kundërvëna. Në dhomat e banimit të Perëndimorëve duartrokitet kur raketat kruiz godasin Bagdadin. Shumica e atyre që jetojnë jashtë e shohin se Perëndimi do të hakmerret pa vonesë ndaj irakenëve ose somalezëve jo të bardhë, por jo ndaj serbëve të bardhë, çka është një sinjal i rrezikshëm nga çfarëdo standard që të vështrohet."⁶

Komunikimet globale janë një prej shfaqjeve më të rëndësishme bashkëkohore të pushtetit Perëndimor. Mirëpo kjo hegjemoni Perëndimore nxit politikanët populistë në shoqëritë joperëndimore që të denoncojnë imperializmin kulturor Perëndimor dhe t'i bëjnë thirrje publikut të tyre që të ruajë mbijetesën e integritetin e kulturës vendëse. Përmasa e mbisundimit të

komunikimeve globale nga Perëndimi është, rrjedhimisht, një burim kryesor i pakënaqësisë e i armiqësisë së popujve joperëndimorë kundër Perëndimit. Për më tepër, nga fillimi i viteve 1990 modernizimi dhe zhvillimi ekonomik në shoqëritë joperëndimore po çonin te ngritja e industrive vendëse e rajonale të mediave, që kënaqin shijet e dalluara të këtyre shoqërive.⁷ Për shembull, më 1994 CNN-i ndërkombëtar ka bërë një vlerësim, se kishte si auditor rreth 55 milion shikues të mundshëm, ose rreth 1 për qind të popullsisë së botës (është e habitshme që del i barabartë si numër dhe pa dyshim në masë të gjerë i njëjtë me njerëzit e Kulturës së Davosit) dhe presidenti i tij parashikonte që emisionet anglisht në fund të fundit mund të kapnin 2 deri në 4 për qind të tregut. Që këtej do të lindnin rrjetet rajonale (d.m.th. qytetërimore) me emisione spanjisht, japonisht, arabisht, frëngjisht (për Afrikën Perëndimore) dhe gjuhë të tjera. Tre studiues kanë ardhur në përfundimin se “Studioja Globale e Lajmeve ende vijon të përballet me Kullën e Babelit.” Ronald Doreja ka bërë një përpjekje të fortë për të vërtetuar përfundimin e kulturës intelektuale globale ndërmjet diplomatëve dhe zyrtarëve publikë. Mirëpo edhe ai vjen te një përfundim mjaft i përcaktuar, lidhur me ndikimin e komunikimeve të fuqizuara: “*nëse gjërat e tjera mbeten të pandryshuara* [kursivi është i tij], shtimi i dendësisë së komunikimit do të duhej të siguronte një bazë gjithnjë e më të madhe për ndjenjat miqësore ndërmjet kombeve, ose të paktën të klasave të mesme, apo tek e fundit të diplomatëve në mbarë botën,” por ai shton: “disa gjëra që mund të mos jenë të pandryshuara, në të vërtetë mund të dalin shumë të rëndësishme.”⁹

Gjuha. Elementët qendrorë të çfarëdo kulture ose qytetërimi janë gjuha dhe feja. Nëse po përftohet

qytetërimi universal, atëherë duhet të ketë prirje drejt përfitimt të një gjuhe universale e të një feje universale. Ky mëtim shprehet shpesh lidhur me gjuhën. “Gjuha botërore është anglishtja,” siç e ka shprehur redaktori i *Wall Street Journal*.¹⁰ Kjo mund të nënkuptojë dy gjëra, prej të cilave vetëm njëra do ta mbështeste çështjen e një qytetërimi universal. Mund të ketë kuptimin, që një përpjesë në rritje e popullsisë së botës flet anglisht. Nuk ka dëshmi që ta mbështesin këtë hamendje dhe dëshmitë më të besueshme, të cilat kuptohet se nuk mund të jenë shumë të përpikëta, tregojnë pikërisht të kundërtën. Të dhënat që kemi mbulojnë periudhën prej më shumë se tre dhjetëvjeçarësh (1958-1992) dhe na tregojnë se modeli i përgjithshëm i përdorimit gjuhësor në botë nuk ka ndryshuar në mënyrë të befasishme, se ka pasur rënie të ndjeshme në përpjesën e njerëzve që flasin anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht e japonisht, se një rënie e vogël ka ndodhur në përpjesën e folësve të mandarinishtes, kurse shtesa ka pasur në përpjesat e njerëzve që flasin hindishten, malaja-indonezishten, arabishten, bengalishten, spanjishten, portugalishten e gjuhë të tjera. Folësit e anglishtes në botë kanë rënë nga 9,8 për qind të njerëzve që më 1958 flisnin gjuhë të përdorura prej të paktën 1 milion njerëzish te 7,6 për qind më 1992 (shih Tabelën 3.1). Përpjesa e popullsisë së botës që flet pesë gjuhët kryesore Perëndimore (anglishten, frëngjishten, gjermanishten, portugalishten e spanjishten) ka rënë prej 24,1 për qind më 1958 te 20,8 për qind më 1992. Më 1992 afërsisht dy herë më shumë njerëz kanë folur mandarinisht, 15,2 për qind e popullsisë së botës, kundrejt atyre që flisnin anglisht, dhe një shtesë prej 3,6 për qind fliste variante të tjera të kinishtes (shih Tabelën 3.2).

Në një kuptim, gjuha që është e huaj për 92 për qind të popullsisë së botës nuk mund të jetë gjuha botërore.

Mirëpo në një kuptim tjetër, ajo mund të cilësohet e tillë, nëse është gjuha e përdorur nga njerëzit e grupeve dhe kulturave të tjera gjuhësore për të komunikuar me njëri-tjetrin, nëse është lingua franca e botës, ose me terma të gjuhësisë, është Gjuha e Komunikimit më të Gjerë (GKG) kryesore e botës.¹¹ Njerëzit që kanë nevojë të komunikojnë me njëri-tjetrin duhet të gjejnë mjetin për këtë. Në një shkallë të caktuar ata mund të mbështeten te profesionistët e kualifikuar posaçërisht, të cilët i flasin lirisht dy a më shumë gjuhë dhe shërbejnë si përkthyes me shkrim e me gojë. Mirëpo kjo është një mënyrë e vështirë, që merr kohë dhe e shtrenjtë. Prandaj gjatë historisë lindin lingua franca (gjuhët e përdorimit nga popuj të ndryshëm), si latinishtja në periudhën klasike dhe mesjetare, frëngjishtja për disa shekuj në Perëndim, suahili në shumë pjesë të Afrikës dhe anglishtja për pjesën më të madhe të botës në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë. Diplomatët, biznesmenët, shkencëtarët, turistët dhe shërbimet që bëhen për ta, pilotët e linjave ajrore e kontrollorët e qarkullimit kanë nevojë për një mjet komunikimi të frytshëm me njëri-tjetrin dhe sot për këtë shërben kryesisht anglishtja.

Tabela 3.1:
Folësit e gjuhëve më të mëdha

(Përqindjet e popullsisë së botës^{*})

Gjuha	Viti			
	1958	1970	1980	1992
Arabishtja	2,7	2,9	3,3	3,5
Bengalishtja	2,7	2,9	3,2	3,2
Anglishtja	9,8	9,1	8,7	7,6

^{*} Numri i përgjithshëm i njerëzve që flasin gjuhë të folura prej mbi 1 milion njerëz

Hindishtja	5,2	5,3	5,3	6,4
Mandarinishtja	15,6	16,6	15,8	15,2
Rusishtja	5,5	5,6	6,0	4,9
Spanjishtja	5,0	5,2	5,5	6,1

Burimi: Përqindjet janë llogaritur prej të dhënave të hartuara nga profesor Sidney S. Culbert, Departamenti i psikologjisë, Universiteti i Uashingtonit, Seattle, për numrin e njerëzve që flasin gjuhë të folura prej 1 milion e më shumë njerëz dhe që paraqiten çdo vit në *World Almanac and Book of Facts*. Llogaritjet e tij përfshijnë si folësit e “gjuhës amëtare” edhe të “gjuhës jo amëtare”, ndërsa nga regjistrimet e popullsisë, kampionet e vëzhgimeve të popullsisë, vëzhgimet e emisioneve të radiove e televizioneve, janë nxjerrë të dhënat për shtimin e popullsisë, studimet dytësore e burime të tjera.

Tabela 3.2:
Folësit e gjuhëve kryesore kineze e perëndimore

Gjuha	1958		1992	
	Numri i folësve (në milion)	Përqindja e botës	Numri i folësve (në milion)	Përqindja e botës
Mandarinishtja	444	15,6	907	15,2
Kantonishtja	43	1,5	65	1,1
Vu	39	1,4	64	1,1
Min	36	1,3	50	0,8
Hakka	19	0,7	33	0,6
Gjuhët kineze	581	20,5	1119	18,8
Anglishtja	278	9,8	456	7,6
Spanjishtja	142	5,0	362	6,1
Portugalishtja	74	2,6	177	3,0
Gjermanishtja	120	4,2	119	2,0

Frëngjishtja	70	2,5	123	2,1
Gjuhët perëndimore	684	24,1	1237	20,8
Totali i botës	2845	44,5	5979	39,4

Burimi: Përqindjet të llogaritura prej të dhënave gjuhësore të hartuara nga profesori Sidney S. Culbert, Departamenti i psikologjisë, Universiteti i Uashingtonit, Seattle, dhe të paraqitura në *World Almanac and Book of Facts* për vitin 1959 dhe 1993.

Në këtë kuptim anglishtja është mënyra botërore për komunikimin ndërkulturor, ashtu si kalendari i krishterë është mënyra botërore për të ndjekur kohën, shifrat arabe janë mënyra për të bërë llogaritjet dhe sistemi metrik është për pjesën më të madhe të botës mënyra për të bërë matjet. Mirëpo përdorimi i anglishtes në këtë mënyrë është komunikim *ndërkulturor*; ai nënkupton ekzistencën e kulturave të veçanta. Lingua franca është një mënyrë për të kapërcyer dallimet gjuhësore e kulturore, jo një mënyrë për t'i zhdukur ato. Ajo është mjet komunikimi dhe jo burim njëjtësimi e përbashkësie. Nëse një bankier japonez dhe një biznesmen indonezian bisedojnë anglisht, kjo nuk do të thotë se secili prej tyre është anglicizuar ose perëndimorizuar. E njëjta gjë mund të thuhet për zviceranët folës të frëngjishtes e folës të gjermanishtes, të cilët ka gjasa të komunikojnë me njëri-tjetrin si anglisht, ashtu dhe me njërin prej gjuhëve të tyre kombëtare. Po kështu, mbajtja e anglishtes si gjuhë kombëtare shoqëruese në Indi, me gjithë planet e Nehrusë për të arritur të kundërtën, dëshmon dëshirën e fortë të popujve të Indisë që nuk flasin hindishten për të ruajtur gjuhët e kulturat e tyre, si dhe për nevojën që ka India për të qëndruar shoqëri shumëgjuhëshe.

Siç ka vënë në dukje gjuhëtari i njohur Joshua Fishman, një gjuhë ka më shumë të ngjarë të pranohet si lingua franca ose GKG, nëse nuk njëjtësohet me një grup etnik, fe ose ideologji të veçantë. Në të kaluarën anglishtja ka pasur mjaft njëjtësime të tilla. Kohët e fundit anglishtja është “çetnizuar (ose e etnizuar në shkallën më të ulët)”, siç kishte ndodhur në të kaluarën me akadishten, aramaishten, greqishten dhe latinishten. “Fakti që burimet e saj kryesore nuk janë vështuar gjerësisht ose thellësisht as si britanike, as si amerikane në një kontekst etnik a ideologjik *për çerekun e shekullit që kaloi ose aty afër* [kursivi i autorit], përbën një pjesë të fatit të mirë që ka pasur anglishtja si gjuhë plotësuese.”¹² Rrjedhimisht, përdorimi i anglishtes për komunikimin ndërkulturor ndihmon për të mbajtur dhe, në të vërtetë, për t’i përforcuar identitetet e veçanta kulturore të popujve. Pikërisht sepse njerëzit duan të ruajnë kulturën e vet, përdorin anglishten për të komunikuar me popujt e kulturave të tjera.

Njerëzit që flasin anglisht në mbarë botën po ashtu gjithnjë e më tepër po flasin anglishte të ndryshme. Anglishtja po indigenizohet dhe po merr ngjyrimë vendore, që e dallojnë prej anglishtes britanike e amerikane dhe që, në rastet e skajshme, i bëjnë këto anglishte pothuaj të pakuptueshme njëra me tjetrën, siç ndodh gjithashtu me variantet e kinishtes. Anglishtja nigeriane e përzier, anglishtja indiane dhe trajtat e tjera të anglishtes po përfshihen në kulturat përkatëse pritëse dhe ndoshta do të vijojnë të veçohen aq sa të bëhen gjuhë të lidhura por të dalluara, madje ashtu si gjuhët romane janë zhvilluar prej latinishtes. Ndryshe nga italishtja, frëngjishtja e spanjishtja, megjithatë, këto gjuhë të prejardhura prej anglishtes ose do të fliten nga një pjesë e vogël e njerëzve në atë shoqëri, ose do të

përdoren kryesisht për komunikimin ndërmjet grupeve të veçanta gjuhësore.

Të gjitha këto procese mund të shihen duke u kryer në Indi. Konkretisht, për shembull, më 1983 ka pasur 18 milion folës të anglishtes në një popullsi prej 733 milionë vetash dhe 20 milionë më 1991, kur popullsia arriti 867 milionë. Përpjesa e folësve të anglishtes në popullsinë indiane ka mbetur kështu e qëndrueshme me afërsisht 2 deri 4 për qind.¹³ Jashtë një elite relativisht të vogël, anglishtja nuk shërben si lingua franca. Siç pohojnë dy profesorë të anglishtes në Universitetin e Nju Delhit, “Realiteti i bazës është se kur dikush udhëton nga Kashmiri teposhtë drejt skajit më jugor në Kaniakumari, lidhjet e komunikimit mbahen më mirë me një trajtë të hindishtes sesa nëpërmjet anglishtes.” Veç kësaj, anglishtja indiane po fiton mjaft tipare të vetat: ajo po indianizohet ose më mirë po bëhet vendore, meqë po zhvillohen dallime ndërmjet folësve të ndryshëm të anglishtes me gjuhë vendore të dalluara.¹⁴ Anglishtja po përthithet në kulturën indiane po ashtu siç ka ndodhur dikur me sanskritishten e persishten.

Gjatë gjithë historisë përhapja e gjuhëve në botë ka pasqyruar përhapjen e fuqisë në botë. Gjuhët e folura më gjerësisht: anglishtja, mandarinishtja, spanjishtja, arabishtja, rusishtja, janë ose kanë qenë gjuhët e shteteve perandorake, që e nxisnin gjallërisht përdorimin e gjuhëve të tyre nga popujt e tjerë. Zhvendosjet në shtrirjen e pushtetit prodhojnë zhvendosje në përdorimin e gjuhëve. “Dy shekuj të pushtetit kolonial, tregtar, industrial, shkencor e fiskal të britanikëve dhe amerikanëve kanë lënë një trashëgimi thelbësore në arsimin e lartë, në qeverisje, tregti e teknologji” në mbarë botën.¹⁵ Britania e Franca kanë ngulmuar të përdorëshin gjuhët e tyre në kolonitë e tyre. Mirëpo pas fitimit të pavarësisë shumica e kolonive të mëparshme

janë përpjekur në shkallë të ndryshme dhe me arritje të ndryshme që ta zëvendësonin gjuhën perandorake me gjuhët e vendit. Gjatë kulmit të fuqisë së Bashkimit Sovjetik rusishtja ishte lingua franca që nga Praga deri në Hanoi. Rënia e fuqisë ruse u shoqërua me rënien paralele në përdorimin e rusishtes si gjuhë e dytë. Ashtu si me format e tjera të kulturës, fuqia në rritje përfton si ngulmimin nga folësit e gjuhës amtare, ashtu dhe nxitjen për ta mësuar gjuhën të tjerët. Në ditët e nxehta menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit e kur dukej sikur Gjermania e bashkuar ishte çudia e re, pati një prirje të dukshme që gjermanët, zotërues të mirë të anglishtes, të flisnin gjermanisht në mbledhjet ndërkombëtare. Fuqia ekonomike japoneze ka nxitur mësimin e japonishtet nga njerëzit jo japonezë, kurse zhvillimi ekonomik i Kinës po përfton një lulëzim të ngjashëm për kinishten. Në Hong Kong kinishtja po e zëvendëson me shpejtësi anglishten si gjuhë mbizotëruese¹⁶ dhe, duke mbajtur para sysh rolin e kinishtes përtej detit në Azinë Juglindore, është bërë gjuha në të cilën kryhet pjesa më e madhe e transaksioneve në këtë trevë të biznesit ndërkombëtar. Me rënien hap pas hapi të fuqisë së Perëndimit kundrejt qytetërimeve të tjera, përdorimi i anglishtes dhe i gjuhëve të tjera Perëndimore në shoqëritë e tjera e për komunikimin ndërmjet shoqërive gjithashtu pak nga pak do të gërryhet. Nëse në një farë pike në të ardhmen e largët Kina do t'i zërë vendin Perëndimit si qytetërimi mbizotërues në botë, anglishtja do t'ia lirojë rrugën mandarinishtes si lingua franca e botës.

Kur kolonitë e dikurshme nisën lëvizjen drejt pavarësisë dhe u bënë të pavarura, nxitja ose përdorimi i gjuhëve vendore dhe mënjanimi i gjuhëve të perandorisë ishin një nga mënyrat që elitat nacionaliste ta dallonin veten prej kolonialistëve Perëndimorë dhe të

përcaktonin identitetin e vet. Mirëpo pas pavarësisë elitat e këtyre shoqërive kishin nevojë ta dallonin veten prej njerëzve të zakonshëm të shoqërive të tyre. Zotërimi i rrjedhshëm i anglishtes, i frëngjishtes ose një gjuhe tjetër Perëndimore e plotësonte këtë. Si rrjedhim, elitat e shoqërive joperëndimore shpesh janë më të afta të komunikojnë me Perëndimorët e me njëra-tjetrën, sesa me njerëzit e shoqërisë së vet (një gjendje e ngjashme me atë në Perëndim në shekullin e shtatëmbëdhjetë e të tetëmbëdhjetë, kur aristokratët e vendeve të ndryshme komunikonin me lehtësi frëngjisht me njëri-tjetrin, por nuk flisnin dot gjuhën amtare të vendit të vet). Në shoqëritë joperëndimore po përvijohen dy prirje të kundërta. Nga njëra anë, anglishtja gjithnjë e më shumë po përdoret në nivelin universitar për t'i pajisur të diplomuarit me aftësinë që të kenë më shumë arritje në garën globale për kapitale e klientë. Nga ana tjetër, trysnitë shoqërore e politike gjithnjë e më tepër çojnë te përdorimi më i përgjithshëm i gjuhëve vendëse, e kështu arabishtja po zëvendëson frëngjishten në Afrikën e veriut, urduja po e mënjanon anglishten si gjuhën shtetërore e të arsimit në Pakistan, kurse mediat në gjuhën amtare po e zhvendosin anglishten në Indi. Ky zhvillim është parashikuar prej Komisionit Arsimor të Indisë më 1948, kur argumentonte se: “përdorimi i anglishtes ...i ndan njerëzit në dy kombe, një pakicë që qeveris dhe një shumicë që qeveriset, secila pjesë e paaftë për të folur gjuhën e tjetrës dhe duke mos e kuptuar njëra-tjetrën.” Dyzet vjet më vonë vijimi i anglishtes si gjuhë e elitës e vërtetonte këtë parashikim dhe kishte krijuar “një gjendje të panatyrshme në një demokraci në veprim, të mbështetur te e drejta e votës për të rriturit ...India anglishtfolëse dhe India politikisht e vetëdijshe po divergojnë gjithnjë e më shumë”, duke ngjallur “tensione

ndërmjet pakicës në krye, që di anglishten, dhe shumë milionave, me të drejtën e votës, që nuk e dinë.”¹⁷ Në atë masë që shoqëritë joperëndimore ngrenë institucione demokratike dhe njerëzit e këtyre shoqërive marrin pjesë më gjerësisht në qeverisje, përdorimi i gjuhëve Perëndimore bie dhe gjuhët vendëse bëhen më mbizotëruese.

Rënia e Perandorisë Sovjetike dhe fundi i Luftës së ftohtë i dhanë shtysë përhapjes e përtëritjes së atyre gjuhëve, të cilat ishin shtypur ose harruar. Përpyekje të mëdha janë bërë në shumicën e republikave të mëparshme sovjetike për të ringjallur gjuhët e tyre tradicionale. Estonishtja, letonishtja, lituanishtja, ukrainishtja, gjeorgjishtja e armenishtja sot janë gjuhët kombëtare të shteteve të pavarura. Ndër republikat myslimane ka ndodhur i njëjti rigjallërim gjuhësor dhe Azerbajxhani, Kirgizistani, Turkmenistani e Uzbekistani prej shkrimit cirilik të sundimtarëve të tyre rusë të mëparshëm kanë kaluar te shkrimi latin i faretisë të tyre turk, ndërsa Tashikistani persishtfolës ka zbatuar shkrimin arab. Nga ana tjetër, serbët tashmë e quajnë gjuhën e tyre serbishtja e jo serbokroatishtja dhe nga shkrimi latin i armiqve të tyre katolikë kanë kaluar te shkrimi cirilik i faretisë të tyre rus. Në drejtimin e kundërt paralel, kroatët sot e quajnë gjuhën kroatishtja dhe po përpiqen ta pastrojnë prej fjalëve turke e të tjera të huaja, ndërsa në Bosnjë po ato “huazime turke e arabe, një mbetje gjuhësore e lënë nga sundimi 450-vjeçar i Perandorisë Osmane në Ballkan, janë bërë përsëri të modës.”¹⁸ Gjuha rirreshtohet dhe rindërtohet për t’u përputhur me identitetet dhe kornizat e qytetërimeve. Me zgjerimin e pushtetit përhapet babilonizimi.

Feja. Gjasat që të përftohet një fe universale janë vetëm fare pak më shumë sesa për një gjuhë universale. Fundi i shekullit të njëzetë që dëshmitar i ringjalljes globale të feve në mbarë botën (shih f. 95-101). Kjo ringjallje solli përforcimin e vetëdijes fetare dhe daljen e lëvizjeve fundamentaliste. Rrjedhimisht, i përforcoi dallimet ndërmjet feve. Por jo domos ka sjellë zhvendosje të ndjeshme në përpjesëtimet e popullsisë së botës sipas përkatësisë në fetë e ndryshme. Të dhënat që kemi për pasuesit e feve janë edhe më të copëzuara e më pak të besueshme sesa të dhënat për folësit e gjuhëve. Tabela 3.3 paraqet shifrat e nxjerra prej një burimi të përdorur gjerësisht. Këto e të dhëna të tjera na bëjnë të mendojmë se sasia përkatëse në numër e feve në mbarë botën nuk ka ndryshuar ndjeshëm në këtë shekull. Ndryshimi më i madh që shënohet prej këtij burimi ka qenë shtimi i përpjesës së njerëzve të cilësuar “jofetarë” dhe “ateistë” nga 0,2 për qind më 1900 në 20,9 për qind më 1980. Kuptohet se kjo mund të pasqyrojë një largim të madh prej fesë dhe më 1980 ringjallja fetare sapo merrte hov. Megjithatë, ky shtim në 20,7 për qind i jobesimtarëve afrohet mjaft me 19,0 për qind të rënies së numrit të atyre, që quhen ithtarë të “feve popullore kineze” nga 23,5 për qind më 1900 në 4,5 për qind më 1980. Në të vërtetë ky barazim i shtesave me pakësimet na bën të mendojmë se me vendosjen e komunizmit një masë e madhe e popullsisë kineze thjesht u riklasifikua nga besimtarë popullorë në jobesimtarë.

Tabela 3.3:

Përpjesëtimi i popullsisë botërore që u përket traditave kryesore fetare

(në përqindje)

Viti

Feja	1900	1970	1980	1985 (vler)	2000 (vler)
E krishtere perëndimore	26,9	30,6	30,0	29,7	29,9
E krishtere ortodokse	7,5	3,1	2,8	2,7	2,4
Myslimane	12,4	15,3	16,5	17,1	19,2
Jofetarë	0,2	15,0	16,4	16,9	17,1
Hindu	12,5	12,8	13,3	13,5	13,7
Budiste	7,8	6,4	6,3	6,2	5,7
Kineze popullore	23,5	5,9	4,5	3,9	2,5
Fisnore	6,6	2,4	2,1	1,9	1,6
Ateistë	0,0	4,6	4,5	4,4	4,2

Burimi: David B. Barrett, red., *World Christian Encyclopedia: A comparative study of churches and religions in the modern world A.D 1900-2000* (Oxford: Oxford University Press, 1982).

Të dhënat tregojnë shtimin e përpjesave të popullsisë botërore, që u përkasin dy feve kryesore veprimtare për kthimin në besimtarë: islamit e krishterimit, gjatë tetëdhjetë vjetëve. Të krishterët perëndimorë janë llogaritur të 26,9 për qind e popullsisë botërore më 1900 dhe 30 për qind më 1980. Myslimanët janë shtuar shumë më fort nga 12,4 për qind më 1900 të 16,5 për qind, kurse sipas llogaritjeve të tjera 18 për qind më 1980. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit të njëzetë si islami, edhe krishterimi i kanë zgjeruar ndjeshëm shifrat e tyre në Afrikë dhe një ndryshim kryesor ndaj krishterimit ka ndodhur në Korenë e Jugut. Në shoqëritë që modernizohen me shpejtësi, nëse feja tradicionale nuk është e aftë të përshtatet me kërkesat e modernizimit, ka mundësi për përhapjen e krishterimit perëndimor dhe të Islamit. Në këto shoqëri protagonistët më të suksesshëm të kulturës Perëndimore

nuk janë ekonomistët neoklasikë ose demokratët kryqtarë, apo administratat e korporatave shumëkombëshe. Ata vijojnë dhe ka shumë të ngjarë që të vijojnë të jenë misionarë të krishterë. As Adam Smithi dhe as Tomas Xheferoni nuk i plotësojnë dot nevojat psikologjike, emocionale, morale e shoqërore të emigrantëve në qytete dhe të nxënësve që mbarojnë shkollat e mesme të brezit të parë. Edhe Jezu Krishti po ashtu nuk mund t'i plotësojë, por Ai ka më shumë gjasa që të ketë më tepër sukses.

Mirëpo në periudhën afatgjatë po fiton Muhamedi. Krishterimi përhapet kryesisht nëpërmjet kthimit në këtë fe, kurse islami nëpërmjet kthimit dhe shumëzimit. Përqindja e të krishterëve në botë e arriti kulmin me afër 30 për qind në vitet 1980, u barazua dhe sot është në rënie e ka mundësi që të arrijë afërsisht në 25 për qind të popullsisë botërore nga viti 2025. Si pasojë e përqindjes tejet të lartë të shtimit të popullsisë (shih kreun 5), përpjesa e myslimanëve në botë do të vijojë të shtohet fort, duke arritur 20 për qind të popullsisë botërore rreth fundit të shekullit, do ta kapërcejë numrin e të krishterëve disa vjet më vonë dhe ka mundësi të arrijë në rreth 30 për qind të popullsisë së botës aty nga viti 2025.¹⁹

Qytetërimi universal: burimet

Koncepti i një qytetërimi universal është prodhim i dallueshëm i qytetërimit Perëndimor. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë ideja e “barrës së njeriut të bardhë” ndihmoi për të përligjur zgjerimin e sundimit politik dhe ekonomik Perëndimor mbi shoqëritë joperëndimore.

Nga fundi i shekullit të njëzetë koncepti i një qytetërimi universal ndihmon për të përligjur mbizotërimin kulturor mbi shoqëritë e tjera dhe nevojën e këtyre shoqërive për të imituar praktikën e institucionet Perëndimore. Universalizmi është ideologjia e Perëndimit për ballafaqimin me kulturat joperëndimore. Siç ndodh shpesh me të mënjanuarit ose të kthyerit, ndër mbështetësit më entuziastë të idesë për një qytetërim të vetëm janë emigrantët intelektualë në Perëndim, si Naipauli dhe Fuad Axhami, për të cilët ky koncept jep një përgjigje tepër të kënaqshme për pyetjen themelore: Kush jam unë? Por termi që një intelektual arab ka përdorur për këta emigrantë është “Zezak i të bardhëve”,²⁰ dhe ideja për një qytetërim universal gjen fare pak mbështetje te qytetërimet e tjera. Joperëndimësit e shohin si Perëndimore atë çka Perëndimësit e shohin si universale. Atë që Perëndimorët e shohin si integrimin global të mirë, domethënë përhapjen e mediave mbarëbotërore, joperëndimorët e denoncojnë si imperializëm Perëndimor të pandershëm. Pikërisht po në atë shkallë që joperëndimorët e shohin botën si një, po aq e shohin si kërcënim.

Argumentet se po përftohet një farë qytetërimi universal mbështeten në një ose më shumë nga tre gjykimet se përse duhet të ndodhë kështu. I pari vjen mendimi i diskutuar në kreun 1, se shembja e komunizmit sovjetik do të thoshte fundi i historisë dhe fitorja universale e demokracisë liberale në mbarë botën. Ky argument vuan nga gabimi se i përmbahet një alternative të vetme. Ai i ka rrënjët në vështrimin prej kohës së Luftës së ftohtë, se e vetmja alternativë kundrejt komunizmit është demokracia liberale dhe se rrëzimi i të parit sjell universalizmin e së dytës. Mirëpo duket qartë, se ka shumë forma të autoritarizmit,

nacionalizmit, korporatizmit dhe komunizmit të tregut (si në Kinë), që janë gjallë e shëndoshë në botën e sotme. Ajo që ka më shumë domethënie, është se kemi të gjitha alternativat fetare, të cilat janë jashtë botës së ideologjive shekullare. Në botën e sotme feja është një forcë qendrore, ose ndoshta, *qendrorja* që shërben si shtysë dhe mobilizon njerëzit. Është thjesht mendjemadhësi të mendohet se, meqë u shemb komunizmi sovjetik, Perëndimi ka fituar përgjithmonë mbi botë dhe se myslimanët, kinezët, indianët e të tjerët po vrapojnë të përqafojnë liberalizmin Perëndimor si të vetmen alternativë. Ka mbaruar ndarja e njerëzimit nga Lufta e ftohtë. Mbeten ndarje më themelore të njerëzimit nga pikëpamja e etnive, feve e qytetërimeve, si dhe ngjallin konflikte të reja.

I dyti, ka një mendim se shtimi i ndërveprimit midis popujve: tregtia, investimet, turizmi, mediat, komunikimi elektronik përgjithësisht, po përftojnë një kulturë të përbashkët botërore. Në të vërtetë përmirësimet e teknologjisë së transportit e të komunikimit e kanë bërë më të lehtë e më të lirë qarkullimin e parave, mallrave, njerëzve, dijeve, ideve dhe pamjeve rreth e rrotull botës. Nuk ka ndonjë dyshim për shtimin e qarkullimit botëror të këtyre gjërave. Mirëpo ka mjaft dyshime lidhur me ndikimin e këtij qarkullimi të shtuar. A e ul apo e shton mundësinë e konfliktit tregtia? Mendimi se ajo i pakëson gjasat për luftë ndërmjet kombeve është, të paktën, i paprovuar dhe ka mjaft dëshmi për të kundërtën. Tregtia ndërkombëtare është zgjeruar ndjeshëm në vitet 1960 e 1970, kurse dhjetëvjeçarin pasues i erdhi fundi Luftës së ftohtë. Më 1913 megjithatë tregtia ndërkombëtare ishte në kulmet e saj, kurse pak vjet më pas kombet po e masakronin njëri-tjetrin në përmasa të papara.²¹ Nëse tregtia ndërkombëtare në atë nivel nuk mundi ta parandalonte luftën, kur mund ta bëjë? Dëshmitë thjesht

nuk i mbështesin mendimet liberale, ndërkombëtariste se tregtia nxit paqen. Analizat e bëra në vitet 1990 po ashtu e vënë në dyshim. Një studim ka arritur në përfundimin se “shtimi i tregtisë në sistemin ndërkombëtar, në vetvete, nuk ka gjasa që t’i ulë tensionet ndërkombëtare ose të mbështesë një stabilitet më të madh ndërkombëtar.”²² Një studim tjetër argumenton, se nivelet e larta të ndërvarësisë ekonomike “ose mund të sjellin paqen, ose mund të sjellin luftën, në varësi nga ajo që shpresohet për tregtinë e viteve të ardhshme.” Ndërvarësia ekonomike jep ndihmesë për paqen vetëm “kur shtetet shpresojnë që nivele të larta tregtie do të vazhdojnë në të ardhshmen e parashikueshme.” Nëse shtetet nuk shohin se do të vijojnë nivele të larta ndërvarësie, ka të ngjarë të bëhet luftë.²³

Pamundësia e tregtisë dhe e komunikimeve për të prodhuar paqen ose ndjenjën e përbashkët pajtohet me arritjet e shkencave shoqërore. Në psikologjinë sociale, teoria e dallimeve mëton se njerëzit e përcaktojnë veten sipas asaj që i bën të dallueshëm prej të tjerëve në një kontekst të veçantë: “njeriu e percepton veten sipas tipareve që e dallojnë prej njerëzve të tjerë, sidomos nga njerëzit në mjedisin e zakonshëm të dikuj ...një grua psikologe në shoqërinë e një duzine grash që merren me punë të tjera e mendon veten si psikologe; por kur është me një duzinë psikologësh burra e mendon veten si grua.”²⁴ Njerëzit e përcaktojnë identitetin sipas asaj çka nuk janë. Shtimi i komunikimeve, tregtisë dhe udhëtimeve i shumëfishon ndërveprimet e qytetërimeve dhe prandaj njerëzit gjithnjë e më tepër e quajnë me peshë më të madhe identitetin e tyre qytetërimor. Dy evropianë, një gjerman e një francez, duke ndërvepruar midis tyre do ta identifikojnë njëri-tjetrin si njëri gjerman e tjetri francez. Dy evropianë, një gjerman e një francez,

duke ndërvepruar me dy arabë, njëri nga Arabia Saudite e tjetri nga Egjipti, do ta përcaktojnë veten si europianë dhe arabë. Imigrimi i afrikanëve veriorë në Francë ngjall qëndrim armiqësor midis francezëve dhe njëkohësisht e shton pranueshmërinë e imigrimit të polakëve europianë katolikë. Amerikanët reagojnë shumë më negativisht kundrejt investimeve japoneze, sesa kundrejt investimeve më të mëdha nga vendet e Europës dhe Kanadaja. Po njësoj, siç e ka vënë në dukje Donald Horovici, “Një Ibo mund të jetë ...një Ibo Overri ose një Ibo Oniça aty ku ka qenë treva Lindore e Nigerisë. Në Lagos ai do të jetë thjesht një Ibo. Në Londër ai është nigerian. Në Nju-Jork është një afrikan.”²⁵ Nga ana e sociologjisë, teoria e globalizimit arrin te një përfundim i ngjashëm: “në botën gjithnjë e më tepër të globalizuar, të karakterizuar historikisht prej shkallëve të jashtëzakonshme të mënyrave qytetërore, sociale e të tjera të ndërvarësisë e rrjedhimisht të vetëdijës së përhapur, ka një *mprehje të lartë* të vetëdijës qytetërore, sociale dhe etnike.” Ringjallja fetare globale, “kthimi tek e shenja,” është një përgjigje e perceptimit të njerëzve për botën si “një vend i vetëm.”²⁶

Perëndimi dhe modernizimi

Argumenti i tretë dhe më i përgjithshmi për lindjen e një qytetërimi universal e sheh atë si rrjedhim të proceseve të gjera të modernizimit, që po kryhen prej shekullit të tetëmbëdhjetë. Modernizimi përfshin industrializimin, urbanizimin, ngritjen e shkallëve të shkollimit, edukimit, pasurisë e mobilizimit shoqëror, si dhe struktura punësimi më të ndërlikuara e të

larmishme. Ai është prodhim i zgjerimit të jashtëzakonshëm të dijeve shkencore e inxhinierike, të nisura në shekullin e tetëmbëdhjetë, që u dhanë mundësi njerëzve të sundonin e t'i jepnin trajtë mjedisit në rrugë tërësisht të panjohura më parë. Modernizimi është një proces revolucionar i krahasueshëm vetëm me kalimin prej shoqërive primitive të ato të qytetëruara, domethënë, lindja e qytetërimit në numrin njëjës, e nisur në luginat e Tigrisit e të Eufratit, të Nilit e të Indit rreth vitit 5000 para e.r.²⁷ Qëndrimet, vlerat, dijet dhe kultura e njerëzve në shoqërinë moderne ndryshojnë tepër nga ato në shoqërinë tradicionale. Si qytetërimi i parë i modernizuar, Perëndimi ka rolin udhëheqës në përvetësimin e kulturës së modernitetit. Ndërsa shoqëritë e tjera përvetësojnë modele të ngjashme të arsimit, punës, mirëqenies dhe strukturës klasore, siç e shpreh ky argument, kjo kulturë Perëndimore do të bëhet kultura universale e botës.

Nuk vihet në dyshim, se ka dallime të qenësishme ndërmjet kulturave tradicionale e moderne. Mirëpo prej këtij nuk rrjedh detyrimisht, që shoqëritë me kultura moderne i ngjasojnë njëra-tjetrës më shumë sesa shoqëritë me kultura tradicionale. Është e qartë se një botë, në të cilën disa shoqëri janë tepër moderne dhe disa ende tradicionale, do të jetë më pak homogjene sesa një botë, në të cilën të gjitha shoqëritë janë në shkallë të krahasueshme të larta të modernitetit. Por si ishte puna me një botë, në të cilën të gjitha shoqëritë ishin tradicionale? Kjo botë ka ekzistuar pak qindra vjet më parë. A ka qenë më pak homogjene, sesa ka të ngjarë të jetë bota e ardhshme e modernitetit universal? Ndoshta jo. “Kina e dinastisë Ming ...me siguri ka qenë më afër me Francën e kohës së Valuave,” arsyeton Brodeli, “sesa Kina e Mao Ce Dunit me Francën e Republikës së Pestë.”²⁸

E megjithatë shoqëritë moderne mund t'i ngjasojnë njëra-tjetrës më shumë sesa shoqëritë tradicionale për dy arsye. E para, ndërveprimi i shtuar ndërmjet shoqërive moderne mund të mos lindë një kulturë të përbashkët, por e lehtëson kalimin e teknikave, shpikjeve dhe të praktikave prej një shoqërie te tjetra me shpejtësinë dhe me përmasat, që ishin të pamundura në botën tradicionale. E dyta, shoqëria tradicionale mbështetet në bujqësi, shoqëria moderne mbështetet në industri, e cila e ka mundësinë e evoluimit prej artizanatit të industria e rëndë klasike dhe të industria e mbështetur në dijet. Modelet e bujqësisë e të strukturës shoqërore që u përshtaten janë shumë më të varura prej mjedisit natyror, sesa janë modelet e industrisë. Ato ndryshojnë sipas llojeve të tokës e të klimës e kështu mund të sjellin përfitim të formave të ndryshme të pronësisë mbi tokën, të strukturës shoqërore e të qeverisjes. Cilatdo qofshin meritat e tezës për qytetërimin hidraulik të Wittfogel-it (Vitfogel), bujqësia e mbështetur në ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të gjera të ujitjes nuk e nxit lindjen e autoriteteve politike të përqendruara dhe burokratike. Vështirë se mund të ndodhte ndryshe. Tokat pjellore dhe klima e mirë ka gjasa të nxisin zhvillimin e bujqësisë me plantacione në shkallë të gjerë dhe rrjedhimisht, daljen e strukturës shoqërore që përbëhet prej një klase të vogël pronarësh toke të pasur dhe të klasës së gjerë të fshatarëve, të skllëvërve ose të bujkrobërve që punojnë në plantacionet. Kushtet e papërshtatshme për bujqësinë në shkallë të gjerë mund të nxisin përfitim të një shoqërie me bujq të pavarur. Në shoqëritë bujqësore, shkurt, struktura shoqërore merr trajtë nga gjeografia. Industria, përkundrazi, është shumë më pak e varur prej mjedisit natyror vendës. Dallimet e organizimit industrial ka mundësi të vijnë prej dallimeve në kulturë e në

strukturën shoqërore dhe jo nga gjeografia, ndërsa të parat dallime mund të përfytyrohet që konvergjojnë, përkundrazi, të dytat nuk munden.

Rrjedhimisht, shoqëritë moderne kanë shumë gjëra të përbashkëta. Por a shkrihen domosdoshmërisht në homogjenitet? Argumenti se ndodh kështu mbështetet në mendimin se shoqëria moderne duhet të përafrohet te një tip i vetëm, te tipi Perëndimor, se qytetërimi modern është qytetërimi Perëndimor dhe se qytetërimi Perëndimor është qytetërimi modern. Mirëpo ky është një njëjtësim tërësisht i rremë. Qytetërimi Perëndimor lindi në shekullin e tetë e të nëntë dhe i zhvilloi tiparet karakteristike në shekujt pasues. Ai nisi të modernizohej vetëm në shekullin e shtatëmbëdhjetë e të tetëmbëdhjetë. Perëndimi ka qenë Perëndim shumë kohë përpara se të ishte modern. Tiparet qendrore karakteristike të Perëndimit, ato që e dallojnë prej qytetërimeve të tjera, vijnë përpara modernizimit të Perëndimit.

Cilat kanë qenë këto tipare dalluese të shoqërisë Perëndimore gjatë qindra vjetëve përpara se të modernizohej? Studiuesit e ndryshëm i kanë dhënë përgjigje kësaj pyetjeje me disa dallime të veçanta, por pajtohen për institucionet, praktikat dhe besimet kyç, që me të drejtë mund të përcaktohen si bërthama e qytetërimit Perëndimor. Ato përfshijnë sa më poshtë.²⁹

Trashëgimia klasike. Si qytetërim i brezit të tretë, Perëndimi ka trashëguar shumë gjëra prej qytetërimeve të mëparshme, duke përfshirë sidomos qytetërimin klasik. Gjërat e trashëguara nga Perëndimi prej qytetërimit klasik janë shumë, ndër to filozofia dhe racionalizmi grek, e drejta romake, latinishtja dhe krishterimi. Edhe qytetërimi islam e ortodoks trashëguan prej qytetërimit klasik, por asgjekundi në atë shkallë sa Perëndimi.

Katolicizmi dhe protestantizmi. Krishterimi Perëndimor, së pari katolicizmi e pastaj katolicizmi e protestantizmi, historikisht është tipari i vetëm më i rëndësishëm i qytetërimit Perëndimor. Gjatë pjesës më të madhe të mijëvjeçarit të parë të vet, në të vërtetë ajo çka sot quhet qytetërimi Perëndimor, quhej Krishterimi perëndimor; ka pasur një ndjenjë të zhvilluar mirë të përbashkësisë ndërmjet popujve të krishterë, se ishin të dalluar prej turqve, maurëve, bizantinëve e të tjerëve; Perëndimorët në shekullin e shtatëmbëdhjetë u nisën që ta pushtonin botën për Zotin e për arin. Reformacioni e Kundërreformacioni, si dhe ndarja e Krishterimit perëndimor në Veriun protestant e në Jugun katolik janë gjithashtu tipare dalluese të historisë së Perëndimit, që mungojnë tërësisht në Ortodoksinë lindore dhe janë mënjanuar në pjesën më të madhe prej përvojës së Amerikës Latine.

Gjuhët evropiane. Gjuha vjen e dyta vetëm pas fesë si faktor dallues i njerëzve të një kulture prej atyre të një tjetre. Perëndimi dallohet prej shumicës së qytetërimeve të tjera nga shumësia e gjuhëve. Japonishtja, hindishtja, mandarinishtja, ruishtja dhe madje arabishtja pranohen si gjuhët bërthama të qytetërimeve të tyre. Perëndimi trashëgoi latinishten, por lindën një varg kombesh dhe bashkë me to gjuhët kombëtare, të grupuara çlirtazi në kategoritë më të gjera të gjuhëve romane e gjermanike. Aty nga shekulli i shtatëmbëdhjetë këto gjuhë përgjithësisht kishin marrë trajtën e sotme.

Shkëputja e autoritetit shpirtëror prej atij laik. Gjatë gjithë historisë së Perëndimit në fillim ka ekzistuar Kisha e pastaj shumë kisha veçan nga shteti. Zoti dhe Cezari, kisha e shteti, autoriteti shpirtëror dhe autoriteti laik kanë qenë dysia mbizotëruese në kulturën Perëndimore. Vetëm në qytetërimin hindu feja dhe politika kanë qenë po kështu të ndara qartë. Në Islam, Zoti është Cezari; në

Kinë e Japoni Cezari është Zoti; në ortodoksi Zoti është ortaku depror i Cezarit. Shkëputjet dhe përplasjet e herëpashershme ndërmjet kishës e shtetit, që përbëjnë tipiken për qytetërimin Perëndimor, nuk ndeshen në asnjë qytetërim tjetër. Kjo ndarje e autoritetit ka dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme për zhvillimin e lirisë në Perëndim.

Sundimi i së drejtës. Koncepti i vendit qendror të së drejtës për ekzistencën e qytetëruar është trashëguar prej romakëve. Mendimtarët mesjetarë përpunuan idenë e së drejtës natyrore, në përshtatje me të cilën mendohej se monarkët do të ushtronin pushtetin e tyre, ndërsa në Angli u zhvillua e drejta tradicionale. Gjatë fazës së absolutizmit në shekullin e shtatëmbëdhjetë e të tetëmbëdhjetë sundimi i së drejtës më tepër respektohej në ndërkohët sesa në realitet, por mbetej e qëndrueshme ideja se pushteti i njeriut i nënshtrohej një farë kufizimi të jashtëm: “*Non sub homine sed sub Deo et lege.*” Tradita e sundimit të së drejtës hodhi bazat për kushtetutshmërinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e pronës, kundër ushtrimit të pushtetit arbitrar. Në shumicën e qytetërimeve të tjera e drejta ishte një faktor shumë më pak i rëndësishëm për formësimin e të menduarit e të sjelljes.

Pluralizmi shoqëror. Historikisht shoqëria Perëndimore ka qenë mjaft pluraliste. Siç e ka vënë në dukje Deutsch-i (Dojç), ana dalluese e Perëndimit është “krijimi dhe qëndrueshmëria e grupeve autonome të mbështetura jo në marrëdhëniet e gjakut ose të martesës.”³⁰ Duke nisur nga shekulli i gjashtë e i shtatë këto grupe në fillim përfshinin rendet e manastireve, manastiret dhe gildat, por pastaj u zgjeruan e në shumë treva të Europës përfshinë lloj-lloj shoqatash e shoqëri të tjera.³¹ Pluralizmi i shoqatave plotësohej me pluralizmin klasor. Shumica e shoqërive europiane

Perëndimore përmbanin një aristokraci relativisht të fortë e autonome, fshatarësinë e gjerë dhe një klasë të vogël por me peshë tregtarësh e dyqanxhinjsh. Fuqia e aristokracisë feudale kishte peshë të veçantë për kufizimin e shkallës, në të cilën absolutizmi ishte në gjendje të hidhte rrënjë të qëndrueshme në shumicën e shteteve europiane. Ky pluralizëm europian është në kontrast të mprehtë me varfërinë e shoqërisë civile, dobësinë e aristokracisë dhe fuqinë e perandorive burokratike të centralizuara, që kanë ekzistuar në Rusi, në Kinë, në viset osmane dhe në shoqëritë e tjera joperëndimore.

Organizmat përfaqësues. Që herët pluralizmi shoqëror solli lindjen e shtresave, të parlamenteve dhe të institucioneve të tjera për të përfaqësuar interesat e aristokracisë, klerit, tregtarëve e grupeve të tjera. Këta organizma siguronin forma përfaqësimi, të cilat gjatë modernizimit evoluuan për t'u bërë institucionet e demokracisë moderne. Në disa raste këta organizma u shfuqizuan ose fuqitë e tyre u kufizuan tepër gjatë periudhës së absolutizmit. Por edhe kur ndodhte kjo, përsëri, si në Francë, ato mund të ringjallehin për të dhënë mjetin e zgjerimit të pjesëmarrjes politike. Asnjë qytetërim tjetër bashkëkohor nuk ka një trashëgimi të krahasueshme organizmesh përfaqësues, që shtrihen prapa për një mijëvjeçar. Gjithashtu në nivelin vendor, duke nisur aty nga shekulli i nëntë, lëvizjet për vetëqeverisje u zhvilluan në qytetet italiane e pastaj u përhapën drejt veriut, “duke i detyruar peshkopët, baronët vendës dhe fisnikët e tjerë të mëdhenj ta ndanin pushtetin me burgerët qytetarë e madje së fundi t’ua lëshonin tërësisht.”³² Kështu, përfaqësimi në nivel kombëtar plotësohej me një shkallë autonomie në nivelin vendor, që nuk gjen shoqe në rajonet e tjera të botës.

Individualizmi. Shumë prej tipareve të mësipërme të qytetërimit Perëndimor kanë dhënë ndihmesë për përftimin e ndjenjës së individualizmit e të traditës së të drejtave individuale e lirive, që janë unike ndër shoqëritë e qytetëruara. Individualizmi u zhvillua në shekullin e katërbëdhjetë e të pesëmbëdhjetë, kurse pranimi i së drejtës për zgjedhjen individuale, të cilën Dojçi e quan “revolucionin i Romeos e Xhulietës”, mbizotëroi në Perëndim që nga shekulli i shtatëmbëdhjetë. Madje, edhe nëse nuk u pranuan universalisht, u shprehën mëtime për të drejta të barabarta për të gjithë individët, “më i varfri në Angli kishte një jetë për ta jetuar si edhe më i pasuri”. Individualizmi mbetet shenjë dalluese e Perëndimit ndër qytetërimet e shekullit të njëzetë. Në një analizë, ku janë marrë kampionë të ngjashëm prej pesëdhjetë vendesh, ndër njëzet vendet e kreut që dalin me nivelin më të lartë të treguesit të individualizmit, përfshiheshin të gjitha vendet e Perëndimit, me përjashtim të Portugalisë, plus Izraeli.³³ Autori i një vëzhgimi të kryqëzuar për individualizmin dhe kolektivizmin po ashtu ka nxjerrë në pah mbizotërimin e individualizmit në Perëndim, krahasuar me mbizotërimin e kolektivizmit gjetkë, dhe arrin në përfundimin se: “vlerat që kanë më shumë rëndësi në Perëndim janë të paktën me rëndësi në mbarë botën. Kurdoherë si Perëndimorët, edhe joperëndimorët, vënë në pah individualizmin si shenjë dalluese kryesore të Perëndimit.”³⁴

Lista e mësipërme nuk është numërtim shterues i tipareve dalluese të qytetërimit Perëndimor. Ajo as nuk lë të nënkuptohet se këto tipare gjithmonë e universalisht kanë qenë të pranishme në shoqërinë Perëndimore. Është e qartë se nuk kanë qenë. Despotët e shumtë në historinë e Perëndimit rregullisht e kanë shpërfillur shtetin ligjor dhe i kanë shfuqizuar

organizmat përfaqësues. Ajo as nuk mëton të shprehë mendimin se asnjë prej këtyre tipareve nuk ndeshet në qytetërimet e tjera. Është e qartë që ndeshen: Kurani dhe *sheriat* përbëjnë të drejtën bazë të shoqërive islamike; Japonia dhe India kanë sisteme klasore paralele me të Perëndimit (e ndoshta si pasojë, janë të vetmet dy shoqëri kryesore joperëndimore që kanë mbajtur qeveri demokratike për një farë periudhe kohe). Individualisht pothuaj asnjëri prej këtyre tipareve nuk ka qenë unikal për Perëndimin. Megjithatë, ka qenë ndërthurja e tyre dhe pikërisht kjo i ka dhënë Perëndimit cilësinë dalluese. Këto koncepte, praktika dhe institucione thjesht në Perëndim kanë qenë më tepër mbizotëruese sesa në qytetërimet e tjera. Ato përbëjnë të paktën pjesën e bërthamës vijuese thelbësore të qytetërimit Perëndimor. Ato janë gjithçka është Perëndimor, por jo moderne, lidhur me Perëndimin. Gjithashtu në një pjesë të madhe përfaqësojnë faktorët që ia bënë të mundur Perëndimit të udhëhiqte modernizimin e vet e të botës.

Përgjigjet ndaj perëndimit dhe modernizimit

Zgjerimi i Perëndimit i ka dhënë shtysa si modernizimit, edhe perëndimorizimit të shoqërive joperëndimore. Udhëheqësit politikë e intelektualë të këtyre shoqërive i janë përgjigjur ndikimit Perëndimor në njërin ose më shumë nga këto tri mënyra: mospranimi i modernizimit dhe i perëndimorizimit; përqafimi i të dyve; përqafimi i të parit dhe hedhja poshtë e të dytit.³⁵

Mospranimi. Japonia ndoqi një kurs të fortë mospranimi që prej kontakteve të para me Perëndimin

më 1542 deri në mes të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Lejoheshin vetëm forma të kufizuara të modernizimit, si blerja e armëve të zjarrit, kurse importimi i kulturës Perëndimore, duke përfshirë sidomos krishterimin, ishte i ndaluar rreptësisht. Në mesin e shekullit të shtatëmbëdhjetë u përjashtuan tërësisht perëndimorët. Ky qëndrim mospranues mori fund me hapjen e detyruar të Japonisë nga Komodoro Perry më 1854 dhe me përpjekjet e menjëhershme për të mësuar nga Perëndimi pas Restaurimit të Meijive më 1868. Për disa shekuj edhe Kina u përpoq t'i vinte lehtë çfarëdo modernizimi të ndjeshëm ose perëndimorizimit. Ndonëse të dërguarit e krishterë u lejuan në Kinë më 1601, u përjashtuan plotësisht më 1722. Ndryshe nga Japonia, politika e mospranimit e Kinës në pjesën më të madhe rrënjët i kishte te përfytyrimi i Kinës për veten si Mbretëria e Mesme dhe te besimi i epërsisë kulturore të Kinës kundrejt gjithë popujve të tjerë. Izolimi kinez, ashtu si dhe izolimi japonez, mori fund nga armët e Perëndimit, që u përdorën ndaj Kinës prej britanikëve në Luftën e Opiumit më 1839-1842. Siç na tregojnë këto raste, gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë fuqia Perëndimore e bëri gjithnjë e më të vështirë dhe në fund të pamundur për shoqëritë joperëndimore që t'u përmbaheshin strategjive thjesht përjashtuese.

Në shekullin e njëzetë përmirësimet e transportit e të komunikimit, si dhe ndërvarësia globale e rritën jashtëzakonisht koston e përjashtimit. Po të lihen mënjanë bashkësitë e vogla, të veçuara, fshatare, që dëshironin të ekzistonin në nivelin e mbijetesës, mospranimi i plotë i modernizimit dhe i perëndimorizimit zor se është i mundur në botën që po bëhet mbizotërueshëm moderne dhe tepër e ndërlydhur. "Vetëm fundamentalistët më të skajshëm, - ka shkruar Daniel Pipes-i (Pajps) lidhur me islamin, - e hedhin

poshtë si modernizimin, edhe perëndimorizimin. Ata i flakin në lumë televizorët, ndalojnë orët e dorës dhe nuk pranojnë motorët me djegie të brendshme. Porse programi aspak praktik e kufizon rëndë forcën tërheqëse të grupeve të tilla, ndërsa në disa raste, si me Jen Izalan e Kanos, vrasësit e Sadatit, atentatorët e xhamisë së Mekës dhe disa grupe malajziase *dakwah*, shpartallimi në përleshjet e dhunshme me autoritetet ka bërë që të zhduken duke lënë fare pak gjurmë.”³⁶ Përgjithësisht fati i politikave thjesht mospranuese nga fundi i shekullit të njëzetë mund të përmbledhet si zhdukja me fare pak gjurmë. Po të përdorim termin e Toinbit, fanatizmi thjesht është një opsion i mbaruar.

Qemalizmi. Një përgjigje e dytë e mundshme ndaj Perëndimit është herodianizmi i Toinbit, përfaqimi si i modernizimit, edhe i perëndimorizimit. Kjo përgjigje mbështetet në mendimin se modernizimi është i dëshirueshëm dhe i nevojshëm, se kultura vendëse nuk pajtohet me modernizimin e duhet braktisur ose hequr, kurse shoqëria duhet të perëndimorizohet plotësisht për t’u modernizuar me sukses. Modernizimi dhe perëndimorizimi e përforcojnë njëri-tjetrin dhe duhet të ecin së bashku. Ky qëndrim është përmbledhur në argumentet e disa intelektualëve japonezë e kinezë të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, se për t’u modernizuar shoqëritë e tyre duhej të braktisnin gjuhët historike e të përvetësonin anglishten si gjuhë kombëtare. Nuk është për t’u habitur, që kjo pikëpamje ka qenë shumë më popullore ndër elitat perëndimore sesa joperëndimore. Mesazhi i saj është: “Për të pasur sukses ju duhet të jeni si ne, rruga jonë është e vetmja rrugë.” Argumentimi është se “vlerat fetare, parimet morale dhe strukturat shoqërore të këtyre shoqërive [joperëndimore] në rastin më të mirë janë të huaja, e disa herë armiqësore ndaj vlerave e praktikave të

industrializmit.” Rrjedhimisht, zhvillimi ekonomik do të “kërkojë ribërjen rrënjësore e shkatërrimtare të jetës e të shoqërisë dhe, shpesh, rishinterpretimin e kuptimit të vetë ekzistencës, siç e kanë kuptuar njerëzit që jetojnë në këto qytetërime.”³⁷ Pajpsi ngre të njëjtën çështje, duke iu drejtuar hapur Islamit:

Për të shpëtuar prej anomisë myslimanët kanë vetëm një rrugë, sepse modernizimi kërkon perëndimorizimin ...Islami nuk paraqet ndonjë rrugë tjetër për t'u modernizuar ...Shekullarizmi nuk mund të shmanget. Shkenca dhe teknologjia moderne kërkojnë përthithjen e proceseve mendore, që i shoqërojnë; kështu ndodh edhe me institucionet politike. Meqë duhet të kapërcehet përmbajtja po aq sa dhe forma, mbizotërimi i qytetërimit Perëndimor duhet pranuar në mënyrën që të mësohet prej tij. Gjuhët europiane dhe institucionet arsimore Perëndimore nuk mund të shmangen, madje edhe nëse këto të dytë nxisin të menduarit e lirë dhe jetesën e lehtë. Vetëm kur myslimanët ta pranojnë hapur modelin Perëndimor, do të jenë në gjendje të fitojnë teknikën e atëherë të zhvillohen.³⁸

Gjashtëdhjetë vjet para se të shkruheshin këto fjalë, Mustafa Qemal Ataturku kishte arritur në një përfundim të ngjashëm, kishte krijuar Turqinë e re prej rrënojave të Perandorisë Osmane dhe kishte nisur përpjekje të gjera si për ta perëndimorizuar, edhe për ta modernizuar. Duke i hyrë kësaj rruge dhe duke e flakur të shkuarën islamike, Ataturku e bëri Turqinë “vend të përçarë”, një shoqëri që ishte myslimane nga feja, trashëgimia, zakonet e institucionet, por me elitën sunduese të vendosur për ta bërë moderne, Perëndimore dhe njësh me Perëndimin. Nga fundi i shekullit të njëzetë disa vende po ndiqnin rrugën qemaliste e po përpiqeshin ta zëvendësonin identitetin joperëndimor me një Perëndimor. Përpjekjet e tyre shqyrtohen në kreun 6.

Reformizmi. Mospranimi sjell si pasojë detyrën e pashpresë për ta veçuar një shoqëri prej botës moderne të ngushtuar. Qemalizmi sjell detyrën e vështirë e traumatizuese që të shkatërrohet kultura, e cila ekzistonte prej kohësh, dhe në vend të saj të vihet një kulturë tërësisht e re, e importuar prej një qytetërimi tjetër. Zgjidhja e tretë është të bëhen përpjekje për ta ndërthurur modernizimin me ruajtjen e vlerave, praktikave e institucioneve qendrore për kulturën vendëse të shoqërisë. Kjo zgjidhje, kuptohet, ka qenë më e pranuar ndër elitat joperëndimore. Në Kinë gjatë fazave të fundit të dinastisë Çing parulla ishte *Ti-Yong*, “Mësimet kineze për parimet themelore, mësimet Perëndimore për përdorimin praktik.” Në Japoni ishte *Wakon Yosei*, “fryma japoneze, teknika Perëndimore”. Në Egjipt në vitet 1830 Muhamed Aliu u përpoq “ta bënte modernizimin teknik pa perëndimorizimin e tepruar kulturor.” Mirëpo kjo përpjekje dështoi kur britanikët e detyruan të hiqte dorë prej shumicës së reformave të modernizimit. Për pasojë, siç vë re Ali Mazrui, “fati i Egjiptit nuk qe fati japonez i modernizimit teknik *pa* perëndimorizimin kulturor, as fati i Ataturkut me modernizimin teknik *nëpërmjet* perëndimorizimit kulturor.”³⁹ Në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, megjithatë, Xhemal al-Din al-Afgani, Muhamed Abduhu dhe reformatorë të tjerë u përpoqën për një pajtim të ri të Islamit me modernitetin, duke sjellë si argument “pajtueshmërinë e Islamit me shkencën moderne dhe me pjesën më të mirë të mendimit Perëndimor”, e duke dhënë “arsyetimin islamik për pranimin e ideve e të institucioneve moderne, qofshin shkencore, teknike ose politike (kushtetutshmëria dhe qeveria përfaqësuese).”⁴⁰ Ky ishte reformizëm me përmasim të gjerë, që prirej drejt qemalizmit, i cili jo vetëm pranonte modernitetin, por

edhe disa institucione Perëndimore. Reformizmi i këtij tipi ishte përgjigjja mbizotëruese ndaj Perëndimit nga ana e elitave myslimane për pesëdhjetë vjet nga vitet 1870 deri në vitet 1920, kur u vu në dyshim prej ngritjes së qemalizmit në fillim e pastaj të reformizmit më të pastër në trajtën e fundamentalizmit.


Mospranimi, qemalizmi dhe reformizmi mbështeten në gjykime të ndryshme lidhur me atë çka është e mundshme dhe çka është e dëshirueshme. Për mospranimin si modernizimi, ashtu dhe perëndimorizimi janë të padëshirueshëm e ka mundësi të hidhen poshtë që të dy. Për qemalizmin si modernizimi, edhe perëndimorizimi janë të dëshirueshëm, ky i fundit sepse është i domosdoshëm për të arritur të parin, ndërsa të dy janë të mundshëm. Për reformizmin, modernizimi është i dëshirueshëm dhe i mundshëm pa perëndimorizimin thelbësor, i cili është i padëshirueshëm. Kështu ka konflikte ndërmjet mospranimit e qemalizmit për dëshirueshmërinë e modernizimit e të perëndimorizimit, si dhe ndërmjet qemalizmit e reformizmit nëse modernizimi mund të bëhet pa perëndimorizimin.

Skica 3.1 i paraqet të tria këto ecuri veprimi me diagrame. Mospranuesi do të mbetet te pika A; qemalisti do të ecte nëpër diagonalen drejt pikës B; reformatori do të lëvizte horizontalisht drejt pikës C. Por nëpër cilin shteg kanë ecur në të vërtetë shoqëritë? Është e qartë se shoqëria joperëndimore ka ndjekur rrugën e vet, që mund të ndryshojë thelbësisht prej këtyre tre shtigjeve prototip. Madje Maztui tregon se Egjipti dhe Afrika kanë ecur drejt pikës D nëpër “procesin e dhimbshëm të perëndimorizimit kulturor *pa* modernizim teknik.” Në atë shkallë që cilido model i përgjithshëm modernizimi e perëndimorizimi është i pranishëm në përgjigjet e shoqërive joperëndimore ndaj Perëndimit, do të dalë se

shkon sipas lakores A-E. Në fillim perëndimorizimi dhe modernizimi janë të lidhur ngushtë, ndërsa shoqëria joperëndimore përthith elementë thelbësorë të kulturës Perëndimore dhe bën përparim të ngadaltë drejt modernizimit. Me shtimin e ritmit të modernizimit, megjithatë, përmasa e perëndimorizimit bie dhe kultura vendëse kalon përmes ringjalljes. Pastaj modernizimi i mëtejshëm e ndryshon peshoren qytetërimore të fuqisë ndërmjet Perëndimit e shoqërisë joperëndimore dhe përforcon përkushtimin ndaj kulturës vendëse.

Skica 3.1:

Përgjigjet alternative kundrejt ndikimit të perëndimit



Në fazat e para të ndryshimit, perëndimorizimi rrjedhimisht nxit modernizimin. Në fazat e mëtejshme modernizimi nxit shperëndimorizimin dhe ringjalljen e kulturës vendëse nëpër dy rrugë. Në nivelin societal,


modernizimi e përforcon fuqinë ekonomike, ushtarake dhe politike të shoqërisë si tërësi, si dhe u jep zemër njerëzve të asaj shoqërie që të kenë besim te kultura e tyre e të bëhen kulturalisht ngulmues. Në nivelin individual, modernizimi ngjall ndjenjat e tjetërsimit e të anomisë, pasi lidhjet tradicionale e marrëdhëniet shoqërore prishen, dhe çon të krizat e identitetit, për të cilat përgjigjen e jep feja. Kjo rrjedhë shkakësore paraqitet në formë të thjeshtë në Skicën 3.2.

Ky model i përgjithshëm hipotetik përputhet si me teorinë e shkencës shoqërore, ashtu dhe me përvojën historike. Nga vështrimi i gjatë i dëshmive të mbledhura lidhur me “hipotezën e invariancës”, Rainer Baumi ka ardhur në përfundimin se “vijimi i pandërprerë i kërkimit të njeriut për autoritetin e kuptimshëm dhe autonominë vetjake të kuptimshme ndodh në mënyra kulturalisht të ndryshme. Në këto punë nuk ka konvergjencë drejt një bote që homogjenizohet përmes kulturave. Në vend të kësaj duket se ka një invariancë të modeleve, të krijuara në forma të dallueshme gjatë etapave historike dhe moderne të fillimeve.”⁴¹ Teoria e huazimit, e përpunuar prej Frobeniusit, Shpenglerit e Bozemanit ndër të tjerë, nënvizon shkallën në të cilën qytetërimet marrëse huazojnë me përzgjedhje copa të qytetërimeve të tjera dhe i përshtasin, i shndërrojnë dhe i përvetësojnë në mënyrë që të përforcojnë e të sigurojnë mbijetesën e vlerave bërthamore ose “paideumën” e kulturës së vet.⁴² Pothuaj të gjitha qytetërimet joperëndimore në botë kanë jetuar të paktën një mijëvjeçar e në disa raste edhe më shumë. Ato kanë treguar dokumentimin e huazimit prej qytetërimeve të tjera me qëllim që ta mbështesin mbijetesën e vet. Përvetësimi i budizmit në Kinë nga India, siç janë të një mendimi studiuesit, nuk arriti që të shkaktonte “indianizimin” e Kinës. Kinezët e përshtatën budizmin

për qëllimet dhe nevojat kineze. Kultura kineze mbeti kineze. Kinezët duhet të llogarisin përpjekjet e dendura Perëndimore për t'i kthyer në të krishterë, të cilat kanë pësuar dështim të qenësishëm. Nëse ndonjëherë ata do ta importojnë krishterimin, na bie të shohim sesi do të përthithet e do të përshtatet në një mënyrë të atillë, që të jetë i pajtueshëm me elementët qendrorë të kulturës kineze. Po njësoj, arabët myslimanë kanë marrë, vlerësuar dhe përdorur “trashëgiminë helenike për arsye thelbësisht utilitare. Duke qenë të interesuar kryesisht për të huazuar disa forma të jashtme ose aspekte teknike, ata kanë ditur sesi të shpërfillnin gjithë elementët në korpusin grek të mendimit, që mund të binin në konflikt me “të vërtetën” e përcaktuar sipas normave e porosive të tyre themelore të Kuranit.”⁴³ Japonia ka ndjekur të njëjtin model. Në shekullin e shtatë Japonia importoi kulturën kineze dhe bëri “shndërrimin me nismën e vet, të çliruar prej trysnive ekonomike e ushtarake” drejt qytetërimit të lartë. “Gjatë shekujve pasues periudhat e veçimit relativ nga ndikimet kontinentale, në kohën e të cilave huazimet e mëparshme u përzgjedhën, kurse të dobishmet u përvetësuan, janë ndërkëmbyer me periudha të përtëritjes së kontakteve e të huazimeve kulturore.”⁴⁴ Gjatë gjithë këtyre fazave, kultura japoneze e ruajti karakterin e vet dallues.

Skica 3.2:

Modernizimi dhe ringjallja kulturore



Mbetet e paprovuar forma e zbutur e qemalizimit, që pohon se shoqëritë joperëndimore *mund* të modernizohen nëpërmjet perëndimorizimit. Argumenti i skajshëm qemalist se shoqëritë joperëndimore *dubet* të perëndimorizohen që të arrijnë të modernizohen, nuk qëndron si tezë universale. Megjithatë, ai ngre pyetjen: a ka disa shoqëri joperëndimore, në të cilat pengesat që i dalin kulturës rrënjëse për modernizim janë aq të mëdha, sa kultura duhet të zëvendësohet qenësisht me kulturën Perëndimore, në rast se do të ndodhte perëndimorizimi? Teorikisht kjo do të ishte më e mundshme me kulturat e konsumit, sesa me kulturat instrumentale. Kulturat instrumentale “kanë si tipar një sektor të gjerë synimesh të ndërmjetme, të shkëputura dhe të pavarura prej synimeve fundore.” Këto sisteme “e fitojnë lehtësisht risinë, duke ia hedhur mbulesën e traditës përsipër vetë ndryshimit...Sisteme të tilla fitojnë risi pa e shfaqur se i kanë ndryshuar themelisht institucionet e veta shoqërore. Për më tepër, risimi bëhet për t’i shërbyer lashtësisë që s’mbahet mend.” Sistemet e konsumit përkundrazi, “kanë si tipar marrëdhënien e ngushtë ndërmjet synimeve të ndërmjetme dhe fundore ...shoqëria, shteti, autoriteti e të tjerat si këto janë që të gjitha pjesë e një sistemi të qëndrueshëm prej përpunimit e me solidaritet të lartë, në të cilin mbizotëron feja si udhërrëfyesi njohës. Sisteme të tilla kanë qenë kundërshtarë të risimit.”⁴⁵ Apteri i përdor këto kategori për të analizuar ndryshimet te fiset afrikane. Ajzenshtadi ka zbatuar një analizë paralele për qytetërimet e mëdha aziatike dhe ka arritur te një përfundim i ngjashëm. Shndërrimi i brendshëm “lehtësohet fort nga autonomia e institucioneve shoqërore, kulturore dhe politike.”⁴⁶ Për këtë arsye, shoqëritë më instrumentale japoneze e hindu e nisën më herët dhe më lehtë modernizimin, sesa shoqëritë

konfuciane e islamike. Ato ishin më të afta të importonin teknologjinë moderne e ta përdornin për të mbështetur kulturën që kishin. A do të thotë kjo se shoqëritë kineze e islamike ose duhet të heqin dorë si nga modernizimi, edhe nga perëndimorizimi, ose duhet t'i përqafojnë të dy? Nuk duket që mundësia e zgjedhjes të jetë kaq e kufizuar. Veç Japonisë edhe Singapori, Tajvani, Arabia Saudite dhe, në një shkallë më të vogël Irani, janë bërë shoqëri moderne pa u bërë Perëndimore. Në të vërtetë, përpjekjet e shahut për të ndjekur rrugën e veprimet qemaliste përfytuan që të dyja një reagim të fortë antiperëndimor, por jo antimodern. Duket qartë që Kina i ka hyrë rrugës reformiste.

Shoqëritë islamike kanë pasur vështirësi me modernizimin dhe Pajpsi mbështet mëtimin e vet, se perëndimorizimi është parakusht, e vë në dukje konfliktet ndërmjet Islamit e modernitetit në çështjet ekonomike, si interesi, agjërimi, ligjet e trashëgimisë dhe pjesëmarrja e gruas si forcë pune. Mirëpo edhe ai citon Maxine Rodinsonin për pikën se “nuk ka asgjë që të tregojë në mënyrë të patundur se feja myslimane e ka penguar botën myslimane të zhvillohet përgjatë rrugës drejt kapitalizmit modern” dhe argumenton, se në shumicën e çështjeve të tjera, përveç atyre ekonomike:

Islami dhe modernizimi nuk përplasen. Myslimanët e përsjirtshëm mund të lëvrojnë shkencat, të punojnë me frytshmëri në fabrika, ose të përdorin armë të fjalës së fundit. Modernizimi nuk kërkon as ndonjë ideologji ose grup institucionesh: zgjedhjet, kufijtë shtetërorë, shoqatat civile dhe tipare të tjera dalluese të jetës Perëndimore nuk janë të domosdoshme për rritjen ekonomike. Si besim, Islami është i kënaqshëm si për këshilltarët e menazhimit, ashtu edhe për fshatarët. Sheriati nuk ka asgjë për të thënë lidhur me ndryshimet që shoqërojnë modernizimin, siç janë kalimi prej bujqësisë te industria, nga fshati në qytet ose nga qëndrueshmëria shoqërore te lëvizshmëria

shoqërore; ai as hyn në çështje të tilla, si arsimit masiv, komunikimet e shpejta, format e reja të transportit ose kujdesi shëndetësor.⁴⁷

Po njësoj, edhe ithtarët e skajshëm antiperëndimoristë e të rigjallërimit të kulturave rrënjëse nuk ngurrojnë kur vjen puna për të përdorur teknikat e postës elektronike, kasetat dhe televizionin që të përhapin çështjen e vet.

Shkurt, modernizimi nuk do të thotë detyrimisht perëndimorizim. Shoqëritë joperëndimore mund të modernizohen dhe janë modernizuar pa i braktisur kulturat e veta dhe pa përvetësuar toptan vlerat, institucionet e praktikat Perëndimore. Në të vërtetë, këto të fundit mund të jenë pothuaj të pamundura: çfarëdo pengesash, që i vënë modernizimit kulturat joperëndimore, janë të zbehta përpara pengesave që i vënë perëndimorizimit. Siç vë re Brodeli, do të ishte pothuaj “punë fëmijësh” të mendohet se modernizimi ose “ngadhënjimi i *qytetërimit* në numrin njëjës” do të sillte fundin e shumësisë së kulturave historike, të trupëzuara gjatë shekujve në qytetërimet e mëdha botërore.⁴⁸ Përkundrazi, modernizimi i përforcon ato kultura dhe e rrëgjon fuqinë relative të Perëndimit. Nëpër rrugët themelore, bota po bëhet më shumë moderne dhe më pak Perëndimore.

II:
**Zhvendosja e peshores
së qytetërimeve**

Kreu 4: Venitja e Perëndimit: fuqia, kultura dhe indigjenizimi

Fuqia perëndimore: mbizotërimi dhe rënia

Për fuqinë e Perëndimit kundrejt qytetërimeve të tjera ka dy tablo. E para paraqet mbizotërimin Perëndimor ngadhënjimtar, dërrmues, pothuaj total. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik e hoqi edhe të vetmin kundërshtar serioz të Perëndimit e, si rrjedhim, bota është dhe do të formësohet më tej sipas synimeve, përparësive dhe interesave të vendeve kryesore Perëndimore, ndoshta me pjesëmarrjen e rastësishme të Japonisë. Duke mbetur e vetmja superfuqi, Shtetet e Bashkuara së bashku me Britaninë e Francën marrin vendimet përcaktuese për çështjet politike e të sigurisë; Shtetet e Bashkuara me Gjermaninë e Japoninë marrin vendimet përcaktuese për çështjet ekonomike. Perëndimi është i vetmi qytetërim që ka interesa thelbësorë në cilindo qytetërim ose rajon tjetër dhe ka aftësinë të ndikojë mbi politikën, ekonominë e sigurinë e cilitdo qytetërim ose rajon tjetër. Shoqëritë nga qytetërimet e tjera zakonisht kanë nevojë për ndihmën e Perëndimit që të arrijnë synimet dhe të mbrojnë

interesat e tyre. Siç e ka thënë përmbledhtas një autor, shtetet Perëndimore:

- Zotërojnë dhe vënë në veprim sistemin bankar ndërkombëtar

- Kontrollojnë gjithë valutat

- Janë blerësi kryesor i botës

- Japin shumicën e mallrave të përfunduara të botës

- Sundojnë tregjet ndërkombëtare të kapitalit

- Ushtrojnë rol të ndjeshëm udhëheqës moral brenda shumë shoqërive

- Janë në gjendje të bëjnë ndërhyrje ushtarake masive

- Kanë nën kontroll rrugët detare

- Kryejnë zhvillimin dhe kërkimet teknike më të përparuara

- Kontrollojnë arsimin teknik të shkallës më të lartë e udhëheqës

- Mbizotërojnë në fluturimet në hapësirë

- Mbizotërojnë në industrinë ajrore-hapësinore

- Mbizotërojnë në komunikimet ndërkombëtare

- Mbizotërojnë industrinë e armëve të teknologjisë së lartë¹

Tabloja e dytë për Perëndimin është mjaft e ndryshme. Ajo paraqet një qytetërim në rënie, ndërsa përpjesa e tij në fuqinë botërore politike, ekonomike dhe ushtarake po shkon teposhtë kundrejt qytetërimeve të tjera. Fitorja e Perëndimit në Luftën e ftohtë ka sjellë jo triumfin, por shterimin. Perëndimi gjithnjë e më shumë është i shqetësuar nga problemet e nevojat e brendshme, sepse ballafaqohet me rritjen e ngadaltë ekonomike, me popullsitë që nuk shtohen, me papunësinë, deficitet e

mëdha qeveritare, me rënien e etikës së punës, me normat e ulëta të kursimeve dhe në shumë vende, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara, me shpërbërjen, drogën e krimin. Fuqia ekonomike me shpejtësi po kalon në Azinë Lindore dhe fuqia ushtarake e ndikimi politik po nisin këtë rrugë. India është në prag të marrjes së vrullit ekonomik dhe bota islamike gjithnjë e më tepër po merr qëndrim armiqësor kundrejt Perëndimit. Po avullohet me shpejtësi dëshira e shoqërive të tjera për të pranuar diktatet e Perëndimit ose për t'iu përmbajtur predikimeve të tij, po kështu po ndodh me vetëbesimin dhe vullnetin e Perëndimit për të mbisunduar. Vitet e fundit të dhjetëvjeçarit 1980 patën shumë debate lidhur me tezën për rënien e Shteteve të Bashkuara. Nga mesi i viteve 1990 një analizë e drejtpeshuar ka ardhur në një përfundim pak a shumë të ngjashëm:

[N]ga shumë anë me rëndësi, fuqia relative e tyre [Shteteve të Bashkuara] do të shkojë duke rënë me hap të përshpejtuar. Nga ana e aftësive ekonomike të përgjithshme pozita e Shteteve të Bashkuara kundrejt Japonisë dhe në fund të fundit kundrejt Kinës ka gjasa të dobësohet edhe më tej. Në fushën ushtarake peshorja e aftësive efektive midis Shteteve të Bashkuara dhe një numri fuqish rajonale në rritje (duke përfshirë, ndoshta, Iranin, Indinë e Kinën) do të zhvendoset nga qendra drejt periferisë. Një pjesë e fuqisë strukturore të Amerikës do të kalojë te shtetet e tjera; një pjesë (po ashtu si një pjesë e fuqisë së saj informative) do ta gjejë rrugën për të rënë në duart e aktorëve joshitetërorë, siç janë korporatat shumëkombëshe.²

Cila prej këtyre dy tablove në kundërvënie për vendin e Perëndimit në botë paraqet realitetin? Përgjigjja, natyrisht, është: që të dyja. Perëndimi është sot dhe do të mbetet numri një me mbizotërim dërrmues nga pikëpamja e fuqisë dhe ndikimit gjatë

shekullit të njëzetënjëtë. Mirëpo gjithashtu pak nga pak po ndodhin ndryshime themelore të pandalshme në peshoren e fuqisë ndërmjet qytetërimeve, kurse fuqia e Perëndimit kundrejt fuqisë së qytetërimeve të tjera do të vijojë të bjerë. Me gërryerjen e parësisë së Perëndimit, pjesa më e madhe e fuqisë së tij thjesht do të avullojë, kurse pjesa tjetër do të shpërhapet mbi baza rajonale ndërmjet disa qytetërimeve kryesore dhe shteteve të tyre bërthama. Shtimi më i ndjeshëm i fuqisë i takon dhe do t'u përkasë qytetërimeve aziatike, me Kinën e cila hap pas hapi do të dalë si shoqëria që ka më shumë gjasa t'i kundërvihet Perëndimit për ndikimin global. Këto zhvendosje të fuqisë ndërmjet qytetërimeve po çojnë dhe do të çojnë te ringjallja e konsolidimi kulturor në rritje i shoqërive joperëndimore dhe te hedhja poshtë gjithnjë e më shumë e kulturës Perëndimore.

Rënia e Perëndimit ka tri karakteristika kryesore.

E para, është një proces i ngadaltë. Ngritja e fuqisë Perëndimore ka kërkuar katërqind vjet. Tatëpjeta e saj do të kërkojë po aq. Në vitet 1980 studiuesi i shquar britanik Hedli Bull është shprehur se “Mbizotërimi evropian ose Perëndimor në shoqërinë ndërkombëtare universale mund të thuhet se e ka arritur kulmin rreth vitit 1900.”³ Vëllimi i parë i Shpenglerit doli më 1918 dhe “rënia e Perëndimit” ka qenë një temë qendrore në historinë e shekullit të njëzetë. Vetë procesi është shtrirë gjatë pjesës më të madhe të shekullit. Megjithatë, mund të përfytyrohet se ka gjasa të përshpejtohet. Rritja ekonomike dhe shtesat e tjera në aftësitë e një vendi shpesh ecin sipas një lakoreje në trajtë S-je: një fillim i ngadaltë, pastaj përshpejtimi i menjëhershëm, që pasohet prej përmasash të rrëguara zgjerimi dhe rrafshimit. Rënia e vendeve mund të ndodhë gjithashtu sipas një lakoreje të anasjelltë në trajtë S-je, siç ndodhi me Bashkimin Sovjetik: në fillim e përmbajtur, pastaj

duke u përshpejtuar me nxitim para se të arrinte fundin fare. Rënia e Perëndimit ende është në fazën e parë të ngadaltë, por në një farë pike befás mund të marrë shpejtësi.

E dyta, rënia nuk ecën sipas një vije të drejtë. Është tepër e parregullt, me ndërprerje, prapakthime dhe rivendosje të fuqisë së Perëndimit, pas shfaqjeve të dobësisë Perëndimore. Shoqëritë e hapura demokratike të Perëndimit kanë aftësi të mëdha përtëritjeje. Veç kësaj, ndryshe nga shumë qytetërime të tjera, Perëndimi ka pasur dy qendra kryesore pushteti. Rënia që Bulli e pa se po niste rreth vitit 1900, në thelb ishte rënie e përbërëses europiane të qytetërimit Perëndimor. Nga viti 1910 deri më 1945 Europa ishte e përçarë kundër vetes dhe e shqetësuar me problemet e veta të brendshme ekonomike, shoqërore e politike. Mirëpo në vitet 1940 nisi faza amerikane e mbizotërimit Perëndimor, kurse më 1945 Shtetet e Bashkuara për pak kohë mbizotëruan mbi gjithë botën në një shkallë pothuaj të krahasueshme me Fuqitë Aleate të bashkuara më 1918. Shkolonizimi pas lufte e zvogëloi më tej ndikimin europian, por jo atë të Shteteve të Bashkuara, që perandorinë territoriale tradicionale e zëvendësuan me imperializmin tejkombëtar. Gjatë Luftës së ftohtë megjithatë fuqisë ushtarake amerikane i kundërvihet ajo sovjetike dhe fuqia ekonomike amerikane pati rënie kundrejt asaj të Japonisë. Sidoqoftë, pati edhe periudha përpjekjesh për përtëritjen ushtarake dhe ekonomike. Në të vërtetë më 1991 një studiues tjetër i shquar britanik, Barry Buzan, është shprehur se “Realiteti më i thellë është se qendra tashti është më mbizotëruese dhe periferia më e nënshtuar, sesa në cilëndo kohë që kur nisi shkolonizimi.”⁴ Mirëpo përpikëria e këtij perceptimi venitit ashtu si fitorja ushtarake, që e solli atë, venitit duke kaluar në histori.

E treta, fuqia është aftësia e një personi ose grupi që ta ndryshojë sjelljen e një personi ose grupi tjetër. Sjellja mund të ndryshojë nëpërmjet bindjes, shtrëngimit ose predikimit, që kërkojnë prej ushtruesit të fuqisë të ketë burime ekonomike, ushtarake, institucionale, demografike, politike, teknologjike, shoqërore ose të tjera. Rrjedhimisht, fuqia e një shteti ose grupi, si rregull, vlerësohet duke matur burimet që ka në dorë kundrejt atyre të shteteve ose grupeve të tjera, mbi të cilat përpiqet të ushtrojë ndikim. Pjesa e Perëndimit në shumicën, por jo në të gjitha burimet e rëndësishme të fuqisë, arriti kulmin në fillim të shekullit të njëzetë dhe pastaj nisi të binte kundrejt atyre të qytetërimeve të tjera.

Territori dhe popullsia. Më 1450 shoqëritë Perëndimore kishin nën sundim shumicën e territorit evropian si gadishull përveç Ballkanit, ose ndoshta 1,5 milion milje katrore nga e gjithë sipërfaqja tokësore (me përjashtim të Antarktikut) prej 52,5 milion miljesh katrore. Në kulmin e zgjerimit territorial më 1920, Perëndimi drejtpërdrejt sundonte rreth 25,5 milion milje katrore, ose afër gjysmën e sipërfaqes së tokës. Nga viti 1993 sundimi territorial ishte përgjysmuar deri në afër 12,7 milion milje katrore. Perëndimi ishte kthyer pas te bërthama e vet evropiane, plus tokat me hapësira të gjera të populluara prej tij në Amerikën e Veriut, në Australi e Zelandë të Re. Përkundrazi, territori i shoqërive islamike të pavarura u shtua nga 1,8 milion milje katrore më 1920 deri te mbi 11 milion milje katrore më 1993. Ndryshime të ngjashme kanë ndodhur në popullsinë që sundohet. Më 1900 perëndimorët përbënin afërsisht 30 për qind të popullsisë së botës dhe qeveritë Perëndimore qeverisnin pothuaj 45 për qind të asaj popullsie në atë kohë, kurse 48 për qind më 1920. Më 1993, me përjashtim të disa mbeturinave të vogla

perandorake, si Hong-Kongu, qeveritë Perëndimore qeverisnin vetëm Perëndimorët dhe askënd tjetër. Perëndimorët arrinin pak më shumë se 13 për qind të njerëzimit dhe do të bien te afër 11 për qind në fillim të shekullit tjetër, ndërsa nga viti 2025 do të bien në 10 për qind.⁵ Nga pikëpamja e popullsisë totale, më 1993 Perëndimi zinte vendin e katërt pas qytetërimeve sinik, islamik dhe hindu.

Tabela 4.1:

Territori nën sundimin politik të qytetërimeve, 1900-1993

Përlogaritjet e përmbledhura të qytetërimeve në mijëra milje katrore

Viti	Perëndimor	Afrikan	Sinik	Hindu	Islamik	Japonez	Latin Amerikan	Ortodoks	Të tjerë
1900	20.290	164	4.317	54	3.592	161	7.721	8.733	7.468
1920	25.447	400	3.913	54	1.811	261	8.098	10.258	2.258
1971	12.806	4.636	3.936	1.316	9.183	142	7.833	10.346	2.302
1993	12.711	5.682	3.923	1.279	11.054	145	7.819	7.169	2.718

Përlogaritjet e territorit botëror në përqindje*									
1900	38.7	0.3	8.2	0.1	6.8	0.3	14.7	16.6	14.3
1920	48.5	0.8	7.5	0.1	3.5	0.5	15.4	19.5	4.3
1971	24.4	8.8	7.5	2.5	17.5	0.3	14.9	19.7	4.4
1993	24.2	10.8	7.5	2.4	21.1	0.3	14.9	13.7	5.2

Shënim: Përpjesët përkatëse botërore të territorit mbështeten në kufijtë ekzistues shtetërorë sipas vitit të treguar.

Burimet: *Statesman's Year-Book* (New York: St. Martin's Press, 1901-1927); *World Book Atlas* (Chicago: Field Enterprises Educational Corp., 1970); *Britannica*

* Përlogaritja e territorit të botës në 52,5 milionë milje katrore nuk përfshin Antarktikun.

Book of the Year (Chicago: Encyclopaedia Britannica, Inc., 1992-1994).

Tabela 4.2:
Popullsitë e vendeve që u përkasin qytetërimeve kryesore të botës, 1993

(në mijëra)

Sinik	1.340.900	Latinoamerikan	507.500
Islamik	927.600	Afrikan	392.100
Hindu	915.800	Ortodoks	261.300
Perëndimor	805.400	Japonez	124.700

Burimi: Llogaritur sipas shifrave në *Encyclopedia Brittanica, 1994 Book of the Year* (Chicago: Encyclopedia Britannica, 1994), f. 764-69.

Kështu, nga pikëpamja sasiore Perëndimorët në popullsinë e botës përbëjnë një pakicë që shkon vazhdimisht duke rënë. Edhe nga pikëpamja cilësore peshorja ndërmjet Perëndimit dhe popullsive të tjera po ndryshon. Popujt joperëndimorë po bëhen më të shëndetshëm, më shumë banorë të qyteteve, më pak analfabetë, me arsim më të mirë. Nga fillimi i viteve 1990 norma e vdekshmërisë foshnjore në Amerikën Latine, në Afrikë, në Lindjen e Mesme, në Azinë Jugore, në Azinë Lindore dhe në Azinë Juglindore përbënte nga një të tretën të gjysmës së asaj që kishte qenë tridhjetë vjet më parë. Jetëgjatësia e pritshme në këto rajone ishte rritur ndjeshëm, duke pasur ngritje nga njëmbëdhjetë vjet në Afrikë deri te njëzet e tre në Azinë Lindore. Në fillim të viteve 1990, me përjashtim të Afrikës, në një grup fare të vogël vendesh kishte më pak se gjysmën e popullsisë analfabete. Rreth pesëdhjetë për qind e

indianëve dhe 75 për qind e kinezëve dinin shkrim e këndim. Norma e mësimit të shkrim-këndimit në vendet në zhvillim më 1970 arriti mesatarisht 41 për qind në vendet në zhvillim; më 1992 arriti mesataren 71 për qind. Nga fillimi i viteve 1990 në secilin rajon, me përjashtim të Afrikës, në të vërtetë i gjithë grupi i moshës ishte përfshirë në arsimin fillor. Ajo që ka më shumë domethënie është se në fillim të viteve 1960 në Azi, Amerikë Latine, Lindje të Mesme dhe Afrikë më pak se një e treta e grupmoshës përkatëse ishte përfshirë në arsimin e mesëm; nga fillimi i viteve 1990 gjysma e grupmoshës përfshihej në këtë arsim, me përjashtim të Afrikës. Më 1960 banorët e qyteteve përbënin më pak se një të katërtën e popullsisë të pjesës më pak të zhvilluar të botës. Porse ndërmjet viteve 1960 e 1992 përqindja e popullsisë qytetare u shtua nga 49 për qind në 73 për qind në Amerikën Latine, nga 34 për qind në 55 për qind në vendet arabe, nga 14 për qind në 29 për qind në Afrikë, nga 18 në 27 për qind në Kinë dhe nga 19 për qind në 26 për qind në Indi.²⁶

Tabela 4.3:
Përpjesët e popullsisë së botës nën sundimin politik të
qytetërimeve, 1900-2025

(në përqindje)

Viti	[Totali botëtor] ^a	Perëndinor	Afrikan	Sinik	Hindu	Islamik	Japonez	Latin Amerikan	Ortodoks	Të tjerë
1900	[1,6]	44,3	0,4	19,3	0,3	4,2	3,5	3,2	8,5	16,3
1920	[1,9]	48,1	0,7	17,3	0,3	2,4	4,1	4,6	13,9	8,6
1971	[3,7]	14,4	5,6	22,8	15,2	13,0	2,8	8,4	10,0	5,5
1990	[5,3]	14,7	8,2	24,3	16,3	13,4	2,3	9,2	6,5	5,1
1995	[5,8]	13,1	9,5	24,0	16,4	15,9	2,2	9,3	6,1 ^b	3,5

^a Llogaritja e popullsisë botërore në miliarda.

^b Llogaritjet nuk përfshijnë anëtarët e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura ose të Bosnjës.

2010	[7,2]	11,5	11,7	22,3	17,1	17,9 ^e	1,8	10,3	5,4 ^e	2,0
2025	[8,5]	10,1	14,4	21,0	16,9	19,2 ^e	1,5	9,2	4,9 ^e	2,8

Shënim: Përlogaritjet relative të popullsisë botërore mbështeten në kufijtë ekzistues të shteteve sipas vitit të treguar. Llogaritjet për vitin 1995 deri më 2025 marrin për bazë kufijtë e vitit 1994.

Burimet: Kombet e Bashkuara, Seksioni i popullsisë, Departamenti i informacionit ekonomik-shoqëror dhe i analizës së politikës, *World Population Prospects, The 1992 Revision* (New York: United Nations, 1993); *Statesman's Year-Book* (New York: St. Martin's Press, 1901-1927); *World Almanac and Book of Facts* (New York: Press Pub. Co., 1970-1993).

Këto zhvendosje në shkallën e alfabetizimit, arsimin dhe urbanizimit kanë krijuar popullsi të mobilizuara nga ana shoqërore me aftësi të shtuara dhe me shpresa më të mëdha, që mund të vihen në veprim për qëllime politike në ato mënyra, në të cilat fshatarët analfabetë nuk do të mundeshin. Shoqëritë e mobilizuara shoqërisht janë shoqëri më të fuqishme. Më 1953, kur më pak se 15 për qind e iranianëve dinin shkrim e këndim dhe më pak se 17 për qind ishin banorë qytetesh, Kermil Roosevelt-i (Ruzvelt) dhe pak operativë të CLA-s e shtypën mjaft lehtë një kryengritje dhe e rivendosën shahun në fron. Më 1979, kur 50 për qind e iranianëve dinin shkrim e këndim dhe 47 për qind banonin në qytete, asnjë forcë ushtarake e SHBA nuk do të mund ta mbante shahun në fronin e tij. Ka ende një hendek të ndjeshëm që i ndan

^e Llogaritjet përfshijnë Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, Gjeorgjinë dhe ish Jugosllavinë.

kinezët, indianët, arabët dhe afrikanët nga Perëndimorët, japonezët e rusët. Porse hendeku po ngushtohet me shpejtësi. Njëkohësisht po hapet një hendek tjetër. Moshë mesatare e perëndimorëve, japonezëve e rusëve po rritet vijueshmërisht, kurse pjesë të mëdha të popullsisë që nuk punojnë më, u vënë mbi kurriz një barrë në rritje atyre që ende janë në punë prodhimtare. Qytetërime të tjera kanë si barrë numrin e madh të fëmijëve, porse fëmijët janë punëtorët dhe ushtarët e ardhshëm.

Prodhimi ekonomik. Përpjesa e Perëndimit në prodhimin e përgjithshëm ekonomik gjithashtu mund ta ketë arritur kulmin në vitet 1920 dhe fare qartë ka nisur rënien që nga Lufta e Dytë Botërore. Më 1750 Kina jepte pothuaj një të tretën, India pothuaj një të katërtën dhe Perëndimi kishte më pak se një të pestën e prodhimit industrial të botës. Nga viti 1830 Perëndimi kishte dalë pakëz përpara Kinës. Në dhjetëvjeçarët që pasuan, siç e ka vënë në dukje Paul Bairoch-u, industrializimi i Perëndimit çoi te çindustrializimi i pjesës tjetër të botës. Më 1913 prodhimi industrial i vendeve joperëndimore ishte afërsisht dy të tretat e asaj që kishte qenë më 1800. Duke nisur me mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, përpjesa Perëndimore u rrit menjëherë, duke arritur kulmin më 1928 me 84,2 për qind të prodhimit industrial botëror. Më pastaj përpjesa e Perëndimit ra, ngaqë norma e rritjes mbeti e paktë dhe ngaqë vendet më pak të industrializuara e zgjeruan prodhimin e tyre me shpejtësi pas Luftës II Botërore. Nga viti 1980 Perëndimi jepte 57,8 për qind të prodhimit të përgjithshëm global, afërsisht përpjesa që kishte pasur 120 vjet më parë në vitet 1860.⁷

Tabela 4.4:
Përpjesët e prodhimit industrial botëror sipas
qytetërimit ose vendit, 1750-1980

(në përqindje, Bota = 100%)

Vendi	1750	1800	1830	1860	1880	1900	1913	1928	1938	1953	1963	1973	1980
Perëndimi	18,2	23,3	31,1	53,7	68,8	77,4	81,6	84,2	78,6	74,6	65,4	61,2	57,8
Kina	32,8	33,3	29,8	19,7	12,5	6,2	3,6	3,4	3,1	2,3	3,5	3,9	5,0
Japonia	3,8	3,5	2,8	2,6	2,4	2,4	2,7	3,3	5,2	2,9	5,1	8,8	9,1
India/Pakistani	24,5	19,7	17,6	8,6	2,8	1,7	1,4	1,9	2,4	1,7	1,8	2,1	2,3
Rusia/BRSS*	5,0	5,6	5,6	7,0	7,6	8,8	8,2	5,3	9,0	16,0	20,9	20,1	21,1
Brazil e Meksikë	-	-	-	0,8	0,6	0,7	0,8	0,8	0,8	0,9	1,2	1,6	2,2
Të tjerët	15,7	14,6	13,1	7,6	5,3	2,8	1,7	1,1	0,9	1,6	2,1	2,3	2,5

Burimi: Paul Bairoch, "International Industrialization Levels from 1750 to 1980", *Journal of European Economic History*, 11 (vjeshtë 1982), 269-334.

Për periudhën para Luftës II Botërore nuk kemi të dhëna të besueshme lidhur me prodhimin e përgjithshëm ekonomik. Megjithatë, më 1950 Perëndimi jepte afërsisht 64 për qind të prodhimit të përgjithshëm botëror; aty nga vitet 1980 kjo përpjesë kishte rënë në 49 për qind. (Shih Tabelën 4.5). Nga viti 2013, sipas një përlllogaritjeje, Perëndimi do të ketë vetëm 30% të prodhimit botëror. Më 1991, sipas një përlllogaritjeje tjetër, katër nga shtatë ekonomitë më të mëdha të botës u përkisnin vendeve joperëndimore: Japonia (në vend të dytë), Kina (e treta), Rusia (e gjashta) dhe India (e shtata). Më 1992 Shtetet e Bashkuara kishin ekonominë më të madhe të botës e në dhjetë ekonomitë në krye të listës përfshiheshin pesë vende Perëndimore, plus shtetet kryesuese të pesë qytetërimeve të tjera: Kina, Japonia, India, Rusia dhe Brazili. Më 2020 parashikime

* Përfshin vendet e Traktatit të Varshavës gjatë viteve të Luftës së Ftohtë.

të pranueshme tregojnë se pesë ekonomitë në krye të listës do të përfshijnë vetëm tre vende Perëndimore. Kjo rënie relative në Perëndim, natyrisht, në pjesën më të madhe paraqitet si funksion i ngritjes së shpejtë të Azisë Lindore.⁸

Shifrat e përgjithshme për prodhimin ekonomik pjesërisht e errësojnë përparësinë cilësore të Perëndimit. Perëndimi dhe Japonia zotërojnë pothuajë totalisht industrinë me teknologji të përparuar. Mirëpo edhe teknologjitë po përhapen dhe, nëse Perëndimi dëshiron ta ruajë epërsinë e vet, do të bëjë gjithçka për ta zvogëluar këtë përhapje. Falë megjithatë botës së ndërlidhur, të cilën Perëndimi e ka krijuar, ngadalësimi i përhapjes së teknologjisë të qytetërimit e tjera po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Aq më tepër do të thellohet kjo tashti që nuk ka një kërcënim të vetëm, mbizotërues e të pranuar, si ai që ekzistonte gjatë Luftës së ftohtë dhe u jepte masave për kontrollin e teknologjisë një farë frytshmërie.

Tabela 4.5:

Përpjesët në prodhimin e përgjithshëm ekonomik botëror sipas qytetërimeve, 1950-1992

(në përqindje)

Viti	Perëndimor	Afrikan	Sinik	Hindu	Islamik	Japonez	Latin Amerikan	Ortodoks	Të tjerë
1950	64,1	0,2	3,3	3,8	2,9	3,1	5,6	16,0	1,0
1970	53,4	1,7	4,8	3,0	4,6	7,8	6,2	17,4	1,1
1980	48,6	2,0	6,4	2,7	6,3	8,5	7,7	16,4	1,4
1992	48,9	2,1	10,0	3,5	11,0	8,0	8,3	6,2	2,0

Burimet: përqindjet e viteve 1950, 1970, 1980 janë llogaritur nga të dhënat me dollar konstant prej Herbert Block-ut, *The Planetary Product in 1980: A Creative Pause?* (Washington, D.C.: Bureau of Public Affairs, U.S. Dept.

of State, 1981), f. 30-45. Përqindjet e vitit 1992 janë llogaritur nga vlerësimet e Bankës Botërore për paritetin e fuqisë blerëse në tabelën 30 të *World Development Report 1994* (New York: Oxford University Press, 1994).

Ka të ngjarë që gjatë pjesës më të madhe të historisë Kina të ketë pasur ekonominë më të madhe të botës. Përhapja e teknologjisë dhe zhvillimi ekonomik i shoqërive joperëndimore në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë po shkaktojnë sot kthimin te modeli historik. Ky do të jetë një proces i ngadaltë, por nga mesi i shekullit të njëzetënjëtë, në mos më përpara, shpërndarja e produktit ekonomik dhe e prodhimit industrial ndërmjet qytetërimeve kryesuese ka gjasa që t'i ngjasojë atij të vitit 1800. "Kërcitja" Perëndimore dyqindvjeçare mbi ekonominë botërore do të marrë fund.

Aftësitë ushtarake. Fuqia ushtarake ka katër përmasa: sasioren, domethënë numrin e njerëzve, armëve, pajisjeve dhe burimeve; teknologjiken, domethënë fuqinë goditëse dhe teknologjinë e lartë të armatimeve e të pajisjeve; organizativen, domethënë koherencën, disiplinën, shkallën e stërvitjes e të moralit të trupave, si dhe frytshmërinë e komandimit e të marrëdhënieve të kontrollit; dhe societalen, domethënë aftësinë dhe vullnetin e shoqërisë për të zbatuar me frytshmëri forcën ushtarake. Në vitet 1920 Perëndimi ishte shumë përpara cilitdo tjetër në çdonjërin nga gjithë këto përmasa. Në vitet prej atëherë fuqia ushtarake e Perëndimit ka rënë krahasimisht me atë të qytetërimeve të tjera, një rënie që pasqyrohet në zhvendosjen e peshores për personelin ushtarak, e cila përbën një nga njësitë matëse, ndonëse duket qartë nuk është më e rëndësishmja, të aftësive ushtarake. Modernizimi e zhvillimi ekonomik përftojnë si burime, ashtu edhe dëshirën e shteteve për t'i zhvilluar

aftësitë e tyre ushtarake, ndërkohë që gjenden pak shtete të cilat nuk e ndjekin këtë rrugë. Në vitet 1930 Japonia dhe Bashkimi Sovjetik krijuan forca ushtarake shumë të fuqishme, siç e treguan në Luftën II Botërore. Gjatë Luftës së ftohtë Bashkimi Sovjetik kishte njëjërën prej dy forcave ushtarake më të fuqishme të botës. Në kohën e sotme Perëndimi ka monopol aftësinë për të dislokuar forca të mëdha ushtarake konvencionale kudo në botë. Nuk është e sigurtë, nëse do të vijojë ta ruajë këtë aftësi. Megjithatë, duket e sigurtë në masë të arsyeshme, që shtete ose grupe të shteteve joperëndimore do të krijojnë aftësi të krahasueshme gjatë dhjetëvjeçarëve që do të vijnë.

Tabela 4.6:
Përpjesët sipas qytetërimit të efektivave ushtarake totale të botës

(në përqindje)

Viti	[Totali botëror]	Perëndimor	Afrikain	Smik	Hiudu	Islamik	Japonez	Latin Amerikan	Ortodoks	Të tjerë
1900	[10.086]	43,7	1,6	10,0	0,4	16,7	1,8	9,4	16,6	0,1
1920	[8.645]	48,5	3,8	17,4	0,4	3,6	2,9	10,2	12,8*	0,5
1970	[23.991]	26,8	2,1	24,7	6,6	10,4	0,3	4,0	25,1	2,3
1991	[25.797]	21,1	3,4	25,7	4,8	20,0	1,0	6,3	14,3	3,5

Shënim: Përlllogaritjet janë mbështetur në kufijtë ekzistues të shteteve sipas vitit të treguar.

Përlllogaritjet e forcave të armatosura totale të botës (në shërbim aktiv) për secilin vit të përzgjedhur shprehen në mijëra.

* Përbërësja e BRSS në shifër është një përlllogaritje e vitit 1924 e bërë nga J. M. Mackintosh në librin e B. H. Liddell-Hart, *The Red Army: The Red Army – 1918 to 1945, The Soviet Army – 1946 to present* (New York: Harcourt, Brace, 1956).

Burimet: U.S. Arms Control and Disarmament Agency, *World Military Expenditures and Arms Transfers* (Washington, D.C.: The Agency, 1971-1994); *Statesman's Year-Book* (New York: St. Martin's Press, 1901-1927).

Për të gjitha pikat në vitet pas Luftës së ftohtë kanë mbizotëruar pesë prirje kryesore në evoluimin e aftësive ushtarake globale.

E para, forcat e armatosura të Bashkimit Sovjetik pushuan së ekzistuari shumë pak kohë pas prishjes së Bashkimit Sovjetik. Përveç Ruisë, vetëm Ukraina trashëgoi aftësi të ndjeshme ushtarake. Forcat ruse u zvogëluan tepër nga përmasat dhe u tërhoqën prej Europës Qendrore e shteteve baltike. Traktati i Varshavës mori fund. U braktis synimi për t'iu kundërvënë Flotës së SHBA. Pajisjet ushtarake ose u hodhën tej, ose u lanë të prisheshin e nuk ishin më në gjendje për të vepruar. U pakësuan rëndë financimet nga buxheti për mbrojtjen. Radhët e oficerëve e të ushtarëve i përfshiu demoralizimi. Ushtarakët rusë në të njëjtën kohë po bënin ripërcaktimin e doktrinës e të misionëve të tyre, si dhe u ristrukturuan për rolet e reja në mbrojtje të rusëve e në trajtimin e konflikteve lokale për shtetet e afërta rreth e rrotull.

E dyta, pakësimi i tatëpjetë i aftësive ushtarake ruse nxiti një rënie më të ngadaltë, por përsëri të ndjeshme, të shpenzimeve, të forcave dhe të aftësive ushtarake të Perëndimit. Sipas planeve të administratës së Bushit e të Klintonit, shpenzimet ushtarake të SHBA duhej të binin me 35 për qind nga 342,3 miliardë dollarë më 1990 (dollarë të vitit 1994) te 222,3 miliardë dollarë më 1998. Struktura e forcave atë vit do të binte nga gjysmë deri te dy të tretat e asaj që kishte qenë në fund të Luftës së ftohtë. Personeli ushtarak total do të zbriste nga 2,1

milion te 1,4 milion. Shumë programe të mëdha armatimesh janë lënë dhe po lihen mënjanë. Ndërmjet viteve 1985 e 1995 blerjet vjetore të armëve kryesore zbritën nga 29 te 6 anije, nga 943 te 127 aeroplanë, nga 720 në 0 tanke dhe nga 48 te 18 raketa strategjike. Duke nisur nga fundi i viteve 1980 Britania, Gjermania dhe në një masë më të vogël Franca bënë shkurtime të ngjashme për shpenzimet e mbrojtjes dhe aftësitë ushtarake. Në mesin e viteve 1990 ishte planifikuar që forcat e armatosura të Gjermanisë të pakësoheshin nga 370.000 në 340.000 e ndoshta në 320.000; ushtria franceze do t'i shkurtonte forcat e saj nga 290.000 më 1990 te 225.000 më 1997. Personeli ushtarak britanik u rrëgjua nga 377.100 më 1985 te 274.800 më 1993. Anëtarët e NATO-s nga kontinenti gjithashtu i shkurtuan afatet e shërbimit të rekrutëve dhe diskutuan mundësinë për të hequr dorë nga rekrutimi.

E treta, prirjet në Azinë Lindore kanë pasur ndryshime të ndjeshme prej prirjeve në Rusi dhe në Perëndim. Në rend të ditës kanë qenë shtimi i shpenzimeve ushtarake dhe përmirësimi i forcave; Kina ka qenë përcaktuesja e ritmit. Të nxitura si nga rritja e ekonomive të tyre, po ashtu dhe nga fuqizimi i Kinës, shtetet e tjera të Azisë Lindore po i modernizojnë e po i zgjerojnë forcat e tyre ushtarake. Japonia ka vijuar ta përmirësojë aftësinë e vet ushtarake me teknologji shumë të stërholluar. Tajvani, Koreja e Jugut, Tajlanda, Malajzia, Singapori dhe Indonezia – të gjitha po shpenzojnë më shumë për ushtritë e tyre dhe po blejnë avionë, tanke e anije prej Ruisë, Shteteve të Bashkuara, Britanisë, Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera. Ndërsa shpenzimet për mbrojtjen të NATO-s ranë afërsisht 10 për qind ndërmjet viteve 1985 e 1993 (nga 539,6 miliardë dollarë në 485,0 miliardë) (dollarë të qëndrueshëm të vitit 1993), shpenzimet në Azinë

Lindore u rritën me 50 për qind nga 89,8 miliardë dollarë te 134,8 miliardë dollarë gjatë së njëjtës periudhë.⁹

E katërta, aftësitë ushtarake, duke përfshirë armët e shkatërrimit në masë, po përhapen gjerësisht nëpër botë. Me zhvillimin e tyre ekonomik, vendet fitojnë aftësinë për të prodhuar armë. Ndërmjet viteve 1960 e 1980, për shembull, numri i vendeve të Botës së Tretë që prodhojnë avionë gjuajtës është shtuar nga një te tetë, për tanke nga një te gjashtë, për helikopterë nga një te gjashtë dhe për raketat taktike nga asnjë te shtatë. Në vitet 1990 u pa një prirje kryesore drejt globalizimit të industrisë së mbrojtjes, e cila ka gjasa t'i gërryejë më tej përparësitë ushtarake të Perëndimit.¹⁰ Shumë nga shoqëritë joperëndimore ose kanë armë bërthamore (Rusia, Kina, Izraeli, India, Pakistani dhe ndoshta Koreja e Veriut), ose kanë bërë përpjekje të sforcuara për t'i blerë (Irani, Iraku, Libia dhe ndoshta Algjeria), ose janë duke dalë në një pozitë, që të kenë mundësinë t'i shtien ato në dorë, nëse e shohin se do të kenë nevojë (Japonia).

Së fundi, të gjitha këto zhvillime e bëjnë rajonalizimin si prirjen qendrore në fuqinë dhe strategjinë ushtarake të botës pas Luftës së ftohtë. Rajonalizimi jep arsye shpjeguese për shkurtimet e forcave ushtarake të Rusisë e të Perëndimit, si dhe për shtimet e forcave ushtarake të shteteve të tjera. Rusia nuk e ka më aftësinë ushtarake globale, por po i përqendron strategjinë dhe forcat në shtetet e afërta kufitare. Kina i ka riorientuar forcat dhe strategjinë për ta vënë theksin te projektet e fuqisë lokale dhe te mbrojtja e interesave kinezë në Azinë Lindore. Vendet europiane po ashtu po i ridrejtojnë forcat e tyre, si nëpërmjet NATO-s edhe Bashkimit Europian Perëndimor, për t'u marrë me paqëndrueshmërinë në

periferinë e Europës Perëndimore. Shtetet e Bashkuara haptazi e kanë kaluar planifikimin ushtarak nga frenimi dhe lufta kundër Bashkimit Sovjetik te një bazë globale për t'u përgatitur që të merren njëkohësisht me ngjarjet e paparashikuara në Gjirin Persik dhe në Azinë Verilindore. Megjithatë, nuk duket se Shtetet e Bashkuara do të kenë aftësitë ushtarake për t'i përballuar këto synime. Për të thyer Irakun, Shtetet e Bashkuara grumbulluan në Gjirin Persik 75 për qind të avionëve taktikë aktivë, 42 për qind të tankeve moderne luftarake, 46 për qind të aeroplanmbajtëseve, 37 për qind të personelit ushtarak dhe 46 për qind të personelit të flotës detare. Me forca të zvogëluara ndjeshëm në të ardhmen, Shtetet e Bashkuara do ta kenë të vështirë të kryejnë një ndërhyrje, aq më tepër dy, kundër fuqive rajonale të mëdha jashtë Gjysmërruzullit Perëndimor. Siguria ushtarake në mbarë botën gjithnjë e më shumë varet jo nga shpërndarja globale e fuqisë dhe e veprimeve të superfuqive, por nga shpërndarja e fuqisë brenda secilit rajon të botës dhe nga veprimet e shteteve bërthamë të qytetërimeve.

Përmbledhtas, për çdo gjë Perëndimi do të mbetet qytetërimi më i fuqishëm për dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XXI. Përtej kësaj ndoshta do të vijojë të ketë pozitë udhëheqëse të ndjeshme në talentin shkencor, në aftësitë kërkimore e të zhvillimit, si dhe në përtëritjen teknologjike civile e ushtarake. Mirëpo kontrolli mbi burimet e tjera të fuqisë gjithnjë e më shumë po shpërndahet ndërmjet shteteve bërthamë dhe vendeve kryesuese të qytetërimeve joperëndimore. Kontrolli i Perëndimit mbi këto burime arriti kulmin në vitet 1920 dhe që prej asaj kohe ka qenë në rënie në mënyrë të parregullt, por të ndjeshme. Në vitet 2020, njëqind vjet pas atij kulmi, Perëndimi ndoshta do të ketë nën kontroll rreth 24 për qind të territorit të botës (më

poshtë sesa kulmi prej 49 për qind), 10 për qind të popullsisë botërore (më poshtë sesa 48 për qind) dhe ndoshta 15-20 për qind të popullsisë shoqërisht të mobilizuar, rreth 30 për qind të prodhimit ekonomik botëror (më poshtë nga kulmi prej ndoshta 70 për qind), ndoshta 25 për qind të prodhimit industrial (më poshtë se kulmi prej 84 për qind) dhe më pak se 10 për qind të efektivave ushtarake (më poshtë se 45 për qind).

Më 1919 Woodrow Wilson-i (Udrou Uilson), Lloyd George-i (Llojd Xhorxh) dhe Georges Clemenceau (Zhorzh Klemanso) në të vërtetë së bashku e sundonin botën. Duke u mbledhur në Paris, ata përcaktonin cilat vende do të ekzistonin dhe cilat jo, çfarë vendesh të reja duheshin krijuar, cilët do të ishin kufijtë e tyre dhe kush do të sundonte në to, e po ashtu si do të ndaheshin Lindja e Mesme dhe pjesët e tjera të botës ndërmjet fuqive fituese. Ata gjithashtu vendosnin për ndërhyrjen ushtarake në Rusi dhe koncesionet ekonomike që i duheshin shkëputur Kinës. Njëqind vjet më vonë asnjë grup i vogël burrash shteti nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë një pushtet të krahasueshëm; edhe kur ndonjë grup e bën këtë, nuk përbëhet prej tre Perëndimorësh, por prej udhëheqësve të shteteve bërthamë të shtatë ose tetë qytetërimeve kryesore të botës. Pasuesit e Reganit, Theçerit, Miteranit dhe Kolit do të jenë në rivalitet me pasuesit e Teng Hsiao Pingut, Nakasones, Indira Gandit, Jelcinit, Komeinit dhe Suhartos. Epoka e mbisundimit të Perëndimit do të ketë mbaruar. Në ndërkohë venitja e Perëndimit dhe ngritja e qendrave të tjera të fuqisë po nxit proceset globale të indigjenizimit e të ringjalljes së kulturave joperëndimore.

Indigjenizimi: ringjallja e kulturave joperëndimore

Përhapja e kulturave në botë pasqyron përhapjen e fuqisë. Tregtia mund ta ndjekë flamurin ose mund të mos e ndjekë, porse kultura pothuaj gjithmonë ndjek fuqinë. Gjatë gjithë historisë zgjerimi i pushtetit të një qytetërimi zakonisht ka ndodhur njëkohësisht me lulëzimin e kulturës së tij dhe pothuaj gjithmonë është shoqëruar nga përdorimi i kësaj fuqie për të zgjeruar vlerat, praktikat dhe institucionet e veta mbi shoqëritë e tjera. Një qytetërim universal kërkon një fuqi universale. Fuqia romake krijoi një qytetërim pothuaj universal brenda kufijve të ngushtë të Botës klasike. Fuqia europiane në formën e kolonializmit europian gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe hegjemonia amerikane në shekullin e njëzetë e zgjeruan kulturën Perëndimore në pjesën më të madhe të botës bashkëkohore. Kolonializmi europian ka marrë fund; hegjemonia amerikan po prapset. Pason dobësimi i kulturës Perëndimore me riafirmimin e zakoneve, gjuhëve, besimeve dhe institucioneve indigjene e me rrënjë historike. Fuqia në rritje e shoqërive joperëndimore, e arritur nga modernizimi, po përfton ringjallërimin e kulturave joperëndimore në mbarë botën.*

* Lidhja ndërmjet fuqisë e kulturës pothuaj shpërfilllet universalisht nga ata, që shprehen se po përftohet dhe se duhet të përftohet një qytetërim universal, e gjithashtu nga ata që shprehen se perëndimorizimi është parakusht për modernizimin. Ata nuk duan ta pranojnë, se logjika e argumentimit të tyre u kërkon që të mbështesin zgjerimin e konsolidimin e mbisundimit Perëndimor mbi botë dhe që, nëse shoqëritë e tjera do të lireshin të lira të përcaktonin fatin e vet, do të përforconin besimet, zakonet e praktikat e tyre të vjetra, të cilat, sipas universalistëve, janë armiqësore ndaj përparimit. Njerëzit që mbështesin virtytet e një qytetërimi universal, megjithatë, zakonisht nuk i mbështesin virtytet e një perandorie universale.

Siç e ka argumentuar Joseph Nye (Xhozef Naji), ka një dallim ndërmjet 'fuqisë së fortë', e cila është fuqia për të komanduar duke u mbështetur në forcën ekonomike e ushtarake, dhe 'fuqisë së butë', e cila është aftësia e shtetit për t'i bërë "shtetet e tjera që ta *duan* çka do ai", duke iu drejtuar kulturës e ideologjisë së tij. Siç e pranon Naji, në botë po ndodh përhapja e fuqisë së fortë dhe shtetet kryesore "janë më pak të afta sesa kanë qenë në të kaluarën t'i përdorin burimet tradicionale të fuqisë për të arritur qëllimet e tyre." Naji vijon duke thënë që nëse "kultura dhe ideologjia e një shteti janë tërheqëse, të tjerët do të kenë më shumë dëshirë që të ndjekin pas" rolin e tyre udhëheqës e që këtë rrjedh, se fuqia e butë është "po aq e rëndësishme sa edhe fuqia e komandimit të fortë."¹¹ Mirëpo çfarë i bën tërheqëse kulturën dhe ideologjinë? Ato bëhen tërheqëse kur shihen se i kanë rrënjët në suksesin dhe ndikimin material. Fuqia e dobët është fuqi vetëm kur mbështetet në themelin e fuqisë së fortë. Shtimi në fuqinë e fortë ekonomike e ushtarake shkakton nxitjen e vetëbesimit, arrogancës dhe besimit të epërsia e kulturës së dikuj ose të fuqisë së butë në krahasim me ato të popujve të tjerë, duke e shtuar shumë forcën tërheqëse për popujt e tjerë. Rëniet në fuqinë ekonomike e ushtarake sjellin dyshimin te vetja, krizat e identitetit dhe përpjekjet për të gjetur te kulturat e tjera çelësat e suksesit ekonomik, ushtarak e politik. Me shtimin e aftësive ekonomike, ushtarake e politike, shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më shumë trumbetojnë virtytet e vlerave, institucioneve dhe kulturës së vet.

Ideologjia komuniste i tërhiqte njerëzit në mbarë botën në vitet 1950 e 1960, kur lidhej me suksesin ekonomik dhe forcën ushtarake të Bashkimit Sovjetik. Kjo tërheqje u avullua kur ekonomia sovjetike ra në amulli dhe nuk ishte më në gjendje ta mbante forcën

ushtarake sovjetike. Vlerat e institucionet Perëndimore i kanë tërhequr njerëzit e kulturave të tjera, sepse shiheshin si burim i fuqisë dhe pasurisë së Perëndimit. Ky proces është zhvilluar gjatë shekujsh. Ndërmjet viteve 1000 e 1300, siç e vë në dukje Uiljam Maknili, krishterimi, e drejta romake dhe elementë të tjerë të kulturës Perëndimore u përvetësuan nga hungarezët, polakët e lituanët, ndërkohë që “pranimi i qytetërimit Perëndimor nxitej nga frika dhe adhurimi të përzier bashkë për bëmat trimërore të princave Perëndimorë.”¹² Me rënien e fuqisë Perëndimore, aftësia e Perëndimit për të imponuar mbi qytetërimet e tjera konceptet Perëndimore të të drejtave të njeriut, liberalizmit e demokracisë, po ashtu bie, e kështu ndodh edhe me forcën tërheqëse të atyre vlerave për qytetërimet e tjera.

Dhe tashmë ka ndodhur kështu. Për disa shekuj popujt joperëndimorë ua kishin smirë lulëzimin ekonomik, stërhollimin teknologjik, fuqinë ushtarake dhe kohezionin politik shoqërive Perëndimore. Ata e kërkonin të fshehtën e këtij sukse si te vlerat dhe institucionet Perëndimore, kurse kur e gjenin atë që mendonin se mund të ishte çelësi i kësaj, përpiqeshin ta zbatonin në shoqëritë e veta. Që të bëheshin të pasur e të fuqishëm atyre u duhej të bëheshin si Perëndimi. Mirëpo sot këto qëndrime qemaliste janë zhdukur në Azinë Lindore. Aziatikët lindorë e shohin zhvillimin e vet ekonomik të befasishëm jo te importimi i kulturës Perëndimore, por më tepër te ndjekja e kulturës së vet. Ata argumentojnë, se po kanë sukses, sepse janë të ndryshëm nga Perëndimi. Po njësoj, kur shoqëritë joperëndimore e ndienin veten të dobëta kundrejt Perëndimit, u drejtoheshin vlerave Perëndimore të vetëvendosjes, liberalizmit, demokracisë e pavarësisë, për të përligjur kundërshtimin ndaj mbisundimit Perëndimor. Sot që nuk janë më të dobëta e po bëhen

gjithnjë e më të fuqishme, nuk ngurrojnë t'i sulmojnë po ato vlera, të cilat më parë i përdornin për të ndjekur interesat e vet. Kryengritja kundër Perëndimit në zanafillë për ligjet duke pohuar universalizmin e vlerave Perëndimore; tashti për ligjet duke pohuar epërsinë e vlerave joperëndimore.

Dalja dhe shtimi i këtyre qëndrimeve është një shfaqje e asaj, që Ronald Doreja e ka quajtur “dukuria e indigjenizimit të brezsisë së dytë.” Si në kolonitë e mëparshme Perëndimore, edhe në vendet e pavarura si Kina e Japonia, “Brezi i parë ‘modernizues’ ose ‘i pas pavarësisë’ shpesh e kishte marrë shkollimin në universitetet e huaja (Perëndimore) në një gjuhë Perëndimore kozmopolite. Pjesërisht sepse ata në fillim shkonin jashtë vendit si djelmosha që u bënte përshtypje gjithçka, mund të ishte shumë e thellë përthithja prej tyre e vlerave dhe e mënyrës së jetesës Perëndimore.” Pjesa më e madhe e brezit të dytë shumë më të gjerë, përkundrazi, e merr arsimin në vendin e vet, në universitetet e krijuara prej brezit të parë, kurse për arsimim gjithnjë e më shumë përdoret gjuha vendëse dhe jo koloniale. Këto universitete “sigurojnë një kontakt më të holluar me kulturën botërore të metropolit”, kurse “dija indigjenizohet nëpërmjet përkthimeve, që zakonisht janë me shtrirje të kufizuar dhe me cilësi të keqe.” Të diplomuarit prej këtyre universiteteve janë të pakënaqur nga mbizotërimi i brezit të mëparshëm të shkolluar në Perëndim dhe rrjedhimisht, shpesh “epen përpara thirrjeve të lëvizjeve vendëse kundërshtuese.”¹³ Me tërheqjen e ndikimit Perëndimor, udhëheqësit e rinj me synime të mëdha nuk mund t'i kthejnë sytë nga Perëndimi për të fituar fuqi e pasuri. Atyre u duhet t'i gjejnë mjetet e suksesit brenda shoqërive të tyre, rrjedhimisht, u duhet të përshtaten me vlerat dhe kulturën e atyre shoqërive.

Procesi i indigjenizimit nuk ka nevojë të presë për brezin e dytë. Udhëheqësit e aftë, përthithës dhe të përshtatshëm të brezit të parë indigjenizohen vetë. Tre raste të shquara janë Muhamed Ali Jinnah (Xhinah), Harry Lee (Li) dhe Solomon Bandaranajke. Ata u diplomuan shkëlqyeshëm përkatësisht në Oksford, Kembrixh dhe Linkoln, ishin juristë të mrekullueshëm dhe anëtarë tërësisht të perëndimorizuar të elitave në shoqëritë e tyre. Xhinahu ishte shekullarist i vendosur. Li ishte, sipas fjalëve të një ministri britanik, “anglezi gjakpastër më i mirë në lindje të Suezit.” Bandaranajke ishte rritur si i krishterë. E përsëri, që të udhëhiqnin shtetet e tyre për të fituar pavarësinë e pas saj, atyre iu desh të indigjenizoheshin. Ata u kthyen te kulturat e stërgjyshëve dhe gjatë procesit sipas kohës ndërruan identitetin, emrat, veshjet e besimet. Avokati anglez M. A. Xhinah u bë Quaid-i-Azam i Pakistanit, Harry Lee u bë Lee Kuan Yew (Li Kuan Jiu). Shekullaristi Xhinah u bë apostull i flaktë i Islamit dhe baza e shtetit të pakistanëve. Liu i anglicizuar mësoi mandarinishten dhe u bë përhapës i shfaqur i konfucianizmit. Bandaranajka i krishterë u kthye në budizëm dhe përkrahu nacionalizmin sinhalez.

Indigjenizimi ka qenë në rendin e ditës në mbarë botën joperëndimore në vitet 1980 e 1990. Ringjallja e Islamit dhe “rëislamizimi” janë temat qendrore në shoqëritë myslimane. Në Indi prirja mbizotëruese është hedhja poshtë e formave dhe vlerave Perëndimore, si dhe “hinduizimi” i politikës e i shoqërisë. Në Azinë Lindore qeveritë po mbështesin konfucianizmin dhe udhëheqësit politikë e intelektualë flasin për “azianizimin” e vendeve të tyre. Në mesin e viteve 1980 Japonia u përfshi nga vala e “*Nihonjinron* ose teoria e Japonisë dhe japonezes.” Më pas një nga intelektualët kryesorë japonezë ka argumentuar, se historikisht

Japonia ka kaluar përmes “cikleve të importimit të kulturave të jashtme” dhe të “indigjenizimit” të këtyre kulturave nëpërmjet kopjimit e përpunimit, ndërsa do të shfaqej një turbullim i pashmangshëm si rrjedhim i shterimit të shtysës krijuese e të importuar dhe rihapjes përfundimtare ndaj botës së jashtme.” Në kohën e sotme Japonia “po hyn në fazën e dytë të këtij cikli.”¹⁴ Me përfundimin e Luftës së ftohtë, Rusia përsëri u bë një vend “i përçarë” me rishfaqjen e luftës klasike ndërmjet perëndimorizuesve dhe sllavofilëve. Mirëpo për një dhjetëvjeçar prirja ishte nga të parët te të dytët, pasi Gorbaçovi i perëndimorizuar ia la vendin Jelcinit rus nga stili dhe Perëndimor në besimet e shprehura, i cili nga ana e tij, u kërcënua prej nacionalistëve, që mishëronin indigjenizimin ortodoks rus.

Indigjenizimi shtyhet më tej prej paradoksit të demokracisë: zbatimi i institucioneve demokratike Perëndimore nga shoqëritë joperëndimore nxit dhe u hap rrugën për të ardhur në pushtet lëvizjeve politike vendëse e antiperëndimore. Në vitet 1960 dhe 1970 qeveritë e perëndimorizuara dhe properëndimore në vendet në zhvillim kërcënoheshin prej grushteve të shtetit e revolucioneve; në vitet 1980 dhe 1990 ato gjithnjë e më shumë ndodhen para rrezikut që të rrëzohen prej zgjedhjeve. Demokratizimi hyn në konflikt me perëndimorizimin dhe demokracia është brendësisht një proces kthimi në lokalizëm e jo kalimi në kozmopolitizëm. Politikanët në shoqëritë joperëndimore nuk i fitojnë zgjedhjet duke treguar sesa Perëndimore janë. Përkundrazi, gara zgjedhore i nxit ata për t’u dhënë formë gjithë aspekteve, që besojnë se do të jenë anët tërheqëse më popullore dhe këto zakonisht janë etnike, nacionaliste e fetare nga karakteri.

Si rrjedhim, kemi mobilizimin popullor kundër elitave të arsimuara në Perëndim dhe të orientuara nga

Perëndimi. Grupet fundamentaliste kanë pasur arritje të mira në disa pak zgjedhje, që janë bërë në vendet myslimane, dhe do të kishin ardhur në pushtet në shkallë kombëtare në Algjeri, nëse ushtarakët nuk do t'i kishin anuluar zgjedhjet e vitit 1992. Në Indi gara për mbështetje zgjedhore pa dyshim i ka nxitur thirrjet e bashkësive fetare dhe dhunën e bashkësive fetare.¹⁵ Demokracia në Sri Lankë ia bëri të mundur Partisë së Lirisë të Sri Lankës që të rrëzonte më 1956 Partinë e Bashkuar Kombëtare elitiste e të orientuar nga Perëndimi dhe përfitoi mundësinë në vitet 1980 për ngritjen e lëvizjes nacionaliste sinhaleze Pathika Chintanaya. Përpara vitit 1949 si elita e Afrikës së Jugut, edhe elitat Perëndimore e shihnin Afrikën e Jugut si një shtet Perëndimor. Pasi mori trajtë regjimi i aparteidit, elitat Perëndimore pak nga pak e nxorën Afrikën e Jugut jashtë kampit Perëndimor, ndërsa afrikanojugorët vijonin të mendonin për veten e tyre se ishin Perëndimore. Mirëpo për të rifituar vendin në rendin ndërkombëtar Perëndimor atyre iu desh të vendosnin institucione demokratike Perëndimore, të cilat patën si pasojë ardhjen në pushtet të një elite zezake tepër të perëndimorizuar. Megjithatë, nëse do të veprojë faktori i brezit të dytë, pasardhësit e tyre do të jenë shumë më xhosa, zulu e afrikanë nga qëndrimet dhe Afrika e Jugut gjithnjë e më tepër do ta përcaktojë veten si shtet afrikan.

Në periudha të ndryshme përpara shekullit të nëntëmbëdhjetë bizantinët, arabët, kinezët, osmanët, mogulët dhe rusët kanë pasur besim të madh te fuqia e arritjet e tyre, në krahasim me ato të Perëndimit. Në këto periudha ata gjithashtu kishin përbuzje për inferioritetin kulturor, prapambetjen institucionale, korrupsionin dhe dekadencën e Perëndimit. Me zbehjen relative të suksesit të Perëndimit, qëndrime të tilla

rishfaqen. Njerëzit e ndiejnë se “nuk duhet ta marrin më.” Irani është një rast i skajshëm, por siç e ka vënë në dukje një vëzhgues, “Vlerat Perëndimore hidhen poshtë në mënyra të ndryshme, por jo me më pak vendosmëri, në Malajzi, Indonezi, Singapor, Kinë e Japoni.”¹⁶ Ne jemi dëshmitarë të “fundit të epokës progresive” të mbisunduar prej ideologjive Perëndimore dhe po hyjmë në epokën, në të cilën qytetërime të ndryshme e të shumëfishta do të ndërveprojnë, do të konkurrojnë, do të bashkekzistojnë dhe do të përshtaten me njëri-tjetrin.¹⁷ Ky proces global indigjenizimi shfaqet gjerësisht në ringjalljen e fesë, që po ndodh në aq shumë pjesë të botës, e sidomos në rilindjen kulturore në vendet aziatike e islamike, të përftuar në një pjesë të madhe nga dinamizmi i tyre ekonomik e demografik.

La revanche de dieu

Në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë elitat intelektuale përgjithësisht e pohonin se modernizimi ekonomik e shoqëror po çonin te zbehja e fesë si element domethënës në ekzistencën e njeriut. Këtë mendim e kishin të përbashkët si ata që e mirëprisnin, edhe ata që e qortonin këtë prirje. Shekullaristët e modernizimit e përshëndesnin shkallën në të cilën shkenca, racionalizmi dhe pragmatizmi po i mënjanonin besëtytnitë, mitet, irracionalizmat dhe ritualet, që përbënin bërthamën e feve ekzistuese. Shoqëria që po përfitohej do të ishte tolerante, racionale, pragmatike, përparimtare, humaniste dhe shekulare. Nga ana tjetër, konservatorët e shqetësuar paralajmëronin për pasojat e tmerrshme nga zhdukja e besimeve fetare, institucioneve

fetare dhe udhërrëfimit moral që jepte feja për sjelljen njerëzore kolektive e individuale. Rezultati përfundimtar do të ishte anarki, shthurje, minim i jetës së qytetëruar. “Nëse nuk do të keni Zot (dhe Ai është një Zot xheloz),” ka thënë T. S. Elioti, “ju do t’u shprehni respekt Hitlerit ose Stalinit.”¹⁸

Gjysma e dytë e shekullit të njëzetë vërtetoi se këto shpresa e frikëra nuk kishin bazë. Modernizimi ekonomik e shoqëror u bë global nga shtrirja e njëkohësisht ndodhi ringjallja globale e fesë. Kjo ringjallje, të cilën Gilles Kepeli e ka quajtur *la revanche de Dieu*, ka përfshirë secilin kontinent, secilin qytetërim dhe në të vërtetë secilin vend. Në mes të viteve 1970, siç vë në dukje Kepeli, prirja për shekullarizim dhe drejt përshtatjes së fesë me shekullarizmin “eci në drejtim të kundërt. Mori trajtë një qëndrim i ri fetar, me synim jo më për t’iu përshtatur vlerave shekulare, por për të rifituar themelin e shenjtë për organizimin e shoqërisë, duke e ndryshuar shoqërinë po të jetë e nevojshme. Ky qëndrim, i shprehur në një shumësi rrugësh, përkrahte largimin prej modernizmit të dështuar, duke ia veshur shkëputjes prej Zotit prapakthimet dhe shtigjet e verbra në të cilat kishte hyrë. Çështja nuk ishte më për *aggiornamento*, por për ‘ungjillëzimin e dytë të Europës’, synimi nuk ishte më të modernizohej Islami, por të ‘islamizohej moderniteti’.”¹⁹

Kjo ringjallje pjesërisht u shoqërua me zgjerimin e disa feve, të cilat fituan anëtarë të rinj në shoqëritë, ku nuk i kishin pasur më përpara. Mirëpo në një shkallë më të gjerë rilindja fetare përfshiu njerëz që iu kthyen, i rifuqizuan dhe u dhanë kuptim të ri feve tradicionale të bashkësive të tyre. Krishterimi, Islami, judaizmi, hinduizmi, budizmi, ortodoksia – që të gjitha përjetuan dallgë të reja përkushtimi, vlerësimi dhe praktikimi nga besimtarët e dikurshëm të rastit. Në të gjitha u ngritën

lëvizje fundamentaliste, të përkushtuara pastrimit militant të doktrineve e institucioneve fetare, si dhe riformësimit të sjelljes vetjake, shoqërore e publike në përputhje me dogmat fetare. Lëvizjet fundamentaliste janë të befasishme dhe mund të kenë ndikim të ndjeshëm politik. Mirëpo ato janë vetëm valë sipërfaqësore të baticës fetare shumë më të gjerë dhe më rrënjësore, që po i jep një pamje të ndryshme jetës njerëzore në fund të shekullit të njëzetë. Përtëritja e fesë në mbarë botën del shumë përtej veprimtarive të ekstremistëve fundamentalistë. Nga një shoqëri në tjetrën ajo e shfaq veten në jetën dhe punën e përditshme të njerëzve, si dhe në problematikën e projektet e qeverive. Ringjallja kulturore në kulturën shekullore konfuciane merr formën e pohimit të vlerave aziatike, por në pjesën tjetër të botës e shfaq veten në pohimin e vlerave fetare. “Deshekullarizimi i botës”, siç ka vënë re George Weigel-i (Xhorxh Uajgel), “është një prej fakteve mbizotëruese nga fundi i shekullit të njëzetë.”²⁰

Kudondodhja dhe pesha e fesë dolën në dukje befasisht në shtetet e mëparshme komuniste. Duke mbushur zbraztësinë e lënë nga rënia e ideologjisë, ringjallja fetare është përhapur në këto vende prej Shqipërisë deri në Vietnam. Në Rusi ortodoksia ka përjetuar një ringjallje të madhe. Më 1994 nga rusët nën moshën njëzet e pesë vjeç 30 për qind thanë se kishin kaluar nga ateizmi te besimi në Zotin. Numri i kishave vepruese në zonën e Moskës nga 50 më 1988 u rrit te 250 më 1993. Udhëheqësit politikë janë bërë njësoj të respektueshëm ndaj fesë dhe qeveritë mbajnë qëndrim mbështetës. Siç ka njoftuar një vëzhgues i mprehtë më 1993, në qytetet ruse “Ushtima e kambanave të kishave përsëri e mbush ajrin. Kupolat e riparuarra shkëlqejnë në diell. Kisha që deri para pak kohe ishin në rrënim,

jehojnë përsëri me këngë madhështore. Kishat janë pika më e gjallë e qytetit.”²¹ Njëkohësisht me ringjalljen e ortodoksisë në republikat sllave, një rilindje islamike përshkoi Azinë Qendrore. Më 1989 kishte 160 xhami vepruese dhe një medrese (seminar islamik) në Azinë Qendrore; nga fillimi i vitit 1993 kishte rreth 10.000 xhami e dhjetë medrese. Ndërsa kjo ringjallje u shoqërua me disa lëvizje politike fundamentaliste dhe pati mbështetje nga jashtë prej Arabisë Saudite, Iranit e Pakistanit, në themel ishte lëvizje kulturore me bazë jashtëzakonisht të gjerë dhe rrymë mbizotëruese.

Si mund të shpjegohet kjo rilindje fetare globale? Në vende dhe qytetërime individuale, natyrisht, kanë vepruar shkaqe të veçanta. Mirëpo nuk mund të mëtohet se një numër i madh shkaqesh të ndryshme do të kishte prodhuar zhvillime të ngjashme e të njëkohshme në shumicën e pjesëve të botës. Një dukuri globale kërkon një shpjegim global. Sado shumë ngjarje në vende të veçanta të jenë ndikuar nga faktorë të vetmuar, duhet të kenë vepruar disa shkaqe të përgjithshme. Cilat kanë qenë?

Shkaku më i dukshëm dhe më i fuqishëm që bie në sy për ringjalljen fetare globale, është pikërisht ai që mendohej se do të shkaktonte vdekjen e fesë: procesi i modernizimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor, i cili përfshiu mbarë botën në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë. Burimet e dikurshme të identitetit dhe sistemet e autoritetit u prishën. Njerëzit lëvizin nga fshati në qytet, shkëputen prej rrënjëve të tyre dhe gjejnë punë të reja ose mbeten fare pa punë. Ata ndërveprojnë me një numër të madh të huajsh dhe gjenden të zbuluar ndaj tufave të reja të marrëdhënieve. Kanë nevojë për burime të reja identiteti, forma të reja bashkësie të qëndrueshme dhe tufa të reja parimesh morale, që t’u japin një ndjenjë kuptimi e qëllimi. Feja, si e rrymës kryesore, edhe

fundamentaliste, i kënaq këto nevoja. Për Azinë Lindore Li Kuan Jiu e ka shpjeguar kështu:

Ne jemi shoqëri bujqësore, të cilat janë industrializuar brenda një a dy brezash. Ajo që ndodhi në Perëndim gjatë më shumë se 200 vjetësh po ndodh këtu në rreth 50 vjet ose më pak. Gjithçka është ngjeshur e rrasur në një kornizë kohe shumë të ngushtë, kështu që detyrimisht do të ketë zhvendosje dhe keqfunksionime. Po t'u hidhni një sy vendeve me rritje të shpejtë: Koresë, Tajlandës, Hong-Kongut dhe Singaport, do të shihni një dukuri të shënuar: ngritjen e fesë...Zakonet dhe fetë e vjetra, si adhurimi i të parëve, shamanizmi, nuk i kënaqin më plotësisht. Ka kërkesë për disa shpjegime më të larta lidhur me qëllimin e njeriut, përse jemi këtu. Kjo shoqërohet me periudha stresi të madh në shoqëri.²³

Njerëzit nuk jetojnë vetëm me arsyen. Ata nuk mund t'i bëjnë llogaritë dhe të veprojnë sipas arsyes duke ndjekur interesin vetjak, në rast se nuk e përcaktojnë vetveten. Politika e interesit nënkupton identitetin. Në kohët e ndryshimit të shpejtë shoqëror identitetet e përcaktuara treten, duhet ripërcaktuar vetvetja dhe të krijohen identitete të reja. Për njerëzit që ballafaqohen me nevojën për të përcaktuar: Kush jam Unë? Ku bëj pjesë? – feja jep përgjigje bindëse, kurse grupet fetare sigurojnë bashkësi të vogla shoqërore për të zëvendësuar ato që humbasin nëpërmjet urbanizimit. Të gjitha fetë, siç ka thënë Hasan al-Turabi, u japin njerëzve “ndjenjën e identitetit dhe të drejtimit në jetë.” Në këtë proces, njerëzit rizbulojnë ose krijojnë identitete të reja historike. Çfarëdo synimesh universaliste që të kenë, njerëzve feja u jep identitetin, duke vendosur një dallim themelor ndërmjet besimtarëve e mosbesimtarëve, ndërmjet një eprori brenda-grupit dhe të ndryshmit e inferiorit jashtë-grupit.²⁴

Siç e parashtron Bernard Lewis-i (Ljuis), në botën myslimane ka pasur “një prije të përsëritur, në periudhat e emergjencave, që myslimanët ta gjenin identitetin e vet dhe besnikërinë bazë në bashkësinë fetare, domethënë, në një tërësi të përcaktuar nga Islami dhe jo nga kriteret etnike ose territoriale.” Gilles Kepeli po ashtu ka vënë në dukje vendin qendror të kërkimit të identitetit: “Ri-islamizimi ‘nga poshtë’ është në radhë të parë e kryesisht një rrugë për të rindërtuar një identitet në një botë që e ka humbur kuptimin dhe është bërë e paformë e tjetërsuese.”²³ Në Indi “po ndërtohet një identitet i ri hindu” si përgjigje ndaj tensioneve dhe tjetërsimit të përfutur prej modernizimit.²⁶ Në Rusi ringjallja fetare është pasojë e “dëshirës së flaktë për identitet, të cilën mund ta japë vetëm kisha ortodokse, lidhja e vetme e pashkëputur me rusët e 1000 vjetëve të shkuara,” ndërsa në republikat islamike ringjallja po ashtu i ka rrënjët te “aspirata më e fuqishme e aziatikëve të pjesës qendrore: të afirmohen identitetet që Moska i kishte shtypur gjatë dhjetëvjeçarëve.”²⁷ Në veçanti lëvizjet fundamentaliste janë “një rrugë për të përballuar përvojën e kaosit, humbjen e identitetit, të kuptimit dhe të strukturave shoqërore të sigurta, që u shkaktuan nga hyrja e shpejtë e modeleve shoqërore e politike moderne, e shekullarizmit, e kulturës shkencore dhe e zhvillimit ekonomik.” “Lëvizjet fundamentaliste” me peshë, siç e pranon edhe Uiliam H. Maknili, “...janë ato që fuqizohen me forca nga shoqëria në gjerësi dhe përhapen sepse u përgjigjen, ose duket sikur u përgjigjen, nevojave të reja njerëzore që ndihen ...Nuk është e rastit që këto lëvizje të gjitha e kanë bazën në vendet, ku trysnia e popullsisë për tokë po e bën vijimin e mënyrave të vjetra fshatare të pamundur për shumicën e popullsisë, dhe ku komunikimet masive të mbështetura

në qytetet, duke depërtuar në fshatra, kanë nisur ta gërryejnë kornizën shumë të vjetër të jetës fshatare.”²⁸

Në një vështrim më të përgjithshëm, ringjallja fetare në mbarë botën është një reagim kundrejt shekullarizmit, relativizmit moral e vetëkënaqjes, si dhe ripohim i vlerave të rendit, disiplinës, punës, ndihmës reciproke e solidaritetit njerëzor. Grupet fetare përmbushin nevojat shoqërore që kanë mbetur të papërfillura prej burokracive shtetërore. Në këto bëjnë pjesë sigurimi i shërbimeve spitalore e mjekësore, kopshtet e fëmijëve dhe shkollat, kujdesi për të moshuarit, ndihma e shpejtë pas katastrofave natyrore e të tjerave, si dhe mbështetja shoqërore e pasurore gjatë periudhave të ngushticave ekonomike. Prishja e rendit dhe e shoqërisë civile krijon zbrazëti, që mbushen nga grupet fetare, shpesh fundamentaliste.²⁹

Nëse fetë tradicionalisht mbisunduese nuk i plotësojnë nevojat emocionale dhe shoqërore të njerëzve me rrënjë të shkulura, për ta bërë këtë hyjnë në fushë grupe të tjera fetare dhe gjatë procesit e zgjerojnë shumë anëtarësinë e tyre e spikatjen e fesë në jetën shoqërore e politike. Koreja e Jugut historikisht ka qenë vend me mbizotërim budist, ndërsa të krishterët më 1950 përbënin ndoshta 1 deri 3 për qind të popullsisë. Kur Koreja e Jugut i hyri zhvillimit të shpejtë ekonomik, me urbanizimin masiv dhe diferencimin e punësimit, budizmi doli se kishte mangësi. “Për milionat që vërshuan në qytet dhe për shumë të tjerë që mbetën në fshatin e ndryshuar, budizmi i amullt i Koresë së periudhës bujqësore e humbi forcën tërheqëse. Krishterimi me mesazhin e tij të shpëtimit vetjak dhe të fatit individual jepte një ngushëllim më të sigurtë në një kohë turbullirash e ndryshimi.”³⁰ Nga vitet 1980 të krishterët, në pjesën më të madhe presbiterianë e

katolikë, arritën të paktën 30 për qind të popullsisë së Koresë së Jugut.

Një zhvendosje e ngjashme dhe paralele ka ndodhur në Amerikën Latine. Numri i protestantëve në Amerikën Latine është rritur afërsisht nga 7 milionë më 1960 te rreth 50 milionë më 1990. Arsyet e këtij suksesi, siç e kanë pranuar peshkopët katolikë të Amerikës Latine, përfshinin “ngadalësinë për të përvetësuar anët teknike të jetës në qytet” të kishës katolike, dhe “strukturën e saj që sipas rastit e bën të paaftë për t’iu përgjigjur nevojave psikologjike të njerëzve të sotëm.” Siç e ka vërejtur një prift brazilian, ndryshe nga kisha katolike, kishat protestante u përgjigjen “nevojave themelore të njeriut: ngrohtësisë njerëzore, shërimit, përvojës së thellë shpirtërore.” Përhapja e protestantizmit mes të varfërve në Amerikën Latine nuk është kryesisht zëvendësimi i një feje me një tjetër, por më tepër një rritje e pastër e lidhjes me fenë dhe e pjesëmarrjes, meqë katolikët sa për emër e pasivë bëhen evangjelistë veprimtarë e të devotshëm. Në Brazil në fillim të viteve 1990, për shembull, 20 për qind e popullsisë e quante veten protestante dhe 73 për qind katolike, megjithatë të dielave 20 milion njerëz shkonin në kishat protestante dhe rreth 12 milion në kishat katolike.³¹ Ashtu si dhe fetë e tjera botërore, krishterimi po përshkon një rilindje të lidhur me modernizimin dhe në Amerikën Latine ka marrë më tepër formën protestante sesa katolike.

Këto ndryshime në Korenë e Jugut dhe në Amerikën Latine pasqyrojnë paaftësinë e budizmit e të katolicizmit të ngulitur për t’iu përgjigjur nevojave psikologjike, emocionale dhe shoqërore të njerëzve, që janë prekur prej traumave të modernizimit. A ndodhin zhvendosje plotësuese me peshë në përkatësinë fetare gjatë, kjo varet nga shkalla në të cilën feja mbizotëruese është në gjendje t’u përgjigjet këtyre nevojave. Për shkak

të thatësisë emocionale, duket se është i cënueshëm në veçanti konfucianizmi. Në vendet konfuciane protestantizmi dhe katolicizmi mund të kishin një forcë tërheqëse të ngjashme me protestantizmin ungjillor për latinoamerikanët, me krishterimin për koreanët jugorë dhe me fundamentalizmin për myslimanët e hindutë. Në Kinë nga fundi i viteve 1980, kur rritja ekonomike ishte në vrull të plotë, edhe krishterimi u përhap “veçanërisht midis të rinjve”. Ndoshta 50 milionë kinezë janë të krishterë. Qeveria është përpjekur ta ndalojë shtimin e tyre duke i futur në burg priftërinjtë, misionarët dhe ungjillorët, duke i ndaluar e shtypur ceremonitë e veprimtaritë fetare, kurse më 1994 miratoi një ligj, i cili u ndalon të huajve prozelitizmin ose hapjen e shkollave fetare e ngritjen e organizatave të tjera fetare, si dhe i ndalon grupet fetare që të ndërmarrin veprimtari të pavarura a të financuara nga jashtë. Ashtu si në Kinë, edhe në Singapor rreth 5 për qind e popullsisë është e krishterë. Nga fundi i viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990 ministrat e qeverisë i kanë paralajmëruar ungjillorët që të mos e përmbysin “drejtpeshimin e brishtë fetar” të vendit, i kanë arrestuar punonjësit fetarë, ndër ta edhe zyrtarët e organizatave katolike, dhe me mënyra të ndryshme i kanë shqetësuar grupet e individët e krishterë.³² Me përfundimin e Luftës së ftohtë dhe hapjet politike që e pasuan, edhe kishat Perëndimore hynë në republikat e mëparshme sovjetike ortodokse, duke bërë konkurrencë me kishat e ringjallura ortodokse. Edhe këtu, ashtu si në Kinë, u bënë përpjekje për ta mënjanuar prozelitizmin e tyre. Më 1993, me kërkesën e kishës ortodokse, parlamenti rus miratoi ligjin, që u kërkonte grupeve të huaja fetare të akreditoheshin nga shteti ose të lidheshin me ndonjë organizatë fetare ruse, nëse do të ndërmerrnin punë misionare a arsimore. Mirëpo presidenti Jelcin nuk

pranoi ta nënshkruante për ta kthyer këtë projekt në ligj. Të dhënat na bëjnë të mendojmë se kudo ku hyjnë në konflikt, *la revanche de Dieu* ia hedh indigjenizimit: nëse nevojat fetare të modernizimit nuk mund të përmbushen nga besimet tradicionale, njerëzit u kthehen importeve fetare që kënaqin anën emocionale.

Përveç traumave psikologjike, emocionale dhe shoqërore të modernizimit, ndër shtysat nxitëse të ringjalljes fetare kanë qenë tërheqja e Perëndimit dhe fundi i Luftës së ftohtë. Duke nisur me shekullin e nëntëmbëdhjetë, përgjigjet e qytetërimeve joperëndimore kundër Perëndimit përgjithësisht kanë kaluar përmes përparimit të ideologjive të importuara nga Perëndimi. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë elitat joperëndimore përthithnin vlerat liberale Perëndimore, kurse shprehjet e tyre të para të kundërshtimit ndaj Perëndimit merrnin trajtën e nacionalizmit liberal. Në shekullin e njëzetë elitat ruse, aziatike, arabe, afrikane dhe latinoamerikane importuan ideologjitë socialiste e marksiste dhe i ndërthurën me nacionalizmin si kundërvënie ndaj kapitalizmit Perëndimor dhe imperializmit Perëndimor. Shembja e komunizmit në Bashkimin Sovjetik, modifikimi i tij i thellë në Kinë dhe dështimi i ekonomive socialiste, që nuk arritën të mbanin një zhvillim të qëndrueshëm, kanë krijuar sot një zbrazëti ideologjike. Qeveritë, grupet dhe institucionet ndërkombëtare Perëndimore, si FMN-ja dhe Banka Botërore, janë përpjekur ta mbushin këtë zbrazëti me doktrinat e ekonomisë neo-ortodokse dhe të politikës demokratike. Nuk është e sigurtë se në çfarë shkalle këto doktrina do të kenë ndikim afatgjatë në kulturat joperëndimore. Mirëpo ndërkaq, njerëzit e shohin komunizmin si të vetmin zot shekullar të fundit që dështoi dhe në mungesë të hyjnive të reja shekulare imponuese, i kthehen me lehtësim e pasion sendit real.

Feja del mbi ideologjinë dhe nacionalizmi fetar i zë vendin nacionalizmit shekullar.³⁴

Lëvizjet për ringjalljen fetare janë antishekullare, antiuniversale dhe, me përjashtim të shfaqjeve të tyre të krishtera, janë antiperëndimore. Ato gjithashtu u kundërvihen relativizmit, egoizmit dhe konsumizmit, të shoqëruar nga ai që Bruce B. Lawrence-i (Brijus Lourens) e ka emërtuar “modernizëm” të dalluar prej “modernitetit”. Përgjithësisht ato nuk e hedhin poshtë urbanizimin, industrializimin, zhvillimin, kapitalizmin, shkencën e teknologjinë, si dhe gjithçka sjellin këto për organizimin e shoqërisë. Në këtë kuptim, ato nuk janë antimoderne. E pranojnë modernizmin, siç ka vërejtur Li Kuan Jiu, dhe “pashmangshmërinë e shkencës e të teknologjisë dhe ndryshimin në mënyrat e jetës që sjellin me vete”, por nuk “e pranojnë idenë që të perëndimorizohen.” Siç e argumenton al-Turabi, as nacionalizmi dhe as socializmi nuk sollën zhvillim në botën islamike. “Feja është motori i zhvillimit” dhe Islami i dëlirur do të luajë në epokën bashkëkohëse një rol të krahasueshëm me atë të etikës protestante në historinë e Perëndimit. Feja gjithashtu nuk është e papajtueshme me zhvillimin e shtetit modern.³⁵ Lëvizjet islamike fundamentaliste kanë qenë të forta në shoqëritë myslimane më të përparuara dhe, me sa duket, më shekullare, si në Algjeri, Iran, Egjipt, Liban e Tunizi.³⁶ Lëvizjet fetare, duke përfshirë sidomos ato fundamentaliste, janë shumë të zonjat në përdorimin e komunikimeve moderne e të teknikave organizative për përhapjen e mesazhit të vet, çka e ilustron në mënyrën më befasuese suksesi i televangjelizmit protestant në Amerikën Qendrore.

Pjesëmarrësit e ringjalljes fetare vijnë nga të gjitha shtigjet e jetës, por kryesisht prej dy lagjesh, që të dyja qytetare dhe të lëvizshme. Të shpërngulurit e ardhur

kohëve të fundit në qytete përgjithësisht kanë nevojë për mbështetje dhe udhëheqje emocionale, shoqërore e materiale, që mund t'ua japin grupet fetare më shumë se cilido burim tjetër. Për ta feja, siç e ka shprehur Régis Debray, nuk është “opiumi i popullit, por vitamina për të dobëtin.”³⁷ Lagjja tjetër kryesore është klasa e re e mesme, që mishëron “dukurinë e indigjenizimit të brezit të dytë” sipas Doresë. Veprimtarët e grupeve islamike fundamentaliste, siç e vë në dukje Kepeli, nuk janë “konservatorë të moshuar ose fshatarë të paditur.” Ashtu si me të tjerët, edhe me myslimanët ringjallja fetare është dukuri e qyteteve dhe u drejtohet njerëzve që janë me orientim modern, me arsim të mirë e që ndjekin karrierën në profesion, në qeverisje e në tregti.³⁸ Ndër myslimanët, janë fetarë të rinjtë, kurse prindët e tyre janë shekullarë. Pothuaj njësoj ndodh me hinduizmin, në të cilin udhëheqësit e lëvizjeve ringjallëse vijnë nga brezi i dytë i indigjenizuar e shpesh janë “biznesmenë e administratorë të suksesshëm”, që janë quajtur nga shtypi indian “Scupy”, një shkurtim prej një shprehjeje anglisht, që do të thotë profesionist nga klasa e mesme, i cili punon në qytet dhe vishet me të verdha. Mbështetësit e tyre në fillim të viteve 1990 nisën të shtoheshin nga “hindutë e klasës së mesme solide të Indisë: prej tregtarëve dhe financierëve të saj, avokatëve dhe inxhinierëve të saj”, si dhe nga “nëpunësit civilë eprorë të saj, intelektualët dhe gazetarët.”³⁹ Në Korenë e Jugut të njëjtët tipa njerëzish gjithnjë e më shumë mbushnin kishat katolike e presbiteriane gjatë viteve 1960 e 1970.

Feja vendëse ose e importuar u jep kuptim dhe drejtim elitave në ngritje të shoqërive që po modernizohen. Ronald Doreja ka shënuar se “Dhënia e vlerës një feje tradicionale është mëtim për barazi respekti të pohuar kundër kombeve ‘të tjera misunduese’

dhe shpesh, njëkohësisht e më nga afër, kundër një klase sunduese vendëse, e cila ka përfaqëuar vlerat dhe mënyrat e jetesës së atyre që sundojnë kombet e tjera.” Siç e vë re Uiliam Maknili, “Mbi gjithçka tjetër, riafirmimi i Islamit, pavarësisht nga forma e tij e veçantë fetare, do të thotë hedhja poshtë e ndikimit europian dhe amerikan mbi shoqërinë, politikën e moralin vendor.” Në këtë kuptim, ringjallja e feve joperëndimore është shfaqja më e fuqishme e antiperëndimorizmit në shoqëritë joperëndimore. Kjo ringjallje nuk është hedhje poshtë e modernitetit; kjo është hedhje poshtë e Perëndimit dhe e kulturës shekulare, relativistike, të degjeneruar, të lidhur me Perëndimin. Kjo është hedhje poshtë e asaj që është quajtur “helmimi perëndimor” i shoqërive joperëndimore. Është shpallja e pavarësisë kulturore nga Perëndimi, një pohim krenar se: “Ne do të jemi modernë, por nuk do të jemi si ju.”

Kreu 5: Ekonomia, demografia dhe qytetërimet sfiduese

Indigjenizimi dhe ringjallja e fesë janë dukuri globale. Megjithatë, ato kanë qenë më të dukshme në ngulmimin kulturor dhe sfidat ndaj Perëndimit, që kanë ardhur nga Azia dhe nga Islami. Këto kanë qenë qytetërimet dinamike të çerekut të fundit të shekullit të njëzetë. Sfidat islamike është e shfaqur në rilindjen kulturore, shoqërore e politike gjithëpërfshirëse të Islamit në botën myslimane dhe në hedhjen poshtë që e shoqëron të vlerave e të institucioneve Perëndimore. Sfidat aziatike është e shfaqur në të gjitha qytetërimet e Azisë Lindore: sinik, japonez, budist e mysliman, si dhe thekson dallimet e tyre kulturore nga Perëndimi e nganjëherë, përbashkësitë që kanë midis tyre, shpesh të njëjtësuar me konfucianizmin. Si aziatikët, edhe myslimanët theksojnë epërsinë e kulturave të tyre ndaj kulturës Perëndimore. Në kundërshti me këtë, njerëzit në qytetërimet e tjera joperëndimore: hindu, ortodoks, latin amerikan, afrikan, mund të afirmojnë karakterin dallues të kulturave të tyre, por po ashtu si në vitet e mesit 1990 kanë qenë në mëdyshje për ta shpallur epërsinë e tyre ndaj kulturës Perëndimore. Azia dhe Islami qëndrojnë veçan, e nganjëherë së bashku, në ngulmimin e tyre gjithnjë e më shumë me vetëbesim kundrejt Perëndimit.

Shkaqe të lidhura ndërmjet tyre, porse të ndryshme, qëndrojnë prapa këtyre sfidave. Vetësiguria aziatike i ka rrënjët në rritjen ekonomike; vetësiguria myslimane vjen në një masë të madhe prej mobilizimit shoqëror e rritjes së popullsisë. Secila prej këtyre sfidave ka ndikim tepër destabilizues mbi politikën globale dhe do të vijojë ta ketë në shekullin e njëzetënjëtë. Mirëpo natyra e këtyre ndikimeve ndryshon ndjeshëm. Zhvillimi ekonomik i Kinës dhe i shoqërive të tjera aziatike u jep qeverive të tyre si shtysat, edhe burimet për t'u bërë më kërkuese në trajtimin e punëve me vendet e tjera. Shtimi i popullsisë në vendet myslimane e sidomos zgjerimi i breznisë me moshë nga pesëmbëdhjetë deri te njëzet e katër vjeç siguron rekrutët për fundamentalizmin, terrorizmin, rebelimin e migrimin. Rritja ekonomike i fuqizon qeveritë aziatike; rritja demografike kërcënon qeveritë myslimane dhe shoqëritë jomyslimane.

Afirmimi i azisë


Zhvillimi ekonomik i Azisë Lindore ka qenë një prej zhvillimeve më domethënëse në botë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Ky proces nisi në Japoni në vitet 1950 dhe për Japoninë mendohej se ajo do të ishte përjashtimi i madh: një vend joperëndimor, që u modernizua me sukses dhe u bë ekonomikisht i zhvilluar. Mirëpo procesi ekonomik u përhap te Katër Tigrat (Hong-Kongu, Tajvani, Koreja e Jugut, Singapori) e pastaj te Kina, Malajzia, Tajlanda dhe Indonezia, ndërsa po zë vend në Filipinet, në Indi e Vietnam. Këto vende për një dhjetëvjeçar ose më shumë kanë pasur shpesh norma rritjeje vjetore të qëndrueshme 8-10 për

qind a më shumë. Një zgjerim po aq i befasishëm i tregtisë ka ndodhur në fillim ndërmjet Azisë e botës dhe pastaj brenda Azisë. Këto arritje ekonomike aziatike janë në kundërshti dramatike me rritjen modeste të ekonomive amerikane e europiane dhe me amullinë, që ka përfshirë pjesën më të madhe të botës tjetër.

Përjashtim kështu nuk është më vetëm Japonia, përherë e më shumë po bëhet gjithë Azia. Nuk do ta kapërcejë shekullin e njëzetë gjendja, kur pasuria njëjtësohej me Perëndimin dhe moszhvillimi me joperëndimin. Shpejtësia e këtij shndërrimi ka qenë e papërmbajtshme. Siç e ka vënë në dukje Kishore Mahbubani, Britanisë e Shteteve të Bashkuara u janë dashur përkatësisht pesëdhjet e tetë dhe dyzet e shtatë vjet për ta dyfishuar prodhimin e tyre për frymë, porse Japonia e arriti këtë në tridhjetë e tre vjet, Indonezia në shtatëmbëdhjetë, Koreja e Jugut në njëmbëdhjetë dhe Kina në dhjetë. Ekonomia e Kinës është rritur me ritme vjetore mesatarisht 8 për qind gjatë viteve 1980 dhe në gjysmën e parë të viteve 1990, kurse Tigrat e ndiqnin nga afër (shih Skicën 5.1). “Zona ekonomike kineze”, siç e ka shpallur Banka Botërore më 1993, u bë “poli i katërt botëror i rritjes”, krahas me Shtetet e Bashkuara, Japoninë e Gjermaninë. Sipas shumicës së përlogaritjeve, ekonomia kineze do të bëhet më e madhja e botës në fillim të shekullit të njëzetënjëtë. Duke pasur ekonomitë më të mëdha të botës në rend të dytë e të tretë në vitet 1990, Azia ka të ngjarë të ketë katër prej pesë ekonomive më të mëdha dhe shtatë prej tetë ekonomive më të mëdha aty nga viti 2020. Në këtë datë shoqëritë aziatike ka gjasa të përbëjnë mbi 40 për qind të prodhimit ekonomik global. Ka mundësi që edhe shumica e ekonomive më konkurruese të jenë aziatike. Madje edhe nëse rritja ekonomike aziatike pas jo shumë kohësh do të kalojë në një rrafsh dhe shumë më me

tatëpjetë sesa pritet, rrjedhimet e rritjes që tashmë ka ndodhur përsëri janë të jashtëzakonshme për Azinë dhe botën.

Skica 5.1:
Sfida ekonomike: Azia dhe Perëndimi



Burimi: Banka Botërore, *World Tables 1995, 1991* (Baltimore: John Hopkins Univeristy Press, 1995, 1991); Directorate-General of Budget, Accounting and Statistics, R.O.C., *Statistical Abstract of National Income, Taiwan Area, Republic of China, 1951-1955* (1995). Shënim: Paraqitjet e të dhënave janë mesataret trevjetore të marra varg.

Zhvillimi ekonomik i Azisë Lindore po e ndryshon peshoren e fuqisë ndërmjet Azisë e Perëndimit, veçanërisht Shteteve të Bashkuara. Zhvillimi ekonomik me sukses përfiton vetëbesimin dhe ngulmimin nga ana e atyre që e prodhojnë dhe përfitojnë prej tij. Pasuria,

ashtu si dhe fuqia, pranohen si prova të virtytit, një demonstrim i epërsisë morale e kulturore. Duke u bërë ekonomikisht më të fuqishëm, aziatikët lindorë nuk ngurrojnë të theksojnë natyrën e dallueshme të kulturës së vet dhe të trumbetojnë epërsinë e vlerave të tyre e të mënyrës së tyre të jetesës, në krahasim me të Perëndimit dhe të shoqërive të tjera. Shoqëritë aziatike gjithnjë e më pak u përgjigjen kërkesave e interesave të SHBA dhe gjithnjë e më shumë janë në gjendje t'u bëjnë qëndresë trysnive nga Shtetet e Bashkuara ose vendet e tjera Perëndimore.

Ambasadori Tomi Koh ka vërejtur më 1993 se "Një rilindje kulturore po përshkon" Azinë. Ajo nënkupton "vetëbesimin në rritje", që do të thotë se aziatikët "nuk e shikojnë më gjithçka Perëndimore ose amerikane si detyrimisht më të mirë." Kjo rilindje e shfaq veten në theksimin që vjen duke u shtuar si të identiteteve të dallueshme kulturore të vendeve aziatike, ashtu edhe të përbashkësive të kulturave aziatike, që i dallojnë prej kulturës Perëndimore. Domethënia e këtij rigjallërimi kulturor është ngulitur në ndërveprimin e ndryshuar me kulturën Perëndimore. të dy shoqërive më të mëdha të Azisë Lindore

Kur Perëndimi në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë iu imponua Kinës e Japonisë, pas një marramendjeje të çastit me qemalizmin, elitat mbizotëruese zgjodhën strategjinë reformiste. Me Restaurimin e Meijive në Japoni erdhi në pushtet një grup dinamik reformatorësh, i studioi dhe i huazoi teknikat e Perëndimit, praktikat e institucionet, dhe nisi procesin e modernizimit japonez. Mirëpo ata vepruan në këtë mënyrë për të ruajtur anët thelbësore të kulturës tradicionale japoneze, që nga shumë pikëpamje dhanë ndihmesë për modernizimin dhe e bënë të mundur për Japoninë t'u drejtohej, t'i riformulonte e të mbështetej në

elementët e asaj kulture, që të gjente mbështetje dhe të përligjte imperializmin e vet në vitet 1930 e 1940. Nga ana tjetër, në Kinë dinastia në rënie Çing nuk qe në gjendje t'i përshtatej me sukses ndikimit të Perëndimit. Kina u mund, u shfrytëzua e u poshtërua nga Japonia dhe fuqitë europiane. Shembja e dinastisë më 1910 u pasua nga përçarja, lufta civile dhe duke iu drejtuar koncepteve Perëndimore konkurruese nëpërmjet udhëheqësve konkurrues intelektualë e politikë kinezë: tre parimeve të Sun Jat Senit “Nacionalizmit, demokracisë e jetesës së njerëzve”; liberalizmit të Liang Çiçaos; marksizëm-leninizmit të Mao Ce Dunit. Nga fundi i viteve 1940 importi prej Bashkimi Sovjetik fitoi mbi atë prej Perëndimit: mbi nacionalizmin, liberalizmin, demokracinë, krishterimin, dhe Kina u përcaktua si shoqëri socialiste.

Në Japoni thyerja e plotë në Luftën II Botërore shkaktoi pështjellimin e plotë kulturor. Më 1994, sipas komenteve të një perëndimori me njohje të thellë të Japonisë, “Tashti është shumë e vështirë për ne ta vlerësojmë shkallën në të cilën gjithçka: feja, kultura, secili aspekt i veçantë i ekzistencës mendore të këtij vendi, ishte vënë në shërbim të asaj lufte. Humbja e luftës ishte një goditje tërësore për atë sistem. Në mendjet e tyre gjithçka u bë pa vlerë dhe u flak tutje.”³ Në vend të saj, gjithçka e lidhur me Perëndimin e në veçanti me Shtetet e Bashkuara fitimtare nisi të shihej si e mirë dhe e dëshirueshme. Japonia në këtë mënyrë u përpoq të rivalizonte me Shtetet e Bashkuara, madje ashtu si Kina rivalizonte me Bashkimin Sovjetik.

Nga fundi i viteve 1970, kur komunizmi dështoi dhe nuk e arriti zhvillimin ekonomik e suksesin e kapitalizmit në Japoni e gjithnjë e më shumë në shoqëritë e tjera aziatike, udhëheqja e re kineze u detyrua të largohej prej modelit sovjetik. Shembja e Bashkimit Sovjetik një

dhjetëvjeçar më vonë i theksoi edhe më tepër dështimet e këtij importi. Kështu Kina u gjend përballë çështjes: a të kthehej nga Perëndimi apo të kthehej nga brenda. Shumë intelektualë dhe disa të tjerë përkrahën perëndimorizimin tërësor, një prirje që i arriti kulmet kulturore e popullore në serinë televizive *Elegjia e lumit* dhe te Hyjnesha e demokracisë, që u ngrit në Sheshin Tienanmen. Mirëpo ky orientim Perëndimor nuk gëzonte mbështetjen as të disa pak qindra njerëzve, që kishin peshë në Pekin, as të 800 milionë fshatarëve që jetonin në fshat. Perëndimorizimi total në fund të shekullit të njëzetë nuk ishte tashmë as më praktik sesa kishte qenë në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në vend të kësaj udhëheqja zgjodhi një variant të ri të kapitalizmit të *Ti-Jongut*: nga njëra anë, kapitalizmi dhe përfshirja në ekonominë botërore, nga ana tjetër, ndërthurja me autoritarizmin politik dhe rikthimi te kultura tradicionale kineze. Në vend të ligjshmërisë revolucionare marksiste-leniniste, regjimi vuri ligjshmërinë e arritjeve që e jepte hovi i zhvillimit ekonomik dhe ligjshmërinë nacionaliste, që e jepte evokimi i tipareve dalluese të kulturës kineze. Si e ka vënë re një vëzhgues, “Regjimi pas Tienanmenit ka përqafuar me zell nacionalizmin kinez si burim të ri të ligjshmërisë” dhe me vetëdije ka ngjallur anti-amerikanizmin për të përligjur pushtetin e qëndrimin e vet.⁴ Kështu, po ngrihet një nacionalizëm kulturor kinez, që e japin shkurt fjalët e njërit prej udhëheqësve të Hong-Kongut më 1991: “Ne, kinezët, e ndiejmë veten nacionalistë, siç nuk e kemi ndier kurrë më parë. Ne jemi kinezë dhe e ndiejmë veten krenarë për këtë.” Në vetë Kinën nga fillimi i viteve 1990 u ngjall një “dëshirë popullore për t’u kthyer te gjithçka autentike kineze, që shpesh është patriarkale, amëtare dhe autoritare. Në këtë ringjallje historike është diskredituar demokracia, po

ashtu si leninizmi, duke u parë thjesht si një imponim tjetër i huaj.”⁵

Në fillim të shekullit të njëzetë intelektualët kinezë, paralelisht dhe në mënyrë të pavarur, e njëjtësonin konfucianizmin si burimin e prapambetjes kineze. Nga fundi i shekullit të njëzetë udhëheqësit kinezë, duke ecur paralelisht me studiuesit socialë të Perëndimit, e ngrenë lart konfucianizmin si burimin e përparimit kinez. Në vitet 1980 qeveria kineze nisi të nxiste interesimin për konfucianizmin, ndërsa udhëheqësit partiakë e shpallnin si “rrymën kryesore” të kulturës kineze.⁶ Natyrisht, konfucianizmi u bë gjithashtu synimi i entuziazmit të Li Kuan Jiut, i cili e shihte si burim të suksesit të Singaporit dhe u bë misionar i vlerave konfuciane për pjesën tjetër të botës. Në vitet 1990 qeveria e Tajvanit e shpalli veten si “trashëgimtare të mendimit konfucian” dhe presidenti Li Teng Hui i gjente rrënjët e demokratizimit të Taivanit te “trashëgimia kulturore” kineze, që shkonte pas në histori deri te Kao Jao (shekulli i njëzetënjëtë para e.r.), Konfuci (shekulli i pestë para e.r.) dhe Menci (shekulli i tretë para.e.r.).⁷ Pavarësisht nëse duan të përlligjin autoritarizmin apo demokracinë, udhëheqësit kinezë e kërkojnë ligjorimin te kultura e tyre e përbashkët kineze dhe jo te konceptet Perëndimore të importuara.

Nacionalizmi i përkrahur prej regjimit është nacionalizmi Han, i cili ndihmon të mbahen nën fre dallimet gjuhësore, rajonale dhe ekonomike ndërmjet 90 për qind të popullsisë kineze. Njëkohësisht ai thekson gjithashtu dallimet me pakicat etnike jokineze, që përbëjnë më pak se 10 për qind të popullsisë së Kinës, por zënë 60 për qind të territorit të saj. Ai gjithashtu jep një mbështetje për kundërshtimin e regjimit ndaj krishterimit, organizatave të krishtera dhe prozelitizmit të krishterë, që japin një besim Perëndimor alternativ për

të mbushur zbrazëtinë e lënë prej rënies së leninizmit maoist.

Ndërkaq në Japoni zhvillimi ekonomik i suksesshëm në kontrast me dështimet e shfaqura dhe “rëniën” e ekonomisë e të sistemit shoqëror amerikan, i shtynte japonezët gjithnjë e më shumë të ishin të zhgënjyer prej modeleve Perëndimore dhe të bindeshin përherë e më shumë se burimet e suksesit të tyre duhet të gjendeshin brenda kulturës së tyre. Kultura japoneze, që shkaktoi katastrofën ushtarake më 1945 dhe, rrjedhimisht, duhej hedhur poshtë, nga viti 1985 kishte prodhuar ngadhënjimin ekonomik e, rrjedhimisht, duhej përqafuar. Njohja e shtuar e japonezëve me shoqërinë Perëndimore i shtyu të “kuptonin se të qenit Perëndimor nuk është si me magji i mrekullueshëm në vetvete dhe për vete. Ata e nxorën këtë prej sistemit të vet.” Ndërsa japonezët e Restaurimit Meiji zbatuan politikën e ‘shkëputjes prej Azisë dhe bashkimit me Europën’, japonezët e ringjalljes së fundit të shekullit të njëzetë hynë në rrugën e politikës për t’u “larguar nga Amerika e për t’u përfshirë në Azi.”⁸ Kjo rrymë përfshinte, së pari, rinjëjtësimin me traditat kulturore japoneze dhe ripohimin e vlerave të atyre traditave, e së dyti si diçka më problematike, një përpjekje për ta “aziatizuar” Japoninë dhe, me gjithë qytetërimin e saj të dallueshëm, për ta njëjtësuar Japoninë me kulturën e përgjithshme aziatike. Duke e ditur shkallën në të cilën Japonia pas Luftës II Botërore, në kontrast me Kinën, e njëjtësonte veten me Perëndimin, dhe duke e ditur shkallën në të cilën Perëndimi, pavarësisht nga dështimet e veta, nuk u shemb tërësisht si ndodhi me Bashkimin Sovjetik, shtysat për Japoninë që ta flakë poshtë Perëndimin tërësisht asgjekund nuk kanë qenë pothuaj po aq të mëdha sesa ato të Kinës për t’u larguar si nga modeli sovjetik, ashtu edhe nga modeli Perëndimor. Nga

njëra anë, natyra e veçantë e qytetërimit japonez, kujtimet në vendet e tjera për imperializmin japonez dhe vendi qendror ekonomik i kinezëve mes shumicës së vendeve të tjera aziatike, gjithashtu duan të thonë se për Japoninë do të jetë më e lehtë të largohet prej Perëndimit, sesa do të jetë të shkrihet me Azinë.⁹ Duke e ripohuar identitetin e vet kulturor, Japonia nënvizon natyrën e saj të veçantë dhe dallimet si nga Perëndimi, edhe nga kulturat e tjera aziatike.

Ndërsa kinezët e japonezët kanë gjetur një vlerë të re të kulturat e veta, kanë pasur gjithashtu të përbashkët një ripohim më të gjerë të vlerës së kulturës aziatike përgjithësisht, në krahasim me atë të Perëndimit. Industrializimi dhe rritja që e shoqëruan kanë përfutur në vitet 1980 e 1990 shprehjen nga ana e aziatikëve lindorë të asaj, që më saktë mund të quhej afirmimi aziatik. Ky kompleks qëndrimesh ka katër përbërëse kryesore.

E para, aziatikët besojnë se Azia Lindore do ta ruajë zhvillimin e shpejtë ekonomik, së shpejti do t'ia kalojë Perëndimit nga prodhimi ekonomik dhe, rrjedhimisht, do të jetë përherë e më e fuqishme në punët e botës krahasuar me Perëndimin. Rritja ekonomike nxit ndër shoqëritë aziatike një ndjenjë fuqie dhe afirmimin e aftësisë së tyre për t'i bërë ballë Perëndimit. "Ditët kur teshtinin Shtetet e Bashkuara dhe Azia atëherë kishte marrë të ftohtë, kanë marrë fund," ka deklaruar një gazetar i njohur japonez më 1993, kurse një zyrtar malajzian i ka shtuar kësaj metafore mjekësore se "madje edhe ethe të larta në Amerikë nuk do ta bëjnë Azinë të kollitet." Si ka thënë një udhëheqës tjetër aziatik, aziatikët janë "në fund të epokës së frikës dhe në fillim të epokës së kundërshtimit" në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Zëvendëskryeministri i Malajzisë është shprehur se "Lulëzimi në rritje i Azisë do të thotë se

tashmë është në gjendje të paraqesë alternativa serioze ndaj rregullimeve globale politike, shoqërore dhe ekonomike.”¹⁰ Kjo do të thotë gjithashtu, si shprehen aziatikët, se Perëndimi po e humbet me shpejtësi aftësinë për t’i bërë shoqëritë aziatike të përputhen me standardet Perëndimore lidhur me të drejtat e njeriut dhe vlerat e tjera.

E dyta, aziatikët besojnë se ky sukses ekonomik në pjesën më të madhe është prodhim i kulturës aziatike, që është eprore ndaj asaj të Perëndimit, e cila është dekadente nga ana kulturore e shoqërore. Gjatë ditëve të vrullshme të viteve 1980, kur po përjetonin një bum ekonomia, eksportet, bilanci tregtar dhe rezervat e valutës së huaj, japonezët po ashtu si arabët sauditë përpara tyre krenoheshin me fuqinë e vet të re ekonomike, flisnin me përçmim për rënien e Perëndimit, kurse suksesin e vet bashkë me dështimet e Perëndimit i lidhnin me epërsinë e kulturës së tyre dhe me dekadencën e kulturës Perëndimore. Në fillim të viteve 1990 ngadhënjimtaria aziatike gjeti shprehje të re në atë që mund të përcaktohet vetëm si “ofensiva kulturore e Singaporit.” Që prej Li Kuan Jiut e më pas udhëheqësit e Singaporit trumbetonin ngritjen e Azisë kundrejt Perëndimit dhe virtytet e kulturës aziatike, në themel konfuciane, si shkaktare të këtij sukcesi: rendin, disiplinën, përgjegjësinë familjare, punën e palodhur, kolektivizmin, përmbajtjen nga veset, i ballafaqonin me vetëkënaqjen, përtacinë, individualizmin, krimin, arsimin më të ulët, mosrespektin për autoritetin dhe “ngurtësimin mendor” si shkaktare të rënies së Perëndimit. Argumentohej se për të konkurruar me Lindjen, Shtetet e Bashkuara “duhet të vënë në pikëpyetje parimet e tyre themelore lidhur me rregullimin shoqëror e politik dhe, në këtë proces, të mësojnë nja dy gjëra nga shoqëritë e Azisë Lindore.”¹¹

Për aziatikët lindorë sukcesi i Azisë Lindore është rrjedhim në veçanti i theksimit kulturor aziatik lindor të kolektivitetit e jo të individit. “Vlerat dhe praktikat me më tepër natyrë bashkësie të aziatikëve lindorë: japonezëve, koreanëve, tajvanezëve, honkongasve dhe singaporasve, e kanë treguar qartë se janë cilësi të çmueshme në procesin e arritjes së të tjerëve,” është shprehur Li Kuan Jiu. “Vlerat të cilave u përmbahet kultura e Azisë Lindore, si vënia e interesave të grupit mbi interesat e individit, mbështetin përpjekjen tërësore të grupit, të nevojshme për t’u zhvilluar me shpejtësi.” Kryeministri i Malajzisë pajtohet se “Etika e punës e japonezëve dhe e koreanëve, që përbëhet prej disiplinës, besnikërisë dhe zellit, ka shërbyer si forca motivuese për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendeve përkatëse. Kjo etikë e punës ka lindur nga filozofia se grupi dhe atdheu janë më të rëndësishëm se individit.”¹²

E treta, ndërsa i njohin dallimet ndërmjet shoqërive dhe qytetërimeve aziatike, aziatikët lindorë shprehen se ka gjithashtu përbashkësi të rëndësishme. Ndër këto vendin qendror e zë, siç e ka vënë në dukje një disident kinez, “sistemi i vlerave i konfucianizmit, që nderohet nga historia dhe e quajnë të përbashkët shumica e vendeve të rajonit”, në veçanti theksimi i kursimtarisë, familjes, punës e disiplinës. Po aq rëndësi si tipar i përbashkët ka hedhja poshtë e individualizmit dhe mbizotërimi i autoritarizmit “të butë” ose i formave mjaft të kufizuara të demokracisë. Shoqëritë aziatike përballë Perëndimit kanë interesa të përbashkët për të mbrojtur këto vlera dalluese dhe për të ndjekur interesat e vet ekonomike. Aziatikët argumentojnë se kjo kërkon zhvillimin e formave të reja të bashkëpunimit ndërasiatik, si zgjerimi i Shoqatës së Shteteve Aziatike Juglindore dhe krijimi i Grupit Ekonomik të Azisë Lindore. Ndërsa interesin e tashëm ekonomik të

shoqërive të Azisë Lindore e përbën ruajtja e depërtimit në tregjet e Perëndimit; nga pikëpamja afatgjatë ka gjasa se do të mbizotërojë rajonalizmi ekonomik dhe, rrjedhimisht, Azia Lindore gjithnjë e më tepër duhet të nxisë tregtinë e investimet ndëraziatike.¹³ Në veçanti për Japoninë, si udhëheqëse e zhvillimit aziatik, është e nevojshme të largohet prej politikës së saj historike “për çazitizimin e properëndimorizimin” dhe të ndjekë një rrugë “të riaziatizimit”, ose më gjerë, të nxisë “aziaticizimin e Azisë”, rrugë në të cilën kanë hyrë zyrtarët e Singaporit.¹⁴

E katërta, aziatikët lindorë shprehen se zhvillimi aziatik dhe vlerat aziatike janë modele, që shoqëritë e tjera joperëndimore duhet t’i synojnë në përpjekjet e tyre për ta arritur Perëndimin dhe të cilat Perëndimi duhet t’i zbatojë që ta përtërijë veten. Aziatikët lindorë mëtojnë se “Modeli zhvillimor anglosakson, që është përndëruar aty shumë gjatë katër dhjetëvjeçarëve të kaluar si mjeti më i mirë për të modernizuar ekonomitë e shteteve në zhvillim dhe për të ndërtuar një sistem politik jetëgjatë, nuk shërben më.” Vendin e tij po e zë modeli i Azisë Lindore, meqë vendet nga Meksika e Kili dhe deri te Irani e Turqia, si dhe republikat e mëparshme sovjetike tashti përpiqen të mësojnë nga suksesi i tij, madje ashtu si u përpoqën brezat e mëparshëm të mësonin nga suksesi i Perëndimit. Azia duhet “t’ia kalojë pjesës tjetër të botës ato vlera aziatike, që kanë cilësi universale ...transmetimi i këtij ideali do të thotë eksportimi i sistemit shoqëror të Azisë, e në veçanti të Azisë Lindore.” Për Japoninë dhe vendet e tjera aziatike është e domosdoshme që të nxisin “globalizmin e Paqësorit”, ta “globalizojnë Azinë” dhe rrjedhimisht, “vendosmërisht t’i japin trajtë natyrës së rendit të ri botëror.”¹⁵

Shoqëritë e fuqishme janë universaliste; shoqëritë e dobëta janë partikulariste. Vetëbesimi në ngritje i Azisë Lindore ka përftuar një universalizëm në rritje, të krahasueshëm me atë që ka qenë karakteristik për Perëndimin. Kryeministri Mahathir u ka thënë shprehur krerëve të qeverive europiane më 1996 se “Vlerat aziatike janë vlera universale. Vlerat europiane janë vlera europiane.”¹⁶ Krahas kësaj shkon edhe “Oksidentalizmi” aziatik, që e paraqet Perëndimin pothuaj në të njëjtën mënyrë të njëtrajtshëm e negativ, siç mëtohet se e paraqiste Lindjen dikur Orientalizmi Perëndimor. Për aziatikët lindorë lulëzimi ekonomik është provë e epërsisë morale. Nëse në një periudhë të caktuar India do t’ia zërë vendin Azisë Lindore si zona ekonomike e botës me zhvillimin më të shpejtë, bota duhet të përgatitet për kërkimet e zgjeruara rreth epërsisë së kulturës hindu, ndihmesave të sistemit të kastave për zhvillimin ekonomik dhe sesi duke iu kthyer rrënjëve të veta e duke kapërcyer trashëgiminë mbytëse Perëndimore, të lënë nga imperializmi, India më në fund e gjeti vendin e saj në krye të listës së qytetërimeve. Suksesi material e ndjek afirmimi kulturor; fuqia e fortë përfiton fuqinë e butë.

Rigjallërimi islamik

Ndërsa aziatikët fituan gjithnjë e më tepër vetësiguri më të madhe si rrjedhim i zhvillimit ekonomik, myslimanët në shifra masive njëkohësisht po ktheheshin nga Islami si burim identiteti, kuptimi, stabiliteti, ligjshmërie, zhvillimi, fuqie dhe shprese, shpresë e përmbledhur në parullën “Zgjidhja është Islami.” Kjo

Ringjallje Islamike* nga shtrirja dhe thellësia është faza e fundit e përshtatjes së qytetërimit islamik ndaj Perëndimit, një përpjekje për të gjetur “zgjidhjen” jo të ideologjitë Perëndimore, por të Islami. Ajo mishëron pranimin e modernitetit, hedhjen poshtë të kulturës Perëndimore dhe ripërkushtimin ndaj Islamit si udhëheqës për jetën në botën moderne. Siç e ka shpjeguar një zyrtar i Arabisë Saudite më 1994, “Importet e huaja janë të bukura si ‘sende’ të ndritshme ose të teknologjisë së lartë. Institucionet shoqërore e politike që nuk preken me dorë, të importuara prej gjetiu, mund të jenë vdekjeprurëse, për këtë pyesni shahun e Iranit ... Islami për ne nuk është thjesht një fe, porse një mënyrë jetese. Ne të Arabisë Saudite duam të modernizohemi, por jo doemos të perëndimorizohemi.”¹⁷

Ringjallja Islamike është përpjekja e myslimanëve për ta arritur këtë synim. Është lëvizja e gjerë intelektuale, kulturore, shoqërore dhe politike, që mbizotëron në mbarë botën islamike. “Fundamentalizmi” islamik, që zakonisht përfytyrohet si Islami politik, është vetëm një përbërëse e rilindjes shumë më të gjerë të ideve, praktikave dhe retorikës islamike, si dhe ripërkushtimi i popullsisë myslimane ndaj Islamit. Ringjallja është rrymë mbizotëruese e jo ekstremiste, është gjithëpërfshirëse dhe jo e izoluar.

Ringjallja ka prekur myslimanët në cilindo vend dhe shumicën e anëve të jetës e të politikës në vendet

* Disa lexues mund të habiten përse e kam dhënë me shkronjë të madhe fjalën “Ringjallje” të togu “Ringjallja Islamike”. Arsyeja është se shënon një ngjarje historike jashtëzakonisht të rëndësishme, që prek një të pestën ose më shumë të njetëzimit, domethënë të paktën është po aq me rëndësi sa Revolucioni Amerikan, Revolucioni Francez ose Revolucioni Rus, për të cilët gjithashtu shkronjat ‘r’ zakonisht shkruhen me të madhe, si dhe i ngjan e është i krahasueshëm me Reformacionin Protestant në shoqërinë Perëndimore, që gjithashtu pothuaj pa ndryshim shkruhet me ‘R’ të madhe.

muslimane. “Treguesit e zgjimit islamik në jetën vetjake”, ka shkruar John L. Esposito (Xhon Esposito):

janë të shumtë: shtimi i vëmendjes për ndjekjen e rregullave fetare (vajtja në xhami, lutja, agjërimi), përhapja e programimit dhe botimeve fetare, theksimi më i madh i veshjeve e i vlerave islamike, ringjallërimi i sufizmit (misticizmit). Kjo ringjallje me bazë të gjerë është shoqëruar gjithashtu nga riafirmimi i Islamit në jetën publike: janë shtuar qeveritë, organizatat, ligjet, bankat, shërbimet e mirëqenies shoqërore dhe institucionet arsimore me orientim islamik. Si qeveritë, edhe lëvizjet e opozitës i janë kthyer Islamit për të shtuar autoritetin dhe për të tërhequr mbështetjen e popullit ... Shumica e sundimtarëve dhe qeverive, duke përfshirë shtete më shekullare si Turqia e Tunizia, po bëhen të vetëdijshme për fuqinë potenciale të Islamit, janë bërë gjithnjë e më të ndjeshme e më të shqetësuara për çështjet islamike.

Një dijetar tjetër i shquar i Islamit, Ali E. Hillal Desouki, duke përdorur të njëjtat shprehje, Ringjalljen e sheh si dukuri që përmban përpjekje për: rivendosjen e së drejtës islamike në vend të së drejtës Perëndimore, përdorimin e shtuar të gjuhës e të simbolizmit fetar, zgjerimin e arsimit islamik (që shfaqet në shumëfishimin e shkollave islamike dhe në islamizimin e programeve në shkollat e rregullta shtetërore), shtimin e zbatimit të kodeve islamike për sjelljen shoqërore (p.sh. mbulimi i grave, mospërdorimi i alkoolit) dhe shtimin e pjesëmarrjes në shërbesat fetare, mbizotërimin e kundërshtimit ndaj qeverive shekullare në shoqëritë muslimane nga ana e grupeve islamike, si dhe zgjerimin e përpjekjeve për të zhvilluar solidaritetin ndërkombëtar midis shteteve e shoqërive islamike.¹⁸ *La Revanche de Dieu* është dukuri globale, por Zoti, ose më mirë Allahu, e ka bërë shpagimin e tij më gjithëpërfshirës dhe të përmbushur në *umajetin*, bashkësinë e Islamit.

Në shfaqjen e vet politike Ringjallja Islamike ka disa ngjashmëri me marksizmin, me shkrimet e shenjta, me përfytyrimin e shoqërisë së përsosur, zotimin për ndryshimin rrënjësor, mospranimin e fuqive e shtetit komb, si dhe me larminë doktrimore nga reformizmi i përmbajtur deri te revolucionarizmi. Mirëpo një analogji më e dobishme është me Reformacionin protestant. Që të dy janë reagime kundrejt amullisë e korrupsionit të institucioneve ekzistuese; kërkojnë kthimin te forma më e pastër dhe më kërkuese e fesë; predikojnë punën, rendin e disiplinën, si dhe u drejtohen njerëzve të klasës së mesme e dinamike që po dalin. Që të dy janë gjithashtu lëvizje komplekse, me rryma të ndryshme, por me dy kryesore prej tyre, luteranizmin e kalvinizmin, nga njëra anë, e fundamentalizmin shiit e suni, nga ana tjetër, madje me paralele ndërmjet Johan Kalvinit e Ajatollah Komeinit, si dhe me disiplinën prej manastiri që përpiqen t'ua bëjnë të detyrueshme shoqërive të tyre. Fryma qendrore si e Reformacionit, edhe e Ringjalljes është reforma rrënjësore. "Reformacioni duhet të jetë universal," ka thënë një prift puritan, "...reformë e të gjitha vendeve, e të gjithë njerëzve dhe fushave; reformë e bankave të gjyqimit, e gjyqtarëve të ulët ...Të reformohen universitetet, të reformohen qytetet, të reformohen fshatrat, të reformohen shkollat e ulëta, të reformohet e diela, të reformohen shërbesat, adhurimi i Zotit." Me terma të ngjashëm shprehet al-Turabi: "ky zgjim është gjithëpërfshirës, ai nuk ka të bëjë vetëm me fetarinë vetjake; nuk është thjesht intelektual e kulturor, as nuk është thjesht politik. Ka të bëjë me të gjitha këto, është një rindërtim tërësor i shoqërisë që nga kreu në themel."¹⁹ Ta shpërfillësh ndikimin e Ringjalljes Islamike mbi politikën e Gjysmërruzullit Lindor në fund të shekullit të njëzetë është njësoj si të shpërfillësh

ndikimin e Reformacionit protestant mbi politikën europiane nga fundi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë.

Ringjallja ndryshon prej Reformacionit në një anë kyç. Ndikimi i të dytit kufizohej kryesisht në Europën veriore, pati pak përhapje në Spanjë, Itali, në Europën lindore dhe në trevat e Habsburgëve përgjithësisht. Ringjallja, përkundrazi, ka prekur pothuaj cilëndo shoqëri myslimane. Duke nisur me vitet 1970, simbolet islamike, besimet, praktikat, institucionet, politika dhe organizatat fituan përkrahje e mbështetje në rritje në mbarë botën e 1 miliard myslimanëve, që shtrihet nga Maroku deri në Indonezi dhe nga Nigeria në Kazakistan. Pati prirje që të bëhej islamizimi në fillim në fushën kulturore e pastaj të kalonte në sferat shoqërore e politike. Udhëheqësit intelektualë e politikë, qofshin të mbështetur ose jo, as nuk mund ta shpërfillnin, as nuk mund të shmangeshin pa e zbatuar në një mënyrë ose në një tjetër. Përgjithësimet tërësore gjithmonë janë të rrezikshme e shpesh të gabuara. Mirëpo njëri, me sa duket, është i përligjur. Më 1995 cilido vend me mbizotërim të popullsisë myslimane, me përjashtim të Iranit, ishte më islamik e islamist nga ana kulturore, politike e shoqërore, sesa kishte qenë pesëdhjetë vjet më parë.²⁰

Në shumicën e vendeve një element qendror i islamizimit ka qenë zhvillimi i organizatave islamike dhe shtënia në dorë nga grupet islamike e organizatave ekzistuese më parë. Vëmendje të veçantë islamistët i kushtuan si ngritjes së shkollave islamike, edhe zgjerimit të ndikimit islamik në shkollat shtetërore. Në të vërtetë grupet islamike sollën në jetë “shoqërinë civile” islamike, e cila u bë paralele, i kapërceu dhe shpesh i zëvendësoi nga shtrirja e veprimtaria institucionet dëndur të brishta të shoqërisë civile shekullare. Nga fillimi i viteve 1990 në Egjipt organizatat islamike ngritën një rrjet të gjerë

organizatash, që duke mbushur zbrazëtinë e lënë prej qeverisë, u siguroi shërbimet shëndetësore, të jetesës, arsimin dhe të tjera një numri të madh njerëzish të varfër të Egjiptit. Pas tërmetit të vitit 1992 në Kajro, këto organizata “dolën në rrugë brenda pak orësh, shpërndanin ushqime e mbulesa, ndërsa po vononin përpjekjet e qeverisë për të dhënë ndihmë.” Në Jordani Vëllezëria Myslimane me vetëdije ndoqi politikën e zhvillimit të “infrastrukturës së një republike islamike” në fushën shoqërore e kulturore dhe nga fillimi i viteve 1990 në këtë vend të vogël prej 4 milionë banorësh tashmë punonin një spital shumë i madh, njëzet klinika, dyzet shkolla islamike dhe 120 qendra studimi të Kuranit. Aty në Bregun Perëndimor dhe në Gazën fqinjë, organizatat islamike ngritën e vunë në veprim “bashkime studentore, organizata rinie dhe shoqata fetare, shoqërore e arsimore,” ndër to shkolla prej kopshteve të fëmijëve e deri te universiteti islamik, klinika, jetimore, një azil pleqsh dhe një sistem gjyqtarësh e arbitrash islamikë. Organizatat islamike u përhapën në mbarë Indonezinë në vitet 1970 e 1980. Nga fillimi i viteve 1980 ajo më e madhja, *Mubamadixhab*, kishte 6 milionë anëtarë, përbënte një “shtet fetar të përkrahjes shoqërore brenda shtetit laik” dhe siguronte shërbime “nga djepi deri në varr” për gjithë vendin nëpërmjet rrjetit të shtrirë të shkollave, klinikave, spitaleve dhe institucioneve në nivel universitar. Në këto shoqëri dhe të tjera myslimane, organizatat islamiste, të cilave u ndalohej veprimtaria politike, siguronin shërbime shoqërore të krahasueshme me ato të makinave politike në Shtetet e Bashkuara nga fillimi i shekullit të njëzetë.²¹

Shfaqjet politike të Ringjalljes kanë qenë më pak gjithëpërfshirëse sesa shfaqjet shoqërore e kulturore, e megjithatë përsëri përbëjnë të vetmin zhvillim më të

rëndësishëm politik në shoqëritë myslimane në çerekun e fundit të shekullit të njëzetë. Shtrirja dhe përbërja e mbështetjes politike për lëvizjet islamiste ka ndryshime prej një vendi në tjetrin. Megjithatë ekzistojnë disa prirje më të gjera. Në tërësi ato lëvizje nuk gjejnë shumë përkrahje te elitat e fshatrave, te fshatarët dhe më të moshuarit. Ashtu si fundamentalistët në fetë e tjera, edhe islamistët janë mbizotërueshëm pjesëmarrës dhe produkte të procesit të modernizimit. Ata janë të rinj me lëvizshmëri e me orientim modern, që në pjesën më të madhe vijnë prej tre grupeve.

Ashtu si me shumicën e lëvizjeve revolucionare, elementi bërthamë përbëhej prej studentëve e intelektualëve. Në pjesën më të madhe të vendeve marrja nën kontroll e bashkimeve studentore dhe e organizatave të ngjashme ka qenë faza e parë në procesin e islamizimit politik, me “çarjen” islamiste për të depërtuar në universitete, që ndodhi në vitet 1970 në Egjipt, Pakistan e Afganistan, e që pastaj kaloi në vendet e tjera myslimane. Tërheqja islamiste që veçanërisht e fortë ndër studentët e instituteve teknike, fakultetet e inxhinierisë dhe sektorët shkencorë. Në vitet 1990 në Arabinë Saudite, në Algjeri e gjetkë, “indigjenizimi i brezit të dytë” u shfaq me përpjesëtime në rritje të studentëve universitarë, që mësonin në gjuhët amëtare dhe, rrjedhimisht, të zbuluar përherë e më tepër ndaj ndikimeve islamiste.²² Gjithashtu islamistët shpesh përpunuan një forcë tërheqëse të ndjeshme për gratë dhe Turqia na dha dëshminë e një vije ndarëse të pastër ndërmjet brezit të vjetër të grave shekullariste dhe bijave e mbesave të tyre me orientim islamist.²³ Nga një studim për udhëheqësit militantë të grupeve islamiste egjiptiane dilte se ata kishin pesë tipare kryesore, që duket se janë tipike për islamistët në vendet e tjera. Ata ishin të rinj, në pjesën dërrmuese në moshën njëzet-tridhjetëvjeçare.

Tetëdhjetë për qind ishin studentë universiteti ose të diplomuar nga universitetet. Mbi gjysma vinin prej kolegjeve të elitës ose prej fushave me kërkesa më të larta intelektuale për specializimin teknik, si mjekësia e inxhinieria. Mbi 70 për qind ishin nga klasa e mesme e shtresës së ulët, “modeste, por jo me të kaluar të varfër,” dhe ishin të brezit të parë në familjet e tyre që kishin marrë arsim të lartë. E kishin kaluar fëmijërinë në qytete të vogla ose në zona fshatare, por ishin bërë banorë të qyteteve të mëdha.²⁴

Ndërsa studentët e intelektualët përbënin kuadrot ushtarakë dhe trupat goditëse të lëvizjeve islamiste, ata me prejardhje nga klasa e mesme qytetare përbënin pjesën kryesore të anëtarëve veprues. Në një farë mase këta vinin prej atyre që shpesh emërtohen grupet “tradicionale” të klasës së mesme: tregtarë, dyqanxhinj, pronarë të bizneseve të vogla, *paçartarë*. Ata luajtën rolin vendimtar në Revolucionin e Iranit dhe dhanë mbështetje të ndjeshme për lëvizjet fundamentaliste në Algjeri, Turqi e Indonezi. Mirëpo në përpjesëtime edhe më të mëdha fundamentalistët u përkisnin sektorëve më “modernë” të klasës së mesme. Veprimtarët islamistë “ndoshta përfshijnë një numër shpërpjesëtimisht të madh nga të rinjtë me arsimim më të mirë dhe më inteligjentë ndër popullatat e tyre përkatëse,” ndër ta mjekë, avokatë, inxhinierë, shkencëtarë, mësues e nëpunës.²⁵

Elementi i tretë çelës në rrethin e islamistëve ishin të shpërngulurit kohët e fundit nga fshati në qytet. Në mbarë botën islamike gjatë viteve 1970 e 1980 popullsia e qyteteve u rrit në përqindje të befasishme. Ardhësit në qytetet, të rrasur në lagjet e rrënuara e shpesh primitive, kishin nevojë dhe përfituan prej shërbimeve shoqërore që siguronin organizatat islamiste. Veç kësaj, Ernest Gellneri vë në dukje se Islami u jepte “një identitet me

dinjitet” këtyre “masave të saposhkulura nga rrënjët”. Në Stamboll e Ankara, në Kajro e Asiut, Algjer e Fes dhe në Rripin e Gazës, partitë islamiste organizuan me sukses dhe u bënë thirrje “të shpronësuarve e të shtypurve.” Oliver Roy-i (Roj) ka thënë, se “Masa e Islamit revolucionar është produkt i shoqërisë moderne ...i ardhësve në qytete, i miliona fshatarëve që e kanë trefishuar popullsinë e metropoleve të mëdha myslimane.”²⁶

Nga mesi i viteve 1990 qeveri islamiste të hapura kishin ardhur në pushtet vetëm në Iran e në Sudan. Një numër i vogël vendesh myslimane, si Turqia e Pakistani, kishin regjime me disa mëtime për ligjshmëri demokratike. Qeveritë në nja dyzet vende të tjera myslimane ishin në pjesën dërrmuese jodemokratike: monarki, sisteme njëpartiake, regjime ushtarake, diktatura vetjake ose ndonjë nga ndërthurjet e këtyre, zakonisht të mbështetura mbi bazë të kufizuar familjare, fisnore a klanore, kurse në disa raste me varësi të theksuar nga mbështetja e huaj. Dy regjime, në Marok dhe në Arabinë Saudite, u përpoqën t’i drejtoheshin një farë forme ligjshmërie. Mirëpo shumicës së këtyre qeverive u mungonte çfarëdo themeli për të përligjur sundimin e vet nga pikëpamja e vlerave islamike, demokratike ose nacionaliste. Ato ishin “regjime bunkerit”, po të përdorim togfjalëshin e Clement Henry Moore-it (Klement Henri Mur), shtypëse, të korruptuara, të shkëputura prej nevojave e synimeve të shoqërive të tyre. Regjime të tilla mund ta mbajnë veten për periudha të gjata kohe; nuk është e thënë se detyrimisht do të dështojnë. Mirëpo në botën moderne është shumë e madhe mundësia që të ndryshojnë ose të shemben. Rrjedhimisht, nga mesi i viteve 1990 një çështje qendrore u bë se cilat alternativa kishin gjasa: kur ose çfarë do të ishte pasardhësi i tyre? Pothuaj në secilin

vend në mes të viteve 1990 regjimi më i mundshëm pasardhës ishte një regjim islamist.

Gjatë viteve 1970 e 1980 mbarë botën e përshkoi një valë demokratizimi, duke përfshirë disa duzina vendesh. Kjo valë pati ndikim mbi shoqëritë myslimane, por të kufizuar. Ndërsa lëvizjet demokratike po fuqizoheshin dhe po vinin në pushtet në Europën jugore, në Amerikën Latine, në periferinë e Azisë Lindore dhe Europën qendrore, njëkohësisht lëvizjet islamiste po fuqizoheshin në vendet myslimane. Islamizmi ishte zëvendësuesi funksional për opozitën demokratike kundër autoritarizmit në shoqëritë e krishtera dhe në një përmasë të gjerë ishte produkt i shkaqeve të ngjashme: mobilizimi shoqëror, humbja e ligjshmërisë për veprim nga regjimet autoritare dhe mjedisi ndërkombëtar që po ndryshonte, duke përfshirë ngritjen e çmimit të naftës, që në botën myslimane nxisnin më tepër prirjet islamiste sesa demokratike. Priftërinjtë, klerikët dhe grupet fetare laike luajtën role kryesore në kundërshtimin e regjimeve autoritare në shoqëritë e krishtera, kurse *ulemajat*, grupet e mbështetura në xhamitë dhe islamistët luajtën role të krahasueshme kundërshtuese në vendet myslimane. Papa pati vend qendror për t'i dhënë fund regjimit komunist në Poloni, kurse ajatollahu për të rrëzuar regjimin e shahut në Iran.

Lëvizjet islamiste në vitet 1980 e 1990 mbizotëruan e shpesh e monopolizuan lëvizjen opozitare ndaj qeverive në vendet myslimane. Fuqia e tyre pjesërisht ishte në funksion të dobësisë së burimeve të tjera të kundërshtimit. Lëvizjet majtiste e komuniste ishin diskredituar e pastaj u dobësuan rëndë nga shembja e Bashkimit Sovjetik dhe e komunizmit ndërkombëtar. Grupet e opozitës liberale, demokratike kishin qenë në shumicën e shoqërive myslimane, por rëndom kufizoheshin me një numër të vogël intelektualësh e të

tjerësh me lidhje ose me rrënjë Perëndimore. Me ndonjë përjashtim të rastit, demokratët liberalë nuk qenë në gjendje të arrinin mbështetje popullore të qëndrueshme në shoqëritë myslimane dhe madje liberalizmi islamik nuk ia doli mbanë të hidhte rrënjë. “Në një shoqëri myslimane,” ka vënë në dukje Fuad Axhami, “të shkruash për liberalizmin dhe një traditë borgjeze nacionale do të thotë të shkruash nekrologjitë për njerëzit që u hynë shtigjeve të pamundshme dhe pastaj dështuan.”²⁷ Dështimi i përgjithshëm i demokracisë liberale, që nuk gjeti vend në shoqëritë myslimane, është një dukuri e përsëritur e vijuese për gjithë shekullin, duke nisur nga fundi i viteve 1800. Ky dështim e kishte burimin të paktën pjesërisht te natyra jomikpritëse e kulturës dhe shoqërisë islamike kundrejt koncepteve liberale Perëndimore.

Suksesi i lëvizjeve islamiste duke shtënë në dorë opozitën dhe ngulitja si e vetmja alternativë jetëgjatë ndaj regjimeve në fuqi, u ndihmuan shumë gjithashtu nga politikat e këtyre regjimeve. Herë pas here gjatë Luftës së ftohtë mjaft qeveri, ndër to të Algjerisë, Turqisë, Jordanisë. Egjiptit e Izraelit, u jepnin zemër dhe i mbështesnin islamistët si kundërvëniet ndaj lëvizjeve komuniste ose nacionaliste armiqësore. Të paktën deri në Luftën e Gjirit, Arabia Saudite dhe shtetet e tjera të Gjirit u jepnin fonde të gjera grupeve islamiste e të Vëllezërisë Myslimane në një varg vendesh. Aftësia e grupeve islamiste për të mbajtur në dorë opozitën gjente nxitje gjithashtu nga shtypja që u bënte qeveria opozitave shekullare. Forca e fundamentalistëve përgjithësisht ndryshonte në lidhje të përkundërt me atë të partive demokratike shekullare ose nacionaliste dhe ishte më e dobët në vende si Maroku e Turqia, të cilat lejonin një farë shkalle të garës shumëpartiake, që nuk ndesheshin në vendet ku shtypej çfarëdo opozite.²⁸ Mirëpo

opozita shekullare është më e prekshme nga përndjekjet sesa opozita fetare. Kjo e dyta mund të veprojë brenda dhe prapa rrjetit të xhamive, organizatave të përkrahjes shoqërore, fondacioneve e institucioneve të tjera fetare, të cilat qeveria e ndien se nuk mund t'i shtypë. Demokratët liberalë nuk kanë një mbulesë të tillë e, rrjedhimisht, kontrollohen ose zhduken më lehtë nga qeveria.

Duke u përpjekur të pengonin rritjen e prirjeve islamiste, qeveritë e zgjeruan edukatën fetare në shkollat shtetërore, të cilat shpesh ranë në duart e mësuesve islamistë e në to mbizotëruan idetë islamiste, si dhe e zgjeruan mbështetjen për fenë e për institucionet arsimore islamiste. Këto veprime pjesërisht ishin dëshmi e mbështetjes më të madhe të qeverive për Islamin dhe, përmes financimit, e zgjeruan kontrollin qeveritar mbi institucionet e arsimit islamik. Mirëpo gjithashtu sollën edukimin e masave të mëdha të studentëve e të njerëzve me vlerat islamike, duke i bërë më të hapur ndaj thirrjeve islamiste, si dhe diplomuan militantë, që e vijuan punën në emër të qëllimeve islamiste.

Fuqia e Ringjalljes dhe forca tërheqëse e lëvizjeve islamiste i shtyu qeveritë të përkrahnin institucionet e praktikën islamike dhe simbolet e praktikën islamike t'i përfshinin në regjimet e tyre. Në rrafshin më të gjerë kjo do të thoshte pohimin ose ripohimin e natyrës islamike të shtetit e të shoqërisë së tyre. Në vitet 1970 e 1980 udhëheqësit politikë vërshuan që t'i njëjtësonin regjimet dhe veten me Islamin. Mbreti Husein i Jordanisë, i bindur se qeveritë shekullare nuk kishin ndonjë të ardhme në botën arabe, ka folur për nevojën që të krijohet “demokracia islamike” dhe një “Islam modernizues.” Mbreti Hasan i Marokut ka nënvizuar prejardhjen e vet nga Profeti dhe rolin si “Komandant i Besimtarit.” Sulltani i Bruneit, që më parë nuk njihej për

praktikat myslimane, u bë “përherë e më i devotshëm” dhe e përcaktoi regjimin e vet si “Monarki myslimane malajase.” Ben Aliu në Tunizi nisi t’i drejtohej rregullisht Allahut në fjalime dhe “u mbështoll me mantelin e Islamit” për të përmbajtur forcën tërheqëse në rritje të grupeve islamike.²⁹ Në vitet e para 1990 Suhartoja hapur ndoqi politikën për t’u bërë “më shumë mysliman.” Në Bangladesh parimi i “shekullarizmit” u hoq nga kushtetuta në mes të viteve 1970 dhe nga fillimi i viteve 1990 për herë të parë u sfidua rëndë identiteti shekullar, qemalist i Turqisë.³⁰ Për të nënvizuar përkushtimin islamik, udhëheqësit e qeverive: Ozali, Suhartoja, Karimovi, u ngutën të shkonin për të bërë *haxh*.

Qeveritë në vendet myslimane kanë vepruar gjithashtu për ta islamizuar të drejtën. Në Indonezi konceptet ligjore dhe praktikat islamike u përfshinë në sistemin ligjor shekullar. Përkundrazi, Malajzia, duke e shqyrtuar natyrën në thelb jomyslimane të popullsisë, eci në drejtimin e zhvillimit të dy sistemeve ligjore të veçuara: njëri islamik dhe tjetri shekullar.³¹ Gjatë regjimit të gjeneralit Zia ul-Hak në Pakistan u bënë përpjekje të gjera për ta islamizuar të drejtën dhe ekonominë. U vendosën dënimet islamike, u ngrit një sistem i gjyqeve të sheriatit dhe sheriatit u shpall e drejta eprore e vendit.

Ashtu si shfaqjet e tjera të rilindjes fetare globale, edhe Ringjallja Islamike është njëherësh produkt dhe përpjekje për t’u ndeshur me modernizimin. Shkaqet prapa saj janë ato, që përgjithësisht kanë sjellë prirjet e indigjenizimit në shoqëritë joperëndimore: urbanizimi, mobilizimi shoqëror, nivelet më të larta të alfabetizimit e të arsimit, komunikimet e fuqizuara dhe konsumi i mediave, si dhe ndërveprimi i zgjeruar me kulturën Perëndimore e të tjerat. Këto zhvillime i minojnë lidhjet tradicionale të fshatit e të fisit, ndërsa krijojnë tjetërsimin dhe krizën e identitetit. Simbolet, përkushtimet dhe

besimet islamiste u përgjigjen këtyre nevojave psikologjike, ashtu si organizatat e përkrahjes sociale islamiste u përgjigjen nevojave shoqërore, kulturore e ekonomike të myslimanëve, që janë rrëmbyer nga procesi i modernizimit. Myslimanët e ndiejnë nevojën për t'u kthyer te idetë, praktikat e institucioneve islamike për të gjetur busullën dhe motorin e modernizimit.³²

Ringjallja Islamike, siç është thënë, ka qenë gjithashtu “një produkt i rënies së fuqisë dhe prestigjit të Perëndimit ...Me rënien e mbizotërimit total të Perëndimit, idealet dhe institucionet e tij e humbën shkëlqimin.” Në mënyrë më konkrete, Ringjallja u nxit dhe mori ushqim prej burimit të naftës në vitet 1970, që e shtoi tepër pasurinë dhe fuqinë e shumë vendeve myslimane, duke i bërë në gjendje t'i përmbysnin marrëdhëniet e sundimit e të nënshtimit, që kishin ekzistuar me Perëndimin. Siç e ka vënë re John B. Kelly (Xhon B Keli) në atë kohë, “Arabët sauditë pa dyshim ndiejnë një kënaqësi të dyfishtë, që u ngjallet duke u dhënë dënime poshtëruese Perëndimorëve, sepse jo vetëm këto janë shprehje e fuqisë dhe e pavarësisë së Arabisë Saudite, por edhe sepse tregojnë, ashtu si synojnë të tregojnë, përbuzjen për krishterimin dhe epërsinë e Islamit.” Veprimet e shteteve të pasura me naftë “nëse vihen në kornizën e tyre historike, fetare, raciale e kulturore, arrijnë në atë pikë, sa të jenë një përpjekje e guximshme për ta bërë Perëndimin e krishterë që t'i paguajë haraç Lindjes myslimane.”³³ Qeveritë e Arabisë Saudite, Libisë e të tjera i përdorën pasuritë e naftës për të nxitur e financuar rilindjen myslimane, kurse pasuria myslimane i bëri myslimanët që të largoheshin nga mahnitja pas kulturës Perëndimore e të kalonin në vlerësimin e kulturës së vet, si dhe te dëshira për të pohuar vendin e rëndësishëm të Islamit në shoqëritë joislamike. Ashtu si më parë pasuria

Perëndimore shihej si dëshmi e epërsisë së kulturës Perëndimore, edhe pasuria me naftë nisi të shihej si dëshmi e epërsisë së Islamit.

Hovi që shkaktuan kërcimet e çmimeve të naftës u fashit në vitet 1980, por shtimi i popullsisë vijonte të ishte forcë lëvizëse. Ndërsa ngritja e Azisë Lindore u ushqye nga normat e jashtëzakonshme të rritjes ekonomike, Ringjallja e Islamit u ushqye nga normat po aq të jashtëzakonshme të rritjes së popullsisë. Zgjerimi i popullsisë në vendet islamike, sidomos në Ballkan, në Afrikën e Veriut dhe në Azinë Qendrore ka qenë ndjeshëm më i madh sesa në vendet fqinje e përgjithësisht në botë. Ndërmjet viteve 1965 e 1990 shifra totale e popullsisë në botë u rrit nga 3,3 miliardë në 5,3 miliardë, kurse shtimi vjetor me 1,85 për qind. Në shoqëritë myslimane norma e shtimit pothuaj gjithmonë ka qenë mbi 2,0 për qind, shpesh i ka kapërcyer 2,5 për qind, kurse nganjëherë ka qenë mbi 3,0 për qind. Ndërmjet viteve 1965 e 1990, për shembull, popullsia e Magrebit u shtua me normën 2,65 për qind në vit, nga 29,8 milionë te 59 milionë, ndërsa algjerianët janë shtuar me normë vjetore 3,0 për qind. Gjatë po këtyre viteve numri i egjiptianëve u rrit me normën 2,3 për qind nga 29,4 milionë në 52,4 milionë. Në Azinë Qendrore ndërmjet viteve 1970 e 1993 popullsitë janë rritur me normën 2,9 për qind në Tashkistan, 2,6 për qind në Uzbekistan, 2,5 për qind në Turkmenistan, 1,9 për qind në Kirgizstan, por vetëm 1,1 për qind në Kazakistan, popullsia e të cilit është pothuaj përgjysmë ruse. Pakistani e Bangladeshi kanë pasur norma të shtimit të popullsisë që i kalojnë 2,5 për qind në vit, ndërsa Indonezia e kishte mbi 2,0 për qind në vit. Myslimanët kudo, siç e kemi përmendur, përbënin ndoshta 18 për qind të popullsisë së botës më 1980 dhe ka të ngjarë të

jenë mbi 20 për qind në vitin 2000 e 30 për qind në vitin 2025.³⁴

Normat e shtimit të popullsisë në Magreb e gjetkë e arritën pikën kulmore dhe kanë nisur të bien, por rritja në shifra absolute do të vijojë të jetë e madhe, kurse ndikimi i kësaj rritjeje do të ndihet gjatë gjithë pjesës së parë të shekullit të njëzetënjetë. Në vitet që do të vijnë popullsitë myslimane do të jenë të moshave të reja në mënyrë të shpërpjesëtuat, me një masë të dukshme demografike të rinjsh dhe njerëzish në moshën e të njëzetave (Skica 5.2). Veç kësaj, njerëzit e kësaj grupmoshe do të jenë në pjesën dërrmuese banorë qytetesh dhe do të kenë të paktën arsim të mesëm. Ndërthurja e përmasave me mobilizimin shoqëror ka tri pasoja domethënëse politike.


E para, të rinjtë janë protagonistët e protestave, paqëndrueshmërisë, reformës dhe revolucionit. Historikisht, prania e të rinjve si grupmosha të gjera ka pasur prirje që të përkonte me lëvizje të tilla. Është thënë se “Reformacioni Protestant është shembull i njërës prej lëvizjeve më të shquara të rinisë në histori.” Siç e ka argumentuar bindshëm Jack Goldstone-i (Xhek Goldston), rritja demografike ka qenë faktor qendror në dy valë të revolucionit, që u ngritën në Eurazi në mes të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë.³⁵ Një zgjerim i ndjeshëm i përpjesës së rinisë në vendet Perëndimore përkoi me “Epokën e revolucionit demokratik” në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë industrializimi i suksesshëm dhe emigrimi e pakësuan ndikimin politik të popullatave të reja në shoqëritë europiane. Përpjesa e rinisë përsëri u rrit në vitet 1920, mirëpo u bë burim i rekrutëve të lëvizjeve fashiste dhe të tjera ekstremiste.³⁶ Katër dhjetëvjeçarë më vonë brezi i shpërthimit të lindjes së

foshnjave pas Luftës II Botërore e tregoi veten politikisht në demonstratat dhe protestat e viteve 1960.

Të rinjtë e Islamit e kanë treguar veten në Ringjalljen Islamike. Kur Ringjallja e nisi rrugën në vitet 1970 dhe mori vrull në vitet 1980, përpjesa e të rinjve (domethënë e atyre me moshë nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e katër vjeç) në vendet kryesore myslimane u rrit ndjeshëm dhe nisi të kapërcente 20 për qind të gjithë popullsisë. Në shumë vende myslimane kulmi i lakores së rinisë u arrit në vitet 1970 e 1980, në të tjerat do të arrihet në fillim të shekullit të ardhshëm (Tabela 5.1). Kulmet e sotme ose të ardhme në të gjitha këto vende, me një përjashtim, janë mbi 20 për qind; kulmi i përlogaritur i Arabisë Saudite në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit të njëzetënjëtë i bie të jetë pothuaj afër kësaj. Këta të rinj japin rekrutët e organizatave e të lëvizjeve politike islamiste. Ndoshta nuk është krejt përkim i rastit që përpjesa e të rinjve në popullsinë e Iranit u rrit befas në vitet 1970, duke arritur 20 për qind në gjysmën e dytë të atij dhjetëvjeçari, e që Revolucioni Iranian ndodhi më 1979, ose që kjo kuotë u arrit në Algjeri në fillim të viteve 1990, pikërisht kur partia islamiste FIS po fitonte mbështetje popullore dhe po arrinte fitore në zgjedhje. Edhe në kulmin e lakores së rinisë myslimane vërehen variacione rajonale me peshë të mundshme. (Skica 5.3). Të dhënat duhen trajtuar me kujdes, por parashikimet thonë se përpjesa e të rinjve shqiptarë e bosnjakë do të bjerë përkatësisht në kapërcyell të shekullit. Nga ana tjetër, kulmi i lakores së rinisë do të mbetet i lartë në shtetet e Gjirit. Më 1988 princi i kurorës Abdullah i Arabisë Saudite ka thënë se kërcënimi më i madh për vendin e tij vjen nga ngritja e fundamentalizmit islamik ndër të rinjtë e saj.³⁷ Sipas këtyre parashikimeve, ky kërcënim do të mbetet mjaft i qëndrueshëm në shekullin e njëzetënjëtë.

Skica 5.2:

Sfida demografike: islami, rusia dhe perëndimi



Burimi: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Seksioni i Popullsisë, Departamenti për informacionin ekonomik e shoqëror dhe analizën e politikave, Parashikimet e popullsisë së botës, *The 1994 Revision* (New York: United Nations, 1995); Organizata e Kombeve të Bashkuara, Seksioni i Popullsisë, Departamenti për informacionin ekonomik e shoqëror dhe analizën e politikave, *Sex and Age Distribution of the World Populations, The 1994 Revision* (New York: United Nations, 1994).

Në vendet më të mëdha arabe (Algjeri, Egjipt, Marok, Siri e Tunizi) numri i njerëzve në vitet e para të moshës njëzetvjeçare, që kërkojnë punë, do të vijojë të rritet deri rreth vitit 2010. Në krahasim me vitin 1990, numri i atyre që hyjnë në tregun e punës do të shtohet me 30 për qind në Tunizi, me afër 50 për qind në

Algjeri, Egjipt e Marok, dhe mbi 100 për qind në Siri. Zgjerimi i shpejtë i shkollimit në shoqëritë arabe gjithashtu krijon një hendek ndërmjet brezit më të ri të shkolluar dhe brezit të vjetër në pjesën më të madhe analfabet, e kështu ka të ngjarë “të ushtrojë trysni mbi sistemet politike” një “shkëputje ndërmjet dijes e pushtetit”.

Tabela 5.1:
Kulmi i lakores së rinisë në vendet myslimane

		Vitet		
1970	1980	1990	2000	2010
Bosnja	Siria	Algjeria	Taxhikistani	Kirgizistani
Bahreini	Shqipëria	Iraku	Turkmenistani	Malajzia
EBA	Jemeni	Jordania	Egjipti	Pakistani
Irani	Turqia	Maroku	Irani	Siria
Kazakistani	Pakistani	Indonezia	Kuvajti	Jordania
	Malajzia		Sudani	Iraku
	Kirgizistani			Omani
	Taxhikistani			Libia
	Turkmenistani			Afganistani
	Azerbajxhani			


Dhjetëvjeçarët në të cilët të rinjtë me moshë 15-24 vjeç kanë arritur kulmin ose pritet ta arrijnë si përpjesë në popullsinë e përgjithshme (pothuaj kurdoherë më tepër se 20%). Në disa vende kjo përpjesë e arrin kulmin dyfish.

Burimi: Shih Skicën 5.2

Popullsitë më të mëdha kërkojnë më shumë burime dhe, rrjedhimisht, njerëzit nga shoqëri me popullsi të

dendura dhe/ose në rritje të shpejtë kanë prirje që të marrin shtysa për të dalë jashtë, për të zënë territore dhe ushtrojnë trysni mbi popujt më pak dinamikë demografikisht. Rritja e popullsisë islamike përbën kështu një faktor kryesor ndihmese për konfliktet përgjatë kufijve të botës islamike ndërmjet myslimanëve dhe popujve të tjerë. Trysnia e popullsisë, e ndërthurur me amullinë ekonomike, nxit emigrimin e myslimanëve drejt shoqërive Perëndimore dhe të tjerave jomyslimane, duke e ngritur emigrimin si çështje të këtyre shoqërive. Pranëvënia e një populli në rritje të shpejtë të një kulture dhe e një populli me rritje të ngadaltë ose të ndërprerë të një kulture tjetër përfton trysni për rregullime ekonomike dhe/ose politike në të dyja shoqëritë. Për shembull, në vitet 1970 peshorja demografike në ish Bashkimin Sovjetik u zhvendos fort, duke e pasur shtimin e myslimanëve nja 24 për qind, ndërsa rusët u shtuan nja 6,5 për qind, duke shkaktuar shqetësim të madh ndër udhëheqësit komunistë të Azisë së Mesme.³⁹ Në mënyrë të ngjashme, shtimi i shpejtë si numër i shqiptarëve nuk i qetëson serbët, grekët ose italianët. Izraelitët janë të shqetësuar nga norma e lartë e shtimit të palestinezëve dhe Spanja, me shtim popullsie më pak se një të pestën e 1 për qindëshit në vit, me shqetësim po ballafaqohet me fqinjët e Magrebit, popullsia e të cilëve rritet më shumë se dhjetë herë më shpejt dhe PKB për frymë është rreth një të dhjetën e Spanjës.

Skica 5.3:
Kulmi i lakores së rinisë sipas rajonit



Burimi: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Seksioni i Popullsisë, Departamenti për informacionin ekonomik e shoqëror dhe analizën e politikave, Parashikimet e popullsisë së botës, *The 1994 Revision* (New York: United Nations, 1995); Organizata e Kombeve të Bashkuara, Seksioni i Popullsisë, Departamenti për informacionin ekonomik e shoqëror dhe analizën e politikave, *Sex and Age Distribution of the World Populations, The 1994 Revision* (New York: United Nations, 1994).

Sfidat që ndryshojnë

Asnjë shoqëri nuk mund të mbajë pa fund një rritje ekonomike të qëndrueshme me dy shifra, kurse bumi ekonomik i Azisë një ditë në fillim të shekullit të njëzetënjetë do të kalojë në vijë të rrafshët. Normat e rritjes ekonomike të Japonisë ranë ndjeshëm në mes të viteve 1970 dhe më pas nuk kanë qenë ndjeshëm më të larta sesa ato në Shtetet e Bashkuara dhe në vendet europiane. Një nga një shtetet e tjera aziatike të “mrekullisë aziatike” do të shohin sesi normat e rritjes së tyre do të bien e do të afrohen me nivelet “normale” që mbahen në ekonomitë komplekse. Po ashtu asnjë lëvizje ringjallëse ose kulturore nuk mund të zgjasë pa fund dhe në një farë pike Ringjallja Islamike do të tërhiqet e do të venitet, duke i kaluar historisë. Kjo gjë ka më shuma gjasa të ndodhë kur shtysa demografike që e fuqizon do të dobësohet në dhjetëvjeçarin e dytë e të tretë të shekullit të njëzetënjetë. Në atë kohë radhët e militantëve, luftëtarëve e migrantëve do të pakësohen dhe nivelet e larta të konfliktit brenda Islamit e ndërmjet myslimanëve dhe të tjerëve ka gjasa që të shkojnë drejt rënies (shih kreun 10). Marrëdhëniet ndërmjet Islamit e Perëndimit nuk do të bëhen të ngushta, por do të jenë më pak me natyrë konflikti dhe ka të ngjarë që pothuaj lufta (shih kreun 9) t’ia lërë vendin luftës së ftohtë ose ndoshta edhe paqes së ftohtë.

Zhvillimi ekonomik në Azi do të lërë një trashëgimi ekonomish më të pasura, më komplekse, me ndërthurje të qenësishme ndërkombëtare, me borgjezi të lulëzuara dhe klasa të mesme të kapura mirë. Këto ka të ngjarë të çojnë drejt politikave më pluraliste e ndoshta më demokratike, mirëpo nuk do të jenë detyrimisht më

properëndimore. Fuqia e shtuar në vend të kësaj do të nxisë vetësigurinë e vijuar aziatike në punët ndërkombëtare dhe përpjekjet për t'i drejtuar prirjet globale nëpër rrugë të papërshtatshme për Perëndimin e për t'i rindërtuar institucionet ndërkombëtare, duke u larguar prej modeleve e normave Perëndimore. Ringjallja Islamike, ashtu si lëvizjet e krahasueshme duke përfshirë edhe Reformacionin, gjithashtu do të lërë trashëgimi të ndjeshme. Myslimanët do të kenë një vetëdije më të lartë për çka e kanë të përbashkët dhe çka i dallon prej jomyslimanëve. Brezi i ri i udhëheqësve, që do të marrë punët në duar si lakorja moshore e rinisë, nuk do të jetë detyrimisht fundamentalist, porse do të jetë më i përkushtuar ndaj Islamit sesa paraardhësit. Indigjenizimi do të përforcohet. Ringjallja do të lërë pas një rrjet organizatash islamiste shoqërore, kulturore, ekonomike e politike brenda shoqërive dhe në ato shoqëri, të cilave do t'u zënë vendin. Gjithashtu Ringjallja do ta ketë treguar se "Islami është zgjidhja" për problemet e moralitetit, identitetit, kuptimit e besimit, por jo për problemet e padrejtësisë shoqërore, shtypjes politike, prapambetjes ekonomike dhe dobësisë ushtarake. Këto dështime mund të përftojnë zhgënjim nga Islami politik të përhapur gjerësisht, një reagim kundër tij dhe synimin për të gjetur "zgjidhje" alternative për këto probleme. Mund të përfytyrohet madje se do të lindnin nacionalizma edhe më të forta antiperëndimore, që do ta fajësonin Perëndimin për dështimet e Islamit. Si alternativë, nëse Malajzia dhe Indonezia do të vijonin pëparimin e tyre ekonomik, mund të jepnin një "model islamik" për zhvillim në konkurrencë me modelet Perëndimore dhe aziatike.

Sidoqoftë, gjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm rritja ekonomike e Azisë do të ketë pasoja thellësisht destabilizuese mbi rendin ndërkombëtar të ngulitur e

nën mbisundimin Perëndimor, ndërsa zhvillimi i Kinës, nëse do të vijojë, do të shkaktonte një zhvendosje masive në shpërndarjen e fuqisë ndërmjet qytetërimeve. Veç kësaj, India mund të hynte në rrugën e zhvillimit të shpejtë ekonomik dhe të dilte si konkurruesi kryesor për ndikim në punët e botës. Ndërkaq, shtimi i popullsisë myslimane do të ishte një forcë destabilizuese si për shoqëritë myslimane, ashtu edhe për fqinjët e tyre. Sasitë e mëdha të të rinjve me arsim të mesëm do të vijojnë të fuqizojnë Ringjalljen Islamike dhe do të nxisin militantizmin, militarizmin e emigrimin mysliman. Si rrjedhim, vitet e para të shekullit të njëzetënjëtë ka të ngjarë të jenë dëshmitare të ringjalljes së vazhduar të fuqisë e të kulturës joperëndimore dhe të përplasjes së popujve të qytetërimeve joperëndimore me Perëndimin e ndërmjet tyre.

III.

Rendi që po përfitohet i qytetërimeve

Kreu 6: Rikonfigurimi kulturor i politikës globale

Hulumtimi për grupimet: politikat e identitetit

Nën nxitjen e modernizimit politika globale po rikonfigurohet sipas vijave kulturore. Popujt dhe vendet me kultura të ngjashme po bashkohen. Popujt dhe vendet me kultura të ndryshme po ndahen. Rreshtimet sipas ideologjisë dhe marrëdhënieve me superfuqitë po ua lënë vendin rreshtimeve të përcaktuara nga kultura e qytetërimi. Kufijtë politikë përherë e më tepër po ripërcaktohen për t'u përputhur me kufijtë kulturorë: etnikë, fetarë e qytetërimorë. Bashkësitë kulturore po zëvendësojnë blloqet e Luftës së ftohtë dhe vijat e shkëputjes ndërmjet qytetërimeve po bëhen vijat qendrore të konfliktit në politikën globale.

Gjatë Luftës së ftohtë një vend mund të ishte i paangazhaur, siç ishin shumë prej tyre, ose, siç patën bërë disa, mund ta ndryshonin rreshtimin nga njëra palë te tjetra. Udhëheqësit e një vendi mund t'i përcaktonin zgjedhjet e veta sipas perceptimit që kishin për interesat e sigurimit, përlllogaritjet e peshores së fuqisë dhe parapëlqimet ideologjike. Mirëpo në botën e re identiteti

kulturor është faktori qendror që u jep trajtën shoqërimeve dhe kundërshtimeve të një vendi. Ndërsa një vend mund t'i shmangej rreshtimit të Luftës së ftohtë, pa identitet nuk mund të mbetet. Pyetja: "Me cilën anë jeni?" është zëvendësuar prej një pyetjeje më themelore: "Kush jeni ju?" Secili shtet detyrohet të japë një përgjigje. Kjo përgjigje, identiteti i tij kulturor, përcakton vendin e shtetit në politikën botërore, miqtë e armiqtë e tij.

Vitet 1990 qenë dëshmitarë të shpërthimit të një krize identiteti globale. Pothuaj kudo që të hidhje sytë, njerëzit bënin pyetjen: "Kush jemi?" "Ku bëjmë pjesë?" dhe "Kush nuk është si ne?" Këto pyetje kanë vend qendror jo vetëm për popujt në përpjekje për të farkëtuar shtete kombe të reja, si në ish Jugosllavinë, por gjithashtu edhe më përgjithësisht. Në mes të viteve 1990 vendet ku debatoheshin gjallërisht çështjet e identitetit kombëtar përfshinin, ndër të tjera: Algjerinë, Kanadanë, Kinën, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Indinë, Iranin, Japoninë, Meksikën, Marokun, Rusinë, Afrikën e Jugut, Sirinë, Tunizinë, Turqinë, Ukrainën dhe Shtetet e Bashkuara. Natyrisht, çështjet e identitetit janë sidomos të fuqishme në vendet e përçara, që kanë grupe me përmasa të njerëzve prej qytetërimesh të ndryshme.

Për të përballuar krizën e identitetit me rëndësi për njerëzit janë gjaku e besimet, feja dhe familja. Njerëzit afrohen me ata, që kanë prejardhje, fe, gjuhë, vlera e institucione të ngjashme, kurse largohen prej atyre që i kanë të gjitha këto të ndryshme. Në Europë Austria, Finlanda e Suedia, që nga ana kulturore janë pjesë e Perëndimit, u detyruan të shkëputeshin prej Perëndimit e të ishin asnjëherë gjatë Luftës së ftohtë; sot ato përsëri mund të bashkohen me farefisën e tyre kulturor në Bashkimin European. Vendet katolike e protestante në Traktatin e mëparshëm të Varshavës: Polonia, Hungaria,

Republika Çeke dhe Sllovakia, po shkojnë drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe në NATO, kurse shtetet baltike janë në radhë pas tyre. Fuqitë europiane e kanë bërë të qartë se nuk e duan një shtet mysliman, Turqinë, në Bashkimin Europian dhe nuk janë të kënaqura që të kenë një shtet të dytë mysliman, Bosnjën, në kontinentin europian. Në veri prishja e Bashkimit Sovjetik po i jep shtysa daljeve të modeleve të reja (dhe të vjetra) të shoqërimeve ndërmjet republikave baltike dhe me Suedinë e Finlandën. Kryeministri i Suedisë ia ka përmendur qartë Rosisë se republikat baltike janë pjesë e “ fqinjësisë jashtë shtetit” dhe se Suedia nuk do të qëndronte asnjëherë në rast të një agresioni rus kundër tyre.

Rirreshtime të ngjashme po ndodhin në Ballkan. Gjatë Luftës së ftohtë Greqia dhe Turqia ishin në NATO, Bullgaria e Rumania ishin në Traktatin e Varshavës, Jugosllavia ishte e paangazhuar dhe Shqipëria ishte e izoluar e një farë kohe e lidhur me Kinën komuniste. Sot të gjitha këto rreshtime të Luftës së ftohtë po ua lëshojnë rrugën atyre qytetërimore, me rrënjët në Islam e Ortodoksi. Udhëheqësit ballkanikë bisedojnë për kristalizimin e aleancës ortodokse greko-serbo-bullgare.”Luftërat e Ballkanit”, siç e paraqet kryeministri grek, “...kanë nxjerrë në sipërfaqe jehonën e lidhjeve ortodokse ...ky është një detyrim. Ajo ka qenë e fjetur, por me zhvillimet në Ballkan, po merr një farë përmbajtjeje reale. Në botën tepër të luhatshme, njerëzit po kërkojnë identitetin dhe sigurinë. Njerëzit po shohin të gjejnë rrënjët e lidhjet për t’u mbrojtur nga e panjohura.” Këto pikëpamje gjetën jehonë te partia kryesore opozitare në Serbi: “Gjendja në Europën juglindore shpejt do të kërkojë formimin e aleancës së re ballkanike të vendeve ortodokse, duke përfshirë Serbinë, Bullgarinë e Greqinë, me qëllim që t’i bëhet qëndresë

ndërhyrjes së Islamit.” Po të vështrojmë nga veriu, Serbia ortodokse dhe Rumania bashkëpunojnë ngushtë në trajtimin e problemeve të përbashkëta me Hungarinë katolike. Pas zhdukjes së kërcënimit sovjetik, aleanca “e panatyrshme” ndërmjet Greqisë e Turqisë në thelb bëhet e pakuptimtë, pasi konflikti ndërmjet tyre është shtuar lidhur me Detin Egje, me Qipron, me baraspeshën ushtarake, rolet e tyre në NATO e në Bashkimin Europian, si dhe për marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Turqia po ripohon rolin si mbrojtëse e myslimanëve të Ballkanit dhe i jep përkrahje Bosnjës. Në ish Jugosllavinë Rusia mbështet Serbinë ortodokse, Gjermania përkrah Kroacinë katolike, vendet myslimane bashkohen për të mbrojtur qeverinë bosnjake dhe serbët luftojnë me kroatët, me myslimanët bosnjakë e me myslimanët shqiptarë. Gjithandej Ballkani përsëri është ballkanizuar sipas vijave fetare. Siç e ka vënë në dukje Misha Glenny (Gleni), “Po dalin në dritë dy boshte, njëri i veshur me rasën e ortodoksisë lindore, tjetri me xhyben islamike” dhe ka gjasa që të zhvillohet “një luftë gjithnjë më e madhe për ndikim ndërmjet boshtit Beograd/Athinë dhe aleancës shqiptaro/turke.”¹

Ndërkohë në ish Bashkimin Sovjetik, Bjellorusia ortodokse, Moldova dhe Ukraina rrotullohen si satelitë të Ruisë, kurse armenët e azerët luftojnë me njëri-tjetrin, ndërkohë që farefisi i tyre rus e turk synojnë si t’i mbështesin, edhe t’i përmbajnë në këtë konflikt. Ushtria ruse lufton kundër fundamentalistëve myslimanë në Tashkistan dhe nacionalistëve myslimanë në Çeçeni. Republikat myslimane të mëparshme sovjetike punojnë për të krijuar forma të ndryshme shoqatash ekonomike e politike ndërmjet tyre dhe për t’i zgjeruar lidhjet me fqinjët e tyre myslimanë, ndërsa Turqia, Irani e Arabia Saudite bëjnë përpjekje të mëdha për të lëvruar marrëdhëniet me këto shtete të reja. Në Nënkontinent

India e Pakistani mbeten majë më majë lidhur me Kashmirin e baraspeshimin ushtarak ndërmjet tyre, luftimet në Kashmir janë shtuar dhe brenda Indisë kanë lindur konflikte të reja ndërmjet fundamentalistëve myslimanë e hindu.

Në Azinë Lindore, atdheu i njerëzve nga gjashtë qytetërime të ndryshme, po shkohet drejt kulmit të armatimit dhe kanë dalë në shesh grindjet për territore. Tri Kinat më të vogla: Tajvani, Hong-Kongu e Singapori po bëhen gjithnjë e më shumë të orientuara nga kontinenti, të përfshira në të dhe të varura prej tij. Dy Koretë me ngurrime por në mënyrë domethënëse po ecin drejt bashkimit. Marrëdhëniet në shtetet e Azisë juglindore ndërmjet myslimanëve, nga njëra anë, dhe kinezëve e të krishterëve, nga ana tjetër, po bëhen gjithnjë e më të tendosura e nganjëherë edhe të dhunshme.

Në Amerikën Latine shoqatat ekonomike: Mercosur, Pakti i Andeve, pakti tripalësh (Meksika, Kolombia, Venezuela), Tregu i Përbashkët i Amerikës Qendrore, po marrin jetë të re, duke ripohuar atë çka e dëshmoi mjaft konkretisht Bashkimi European, se integrimi ekonomik ecën më shpejt e më përpara, nëse mbështetet në përbashkësinë kulturore. Në të njëjtën kohë, Shtetet e Bashkuara e Kanadaja po përpiqen ta thithin Meksikën në Zonën e Tregtisë së Lirë të Amerikës Veriore në një proces, suktesi afatgjatë i të cilit varet mjaft nga aftësia e Meksikës për ta ripërcaktuar veten kulturalisht duke kaluar nga latinamerikane në veriamerikane.

Me mbarimin e rendit të Luftës së ftohtë, vendet në mbarë botën nisën të zhvillonin antagonizma të rinj dhe të rifuqizonin antagonizmat e lidhjet farefisnore të vjetra. Ato po hulumtojnë për grupimet dhe po gjejnë ato grupime të vendet që kanë kultura të ngjashme e

qytetërim të njëjtë. Politikanët u drejtohen dhe publiku e njëjtëson veten me bashkësitë “e mëdha” kulturore, që i kapërcejnë kufijtë e shteteve kombe, e ndër këto janë “Serbia e Madhe”, “Kina e Madhe”, “Turqia e madhe”, “Kroacia e Madhe”, “Azerbajxhani i Madh”, “Rusia e Madhe”, “Shqipëria e Madhe”, “Irani i Madh” dhe “Uzbekistani i Madh.”

Rreshtimet politike dhe ekonomike a do të përputhen gjithherë me ato të kulturës e të qytetërimit? Arsye të baraspeshimit të fuqisë nganjëherë sjellin aleanca me kryqëzim qytetërimesh, siç ka ndodhur kur Franci I u bashkua me osmanët kundër Habsburgëve. Veç kësaj, modelet e shoqërimeve të formuara për t'u shërbyer synimeve të shteteve në një epokë do të vijojnë edhe në epokën e re. Mirëpo ato ka të ngjarë të bëhen më të dobëta e më pak domethënëse, sidhe do të përshtaten për t'u shërbyer synimeve të kohës së re. Greqi e Turqia pa dyshim do të mbeten anëtare të NATO-s, por lidhjet e tyre me shtetet e tjera të NATO-s ka gjasa që të zbehen. Po të tilla janë aleancat e Shteteve të Bashkuara me Japoninë e Korenë, aleanca e tyre de facto me Izraelin dhe lidhjet për sigurinë me Pakistanin. Organizatat ndërkombëtare shumëqytetërimore, si ASEAN-i, mund të ballafaqohen me vështirësi në rritje për ta ruajtur koherencën. Vende si India e Pakistani, partnerë të superfuqive të ndryshme gjatë Luftës së ftohtë, sot po i ripërcaktojnë interesat e tyre dhe po kërkojnë shoqërime të reja, që pasqyrojnë realitetet e politikës kulturore. Vendet afrikane, që vareshin prej mbështetjes Perëndimore, e cila synonte t'i kundërvihej ndikimit sovjetik, gjithnjë e më shumë po i hedhin sytë nga Afrika e Jugut për udhëheqje e ndihmë.

Përse përbashkësitë kulturore e lehtësojnë bashkëpunimin e lidhjen ndërmjet njerëzve, kurse dallimet kulturore nxisin përçarjen e konfliktet?

Së pari, cilido ka një shumësi identitetesh, që mund të konkurrojnë ose të përforcojnë të tjerat: të farefisnisë, të punës, kulturore, institucionale, territoriale, arsimore, partiake, ideologjike e të tjera. Identifikimet përgjatë njërës përmasë mund të ndeshen me ato përgjatë një përmasë tjetër: në një rast që është klasik, punëtorët gjermanë më 1914 ishin të detyruar të bënin zgjedhjen ndërmjet identifikimit klasor me proletariatin ndërkombëtar dhe identifikimit kombëtar me popullin e perandorinë gjermane. Në botën bashkëkohore, identifikimi kulturor po shtohet nga rëndësia në mënyrë befasuese krahasuar me përmasat e tjera të identitetit.

Përgjatë cilësdo përmasë të vetme, identiteti zakonisht është niveli më kuptimplotë dhe i drejtpërdrejtë ballë për ballë. Mirëpo identitetet më të ngushta jo doemos hyjnë në konflikte me më të gjerat. Një oficer ushtarak institucionalisht mund ta njëjtësojë veten me kompaninë, regjimentin, divizionin e armën. Po ashtu një njeri mund të njëjtësohet kulturalisht me fisin e vet, grupin etnik, kombësinë, fenë dhe qytetërimin. Dalja përherë e më e madhe në dukje e identitetit kulturor në nivelet e ulëta fare mirë mund ta përforcojë daljen në dukje në nivelet më të larta. Siç e shpreh Burke: “Dashuria për të gjithën nuk shuhet nga pjesorja që i nënshtrohet ... Të lidhesh pas nënndarjes, të duash togën e vogël së cilës i përkasim në shoqëri, përbën parimin e parë (si të thuash, mugullin) e lidhjeve publike.” Në një botë ku ka peshë kultura, togat janë fiset e grupet etnike, kombet janë regjimentet dhe ushtritë janë qytetërimet. Shtimi i përmasave në të cilat në mbarë botën njerëzit e dallojnë veten sipas vijave kulturore do të thotë se konfliktet ndërmjet grupeve kulturore janë përherë e më të rëndësishme; qytetërimet janë tërësitë më të gjera kulturore; rrjedhimisht,

konfliktet ndërmjet grupeve prej qytetërimesh të ndryshme dalin me vend qendror në politikën globale.

Së dyti, dalja në pah e shtuar e identitetit kulturor, siç është arsyetuar në krerët 3 dhe 4, është në një pjesë të madhe pasojë e modernizimit shoqëror-ekonomik në nivelin individual, ku zhvendosja dhe tjetërsimi krijojnë nevojën për identitete më domethënëse, dhe në nivelin shoqëror, ku aftësitë e shtuara dhe fuqia e shoqërive joperëndimore u japin shtysa e rigjallërojnë identitetet e kulturën indigjene.

Së treti, identiteti në cilindo nivel: vetjak, fisnor, racial, qytetërimor, mund të përcaktohet vetëm në lidhje me një “tjetër”, një njeri, fis, racë ose qytetërim të ndryshëm. Historikisht marrëdhëniet ndërmjet shteteve ose tërësive të tjera të të njëjtit qytetërim kanë pasur dallime prej marrëdhënieve ndërmjet shteteve ose tërësive të qytetërimeve të ndryshme. E kanë qeverisur kode të veçanta sjelljen ndaj atyre që janë “si ne” dhe “barbarëve”, që nuk janë si ne. Rregullat e shteteve të krishterimit për të trajtuar punët midis tyre kanë qenë të ndryshme prej atyre për t’i trajtuar punët me turqit e me “paganët” e tjerë. Myslimanët kanë vepruar me dallime kundrejt atyre të *Dar al-Islam*-it dhe atyre të *Dar al-Harb*-it. Kinezët i kanë trajtuar të huajt e Kinës dhe të huajt jo të Kinës në mënyra të veçanta. “Uni” qytetërimor dhe “ata” jashtëqytetërimore përbëjnë një konstante në historinë njerëzore. Këto dallime në sjelljen brenda- dhe jashtëqytetërimore burojnë nga:

1. ndjenjat e epërsisë (e rastësisht dhe të inferioritetit) ndaj njerëzve që shihen se janë mjaft të ndryshëm;

2. frika dhe mungesa e besimit ndaj njerëzve të tillë;

3. vështirësia e komunikimit me ta si pasojë e dallimeve nga gjuha dhe nga çka quhet sjellje civile;

4. mungesa e njohjes së mendësisë, motivimeve, marrëdhënieve shoqërore e praktikave shoqërore të njerëzve të tjerë.

Në botën e sotme përmirësimet e transportit e të komunikimit kanë sjellë ndërveprime më të dendura, më të shpeshta, më simetrike dhe më përfshirëse ndërmjet njerëzve prej qytetërimesh të ndryshme. Si pasojë, identitetet e tyre qytetërimore po dalin gjithnjë e më në pah. Francezët, gjermanët, belgjanët dhe holandezët përherë e më tepër e mendojnë veten si evropianë. Myslimanët e Lindjes së Mesme e njëjtësojnë veten me bosnjakët e çeçenët dhe tubohen për t'i mbështetur. Kinezët në mbarë Azinë i njëjtësojnë interesat e tyre me ato të kontinentit. Rusët e njëjtësojnë veten me serbët e popujt e tjerë ortodoksë dhe u japin mbështetje. Këto nivele më të gjera identiteti qytetërimor duan të thonë një vetëdije më e thellë për dallimet qytetërimore dhe për nevojën që të mbrohet çka na shquan "ne" prej "atyre".

Së katërti, burimet e konfliktit ndërmjet shteteve e grupeve prej qytetërimesh të ndryshme janë, në një masë të madhe, ato që kanë përfutur gjithmonë konfliktet ndërmjet grupeve: sundimi i njerëzve, territorit, pasurisë e burimeve, si dhe pushteti relativ, domethënë aftësia e njërit grup për t'ia imponuar vlerat, kulturën e institucionet grupit tjetër, krahasuar me aftësinë e atij grupi për të vepruar anasjelltas. Konflikti ndërmjet grupeve kulturore, megjithatë, mund të përfshijë edhe çështje kulturore. Dallimet në ideologjinë shekullare ndërmjet marksizëm-leninizmit e demokracisë liberale të paktën nëse nuk zgjidhen, mund të diskutohen. Dallimet në interesat materialë mund të jenë objekt bisedimesh dhe shpesh zgjidhen me kompromis në atë mënyrë, që nuk bëhet dot për çështjet kulturore.

Hindutë e myslimanët nuk ka të ngjarë ta zgjidhin çështjen nëse duhet ndërtuar një tempull ose një xhami në Ajodhia, duke i ndërtuar që të dy apo asnjërin, ose me një ndërtesë të përzier, që do të ishte njëkohësisht tempull e xhami. Po ashtu nuk mund të zgjidhet lehtë çështja, që mund të duket drejtpërdrejt territoriale, ndërmjet myslimanëve shqiptarë e serbëve ortodoksë lidhur me Kosovën, ose ndërmjet çifutëve e arabëve lidhur me Jerusalem, pasi secila trevë ka kuptim të thellë historik, kulturor e emocional për të dy popujt. Në mënyrë të ngjashme, as autoritetet franceze, as prindët myslimanë nuk ka gjasa të pranojnë kompromisin, që do t'i lejonte nxënëset e shkollës të mbanin veshjen myslimane një ditë po e një jo gjatë vitit shkollor. Çështjet kulturore si këto nënkuptojnë një po ose një jo, kurse zgjedhja është zero.

Së pesti e së fundi, konflikti është i kudondodhur. Urrejtja është tipar njerëzor. Për vetëpërcaktimin dhe motivimin njerëzit kanë nevojë për armiq: konkurrentë në biznes, rivalë në arritjet, kundërshtarë në politikë. Në mënyrë të natyrshme ata shfaqin mosbesim dhe i shohin si kërcënim ata që janë të ndryshëm e kanë aftësinë t'u bëjnë dëm. Zgjidhja e një konflikti dhe zhdukja e një armiku prodhon forca vetjake, shoqërore e politike, që përftojnë konflikte e armiq të rinj. "Prirja për të kundërvënë 'ne' përballë 'atyre' është," si ka thënë Ali Mazrui, "pothuaj universale në arenën politike."² Në botën bashkëkohore "ata" gjithnjë e më shumë ka të ngjarë të jenë njerëzit e një qytetërimi të ndryshëm. Fundi i Luftës së ftohtë nuk i dha fund konfliktit, madje ngjalli identitetet e reja të rrënjosura në kulturë e modele të reja konflikti, ndërmjet grupeve prej kulturash të ndryshme, që në nivelin më të gjerë janë qytetërimet. Njëkohësisht kultura e përbashkët gjithashtu nxit bashkëpunimin ndërmjet shteteve e grupeve, të cilat e

kanë të përbashkët atë kulturë, siç mund të shihet në modelet që po dalin të shoqatave rajonale ndërmjet vendeve, sidomos në fushën ekonomike.

Kultura dhe bashkëpunimi ekonomik

Në fillim të viteve 1990 u fol shumë për rajonalizmin dhe rajonalizimin e politikës botërore. Konfliktet rajonale zëvendësuan konfliktin global në rendin e ditës të sigurisë botërore. Fuqitë kryesore, si Rusia, Kina e Shtetet e Bashkuara, po ashtu si fuqitë e dorës së dytë, si Suedia e Turqia, i ripërcaktuan interesat e tyre të sigurisë nga pikëpamja e shprehur rajonale. Tregtia ndërmjet rajoneve u zgjerua më shpejt ndërmjet rajoneve dhe mjaft veta parashikonin daljen e blloqeve ekonomike rajonale: europian, amerikanoverior, aziatikolindor e ndoshta të tjerëve.

Mirëpo termi “rajonalizëm” nuk e paraqet me përpikëri atë që po ndodhte. Rajonet janë tërësi gjeografike e jo politike ose kulturore. Ashtu si me Ballkanin ose me Lindjen e Mesme, ato mund të përçahen prej konflikteve ndër- e brendaqytetërimore. Rajonet janë një bazë për bashkëpunim ndërmjet shteteve vetëm në atë masë, sa gjeografia përputhet me kulturën. Po të ndahet prej kulturës, afërsia nuk prodhon përbashkësinë dhe madje mund të farkëtojë të kundërtën. Aleancat ushtarake dhe shoqatat ekonomike kërkojnë bashkëpunimin e anëtarëve të tyre, bashkëpunimi mbështetet te besimi dhe besimi fare lehtë buron prej vlerave e kulturës së përbashkët. Si pasojë, ndërsa epoka dhe qëllimi gjithashtu luajnë rol, frytshmëria e përgjithshme e organizatave rajonale

përgjithësisht ndryshon në drejtim të përkundërt me larminë qytetërimore të anëtarësisë së tyre. Përgjithësisht organizatat me një qytetërim bëjnë shumë më tepër gjëra dhe kanë më shumë sukses sesa organizatat shumëqytetërimore. Kjo është e vërtetë si për organizatat politike e të sigurisë, nga njëra anë, ashtu edhe për organizatat ekonomike, nga ana tjetër.

Suksesi i NATO-s del në pjesën më të madhe si rrjedhim i faktit, se është organizata qendrore e sigurisë së vendeve Perëndimore me vlera dhe qëndrime filozofike të përbashkëta. Bashkimi Europian Perëndimor është produkt i një kulture të përbashkët europiane. Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë, nga ana tjetër, përfshin vende prej të paktën tre qytetërimesh me interesa dhe vlera mjaft të ndryshme, që përbëjnë pengesat kryesore në rrugën për të krijuar një identitet të rëndësishëm institucional dhe për të kryer një gamë të gjerë veprimtarish të rëndësishme. Bashkësia e Karaibeve (CARICOM) me një qytetërim, e përbërë prej trembëdhjetë kolonish të dikurshme britanike e që flasin anglisht, ka krijuar një larmi të gjerë organizimesh bashkëpunimi, duke e pasur bashkëpunimin më të dendur ndërmjet disa nëngrupimeve. Mirëpo kanë dështuar në thelb përpjekjet për të krijuar organizata më të gjera të Karaibeve, që do ta kapërcenin vijën e shkëputjes anglo-hispanike. Po njësoj, Shoqata e Azisë Jugore për Bashkëpunimin Rajonal, e ngritur më 1985 dhe që përfshin shtatë shtetet hindu, myslimane e budiste, ka qenë pothuaj plotësisht e pafrytshme, madje deri në atë pikë sa të mos ishte në gjendje të bënte mbledhjet.³

Marrëdhënia e kulturës me rajonalizmin është fare e qartë lidhur me integrimin ekonomik. Të paktën për më të integruarat, katër nivelet e pranuar të shoqatave ekonomike ndërmjet vendeve janë:

1. zona e tregtisë së lirë;
2. bashkimi doganor;
3. tregu i përbashkët;
4. bashkimi ekonomik.

Bashkimi European ka ecur më përpara, duke e përshkuar këtë renditje në rrugën e integritit, dhe ka tregun e përbashkët e shumë elementë të bashkimit ekonomik. Vendet relativisht homogjene të Mercosur-it dhe të Paktit të Andeve më 1994 ishin në procesin e ngritjes së bashkimeve doganore. Në Azi ASEAN-i shumëqytetërimor vetëm më 1992 nisi të ecte drejt zhvillimit të një zone të tregtisë së lirë. Organizatat e tjera ekonomike shumëqytetërimore madje kanë mbetur edhe më prapa. Më 1995, me përjashtimin anësor të NAFTA-s, asnjë organizatë e tillë nuk kishte krijuar zonën e tregtisë së lirë, aq më pak ndonjë formë më të zgjeruar të integritit ekonomik.

Në Europën Perëndimore dhe në Amerikën Latine përbashkësia qytetërimore ushqen bashkëpunimin dhe organizimin rajonal. Europeanët perëndimorë dhe latinoamerikanët e dinë se kanë mjaft gjëra të përbashkëta. Pesë qytetërime (gjashtë, po të përfshihet edhe Rusia) gjenden në Azinë Lindore. Rrjedhimisht, Azia Lindore është rasti për provën e ngritjes së organizatave domethënëse, që nuk i kanë rrënjët në një qytetërim të përbashkët. Aty nga fillimi i viteve 1990 nuk kishte asnjë organizatë sigurie ose aleancë ushtarake shumëpalëshe, të krahasueshme me NATO-n. Më 1967 ishte ngritur një organizatë rajonale shumëqytetërimore, ASEAN-i, me një shtet sinik, një budist, një të krishterë dhe dy myslimanë, që të gjithë përballë sfidave aktive nga kryengritjet komuniste dhe atyre të mundshme nga Vietnam i Veriut e Kina.

ASEAN-i shpesh përmendet si shembull i një organizate të frytshme shumëkulturore. Mirëpo ai është edhe shembull i kufizimeve të organizatave të tilla. Nuk është aleancë ushtarake. Ndërkohë që anëtarët e tij herë pas here bashkëpunojnë ushtarakisht mbi baza dypalëshe, që të gjithë janë duke i shtuar buxhetet ushtarake dhe kanë hyrë në rrugën e fuqizimit ushtarak, në kontrast të hapur me pakësimet që po bëjnë vendet e Europës Perëndimore dhe të Amerikës Latine. Në fushën ekonomike, që në fillim ASEAN-i ishte planifikuar të arrinte “bashkëpunimin ekonomik dhe jo integrimin ekonomik,” prandaj si rrjedhim, rajonalizmi u zhvillua me “hap modest”, madje as është menduar për një zonë të tregtisë së lirë deri në shekullin e njëzetentjetë.⁴ Më 1978 ASEAN-i ngriti Konferencën e Ministrave të Jashtëm, në të cilën ministrat e punëve të jashtme mund të takoheshin me “partnerët e tyre të dialogut”: Shtetet e Bashkuara, Japonia, Kanadaja, Australia, Zelanda e Re, Koreja e Jugut dhe Bashkimi Europian. Mirëpo KMJ ka qenë kryesisht një forum për bisedime dypalëshe dhe nuk ka qenë në gjendje të trajtojë “ndonjë çështje të rëndësishme të sigurisë.”⁵ Më 1993 ASEAN-i u shumëzua me një arenë edhe më të gjerë, Forumin Rajonal të ASEAN-it, i cili përmbledhonte anëtarët e tij dhe partnerët e dialogut, plus Rusinë, Kinën, Vietnamin, Laosin dhe Guinenë e Re Papua. Mirëpo, siç e nënkupton emri, kjo organizatë ishte selia për bisedime kolektive dhe jo për veprime kolektive. Mbledhjen e tij të parë në korrik 1994 anëtarët e përdorën “për të shtjelluar pikëpamjet e tyre lidhur me çështjet e sigurisë rajonale”, ndërkaq çështjet me kontradikta u shmangën, sepse, siç e komentoi një zyrtar, nëse do të shtroheshin ato, “pjesëmarrësit e përfshirë në to do të nisnin sulmet kundër njëri-tjetrit.”⁶ ASEAN-i dhe pinjulli i tij dëshmojnë për kufizimet që

janë tipar i brendshëm në organizatat rajonale shumëqytetërore.

Organizata rajonale domethënëse të Azisë Lindore do të dalin vetëm kur do të ketë përbashkësi kulturore të mjaftueshme të Azisë Lindore për t'i mbështetur. Pa dyshim, shoqëritë e Azisë Lindore kanë disa gjëra të përbashkëta, që i shquajnë prej Perëndimit. Kryeministri i Malajzisë, Mahathir Mohamadi, është shprehur se këto përbashkësi përbëjnë një bazë për t'u lidhur dhe ka mbështetur formimin e Grupit Ekonomik të Azisë Lindore mbi këto fillesa. Ai do të përfshinte vendet e ASEAN-it, Mianmarin, Tajvanin, Hong-Kongun, Korenë e Jugut dhe, ajo që është më e rëndësishme, edhe Kinën e Japoninë. Mahathiri arsyeton se GEAL-i i ka rrënjët në kulturën e përbashkët. Ai duhet menduar "jo thjesht si një grup gjeografik, meqë është në Azinë Lindore, por edhe si grup kulturor. Ndonëse aziatikët lindorë mund të jenë japonezë, koreanë ose indonezianë, nga ana kulturore ata kanë disa ngjashmëri ...Europianët tubohen bashkë dhe amerikanët tubohen bashkë. Edhe ne, aziatikët, duhet të tubohemi." Siç ka thënë një prej anëtarëve, qëllimi i tij është të nxisë "tregtinë rajonale ndërmjet vendeve që kanë përbashkësi këtu në Azi."⁷

Rrjedhimisht, premisa në themel të GEAL-it është se ekonomia ndjek pas kulturën. Australia, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara përjashtohen, sepse kulturalisht nuk janë aziatike. Mirëpo sukcesi i GEAL-it varet ndjeshëm prej pjesëmarrjes së Japonisë e Kinës. Mahathiri i është drejtuar me lutje Japonisë që të marrë pjesë. "Japonia është aziatike. Japonia është e Azisë Lindore," ka thënë ai përpara auditorit japonez. "Ju nuk mund t'i ktheni kurrizin këtij fakti gjeokulturor. Ju bëni pjesë këtu."⁸ Mirëpo qeveria japoneze ngurronte që të hynte në GEAL, pjesërisht nga frika se mos fyente

Shtetet e Bashkuara dhe pjesërisht sepse ishte e përçarë, se a duhej ta njëjtësonte veten me Azinë. Nëse Japonia hyn në GEAL, do të mbisundojë, çka ka të ngjarë të ngjallë frikë e pasiguri ndërmjet anëtarëve të tij, si dhe do ta përforcojë antagonizmin nga ana e Kinës. Disa vjet me radhë ka pasur shumë fjalë se Japonia po krijonte një “bllok të jenit” aziatik për kundërpeshë të Bashkimit European e NAFTA-s. Mirëpo Japonia është vend i vetmuar, me pak lidhje kulturore me fqinjët dhe deri më 1995 asnjë bllok i jenit nuk u bë fakt.

Ndërkohë që ASEAN-i lëvizte ngadalë, blloku i jenit mbetej një ëndërr, Japonia luhatej dhe GEAL-i nuk u ngrit nga toka, ndërveprimi ekonomik në Azinë Lindore megjithatë u shtua në mënyrë të befasishme. Ky zgjerim i kishte rrënjët në lidhjet kulturore ndërmjet bashkësive kineze të Azisë Lindore. Këto lidhje bënë të lindte “integrimi jozyrtar i vijueshëm” i ekonomisë ndërkombëtare të bazuar te kinezët, i krahasueshëm nga shumë anë me Lidhjen Hanseatike e “ndoshta çon te tregu i përbashkët kinez de facto”⁹ (shih f. 168-74). Në Azinë Lindore, ashtu si gjetkë, përbashkësia kulturore ka qenë parakusht për integrimin domethënës ekonomik.

Mbarimi i Luftës së ftohtë u dha zemër përpjekjeve për të krijuar organizata rajonale ekonomike dhe për të rigjallëruar organizatat e vjetra. Suksesi i këtyre përpjekjeve varej tërësisht nga homogjeniteti kulturor i shteteve të përfshira. Plani i Shimon Peresit i vitit 1994 për tregun e përbashkët ekonomik të Lindjes së Mesme ka të ngjarë të mbetet një “mirazh shkretëtire” për një farë kohe në të ardhmen, sepse siç e ka komentuar një zyrtar arab: “Bota arabe nuk ndien nevojën për një institucion ose për ngritjen e një banke, në të cilën të marrë pjesë Izraeli.”¹⁰ Shoqata e Shteteve të Karaibeve, e krijuar më 1994 për ta lidhur CARICOM-in me Haitin dhe vendet spanjishtfolëse të rajonit, ka treguar pak

shenja kapërcimi të dallimeve gjuhësore e kulturore ndërmjet anëtarëve të ndryshëm, si dhe natyrën e mbyllur ishullore të kolonive të dikurshme britanike e të orientimit të tyre tërësisht drejt Shteteve të Bashkuara.¹¹ Nga ana tjetër, përpjekjet për të bërë organizata më homogjene kulturalisht kanë ecur përpara. Ndonëse janë të ndarë sipas vijave nënqytetërimore, Pakistani, Irani dhe Turqia më 1985 ringritën Bashkëpunimin Rajonal për Zhvillim, të krijuar më 1977 e që ishte duke dhënë shpirt, duke ia ndryshuar emrin në Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik. Më pas u arritën marrëveshje për pakësimin e tarifave dhe për një varg masash të tjera, kurse më 1992 anëtarësia e OBE-së u zgjerua dhe përfshiu Afganistanin e gjashtë republika myslimane të mëparshme sovjetike. Ndërkaq, pesë republika të mëparshme sovjetike të Azisë Qendrore më 1991 u morën vesh në parim që të krijojnë një treg të përbashkët dhe më 1994 dy shtetet më të mëdha, Uzbekistani e Kazakistani nënshkruan marrëveshjen për të lejuar “qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve e kapitalit”, si dhe për të bashkërenduar politikat e tyre fiskale, monetare e të tarifave. Më 1991 Brazili, Argjentina, Uruguai dhe Paraguai u bashkuan në Mercosur me qëllimin që të kapërcenin etapat normale me hope të integritit ekonomik, kurse nga viti 1995 ishte ngritur një bashkim i pjesshëm doganor. Më 1990 Tregu i Përbashkët i Amerikës Qendrore, që kishte qenë në amulli, krijoi një zonë të tregtisë së lirë dhe më 1994 Grupi i Andeve i mëparshëm, i cili po ashtu kishte qenë pasiv, krijoi një bashkim doganor. Më 1992 vendet e Vishegradit (Polonia, Hungaria, Republika Çeke dhe Sllovakia) u morën vesh që të krijojnë Zonën e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore dhe më 1994 i shpejtuan afatet për realizimin e saj.¹²

Integrimin ekonomik e pason zgjerimi i tregtisë dhe gjatë viteve 1980 e në fillim të viteve 1990 tregtia brendarajonale u bë gjithnjë e më tepër më me rëndësi kundrejt tregtisë ndërrajonale. Tregtia me Bashkësinë Europiane më 1980 përbënte 50,6 për qind të tregtisë së përgjithshme të bashkësisë dhe u rrit në 58,9 për qind nga viti 1989. Zhvendosje të ngjashme drejt tregtisë rajonale kanë ndodhur në Amerikën e Veriut dhe në Azinë Lindore. Krijimi i Mercosur-it dhe rigjallërimi i Paktit të Andeve në Amerikën Latine i dhanë shtysa hovit në tregtinë ndërlatinoamerikane në fillim të viteve 1990, kurse tregtia ndërmjet Brazilit e Argjentinës u trefishua dhe tregtia Kolombi-Venezuelë u katërfishua ndërmjet viteve 1990 e 1993. Më 1994 Shteteve të Bashkuara si partneri kryesor tregtar ua zuri vendin Brazili. Krijimi i NAFTA-s po ashtu u shoqërua me një rritje të ndjeshme në tregtinë Meksikë-SHBA. Tregtia brenda Azisë Lindore gjithashtu u zgjerua më shpejt sesa tregtia jashtërajonale, por zgjerimi i saj gjeti pengesë nga prirja e Japonisë për t'i mbajtur të mbyllura tregjet e veta. Tregtia ndërmjet vendeve të zonës kulturore kineze (ASEAN, Tajvani, Hong-Kongu, Koreja e Jugut dhe Kina), nga njëra anë, është shtuar nga më pak se 20 për qind e totalit më 1970 te pothuaj 30 për qind e totalit më 1992, ndërsa pjesa e Japonisë në tregtinë e tyre ra nga 23 për qind në 13 për qind. Më 1992 eksportet e zonës kineze drejt vendeve të zonave të tjera i kapërcyen si eksportet e tyre drejt Shteteve të Bashkuara, ashtu edhe eksportet e tyre të përbashkëta drejt Japonisë e Bashkësisë Europiane.¹³

Duke qenë një shoqëri dhe qytetërim unikal në vetvete, Japoni

a ballafaqohet me vështirësi për të zhvilluar lidhjet ekonomike me Azinë Lindore dhe për të trajtuar dallimet ekonomike që ka me Shtetet e Bashkuara dhe

Europën. Sado lidhje të forta tregtie e investimesh të farkëtojnë Japonia me vendet e tjera të Azisë Lindore, dallimet e saj kulturore kundrejt atyre vendeve e në veçanti nga elitat ekonomike në pjesën më të madhe kineze, e pengojnë të krijojnë një grupim ekonomik rajonal të udhëhequr prej Japonisë, të krahasueshëm me NAFTA-n ose Bashkimin Europian. Njëkohësisht dallimet kulturore me Perëndimin i acarojnë keqkuptimet dhe antagonizmat në marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara dhe Europën. Nëse integrimi ekonomik, e me sa duket kështu është, varet prej përbashkësisë kulturore, Japonia si vend i vetmuar kulturalisht do të kishte një të ardhme ekonomikisht të vetmuar.

Në të kaluarën modelet e tregtisë ndërmjet shteteve kanë ndjekur dhe kanë ecur paralel me modelet e aleancave ndërmjet vendeve.¹⁴ Në botën që po përftohet, modelet e tregtisë do të ndiejnë ndikimin vendimtar të modeleve të kulturës. Biznesmenët bëjnë punë me njerëz, të cilët i kuptojnë dhe u besojnë; shtetet ua kalojnë sovranitetin shoqatave ndërkombëtare të përbëra prej shteteve me mendësi të ngjashme, që i kuptojnë dhe u besojnë. Rrënjët e bashkëpunimit ekonomik gjenden te përbashkësia kulturore.

Struktura e qytetërimeve

Gjatë Luftës së ftohtë vendet lidheshin me dy superfuqitë si aleate, satelite, kliente, asnjëse e të paangazhuara. Në botën pas Luftës së ftohtë vendet lidhen me qytetërimet si shtete pjesëtare, shtete bërthamë, shtete të vetmuara, shtete të çara dhe të

përçara. Ashtu si fiset e kombet, qytetërimet kanë struktura politike, Një *shtet anëtar* është një vend që njëjtësohet plotësisht nga ana kulturore me një qytetërim, si Egjipti me qytetërimin arab-islamik dhe Italia me qytetërimin europian perëndimor. Një qytetërim gjithashtu mund të përfshijë njerëz, që kanë të përbashkët kulturën e tij dhe e njëjtësojnë veten me të, por që jetojnë në shtete ku mbizotërojnë anëtarët e një qytetërimi tjetër. Qytetërimet zakonisht kanë një ose dy vende, të cilat anëtarët e tyre i vështrojnë si burimi apo burimet kryesore të kulturës së qytetërimin. Këto burime shpesh ndodhen brenda *shteteve bërthamë* ose shteteve të qytetërimin, domethënë shteti ose shtetet më qendrore nga ana kulturore e më të fuqishme.

Numri dhe roli i shteteve bërthamë luhaten nga qytetërimi në qytetërim dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Qytetërimi japonez në të vërtetë është i njëjtë me shtetin bërthamë të vetëm japonez. Qytetërimet sinik, ortodoks e hindu secili kanë një shtet bërthamë tërësisht mbizotërues, shtete të tjera anëtare dhe njerëz të lidhur me qytetërimin e tyre në shtete ku mbizotërojnë njerëz të një qytetërimin të dalluar (kinezët e përtejdetit, rusët në “fqinjët e afërt të jashtëm”, tamilët e Sri Lankës). Historikisht Perëndimi zakonisht ka pasur disa shtete bërthamë; sot ka dy bërthama, Shtetet e Bashkuara dhe bërthamën franko-gjermane në Europë, kurse Britania është një qendër fuqie shtojcë në luhajtje midis tyre. Islami, Amerika Latine dhe Afrika nuk kanë shtete bërthamë. Kjo vjen pjesërisht ngaqë imperializmi i vendeve Perëndimore, i cili i ndante për vete Afrikën e Lindjen e Mesme dhe, në shekujt e fillimit e në mënyrë më pak të përcaktuar, edhe Amerikën Latine.

Mungesa e shtetit islamik bërthamë si për shoqëritë myslimane, edhe për jomuslimanet, shtron probleme të mëdha që diskutohen në kreun 7. Lidhur me Amerikën

Latine, mund të përfytyrohet që Spanja do të përbente një shtet bërthamë të qytetërimit spanjishtfolës e madje iberik, por udhëheqësit e tij me vetëdije kanë zgjedhur që të bëhen shtet anëtar i qytetërimit europian, i cili njëkohësisht mban lidhje kulturore me ish kolonitë. Madhësia, burimet, popullsia, aftësitë ushtarake dhe ekonomike i japin cilësitë Brazilit që të jetë udhëheqës i Amerikës Latine dhe mund të përfytyrohet që të bëhet i tillë. Mirëpo Brazili për Amerikën Latine është si Irani për Islamin. Ndonëse nga anë të tjera i ka mirë cilësitë për të qenë shtet bërthamë, dallimet nënqytetërimore (fetare për Iranin dhe gjuhësore për Brazilin) e bëjnë të vështirë që ta marrë atë rol. Kështu Amerika Latine ka disa shtete: Brazilin, Meksikën, Venezuelën dhe Argjentinën, që bashkëpunojnë e konkurrojnë për vend udhëheqës. Gjendja e Amerikës Latine ndërlikohet gjithashtu nga fakti se Meksika ka bërë përpjekje për ta ripërcaktuar veten nga identiteti latinamerikan në atë veriamerikan, kurse Kili dhe shtete të tjera mund ta ndjekin këtë shembull. Në fund qytetërimi latinamerikan mund të shkrihet e të bëhet një nënvariant i qytetërimit Perëndimor me bigëzim të trefishtë.

Aftësia e ndonjë shteti bërthamë të mundshëm, që të sigurojë udhëheqjen për Afrikën nënsahariane, kufizohet prej ndarjes në vende frëngjishtfolëse dhe anglishtfolëse. Për një farë kohe Bregu i Fildishtë ishte shteti bërthamë i Afrikës frëngjishtfolëse. Mirëpo në një masë të ndjeshme shteti bërthamë i Afrikës franceze ka qenë Franca, e cila mbajti lidhje të ngushta ekonomike, ushtarake e politike pasi kolonitë e saj fituan pavarësinë. Dy vende afrikane, që i zotërojnë më shumë cilësitë për t'u bërë shtete bërthamë janë anglishtfolëse. Madhësia, burimet dhe vendndodhja e bëjnë Nigerinë shtet bërthamë të mundshëm, por copëtimi i saj ndërqytetërimor, korrupsioni masiv, paqëndrueshmëria

politike, qeveria shtypëse dhe problemet ekonomike e kanë kufizuar rëndë aftësinë e saj për ta luajtur këtë rol, ndonëse e ka luajtur në disa raste. Kapërcimi paqësor e nëpërmjet bisedimesh i aparteidit në Afrikën e Jugut, fuqia e saj industriale, niveli i lartë i zhvillimit ekonomik krahasuar me vendet e tjera afrikane, aftësitë ushtarake, burimet natyrore dhe udhëheqja politike e nivelit të lartë me ndërthurje zezakësh e të bardhësh – që të gjitha e shquajnë Afrikën e Jugut si udhëheqësen e qartë të Afrikës jugore, e ndoshta udhëheqësen e Afrikës anglishtfolëse dhe, ka të ngjarë, udhëheqëse të gjithë Afrikës nën Saharanë.

Një *vendi të vetmuar* i mungon përbashkësia me shoqëritë e tjera. Për shembull, Etiopia është e veçuar kulturalisht për shkak të gjuhës mbizotëruese, amharishtes, që shkruhet me alfabetin etiopik, të fesë mbizotëruese, ortodoksisë kopte, historisë perandorake dhe dallimit fetar prej popujve rrethues, që janë në pjesën dërrmuese myslimanë. Ndërsa tradicionalisht elita e Haitit ka gëzuar lidhje kulturore me Francën, për ta bërë vend të vetmuar ndërthuren gjuha kreole e Haitit, feja vudu, prejardhja prej skllëvërve revolucionarë dhe historia e ashpër. “Çdo shtet është unikal,” ka vënë në dukje Sidney Mintz (Sidnej Minc), “por Haiti përbën një klasë më vete.” Si rrjedhim, gjatë krizës së Haitit më 1994 vendet e Amerikës Latine nuk e vështronin Haitin si problem të Amerikës Latine dhe nuk patën dëshirë t’i pranonin refugjatët haitianë, ndonëse i kishin pranuar kubanët. “[N]ë Amerikën Latine,” siç e ka thënë presidenti i zgjedhur i Panamasë, “Haiti nuk pranohet si vend i Amerikës Latine. Haitianët flasin një tjetër gjuhë. Ata kanë kulturë të ndryshme dhe rrënjë etnike të ndryshme. Përgjithësisht janë shumë të ndryshëm.” Po aq i shkëputur është Haiti prej vendeve anglishtfolëse me zezakë të Karaibeve. Një komentator ka vërejtur se

haitianët janë “po aq të huaj për dikë nga Grenada ose Xhamajka, sa do të ishin për dikë nga Ajova ose Montana.” Haiti, “fqinji të cilin nuk e do askush”, është me të vërtetë një vend pa farefis.¹⁵

Vendi i vetmuar më i rëndësishëm është Japonia. Asnjë vend tjetër nuk e ka të përbashkët me të kulturën e saj të dalluar, kurse emigrantët japonezë as nuk janë në shifra të mëdha nëpër vendet e tjera, as nuk janë asimiluar në kulturat e atyre vendeve (p.sh. amerikanët japonezë). Vetmia e Japonisë theksohet më tej nga fakti se kultura e saj është tepër e veçantë dhe nuk përmban një fe të mundshme universale (krishterimin, islamizmin) ose një ideologji të tillë (liberalizmin, komunizmin), që do të mund të eksportohej te shoqëritë e tjera e kështu të vendoste lidhje kulturore me njerëzit e atyre shoqërive.

Pothuaj të gjitha shoqëritë janë heterogjene, meqë përfshijnë dy ose më shumë grupe etnike, raciale e fetare. Shumë vende janë të përçara, sepse dallimet dhe konfliktet ndërmjet këtyre grupeve luajnë rol të rëndësishëm në politikën e vendit. Thellësia e përçarjes zakonisht ndryshon sipas kohës. Përçarjet e thella brenda një vendi mund të shpien te dhuna masive ose të kërcënojnë ekzistencën e vendit. Ky kërcënim i fundit dhe lëvizjet për autonomi ose shkëputje ka më shumë të ngjarë të lindin, kur dallimet kulturore përkojnë me dallimet në vendndodhjen gjeografike. Nëse nuk përputhen kultura me gjeografinë, ato mund të bëhen të përkojnë ose nëpërmjet gjenocidit, ose nëpërmjet emigrimit të detyruar.

Vendet me grupime të dalluara kulturore, që i përkasin të njëjtit qytetërim, mund të përçahen thellë nga shkëputja që ndodh (Çekosllovakia) ose që kthehet në mundësi (Kanadaja). Mirëpo përçarjet e thella ka më shumë gjasa të përftohen brenda një vendi të çarë, ku

grupe të gjera u përkasin qytetërimeve të ndryshme. Ndarje dhe tensione të tilla që i shoqërojnë shpesh krijohen kur një grup i shumicës, i cili i përket njërit qytetërim, përpiqet ta përcaktojë shtetin si veglën e vet politike dhe gjuhën e vet, fenë e simbolet t'i bëjë të atij shteti, siç janë përpjekur të bëjnë hindutë, sinhalezët e myslimanët në Indi, Sri Lankë e Malajzi.

Vendet e çara, që nga ana territoriale janë në kapërcyell të vijave të shkëputjes ndërmjet qytetërimeve, ndeshen me probleme të veçanta për ta ruajtur unitetin. Në Sudan lufta civile ka vijuar për dhjetëvjeçarë ndërmjet veriut mysliman e jugut në pjesën më të madhe të krishterë. E njëjta ndarje qytetërimore e ka munduar politikën e Nigerisë për një periudhë po aq të gjatë kohe dhe ka shkaktuar një luftë të madhe për shkëputje, plus grushte shteti, trazira dhe shfaqje të tjera të dhunës. Në Tanzani kontinenti animist i krishterë dhe Zanzibari arab mysliman janë shkëputur prej njëri-tjetrit dhe nga shumë pikëpamje janë bërë dy vende të veçuara, kështu që Zanzibari më 1992 fshehurazi hyri në Organizatën e Konferencës Islamike e pastaj Tanzania u detyrua të tërhiqej prej saj vitin pasues.¹⁶ Po e njëjta përçarje ndërmjet të krishterëve e myslimanëve ka lindur acarime e konflikte në Kenia. Në bririn e Afrikës më 1993 u ndanë nga njëra-tjetra Etiopia në pjesën më të madhe e krishterë dhe Eirtrea me mbizotërim dërmues mysliman. Mirëpo Etiopia mbeti me një pakicë të ndjeshme myslimane mes popullsisë oromo. Ndër vende të tjera, të ndara prej vijave qytetërimore të shkëputjes, bëjnë pjesë: India (budistë sinhalezë dhe hindu tamilë), Malajzia e Singapori (kinezë e myslimanë malajas), Kina (kinezë han, budistë tibetianë, myslimanë turq), Filipinet (të krishterë e myslimanë) dhe Indonezia (myslimanë e të krishterë të Timorit).

Veprimi përçarës i vijave qytetërimore të shkëputjes ka qenë shumë më i dukshëm në ato vende të çara, që u mbajtën bashkë gjatë Luftës së Ftohtë nga regjimet autoritare komuniste të mbështetura në ideologjinë marksiste-leniniste. Me shembjen e komunizmit, ideologjinë e zëvendësoi kultura si forca magnetike shtytëse dhe tërheqëse, kurse Jugosllavia e Bashkimi Sovjetik u shpërbënë e u ndanë në tërësi të reja, që u grupuan sipas vijave qytetërimore: republikat baltike (protestante e katolike), ortodokse dhe myslimane në ish Bashkimin Sovjetik; Sllovenia e Kroacia katolike; Bosnjë-Hercegovina pjesërisht myslimane dhe Serbia-Mali i Zi e Maqedonia ortodokse në ish Jugosllavinë. Atje ku këto tërësi trashëguese përsëri përfshinin grupe shumëqytetërimore, u shfaqën ndarje të fazës së dytë. Bosnjë-Hercegovina u nda prej luftës në pjesët serbe, myslimane e kroate, kurse serbët e kroatët luftuan kundër njëri-tjetrit në Kroaci. Qëndrimi i vijuar paqësor i shqiptarëve myslimanë të Kosovës brenda Serbisë sllave ortodokse është tepër i pasigurtë dhe janë rritur tensionet ndërmjet pakicës myslimane shqiptare e shumicës sllave ortodokse në Maqedoni. Gjithashtu mjaft nga republikat e mëparshme sovjetike janë në kapërcyell të vijave të shkëputjes qytetërimore, pjesërisht sepse qeveria sovjetike i kishte përcaktuar kufijtë, që të krijonte republika të ndara, e prandaj Krimeja shkonte me Ukrainën, Nagorno-Karabaku i Armenisë me Azerbajxhanin. Rusia kishte disa pakica myslimane, relativisht të vogla, shumica kryesisht në Kaukazin verior dhe në trevën e Vollgës. Estonia, Letonia dhe Kazakistani kanë pakica të ndjeshme ruse, të cilat gjithashtu në masën më të madhe janë rrjedhim i politikës sovjetike. Ukraina është e ndarë ndërmjet perëndimit nacionalist uniat, që flet ukrainisht, dhe lindjes ortodokse, që flet rusisht.

Në një vend të çarë grupet më të mëdha prej dy ose më shumë qytetërimesh, në thelb, thonë: “Ne jemi popuj të ndryshëm dhe u përkasim vendeve të ndryshme.” Forcat shtytëse i bëjnë të ndahen dhe ato anojnë nga magnetet qytetërimore në shoqëritë e tjera. Përkundrazi, një *vend i përçarë* ka një kulturë të vetme qytetërimore, e cila e vendos në një qytetërim, por udhëheqësit e tij duan të zhvendosen te një qytetërim tjetër. Në thelb, ata thonë: “Ne jemi një popull dhe së bashku i përkasim një vendi, por duam ta ndryshojmë këtë vend.” Ndryshe prej njerëzve në një vend të çarë, njerëzit e vendeve të përçara pajtohen se kush janë, por nuk pajtohen se cili qytetërim është mirëfilli qytetërimi i tyre. Si rregull, një pjesë e ndjeshme e udhëheqësve përqafojnë strategjinë qemaliste dhe vendosin që shoqëria e tyre duhet të flakë kulturën e vet e institucionet joperëndimore, duhet të bashkohet me Perëndimin dhe duhet të modernizohet e të perëndimorizohet njëherësh. Rusia ka qenë vend i përçarë që nga koha e Pjetrit të Madh, e përçarë lidhur me çështjen nëse bën pjesë në qytetërimin Perëndimor, apo është bërthama e një qytetërimi ortodoks euroaziatik. Atdheu i Mustafa Qemalit, natyrisht, është vend klasik i përçarë, i cili që nga vitet 1920 është përpjekur të modernizohet, të perëndimorizohet dhe të bëhet pjesë e Perëndimit. Pothuaj pas dy shekujsh që Meksika e përcaktonte veten si vend latinoamerikan, në kundërvënje me Shtetet e Bashkuara, udhëheqësit e saj që prej viteve 1980 e kanë kthyer në një vend të përçarë, duke u përpjekur ta ripërcaktojnë si shoqëri veriamerikane. Udhëheqësit e Australisë në vitet 1990, përkundrazi, po përpiqen ta shkëpusin vendin prej Perëndimit dhe ta bëjnë pjesë të Azisë, rrjedhimisht, po krijojnë një vend të përçarë nga ana e kundërt. Vendet e përçara njihen prej dy dukurish. Udhëheqësit e tyre i

quajnë si “ura” ndërmjet dy kulturave, kurse vëzhguesit i paraqesin me dy fytyra, si Janusi i mitologjisë. Tituj tipikë të gazetave, që nxjerrin në pah problemet e identitetit të vendeve të përcara, janë: “Rusia shikon nga Perëndimi dhe nga Lindja”; “Turqia: nga Lindja, nga Perëndimi, cili është më i mirë?”; “Nacionalizmi australian: besnikëri të ndara”.¹⁷

Vendet e përcara: dështimi i zhvendosjeve kulturore

Që një vend i përcarë ta ripërcaktojë me sukses identitetin e vet qytetërimor, duhet të plotësojë të paktën tri kërkesa. E para, elita politike dhe ekonomike e vendit duhet përgjithësisht ta mbështesë e të jetë entuziaste për këtë lëvizje. E dyta, publiku të paktën duhet të ketë dëshirë heshturazi për ripërcaktimin e identitetit. E treta, elementët mbizotërues në qytetërimin pranues, në shumicën e rasteve, Perëndimi, duhet të kenë dëshirë ta përqafojnë të shndërruarin. Procesi i ripërcaktimit të identitetit do të zgjatet, do të ketë ndërprerje dhe do të jetë i dhimbshëm nga ana politike, shoqërore, institucionale e kulturore. E gjithashtu deri më sot ka dështuar.

Rusia. Në vitet 1990 Meksika ishte vend i përcarë për disa vjet dhe Turqia për disa dhjetëvjeçarë. Rusia përkundrazi, ka qenë vend i përcarë për disa shekuj e ndryshe nga Meksika ose Turqia republikane, është gjithashtu shteti bërthamë i një qytetërimi kryesor. Nëse Turqia ose Meksika do ta ripërcaktonin veten me sukses

si pjesëtare të qytetërimit Perëndimor, pasoja për qytetërimin islamik ose latinoamerikan do të ishte fare e paktë ose e kufizuar. Nëse Rusia do të bëhej Perëndimore, qytetërimi ortodoks do të pushonte së ekzistuari. Shembja e Bashkimit Sovjetik e rindezi mes rusëve debatin për çështjen qendrore të Rosisë e Perëndimit.

Marrëdhëniet e Rosisë me qytetërimin Perëndimor kanë evoluuar përmes katër fazave. Në fazën e parë, e cila zgjati deri te mbretërimi i Pjetrit të Madh (1689-1725), Rusia e Kievit dhe Moskovi ekzistonin të shkëputura nga Perëndimi e kishin pak kontakte me shoqëritë europiane Perëndimore. Qytetërimi rus u zhvillua si pinjoll i qytetërimit bizantin e pastaj për dyqind vjet, që nga mesi i shekullit të trembëdhjetë deri te mesi i shekullit të pesëmbëdhjetë Rusia qe nën suzerenitetin e mongolëve. Rusia ishte pak ose aspak e hapur ndaj dukurive historike përcaktuese të qytetërimit Perëndimor: katolicizmit, feudalizmit, Rilindjes, Reformacionit, shtrirjes përtej detit e kolonizimit, Iluminizmit dhe daljes së shtetit komb. Shtatë nga tetë tiparet dalluese të përcaktuara më sipër të qytetërimit Perëndimor: feja, gjuhët, ndarja e kishës nga shteti, sundimi i së drejtës, pluralizmi shoqëror, organet përfaqësuese, individualizmi, mungonin pothuaj tërësisht në përvojën ruse. I vetmi përjashtim i mundshëm është trashëgimia klasike, e cila megjithatë erdhi në Rusi nëpërmjet Bizantit e, rrjedhimisht, ishte mjaft e ndryshme nga çka erdhi në Perëndim drejtpërdrejt nga Roma. Qytetërimi rus qe produkt i rrënjëve vendëse në Rusinë e Kievit dhe në Moskov, i ndikimit të qenësishëm bizantin dhe i sundimit të zgjatur mongol. Këto ndikime i dhanë trajtën një shoqërie e një kulture, që kishte pak anë të ngjashme me ato të

zhvilluara në Europën Perëndimore nën ndikimin e forcave mjaft të ndryshme.

Në fund të shekullit të shtatëmbëdhjetë Rusia jo vetëm ishte e ndryshme nga Europa, por edhe e prapambetur krahasuar me Europën, siç e mori vesh Pjetri i Madh gjatë udhëtimit nëpër Europë më 1697-98. Ai fitoi vendosmërinë si për ta modernizuar, ashtu edhe për ta Perëndimorizuar vendin e vet. Për t'i bërë njerëzit e tij që të dukeshin europianë, e para gjë që bëri Pjetri me t'u kthyer në Moskë, ishte prerja e mjekrave të bujarëve dhe ndalimi i xhybeve të gjata e kapeleve konike. Ndonëse Pjetri nuk e hoqi alfabetin cirilik, e reformoi dhe e thjeshtësoi për të futur fjalë e togfjalësha perëndimorë. Mirëpo përparësinë kryesore ia dha zhvillimit e modernizimit të forcave ushtarake të Ruisë: krijoi flotën, vendosi rekrutimin e përgjithshëm, ngriti industrinë e mbrojtjes, krijoi shkolla teknike, i dërgoi njerëzit të studionin në Perëndim dhe importoi nga Perëndimi dijet më të fundit për armët, anijet dhe ndërtimin e anijeve, lundrimin, administratën burokratike e çështjet e tjera të qenësishme për aftësitë ushtarake. Për t'i zbatuar këto risi, e reformoi rëndë dhe e zgjeroi sistemin e taksave, e gjithashtu, aty nga fundi i mbretërimit, e riorganizoi strukturën e qeverisë. Duke qenë i vendosur për ta bërë Rusinë jo vetëm një fuqi europiane, por edhe fuqi në Europë, e braktisi Moskën, ngriti një kryeqytet të ri në Shën Peterburg dhe nisi Luftën e Madhe Veriore kundër Suedisë, me qëllim që ta nguliste Rusinë si forcën mbizotëruese në Baltik dhe të krijonte një prani në Europë.

Mirëpo në përpjekjet për ta bërë vendin e tij modern dhe europian, Pjetri përforcoi gjithashtu tiparet aziatike të Ruisë, duke e përsosur despotizmin dhe duke zhdukur çfarëdo burimi të mundshëm pluralizmi shoqëror ose politik. Fisnikëria ruse asnjëherë nuk kishte

qenë e fuqishme. Pjetri e dobësoi edhe më, zgjeroi fisnikërinë sipas shërbimit dhe hartoi Tabelën e Rangjeve të mbështetur në meritat, jo në pozitën shoqërore ose të lindur. Edhe fisnikët, po ashtu si fshatarët thirreshin në shërbim të shtetit, duke përbërë “aristokracinë bujkrore”, që më vonë e tërbonte Custine-in.¹⁸ Autonomia e bujkrobërve u ngushtua më keq, sepse ata u lidhën më fort pas tokës dhe zotërve të tyre. Kisha ortodokse, e cila kurdoherë kishte qenë nën kontrollin e gjerë të shtetit, u riorganizua dhe u vu nën një sinod, të cilin e emëronte drejtpërdrejt cari. Carit gjithashtu iu dha fuqia që të caktonte pasardhësin pa iu drejtuar praktikave mbizotëruese të trashëgimisë. Me këto ndryshime Pjetri i nisi në Rusi dhe dha shembullin e lidhjeve të ngushta ndërmjet modernizimit e perëndimorizimit, nga njëra anë, e despotizmit, nga ana tjetër. Duke ndjekur modelin e Pjetrit, edhe Lenini, Stalini, e në një shkallë më të ulët Ekaterina II dhe Aleksandri II, gjithashtu u përpoqën në mënyra të ndryshme ta modernizonin e ta perëndimorizonin Rusinë, si dhe ta përforconin pushtetin autokratik. Të paktën deri nga vitet 1980 demokratizuesit në Rusi kanë qenë zakonisht perëndimorizues, por perëndimorizuesit nuk ishin demokratizues. Mësimi që del nga historia ruse është se përqendrimi i pushtetit është parakusht për reformën shoqërore dhe ekonomike. Nga fundi i viteve 1980 mbështetësit e Gorbaçovit ankoheshin, sepse nuk arritën ta vlerësonin këtë fakt, kur dënonin pengesat që kishte krijuar *glasnosti* për liberalizimin ekonomik.

Pjetri pati më shumë sukses për ta bërë Rusinë pjesë të Europës, sesa për ta bërë Europën pjesë të Rusisë. Në kundërshtim me Perandorinë Osmane, Perandoria Ruse u pranua si pjesëmarrëse kryesore dhe e ligjshme në sistemin ndërkombëtar evropian. Brenda vendit reformat e Pjetrit sollën disa ndryshime, por shoqëria e

tij mbeti hibride: me përjashtim të një elite të vogël; mënyrat, institucionet e besimet aziatike e bizantine mbisundonin në shoqërinë ruse dhe perceptoheshin si të tilla njësoj nga europianët e rusët. Siç ka vënë në dukje de Maistre, “Gërvishteni një rus dhe do të keni plagosur një tartar.” Pjetri krijoi një vend të përçarë dhe gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë sllavofilët e perëndimorizuesit së bashku ankoheshin për këtë gjendje fatkeqe dhe kishin mosmarrëveshje të forta, nëse duhej t’i jepnin fund duke u bërë tërësisht të europianizuar, apo duke i zhdukur ndikimet europiane e duke u kthyer te shpirti i vërtetë i Ruisë. Një perëndimorist si Çaadajevi arsyetonte se “dielli është dielli i Perëndimit” dhe Rusia duhet ta përdorë këtë dritë për të ndriçuar e për të ndryshuar institucionet e saj të trashëguara. Një sllavofil si Danilevskij, me fjalë të cilat u dëgjuan gjithashtu në vitet 1990, i denoncoi përpjekjet e europianizimit si “shtrembëruese të jetës së popullit dhe zëvendësuese të formave të saj me forma të huaja, të jashtme,” “duke huazuar institucione të huaja e duke i shpërngulur në truallin rus,” dhe “duke i parë si marrëdhëniet e brendshme e të jashtmet, ashtu edhe çështjet e jetës ruse nga një pikëpamje e huaj, europiane, duke i vështruar siç ishin përmes një prizmi të bërë me kënd përthyerjeje sipas mënyrës europiane.”¹⁹ Në historinë e mëvonshme të Ruisë Pjetri u bë heroi i perëndimorizuesve dhe djalli i kundërshtarëve të tyre, që në vitet 1920 përfaqësoheshin në mënyrë të skajshme prej euroaziatistëve, të cilët e dënuan si tradhtar dhe i përshëndetën bolshevikët për hedhjen poshtë të perëndimorizimit, për sfidën kundër Europës dhe kthimin e kryeqytetit përsëri në Moskë.

Revolucioni Bolshevik nisi një fazë të tretë marrëdhëniesh ndërmjet Ruisë e Perëndimit, krejt të ndryshme nga faza e dykuptimshme, që kishte vijuar për

dy shekuj. Ai krijoi një sistem politik-ekonomik, që nuk mund të ekzistonte në Perëndim, në emër të një ideologjie, e cila ishte krijuar në Perëndim. Sllavofilët dhe perëndimorizuesit ishin grindur, nëse Rusia mund të ishte e ndryshme nga Perëndimi pa qenë e prapambetur krahasuar me Perëndimin. Komunizmi e zgjidhi shkëlqyeshëm këtë çështje: Rusia ishte e ndryshme dhe themelisht e kundërvënë me Perëndimin, sepse ishte më e përparuar sesa Perëndimi. Ajo po merrte udhëheqjen e revolucionit proletar, i cili përfundimisht do të përhapej në mbarë botën. Rusia mishëronte jo të kaluarën e prapambetur aziatike, por të ardhmen e përparuar sovjetike. Në të vërtetë, Revolucioni ia bëri të mundur Rusisë ta kalonte kapërcimthi Perëndimin, duke u dalluar prej tij jo sepse “ju jeni të ndryshëm dhe ne nuk duam të bëhemi si ju,” siç shpreheshin sllavofilët, por sepse “ne jemi të ndryshëm dhe përfundimisht ju do të bëheni si ne,” dhe ky ishte mesazhi i Internacionales Komuniste.

E megjithatë, ndërkohë që komunizmi u dha mundësinë udhëheqësve sovjetikë të shquheshin prej Perëndimit, njëkohësisht krijoi edhe lidhje të fuqishme me Perëndimin. Marksi dhe Engelsi ishin gjermanë; përfaqësuesit kryesorë të pikëpamjeve të tyre nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit të njëzetë ishin europianë perëndimorë; aty nga viti 1910 shumë sindikata punëtorësh dhe parti laburiste e socialdemokrate në shoqëritë Perëndimore i ishin përkushtuar ideologjisë së tyre e po fitonin gjithnjë e më shumë ndikim në politikën europiane. Pas Revolucionit Bolshevik partitë e majta u ndanë në parti komuniste dhe parti socialiste, ndërsa që të dyja palët ishin shpesh forca të mëdha në vendet europiane. Nëpër pjesën më të madhe të Perëndimit perspektiva marksiste mori epërsinë: komunizmi e socializmi vështroheshin si vala e

së ardhmes dhe u përqafuan gjerësisht në ndonjë mënyrë nga elitat politike dhe intelektuale. Debati në Rusi ndërmjet sllavofilëve dhe perëndimorizuesve lidhur me të ardhmen e Rusisë u zëvendësua kështu nga debati në Europë ndërmjet të majtëve e të djathtëve lidhur me të ardhmen e Perëndimit dhe a e përbënte Bashkimi Sovjetik këtë të ardhme. Pas Luftës II Botërore fuqia e Bashkimit Sovjetik e shtoi forcën tërheqëse të komunizmit si në Perëndim, ashtu edhe më me peshë në ato qytetërime joperëndimore, që tashmë po reagonin kundër Perëndimit. Elitat në shoqëritë joperëndimore me mbizotërim Perëndimor, të cilat donin ta joshnin Perëndimin, flisnin me termat e vetëvendosjes e të demokracisë; ato që dëshironin të ballafaqoheshin me Perëndimin, i drejtoheshin revolucionit dhe çlirimit kombëtar.

Duke zbatuar ideologjinë Perëndimore dhe duke e përdorur për të sfiduar Perëndimin, në një farë kuptimi rusët u bënë më të afërt e të lidhur më ngushtë me Perëndimin, sesa kurdo qoftë më parë gjatë historisë së tyre. Ndonëse ideologjitë e demokracisë liberale dhe të komunizmit dalloheshin shumë, që të dyja palët, në një farë kuptimi, flisnin të njëjtën gjuhë. Shembja e komunizmit dhe e Bashkimit Sovjetik i dha fund këtij ndërveprimi politik-ideologjik ndërmjet Perëndimit e Rusisë. Perëndimi shpresonte e besonte se përfundimi do të dilte ngadhënjimi i demokracisë liberale në mbarë perandorinë e mëparshme sovjetike. Mirëpo kjo nuk ishte diçka e paracaktuar. Aty nga viti 1995 e ardhmja e demokracisë liberale në Rusi dhe në republikat e tjera ortodokse ishte e pasigurtë. Përveç kësaj, meqë rusët nuk mbanin më qëndrim marksist dhe nisën të silleshin si rusë, hendeku ndërmjet Rusisë e Perëndimit u thellua. Konflikti ndërmjet demokracisë liberale e marksizëm-leninizmit ishte ndërmjet ideologjive, të cilat me gjithë

dallimet e mëdha, ishin të dyja moderne e shekullare, kurse kishin dukshëm të përbashkëta qëllimet përfundimtare të lirisë, barazisë dhe mirëqenies materiale. Një demokrat Perëndimor mund të zhvillonte një debat intelektual me një marksist sovjetik. Do të kishte qenë e pamundur ta zhvillonte me një nacionalist ortodoks rus.

Gjatë viteve sovjetike lufta ndërmjet sllavofilëve dhe perëndimorizuesve ishte pezulluar, pasi si Solzhenicini edhe Saharovi i kundërviheshin sintezës komuniste. Me shembjen e kësaj sinteze, debati rreth identitetit të vërtetë të Ruisë u rishfaq me fuqi të plotë. A do t'i përvetësonte Rusia vlerat, institucionet e praktikat Perëndimore, dhe a do të përpiqej të bëhej pjesë e Perëndimit? Apo Rusia mishëronte një qytetërim të dalluar ortodoks dhe euroaziatik, të ndryshëm nga i Perëndimit dhe me fatin e veçantë që të lidhte Europën me Azinë? Elitat intelektuale e politike, si dhe publiku i përgjithshëm ishin të përçarë rëndë rreth këtyre pyetjeve. Nga njëra anë, ishin Perëndimorizuesit, “kozmpolitët” ose “atlantistët”, kurse nga ana tjetër, pasardhësit e sllavofilëve, që në mënyra të ndryshme quheshin “nacionalistë”, “euroaziatistë” ose “*derzhavniki*” (përkrahës të vendosur të shtetit).²⁰

Dallimet kryesore ndërmjet këtyre grupeve shfaqeshin lidhur me politikën e jashtme dhe në një shkallë më të vogël me reformën ekonomike e strukturën shtetërore. Mendimet shtriheshin përgjatë një vije të vazhduar që nga njëri skaj deri te tjetri. Te njëri skaj i spektrit tuboheshin ata, që shprehnin “mendimin e ri” të përqafuar prej Gorbaçovit dhe të përmbledhur në synimin e tij për “shtëpinë e përbashkët europiane”, si dhe nga shumë këshilltarë kryesorë të Jelcinit, që shprehej në dëshirën e tij për t'u bërë Rusia “një vend normal” dhe të pranohej si anëtar i tetë i klubit G-7 të

demokracive më të mëdha të industrializuara. Nacionalistët më të moderuar, si Sergej Stankeviçi, shpreheshin se Rusia duhej ta hidhte poshtë kursin “atlantist” dhe t’i jepte përparësi mbrojtjes së rusëve në vendet e tjera, të theksonte lidhjet turke e myslimane dhe të mbështeste “një rishpërndarje të vlefshme të burimeve tona, alternativave tona, lidhjeve tona dhe interesave tanë në të mirë të Azisë ose të drejtimit lindor.”²¹ Njerëzit me këto bindje e kritikonin Jelcinin, sepse ua nënshtropte interesave të Perëndimit interesat e Ruisë, se e pakësoi fuqinë ushtarake të Ruisë, se pësoi dështim e nuk i ndihmoi miqtë tradicionalë, si Serbia, dhe se e futi reformën politike e ekonomike në shtigje lënduese për popullin rus. Tregues i qartë i kësaj rryme ishte popullariteti i ri i ideve të Peter Savickit, i cili në vitet 1920 ishte shprehur që Rusia përbënte një qytetërim unikal.

Nacionalistët më të skajshëm ndaheshin ndërmjet nacionalistëve rusë, si Solzhenicini, që mbështeste një Rusi, në të cilën të përfshiheshin gjithë rusët plus bjellorusët e ukrainasit sllavë ortodoksë të lidhur ngushtë, por askush tjetër më, dhe nacionalistët perandorakë, si Vladimir Zhirinovski, i cili donte të ringjallte Perandorinë Sovjetike dhe fuqinë ushtarake ruse. Njerëzit e grupit të fundit nganjëherë ishin antisemitë e po aq antiperëndimorë, duke dashur që ta riorientonin politikën e jashtme ruse ndaj Lindjes e Jugut, ose duke vendosur sundimin mbi Jugun mysliman (siç e kërkonte Zhirinovski), ose duke bashkëpunuar me shtetet myslimane e Kinën kundër Perëndimit. Nacionalistët kërkonin gjithashtu një përkrahje më të fuqishme për serbët në luftën me myslimanët. Dallimet ndërmjet kozmopolitëve dhe nacionalistëve pasqyroheshin nga ana institucionale në pikëpamjet e ministrisë së jashtme e të ushtarakëve. Ato

pasqyroheshin gjithashtu në zhvendosjet e politikave të jashtme e të sigurisë të Jelcinit në fillim në një drejtim e pastaj në drejtim tjetër.

Publiku rus ishte i përçarë po ashtu si elitat ruse. Më 1992 vëzhgimi i një mostre prej 2069 rusësh europianë tregoi se 40 për qind e atyre që u përgjigjën ishin “të hapur ndaj Perëndimit”, 36 për qind “të mbyllur ndaj Perëndimit” dhe 24 për qind “të pavendosur”. Në zgjedhjet parlamentare të dhjetorit 1993 partitë reformiste fituan 34,2 për qind të votave, partitë antireformiste e nacionaliste 43,3 për qind dhe partitë e qendrës 13,7 për qind.²² Në mënyrë të ngjashme, në zgjedhjet për president të qershorit 1996 publiku rus u nda përsëri me afërsisht 43 për qind që mbështesnin kandidatin e Perëndimit, Jelcinin e kandidatët e tjerë për reforma, dhe 52 për qind që votuan për kandidatët komunistë e nacionalistë. Për çështjen qendrore të identitetit, në vitet 1990 Rusia mbetej qartas një vend i përçarë, me dyzimin perëndimor-sllavofil si “tipar i patjetërsueshëm i ...karakterit kombëtar.”²³

Turqia. Nëpërmjet një vargu reformash të llogaritura me kujdes në vitet 1920 e 1930, Mustafa Qemal Ataturku bëri një përpjekje për ta larguar popullin e tij prej së kaluarës osmane e myslimane. Parimet themelore ose “gjashtë shigjetat” e qemalizmit ishin populizmi, republikanizmi, nacionalizmi, shekullarizmi, etatizmi dhe reformizmi. Me hedhjen poshtë të idesë për një perandori shumëkombëshe, Qemali synonte të përfntonte një shtet komb homogjen, e gjatë procesit duke dëbuar e vrarë armenët e grekët. Pastaj rrëzoi sulltanin dhe ngriti një sistem republikan të autoritetit politik, të tipit Perëndimor. E shfuqizoi kalifatin, burimin qendror të autoritetit fetar, hoqi ministritë tradicionale të arsimit e fesë, i ndaloi shkollat e kolegjet e veçuara fetare, vendosi

një sistem të njësuar shekullar arsimit publik dhe i hoqi qafe gjyqet fetare, të cilat zbatonin të drejtën islamike, duke i zëvendësuar me sistemin e ri ligjor, të mbështetur në kodin civil zviceran. Ai e zëvendësoi gjithashtu kalendarin tradicional me kalendarin grigorian, kurse zyrtarisht e mënjanoi Islamën si fe shtetërore. Duke imituar Pjetrin e Madh, ndaloi përdorimin e festes, sepse ishte simbol i tradicionalizmit fetar, u jepte zemër njerëzve të mbanin kapele dhe dekretoi që turqishtja të shkruhej me alfabetin latin e jo me atë arab. Reforma e fundit pati rëndësi themelore. “Për brezat e rinj të arsimuar me shkrimin latin ajo në të vërtetë e bëri të pamundur që të shfrytëzonin masën e madhe të letërsisë tradicionale; kjo nxiste mësimin e gjuhëve europiane dhe e lehtësoi jashtë mase problemin e pakësimit të analfabetizmit.”²⁴ Pasi e ripërcaktoi identitetin kombëtar, politik, fetar dhe kulturor të turqve, Qemali në vitet 1930 u përpoq fuqishëm të nxiste zhvillimin ekonomik. Perëndimorizimi ecte në një hap me modernizimin dhe ishte mjeti i tij.

Turqia qëndroi asnjëherë gjatë luftës civile të Perëndimit ndërmjet viteve 1939 e 1945. Mirëpo pas kësaj lufte ajo eci me shpejtësi drejt njëjtësisimit me Perëndimin. Duke i ndjekur hapur modelet Perëndimore, ajo kaloi prej sundimit njëpartiak te sistemi me garë midis partish. Ajo i bëri përpjekjet dhe në të vërtetë arriti të anëtarësohej në NATO më 1952, duke e pohuar veten si pjesëtare të Botës së Lirë. Mori miliarda dollarë të ndihmës ekonomike e për sigurinë nga Perëndimi; forcat e saj ushtarake u stërvitën dhe u pajisën nga Perëndimi, duke u integruar në strukturat e komandimit të NATO-s; pranoi baza ushtarake amerikane. Turqia nisi të vështrohej nga Perëndimi si ledhi lindor i përballimit, që parandalonte zgjerimin e Bashkimit Sovjetik drejt Mesdheut, Lindjes së Mesme

dhe Gjirit Persik. Kjo lidhje dhe vetënjëjtësimi me Perëndimin shkaktuan që vendet joperëndimore, të paangazhuara, t'i denonconin turqit më 1955 në Konferencën e Bandungut dhe vendet islamike t'i sulmonin si besëshkalë.²⁵

Pas Luftës së ftohtë elita turke mbeti në pjesën dërrmuese mbështetëse e idesë që Turqia të ishte Perëndimore dhe europiane. Anëtarësia e qëndrueshme në NATO për ta është e domosdoshme, sepse i garanton një lidhje të ngushtë organizative me Perëndimin dhe është e domosdoshme si kundërpeshë me Greqinë. Mirëpo përfshirja e Turqisë në Perëndim, që mishërohet nga anëtarësia në NATO, ka qenë produkt i Luftës së ftohtë. Përfundimi i kësaj e hoqi arsyen kryesore për këtë përfshirje dhe shpie te dobësimi e ripërcaktimi i kësaj lidhjeje. Turqia nuk është më e dobishme për Perëndimin si ledh kundër kërcënimit kryesor nga veriu, por, siç ishte rasti i Luftës së Gjirit, përbën një partner të mundshëm në trajtimin e kërcënimeve më të vogla nga jugu. Në atë luftë Turqia dha një ndihmë vendimtare për koalicionin kundër Sadam Hyseinit, sepse mbylli naftësjellësit përmes territorit të vet, nëpër të cilët nafta e Irakut dilte në Mesdhe, dhe u lejoi avionëve amerikanë të vepronin kundër Irakut prej bazave në Turqi. Mirëpo këto vendime të presidentit Ozal nxitën kritika të rënda në Turqi dhe shkaktuan dorëheqjen e ministrit të punëve të jashtme, ministrit të mbrojtjes dhe shefit të shtabit të përgjithshëm, si dhe demonstrata të gjera publike si protesta kundër bashkëpunimit të ngushtë të Ozalit me Shtetet e Bashkuara. Më pas si presidenti Demirel, ashtu edhe kryeministrja Çiller kërkuan që të hiqeshin sa më parë sanksionet e OKB-së kundër Irakut, të cilat i vinin edhe Turqisë një barrë të rëndë ekonomike.²⁶ Vullneti i Turqisë për të punuar me Perëndimin në trajtimin e

kërcënimeve islamike nga jugu është më i pasigurtë, sesa ka qenë vullneti i saj të qëndronte përkrah Perëndimit kundër kërcënimit sovjetik. Gjatë krizës së Gjirit kundërshtimi i Gjermanisë, një mike tradicionale e Turqisë, për ta quajtur një sulm me raketa të Irakut kundër Turqisë si sulm mbi NATO-n, tregoi gjithashtu se Turqia mund të mos kishte shpresë për mbështetjen e Perëndimit kundrejt kërcënimeve nga jugu. Ballafaqimet e Luftës së ftohtë me Bashkimin Sovjetik nuk e shtronin çështjen e identitetit të qytetërimit të Turqisë; marrëdhëniet pas Luftës së ftohtë me vendet arabe e shtrojnë.

Duke nisur me vitet 1980 një synim parësor, ndoshta *parësori* i politikës së jashtme i elitës me orientim Perëndimor të Turqisë, ka qenë të arrinte anëtarësimin në Bashkimin Europian. Zyrtarisht Turqia paraqiti kërkesën për anëtarësim më 1987. Në dhjetor 1989 Turqisë iu tha se kërkesa e saj nuk do të shqyrtohej para vitit 1993. Më 1994 Bashkimi miratoi kërkesat e Austrisë, Finlandës, Suedisë e Norvegjisë dhe u shpreh gjerësisht parashikimi se në vitet e ardhshme veprime të përshtatshme do të ndërmerreshin për kërkesat e Sllovenisë, Sllovakisë e republikave të Baltikut. Turqit u zhgënjyen sidomos sepse përsëri Gjermania, anëtari më me ndikim i Bashkësisë Europiane, nuk i mbështeti gjallërisht kërkesat për anëtarësimin e saj e në vend të kësaj i dha përparësi përkrahjes së anëtarësimit të shteteve të Europës Qendrore.²⁷ Nën tryshninë e Shteteve të Bashkuara, Bashkimi zhvilloi bisedimet për bashkimin doganor me Turqinë, mirëpo anëtarësimi i plotë mbetet një mundësi e largët dhe e dyshimtë.

Përse u kapërcye Turqia dhe përse kurdoherë duket sikur ajo është në fund të radhës? Publikisht zyrtarët europianë e përliqjin me nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të Turqisë dhe me respektimin e të drejtave të

njeriut nga ana e saj më pak sesa vendet skandinave. Privatisht si europianët, edhe turqit pajtohen që arsyet e vërteta kanë qenë kundërshtimi i fortë i grekëve dhe, ajo që ka më shumë rëndësi, fakti se Turqia është vend mysliman. Vendet europiane nuk duan të përballen me mundësinë që t'ua hapin kufijtë emigrantëve nga një vend me 60 milion myslimanë dhe me papunësi të lartë. Është edhe më domethënëse, që ata e ndiejnë se Turqia kulturalisht nuk bën pjesë në Europë. Problemi i të drejtave të njeriut në Turqi, siç e ka thënë presidenti Ozal më 1992, është “një arsye e trilluar përse Turqia nuk duhet të hyjë në BE. Arsyeja e vërtetë është se ne jemi myslimanë dhe se ata janë të krishterë,” por ai ka shtuar që “ata nuk e thonë këtë.” Nga ana e tyre zyrtarët europianë pajtohen që Bashkimi është “një klub i krishterë” dhe se “Turqia është tepër e varfër, tepër e populluar, tepër myslimane, tepër e ashpër, tepër e ndryshme kulturalisht, tepër për gjithçka.” Siç e ka komentuar një vëzhgues, “ankthi privat” i europianëve është kujtesa historike e “sulmeve të saracenëve në Europën Perëndimore dhe e turqve në portat e Vjenës.” Këto qëndrime, nga ana e tyre, përftojnë “perceptimin e përbashkët mes turqve” se “Perëndimi nuk sheh të ketë ndonjë vend për një Turqi myslimane brenda Europës.”²⁸

Pasi e braktisi Mekën dhe pasi u braktis prej Brukselit, Turqia e rroku rastin që ia hapi shpërbërja e Bashkimit Sovjetik për t'ua kthyer me drejtim nga Tashkenti. Presidenti Ozal dhe udhëheqës të tjerë turq parashtruan vizionin e një bashkësie popujsh turq dhe bënë përpjekje të mëdha që të zhvillonin lidhjet me “turqit e jashtëm” në “shtetet e afërta kufitare”, që shtrihen “nga Adriatiku deri në kufijtë e Kinës.” Vëmendje e veçantë iu kushtua Azerbajxhanit dhe katër republikave turqishtfolëse të Azisë Qendrore:

Uzbekistanit, Turkmenistanit, Kazakistanit e Kirgizstanit. Më 1991 e 1992 Turqia ndërmoi një freskore të gjerë veprimtarish, me synimin të mbështeteshin lidhjet e ndikimi i saj në këto republika të reja. Këtu përfshiheshin 1,5 miliardë dollarë huash afatgjatë me interes të ulët, 79 milionë dollarë për ndihmë të drejtpërdrejtë, për televizionin satelitor (duke zëvendësuar një kanal rusisht), komunikimet telefonike, shërbimet ajrore, mijëra bursa për studentët që të studionin në Turqi dhe kualifikimin në Turqi të bankierëve, biznesmenëve, diplomatëve e qindra oficerëve ushtarakë nga Azia Qendrore dhe azerë. Në republikat e reja u dërguan mësues për të dhënë mësim turqishten dhe u ngritën rreth 2000 sipërmarrje të përbashkëta. Përbashkësia kulturore ua lehtësoi rrugën këtyre marrëdhënieve ekonomike. Siç e ka komentuar një biznesmen turk, “Gjëja më e rëndësishme për suksesin në Azerbajxhan ose në Turkmenistan është të gjendet partneri i përshtatshëm. Për turqit kjo nuk është e vështirë. Ne kemi të njëjtën kulturë, pak a shumë të njëjtën gjuhë dhe hamë nga i njëjti tip kuzhine.”²⁹

Riorientimi i Turqisë drejt Kaukazit e Azisë Qendrore u ushqye jo vetëm nga ëndrra për t’u bërë udhëheqëse e një bashkësie turkashe të shteteve, por edhe nga dëshira për t’u kundërvënë Iranit e Arabisë Saudite, që kërkonin ta zgjeronin ndikimin e vet dhe të përhapnin fundamentalizmin islamik në këtë rajon. Turqit e shihnin veten se jepnin si zgjidhje alternative “modelin turk” ose “idenë e Turqisë”, të një shteti shekullar, demokratik, mysliman me ekonomi tregu. Përveç kësaj, Turqia shpresonte të përmbante ringjalljen e ndikimit rus. Duke dhënë një zgjidhje alternative kundrejt Rusisë e Islamit, Turqia gjithashtu do të mbështeste mëtimin e vet për të marrë përkrahje dhe

përfundimisht për t'u bërë anëtare e Bashkimit Europian.

Vrulli fillestar i Turqisë në veprimtarinë me republikat turkashe u bë më i përmbajtur më 1993 për shkak të caqeve të burimeve të veta, pas ardhjes së Sulejman Demirelit si president me vdekjen e Ozalit dhe nga ripohimi i ndikimit rus në ato që quhen "shtetet rrethuese kufitare." Kur republikat turkashe të mëparshme sovjetike fituan në fillim pavarësinë, udhëheqësit e tyre vërshuan në Ankara për t'i bërë qejfin Turqisë. Më pas, kur Rusia ushtroi trysni dhe përdori joshjet, ata u tërhoqën e përgjithësisht e vunë theksin te nevoja për marrëdhënie "të baraspeshuara" ndërmjet kushëririt kulturor dhe zotit të tyre të mëparshëm perandorak. Mirëpo turqit vijuan përpjekjet për ta përdorur farsifisninë kulturore, që të zgjeronin lidhjet ekonomike e politike, si dhe bënë veprimin më të rëndësishëm, siguruan me qeveritë e me kompanitë e naftës me peshë marrëveshje për ndërtimin e një naftësjellësi, që nga Azia Qendrore dhe Azerbajxhani nafta të kalonte përmes Turqisë për të dalë në Mesdhe.³⁰

Ndërsa Turqia po punonte për t'i zgjeruar lidhjet me republikat turkashe të mëparshme sovjetike, identiteti shekullar qemalist i asaj vetë u sfidua brenda vendit. Së pari, për Turqinë, ashtu si për shumë vende të tjera, përfundimi i Luftës së ftohtë së bashku me zhvendosjet që përftuan zhvillimi shoqëror e ekonomik, ngritën problemet e mëdha të "identitetit kombëtar e të identifikimit etnik,"³¹ dhe feja ishte aty e gatshme për të dhënë një përgjigje. Trashëgimia shekullore e Ataturkut dhe e elitës turke për dy të tretat e një shekulli ra nën një zjarr gjithnjë e më të fortë. Përvoja e turqve jashtë vendit pati prirje që t'i nxiste ndjenjat islamiste brenda vendit. Turqit që ktheheshin nga Gjermania Perëndimore "reagonin ndaj armiqësisë që kishin ndier atje, duke u

rikthyer te ajo që ishte e njohur për ta. E ky ishte Islami.” Mendimi dhe praktika e rrymës kryesore u bënë gjithnjë e më islamiste. Sipas njoftimeve më 1993 “mjekrat e stilit islamist dhe gratë e mbuluara janë përhapur gjerësisht në Turqi, xhamitë po tërheqin turma përherë e më të mëdha dhe disa librari janë përmbytur nga librat, revistat, kasetat, disqet kompakte dhe videot që ngrenë lart historinë, rregullat e mënyrën e jetesës islamike, si dhe lavdërojnë rolin e Perandorisë Osmane për ruajtjen e vlerave të profetit Muhamed.” Sipas njoftimeve, “jo më pak se 290 shtëpi botuese dhe shtypshkronja, 300 botime e ndër to dy gazeta të përditshme, disa qindra radiostacione pa leje dhe afër 30 kanale televizive po ashtu pa leje propagandojnë që të gjitha ideologjinë islamike.”³²

Duke u ndodhur përballë shtimit të ndjenjave islamiste, udhëheqësit e Turqisë u përpoqën të zbatonin praktika fundamentaliste dhe të tërhiqnin nga ana e tyre mbështetjen e fundamentalistëve. Në vitet 1980 e 1990 qeveria turke, që mendohet se është shekullare, mbajti një Zyrë të çështjeve fetare me buxhet më të madh sesa i disa ministrive, financoi ndërtimin e xhamive, kërkoi mësimet fetare në të gjitha shkollat publike dhe dha fonde për shkollat islamike, që u pesëfishuan si numër gjatë viteve 1980, duke përfshirë rreth 15 për qind të fëmijëve të shkollës së mesme, të cilat ndërkohë predikonin doktrina islamiste e nxorën mijëra të diplomuar, madje shumica e tyre hynë në shërbimet qeveritare. Në kontrast simbolik por dramatik me Francën, qeveria i lejoi në praktikë nxënëset e shkollave të mbanin shaminë tradicionale myslimane të kokës, shtatëdhjetë vjet pasi Ataturku e kishte ndaluar festen.³³ Këto veprime qeveritare, në pjesën më të madhe të përligjura me dëshirën që të mos frynte era në dobi të

velave të islamistëve, dëshmojnë sesa e fuqishme qe ajo erë në vitet 1980 e në fillim të viteve 1990.

E dyta, ringjallja e Islamit ia ndryshoi natyrën politikës turke. Udhëheqësit politikë, e sidomos Turgut Ozali, e njëjtësonin fare hapur veten me simbolet e politikat myslimane. Në Turqi, ashtu si dhe gjetkë, demokracia e përforcoi indigjenizimin dhe kthimin te feja. “Me zellin për të fituar përkrahjen e publikut dhe votat, politikanët e madje ushtarakët, kështjella dhe roja e shekullarizmit, u detyruan të merrnin para sysh aspiratat fetare të popullsisë: jo pak prej lëshimeve që bënë, kërcisnin nga demagogjia.” Lëvizjet popullore kishin anime fetare. Ndërsa elita dhe grupet burokratike, sidomos ushtarakët, kishin orientim shekullar, ndjenjat islamiste u shfaqën brenda vetë forcave të armatosura, kurse disa qindra kadetë u pastruan prej akademive ushtarake më 1987, mbasi dyshoheshin që kishin ndjenja islamiste. Partitë kryesore politike gjithnjë e më shumë e ndienin nevojën për të kërkuar mbështetje elektorale nga *tarikatet* e ringjallura myslimane, ose nga shoqëritë e zgjedhura, që i kishte ndaluar Ataturku.³⁴ Në zgjedhjet vendore të marsit 1994 Partia e Mirëqenies fundamentaliste, e vetmja ndër pesë partitë kryesore, e shtoi përpjesën e votave dhe mori afër 19 për qind të votave, krahasuar me 21 për qind për Partinë e Rrugës së Vërtetë të kryeministres Çiller dhe 20 për qind të Partisë së Mëmëdheut të të ndjerit Ozal. Partia e Mirëqenies shtiu në dorë dy qytetet kryesore të Turqisë, Stambollin e Ankaranë, si dhe doli mjaft e fuqishme në pjesën juglindore të vendit. Në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1995 Partia e Mirëqenies fitoi më shumë vota e vende në parlament sesa cilado parti tjetër, kurse gjashtë muaj më vonë mori në duar qeverinë në koalicion me njëjërën nga partitë shekullare. Ashtu si dhe në vendet e tjera, mbështetja për fundamentalistët erdhi nga

emigrantët e rinj të kthyer, nga “të shtypurit e të shpronësuarit” dhe nga “ardhësit e rinj të qyteteve, ‘sans culottes’ e qyteteve të mëdha.”³⁵

E treta, ringjallja e Islamit preku politikën e jashtme të Turqisë. Nën udhëheqjen e presidentit Ozal, Turqia mbajti vendosmërisht anën e Perëndimit në Luftën e Gjirit, duke parashikuar se ky veprim do ta ndihmonte anëtarësimin në Bashkësinë Europiane. Mirëpo ky rrjedhim nuk ndodhi konkretisht, kurse lëkundja e NATO-s se çfarë përgjigjeje do të jepej, në rast se Turqia do të sulmohej nga Iraku gjatë asaj lufte, nuk u dha siguri turqve, sesi do të përgjigjej NATO-ja kundrejt një kërcënimi për vendin e tyre jo nga rusët.³⁶ Udhëheqësit turq u përpoqën ta zgjeronin lidhjen ushtarake me Izraelin, çka ngjalli kritika të forta nga islamistët turq. Më e rëndësishme është se gjatë viteve 1980 Turqia i zgjeroi marrëdhëniet me vendet e tjera arabe e myslimane e në vitet 1990 i përkrahu gjallërisht interesat islamikë, duke u dhënë mbështetje të ndjeshme myslimanëve bosnjakë e gjithashtu Azerbajxhanit. Lidhur me Ballkanin, Azinë Qendrore ose Lindjen e Mesme, politika e jashtme e Turqisë u bë gjithnjë e më e islamizuar.

Për shumë vjet Turqia plotësonte dy nga tri kërkesat minimale për një vend të përcarë që të ndryshonte identitetin qytetërimor. Elitat e Turqisë në mënyrë dërrmuese e mbështetën këtë lëvizje dhe publiku e pranonte heshturazi. Mirëpo elitat e marrësit, domethënë qytetërimin Perëndimor, nuk dhanë shenja pranimi. Ndërkohë që çështja mbetej pezull mbi peshore, ringjallja e Islamit brenda Ruisë i gjallëroi ndjenjat antiperëndimore mes publikut dhe nisi të minonte orientimin shekullarist, properëndimor të elitave turke. Pengesat që Turqia të mos bëhej plotësisht europiane, caqet e aftësisë së saj për të luajtur rol

mbizotërues kundrejt republikave turkashe të mëparshme sovjetike dhe ngritja e prirjeve islamike që e dobësuan trashëgiminë e Ataturkut, që të gjitha dukej se siguronin që Turqia do të mbetej vend i përcarë.

Duke pasqyruar këto shtysa në konflikt, udhëheqësit turq e kanë përcaktuar rregullisht vendin e tyre si një “urë” ndërmjet kulturave. Siç e ka shprehur kryeministrja Tansu Çiller më 1993, Turqia është njëkohësisht një “demokraci Perëndimore” dhe “pjesë e Lindjes së Mesme”, si dhe “shërben si urë e dy qytetërimeve, fizikisht e filozofikisht.” Duke pasqyruar këtë gjendje të dykuptimtë, Çilleri në publikun e vendit të vet shpesh është shfaqur si myslimane, por kur i është drejtuar NATO-s ka thënë se “është fakt gjeografik e politik që Turqia është një vend european.” Po ashtu presidenti Sulejman Demirel e ka quajtur Turqinë “një urë mjaft të rëndësishme në një rajon që shtrihet nga perëndimi në lindje, domethënë prej Europës në Kinë.”³⁷ Mirëpo një urë është një ndërtim artificial, që lidh dy tërësi solide, por nuk është pjesë e asnjërës. Kur udhëheqësit e Turqisë e quajnë vendin e tyre urë, në mënyrë eufemistike e pohojnë se është e përcarë.

Meksika. Turqia u bë vend i përcarë në vitet 1920, kurse Meksika nuk ishte deri në vitet 1980. Megjithatë, marrëdhëniet historike me Perëndimin kanë disa ngjashmëri. Ashtu si Turqia, Meksika kishte një kulturë të dalluar joperëndimore. Madje edhe në shekullin e njëzetë, siç e ka shprehur Oktavio Pazi, “bërthama e Meksikës është indiane. Nuk është europiane.”³⁸ Në shekullin e nëntëmbëdhjetë Meksika, ashtu si Perandoria Osmane, u copëtua nga duart e Perëndimit. Në dhjetëvjeçarin e dytë e të tretë të shekullit të njëzetë Meksika, ashtu si Turqia, kaloi nëpër një revolucion, i cili hodhi një bazë të re të identitetit kombëtar dhe një

sistemi të ri politik njëpartiak. Mirëpo në Turqi revolucioni përfshinte si flakjen e kulturës islamike e osmane, ashtu dhe përpjekjen për të importuar kulturën Perëndimore e për të hyrë në Perëndim. Në Meksikë, ashtu si në Rusi, revolucioni përfshinte përthithjen dhe përshtatjen e elementëve të kulturës Perëndimore, që përftonin një nacionalizëm të ri, të kundërvënë kapitalizmit e demokracisë së Perëndimit. Kështu për gjashtëdhjetë vjet Turqia u përpoq ta përcaktonte veten si europiane, ndërsa Meksika u përpoq ta përcaktonte veten në kundërvënie me Shtetet e Bashkuara. Që nga vitet 1930 e deri në vitet 1980 udhëheqësit e Meksikës ndoqën politika ekonomike e të jashtme, që i sfidonin interesat amerikanë.

Në vitet 1980 kjo gjendje ndryshoi. Presidenti Miguel de la Madrid e nisi dhe pasardhësi i tij, presidenti Karlos Salinas de Gortari, e çoi përpara ripërcaktimin në përmasa të plota të qëllimeve, praktikave dhe identitetit meksikan, si përpjekja më e fuqishme për ndryshim që nga Revolucioni i vitit 1910. Në të vërtetë Salinasi u bë Mustafa Qemali i Meksikës. Ataturku nxiti shekullarizmin e nacionalizmin, si temat mbizotëruese në Perëndimin e kohës së tij (tjetrën, atë të demokracisë politike, nuk e përqafoi). Ashtu si me Ataturkun, këto pikëpamje i kishin gjerësisht të përbashkëta elitat politike dhe ekonomike, shumë pjesëtarë të të cilave, ashtu si Salinasi dhe de la Madridi, ishin arsimuar në Shtetet e Bashkuara. Salinasi arriti një ulje të thellë të inflacionit, privatizoi një numër të madh ndërmarrjesh publike, nxiti investimet e huaja, pakësoi tarifën dhe subvencionimet, e ristrukturoi borxhin e jashtëm, iu kundërvu fuqisë së sindikatave, shtoi rendimentin dhe bëri që Meksika të hynte në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Amerikës Veriore me Shtetet e Bashkuara dhe Kanadanë. Ashtu si reformat e Ataturkut synonin ta shndërronin Turqinë

nga një vend mysliman i Lindjes së Mesme në një vend shekullar european, edhe reformat e Salinasit synonin ta ndryshonin Meksikën nga një vend i Amerikës Latine në një vend të Amerikës Veriore.

Kjo qe një zgjedhje e pashmangshme për Meksikën. Mund të përfytyrohet që elitat meksikane do ta kishin vazhduar rrugën nacionaliste e proteksioniste të Botës së Tretë kundër SHBA, të cilën paraardhësit e tyre e kishin ndjekur për më shumë se një shekull. Nga ana tjetër, ashtu siç kërkonin disa meksikanë, ata mund të kishin bërë përpjekje për të ngritur një shoqatë shtetesh iberike me Spanjën, Portugalinë dhe vendet e Amerikës Jugore.

A do të dalë me sukses Meksika në këtë tentativë drejt Amerikës së Veriut? Pjesa dërmuese e elitave intelektuale, politike e ekonomike janë në të mirë të këtij kursi. Gjithashtu, ndryshe nga gjendja në Turqi, pjesa dërmuese e elitave intelektuale, politike dhe ekonomike të qytetërimit marrës kanë qenë në të mirë të rirreshtimit kulturor të Meksikës. Këtë dallim e nxjerr në pah çështja thelbësore ndërqytetërimore e imigrimit. Frika nga imigrimi masiv i turqve përftoi kundërshtimin si nga elita edhe nga publiku european për ta përfshirë Turqinë në Europë. Përkundrazi, fakti i imigrimit masiv për në Shtetet e Bashkuara të meksikanëve, të ligjshëm e të paligjshëm, bënte pjesë në mbështetjen e Salinës për NAFTA-n: “Ose do të pranoni mallrat tona, ose do të pranoni njerëzit tanë.” Përveç kësaj, largësia kulturore ndërmjet Meksikës e Shteteve të Bashkuara është shumë më e vogël sesa ndërmjet Turqisë e Europës. Feja e Meksikës është katolicizmi, gjuha e saj është spanjishtja, elitat e saj historikisht kanë qenë të orientuara nga Europa (ku i dërgonin fëmijët për t’u shkolluar) dhe në kohët më të fundit nga Shtetet e Bashkuara (ku i dërgojnë sot fëmijët e tyre). Përshtatja ndërmjet Amerikës Veriore anglo-amerikane dhe Meksikës

spanjollo-indiane duhet të jetë ndjeshëm më e lehtë, sesa ndërmjet Europës së krishterë dhe Turqisë myslimane. Pavarësisht nga këto përbashkësi, pas ratifikimit të NAFTA-s, u shtua në Shtetet e Bashkuara kundërshtimi ndaj cilësdo ndërthurje më të ngushtë me Meksikën dhe u shfaqën kërkesat për të kufizuar imigrimin, ankesat për fabrikat që zhvendoseshin drejt jugut dhe çështjet lidhur me aftësinë e Meksikës për të pranuar konceptet amerikanoveriore të lirisë e të shtetit ligjor.³⁹

Parakushti i tretë për zhvendosjen me sukses të identitetit nga një vend i përçarë është pranimi, ndonëse jo detyrimsht mbështetja, nga publiku i tij. Rëndësia e këtij faktori varet, në një farë mase, nga shkalla sesa pikëpamjet e publikut kanë peshë në proceset e vendimmarrjes së vendit. Qëndrimi properëndimor i Meksikës, deri më 1995, nuk ka qenë provuar nëpërmjet demokratizimit. Revolta e ditës së Vitit të Ri e disa mijëra gueriljeve të organizuara mirë dhe me mbështetje nga jashtë në Çiapas nuk qe në vetvete ndonjë tregues i kundërshtimit të ndjeshëm ndaj amerikanizimit verior. Mirëpo përgjigjja me simpati që përftoi ndërmjet intelektualëve, gazetarëve dhe formësuesve të tjerë meksikanë të opinionit publik, bënte të mendohej se amerikanizimi verior përgjithësisht dhe NAFTA në veçanti mund të ndeshnin kundërshtim në rritje nga ana e elitave dhe e publikut meksikan. Presidenti Salinas me vetëdije të plotë përparësinë ua dha reformës ekonomike e perëndimorizimit kundrejt reformës politike e demokratizimit. Si zhvillimi ekonomik, ashtu edhe bashkëveprimi në rritje me Shtetet e Bashkuara, megjithatë, do t'i fuqizojnë forcat që përkrahin një demokratizim të vërtetë për sistemin politik meksikan. Çështja kyç për të ardhmen e Meksikës është: në çfarë përmase modernizimi dhe demokratizimi e ushqejnë shperëndimorizimin, duke shkaktuar tërheqjen ose

dobësimin e fortë të NAFTA-s dhe ndryshimet paralele në politikat, që i janë imponuar Meksikës nga elitat e saj me orientim Perëndimor të viteve 1980 e 1990? A është amerikanizimi verior i Meksikës i pajtueshëm me demokratizimin e saj?

Australia. Ndryshe nga Rusia, Turqia dhe Meksika, qysh në zanafillë Australia ka qenë shoqëri Perëndimore. Gjatë gjithë shekullit të njëzetë ka qenë në aleancë të ngushtë së pari me Britaninë e më pas me Shtetet e Bashkuara, kurse gjatë Luftës së ftohtë jo vetëm ishte anëtare e Perëndimit, por edhe e bërthamës ushtarake të Perëndimit e të zbulimit SHBA-MB-Kanada. Mirëpo nga fillimi i viteve 1990 udhëheqësit politikë të Australisë vendosën, në të vërtetë, që Australia duhej të largohej prej Perëndimit, ta ripërcaktonte veten si shoqëri aziatike dhe të ndërtonte lidhje të ngushta me fqinjët e vet gjeografikë. Kryeministri Paul Keating (Pol Kiting) ka deklaruar, se Australia duhet të pushojë së qeni një “zyrë dege e perandorisë”, të bëhet republikë dhe të synojë “ndërthurjen” në Azi. Ai argumentonte se kjo ishte e nevojshme me qëllim që të ngulitej identiteti i Australisë si vend i pavarur. “Australia nuk mund ta përfaqësojë vetveten para botës si shoqëri shumëkulturore, të ndërlidhet me Azinë, ta bëjë këtë lidhje dhe të jetë bindëse, nëse në një farë mënyre, ose të paktën nga pikëpamja kushtetuese, do të mbetet shoqëri e prejardhur.” Kitingu ka deklaruar se Australia ka vuajtur prej vitesh të pashprehura nga “anglofilia e memecëria” dhe shoqërimi i vazhduar me Britaninë do të ishte “dëmtues për kulturën tonë kombëtare, të ardhmen tonë ekonomike dhe fatin tonë në Azi e në Paqësor.” Ministri i jashtëm Gareth Evans (Garet Ivans) ka shprehur ndjenja të ngjashme.⁴⁰

Rasti i ripërcaktimit të Australisë si vend aziatik mbështetëj në hamendësimin se ekonomia e shkel ekonominë, kur i jep trajtë fatit të shteteve. Shtysa qendrore ka qenë rritja dinamike e ekonomive të Azisë Lindore, që nga ana e vet i dha nxitje zgjerimit të shpejtë të tregtisë së Australisë me Azinë. Më 1971 Azia Lindore dhe Juglindore thithën 39 për qind të eksporteve të Australisë dhe dhanë 21 për qind të importeve të Australisë. Nga viti 1994 Azia Lindore e Juglindore merrnin 62 për qind të eksporteve të Australisë dhe i jepnin 41 për qind të importeve të saj. Përkundrazi, 11,8 për qind të eksporteve të Australisë më 1991 shkonin në Bashkësinë Europiane dhe 10,1 për qind në Shtetet e Bashkuara. Kjo lidhje duke u thelluar me Azinë, u përforcua në mendjet e australianëve nga besimi, se bota po lëvizte në drejtimin e tre blloqeve kryesore ekonomike dhe se vendi i Australisë ishte në bllokun e Azisë Lindore.

Në kundërshtim me këto lidhje ekonomike, kjo bëmë aziatike australiane duket se nuk ka gjasa të plotësojë asnjë prej kërkesave që të ketë sukses zhvendosja kulturore e një vendi të përçarë. Së pari, në mes të viteve 1990 elitat e Australisë përgjithësisht nuk ishin aspak entuziaste lidhur me këtë kurs. Në një farë mase kjo ishte një çështje partiake e atyre udhëheqësve të Partisë Liberale në mëdyshje ose që kundërshtonin. Edhe qeveria laburiste hëngri kritika të forta nga një varg intelektualësh e gazetarësh. Nuk kishte asnjë pajtim të qartë të elitës për të zgjedhur në të mirë të Azisë. E dyta, opinionin publik ishte i dyzuar. Nga viti 1987 deri më 1993 përpjesa e publikut australian që përkrahte heqjen e monarkisë u rrit nga 21 për qind në 46 për qind. Mirëpo në këtë pikë mbështetja nisi të lëkundej e të dobësohej. Përpjesa e publikut që mbështeste heqjen e shenjave të flamurit britanik nga flamuri i Australisë ra

nga 42 për qind në maj 1992 te 35 për qind në gusht 1993. Siç ka vënë re një zyrtar australian më 1992, “Është e vështirë për publikun ta honepsë këtë. Kur unë them herë pas here se Australia duhet të jetë pjesë e Azisë, nuk ua tregoj dot sesa letra me urrejtje marr.”⁴¹

E treta dhe më e rëndësishmja, elitat e vendeve aziatike kanë qenë edhe më pak pranuese për propozimet e Australisë, sesa kanë qenë elitat europiane për Turqinë. Ato e kanë bërë të qartë që, nëse Australia dëshiron të bëhet pjesë e Azisë, duhet të bëhet vërtet aziatike, gjë që ata e mendojnë si me pak gjasa, në mos fare të pamundur. “Suksesi i integritit të Australisë me Azinë,” ka thënë një zyrtar indonezian, “varet prej një gjëje: sa e mirëpresin synimin e Australisë. Pranimi i Australisë në Azi varet nga shkalla sesa mirë qeveria dhe populli i Australisë e kuptojnë shoqërinë e kulturën aziatike.” Aziatikët shohin një hendek ndërmjet retorikës aziatike të Australisë dhe realitetit të saj anasjelltas Perëndimor. Sipas një diplomati australian, ngulmimin e Australisë se është aziatike taitë e trajtojnë me “tolerancë të habitur.”⁴² “[K]ulturalisht Australia ende është europiane,” ka deklaruar kryeministri i Malajzisë Mahathir në tetor 1994, “...ne mendojmë se është europiane,” e rrjedhimisht, Australia nuk duhet të jetë anëtare e Grupit Ekonomik të Azisë Lindore. Ne, aziatikët “jemi më pak të prirur të bëjmë kritikë të hapur për vendet e tjera, ose të japim gjykime për to. Por Australia, duke qenë kulturalisht europiane, e ndien se ka të drejtë t’u thotë të tjerëve çfarë të bëjnë, çfarë të mos bëjnë, çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar. E pastaj, natyrisht, ajo nuk përshtatet me grupin. Kjo është arsyeja ime [për të kundërshtuar anëtarësimin në EAEC]. Nuk është puna te ngjyra e lëkurës, por te kultura.”⁴³ Shkurt, aziatikët janë të vendosur për të mos e qasur Australinë në klubin e tyre për të njëjtën arsye,

që europianët veprojnë me Turqinë: ata dallohen prej nesh. Kryeministrit Kiting i pëlqente të thoshte, se kishte ndër mend ta ndryshonte Australinë nga “njeriu i çuditshëm jashtë te njeriu i çuditshëm brenda” në Azi. Mirëpo ky është një oksimoron: ai që është i çuditshëm nuk hyn në të zakonshmit.

Siç ka pohuar Magathiri, kultura dhe vlerat janë pengesa themelore për Australinë që të hyjë në Azi. Ndodhin vazhdimisht përplasje lidhur me përkushtimin e australianëve ndaj demokracisë, të drejtave të njeriut, shtypit të lirë dhe protestave të saj kundër shkeljes së atyre të drejtave prej qeverive praktikisht të gjithë fqinjëve të saj. “Problemi i vërtetë për Australinë në rajon,” ka vënë në dukje një diplomat i lartë australian, “nuk është flamuri ynë, por vlerat shoqërore rrënjësore. Kam dyshim se zor të gjeni australianë, të cilët të jenë të gatshëm të heqin dorë nga ato vlera për t’u pranuar në rajon.”⁴⁴ Dallimet e karakterit, stilit dhe sjelljes gjithashtu janë të dukshme. Siç e ka parashtuar Mahathiri, përgjithësisht aziatikët i ndjekin synimet e tyre kundrejt të tjerëve në mënyra që janë të brishta, të tërthorta, të përpunuara, të përdredhura, pa dhënë gjykime, pa moralizime dhe pa ballafaqime. Australianët përkundrazi, janë njerëzit më të drejtpërdrejtë, të pagdhendur, hapur të shprehur, e disa do të thoshin të pandjeshëm në botën që flet anglisht. Kjo përplasje e kulturave ka qenë më dramatikisht e dukshme në vetë marrëdhëniet e Pol Kitingut me aziatikët. Kitingu i mishëronte karakteristikat kombëtare të australianëve në shfaqjen e skajshme. Atë e kanë paraqitur si “politikanin e tipit të batipalit”, me një stil që është “brendësisht provokues e grindavec,” dhe ai nuk ka ngurruar që t’i denonconte kundërshtarët politikë si “batakçinj”, “dylberë të parfumuar plakash” dhe “kriminelë trushkullur e të lojtur.”⁴⁵ Ndërsa argumentonte që

Australia duhej të ishte Aziatike, Kitingu rregullisht i ka acaruar, tronditur dhe kundërshtuar prerazi udhëheqësit aziatikë me çiltërinë e vet brutale. Hendeku ndërmjet kulturave ka qenë aq i thellë, sa e ka verbuar përkrahësin e konvergimit kulturor në atë masë, që sjellja e tij i neveriste ata, të cilët ai mëtonte se i kishte vëllezër nga kultura.

Zgjedhja e Kitingut dhe Ivansit mund të shihet si rrjedhoja dritëshkurtër e mbivlerësimit të faktorëve ekonomikë dhe e shpërfilljes e jo përtëritjes së kulturës së vendit, si dhe një marifet politik taktike për të larguar vëmendjen nga problemet ekonomike të Australisë. Anasjelltas, mund të vështrohet si nismë largpamëse, me synimin për ta bërë Australinë të hyjë dhe të njëjtësohet me qendrat në ngritje të fuqisë ekonomike, politike e përfundimisht ushtarake në Azinë Lindore. Nga kjo pikëpamje, Australia mund të ishte i pari nga shumë vende të tjera të mundshme Perëndimore, që përpiqen të braktisin Perëndimin dhe të ngjiten pas qytetërimeve joperëndimore në ngritje. Në fillim të shekullit të njëzetedytë, historianët mund t'i kthejnë prapa sytë për ta parë zgjedhjen Kiting-Ivans si treguesin kryesor të rënies së Perëndimit. Mirëpo nëse ndiqet kjo rrugëzgjdhje, ajo nuk do ta zhdukë trashëgiminë Perëndimore të Australisë dhe “vendi i lumtur” do të jetë përherë vend i përçarë, njëkohësisht “zyrë dege e perandorisë” siç e ka përgojuar Pol Kitingu, ashtu edhe “byku i ri i bardhë i Azisë”, siç e ka emërtuar me përbuzje Li Kuan Jiu.⁴⁶

Ky nuk ka qenë dhe nuk është fati i pashmangshëm i Australisë. Udhëheqësit e Australisë, duke e pranuar dëshirën për t'u shkëputur nga Britania, në vend që ta përcaktojnë Australinë si fuqi aziatike, mund ta përcaktonin si vend i Paqësorit, ashtu si ishte përpjekur ta bënte në të vërtetë kryeministri paraardhës i Kitingut,

Robert Hawke (Houk). Nëse Australia dëshiron ta bëjë veten një republikë të ndarë prej Kurorës britanike, mund ta lidhte veten me të parin vend në botë që e ka bërë diçka të tillë, një vend që po ashtu si Australia është me prejardhje britanike, është vend emigrantësh, ka përmasa kontinentale, flet anglisht, ka qenë aleat në tri luftëra dhe ka popullsi në pjesën dërrmuese europiane, ndonëse po ashtu si Australia po i bëhet gjithnjë e më shumë aziatike. Nga ana kulturore, vlerat e Deklaratës së Pavarësisë të 4 korrikut 1776 pajtohen shumë më tepër me vlerat australiane, sesa me të cilitdo vend aziatik. Nga ana ekonomike, në vend që të bëhen përpjekje për hapur rrugën drejt një grupi shoqërisht, kundrejt të cilave është kulturalisht e huaj, dhe që për këtë arsye nuk e pranojnë, udhëheqësit e Australisë mund të propozonin zgjerimin e NAFTA-s për ta kthyer në marrëveshje Amerikanoveriore-Paqësorojugore (NASP), ku të përfshiheshin Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Australia dhe Zelanda e Re. Një grupim i tillë do ta përputhte kulturën me ekonominë dhe do të jepte Australisë një identitet solid e të qëndrueshëm, i cili nuk do të rridhte prej përpjekjesh të kota që Australia të bëhej aziatike.

Virusi Perëndimor dhe skizofrenia kulturore. Ndërsa udhëheqësit e Australisë i hynë udhës së kërkimit për në Azi, vendet e tjera të përçara: Turqia, Meksika, Rusia, u përpoqën ta përfshinin Perëndimin në shoqëritë e tyre dhe t'i përfshinin shoqëritë e tyre në Perëndim. Mirëpo përvoja e tyre tregon ngulmueshëm fuqinë, elasticitetin dhe veshtullinë e kulturave vendëse, si dhe aftësinë e tyre për ta përtërirë veten e për t'u bërë qëndresë, për t'i përmbajtur e për t'i përshtatur importet nga Perëndimi. Ndërsa përgjigjja duke e hedhur poshtë Perëndimin është e pamundur, përgjigjja qemaliste ka qenë e pasuksesshme. Nëse shoqëritë joperëndimore duhet të

modernizohen, ato duhet ta bëjnë këtë në mënyrën e vet dhe jo në mënyrën Perëndimore, si dhe të mbështeten e të shfrytëzojnë traditat, institucionet e vlerat e veta, duke imituar Japoninë.

Udhëheqësit politikë, të ushqyer me mendjemadhësinë, e cila i bën të kujtojnë se mund të riformësojnë rrënjësisht kulturën e vendeve të tyre, janë të paracaktuar të dështojnë. Ndërsa mund të fusin elementë të kulturës Pëerëndimore, ata nuk janë në gjendje të shtypin ose të zhdukin përfundimisht elementët bërthamë të kulturës së tyre vendëse. Anasjelltas, virusi Perëndimor, pasi zë vend në një shoqëri tjetër, është e vështirë të shkulet. Virus i mbetet, por nuk është vdekjeprurës; i sëmuri mbijeton, por asnjëherë nuk është i plotë. Udhëheqësit politikë mund ta bëjnë historinë, por nuk mund t'i shpëtojnë historisë. Ata prodhojnë vende të përçara; ata nuk krijojnë shoqëri Perëndimore. E infektojnë vendin e tyre me skizofreninë kulturore, e cila bëhet karakteristike përcaktuese dhe e vazhdueshme e tij.

Kreu 7: Shtetet bërthamë, rrathët bashkëqendrorë dhe rendi qytetërimor

Qytetërimet dhe rendi

Në politikën globale që po përftohet, dy superfuqive të kohës së Luftës së ftohtë, si polet kryesore të tërheqjes e të shtytjes për vendet e tjera, po ua zënë vendin shtetet bërthamë të qytetërimeve të mëdha. Këto ndryshime duken më qartë lidhur me qytetërimet Perëndimor, ortodoks dhe sinik. Në këto raste grupimet qytetërimore po përftohen duke përfshirë shtetet bërthamë, shtetet anëtare, popullsitë e pakicave të ngjashme kulturalisht në shtetet kufitare dhe, ajo që sjell më shumë kontradikta, popujt e kulturave të tjera në shtetet fqinje. Shpesh në këto blloqe qytetërimore shtetet kanë prirje të shpërndahen në rrathë bashkëqendrorë për qark shtetit ose shteteve, duke pasqyruar shkallën e tyre të njëjtësimit me atë bllok dhe të integritetit në të. Islami po përforcon vetëdijen e përbashkët, por ngaqë i mungon një shtet bërthamë i njohur, deri më sot ka arritur të ndërtojë vetëm një strukturë politike të përbashkët fillestare.

Vendet kanë prirje të rreshtohen pas vendeve që kanë kulturë të ngjashme, si dhe të gjejnë drejtpeshimin kundrejt vendeve, me të cilat nuk kanë përbashkësi kulturore. Kjo është e vërtetë sidomos për shtetet bërthamë. Fuqia e tyre i tërheq ato që kanë ngjashmëri kulturore dhe i shtyn ato, që janë të ndryshme nga ana kulturore. Për arsye të sigurisë, shtetet bërthamë mund të bëjnë përpjekje për të përfshirë ose për të sunduar disa popuj të qytetërimeve të tjera, të cilët nga ana e tyre do të bëjnë përpjekje për të kundërshtuar ose për t'i shpëtuar këtij sundimi (Kina kundrejt tibetianëve dhe uigurëve; Rusia kundrejt tartarëve, çeçenëve, myslimanëve të Azisë Qendrore). Gjithashtu arsyet e marrëdhënieve historike dhe të baraspeshimit të fuqisë i shtojnë disa vende që ta kundërshtojnë ndikimin e shtetit të tyre bërthamë. Si Gjeorgjia, ashtu edhe Rusia janë vende ortodokse, por gjeorgjianët historikisht e kanë kundërshtuar sundimin rus dhe lidhjen e ngushtë me Rusinë. Vietnami dhe Kina janë që të dy vende konfuciane, mirëpo ndërmjet tyre po ashtu ka pasur një model të krahasueshëm armiqësie historike. Megjithatë, me kalimin e kohës përbashkësia kulturore dhe zhvillimi i një vetëdijeje më të gjerë e më të fortë qytetërimore mund t'i bashkonin këto vende, ashtu siç janë bërë bashkë vendet e Europës Perëndimore.

Gjatë Luftës së ftohtë, çfarëdo rendi që të kishte, ishte produkt i mbisundimit të superfuqive mbi dy bllloqet e tyre dhe i ndikimit të superfuqive në Botën e Tretë. Në botën që po përftohet fuqia është diçka e vjetruar, ndërsa bashkësia globale një ëndërr e largët. Asnjë vend, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara, nuk ka më interesa të rëndësishëm globalë për sigurinë. Në botën e sotme më komplekse e heterogjene, përbërësit e rendit gjenden brenda dhe ndërmjet qytetërimeve. Bota ose do të gjejë rend në bazë të

qytetërimeve, ose s'ka për ta gjetur fare. Në këtë botë shtetet bërthamë të qytetërimeve janë burime të rendit brenda qytetërimeve dhe, përmes bisedimeve me shtetet e tjera bërthamë, edhe ndërmjet qytetërimeve.

Një botë në të cilën shtetet bërthamë luajnë rol udhëheqës ose sundues është një botë e ndarë në sfera influence. Por ajo është gjithashtu një botë në të cilën ushtrimi i influencës nga shtetet bërthamë përmbahet dhe zbutet nga kultura e përbashkët që kanë shtetet anëtare të qytetërimit të saj. Përbashkësia kulturore e ligjoron udhëheqjen dhe rolin e vendosjes së rendit nga ana e shtetit bërthamë si për shtetet anëtare, ashtu edhe për fuqitë dhe institucionet e jashtme. Kështu që është e kotë të veprohet, siç bëri sekretari i përgjithshëm Butro Butros-Gali më 1994, dhe të shpallet një lloj rregulli i "sferës së mbajtjes së influencës", sipas të cilit nga fuqia mbizotëruese rajonale nuk do të jepej më shumë se një e treta e forcës paqeruajtëse të OKB-së. Një kërkesë e tillë bie ndesh me realitetin gjeopolitik, se në cilindo rajon të dhënë ku ka një shtet mbizotërues, paqja mund të arrihet dhe të mbahet vetëm nëpërmjet rolit udhëheqës të atij shteti. Kombet e Bashkuara nuk përbëjnë asnjë lloj alternative kundrejt pushtetit rajonal, kurse pushteti rajonal bëhet si përgjegjës, ashtu edhe i ligjshëm, kur ushtrohet nga shtetet bërthamë kundrejt anëtarëve të tjerë të qytetërimit të vet.

Një shtet bërthamë mund ta kryejë funksionin e vet për të vendosur rend, sepse shtetet anëtare e perceptojnë si farefis kulturor. Një qytetërim është si një familje e zgjeruar dhe, po ashtu si pjesëtarët me moshë më të madhe të familjes, shtetet bërthamë u sigurojnë farefisit të tyre si mbështetje, ashtu edhe disiplinë. Kur mungon kjo lidhje farefisnore, aftësia e një shteti më të fuqishëm për të zgjidhur konfliktet dhe për të imponuar rendin në rajonin e vet është e kufizuar. Pakistani, Bangladeshi e

madje as Sri Lanka nuk do ta pranonin Indinë si siguruesin e rendit në Azinë Jugore dhe asnjë shtet tjetër i Azisë Lindore nuk do ta pranonte me këtë rol Japoninë në Azinë Lindore.

Kur qytetërimeve u mungojnë shtetet bërthamë, bëhen më të vështira problemet për të krijuar rendin brenda qytetërimeve ose për të biseduar për rendin ndërmjet qytetërimeve. Mungesa e një shteti bërthamë islamik, i cili në mënyrë të ligjshme e me autoritet do të kishte të bënte me bosnjakët, siç veproi Rusia me serbët dhe Gjermania me kroatët, i pengoi Shtetet e Bashkuara që ta ndërmerinin atë rol. Nuk patën mundësi efektive për ta bërë këtë, sepse mungonte interesi strategjik i amerikanëve se ku do të vendoseshin kufijtë në ish Jugosllavi, mungonte çfarëdo lidhjeje kulturore ndërmjet Shteteve të Bashkuara e Bosnjës, ndërsa Europa ishte kundër krijimit të një shteti mysliman në Europë. Mungesa e shteteve bërthamë si në Afrikë, edhe në botën arabe, i ka ndërlikuar mjaft përpjekjet për të zgjidhur problemet e luftës që po bëhet në Sudan. Nga ana tjetër, atje ku ka shtete bërthamë, ato dalin si elementi qendror i rendit të ri ndërkombëtar, të mbështetur në qytetërimet.

Lidhja e perëndimit

Gjatë Luftës së ftohtë Shtetet e Bashkuara qenë në qendër të një grupimi të gjerë, të larmishëm, shumëqytetërimor shtetesh, të cilat kishin të përbashkët qëllimin për të parandaluar zgjerimin e mëtejshëm të Bashkimit Sovjetik. Ky grupim, i cili quhej me emra të ndryshëm, si 'Bota e Lirë', 'Perëndimi', ose 'Aleatët',

përfshinte shumë shoqëri Perëndimore, por jo të gjitha: Turqinë, Greqinë, Japoninë, Korenë, Filipinet, Izraelin dhe, në mënyrë më të çlirët, vende të tjera, si Tajvani, Tajlanda dhe Pakistani. Kundër tij ishte një grupim vendesh një çikë më pak heterogjene, ndër të cilat bënin pjesë të gjitha vendet ortodokse, me përjashtim të Greqisë, disa vende që historikisht kishin qenë Perëndimore, Vietnami, Kuba, në një masë më të paktë India, dhe herë pas herë një ose disa vende të Afrikës. Me përfundimin e Luftës së ftohtë këto grupime shumëqytetërimore e që i kapërcenin kufijtë kulturorë, u copëzuan. Shpërbërja e sistemit sovjetik, në veçanti e Traktatit të Varshavës, ndodhi befasisht. Më ngadalë, por në mënyrë të ngjashme “Bota e lirë” shumëqytetërimore e Luftës së ftohtë po rikonfigurohet në një grupim me shtrirje pak a shumë që përkon me qytetërimin Perëndimor. Po ndodh një proces lidhjeje, i cili kërkon përcaktimin e anëtarësisë së organizatave ndërkombëtare Perëndimore.

Shtetet bërthamë të Bashkimit European: Franca dhe Gjermania, janë të rrethuara së pari nga grupimi i brendshëm i Belgjikës, Holandës e Luksemburgut, të cilat të gjitha kanë pranuar t’i heqin gjithë kufijtë për qarkullimin e njerëzve e të mallrave; pastaj nga vendet e tjera anëtare, si Italia, Spajna, Portugalia, Danimarka, Britania, Irlanda e Greqia; shtetet që u bënë anëtare më 1995 (Austria, Finlanda, Suedia), dhe ato vende, të cilat në atë kohë ishin anëtarë të asociuar (Polonia, Hungaria, Republika Çeke, Sllovakia, Bullgaria e Rumania). Duke pasqyruar këtë realitet, në vjeshtë 1994 si partia në pushtet në Gjermani, ashtu edhe zyrtarët më të lartë të Francës paraqitën propozime për një Bashkim me diferencime. Plan i gjerman propozonte që ‘bërthama e fortë’ të përbëhej prej anëtarëve fillestarë, duke përjashtuar Italinë, dhe që “Gjermania e Franca të

përbënin bërthamën e bërthamës së fortë”. Vendet e bërthamës së fortë do të përpiqeshin që të krijonin me shpejtësi një bashkim monetar dhe t’i integronin politikat e tyre të jashtme e të mbrojtjes. Pothuaj njëkohësisht kryeministri francez Edouard Balladur (Eduard Baladyr) sugjeroi një Bashkim me tri lidhje dhe pesë shtetet pro integritit të formonin bërthamën, kurse anëtarët e tjerë të atëhershëm të përbënin një rreth tjetër, dhe rrethin e jashtëm ta përbënin shtetet e reja në rrugën për t’u bërë anëtare. Më pas ministri i jashtëm i Francës, Alain Juppé (Alen Zhupe) e përpunoi këtë koncept, duke propozuar “një rreth të jashtëm të shteteve ‘partnere’, që të përfshinte Europën Qendrore e Lindore; një rreth të mesëm të shteteve anëtare të cilit do t’i kërkohej të pranonte disiplinën e përbashkët në disa fusha (një treg i vetëm, bashkim doganor etj.), si dhe disa rrethë të brendshëm të ‘solidaritetit të përforcuar’, që do të përfshinte ato të cilat do të kishin dëshirën dhe do të ishin në gjendje të ecnin më shpejt sesa të tjerat në fusha të tilla, si mbrojtja, integrimi monetar, politika e jashtme e kështu më tej.”¹ Udhëheqës të tjerë politikë propozuan tipa të tjerë rregullimesh, të cilat megjithatë përfshinin të gjitha një grupim të brendshëm shtetesh të asociuara më ngushtë dhe pastaj grupime të jashtme shtetesh, më pak të integruara tërësisht me shtetin bërthamë, derisa vija të arrinte t’i ndante anëtarët prej atyre që nuk ishin anëtarë.

Një nga sfidat kryesore, me të cilat është ballafaquar Perëndimi në botën pas Luftës së ftohtë, ka qenë të vendosej kjo vijë. Gjatë Luftës së ftohtë Europa si tërësi nuk ekzistonte. Mirëpo, me shembjen e komunizmit, u bë e domosdoshme të përballohej e të merrte përgjigje kjo pyetje: Çfarë është Europa? Kufijtë e Europës në veri, në perëndim dhe në jug përcaktohen nga hapësira të mëdha ujore, të cilat në jug përkojnë me dallime të

qarta në kulturë. Por ku është kufiri lindor i Europës? Kush duhet menduar se është european dhe, rrjedhimisht, si anëtar në mundësi i Bashkimit European, NATO-s dhe organizatave të ngjashme?

Përgjigjja më gjithëpërfshirëse dhe më e pamënjanueshme për këto pyetje jepet nga vija e madhe historike, që ka ekzistuar prej shekujsh, duke ndarë popujt e krishterë të Perëndimit nga popujt myslimanë e ortodoksë. Kjo vijë vjen që nga koha e ndarjes së Perandorisë Romake në shekullin e katërt e deri te krijimi i Perandorisë së Shenjtë Romake në shekullin e dhjetë. Ajo ka qëndruar afërsisht në po atë vend ku është edhe sot të paktën për pesëqind vjet. Duke nisur nga veriu, ajo kalonte nëpër ata që janë sot kufijtë ndërmjet Finlandës e Ruisë dhe shteteve baltike (Estonisë, Lituanisë, Letonisë) e Ruisë nëpër Bjellorusinë perëndimore, përmes Ukrainës duke e ndarë perëndimin uniat prej lindjes ortodokse, nëpër Rumani ndërmjet Transilvanisë me popullsinë e saj katolike hungareze dhe pjesën tjetër të vendit, kurse nëpër ish Jugosllavinë përgjatë kufirit që ndan Slloveninë e Kroacinë nga republikat e tjera. Natyrisht, në Ballkan kjo vijë përkon me ndarjen historike ndërmjet Perandorisë Austro-Hungareze dhe Perandorisë Osmane. Ky është kufiri kulturor i Europës dhe në botën pas Luftës së ftohtë ai është edhe kufiri politik e ekonomik i Europës dhe i Perëndimit.

Kështu, paradigma qytetërimore na jep një përgjigje të prerë qartas e të pamënjanueshme për pyetjen, me të cilën ballafaqohen europianët perëndimorë: Ku mbaron Europa? Europa mbaron aty ku mbaron krishterimi Perëndimor dhe nisin Islami e ortodoksia. Kjo është përgjigjja që europianët Perëndimorë duan ta dëgjojnë, të cilën ata e mbështetin në shumicë dërrmuese nën zë dhe të cilën intelektualë e udhëheqës politikë të

ndryshëm e kanë pranuar shprehur. Siç e ka argumentuar Michael Howard-i (Majkëll Hauard), është e domosdoshme të pranohet ky dallim, që ishte megjulluar gjatë viteve sovjetike, ndërmjet Europës Qendrore ose *Mittleuropa* dhe Europës Lindore të mirëfilltë. Europa Qendrore përfshin “ato toka, të cilat dikur përbënin pjesën e krishterimit Perëndimor; tokat e vjetra të Perandorisë së Habsburgëve, të Austrisë, Hungarisë e Çekosllovakisë, së bashku me Poloninë e brezat kufitarë lindorë të Gjermanisë. Termi ‘Europa Lindore’ duhet ruajtur për ato rajone, të cilat u zhvilluan nën egjidhjen e Kishës ortodokse: bashkësitë e Detit të Zi të Bullgarisë e Rumanisë, që dolën nga sundimi osman vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë, si dhe pjesët ‘europiane’ të Bashkimit Sovjetik”. Sipas tij, detyra e parë e Europës Perëndimore duhet të jetë “të rithithë popujt e Europës Qendrore në bashkësinë tonë kulturore e ekonomike, së cilës i përkasin në të vërtetë: të rithuren lidhjet ndërmjet Londrës, Parisit, Romës, Mynihut e Lajpcigut, Varshavës, Pragës e Budapestit.” Po del një ‘vijë e re shkëputjeje’,” siç e ka komentuar dy vjet më vonë Pierr Behar, “nga njëra anë, një vijë ndarëse në themel kulturore ndërmjet Europës së karakterizuar prej krishterimit Perëndimor (katolik ose protestant) dhe, nga ana tjetër, Europës që e karakterizojnë krishterimi Lindor dhe traditat islamike.” Një finlandez i shquar gjithashtu e ka vështruar ndarjen thelbësore në Europë që po zëvendëson Perden e Hekurt si “vijën e shkëputjes së lashtë kulturore ndërmjet Lindjes e Perëndimit”, që i vendos “vendet e Perandorisë së mëparshme Austro-Hungare, si dhe Poloninë e Vendet Baltike” brenda Europës së Perëndimit, ndërsa vendet e tjera të Europës Lindore e të Ballkanit jashtë saj. Siç e ka pranuar edhe një anglez i njohur, “fetë e madhe bëjnë ndarjen ...ndërmjet kishave

Lindore e Perëndimore: në kuptim të gjerë, ndërmjet atyre popujve, që e kanë marrë krishterimin drejtpërdrejt nga Roma ose nëpër ndërmjetësinë kelte e gjermanike, dhe atyre të Lindjes e Juglindjes, te të cilat ka ardhur nëpërmjet Konstantinopolit (Bizantit).”²

Harta 7.1:
Kufiri Lindor i qytetërimit Perëndimor



Edhe njerëz nga Europa Qendrore nënvizojnë domethënien e kësaj vije ndarëse. Vendet që kanë bërë përpunim të ndjeshëm në rrugën e zhveshjes prej trashëgimisë komuniste e po ecin drejt politikave demokratike dhe ekonomive të tregut, janë të ndara prej atyre të cilat nuk po ecin nga “vija që ndan katolicizmin e protestantizmin, nga njëra anë, dhe ortodoksinë, nga ana tjetër.” Shekuj më parë, ka argumentuar presidenti i Lituanisë, lituanëve u ishte dashur të zgjidhnin ndërmjet “dy qytetërimeve” dhe “kishin mbështetur botën latine, u kthyen në katolicizëm e zgjodhën një formë organizimi të shtetit, që mbështetet në të drejtën.” Me një shprehje të ngjashme, polakët thonë se kanë qenë pjesë e Perëndimit që kur bënë zgjedhjen në shekullin e dhjetë për krishterimin latin kundër Bizantit.³ Përkundrazi, njerëzit nga vendet ortodokse të Europës Lindore e shohin me mëdyshje theksimin e ri të kësaj vije kulturore të shkëputjes. Bullgarët e rumunët shohin përfitime të mëdha po të bëhen pjesë e Perëndimit dhe të përfshihen në institucionet e tij; por ata gjithashtu e identifikojnë veten me traditat e tyre ortodokse dhe, nga ana e bullgarëve, me lidhjen e ngushtë historike me Rusinë e Bizantin.

Njëjtësimi i Europës me krishterimin Perëndimor jep një kriter të qartë për pranimin e anëtarëve të rinj në organizatat Perëndimore. Bashkimi European është tërësia parësore e Perëndimit në Europë dhe zgjerimi i anëtarësisë së tij, i ndërmarrë më 1994, u bë me pranimin e vendeve kulturalisht Perëndimore: Austria, Finlanda dhe Suedia. Në pranverë 1994 Bashkimi vendosi përkohësisht të përjashtonte nga anëtarësimi gjithë republikat e mëparshme sovjetike, por duke mbajtur veçan Shtetet e Baltikut. Ai gjithashtu nënshkroi “marrëveshje asociimi” me katër shtete të Europës Qendrore (Poloninë, Hungarinë, Republikën Çeke e

Sllovakinë) dhe me dy nga Europa Lindore (Rumaninë e Bullgarinë). Mirëpo asnjë prej këtyre shteteve nuk ka të ngjarë të bëhet anëtar i plotë i BE-së deri në një farë kohe gjatë shekullit të njëzetënjëtë, kurse shtetet e Europës Qendrore, pa dyshim, do ta arrijnë këtë status para Rumanisë e Bullgarisë, po që se këto të fundit do ta arrijnë ndonjëherë. Ndërkaq, anëtarësimi përfundimtar i Shteteve Baltike e i Sllovenisë duket se ka shpresa të mira, kurse kërkesa e Turqisë myslimane, e Maltës tepër të vogël dhe e Qipros ortodokse më 1995 ende kishin mbetur pezull. Në zgjerimin e anëtarësisë së BE-së duket qartë se parapëlqimi është për ato shtete, të cilat nga ana kulturore janë Perëndimore e që gjithashtu shfaqen si më të zhvilluara ekonomikisht. Nëse do të zbatohet ky kriter, shtetet e Vishegradit (Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria), Republikat baltike, Sllovenia, Kroacia dhe Malta më në fund do të bëhen anëtare të BE-së dhe Bashkimi do të ketë shtrirjen që përkon me qytetërimin Perëndimor, siç ka ekzistuar historikisht në Europë.

Logjika e qytetërimeve dikton një përfundim të ngjashëm lidhur me zgjerimin e NATO-s. Lufta e ftohtë nisi me zgjerimin e sundimit politik dhe ushtarak sovjetik në Europën Qendrore. Shtetet e Bashkuara dhe vendet e Europës Perëndimore e formuan NATO-n për ta përmbajtur dhe, po të dilte nevoja, për ta thyer agresionin e mëtejshëm sovjetik. Në botën pas Luftës së ftohtë NATO-ja është organizata e sigurimit të qytetërimit Perëndimor. Me mbarimin e Luftës së ftohtë, NATO-ja ka një qëllim qendror e të detyrueshëm: të sigurojë që të mbetet, si pengesë që të mos ndodhë rivendosja e sundimit politik e ushtarak të Ruisë në Europën Qendrore. Si organizata e sigurisë e Perëndimit, NATO-ja është e hapur përkatësisht për anëtarësimin e vendeve Perëndimore, të cilat dëshirojnë

të hyjnë në të dhe që i plotësopjnë kërkesat bazë nga pikëpamja e aftësisë ushtarake, demokracisë politike dhe kontrollit civil mbi ushtrinë.

Politika amerikane kundrejt rregullimeve për sigurimin europian pas Luftës së ftohtë në fillim mishëronte një qëndrim më universalist, që gjeti shprehje në Partneritetin për Paqe, i cili do të ishte i hapur përgjithësisht për vendet europiane dhe, në të vërtetë, euroaziatike. Ky qëndrimi gjithashtu nënvizonte rolin e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë. Ai ka gjetur pasqyrim në thëniet e presidentit Klinton, kur vizitoi Europën në janar 1994: “Kufijtë e lirisë tashti duhet të përcaktohen prej sjelljes së re, jo më prej historisë së vjetër. Po u drejtohem gjithë atyre ...që do të heqin një vijë të re në Europë: ne nuk duhet që paraprakisht ta mbyllim derën për një të ardhme më të mirë të Europës - për demokraci kudo, për ekonomi tregu kudo, për vende që bashkëpunojnë kudo lidhur me sigurinë reciproke. Ne duhet të kemi kujdes që të mos pranojmë një arritje më të vogël.” Mirëpo pas një viti administrata erdhi përsëri te pranimi i rëndësisë së kufijve të përcaktuar prej “historisë së vjetër” dhe vajti deri aty sa të pranonte një “arritje më të vogël”, duke pasqyruar realitetet e dallimeve qytetërimore. Administrata nisi veprime aktive për të përpunuar kriteret dhe për të vendosur afatet e zgjerimit të anëtarësisë së NATO-s, së pari për Poloninë, Hungarinë e Republikën Çeke dhe Sllovakinë, pastaj për Slloveninë e ndoshta më vonë për republikat e Baltikut.

Rusia e kundërshtoi me forcë çfarëdo zgjerimi të NATO-s, ndërsa ata rusë që mendohej se ishin më liberalë e properëndimorë argumentonin se zgjerimi do të fuqizonte shumë forcat politike nacionaliste e antiperëndimore në Rusi. Zgjerimi i NATO-s megjithatë, i kufizuar me vendet që historikisht kanë

qenë pjesë e krishterimit Perëndimor, i garanton gjithashtu Ruisë se do të përjashtohen nga pranimi Serbia, Bullgaria, Rumania, Moldova, Belarusi dhe Ukraina, për aq kohë sa kjo të mbetet e bashkuar. Zgjerimi i NATO-s, i kufizuar me shtete Perëndimore, gjithashtu, do ta theksonte rolin e Ruisë si shteti bërthamë i një qytetërimi të veçantë, ortodoks, dhe si rrjedhim, si një vend që do të ishte përgjegjës për rendin përgjatë dhe brenda kufijve të ortodoksisë.

Dobia e dallimit ndërmjet vendeve sipas qytetërimit del qartë kundrejt republikave të Baltikut. Ato janë të vetmet republika të mëparshme sovjetike, të cilat janë qartas Perëndimore nga pikëpamja e historisë së tyre, e kulturës dhe e fesë, ndërsa fati i tyre ka qenë një ndër shqetësimet kryesore të Perëndimit. Shtetet e Bashkuara asnjëherë nuk e kishin njohur zyrtarisht përfshirjen e tyre në Bashkimin Sovjetik, kishin mbështetur lëvizjen e tyre drejt pavarësisë gjatë kohës së shembjes së Bashkimit Sovjetik dhe kishin këmbëngulur që rusët të pranonin afatet e caktuara me marrëveshje për largimin e trupave të tyre nga ato republika. Mesazhi drejtuar rusëve kishte qenë që duhej të pranonin se republikat e Baltikut ishin jashtë çfarëdo sfere të ndikimit, që ata do të dëshironin të krijonin kundrejt ish republikave të tjera sovjetike. Kjo arritje nga administrata e Klintonit ishte, sipas fjalëve të kryeministrit të Suedisë, “një nga ndihmesat më të rëndësishme për sigurinë dhe stabilitetin e Europës” dhe u kishte dhënë ndihmë demokratëve rusë, duke treguar se çfarëdo planesh revanshiste të nacionalistëve rusë ekstremistë ishin të kota përballë angazhimit të hapur të Perëndimit lidhur me këto republika.⁴

Ndërsa i është kushtuar shumë vëmendje zgjerimit të Bashkimit European e NATO-s, rikonfigurimi kulturor i këtyre organizatave gjithashtu shtron

probleme të rrudhjes së tyre të mundshme. Një vend joperëndimor, Greqia, është anëtar i të dyja organizatave, dhe një tjetër, Turqia, është anëtare e NATO-s dhe ka bërë kërkesë për anëtarësimin në Bashkim. Këto marrëdhënie kanë qenë produkt i Luftës së ftohtë. A kanë më vend në botën e qytetërimeve pas Luftës së ftohtë?

Anëtarësimi i plotë i Turqisë në Bashkimin Europian është diçka problematike dhe anëtarësimi i saj në NATO është kritikuar nga Partia e Mirëqenies. Megjithatë, Turqia ka të ngjarë se do të qëndrojë në NATO, veç në rast se Partia e Mirëqenies arrin një fitore të madhe në zgjedhje, ose nëse Turqia në ndonjë mënyrë tjetër me vetëdije do ta hidhte poshtë trashëgiminë e Ataturkut dhe do ta ripërcaktonte veten si udhëheqëse e Islamit. Kjo është e përfytyrueshme e mund të jetë e dëshirueshme për Turqinë, por gjithashtu nuk ka gjasa të ndodhë në të afërmen e afërt. Cilido qoftë roli i saj në NATO, Turqia gjithnjë e më tepër do të ndjekë interesat e saj të veçantë lidhur me Ballkanin, botën arabe dhe Azinë Qendrore.

Greqia nuk bën pjesë në qytetërimin Perëndimor, por ajo ka qenë atdheu i qytetërimit klasik, i cili përbënte një burim të rëndësishëm për qytetërimin Perëndimor. Në kundërshtimin ndaj turqve historikisht grekët e kanë quajtur veten maja e përçuesve të krishterimit. Ndryshe nga serbët, rumunët ose bullgarët, historia e tyre ka qenë e ndërthurur ngushtë me atë të Perëndimit. E megjithatë Greqia është gjithashtu një anomali, një i jashtëm ortodoks në organizatat Perëndimore. Asnjëherë ajo nuk ka qenë një anëtar pa probleme as i BE-së, as i NATO-s, dhe ka pasur vështirësi për t'ua përshtatur veten parimeve e zakoneve të të dyjave. Që nga mesi i viteve 1960 e deri në mesin e viteve 1970 aty sundoi një juntë ushtarake dhe prandaj nuk mund të hynte në

Komunitetin Europian deri në kohën që mori rrugën drejt demokracisë. Udhëheqësit e saj shpesh duket se kanë dalë nga drejtimi dhe janë shmangur prej normave Perëndimore, duke qenë në kundërshtim me qeveritë Perëndimore. Ajo ka qenë vendi më i varfër se cilido anëtar tjetër i Komunitetit dhe i NATO-s, madje shpesh ka ndjekur politika ekonomike, që dukej se shpërfillnin standardet mbizotëruese në Bruksel. Sjellja e saj, kur i erdhi radha si kryesuese e Këshillit të KE-së më 1994, ua solli në majë të hundës anëtarëve të tjerë dhe zyrtarët europianë perëndimorë në mënyrë private e quanin gabim pranimin e saj si anëtare.

Në botën pas Luftës së ftohtë politikat e Greqisë gjithnjë e më tepër kanë devijuar prej atyre të Perëndimit. Bllokimi që i bëri Maqedonisë u kundërshtua vendosmërisht prej qeverive të Perëndimit dhe puna arriti deri aty, sa Komisioni Europian të kërkonte një vendim nga Gjykata Europiane kundër Greqisë. Lidhur me konfliktet në ish Jugosllavinë, Greqia u veçua nga politika që ndoqën fuqitë kryesore Perëndimore, mbështeti gjallërisht serbët dhe i shkeli hapur sanksionet e OKB-së kundër tyre. Me rrëzimin e Bashkimit Sovjetik dhe të kërcënimit komunist, Greqia ka dalë me interesa reciprokë me Rusinë në kundërshtim me armikun e tyre të përbashkët, Turqinë. Ajo i ka lejuar Ruisë të ketë një prani të rëndësishme në Qipron greke dhe si rrjedhim i “fesë së përbashkët ortodokse lindore”, qipriotët grekë i kanë pritur në ishullin e tyre me mirëseardhje si rusët edhe serbët.⁵ Më 1995 ishin nja dy mijë biznese me pronësi të rusëve që punonin në Qipro; atje botohen gazeta ruisht e serbokroatisht dhe furnizimet kryesore me armë qeveria qipriote i ka blerë nga Rusia. Greqia gjithashtu ka shqyrtuar me Rusinë mundësinë për të sjellë naftë nga Kaukazi e Azia Qendrore në Mesdhe nëpërmjet një naftësjellësi nëpër

Bullgari e Greqi, duke i anashkaluar Turqinë dhe vendet e tjera myslimane. Politika e jashtme greke përgjithësisht ka marrë një orientim të fortë ortodoks. Pa dyshim, Greqia do të mbetet një anëtar formal i NATO-s dhe i Bashkimit Europian. Megjithatë, me përforcimin e procesit të rikonfigurimit, këto anëtarësime gjithashtu pa dyshim do të bëhen më të dobëta, me më pak domethënie për palët pjesëmarrëse. Antagonisti i Bashkimit Sovjetik në kohën e Luftës së ftohtë po evoluon drejt aleatit të Ruisë pas Luftës së ftohtë.

Rusia dhe shtetet e jashtme të afërta me të

Trashëgimtari i perandorive cariste e komuniste është një bllok qytetërimor, i cili nga shumë anë është paralel me atë të Perëndimit në Europë. Në bërthamë Rusia, si ekuivalenti i Francës e Gjermanisë, është e lidhur ngushtë me një rreth të brendshëm, që përfshin: dy republikat me mbizotërim sllav ortodoks, Belarusin e Moldovën, Kazakistanin, që e ka 40 për qind të popullsisë ruse, dhe Armeninë, e cila historikisht ka qenë aleate e afërt me Rusinë. Në mesin e viteve 1990 të gjitha këto vende kishin qeveri proruse, të cilat përgjithësisht kishin ardhur në pushtet nëpërmjet zgjedhjeve. Marrëdhënie të ngushta por më të dobëta ka ndërmjet Ruisë e Gjeorgjisë (me mbizotërim ortodoks) dhe Ukrainës (në pjesën më të madhe ortodokse), por që të dyja këto kanë gjithashtu ndjenjë të fortë të identitetit kombëtar dhe të kaluar të pavarur. Në Ballkanin ortodoks, Rusia ka lidhje të ngushta me Bullgarinë, Greqinë, Serbinë dhe Qipron, si dhe lidhje diçka më pak të afërta me Rumaninë. Republikat myslimane të

Bashkimit Sovjetik të mëparshëm mbeten tepër të varura nga Rusia qoftë nga ana ekonomike, ashtu edhe si zonë sigurie. Përkundrazi, Republikat Baltike, duke iu përgjigjur tërheqjes gravitacionale të Europës, në të vërtetë janë shkëputur prej sferës së influencës të Ruisë.

Përgjithësisht Rusia po krijon një bllok me një terren qendror ortodoks nën udhëheqjen e vet, si dhe me një zonë rrethuese amortizimi prej shtetesh islamike relativisht të dobëta, të cilat në shkallë të ndryshme do t'i mbajë nën sundim dhe prej të cilave do të përpiqet të përjashtojë influencën e fuqive të tjera. Rusia gjithashtu pret që bota ta pranojë e ta miratojë këtë sistem. Siç e ka thënë Jelcini në shkurt 1993, qeveritë e huaja dhe organizatat ndërkombëtare është e nevojshme "t'i japin fuqi të posaçme si garantuese e paqes dhe stabilitetit në rajonet e mëparshme të BRSS." Ndërsa Bashkimi Sovjetik ishte një superfuqi me interesa globale, Rusia është një fuqi e madhe me interesa rajonale e qytetërimore.

Vendet ortodokse të ish Bashkimit Sovjetik kanë rol qendror për zhvillimin e një blloku rus koherent në punët e Eurazisë e të botës. Gjatë shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik që të pesë këto vende në fillim ecën në një drejtim tepër nacionalist, duke theksuar pavarësinë e tyre të re dhe largësinë prej Moskës. Më pas, pranimi i realiteteve ekonomike, gjeopolitike e kulturore i shtyu votuesit e katër prej tyre që të rizgjidhnin qeveri proruse dhe të mbështesnin politikat proruse. Njerëzit në këto vende i drejtojnë sytë nga Rusia për mbrojtje dhe mbështetje. Në vendin e pestë, në Gjeorgji, ishte ndërhyrja ushtarake ruse që e bëri të detyrueshme një zhvendosje të tillë në qëndrimin e qeverisë.

Armenia historikisht i ka njëjtësuar interesat e vet me Rusinë dhe Rusia është krenuar si mbrojtëse e

Armenisë kundër fqinjëve të saj myslimanë. Këto marrëdhënie u rifuqizuan në vitet passovjetike. Armenët kanë qenë të varur nga mbështetja ekonomike e ushtarake ruse dhe e kanë përkrahur Rusinë në çështjet e lidhura me marrëdhëniet ndërmjet ish republikave sovjetike. Të dy vendet kanë interesa strategjike që përputhen.

Ndryshe nga Armenia, Belarusi e ka të paktë ndjenjën e identitetit kombëtar. Ai gjithashtu është më shumë i varur nga mbështetja ruse. Mjaft prej banorëve të tij duket se e njëjtësojnë veten më shumë me Rusinë, sesa me vendin e tyre. Në janar 1994 parlamenti e zëvendësoi nacionalistin e moderuar centrist që ishte në krye të shtetit, me një konservator prorus. Në korrik 1994 me 80 për qind të votave u zgjodh si president një aleat prorus i skajshëm i Vladimir Zhirinovskit. Belarusi i pari hyri në Bashkësinë e Shteteve të Pavarura (BSHP), ishte anëtar themelues i bashkimit ekonomik të krijuar më 1993 me Rusinë dhe Ukrainën, pranoi një bashkim monetar me Rusinë, ia dha armët e veta bërthamore Ruisë dhe pranoi që të qëndronin trupa ruse në tokën e tij deri në fund të shekullit. Më 1995 në të vërtetë Belarusi ishte pjesë e Ruisë në gjithçka, me përjashtim të emrit.

Pasi Moldova fitoi pavarësinë me shembjen e Bashkimit Sovjetik, shumë njerëz parashikonin më në fund integrimin e saj përsëri me Rumaninë. Por frika se mos ndodhte kjo gjë, nga ana e saj, nxiti një lëvizje për shkëputje në lindjen e rusifikuar, e cila kishte mbështetjen e heshtur të Moskës dhe mbështetjen aktive të Armatës së 14-të ruse, duke çuar te krijimi i Republikës Tejdnjestrane. Mirëpo ndjenja e moldovanëve për bashkimin me Rumaninë shkoi në rënie si pasojë e problemeve ekonomike në të dy vendet dhe e trysnisë nga ana e Ruisë. Moldova hyri në BSHP

dhe u zgjerua tregtia me Rusinë. Në shkurt 1994 partitë proruse patën sukses dërmues në zgjedhjet për parlamentin.

Në këto tre shtete opinioni publik, duke iu përgjigjur disa ndërthurjeve të interesave strategjike dhe ekonomike, nxori qeveri që përkrahnin lidhjet e ngushta me Rusinë. Përfundimisht një farë modeli i ngjashëm u përftua edhe në Ukrainë. Në Gjeorgji rrjedha e ngjarjeve që e ndryshme. Gjeorgjia ka qenë vend i pavarur deri më 1801, kur sundimtari i saj, mbreti Gjergji XIII kërkoi ndihmën e Rosisë kundër turqve. Tre vjet pas Revolucionit Rus, 1918-1921, Gjeorgjia u bë përsëri e pavarur, por bolshevikët e përfshinë me detyrim në Bashkimin Sovjetik. Kur i erdhi fundi Bashkimit Sovjetik, Gjeorgjia përsëri shpalli pavarësinë. Zgjedhjet i fitoi një koalicion nacionalist, por udhëheqësi i tij i hyri një shtypjeje vetëshkatërruese dhe u rrëzua me forcë. Eduard A. Sheverdnadze, i cili kishte qenë ministër i jashtëm i Bashkimit Sovjetik, u kthye për ta udhëhequr vendin dhe u konfirmua në pushtet me zgjedhjet për president më 1992 e më 1995. Mirëpo u ballafaqua me një lëvizje separatiste në Abhazi, e cila u bë marrëse e një mbështetjeje të ndjeshme ruse, si dhe me një kryengritje të udhëhequr prej Gamsakurdisë së dëbuar. Duke dashur t'ia kalonte mbretit Gjergj, ai arriti në përfundimin se “Nuk kemi ndonjë mundësi të madhe për të zgjedhur” dhe iu drejtua Moskës për ndihmë. Trupat ruse ndërhyjnë për ta mbështetur dhe çmimi që që Gjeorgjia të hynte në BSHP. Më 1994 gjeorgjianët pranuan t'u linin rusëve t'i mbanin tri baza ushtarake në Gjeorgji për një periudhë kohe të pacaktuar. Ndërhyrja ushtarake ruse së pari për ta dobësuar qeverinë gjeorgjiane dhe pastaj për ta mbështetur atë e solli kështu në kampin rus Gjeorgjinë me mendje për pavarësi.

Përveç Rosisë, republika e mëparshme sovjetike me më shumë popullsi dhe më e rëndësishme është Ukraina. Në periudha të ndryshme të historisë Ukraina ka qenë e pavarur. Porse gjatë pjesë më të madhe të kohëve të reja ajo ka qenë pjesë e një tërësie politike të qeverisur prej Moskës. Ngjarja vendimtare ka ndodhur më 1654, kur Bogdan Hmelnicki, udhëheqësi i kozakëve i një kryengritjeje kundër sundimit polak, pranoi që të bëhej besnik i carit në këmbim të ndihmës kundër polakëve. Që atëherë e deri më 1991, me përjashtim të një republike të pavarur për një kohë të shkurtër ndërmjet viteve 1917-1920, ajo që është sot Ukraina ka qenë nën sundimin politik të Moskës. Mirëpo Ukraina është një vend i çarë me dy kultura të dalluara. Vija e shkëputjes kulturore ndërmjet Perëndimit e Ortodoksisë kalon përmes zemrës së saj dhe kështu ka qenë gjatë shekujve. Në kohët e shkuara, Ukraina perëndimore ka qenë pjesë e Polonisë, e Lituanisë dhe e Perandorisë Austro-Hungareze. Një përpjesë e madhe e popullsisë së saj ka qenë e Kishës uniate, e cila i ushtron ritet ortodokse, por pranon autoritetin e papës. Historikisht ukrainasit e perëndimit kanë folur ukrainishten dhe nga botëkuptimi kanë qenë nacionalistë të fortë. Nga ana tjetër, banorët e Ukrainës lindore kanë qenë në pjesën dërrmuese ortodoksë dhe në shumicë kanë folur rusisht. Në fillim të viteve 1990 rusët përbënin 22 për qind dhe folësit e rusishtes si gjuhë amëtare përbënin 31 për qind të popullsisë së përgjithshme të Ukrainës. Përpjesa më e madhe e nxënësve të shkollës fillore e të shkollave të mesme i bënin mësimet rusisht.⁶ Krimeja është në pjesën dërrmuese ruse dhe ka qenë pjesë e Federatës Ruse deri më 1954, kur Hrushovi ia kaloi Ukrainës për t'u dukur si mirënjohës ndaj vendimit të Hmelnickit 300 vjet më parë.

Dallimet ndërmjet Ukrainës lindore e perëndimore shfaqen në qëndrimet e popullsisë të tyre. Për shembull, nga fundi i vitit 1992 një e treta e rusëve në Ukrainën perëndimore kundërshtojnë 10 për qind në Kiev, thanë se kishin vuajtur prej armiqësisë antirusë.⁷ Përçarja lindje-perëndim doli në dukje dramatikisht në zgjedhjet e korrikut 1994 për presidentin. Ai që ishte në detyrë, Leonid Kravçuku, i cili ndonëse punonte ngushtë me udhëheqësit rusë, e paraqiste veten si nacionalist, fitoi në trembëdhjetë zona të Ukrainës perëndimore me shumicë që arrinte deri mbi 90 për qind. Kundërshtari i tij, Leonid Kuçma, i cili kishte marrë mësim për të përvetësuar ukrainishten gjatë fushatës, fitoi në trembëdhjetë zonat lindore me shumicë të krahasueshme. Kuçmai fitoi 52 për qind të votave. Në të vërtetë, një shumicë e thjeshtë e republikës ukrainase më 1994 e konfirmoi zgjedhjen që kishte bërë Hmelnicki më 1654. Siç vuri në dukje një specialist amerikan, këto zgjedhje “pasqyruan, madje kristalizuan përçarjen ndërmjet sllavëve të europianizuar në Ukrainën perëndimore dhe vizionit ruso-sllav sesi duhej të ishte Ukraina. Nuk është puna të polarizimi etnik sesa të dallimet kulturore.”

Harta 7.2: Ukraina: një vend i çarë



Burimi: Fondacioni Ndërkombëtar për sistemet zgjedhore

Si rrjedhim i kësaj ndarjeje, marrëdhëniet ndërmjet Ukrainës e Rusisë mund të ecin në njërin nga tri rrugë të mundshme. Në fillim të viteve 1990 ndërmjet dy vendeve kishte çështje të rëndësishme të mprehta lidhur me armët bërthamore, Krimenë, të drejtat e rusëve në Ukrainë, flotën e Detit të Zi dhe marrëdhëniet ekonomike. Shumë njerëz mendonin se kishte gjasa të shpërthente një konflikt i armatosur, prandaj disa analistë nga Perëndimi argumentuan se Perëndimi duhej të mbështeste Ukrainën për ta ruajtur arsenalin bërthamor, që të përballonte një agresion nga Rusia.⁹ Mirëpo, nëse rolin kryesor e ka qytetërimi, nuk ka të ngjarë që të ketë dhunë ndërmjet ukrainasve e rusëve. Këta janë dy popuj sllavë, kryesisht ortodoksë, që kanë pasur marrëdhënie të ngushta prej shekujsh e madje

midis tyre janë të zakonshme martesat. Pavarësisht nga çështjet shumë të diskutueshme dhe nga trysnia e nacionalistëve ekstremistë të të dyja palëve, udhëheqësit e të dy vendeve kanë punuar fort dhe në pjesën më të madhe me sukses për t'i zbutur këto grindje. Zgjedhja në mes të vitit 1994 në Ukrainë e një presidenti haptazi me orientim rus e zvogëloi edhe më tej gjasën e një konflikti të acaruar ndërmjet dy vendeve. Ndërsa gjetkë në ish Bashkimin Sovjetik ndërmjet myslimanëve e të krishterëve kanë ndodhur përleshje të rënda dhe ka pasur acarim të madh e ndonjë përleshje ndërmjet rusëve e popujve balltikë, që nga viti 1995 praktikisht nuk ka pasur asnjë lloj dhune ndërmjet rusëve e ukrainasve.

Mundësia e dytë dhe që ka ndoshta më shumë gjasa është që Ukraina të copëtohet sipas vijës së shkëputjes në dy etni të veçanta, prej të cilave ajo lindore do të bashkohej me Rusinë. Çështja e shkëputjes doli në pah për herë të parë lidhur me Krimenë. Publiku i Krimesë, që përbëhet 70 për qind nga rusë, në referendumin e dhjetorit 1991 e mbështeti mjaft pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik. Në maj 1992 parlamenti i Krimesë gjithashtu votoi për të shpallur pavarësinë nga Ukraina, por pastaj nën trysninë e Ukrainës, e hodhi poshtë atë votim. Mirëpo parlamenti rus votoi që të anulohet lëshimi i bërë më 1994 për t'ia kaluar Krimenë Ukrainës. Në janar 1994 krimeasit zgjodhën një president, i cili e kishte bërë fushatën me platformën "Bashkim me Rusinë." Kjo i nxiti disa njerëz që të shtronin pyetjen: "A do të bëhet Krimeja një Nagorno-Karabak tjetër apo Abhazia tjetër?"¹⁰ Përgjigja qe një "Jo!" e fortë, kur presidenti hoqi dorë nga zotimi për të mbajtur një referendum për pavarësinë dhe në vend të tij nisi bisedimet me qeverinë e Kievit. Në maj 1994 gjendja u ndez prapë, kur parlamenti i Krimesë votoi për të

rivendosur kushtetutën e vitit 1992, e cila në fakt e bënte të pavarur prej Ukrainës. Megjithatë, përsëri me shtrëngesat e udhëheqësve rusë e ukrainas u parandalua që kjo çështje të përftonte dhunë dhe zgjedhjet dy muaj më vonë, të cilat i fitoi Kuçmaja prorus, duke u bërë president i Ukrainës, e dobësuan vrullin e Krimesë për shkëputje.

Megjithatë këto zgjedhje shtruan mundësinë që pjesa perëndimore e vendit të shkëputej nga Ukraina, e cila po lidhej gjithnjë e më ngushtë me Rusinë. Disa rusë do ta mirëprisnin këtë. Siç e ka shprehur një gjeneral rus, “Ukraina, ose më mirë Ukraina Lindore, brenda pesë, dhjetë a më shumë vjetëve do të kthehet përsëri. Ukraina perëndimore le të shkojë në djall!”¹¹ Një Ukrainë e tillë e gjymtuar uniate dhe me orientim perëndimor, megjithatë, do të kishte mundësi mbijetese vetëm po të kishte një mbështetje të fuqishme e të frytshme Perëndimore. Nga ana e vet, kjo mbështetje do të kishte gjasa të jepej vetëm nëse marrëdhëniet ndërmjet Perëndimit e Rosisë do të keqësoheshin rëndë dhe do të bëheshin të ngjashme me ato të kohës së Luftës së ftohtë.

Skenari i tretë dhe që ka më shumë gjasa është që Ukraina do të mbetet e bashkuar, do të mbetet e çarë, do të mbetet e pavarur dhe përgjithësisht do të bashkëpunojë ngushtë me Rusinë. Pasi u zgjidhën çështjet e tranzicionit lidhur me armët bërthamore dhe forcat ushtarake, problemet afatgjata më të rënda do të jenë ekonomike, zgjidhja e të cilave do të lehtësohet nga kultura pjesërisht e përbashkët dhe nga lidhjet e ngushta personale. Siç e ka vënë në dukje John Morrison-i (Xhon Morrison), marrëdhëniet ruso-ukrainase janë ashtu si marrëdhëniet franko-gjermane për Europën Perëndimore.¹² Ashtu si këto të fundit përbëjnë

bërthamën e Bashkimit Europian, po ashtu të parat janë bërthama e qenësishme për unitetin e botës ortodokse.

Kina e madhe dhe sfera e saj e bashkëlulëzimit

Historikisht Kina e ka konceptuar veten se kishte një përfshirje të gjerë: një “Zonë Sinike”, që përfshin Korenë, Vietnamin, Ishujt Liu Çiu dhe nganjëherë Japoninë; një “Zonë të brendshme aziatike” të popujve jo kinezë: mançu, mongolë, uigurë, turq dhe tibetas, të cilët duhej të mbaheshin nën kontroll për arsye sigurimi, dhe së fundi një “Zonë e Jashtme” prej barbarësh, të cilët megjithatë “duhej të paguanin tribut dhe ta pranonin epërsinë e Kinës.”¹³ Edhe qytetërimi i sotëm sinik ka zënë të strukturohet në një mënyrë të ngjashme: bërthama qendrore e Kinës Han, provincat rrethuese që janë pjesë e Kinës, por kanë autonomi të ndjeshme, provincat ligjërisht pjesë e Kinës, por që janë të populluara në pjesën më të madhe prej banorësh jo kinezë të qytetërimeve të tjera (Tibeti, Ksingiang), shoqëritë kineze që do të bëhen ose kanë gjasa të bëhen pjesë e Kinës me qendër në Pekin sipas kushtesh të përcaktuara (Hong-Kongu, Tajvani), një shtet me mbizotërim të kinezëve si popullsi që gjithnjë e më shumë po orientohet nga Pekini (Singapori), popullsitë kineze me ndikim të madh në Tajlandë, Vietnam, Malajzi, Indonezi e Filipine, si dhe shoqëritë jo kineze (Koreja e Veriut dhe e Jugut, Vietnami), që megjithatë kanë të përbashkët me Kinën një pjesë të madhe të kulturës konfuciane.

Gjatë viteve 1950 Kina e përcaktoi veten si aleate e Bashkimit Sovjetik. Pas prishjes kino-sovjetike, ajo e pa

veten si udhëheqëse të Botës së Tretë kundër të dy superfuqive, që i solli shumë shpenzime të rënda por pak përfitime. Pas zhvendosjes që ndodhi në politikën e SHBA gjatë administratës së Niksonit, Kina u përpoq të bëhej pala e tretë në ekuilibrin e lojës së fuqive me dy superfuqitë, kurse gjatë viteve 1970 anoi nga SHBA, kur Shtetet e Bashkuara dukeshin më të dobëta, dhe pastaj rrëshqiti në një pozitë më të baraslarguar në vitet 1980, kur fuqia ushtarake e SHBA u shtua dhe Bashkimi Sovjetik pati rënie ekonomike e u ngatërrua në Afganistan. Mirëpo me mbarimin e garës midis superfuqive, “karta e Kinës” e humbi gjithë vlerën dhe Kina u detyrua sërishmi të ripërcaktonte rolin e vet në punët ndërkombëtare. Ajo vuri përpara vetes dy qëllime: të bëhej mbrojtëse e kulturës kineze, magneti qytetërimor i shtetit bërthamë, drejt të cilit do të orientoheshin gjithë bashkësitë e tjera kineze, dhe të rifitonte pozitën e vet historike si fuqi hegjemone në Azinë Lindore, që e kishte humbur në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Këto role të Kinës që po përvijohen shihen: e para, në mënyrën sesi Kina e përcakton pozitën e saj në punët e botës; e dyta, në përmasat me të cilat kinezët e përtejdetit janë përfshirë ekonomikisht brenda në Kinë; dhe së treti, në lidhjet ekonomike, politike e diplomatike që po shtohen me Kinën nga tri entitete të tjera kryesore kineze: Hong-Kongu, Tajvani dhe Singapori, si dhe nga forcimi i orientimit ndaj Kinës të vendeve të Azisë Juglindore, ku kinezët kanë ndikim të ndjeshëm politik.

Qeveria e Kinës e sheh Kinën kontinentale si shtetin bërthamë të një qytetërimi kinez, drejt të cilit duhet të orientohen gjithë bashkësitë e tjera kineze. Tashmë ajo që prej kohësh i ka braktisur përpjekjet për të përçarur interesat e vet jashtë vendit nëpërmjet partive komuniste vendëse, qeveria është përpjekur “ta vërë

veten në pozitën e përfaqësueses mbarëbotërore të kinezërisë.”¹⁴ Për qeverinë kineze, njerëzit me prejardhje kineze, edhe kur janë qytetarë të një vendi tjetër, vijojnë të jenë anëtarë të bashkësisë kineze dhe, rrjedhimisht, në një farë mase i nënshtrohen autoritetit të qeverisë kineze. Kështu identiteti kinez del se përcaktohet nga pikëpamja raciale. Kinezë janë ata që kanë të njëjtën “racë, gjak e kulturë,” siç e ka formuluar një studiues i RPK. Në mes të viteve 1990 kjo temë nisi të dëgjohej gjithnjë e më shumë nga burimet kineze qeveritare e private. Kështu për kinezët dhe ata me prejardhje kineze, që jetojnë në shoqëri jo kineze, për të provuar se kush janë, bëhet ‘testi i pasqyrës’: “Shko dhe shihu në pasqyrë,” – ky është qortimi i kinezëve të orientuar nga Pekini, që ua bëjnë atyre me prejardhje kineze, të cilët përpiqen të asimilohen në shoqëritë e huaja. Kinezët e diasporës, domethënë *huaren* ose njerëzit me prejardhje kineze, të dalluar prej *zhongguoren* ose njerëzve në shtetin kinez, gjithnjë e më shumë po e paraqesin konceptin e “Kinës kulturore” si shfaqje të *gonshi* të tyre, domethënë vetëdijes së përbashkët. Identiteti kinez, që ka pësuar aq shumë goditje të rënda nga Perëndimi gjatë shekullit të njëzetë, tashmë po riformulohet nga pikëpamja e elementëve vijues të kulturës kineze.¹⁵

Historikisht ky identitet ka qenë i pajtueshëm edhe me marrëdhëniet e ndryshueshme kundrejt autoriteteve qendrore të shtetit kinez. Kjo ndjenjë e identitetit kulturor edhe e lehtëson zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet disa Kinave ekzistuese, edhe përforcohet prej tij, gjë që nga ana e vet, ka qenë një element i rëndësishëm për nxitjen e rritjes së shpejtë ekonomike në Kinën kontinentale e gjetkë, po edhe kjo nga ana e saj, ka dhënë lëndë e nxitje psikologjike për ta rritur më tej identitetin kulturor kinez.

Rrjedhimisht, “Kina e Madhe” nuk është thjesht një nocion abstrakt. Ajo përbën një realitet ekonomik e kulturor në rritje të shpejtë dhe ka nisur të shndërrohet në një realitet politik. Kinezët kanë qenë forca shtytëse e zhvillimit të vrullshëm ekonomik në vitet 1980 dhe 1990: në kontinent, me Tigrat (janë kinezë tre prej katër ndër ta) dhe në Azinë Juglindore. Ekonomia e Azisë Lindore gjithnjë e më tepër po bëhet me mbizotërim kinez e me qendërzim kinez. Kinezët nga Hong-Kongu, Tajvani dhe Singapori kanë dhënë pjesën më të madhe të kapitalit, që ka sjellë rritjen në kontinent në vitet 1990. Kinezët e përtejdetit gjetkë në Azinë Juglindore kanë mbizotëruar në ekonomitë e vendeve të tyre. Në fillim të viteve 1990, kinezët përbënin deri në 1 përqind të popullsisë së Filipineve, por atyre u përkisnin 35 përqind të shitjeve nga firmat me pronësi vendore. Në mesin e viteve 1980 në Indonezi kinezët përbënin 2-3 përqind të popullsisë, por zotëronin rreth 70 përqind të kapitalit privat vendës. Shtatëmbëdhjetë nga njëzet e një bizneset më të mëdha ishin në duart e kinezëve, kurse sipas njoftimeve një konglomerat kinez zinte 5 përqind të PKB-së së Indonezisë. Në fillim të viteve 1990 kinezët ishin 10 përqind e popullsisë së Tajlandës, por zotëronin nëntë të dhjetat të grupeve më të mëdha të biznesit dhe jepnin 50 përqind të PBK-së. Kinezët përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë së Malajzisë, por e sundojnë pothuaj tërësisht ekonominë e saj.¹⁶ Jashtë Japonisë e Koresë, ekonomia e Azisë Lindore në themel është ekonomi kineze.

Krijimi i sferës bashkëlulëzuese të Kinës së Madhe është lehtësuar shumë nga ‘rrjeti prej bambuje’ i marrëdhënieve familjare e personale, si dhe nga kultura e përbashkët. Kinezët e përtejdetit janë shumë më të aftë sesa Perëndimorët ose japonezët për të bërë biznes në Kinë. Besimi dhe angazhimi në Kinë varen prej

kontakteve personale dhe jo prej kontratave ose ligjeve e dokumenteve të tjera legale. Bizensmenët perëndimorë e kanë më të lehtë të bëjnë biznes në Indi, sesa në Kinë, ku zbatimi i përpiktë i një marrëveshjeje mbështetet në marrëdhëniet personale ndërmjet palëve. Siç e ka vënë në dukje me smirë një japonez me peshë më 1993, Kina përfiton nga “një rrjet i pakufi i tregtarëve kinezë në Hong-Kong, Tajvan e Azi Juglindore.”¹⁷ Një biznesmen amerikan pajtohet se kinezët e përtejdetit “kanë aftësi sipërmarrësi, e njohin gjuhën dhe e ndërthurin rrjetin e bambusë që nga marrëdhëniet familjare e deri te kontaktet. Kjo paraqet një epërsi të jashtëzakonshme kundrejt dikujt tjetër, i cili është i detyruar të raportoje në bordin drejtues në Akron ose në Filadelfi.” Epërsitë e kinezëve që nuk janë të kontinentit në afarizmin me ata të kontinentit janë shprehur mirë edhe nga Li Kuan Jui: “Ne jemi kinezë etnikë. Kemi disa karakteristika të përbashkëta prej kulturës dhe prejardhjes së përbashkët ...Njerëzit kanë një mirëkuptim të natyrshëm për ata që kanë tipare të njëjta fizike me ta. Kjo ndjenjë afërie përforcohet kur kanë edhe të njëjtën bazë për kulturën e gjuhën. Kështu bëhen më të lehta marrëdhëniet dhe besimi i ndërsjellë, që janë themeli për të gjitha marrëdhëniet e biznesit.”¹⁸ Nga fundi i viteve 1980 dhe fillimi i viteve 1990 kinezët e përtejdetit qenë në gjendje “t’i dëshmonin botës skeptike se lidhjet *quanxi* nëpërmjet po asaj gjuhe e kulture mund të plotësonin rastin e mungesës së sundimit të ligjit e të transparencës në rregullat e në kriteret.” Në Konferencën e Dytë Botërore të Sipërmarrësve Kinezë që u mbajt në Hong-Kong në nëntor 1993 u nxorën në pah rrënjët e zhvillimit ekonomik brenda një kulture të përbashkët, dhe konferenca u paraqit si “përurim i triumfalizmit kinez, në të cilin morën pjesë biznesmenët kinezë etnikë

nga mbarë bota.”¹⁹ Në botën sinike, si kudo gjetkë, përbashkësia e nxit angazhimin ekonomik.

Pakësimi i lidhjeve ekonomike të Perëndimit me Kinën pas ngjarjeve në Sheshin Tienanmen, që pasoi një dhjetëvjeçar të rritjes së shpejtë ekonomike të Kinës, krijoi mundësitë dhe shtysat për kinezët e përtejdetit, që të nxirrnin përfitime nga kultura e tyre e përbashkët dhe kontaktet personale për të bërë investime të mëdha në Kinë. Si pasojë ndodhi një zgjerim i befasishëm i mbarë lidhjeve ekonomike ndërmjet bashkësive kineze. Më 1992 nga investimet e huaja të drejpërdrejta në Kinë (11,3 miliardë dollarë) 80 për qind erdhën prej kinezëve të përtejdetit, kryesisht nga Hong-Kongu (68,3 për qind), por edhe nga Tajvani (9,3 për qind), Singapori, Makaoja e gjetkë. Përkundrazi, Japonia dha 6,6 për qind dhe Shtetet e Bashkuara 4,6 për qind të shumës së përgjithshme. Nga gjithsej 50 miliardë investime të huaja të grumbulluara, 67 për qind qenë nga burime kineze. Po aq përshtypjëlënëse qe rritja e tregtisë. Eksportet e Tajvanit për në Kinë u rritën nga pothuaj asgjë më 1986 te 8 për qind të gjithë eksporteve të Tajvanit më 1992, kurse atë vit u zgjetuan me një normë 35 për qind. Eksportet e Singaporit për në Kinë u rritën 22 për qind më 1992, në krahasim me rritjen e përgjithshme të eksporteve të tij prej më pak se 2 për qind. Siç ka vënë në dukje Murray Weidenbaum-i (Marri Uajdenbaum) më 1993, “Me gjithë mbizotërimin e tanishëm të Japonisë në këtë rajon, ekonomia e mbështetur te kinezët në Azi po del me shpejtësi si epiqendra e re për industrinë, tregtinë dhe financat. Kjo zonë strategjike ka një sasi të madhe aftësish teknologjike e prodhimi (Tajvani), një aftësi të shkëlqyer depërtuese sipërmarrëse, marketingu e të shërbimeve (Hong-Kongu), një rrjet të mrekullueshëm komunikimesh (Singapori), një kartel të hatashëm kapitali financiar (që të tria) dhe bollëk shumë

të madh toke, burimesh e krahu pune (Kina kontinentale).”²⁰ Natyrisht, përveç këtyre Kina kontinentale, si mundësi, ka qenë tregu më i madh ndër gjithë tregjet që po zgjerohen, kurse nga mesi i viteve 1990 investimet në Kinë gjithnjë e më shumë po orientoheshin nga shitjet në këtë treg, si dhe nga eksportet prej tij.

Kinezët në Azinë Juglindore janë asimiluar në shkallë të ndryshme nga popullsia vendëse, kurse kjo e fundit ka ushqyer ndjenja antikineze, të cilat me raste, siç ndodhi me trazirat në Medan të Indonezisë në prill 1994, shpërthejnë me dhunë. Disa malajzianë e indonezianë e kritikuan si ‘largim kapitali’ rrjedhën e investimeve kineze drejt kontinentit, kurse udhëheqësit politikë të drejtuar nga presidenti Suharto qenë të detyruar të jepnin sigurime për publikun e tyre, se kjo nuk do t’i dëmtonte ekonomitë e tyre. Nga ana e tyre, kinezët e Azisë Juglindore kanë këmbëngulur, se besnikëria e tyre ishte në mënyrë të përcaktuar prerazi kundrejt vendit të lindjes, dhe jo kundrejt stërgjyshëve të tyre. Në fillim të viteve 1990 rrjedha e kapitalit kinez nga Azia Juglindore drejt Kinës është balancuar prej rrjedhës së madhe të investimeve të Tajvanit në Filipinet, Malajzi e Vietnam.

Ndërthurja e fuqisë ekonomike në rritje me kulturën e përbashkët kineze ka sjellë që Hong-Kongu, Tajvani dhe Singapori gjithnjë e më shumë të angazhohen në atdheun kinez. Kinezët e Hong-Kongut, duke iu përshtatur kalimit të pushtetit që po afrohej, nisën të mësoheshin me sundimin nga Pekini dhe jo nga Londra. Biznesmenët dhe udhëheqësit e tjerë nisën të ngurronin për ta kritikuar Kinën ose për të bërë diçka që mund të fyente Kinën. Po kur ndodhte që e fyenin, qeveria kineze nuk ngurronte t’ua shpaguante pa e zgjatur. Aty nga viti 1994 qindra biznesmenë tashmë bashkëpunonin

me Pekinin dhe shërbenin si 'këshilltarë të Hong-Kongut' në atë, që faktikisht ishte një qeveri hije. Në fillim të viteve 1990 ndikimi ekonomik i Kinës mbi Hong-Kongun gjithashtu u zgjerua vrullshëm, me investimet që, siç është njoftuar, aty nga viti 1993 ishin më të mëdha sesa ato që vinin nga Japonia e Shtetet e Bashkuara së bashku.²¹ Aty nga mesi i viteve 1990 integrimi ekonomik i Hong-Kongut me Kinën kontinentale tashmë ishte bërë faktikisht i plotë, kurse integrimi politik do të arrihej më 1997.

Zgjerimi i lidhjeve të Tajvanit me kontinentin mbeti prapa atij me Hong-Kongun. Megjithatë, në vitet 1980 nisën të bëheshin ndryshime të ndjeshme. Për tre dhjetëvjeçarë pas vitit 1949 dy republikat kineze nuk kishin pranuar ta njihnin ekzistencën ose ligjshmërinë e njëra-tjetrës, nuk kishin pasur komunikim ndërmjet tyre dhe ishin faktikisht në gjendje lufte, e cila shfaqej herë pas here me shkëmbim zjarri në ishujt pranë brigjeve. Pasi Teng Hsiao Pini e konsolidoi pushtetin e vet dhe nisi procesin e reformave ekonomike, sidoqoftë, qeveria e kontinentit ndërmori një varg lëvizjesh pajtimi. Më 1981 qeveria e Tajvanit u përgjigj dhe nisi të largohej nga politika e mëparshme e 'tri jo-ve': jo kontakte, jo bisedime, jo kompromis me kontinentin. Në maj 1986 u bënë bisedimet e para ndërmjet përfaqësuesve të të dy palëve për kthimin në Republikën e Kinës të një aeroplani, që ishte grabitur, kurse vitin pasues ROC-ja e hoqi ndalimin për të udhëtuar në kontinent.²²

Zgjerimi i shpejtë i marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Tajvanit e kontinentit, që ndodhi më pas, u lehtësua mjaft nga 'kinezëria e përbashkët' ndërmjet tyre dhe nga besimi i dyanshëm që vinte prej saj. Banorët e Tajvanit e të Kinës, siç e ka vënë në dukje një bashkëbisedues kryesor i Tajvanit, kanë "një ndjenjë se gjaku nuk bëhet ujë" dhe e ndienin veten krenarë për

arritjet e njëri-tjetrit. Aty nga fundi i vitit 1992 ishin bërë mbi 4,2 milion vizita të tajvanasve në kontinent dhe 40.000 vizita të banorëve të kontinentit në Tajvan; çdo ditë shkëmbeheshin 40.000 letra dhe bëheshin 13.000 thirrje telefonike. Tregtia midis dy Kinave, sipas njoftimeve, arriti 14,4 miliardë diollarë më 1993 dhe 20.000 biznese të Tajvanit kishin investuar në kontinent diçka midis 15 miliardëve e 30 miliardëve dollarë. Vëmendja e Tajvanit gjithnjë e më shumë u përqendrua te kontinenti dhe suksesi i vet varej nga kontinenti. “Përpara vitit 1980 tregu më i rëndësishëm për Tajvanin ka qenë Amerika”, ka vënë në dukje një zyrtar tajvanas më 1993, “por për vitet 1990 ne e dimë se faktori më me peshë për suksesin e ekonominë së Tajvanit është kontinenti.” Krahu i punës i lirë i kontinentit ka qenë ana më tërheqëse për investuesit tajvanezë, përballë mungesave të krahut të punës në vendin e tyre. Më 1995 mori udhë një proces prapakthyes për të ndrequr mungesën e baraspeshës ndërmjet kapitalit e krahut të punës mes dy Kinave, kështu kompanitë tajvaneze morën në punë 10.000 kinezë të kontinentit për ekuipazhet e anijeve të tyre.²³

Zhvillimi i lidhjeve ekonomike çoi te bisedimet ndërmjet dy qeverive. Më 1991 Tajvani krijoi Fondacionin e Shkëmbimeve përmes Ngushticave, kurse kontinenti bëri Shoqatën për Marrëdhëniet përmes Ngushticës së Tajvanit, për të komunikuar njëri me tjetrin. Takimi i parë u mbajt në Singapor në prill 1993, ndërsa më pas mbledhjet u bënë në kontinent dhe në Tajvan. Në gusht 1994 një marrëveshje “udhëçelëse” u arrit për një numër çështjesh kyç dhe filluan spekulimet për një takim të mundshëm të nivelit të lartë ndërmjet udhëheqësve më të lartë të të dy qeverive.

Në mes të viteve 1990 ende ekzistonin çështjet më të mëdha ndërmjet Tajpeit dhe Pekinit, ndër to çështja e

sovrانيتit, pjesëmarrja e Tajvanit në organizatat ndërkombëtare dhe mundësia që Tajvani ta ripërcaktonte veten si shtet i pavarur. Porse mundësia që të ndodhë kjo e fundit është larguar gjithnjë e më shumë, sepse përkrahësi kryesor i pavarësisë, Partia Përparimtare Demokratike, e pa se votuesit tajvanas nuk dëshironin t'i shkëpusnin marrëdhëniet ekzistuese me kontinentin dhe kështu perspektivat zgjedhore të saj do të dëmtoheshin nëse do ta shtronte me forcë këtë çështje. Udhëheqësit e PPD-së prandaj theksonin, se po të vinin në pushtet, në rendin e tyre të ditës nuk do të ishte pavarësia si një nga çështjet e ngutshme. Të dyja qeveritë gjithashtu kishin interes të përbashkët për të pohuar sovranitetin kinez mbi Papalinet dhe ishujt e tjerë në Detin e Kinës Jugore, si dhe të siguronin trajtimin si vend i favorizuar nga Amerika për tregtinë me kontinentin. Në fillim të viteve 1990, ngadalë por ndjeshëm të dy Kinat po afroheshin njëra me tjetrën dhe po gjenin interesa të përbashkët ekonomike nga marrëdhëniet e tyre ekonomike në zgjerim e sipër dhe nga identiteti i përbashkët kulturor.

Kjo ecje drejt bashkëpërshtatjes u ndërpre befas më 1995, kur qeveria e Tajvanit bëri trysni në mënyrë agresive për njohjen diplomatike dhe pranimin në organizatat ndërkombëtare. Presidenti Li Teng Hui bëri një vizitë "private" në Shtetet e Bashkuara dhe Tajvani zhvilloi zgjedhjet parlamentare në dhjetor 1995, pas të cilave u bënë zgjedhjet për president në mars 1996. Si kundërpërgjigje, qeveria kineze bëri prova të raketave në ujërat afër porteve më të mëdha tajvaneze dhe zhvilloi manovra ushtarake afër ishujve pranë brigjeve nën administrimin e Tajvanit. Këto ngjarje nxorën dy çështje kyç. A mund të mbetet Tajvani tani për tani demokratik, pa fituar zyrtarisht pavarësinë? Në të ardhmen, a mund

të mbetet Tajvani demokratik, pa qenë aktualisht i pavarur?

Në të vërtetë marrëdhëniet e Tajvanit kundrejt kontinentit kanë kaluar nëpër dy faza dhe mund të hyjnë në të tretën. Për dhjetëra vjet qeveria nacionaliste ka mëtuar se ka qenë qeveri e mbarë Kinës; natyrisht, ky mëtim do të thoshte konflikt me qeverinë, që faktikisht ishte e gjithë Kinës, me përjashtim të Tajvanit. Në vitet 1980 qeveria e Tajvanit e la mënjanë këtë mëtim dhe e përcaktoi veten si qeveria e Tajvanit dhe kjo përbënte bazën për t'u përshtatur me konceptin e kontinentit se kishim "një vend, por dy sisteme". Njerëz e grupe të ndryshme në Tajvan, megjithatë, gjithnjë e më shumë theksonin identitetin kulturor të veçantë të Tajvanit, periudhën relativisht të shkurtër që kishte qenë nën sundimin e Kinës dhe gjuhën vendëse, që nuk kuptohet prej folësve të mandarinishtes. Në thelb, ata po orvateshin ta përcaktonin shoqërinë tajvaneze si jokineze dhe, rrjedhimisht, të pavarur ligjërisht prej Kinës. Veç kësaj, ndërsa qeveria e Tajvanit po bëhej gjithnjë e më aktive në fushën ndërkombëtare, gjithashtu dukej se kishte një mendim, që çonte te një vend i veçantë, domethënë jo pjesë e Kinës. Shkurt, vetëpërcaktimi i qeverisë së Tajvanit duket se po evoluonte nga një qeveri e mbarë Kinës te një qeveri e një pjese të Kinës dhe më tej te një qeveri që s'kishte të bënte me Kinën. Ky qëndrim i fundit, që do ta zyrtarizonte pavarësinë e tij de facto, do të ishte tërësisht i papranueshëm për qeverinë e Pekinit, e cila herë pas here kishte shprehur gatishmërinë se do të përdorte forcën për ta ndaluar materializimin e tij. Udhëheqësit e qeverisë kineze gjithashtu kishin deklaruar se pas rihyrjes së Hong-Kongut në RPK më 1997 dhe të Makaos më 1999, do të ndëmerrnin hapa për ta ribashkuar Tajvanin me kontinentin. Nënkuptohej, që kjo do të ndodhë në

varësi nga shkalla me të cilën mbështetja për pavarësinë zyrtare do të rritet në Tajvan, nga zgjidhja e luftës për pasardhjen në pushtet në Pekin, e cila u jep zemër udhëheqësve politikë e ushtarakë të mbajnë qëndrim të fortë nationalist, dhe nga zhvillimi i aftësive ushtarake të Kinës, që do ta bënin të zbatueshëm bllokimin ose pushtimin e Tajvanit. Në fillim të shekullit të njëzetënjëtë ka të ngjarë që nëpërmjet shtrëngesës, përshtatjes ose, gjë që ka më shumë të ngjarë, duke i ndërthurur të dyja, Tajvani do të jetë i integruar më ngushtë me Kinën kontinentale.

Deri nga fundi i viteve 1970 marrëdhëniet ndërmjet Singaporit antikomunist të patundur dhe Republikës Popullore ishin të acarta, kurse Li Kuan Jui dhe udhëheqësit e tjerë të Singaporit mbanin qëndrim përbuzës ndaj prapambetjes së Kinës. Kur mori udhë zhvillimi ekonomik i Kinës në vitet 1980, atëherë Singapori nisi të riorientohej nga kontinenti sipas mënyrës klasike të vajtjes pas qerres së më të fortit. Aty nga viti 1992 Singapori kishte investuar 1,9 miliard dollarë në Kinë dhe u shpallën plane për vitin pasues se do të ndërtohej një lagje industriale, "Singapori II", jashtë Shangait, e cila do të merrte miliarda dollarë investimesh. Liu u bë përkrahës entuziast i perspektivave ekonomike të Kinës dhe adhurues i fuqisë së saj. "Kina, ka thënë ai më 1993, është aty ku është veprimi."²⁴ Investimet e huaja të Singaporit, që ishin përqendruar gjerësisht në Malajzi e në Indonezi, u zhvendosën drejt Kinës. Gjysma e projekteve të përtejdetit me ndihmën e qeverisë së Singaporit më 1993 ishin në Kinë. Kur bëri vizitën e parë në Pekin në vitet 1970, Li Kuan Jui, sipas njoftimeve, kishte këmbëngulur që t'u fliste udhëheqësve kinezë anglisht e jo në gjuhën mandarine. Nuk ka të ngjarë ta bënte përsëri këtë dy dhjetëvjeçarë më vonë.

Islami: vetëdija pa kohezion

Struktura e besnikërisë politike ndër arabët e ndërmjet myslimanëve përgjithësisht ka qenë e kundërta me atë që vërehet në Perëndimin e kohëve të reja. Për këtë të fundit shteti-komb ka qenë kulmi i besnikërisë politike. Asaj i nënshtrohen shfaqjet më të ngushta të besnikërisë dhe përmbledhen te besnikëria ndaj shtetit-komb. Grupimet që i kalojnë kufijtë e shteteve-kombe, siç janë bashkësitë gjuhësore ose fetare, apo qytetërimet, kanë kërkuar besnikëri dhe angazhim më pak të fortë. Përgjatë një vazhdimësie tërësish nga më të voglat deri te më të mëdhatë, shfaqjet e besnikërisë Perëndimore priren kështu të kulmojnë në mes, ndërsa lakorja e intensitetit në një farë mase përbën një shkronjë U të përmbysur. Në botën islamike struktura e besnikërisë ka qenë pothuaj krejt e kundërta. Islami ka pasur një mes të zbrazët në hierarkinë e shfaqjeve të besnikërisë. Siç e ka vënë re Ira Lapidus, “Dy struktura themelore, origjinale dhe të qëndrueshme” kanë qenë familja, fisi, klani, nga njëra anë, dhe “njësitë e kulturës, fesë e perandorisë në një shkallë gjithnjë e më të gjerë”, nga ana tjetër.²⁵ Një dijetar libias po ashtu ka vënë re se “Organizimi fisnor dhe feja (Islami) kanë luajtur dhe vijojnë të luajnë rol të rëndësishëm e vendimtar në zhvillimet shoqërore, ekonomike, kulturore e politike në shoqëritë dhe në sistemet politike arabe. Në të vërtetë, ato janë të ndërthurura në një mënyrë të atillë, sa quhen faktorët dhe ndryshoret më të rëndësishme, të cilat i japin trajtë dhe e përcaktojnë kulturën politike arabe, mendjen politike arabe.” Fiset kanë qenë në qendër të politikës së shteteve arabe, shumë prej të cilave, siç e ka shprehur Tahsin Bashiri, thjesht janë “fise me bajrak.” Themeluesi

i Arabisë Saudite në një masë të madhe pati sukses si rrjedhim i shkathtësive të tij për të krijuar një koalicion fisnor nëpërmjet martesave e mjeteve të tjera, kurse politika saudite vijon të jetë gjerësisht një politikë fisnore, që kundërvë sudairët kundër shamarëve dhe fiseve të tjera. Të paktën tetëmbëdhjetë fise kryesore kanë luajtur rol të madh në zhvillimin e Libisë, kurse në Sudan thuhet se jetojnë një pesëqind fise, ndër të cilat më i madhi përfshin 12 për qind të popullsisë së vendit.²⁶

Historikisht në Azinë Qendrore nuk kanë ekzistuar identitetet kombëtare. “Besnikëria shfaqej kundrejt fisit, klanit dhe familjes së gjerë, jo ndaj shtetit.” Në skajin tjetër, njerëzit kishin të përbashkëta “gjuhën, fenë, kulturën dhe mënyrën e jetesës”, ndërsa “Islami ishte forca më e fuqishme bashkuese mes njerëzve, shumë më tepër sesa pushteti i emirit.” Disa nga qindra fiset ‘malësore’ e ‘fusharake’ gjithnjë kanë ekzistuar te çeçenët dhe te popujt në farefisni me ta të Kaukazit Verior, ato kanë pasur në duar politikën dhe ekonominë në ato përmasa, sa që në kundërshtim me ekonominë e planifikuar sovjetike, çeçenët thuhej se kishin një ‘ekonomi fisnore’.²⁷

Në mbarë islamin vatrat kryesore të besnikërisë e të angazhimit kanë qenë grupet e vogla dhe besimi i madh, fisi dhe *umeti*, ndërsa shteti-komb ka pasur më pak rëndësi. Në botën arabe shtetet ekzistuese kanë probleme të ligjshmërisë, sepse në pjesën më të madhe janë produkte arbitrare, në mos të trilleve, të imperializmit evropian, kurse kufijtë e tyre shpesh as që përputhen me kufijtë e grupeve etnike, si ato të berberëve e të kurdëve. Këto shtete e kanë përçarë kombin arab, por nga ana tjetër, kurrë nuk është materializuar një shtet panarab. Veç kësaj, ideja e shteteve-kombe sovraane nuk përputhet me besimin te

sovrانيتeti i Allahut dhe përparësia e *umetit*. Si lëvizje revolucionare, fundamentalizmi islamik e hedh poshtë shtetin-komb në të mirë të unitetit të islamit, ashtu si marksizmi e hidhte poshtë në të mirë të unitetit të proletariatit ndërkombëtar. Dobësia e shtetit-komb në islam pasqyrohet gjithashtu në faktin, se ndërsa kanë ndodhur shumë konflikte ndërmjet *grupeve* myslimane gjatë viteve pas Luftës II Botërore, luftërat e mëdha ndërmjet *shteteve* myslimane kanë qenë të rralla, ndër to më të rëndësishmet kanë qenë ato, kur Iraku ka pushtuar fqinjët.

Në vitet 1970 e 1980 të njëjtët faktorë, të cilët brenda vendeve sollën ngritjen e Ringjalljes Islamike, po ashtu forcuan identifikimin me *umetin* ose qytetërimin islamik si tërësi. Siç e ka vënë në dukje një studiuës në mes të viteve 1980:

Një preokupim i thellë për identitetin dhe unitetin mysliman ka marrë shtysa të mëtejme nga shkolonizimi, shtimi demografik, industrializimi, urbanizimi dhe ndryshueshmëria e rendit ndërkombëtar, të shoqëruar, ndër të tjera, nga pasuria e naftës nën tokën e vendeve myslimane ...Komunikimet moderne i kanë zhvilluar dhe fuqizuar lidhjet ndërmjet popujve myslimanë. Ka pasur një rritje të pandërprerë të numrit të atyre që shkojnë për haxhillëk në Mekë, duke krijuar një ndjenjë më të fortë të identitetit ndër myslimanët që prej aq larg sa Kina e Senegali, Jemeni e Bangladeshi. Gjithnjë e më shumë studentë nga Indonezia, Malajzia dhe Filipinet e Jugut e Afrika po vijnë të studiojnë në universitetet e Lindjes së Mesme, duke përhapur ide dhe duke vendosur kontakte personale përmes kufijve kombëtarë. Organizohen konferenca dhe konsultime të rregullta gjithnjë e më dendur mes intelektualëve myslimanë dhe *ulemave* (dijetarëve fetarë), që mbahen në qendra të tilla, si Teherani, Meka dhe Kuala Lumpur...Me kaseta (zanore e tashti me video) përhapen lutjet e xhamive duke i kapërcyer kufijtë ndërkombëtarë, kështu që predikuesit

me ndikim tashti e çojnë zërin e tyre në auditore shumë larg bashkësive të tyre vendore.²⁸

Ndjenja e unitetit mysliman gjithashtu është pasqyruar dhe ka marrë shtysa nga veprimet e shteteve e të organizatave ndërkombëtare. Më 1969 udhëheqësit e Arabisë Saudite, në bashkëpunim me ata të Pakistanit, Marokut, Iranit, Tunizisë dhe Turqisë organizuan konferencën e parë islamike të nivelit të lartë në Rabat. Prej saj doli Organizata e Konferencës Islamike, e cila zyrtarisht u vendos në selinë e Xhedahut më 1972. Në të vërtetë gjithë shtetet me popullsi kryesisht myslimane tashti marrin pjesë në këtë Konferencë, që është vetëm një organizatë ndërshtetërore e këtij lloji. Qeveritë e krishtera, ortodokse, budiste, hindu nuk kanë organizata ndërshtetërore me anëtarësim të mbështetur te feja, kurse qeveritë myslimane i kanë. Veç kësaj, qeveritë e Arabisë Saudite, Pakistanit, Iranit dhe Libisë kanë përkrahur e mbështetur organizatat joqeveritare, si Kongresin Mysliman Botëror (një krijim i Pakistanit) dhe Lidhjen e Botës Myslimane (një krijesë e Arabisë Saudite), si dhe “një numër të madh regjimesh, partish, lëvizjesh dhe çështjesh, shpesh në largësi mjaft të mëdha, që besohet se kanë të përbashkëta orientimet e tyre ideologjike” dhe të cilat “po pasurojnë rrjedhën e informacionit dhe burimet ndërmjet myslimanëve.”²⁹

Megjithatë, lëvizja nga vetëdija islame drejt kohezionit islamik ngërthen dy paradokse. Së pari, islami është i përçarë ndërmjet disa qendrash pushteti në konkurrencë midis tyre, ndërkohë që secila prej tyre përpiqet të nxjerrë leverdi nga identifikimi mysliman me një *umet*, që të arrijë të mbështesë kohezionin islamik nën udhëheqjen e vet. Kjo konkurrencë zhvillohet ndërmjet regjimeve të konsoliduara e organizatave të tyre, nga njëra anë, dhe regjimeve islamiste e

organizatave të tyre, nga ana tjetër. Arabia Saudite mori epërsinë kur krijoi OKI-në pjesërisht për të kundërpeshuar Lidhjen Arabe, e cila në atë kohë ishte nën sundimin e Naserit. Pas Luftës së Gjirit më 1991, udhëheqësi sudanez Hasan al-Turabi krijoi Konferencën Popullore Arabe (KPAI) si kundërvënie ndaj OKI-së ku mbizotëronte Arabia Saudite. Në Konferencën e tretë të KPAI-t në fillim të vitit 1995 në Hartum morën pjesë disa qindra delegatë nga organizatat dhe lëvizjet islamiste të tetëdhjetë vendeve.³⁰ Përveç këtyre organizatave zyrtare, lufta në Afganistan solli krijimin e një rrjeti të gjerë grupesh jozyrtare dhe ilegale të veteranëve, që e kanë treguar veten duke luftuar për çështjen myslimane ose islamiste në Algjeri, Çeçeni, Egjipt, Tunizi, Bosnjë, Palestinë, Filipine e gjetkë. Pas luftës radhët e tyre u përtërinë me luftëtarë të stërvitur në Universitetin e Davas dhe Xhihadit jashtë Peshavarit, si dhe në kampet e mbështetura nga fraksionet e ndryshme dhe përkrahësit e tyre të huaj në Afganistan. Interesat e përbashkëta që kanë regjimet dhe lëvizjet radikale me raste madje kanë kapërcyer antagonizmat tradicionalë dhe me ndihmën e Iranit janë krijuar lidhje mbështetëse ndërmjet grupeve fundamentaliste suni e shiite. Ka një bashkëpunim të ngushtë ushtarak ndërmjet Sudanit e Iranit, forcat ajrore të Iranit dhe flota ushtarake kanë përdorur pajisjet aeroportuale sudaneze, kurse të dy qeveritë kanë bashkëpunuar për të mbështetur grupet fundamentaliste në Algjeri e gjetkë. Thuhet se Hasan al-Turabi dhe Sadam Huseini kanë vendosur lidhje të ngushta më 1994, kurse Irani e Iraku bënë hapa drejt pajtimit.³¹

Së dyti, nocioni i *umetit* nënkupton se është i paligjshëm shteti-komb, por megjithatë *umeti* mund bashkohet vetëm nëpërmjet veprimeve të njërit ose të më shumë shteteve bërthamë të forta, që aktualisht

mungojnë. Nocioni i Islamit si një bashkësi fetare-politike e bashkuar do të thotë që shtetet bërthamë zakonisht janë bërë realitet në të kaluarën vetëm kur udhëheqja fetare e politike – kalifati e sulltanati – kanë qenë ndërthurur në një institucion të vetëm sundues. Pushtimi i shpejtë i Afrikës së veriut dhe i Lindjes së Mesme nga arabët e shekullit të shtatë arriti kulmin me kalifatin Umajjad, që e kishte kryeqytetin në Damask. Pas tij në shekullin e tetë erdhi Kalifati Abasid me bazë në Bagdad dhe nën ndikimin persian, ndërsa në shekullin e dhjetë në Kajro e në Kordovë lindën kalifate dytësore. Katërqind vjet më pas turqit osmanë u përhapën në Lindjen e Mesme, pushtuan Konstantinopolin më 1453 dhe ngritën një kalifat të ri më 1517. Afërsisht në të njëjtën kohë popullsi të tjera turkike pushtuan Indinë dhe themeluan Perandoritë Mogule, porse rënia e Perandorisë Osmane e la islamin pa një shtet bërthamë. Në pjesën më të madhe territoret e perandorisë u ndanë mes fuqive Perëndimore, të cilat kur u tërhoqën, nga ana e tyre lanë pas shtete të brishta, të formuara sipas modelit Perëndimor, të huaja për traditat e islamit. Rrjedhimisht, gjatë pjesë më të madhe të shekullit të njëzetë asnjë prej vendeve myslimane nuk pati as fuqi të mjaftueshme dhe as ligjshmëri të mjaftueshme kulturore e fetare, që ta merrte atë rol dhe të pranohej si udhëheqës i islamit nga shtetet e tjera islamike e nga vendet joislamike.

Mungesa e një shteti bërthamë islamik ka qenë shkaku kryesor për konfliktet e përhapura të brendshme e të jashtme, që e kanë karakterizuar islamin. Vetëdija pa kohezion është një nga burimet e dobësisë së islamit dhe një burim kërcënimi kundrejt qytetërimeve të tjera. A ka gjasa që kjo gjendje të vazhdojë?

Një shtet bërthamë islamik duhet të zotërojë burimet ekonomike, fuqinë ushtarake, kompetencën

organizative dhe identitetin e përkushtimin islam për të siguruar udhëheqjen si politike, edhe fetare për *umetin*. Si udhëhqës të mundshëm të islamit herë pas here përmenden gjashtë shtete; sot për sot asnjëri prej tyre, megjithatë, nuk i plotëson të gjitha kërkesat për të qenë një shtet bërthamë i efektshëm. Indonezia është vendi mysliman më i madh dhe ka rritje ekonomike të shpejtë. Mirëpo ajo ndodhet në periferi të islamit, mjaft larg nga qendra e tij arabe; islami i saj është i variantit të çlirët të Azisë Juglindore, kurse popullsia dhe kultura e saj janë një përzierje e ndikimeve vendëse, myslimane, hindu, kineze e të krishtera. Egjipti është vend arab, ka popullsi të madhe, gjendet në një pozicion qendror, gjeografikisht me rëndësi strategjike në Lindjen e Mesme dhe ka një institucion kryesor të dijes islamike, Universitetin e Al-Azharit. Mirëpo është vend i varfër, ekonomikisht i varur nga Shtetet e Bashkuara, nga institucionet ndërkombëtare nën kontrollin Perëndimor dhe nga shtetet arabe të pasura me naftë.

Irani, Pakistani dhe Arabia Saudite - të gjitha e kanë përcaktuar hapur veten si vende myslimane dhe kanë bërë përpjekje aktive për të ushtruar ndikim të *umeti* e për të arritur udhëheqjen e tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, ato kanë qenë në konkurrencë njëra me tjetrën për mbështetjen financiare të organizatave, kanë financuar grupe islamike, u kanë dhënë mbështetje luftëtarëve në Afganistan dhe janë përpjekur të bëjnë për vete popujt myslimanë të Azisë Qendrore. Irani i ka përmasat, pozicionin në qendër, popullsinë, traditat historike, burimet e naftës dhe nivelin mesatar të zhvillimit ekonomik, që do ta nxirrnin si një shtet bërthamë islamik. Mirëpo nëntëdhjetë për qind e myslimanëve janë suni dhe shiitë iranas; persishtja është mjaft larg si gjuha e dytë pas arabishtes për të qenë gjuhë

e islamit dhe marrëdhëniet ndërmjet persëve e arabëve historikisht kanë qenë antagoniste.

Pakistani ka përmasat, popullsinë dhe fuqinë ushtarake, kurse udhëheqësit e tij në mënyrë mjaft këmbëngulëse janë përpjekur të marrin rolin e nxitësve të bashkëpunimit ndërmjet shteteve islamike e të zëdhënësit të islamit ndaj botës tjetër. Megjithatë, Pakistani është relativisht i varfër dhe vuan nga përçarje të brendshme të rënda etnike e krahinore, ka një histori paqëndrueshmërie politike dhe është mbërthyer nga problemi i sigurisë përballë Indisë, madje prej këtij vjen në pjesën më të madhe interesi i tij për marrëdhënie të ngushta me vendet e tjera islamike, si dhe me fuqitë jomyslimane, si Kina e Shtetet e Bashkuara.

Arabia Saudite ka qenë vendlindja e islamit; tempujt më të shenjtë islamikë ndodhen atje; gjuha e saj është gjuha e islamit, ajo ka rezervat më të mëdha të botës me naftë dhe ndikimin përkatës që vjen nga ana financiare, kurse qeveria e saj e ka formësuar shoqërinë saudite sipas parimeve të rrepta islamike. Gjatë viteve 1970 e 1980 Arabia Saudite ka qenë e vetmja forcë më me ndikim në islam. Ajo ka shpenzuar miliarda dollarë për të mbështetur çështjen myslimane në mbarë botën, që nga xhamitë e tekstet dhe deri te partitë politike, organizatat islamiste dhe lëvizjet terroriste, kurse i ka kryer këto relativisht pa bërë diskriminime. Nga ana tjetër, popullsia e saj relativisht e vogël dhe cenueshmëria e pozicionit gjeografik e bëjnë të varur prej Perëndimit për sigurinë e vet.

Së fundi, Turqia ka historinë, popullsinë, nivelin mesatar të zhvillimit ekonomik, koherencën kombëtare dhe traditat ushtarake e kompetencën për të qenë shteti bërthamë i Islamit. Mirëpo Ataturku, që e përcaktoi shprehur Turqinë si shoqëri shekullare, e ka penguar Republikën Turke që të jetë pasardhëse e Perandorisë

Osmane me atë rol. Turqia nuk mundi as të bëhej anëtare nënshkruese e OKI-së, për shkak të përkushtimit ndaj shekullarizmit të përfshirë në kushtetutën e saj. Për sa kohë Turqia ta përcaktojë veten si shtet shekullar, do t'i mohohet udhëheqja e islamit.

Megjithatë, çfarë do të ndodhte, sikur Turqia ta ripërcaktonte veten? Në një farë momenti, Turqia mund të ishte e gatshme të hiqte dorë nga roli ndrydhës e përrulës si lypëse, që kërkon të anëtarësohet në Perëndim, dhe të rimerrte rolin historik më të lartë e më mbresëlënës si bashkëbiseduesi kryesor islamik dhe antagonist i Perëndimit. Në Turqi fundamentalizmi ka pasur rritje; në periudhën e Ozalit Turqia bëri përpjekje të gjera për ta identifikuar veten me botën arabe; ajo ka përfituar nga lidhjet etnike e gjuhësore për të luajtur një rol modest në Azinë qendrore; u ka dhënë nxitje e mbështetje myslimanëve të Bosnjës. Ndër vendet myslimane Turqia është e vetmja që ka lidhje të gjera historike me myslimanët në Ballkan, në Lindjen e Mesme, në Afrikën e Veriut dhe në Azinë Qendrore. Mund të përfytyrohej që Turqia, në të vërtetë mund “të bënte si Afrika e Jugut”: të hiqte dorë nga shekullarizmi si diçka e huaj për të, ashtu siç braktisi aparteidin Afrika e Jugut dhe rrjedhimisht, të ndryshonte si shtet i rangut të ulët në qytetërimin e vet dhe të bëhej shtet udhëheqës i atij qytetërimi. Pasi kishte provuar të mirat e të këqijat e Perëndimit në krishterim dhe aparteidin, Afrika e Jugut në veçanti i kishte cilësitë për të udhëhequr Afrikën. Pasi i kishte provuar të mirat e të këqijat e Perëndimit në shekullarizëm e demokraci, Turqia po ashtu mund t'i kishte cilësitë për të udhëhequr islamin. Por që ta bënte këtë, i duhej të hidhte poshtë trashëgiminë e Ataturkut më rrënjësisht sesa Rusia ka hedhur poshtë trashëgiminë e Leninit. Kjo do të kërkonte gjithashtu një udhëheqës të kalibrit të Ataturkut dhe një njeri, që të ndërthurte

ligjshmërinë fetare e politike për ta shndërruar Turqinë nga një vend i përçarë në një shtet bërthamë.

IV: Përplasjet e qytetërimeve

Kreu 8: Perëndimi dhe të tjerët: çështjet ndërqytetërimore

Universalizmi perëndimor

Në botën që po përftohet, marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe grupeve prej qytetërimesh të ndryshme nuk do të jenë të ngushta dhe shpesh do të jenë antagoniste. Ndërkaq, disa marrëdhënie ndërqytetërimore janë më të prirura për konflikte sesa disa të tjera. Në mikronivel, vijat e shkëputjes më të dhunshme kalojnë ndërmjet islamit dhe fqinjëve të tij ortodoksë, hindu, afrikanë e të krishterë Perëndimorë. Në makronivel, ndarja mbisunduese është ndërmjet “Perëndimit dhe të tjerëve”, ndërsa konfliktet më të forta ndodhin ndërmjet shoqërive myslimane e aziatike, nga njëra anë, dhe Perëndimit, nga ana tjetër. Përplasjet e rrezikshme në të ardhmen ka gjasa që të shkaktohen nga ndërveprimi i arrogancës Perëndimore, intolerancës islamike dhe vetësigurisë aziatike.

Ndër qytetërimet, vetëm Perëndimi ka pasur një ndikim të madh e nganjëherë shkatërrimtar mbi secilin qytetërim tjetër. Raporti ndërmjet fuqisë e kulturës së Perëndimit dhe fuqisë e kulturës së qytetërimeve të tjera,

si rrjedhim, është karakteristika më gjithëpërfshirëse e botës së qytetërimeve. Me rritjen e pushtetit relativ të qytetërimeve të tjera, forca tërheqëse e kulturës Perëndimore venitet dhe popujve jo-Perëndimorë u shtohet besimi dhe përkushtimi ndaj kulturave të tyre autoktone. Problemi qendror në marrëdhëniet ndërmjet Perëndimit dhe të tjerëve, rrjedhimisht, është mospërputhja ndërmjet përpjekjeve të Perëndimit – në veçanti të Amerikës – për të nxjerrë në pah një kulturë universale Perëndimore dhe aftësisë së tij për ta arritur këtë.

Shembja e komunizmit e thelloi këtë mospërputhje, sepse në Perëndim përforcoi pikëpamjen, se ideologjia e liberalizmit demokratik kishte ngadhënjyer në shkallë globale e rrjedhimisht, ishte me vlerë universale. Perëndimi, e në veçanti Shtetet e Bashkuara, që gjithnjë kanë qenë një shtet misionar, besojnë se popujt jo-Perëndimorë duhet t'u drejtohen vlerave Perëndimore të demokracisë, tregjeve të lira, kufizimit të qeverisë, të drejtave të njeriut, individualizmit, shtetit të së drejtës, dhe duhet që këto vlera t'i mishërojnë në institucionet e tyre. Pakicat në qytetërimet e tjera i përqafojnë dhe i përkrahin këto vlera, por në shoqëritë jo-Perëndimore qëndrimet mbizotëruese kundrejt tyre shkojnë që nga skepticizmi shumë i përhapur e deri te kundërshtimi i fortë. Ajo që për Perëndimin është universalizëm, për të tjerët është imperializëm.

Perëndimi po përpiqet dhe do të vazhdojë të bëjë përpjekje që ta ruajë pozitën e vet mbizotëruese e të mbrojë interesat e vet, duke i përcaktuar këto si interesa të “bashkësisë ndërkombëtare”. Kjo shprehje është bërë emër përmbledhës eufemistik (ka zëvendësuar ‘Botën e Lirë’) për t'u dhënë trajtën globale të ligjshmërisë veprimeve, të cilat pasqyrojnë interesat e Shteteve të Bashkuara dhe të fuqive të tjera Perëndimore. Për

shembull, Perëndimi po orvatet të integrojë ekonominë e shoqërive jo-Perëndimore në një sistem ekonomik global, në të cilin mbisunon. Nëpërmjet FMN-së dhe institucioneve të tjera ekonomike ndërkombëtare, Perëndimi u jep shtysa interesave të vet ekonomike dhe u imponon shteteve të tjera politikat ekonomike që i mendon se janë të përshtatshme. Mirëpo në çfarëdo sondazhi të popujt jo-Perëndimorë pa asnjë dyshim FMN-ja do të fitonte mbështetjen e ministrave të financave dhe të pak njerëzve të tjerë, por do të merrte një përqindje mbizotëruese negative prej pothuaj gjithë njerëzve të tjerë, të cilët do të pajtoheshin me përcaktimin që u ka bërë Georgi Arbatovi zyrtarëve të FMN-së si “neobolshevikë, të cilëve u pëlqen të shpronësojnë paratë e njerëzve të tjerë, duke u imponuar rregulla të sjelljes ekonomike e politike jodemokratike e të huaja për ta dhe një liri ekonomike mbytëse.”¹

Po ashtu, jo-Perëndimorët nuk ngurrojnë të vënë në dukje hendekun ndërmjet parimeve dhe veprimeve të Perëndimit. Çmimi i pretendimeve universaliste janë hipokrazia, standardet e dyfishta dhe “por-et”. Demokracia gjen përkrahje, por jo nëse i sjell në pushtet fundamentalistët islamikë; mospërhapja e armëve të shkatërrimit në masë predikohet për Irakun dhe Iranin, por jo për Izraelin; tregtia e lirë është eliziri i rritjes ekonomike, por jo për bujqësinë; të drejtat e njeriut janë një çështje për Kinën, por jo për Arabinë Saudite; agresioni kundër kuvajtianëve pronarë të naftës zbrapset me pjesëmarrje masive, por jo për bosnjakët, që nuk zotërojnë puse naftë. Standardet e dyfishta në praktikë janë çmimi i pashmangshëm i standardeve universale të parimeve.

Pasi e arrijnë pavarësinë politike, shoqëritë jo-Perëndimore duan të çlirohen nga sundimi ekonomik, ushtarak dhe kulturor Perëndimor. Shoqëritë e Azisë

Lindore kanë hyrë mbarë në udhën e tyre për t'u barazuar me Perëndimin ekonomikisht. Vendet aziatike dhe islamike po synojnë të gjejnë rrugë më të shkurtra që të baraspeshohen me Perëndimin ushtarakisht. Aspiratat universale të qytetërimit Perëndimor, rënia relative e pushtetit të Perëndimit dhe rritja e vetësigurisë kulturore të qytetërimeve të tjera përgjithësisht sjellin marrëdhënie të vështira ndërmjet Perëndimit dhe të tjerëve. Natyra e këtyre marrëdhënieve dhe përmasa në të cilën janë antagonistë, megjithatë, ndryshojnë shumë dhe ndahen në tri kategori. Me qytetërimet sfiduese, islamit e Kinën, Perëndimi ka të ngjarë që të ketë marrëdhënie mjaft të tendosura dhe shpesh tepër antagonistë. Marrëdhëniet e tij me Amerikën Latine dhe Afrikën, si qytetërime më të dobëta, që në një farë mase kanë qenë të varura prej Perëndimit, do të kenë nivele shumë më të ulëta konflikti, sidomos me Amerikën Latine. Marrëdhëniet e Rusisë, Japonisë dhe Indisë me Perëndimin ka të ngjarë të klasifikohen midis atyre të dy grupeve të tjera, duke pasur elementë bashkëpunimi e konflikti, pasi këto tre shtete bërthamë herë ecin në një radhë me qytetërimet sfiduese, dhe herë shkojnë me Perëndimin. Ato janë qytetërime "luhatëse" ndërmjet Perëndimit, nga njëra anë, dhe qytetërimeve islamike e sinike, nga ana tjetër.

Islami dhe Kina mishërojnë tradita të mëdha kulturore mjaft të ndryshme nga të Perëndimit dhe sipas vështrimit të tyre, shumë herë më eprore kundrejt tij. Fuqia dhe ngulmimi i të dyve kundrejt Perëndimit po vijnë duke u shtuar, kurse konfliktet ndërmjet vlerave e interesave të tyre dhe vlerave e interesave të Perëndimit po shumëfishohen e po bëhen më të forta. Për shkak se islamit i mungon një shtet bërthamë, marrëdhëniet e tij me Perëndimin kanë ndryshime shumë të mëdha nga një vend në tjetrin. Megjithatë, që prej viteve 1970 ka pasur

një prirje mjaft të qëndrueshme antiperëndimore, të cilën e kanë shoqëruar ngritja e fundamentalizmit, zhvendosjet e pushtetit brenda vendeve myslimane me qeveri nga më properëndimore te më antiperëndimore, shfaqja e pothuajse luftës ndërmjet disa grupeve islamike me Perëndimin dhe dobësimi i lidhjeve të sigurisë të kohës së Luftës së ftohtë, që kishin qenë ndërmjet disa shteteve myslimane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Prapa këtyre dallimeve për çështje të veçanta ndodhet çështja themelore për rolin, që këto qytetërime do të luajnë kundrejt Perëndimit në formësimin e së ardhmes së botës. Institucionet globale, shpërndarja e pushtetit dhe politikat e ekonomitë e vendeve në shekullin e njëzetënjëtë a do të pasqyrojnë kryesisht interesat dhe vlerat Perëndimore, apo do ta marrin trajtën kryesisht sipas atyre të islamit e të Kinës?

Teoria realiste për marrëdhëniet ndërkombëtare parashikon që shtetet bërthamë të qytetërimeve joperëndimore do të lidhen së bashku si kundërpeshë ndaj fuqisë mbizotëruese të Perëndimit. Kjo ka ndodhur në disa zona. Megjithatë, një koalicion i përgjithshëm anti-perëndimor duket se nuk ka gjasa të bëhet në të ardhmen e afërt. Qytetërimi islamik dhe ai sinik kanë dallime themelore nga pikëpamja e fesë, kulturës, strukturës shoqërore, traditave, politikës dhe parimeve bazë që janë në rrënjët e mënyrës së tyre të jetesës. Nga ana e brendshme secili ndoshta ka më pak gjëra të përbashkëta me njëri-tjetrin, sesa ka me qytetërimin Perëndimor. E megjithatë, në politikë një armik i përbashkët krijon një interes të përbashkët. Shoqëritë islamike dhe sinike, që e shohin Perëndimin si antagonistin e tyre, kanë kështu arsye që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën kundër Perëndimit, madje po ashtu siç bashkëpunuan Aleatët dhe Stalini kundër Hitlerit. Ky bashkëpunim bëhet për një varg

çështjesh, duke përfshirë të drejtat e njeriut, ekonominë dhe sidomos përpjekjet prej shoqërive në të dy qytetërimet për të zhvilluar aftësitë e tyre ushtarake, në veçanti armët e shkatërrimit në masë dhe raketat për bartjen e tyre, në mënyrë që të kundërveprojnë ndaj epërsisë që ka Perëndimi në armatimet ushtarake konvencionale. Nga fillimi i viteve 1990 ishte arritur një 'lidhje islamike-konfuciane' ndërmjet Kinës e Koresë së Veriut, nga njëra anë, dhe në shkallë të ndryshme me Pakistanin, Iranin, Irakun, Sirinë, Libinë e Algjerinë, nga ana tjetër, për t'u përballur me Perëndimin për këto çështje.

Çështjet që i ndajnë Perëndimin dhe shoqëritë e tjera po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në rendin e ditës të botës. Përpjekjet e Perëndimit kanë të bëjnë me tri çështje të tilla: (1) të mbajë epërsinë e tij ushtarake nëpërmjet politikës së mospërhapjes dhe të kundërshtimit të përhapjes lidhur me armët bërthamore, biologjike e kimike, si dhe të mjeteve për lëshimin e tyre; (2) të mbështeten vlerat politike dhe institucionet Perëndimore, duke u bërë trysni shoqërive të tjera që të respektojnë të drejtat e njeriut; dhe (3) të mbrohet integriteti kulturor, shoqëror dhe etnik i shoqërive Perëndimore, duke e kufizuar numrin e jo-Perëndimorëve që pranojnë si imigrantë ose si refugjatë. Në të tria këto fusha Perëndimi ka pasur dhe ka gjasa që do të vazhdojë të ketë vështirësi për të mbrojtur interesat e vet kundër atyre të shoqërive jo-Perëndimore.

Përhapja e armëve

Përhapja e mjeteve dhe aftësive ushtarake është pasojë e zhvillimit global ekonomik e shoqëror. Duke u bërë më të pasura ekonomikisht, Japonia, Kina dhe vende të tjera aziatike do të bëhen më të fuqishme edhe ushtarakisht, ashtu siç do të bëjnë në fund edhe shoqëritë islamike. Kështu do të ndodhë edhe me Rusinë, nëse do ta bëjë me sukses reformën në ekonomi. Dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të njëzetë kanë qenë dëshmitarë, sesi shumë shtete jo-Perëndimore kanë marrë armë të sofistikuarra nëpërmjet transferimeve të armëve nga shoqëritë Perëndimore, Rusia, Izraeli e Kina, si dhe kanë ngritur uzina vendëse për prodhimin e armëve për armatime shumë të sofistikuarra. Këto procese do të vijojnë dhe ndoshta do të përshpejtohen gjatë viteve të para të shekullit të njëzetënjëtë. E megjithatë, gjatë këtij shekulli të ri Perëndimi, duke pasur parasysh kryesisht Shtetet e Bashkuara me disa plotësime nga Britania e Franca, do të mbeten i vetmi vend që do të jetë në gjendje të ndërhyjë ushtarakisht pothuaj në çdo pjesë të botës. Dhe vetëm Shtetet e Bashkuara do të kenë fuqinë ajrore të aftë për të bombarduar në të vërtetë cilindo vend të botës. Këta janë elementë qendrorë të pozitës ushtarake të Shteteve të Bashkuara si fuqi globale dhe të Perëndimit si qytetërimi mbisundues i botës. Për të ardhmen e afërt peshorja e fuqisë ushtarake me armë konvencionale ndërmjet Perëndimit dhe të tjerëve do të jetë në mënyrë dërrmuese nga ana e Perëndimit.

Koha, përpjekjet dhe shpenzimet që kërkohen për të zhvilluar aftësinë ushtarake me armë konvencionale të klasit të parë u ngjallin shtysa kolosale shteteve jo-

Perëndimore që të ndjekin rrugë të tjera për të përballuar fuqinë ushtarake të Perëndimit me armë konvencionale. Rruga më e shkurtër që mund të mendohet është gjetja e armëve të shkatërrimit në masë dhe e mjeteve për bartjen e tyre. Shtetet bërthama të qytetërimeve dhe vendet që janë ose aspirojnë të bëhen fuqi mbisunduese rajonale, kanë shtysa të veçanta për t'i gjetur këto armë. Armë të tilla, së pari, u mundësojnë këtyre shteteve që të vendosin mbisundimin e tyre mbi shtetet e tjera në qytetërimin e tyre dhe në rajon, e së dyti, u sigurojnë mjetet për të penguar ndërhyrjen në qytetërimet e tyre dhe në rajon nga Shtetet e Bashkuara ose nga fuqi të tjera të jashtme. Nëse Sadam Hyseini do ta kishte shtyrë pushtimin e Kuvajtit për dy-tre vjet, derisa Iraku të kishte në dorë armë bërthamore, ka shumë të ngjarë që do ta merrte Kuvajtin dhe ishte plotësisht e mundur që do të kishte shtënë në duar edhe fushat e Arabisë Saudite. Shtetet jo-Perëndimore nxorën mësimin e qartë nga Lufta e Gjirit. Për ushtarakët e Koresë së Veriut ky mësim ishte: "Mos i lini amerikanët të grumbullojnë forcat e tyre, mos i lejonit që të vënë në veprim fuqinë ajrore, mos i lejonit të marrin iniciativën, mos i lejonit të bëjnë një luftë me humbje të vogla për SHBA." Për një zyrtar ushtarak indian të lartë mësimi ka qenë edhe më haptas i shprehur: "Mos luftoni me Shtetet e Bashkuara, nëse nuk keni armë bërthamore."² Këtë mësim e kanë mësuar shumë mirë udhëheqësit politikë dhe krerët ushtarakë në mbarë botën jo-Perëndimore, si një rrjedhim të pranueshëm: "Nëse keni armë bërthamore, Shtetet e Bashkuara nuk do të bëjnë luftë kundër jush."

Siç e ka vënë në dukje Lawrence Freedman-i (Lourens Fridman): "Në vend që të përforcojnë politikën e fuqisë si zakonisht, armët bërthamore në fakt sjellin një prirje drejt fragmentarizimit të sistemit ndërkombëtar, në të cilin fuqitë e mëdha të mëparshme

luajnë një rol të zvogëluar.” Në këtë mënyrë, roli i armëve bërthamore për Perëndimin në botën pas Luftës së ftohtë është i kundërt me atë gjatë Luftës së ftohtë. Në atë kohë, siç e ka vënë në dukje sekretari i shtetit për mbrojtjen Les Aspin, armët bërthamore për Perëndimin kompensojnë inferioritetin në armë konvencionale kundrejt Bashkimit Sovjetik. Ato ishin ‘barazueset’. Mirëpo në botën pas Luftës së ftohtë Shtetet e Bashkuara kanë “një forcë ushtarake me armë konvencionale të paparë dhe janë kundërshtarët tanë potencialë tashti që mund të shtien në zotërim armë bërthamore. Ne jemi tani ata që mund të përfundojmë duke na barazuar.”³

Prandaj nuk është për t’u çuditur, që Rusia e ka vënë theksin te roli i armëve bërthamore në planifikimet për mbrojtjen dhe më 1995 e rregulloi që të blinte raketa ndërkontinentale të tjera shtesë dhe bombardues nga Ukraina. “Tashti po dëgjojmë atë, që ishim mësuar ta thoshim për rusët në vitet 1950”, ka komentuar një specialist armësh i SHBA. “Tashti janë rusët që po thonë: ‘Kemi nevojë për armë bërthamore që të kompensojmë epërsinë e tyre në armë konvencionale’” Në rrethana të lidhura me këto por të përmbysura, gjatë Luftës së ftohtë Shtetet e Bashkuara me qëllim që të zotëronin forcën përmbajtëse, nuk pranuan të hiqnin dorë nga përdorimi si të parët i armëve bërthamore. Në përputhje me funksionin e ri frenues të armëve bërthamore në botën pas Luftës së ftohtë, Rusia më 1993 në të vërtetë hoqi dorë nga zotimi i mëparshëm sovjetik se nuk do të ishte e para që do të përdorte armë bërthamore. Njëkohësisht Kina, duke zhvilluar strategjinë e vet bërthamore pas Luftës së ftohtë për përmbajtjen në shkallë të kufizuar, gjithashtu do ta vinte në pikëpyetje dhe do ta dobësonte zotimin e vet të vitit 1964 për të mos i përdorur e para.⁴ Hap pas hapi me

zotërimin e armëve bërthamore dhe të tjerave të shkatërrimit në masë, shtetet e tjera bërthamë dhe fuqitë rajonale po ashtu ka të ngjarë që të ndjekin këta shembuj, në mënyrë që ta shtojnë sa më shumë veprimin frenues të armëve të tyre kundrejt veprimit ushtarak me armë konvencionale të Perëndimit kundër tyre.

Armët bërthamore veç kësaj, mund ta kërcënojnë më drejtpërdrejt Perëndimin. Kina dhe Rusia kanë raketa balistike me mbushje bërthamore, që mund të arrijnë deri në Europë dhe në Amerikën e Veriut. Koreja e Veriut, Pakistani dhe India po e zmadhojnë rrezën e raketave të tyre dhe në një moment të caktuar ka gjasa që të zotërojnë aftësitë për të vënë në shënjestër Perëndimin. Veç kësaj, armët bërthamore mund të barten edhe me mjete të tjera. Analistët ushtarakë kanë parashtruar një shkallëzim ushtrimi dhune që nga lufta me intensitet shumë të vogël, si terrorizmi dhe lufta e rastit guerile, nëpër luftërat e kufizuara e të luftërat më të gjera, që do të bëheshin me përdorimin masiv të forcave konvencionale, dhe deri te lufta bërthamore. Terrorizmi historikisht është arma e të dobëtisë, domethënë e atyre që nuk zotërojnë fuqi ushtarake konvencionale. Që nga Lufta e Dytë Botërore armët bërthamore gjithashtu kanë qenë arma, me anë të së cilës i dobëti është përpjekur të kompensojë inferioritetin konvencional. Në të kaluarën, terroristët mund të ushtronin vetëm dhunë të kufizuar, duke vrarë disa njerëz këtu e duke shkatërruar ndërtesa atje. Nevojiteshin forca ushtarake masive për të ushtruar dhunë masive. Mirëpo në një moment të caktuar një numër i vogël terroristësh do të jenë në gjendje të vënë në veprim dhunë masive dhe të bëjnë shkatërrime masive. Veç e veç, terrorizmi dhe armët bërthamore janë armët e të dobëtëve jo-Perëndimorë. Nëse ndërthuren dhe kur të ndërthuren bashkë, të dobëtit jo-Perëndimorë do të jenë të fuqishëm.

Në botën pas Luftës së ftohtë përpjekjet për të zhvilluar armët e shkatërrimit në masë dhe mjetet për bartjen e tyre janë përqendruar në vendet islamike e konfuciane. Pakistani e ndoshta Koreja e Veriut kanë një numër të vogël armësh bërthamore, ose të paktën aftësinë për t'i montuar me shpejtësi, e gjithashtu po blejnë ose po i ndërtojnë vetë raketat me rreze të gjatë, të afta për t'i bartur ato. Iraku ka pasur një aftësi të madhe mjetesh kimike luftarake dhe ka qenë duke u përpjekur për të siguruar armë biologjike e bërthamore. Irani ka një program të gjerë për të zhvilluar armët bërthamore dhe e ka zgjeruar aftësinë për sulmin me to. Më 1988 presidenti Rafsanxhani ka deklaruar, se iranianët "duhet të pajisen plotësisht për përdorimin sulmues e mbrojtës të armëve kimike, bakteriologjike e radiologjike," kurse tre vjet më vonë zëvendëspresidenti i tij ka thënë në një konferencë islamike: "Meqë Izraeli vazhdon të ketë armë bërthamore, ne, myslimanët, duhet të bashkëpunojmë që të prodhojmë një bombë atomike, pavarësisht nga përpjekjet e OKB-së për të ndaluar përhapjen e armëve bërthamore." Më 1992 dhe 1993 zyrtarë të lartë të zbulimit amerikan kanë thënë, se Irani po kërkonte blerjen e armëve bërthamore, kurse më 1995 sekretari i shtetit Warren Christopher (Uorren Kristofer) ka pohuar prerazi, se "Sot Irani u ka hyrë përpjekjeve të ethshme për të zhvilluar armët bërthamore." Është njoftuar se edhe shtete të tjera myslimane janë interesuar për zhvillimin e armëve bërthamore, duke përfshirë Libinë, Algjerinë dhe Arabinë Saudite. Sipas shprehjes plot ngjyra të Ali Mazruit, "Gjysmëhëna është mbi renë e kërpuhdës" dhe mund të kërcënojë edhe të tjerë, përveç Perëndimit. Islami mund të arrijë "të luajë ruletën ruse bërthamore me dy qytetërimet e tjera: me hinduizmin në Azinë

Jugore dhe me zionizmin e judaizmin e politizuar në Lindjen e Mesme.”⁵

Përhapja e armëve po ndodh atje ku lidhja konfuciane-islamike ka qenë më e gjerë e më konkrete, ndërsa Kina luan rolin qendror në transferimin si të armëve konvencionale, edhe të atyre jokonvencionale të shumë shtete muslimane. Në këto transferime bëjnë pjesë: ndërtimi i reaktorit të fshehtë, me mbrojtje të madhe, në shkretëtirën e Algjerisë, në pamje të jashtme për kërkime, por specialistët perëndimorë besojnë përgjithësisht se është në gjendje të prodhojë plutonium; shitja e armëve kimike Libisë; furnizimi i Arabisë Saudite me raketa me rreze të mesme CSS-2; furnizimi me teknologji ose materiale bërthamore i Irakut, Libisë, Sirisë dhe Koresë së Veriut, si dhe transferimi i një numri të madh armësh konvencionale Irakut. Duke i plotësuar transferimet e Kinës, në fillim të viteve 1990 Koreja e Veriut e ka furnizuar Sirinë me raketa Scud-C, që janë dhënë nëpërmjet Iranit, si dhe të shtretërve të lëvizshëm për lëshimin e tyre.⁶

Tokëza qendrore në lidhjet për armët të vendeve konfuciane-islamike kanë qenë marrëdhëniet ndërmjet Kinës e në një shkallë më të vogël të Koresë së Veriut, nga njëra anë, dhe Pakistanit e Iranit, nga ana tjetër. Ndërmjet viteve 1980 e 1991 dy marrësit kryesorë të armëve kineze kanë qenë Irani e Pakistani, ndërsa Iraku vinte në radhë të dytë. Duke nisur nga vitet 1970 Kina e Pakistani kanë vendosur marrëdhënie ushtarake jashtëzakonisht të ngushta. Më 1989 të dy vendet nënshkruan një memorandum dhjetëvjeçar mirëkuptimi për “bashkëpunimin ushtarak në fushat e blerjes, kërkimit të përbashkët e zhvillimit, prodhimit të përbashkët, transferimit të teknologjisë, si dhe të eksportimit në vende të treta nëpërmjet marrëveshjes së dyanshme.” Më 1993 u nënshkrua një marrëveshje

plotësuese, që i siguronte Pakistanit kredi nga Kina për të blerë armë. Si rrjedhim, Kina u bë “Furnizuesi më i sigurtë dhe më i gjerë i materialeve ushtarake, që i transferonte mallra eksporti me karakter ushtarak praktikisht të çfarëdo lloji dhe të destinuara për cilëndo degë të nevojave ushtarake të Pakistanit.” Kina gjithashtu e ka ndihmuar Pakistanin për të ndërtuar uzinat e prodhimit të aeroplanëve reaktivë, tankeve, artilerisë e raketave. Po ajo që ka rëndësi edhe më të madhe është se Kina i ka dhënë Pakistanit ndihmë thelbësore për zhvillimin e aftësive në prodhimin e armëve bërthamore: thuhet se e ka furnizuar Pakistanin me uranium për pasurim, i ka dhënë këshilla për projektet e bombave dhe ndoshta e ka lejuar Pakistanin të bëjë një shpërthim bërthamor në një nga vendet e provave të Kinës. Veç kësaj, Kina i ka dhënë Pakistanit M-11, raketa balistike me rreze 300 kilometra, që mund të bartin armë bërthamore, duke e shkelur kështu zotimin dhënë Shteteve të Bashkuara. Nga ana e vet, Kina ka siguruar teknologjinë e rifurnizimit në ajër me karburant dhe raketa Stinger prej Pakistanit.⁷

Aty nga vitet 1990 lidhjet për armë ndërmjet Kinës e Iranit po ashtu u bënë të dendura. Gjatë luftës Iran-Irak në vitet 1980, Kina e ka furnizuar Iranin me 22 për qind të armëve dhe më 1989 u bë i vetmi furnizues më i madh i armëve. Kina gjithashtu ka bashkëpunuar gjallërisht me përpjekjet e shpallura hapur të Iranit për të siguruar armë bërthamore. Pasi nënshkruan “një marrëveshje fillestare kino-iraniane”, të dy vendet në janar 1990 arritën një marrëveshje dhjetëvjeçare mirëkuptimi për bashkëpunimin e posaçëm shkencor dhe transferimin e teknologjisë. Në shtator 1992 presidenti Rafsanxhani, i shoqëruar prej specialistëve bërthamore të Iranit, vizitoi Pakistanin dhe pastaj kaloi në Kinë, ku nënshkroi një marrëveshje tjetër për

bashkëpunimin bërthamor, kurse në shkurt 1993 Kina pranoi që të ndërtonte dy reaktorë bërthamore prej 300-MW në Iran. Duke iu përmbajtur këtyre marrëveshjeve, Kina transferoi teknologji dhe informacion bërthamor në Iran, i kualifikoi shkencëtarët dhe inxhinierët, si dhe i dha Iranit aparaturën e pasurimit kalutron.

Tabela 8.1:
Transferimet e armëve nga kina, me përzgjedhje, më 1980-1991

	Irani	Pakistani	Iraku
Tanke luftarake kryesore	540	1.100	1.300
Automjete të blinduara për efektiva	300	---	650
Raketa të drejtuara antitank	7.500	100	---
Gryka artilerie/raketalëshuese	1.200	50	720
Aeroplanë gjuajtës	140	212	---
Raketa kundër anijeve	332	32	---
Raketa tokë-ajër	788*	222*	---

* Tregon shitjet të pakonfirmuara të gjitha.

Burimi: Karl W. Eikenberry, *Explaining and Influencing Chinese Arms Transfers* (Washington: National Defense University, Institute for National Strategic Studies, McNair Paper No. 36, shkurt 1995), f. 12.

Më 1995, pas një trysnie të gjatë nga ana e SHBA, Kina pranoi të 'anulonte' sipas Shteteve të Bashkuara, ose të 'pezullonte' sipas Kinës, shitjen e dy reaktorëve me 300-MW. Kina ka qenë gjithashtu furnizuesi kryesor i raketave dhe i teknologjisë së raketave për Iranin, duke përfshirë nga fundi i viteve 1980 raketat Krimbi i mëndafshit, të shitura nëpërmjet Koresë së Veriut, dhe të "duzinave e, ndoshta, të qindra sistemeve drejtuese të

raketave dhe mjetes të kompjuterizuara për makinat” më 1994-1995. Gjithashtu Kina i dha lejë Iranit që të prodhonte raketa kineze tokë-tokë. Koreja e plotësoi këtë ndihmë duke dërguar raketa Skud në Iran dhe e ndihmoi Iranin që të ndërtonte uzinat për prodhimin vendës, kurse më pas, më 1993 pranoi që ta furnizonte Iranin me raketat e veta Nodong 1 me rreze veprimi 600 milje. Në brinjën e tretë të trekëndëshit, Irani dhe Pakistani gjithashtu arritën një bashkëpunim të gjerë në fushën bërthamore, me Pakistanin që kualifikonte shkencëtarët iranianë dhe me Pakistanin, Iranin e Kinën që arritën marrëveshje në nëntor 1992 për të punar së bashku për projektet bërthamore.⁸ Ndihma e gjerë e Kinës për Pakistanin dhe Iranin në përgatitjen e armëve të shkatërrimit në masë dëshmon për një nivel të jashtëzakonshëm të bashkëpunimit dhe zotimeve ndërmjet këtyre vendeve.

Si pasojë e këtyre zhvillimeve dhe e kërcënimeve të mundshme që u bëhen interesave të Perëndimit, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë ka dalë në krye të rendit të ditës për sigurinë e Perëndimit. Më 1990, për shembull, 59 për qind e publikut amerikan mendonte se parandalimi i përhapjes së armëve bërthamore ishte një synim i rëndësishëm i politikës së jashtme. 82 për qind e publikut më 1994 dhe 90 për qind e udhëheqësve të politikës së jashtme ishin po të të njëjtit mendim. Presidenti Klinton e vuri në pah përparësinë e mospërhapjes në shtator 1993, kurse në vjeshtë 1994 shpalli një ‘emergjencë kombëtare’ për t’u marrë me “kërcënimin e jashtëzakonshëm dhe të madh kundrejt sigurisë kombëtare, politikës së jashtme dhe ekonomisë së Shteteve të Bashkuara” prej “përhapjes së armëve bërthamore, biologjike e kimike dhe mjeteve për dërgimin e armëve të tilla.” Më 1991 CIA krijoi një Qendër të Mospërhapjes me personel prej 100 vetash

dhe në dhjetor 1993, sekretari i mbrojtjes Aspin njoftoi për Nismën e re të Mbrojtjes kundër Përhapjes, si dhe për krijimin e një posti të ri për ndihmëssekretarin e sigurimit bërthamor e të kundërpërhapjes.⁹

Gjatë kohës së Luftës së ftohtë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik kishin hyrë në një garë klasike armatimi, po krijonin armë bërthamore e mjete për lëshimin e tyre gjithnjë e më të stërholluara nga ana teknologjike. Ishte një rast, kur njëri bënte më shumë dhe tjetri bënte më shumë. Në botën pas Luftës së ftohtë gara qendrore e armatimeve është e tjetër lloji. Kundërshtarët e Perëndimit po përpiqen të sigurojnë armë të shkatërrimit në masë dhe Perëndimi po përpiqet t'i ndalojë ta bëjnë këtë. Nuk jemi, pra, në rastin që njëri bën më shumë dhe tjetri bën më shumë, por njëri bën më shumë dhe përpiqet të ndalojë të tjerët. Përmasat dhe aftësitë e arsenalit bërthamor të Perëndimit, me përjashtim të shprehjeve retorike, nuk janë pjesë e garës. Rezultati i garës së armatimeve kur njëri bënte më shumë dhe tjetri bënte më shumë varej nga burimet, përkushtimi dhe aftësia teknologjike e të dy palëve. Nuk ishte i paracaktuar. Rezultati i garës ndërmjet 'bëj më shumë e ndalo të tjerët' është më i parashikueshëm. Përpjekjet e Perëndimit për të ndaluar të tjerët mund ta ngadalësojnë prodhimin e armëve nga shoqëritë e tjera, por nuk mund ta ndalojnë atë. Zhvillimi ekonomik e shoqëror i shoqërive jo-Perëndimore, shtysat tregtare për të gjitha shoqëritë Perëndimore dhe jo-Perëndimore për të fituar para nëpërmjet shitjes së armëve, të teknologjisë e njohurive speciale, si dhe motivet e shteteve bërthamë e të fuqive rajonale për të mbrojtur hegjemonitë e tyre lokale – që të gjitha bashkë veprojnë për t'i përmbysur përpjekjet e Perëndimit për të ndaluar të tjerët.

Perëndimi e përkrah mospërhapjen, duke e paraqitur si pasqyrim të interesave të gjithë vendeve për rendin ndërkombëtar dhe qëndrueshmërinë. Mirëpo vendet e tjera e shohin mospërhapjen si diçka që u shërben interesave të hegjemonisë së Perëndimit. Që është pikërisht kështu, pasqyrohet te dallimet në shqetësimet lidhur me përhapjen ndërmjet Perëndimit e në veçanti Shteteve të Bashkuara, nga njëra anë, dhe fuqive rajonale, siguria e të cilave do të prekej nga përhapja, nga ana tjetër. Kjo ka të bëjë sidomos me Kinën. Më 1993 dhe 1994 Shtetet e Bashkuara krijuan një gjendje krize në trajtimin e perspektivës lidhur me armët bërthamore të Koresë së Veriut. Në nëntor 1993 presidenti Klinton u shpreh drejtpërdrejt: “Koreja e Veriut nuk mund të lejohet që të prodhojë bombën bërthamore. Ne duhet të jemi shumë të vendosur për këtë.” Senatorët, përfaqësuesit dhe zyrtarët e mëparshëm të administratës së Bushit kanë diskutuar nevojën që del për një sulm parandalues mbi uzinat bërthamore të Koresë së Veriut, ndërsa shqetësimi i SHBA lidhur me programin e Koresë së Veriut në pjesën më të madhe buronte nga shqetësimi për përhapjen globale; një aftësi e tillë jo vetëm do t’i ngushtonte dhe do t’i ndërlikonte veprimet e mundshme të SHBA në Azinë Lindore, por edhe po të shiste Koreja e Veriut teknologjinë e saj dhe/ose armët, kjo do të kishte pasoja të njëjlojta për Shtetet e Bashkuara në Azinë Jugore dhe në Lindjen e Mesme.

Nga ana tjetër, Koreja e Jugut e shihte bombën në lidhje me interesat e saj rajonale. Shumë koreanë të jugut e vështronin një bombë të Koresë së Veriut si një bombë *koreane*, pra që kurrë nuk do të përdorej kundër koreanëve të tjerë, por mund të përdorej për të mbrojtur pavarësinë dhe interesat koreanë kundër Japonisë e kërcënimeve të tjera të mundshme. Zyrtarët civilë dhe

oficerët ushtarakë të Koresë së Jugut e shprehnin hapur, se e mendonin një Kore të bashkuar, që do ta kishte aftësinë bërthamore. Kjo u shërbente mjaft mirë interesave të Koresë së Jugut: Koreja e Veriut do të bënte gjithë ato shpenzime dhe do të ngjallte zemërimin ndërkombëtar se kishte prodhuar bombën; Koreja e Jugut në fund të fundit do ta trashëgonte atë; ndërthurja e armëve bërthamore të veriut me specializimin e lartë industrial të jugut do t'i jepte mundësinë një Koreje të bashkuar që të fitonte rolin e merituar si një ndër aktorët kryesorë në skenën e Azisë Lindore. Rrjedhimisht, kishte dallime të ndjeshme në përmasat me të cilat Uashingtoni e shihte se kishte një krizë të madhe në gadishullin e Koresë më 1994, dhe mungesës së çfarëdo ndjenje për praninë e krizës në Seul, duke krijuar kështu një 'hendek paniku' ndërmjet dy kryeqyteteve. Në kulmin e 'krizës' në qershor 1994 një gazetar ka vënë re se një prej "çudive të qëndrimit bërthamor të Koresë së Veriut qysh prej fillimit disa vjet më parë, është se ndjenja e krizës rritet, sa më larg shkohet nga Koreja." Një hendek i ngjashëm ndërmjet interesave të sigurimit të Amerikës dhe atyre të fuqive rajonale u hap në Azinë e Jugut, kur Shtetet e Bashkuara ishin të shqetësuara për përhapjen e armëve bërthamore më shumë sesa banorët e rajonit, kurse India dhe Pakistani e quajtën më të lehtë të pranonin kërcënimin bërthamor të palës tjetër, sesa propozimet amerikane për t'i zbutur, zvogëluar ose eliminuar që të dy kërcënimet.¹⁰

Përpjekjet e Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve të tjera Perëndimore për të parandaluar përhapjen e armëve 'baraspeshuese' të shkatërrimit në masë kanë pasur dhe, sipas gjasave, do të vazhdojnë të kenë sukses të paktë. Një muaj pasi presidenti Klinton tha se nuk duhet lejuar që Koreja e Veriut të ketë armë bërthamore, agjencitë e zbulimit të SHBA e njoftuan se ndoshta ajo

tashmë i kishte një a dy bomba.¹¹ Si pasojë, politika e SHBA bëri një kthesë, duke u ofruar koreanëve të veriut karrotën, me qëllim që t'i shtynin të mos e zgjeronin më tej arsenalin e tyre bërthamor. Gjithashtu Shtetet e Bashkuara nuk qenë në gjendje të kthenin mbrapsht ose të pengonin zhvillimet e armëve bërthamore në Indi e Pakistan, si dhe nuk kanë qenë në gjendje të ndalonin përparimin e Iranit në fushën bërthamore.

Në konferencën e prillit 1995 për Traktatin e Mospërhapjes së Armëve Bërthamore çështja kyç qe: a duhej të shtyhej për një periudhë të pacaktuar apo duhej përcaktuar se do të vlente vetëm për njëzet e pesë vjet. Shtetet e Bashkuara ishin në krye të përpjekjeve për ta lënë të përhershëm. Mirëpo një numër i madh shtetesh të tjera e kundërshtuan një shtrirje të tillë, në rast se traktati nuk shoqërohej me një pakësim shumë më të ndjeshëm të armëve bërthamore nga pesë fuqitë bërthamore të njohura. Veç kësaj, Egjipti e kundërshtoi zgjerimin e afatit, në rast se Izraeli nuk e nënshkruante traktatin dhe nuk pranonte inspektimet për të kontrolluar sigurinë. Në fund, Shtetet e Bashkuara fituan një mirëkuptim të gjerë për shtrirjen pa afat nëpërmjet strategjisë tepër të suksesshme të trysnisë, ryshfetit dhe kërcënimit. As Egjipti dhe as Meksika, për shembull, që të dyja kundërshtare të shtrirjes pa afat, nuk e mbajtën qëndrimin e tyre përballë varësisë ekonomike nga Shtetet e Bashkuara. Ndërsa traktati u shtri me mirëkuptim, përfaqësuesit e shtatë vendeve myslimane (Siria, Jordania, Irani, Iraku, Libia, Egjipti e Malajzia) dhe një vend afrikan (Nigeria) shprehën pikëpamje kundërshtuese në debatin përfundimtar.¹²

Më 1993 synimet parësore të Perëndimit, siç përcaktohen në politikën amerikane, kaluan prej mospërhapjes te kundërpërhapja. Kjo zhvendosje ishte një pranim realist i shkallës, në të cilën një farë mase e

përhapjes së armëve bërthamore nuk ishte e mundur të shmangej. Në kohën e përshtatshme, politika e SHBA do të zhvendoset nga kundërshtimi i përhapjes të përshtatja e përhapjes dhe, nëse qeveria mund të shpëtojë prej mënyrës së të menduarit të kohës së Luftës së ftohtë, do të shohë sesi nxitja e përhapjes do të mund t'u shërbente interesave të Shteteve të Bashkuara e Perëndimit. Mirëpo deri më 1995 Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimi vijuan t'i përmbaheshin një politike të trysnisë, e cila në fund është e paracaktuar të dështojë. Përhapja e armëve bërthamore dhe e të tjerave të shkatërrimit në masë është një dukuri qendrore e shpërndarjes së ngadaltë por të pashmangshme të fuqisë në botën shumëqytetërimore.

Të drejtat e njeriut dhe demokracia

Gjatë viteve 1970 e 1980 mbi tridhjetë vende kaluan nga sistemet politike autoritare te sistemet demokratike. Për këtë dallgë tranzicioni pati një varg arsyesh që e shkaktuan. Pa dyshim, zhvillimi ekonomik ka qenë faktori themelor, i cili i përftoi këto ndryshime politike. Mirëpo, veç kësaj, edhe politikat e veprimet e Shteteve të Bashkuara, e fuqive kryesore të Europës Perëndimore dhe institucionet ndërkombëtare ndihmuan që të vendosej demokracia në Spanjë e Portugali, në shumë shtete të Amerikës Latine, në Filipine, Korenë e Jugut dhe Europë. Demokratizimi pati më shumë sukses në vendet ku ishin më të forta ndikimet e krishtera e Perëndimore. Regjimet e reja doli se kishin më shumë gjasa të stabilizoheshin në vendet e Europës jugore e qendrore, që ishin me mbizotërim katolik ose protestant,

dhe kishte më pak gjasa në vendet e Amerikës Latine. Në Azinë Lindore Filipinet, që janë me mbizotërim katolik dhe nën ndikimin e fortë amerikan, u kthyen në demokraci në vitet 1980, ndërsa udhëheqësit e krishterë përkrahën lëvizjen drejt demokracisë në Korenë e Jugut dhe në Tajvan. Siç është vënë në dukje më sipër, në ish Bashkimin Sovjetik, duket se republikat baltike po e stabilizojnë me sukses demokracinë; shkalla dhe qëndrueshmëria e demokracisë në republikat ortodokse kanë pasur luhafje të mëdha dhe janë të pasigurta; perspektivat demokratike në republikat islamike janë të dobëta. Aty nga vitet 1990, me përjashtim të Kubës, tranzicioni demokratik ishte kryer në shumicën e vendeve, me përjashtim të Afrikës, te popujt që e kishin përçafuar krishterimin Perëndimor ose kishin prani të madhe të ndikimit të krishterë.

Këto procese tranzicioni dhe shembja e Bashkimit Sovjetik krijuan besimin në Perëndim, sidomos në Shtetet e Bashkuara, se po kryhej një revolucion demokratik global dhe pas jo shumë kohësh në mbarë botën do të merrnin epërsinë konceptet e të drejtave të njeriut dhe format Perëndimore të demokracisë politike. Përkrahja e përhapjes së demokracisë qysh atëherë u bë synimi me përparësi kryesore për Perëndimorët. Këtë e miratoi administrata e Bushit nëpërmjet sekretarit të shtetit, James Baker (Xhejms Bejker), i cili në prill 1990 shpalli se “Përtej frenimit shtrihet demokracia” dhe se për botën pas Luftës së ftohtë “Presidenti Bush ka përcaktuar si misionin tonë të ri të përkrahim e të forcojmë demokracinë.” Në fushatën e tij të vitit 1992 Bill Klintoni disa herë tha se përkrahja e demokracisë do të jetë përparësia më e lartë e administratës së Klintonit, kurse demokratizimi që e vetmja temë e politikës së jashtme, së cilës ai i kushtoi tërësisht një nga fjalimet kryesore të fushatës. Kur erdhi në detyrë, ai rekomandoi

që të bëhej një shtesë prej dy të tretash për Mbështetjen Kombëtare për Demokracinë; ndihmësi i tij për sigurimin kombëtar përcaktoi si temë qendrore të politikës së jashtme të Klintonit “zgjerimin e demokracisë”; kurse sekretari i tij për mbrojtjen e quajti përkrahjen e demokracisë si një nga katër qëllimet kryesore dhe u përpoq të krijonte një post të lartë në departamentin e vet që të mbështeste këtë qëllim. Në një shkallë më të vogël dhe në mënyrë më pak të dukshme, përkrahja e të drejtave të njeriut dhe e demokracisë mori rol parësor edhe në politikën e jashtme të shteteve europiane, duke u bërë kriteri që përdoret nga institucionet ekonomike ndërkombëtare në duart e Perëndimit për dhënien e huave e granteve vendeve në zhvillim.

Aty nga viti 1995 përpjekjet europiane dhe amerikane për arritjen e këtyre synimeve u pa se nuk kishin arritur sukses të madh. Pothuaj të gjitha qytetërimet jo-Perëndimore po i bënin qëndresë kësaj trysnie nga Perëndimi. Ndër këto bënin pjesë vendet hindu, ortodokse, afrikane e, në një farë mase, edhe vendet e Amerikës Latine. Mirëpo kundërshtimi më i madh ndaj përpjekjeve të Perëndimit për demokratizim erdhi nga islami dhe Azia. Kjo qëndresë i kishte rrënjët në lëvizjet më të gjera të konfirmimit kulturor, që mishërohen në Ringjalljen islamike dhe në Afirmimin aziatik.

Dështimi i Shteteve të Bashkuara lidhur me Azinë ka ardhur kryesisht prej mirëqenies ekonomike në rritje dhe vetëbesimit të qeverive aziatike. Publicistët aziatikë herë pas here ia kanë kujtuar Perëndimit, se kohët e vjetra të varësisë e nënshtrimit i përkasin së kaluarës dhe se Perëndimi, i cili jepte gjysmën e produktit ekonomik të botës në vitet 1940, që sundonte në Kombet e Bashkuara dhe hartoi Deklaratën Universale për të

Drejtat e Njeriut, ishte zhdukur në të kaluarën historike. “[Për]pjekjet për të nxitur të drejtat e njeriut në Azi,” siç ka argumentuar një zyrtar i Singaporit, “duhet gjithashtu të llogarisin se ka ndryshuar shpërndarja e fuqisë në botën pas Luftës së ftohtë...Dora e Perëndimit mbi Lindjen dhe Azinë Juglindore është shkurtuar mjaft.”¹³

Ai kishte të drejtë. Ndërsa marrëveshja për çështjet bërthamore ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut mund të quhej me të drejtë një “dorëzim me marrëveshje”, kapitullimi i Shteteve të Bashkuara për çështjen e të drejtave të njeriut kundrejt Kinës dhe fuqive të tjera aziatike ishte një dorëzim pa kushte. Pasi e kërcënoi Kinën se do t’ia hiqte trajtimin e kombit më të favorizuar nëse nuk do të përparonte lidhur me të drejtat e njeriut, administrata e Klintonit e pa për herë të parë sekretarin e vet të shtetit të poshtëruar në Pekin, duke ia mohuar madje edhe një gjest sa për të shpëtuar faqen, e pastaj iu përgjigj këtij qëndrimi duke hequr dorë nga politika e mëparshme dhe duke e shkëputur statusin e MFN-së prej shqetësimeve lidhur me të drejtat e njeriut. Nga ana e vet, Kina u përgjigj kundrejt kësaj shfaqjeje të dobësisë duke e vazhduar dhe përforcuar qëndrimin, të cilin e kishte kundërshtuar administrata e Klintonit. Administrata bëri tërheqje të po kësaj natyre në marrëdhëniet me Singaporin lidhur me rrahjen e një qytetari amerikan dhe me Indonezinë për dhunën shtypëse në Timorin Lindor.

Aftësia e regjimeve aziatike për ta kundërshtuar trysninë nga ana e Perëndimit lidhur me të drejtat e njeriut u përforcua prej disa faktorëve. Bizneset amerikane dhe europiane ishin në ankth dëshpërues për të zgjeruar tregtinë e tyre dhe për të investuar në këto vende me rritje të shpejtë, prandaj u bënë qeverive të tyre trysni të madhe që të mos i ndërprisnin marrëdhëniet ekonomike me to. Veç kësaj, vendet

aziatike e shihnin këtë trysni si një shkelje të sovranitetit dhe u lidhën së bashku në mbështetje të njëra-tjetrës kur dilnin këto çështje. Biznesmenët tajvanas, japonezë dhe të Hong-Kongut, që kishin investuar në Kinë, kishin interesa të mëdhenj që Kina t'i ruante privilegjet në MFN me Shtetet e Bashkuara. Qeveria japoneze përgjithësisht e distancoi veten nga politika amerikane e të drejtave të njeriut: Ne nuk do të lejojmë që “nacionet abstrakte të të drejtave të njeriut” të prekin marrëdhëniet tona me Kinën, tha kryeministri Kiiçi Mijazava pas pak kohësh nga ngjarjet e Sheshit Tienanmen. Vendet e ASEAN-it nuk kishin dëshirë të ushtronin trysni mbi Mianmarin dhe, në të vërtetë, më 1994 e mirëpritën juntën ushtarake në mbledhjen e tyre, ndërsa Bashkimi Europian, siç ka thënë zëdhënësi i tij, u detyrua ta pranonte që politika e tij “nuk ka patur shumë sukses” dhe se do të duhej ta pasonte qëndrimin e ASEAN-it ndaj Mianmarit. Veç kësaj, fuqia e tyre ekonomike në rritje u jepte mundësinë shteteve të tilla, si Malajzia e Indonezia, të zbatonin “kushtëzimin e anasjelltë” ndaj vendeve dhe firmave, që i kritikojnë ose që mbajnë qëndrime të tjera, të cilat për ta janë të papranueshme.¹⁴

Mbi të gjitha, forca ekonomike në rritje e vendeve aziatike i bënë ato gjithnjë e më të imunizuara kundrejt trysnisë Perëndimore lidhur me të drejtat e njeriut dhe demokracinë. “Fuqia ekonomike e Kinës sot,” ka vënë në dukje Niksoni më 1994, “i bënë pa vend leksionet e SHBA për të drejtat e njeriut. Brenda një dhjetëvjeçari do t'i bëjë të papërfillshme. Brenda dy dhjetëvjeçarësh do t'i bëjë qesharake.” Megjithatë, ndërkohë, zhvillimi ekonomik i Kinës mund t'i bëjë leksionet e Perëndimit të panevojshme. Rritja ekonomike po i fuqizon qeveritë aziatike kundrejt qeverive Perëndimore. Në vështrimin afatgjatë, ajo do t'i fuqizojë edhe shoqëritë aziatike kundrejt qeverive aziatike. Nëse demokracia do të

përfshijë edhe disa vende të tjera aziatike, kjo do të ndodhë sepse borgjezitë gjithnjë e më të forta aziatike dhe klasat e mesme do ta duan që të vendoset.

Në kundërshtim me marrëveshjen për zgjatjen pa afat të traktatit për mospërhapjen, përpjekjet e Perëndimit për të përkrahur të drejtat e njeriut dhe demokracinë në agjencitë e OKB-së përgjithësisht u fshinë fare. Me pak përjashtime, si dënimi për Irakun, vendimet për të drejtat e njeriut pothuaj gjithnjë janë hedhur poshtë nga votimet në OKB. Me përjashtim të disa vendeve të Amerikës Latine, qeveritë e tjera ngurronin që të pranonin të mermin pjesë ndaj asaj që shumë veta e quanin "imperializmi i të drejtave të njeriut." Për shembull, më 1990 Suedia paraqiti në emër të njëzet vendeve Perëndimore një rezolutë, e cila dënonte regjimin ushtarak në Mianmar, porse kundërshtimi nga vendet aziatike dhe të tjera e hoshi poshtë. Gjithashtu janë rrëzuar me votim rezolutat që dënonin shkeljet e të drejtave të njeriut dhe gjatë pesë vjetëve rresht pas vitit 1990 Kina ka qenë në gjendje të mobilizonte mbështetjen e aziatikëve për të hedhur poshtë rezolutat e mbështetura nga Perëndimi, që shprehnin shqetësime për shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e saj. Më 1994 Pakistani parashtroi një rezolutë në Komisionin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, që dënonte shkeljet e të drejtave të njeriut nga India në Kashmir. Vendet në miqësi me Indinë u mbledhën kundër saj, por po ashtu bënë miqtë më të ngushtë të Pakistanit, Kina dhe Irani, të cilat kishin qenë vetë në shënjestër për masa të tilla, prandaj e bindën Pakistanin që ta tërhiqte propozimin. Kur dështoi dënimi i brutalitetit të Indisë në Kashmir, *The Economist* vuri në dukje se Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut "e sanksionoi për shkak të mungesave. Edhe vende të tjera po vazhdojnë me vrasje: Turqia, Indonezia, Kolombia

dhe Algjeria po ashtu të gjitha kanë shpëtuar nga kritikën. Në këtë mënyrë Komisioni po u jep krahë qeverive që zbatojnë torturat e masakrat, domethënë pikërisht e kundërta e asaj për të cilën e kanë përcaktuar krijuesit e tij.”¹⁶

Dallimet lidhur me të drejtat e njeriut ndërmjet Perëndimit e qytetërimeve të tjera dhe aftësia e kufizuar e Perëndimit për t'i arritur synimet e veta u zbuluan qartë në Konferencën e OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Vjenë në qershor 1993. Nga njëra anë ishin vendet europiane dhe të Amerikës së Veriut, në anën tjetër ishte një bllok prej rreth pesëdhjetë shtetesh jo-Perëndimore, ndër të cilat pesëmbëdhjetë anëtarët më aktivë që përfshinin qeveritë e një vendi të Amerikës Latine (Kubën), një vend budist (Mianmarin), katër vende konfuciane me ideologji politike, sisteme ekonomike dhe nivele të zhvillimit mjaft të ndryshme (Singaporin, Vietnamin, Korenë e Veriut dhe Kinën), si dhe nëntë vende myslimane (Malajzinë, Indonezinë, Pakistanin, Iranin, Irakun, Sirinë, Jemenin, Sudanin dhe Libinë). Udhëheqjen e këtij grupimi aziatik-islamit e përbënin njerëz nga Kina, Siria dhe Irani. Ndërsa midis këtyre dy grupimeve ndodheshin vendet e Amerikës Latine, me përjashtim të Kubës, e cila shpesh ka mbështetur Perëndimin, dhe vendeve afrikane e ortodokse, që nganjëherë mbështesnin po më shpesh i kundërshtonin pozitat e Perëndimit.

Ndër çështjet, që i ndanin vendet sipas vijave të qytetërimit, bënin pjesë: universalizmi kundrejt relativizmit kulturor lidhur me të drejtat e njeriut; përparësia relative e të drejtave ekonomike dhe shoqërore lidhur me të drejtën për zhvillimin kundrejt të drejtave politike e civile; kushtëzimi politik lidhur me ndihmën ekonomike; krijimi i një Komisioneri të OKB-së për të Drejtat e Njeriut; përmasat në të cilat

organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut, të cilat ishin mbledhur njëkohësisht në Vjenë, duhej të kishin për të marrë pjesë në konferencën e nivelit qeveritar; të drejtat e veçanta që duhej të miratonte konferenca dhe çështjet më të posaçme, si: a duhej lejuar Dalja Lama të fliste në konferencë dhe a duheshin dënuar shprehurazi shkeljet e të drejtave të njeriut në Bosnje.

Për këto çështje dolën dallimet më të mëdha ndërmjet vendeve Perëndimore dhe bllokut aziat-islamik. Dy muaj para konferencës së Vjenës vendet aziatike ishin mbledhur në Bangkok dhe miratuan një deklaratë, e cila e vinte theksin te të drejtat e njeriut, që duheshin vështruar “në kontekstin...e veçantive kombëtare e rajonale dhe të së kaluarës historike fetare e kulturore të ndryshme,” se mbikëqyrja e të drejtave të njeriut shkelte sovranitetin e shtetit dhe se kushtëzimi i ndihmës ekonomike me zbatimin e të drejtave të njeriut ishte në kundërshtim me të drejtën për zhvillim. Dallimet lidhur me këto dhe me çështje të tjera qenë aq të mëdha, sa pothuaj gjithë dokumenti i përgatitur nga konferenca e fundit para Vjenës prej mbledhjes përgatitore në Gjenevë në fillim të majit ishte përplot me kllapa, që tregonin për mospajtimin e njërës ose të më shumë vendeve.

Vendet Perëndimore nuk ishin përgatitur mirë për Vjenën, në konferencë numri i të tjerave ishte më i madh dhe gjatë punimeve bënë më shumë lëshime sesa kundërshtarët e tyre. Si rrjedhim, përveç një miratimi të fortë për të drejtat e grave, deklarata e miratuar nga konferenca ishte vetëm diçka minimale. Siç vuri në dukje një mbështetës i të drejtave të njeriut, ishte një dokument “kontradiktor e me të meta” dhe përfaqësonte një fitore të koalicionit aziat-islamik e një dështim për Perëndimin.¹⁷ Deklarata e Vjenës nuk përmbante asnjë pohim të shprehur për të drejtat e liritë

e fjalës, të shtypit, të mbledhjes dhe të besimit fetar, duke dalë kështu nga shumë anë më e dobët se Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, që OKB-ja e ka miratuar më 1948. Kjo zhvendosje pasqyrore rënien e fuqisë së Perëndimit. “Regjimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i vitit 1945,” siç e ka vërejtur një mbështetës i të drejtave të njeriut, “nuk ekziston më. Hegjemonia amerikane është gërryer. Europa, me gjithë ngjarjet e vitit 1992, është vetëm diçka më pak se një gadishull. Bota sot është po aq arabe, aziatike dhe afrikane, sa është edhe Perëndimore. Sot Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventat Ndërkombëtare janë me më pak peshë për shumicën e planetit, sesa në epokën menjëherë pas Luftës Botërore.” Një kritik aziatik i Perëndimit ka shprehur pikëpamje të ngjashme: “Për herë të parë qysh kur u miratua Deklarata Universale më 1948, vende të cilat nuk janë futur tërësisht në traditat e së drejtës natyrore e judeo-krishtere, kanë dalë në radhën e parë. Kjo gjendje e paprecedent do të përcaktojë politikën e re ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo gjithashtu do të shumëfishojë rastet për konflikte.”¹⁸

“Fitimtari i madh” në Vjenë, siç e ka komentuar një vëzhgues tjetër, “dukej qartë se ishte Kina, të paktën nëse sukcesi matet me aftësinë për t’u thënë të tjerëve që mos na zini rrugën. Pekini vijoi të korrite fitore gjatë gjithë mbledhjes, thjesht duke e lëshuar peshën e vet rreth e rrotull.”¹⁹ Perëndimi, të cilit ia kaluan me vota dhe me manovrimë në Vjenë, megjithatë që në gjendje disa muaj më vonë të arrinte një fitore jo të vogël kundër Kinës. Për qeverinë kineze kishte qenë një nga qëllimet kryesore të siguronte që Olimpiada verore e vitit 2000 të bëhej në Pekin dhe ajo kishte investuar burime të jashtëzakonshme, duke u përpjekur që ta fitonte këtë. Në Kinë u bë një reklamë kolosale lidhur me zgjedhjen e

vendit të Lojërave Olimpikë dhe publiku kishte shpresa të mëdha; qeveria tërhoqi pas vetes qeveri të tjera që të bënë trysni mbi shoqatat e tyre olimpikë; edhe Tajvani e Hong-Kongu u bashkuan me këtë fushatë. Nga ana tjetër, Kongresi i Shteteve të Bashkuara, parlamenti evropian dhe organizatat e të drejtave të njeriut - që të gjitha iu kundërvunë fuqimisht zgjedhjes së Pekinit. Ndonëse votimi në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar bëhet me votë të fshehtë, është e qartë se ai u zhvillua sipas vijave qytetërimore. Në votimin e parë Pekini, me mbështetjen e kuptueshme mjaft të gjerë të vendeve afrikane, doli në vend të parë dhe Sidneji doli në vend të dytë. Por në votimet e mëpasme, kur u hoq Stambolli, lidhja konfuciane-islamike ia kaloi votat gjerësisht Pekinit; kur u eliminuan Mançesteri dhe Berlina, votat e tyre i kaluan në pjesën dërrmuese Sidnejit, duke ia dhënë fitoren në votimin e katërt dhe duke i shkaktuar një humbje poshtëruese Kinës, për të cilën ajo fajësoi katërcipërisht Shtetet e Bashkuara.* Siç e komentoi Li Kuan Jiu, “Amerika dhe Britania ia arritën ta rrëzonin poshtë Kinën në përmasat e saj...Arsyeja në dukje ishin ‘të drejtat e njeriut’. Por arsyeja e vërtetë ishte politike, për të treguar grushtin politik të Perëndimit.”²⁰ Pa dyshim, shumë njerëz në botë merren më shumë me sport sesa me të drejtat e njeriut, por për shkak të humbjes që pësoi lidhur me të drejtat e njeriut Perëndimi në Vjenë e gjetkë, ky demonstrim i veçuar i ‘grushtit’ të Perëndimit ishte njëkohësisht edhe një përkujtim i dobësisë së Perëndimit.

* Rezultatet e votimeve për katër herët kanë qenë si më poshtë:

	I pari	I dyti	I treti	I katërti
Pekini	32	37	40	43

Sidneji	30	30	37	45
Mançesteri	11	13	11	
Stambolli	7			
Abstenime			1	1
Gjithsej	89	89	89	89

Jo vetëm ka rënë forca e grushtit të Perëndimit, por edhe paradoksi i demokracisë gjithashtu e dobëson Perëndimin në përkrahjen e demokracisë në botën pas Luftës së ftohtë. Gjatë Luftës së ftohtë Perëndimi dhe Shtetet e Bashkuara në veçanti ballafaqoheshin me problemin e “tiranit miqësor”: me dilemën për të bashkëpunuar me juntat ushtarake dhe me diktatorët, që ishin antikomunistë e prandaj përbënin një zgjidhje të dobishme në Luftën e ftohtë.. Një bashkëpunim i tillë shkaktonte pakënaqësi e nganjëherë i vinte në pozitë të vështirë, kur këto regjime ecnin në rrugën e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Megjithatë, bashkëpunimi mund të përliqej, duke i parë si të keqen më të vogël: zakonisht këto regjime ishin më pak shtypëse se regjimet komuniste dhe mund të shpresohej se nuk do të zgjasnin shumë, duke qenë më të hapura për ndikimin nga ana e Shteteve të Bashkuara dhe të tjerave. Përse të mos punohej bashkë me mikun tiran më pak të ashpër, nëse e vetmja alternativë ishte vetëm një tjetër armiqësor dhe më i ashpër? Në botën pas Luftës së ftohtë zgjedhja bëhet më e vështirë ndërmjet një tirani miqësor dhe një demokracie armiqësore. Mendimi i përciptë i Perëndimit se qeveritë e zgjedhura demokratikisht do të ishin më të prirura për bashkëpunim dhe me qëndrim më pro Perëndimit, nuk del i vërtetë në shoqëritë jo-Perëndimore, ku gara zgjedhore mund të sjellë në pushtet nacionalistë anti-Perëndimorë dhe

fundamentalistë. Perëndimi u ndie i lehtësuar kur ushtarakët algjerianë ndërhyjnë më 1992 dhe i anuluan zgjedhjet, në të cilat dukej qartë se do të fitonte FIS. Gjithashtu qeveritë Perëndimore u qetësuan kur Partia e Mirëqenies fundamentaliste në Turqi dhe BJP nacionaliste në Indi u përjashtuan nga pushteti, pasi kishin arritur fitore në zgjedhjet e vitit 1995 dhe 1996. Nga ana tjetër, brenda kontekstit të revolucionit të vet, Irani nga disa anë ka njërin prej regjimeve më demokratike në botën islamike, kurse zgjedhjet me konkurrencë në shumë vende arabe, duke përfshirë edhe Arabinë Saudite e Egjiptin, pothuajse me siguri do të nxirrnin qeveri shumë më pak simpatizuese për interesat e Perëndimit, sesa paraardhëset e tyre jodemokratike. Një qeveri e zgjedhur nga populli në Kinë do të ishte shumë më nacionaliste. Meqë udhëheqësit e Perëndimit po e kuptojnë se proceset demokratike në shoqëritë jo-Perëndimore shpesh nxjerrin qeveri me qëndrim jomiqësor ndaj Perëndimit, ato edhe përpiqen të ndikojnë në ato zgjedhje, edhe e humbasin entuziazmin e vet për përkrahjen e demokracisë në ato shoqëri.

Imigrimi

Nëse demografia është çështje e fatit, lëvizjet e popullsisë janë motori i historisë. Në shekujt e kaluar, normat e ndryshme të shtimit të popullsisë, kushtet ekonomike dhe politikat qeveritare kanë shkaktuar shpërngulje masive të grekëve, çifutëve, fiseve gjermanike, nordikëve, turqve, rusëve, kinezëve dhe të tjerëve. Në disa raste këto lëvizje kanë qenë relativisht paqësore, në raste të tjera shumë të dhunshme.

Megjithatë, europianët e shekullit të nëntëmbëdhjetë kanë qenë raca mbisunduese e invadimit demografik. Ndërmjet viteve 1821 e 1924, afërsisht 55 milionë europianë kanë emigruar përtej oqeanit, 34 milionë prej tyre për në Shtetet e Bashkuara. Perëndimorët i pushtuan dhe disa herë i shfarosën popujt e tjerë, i shfrytëzuan dhe i kolonizuan tokat me densitet më të vogël popullsie. Eksportimi i njerëzve ka qenë ndoshta përmasa më e rëndësishme e veçantë e ngritjes së Perëndimit ndërmjet shekujve XVII dhe XX.

Nga fundi i shekullit të njëzetë ndodhi një shpërthim i ndryshëm dhe madje më i gjerë i emigrimit. Emigrantët e ligjshëm ndërkombëtarë më 1990 arrinin afër 100 milionë, refugjatët afër 19 milionë dhe emigrantët e paligjshëm ndoshta të paktën 10 milionë të tjerë. Kjo dallgë e re migrimi pjesërisht ishte produkt i shkolonizimit, i ngritjes së shteteve të reja dhe i politikave shtetërore, që i nxisnin ose i detyronin njerëzit të zhvendoseshin. Megjithatë, ajo ishte po ashtu rezultat i modernizimit dhe i zhvillimit teknologjik. Përmirësimet e transportit e bënë migrimin më të lehtë, më të shpejtë dhe më të lirë; përmirësimet e komunikimit ngjallën shtypa për të synuar mundësitë ekonomike dhe u hapën rrugë marrëdhënieve ndërmjet emigrantëve dhe familjeve të vendlindjes. Veç kësaj, po ashtu si në shekullin e nëntëmbëdhjetë rritja ekonomike e Perëndimit i jepte shtypa emigrimit, po ashtu në shekullin e njëzetë zhvillimi ekonomik ka nxitur emigrimin në shoqëritë jo-Perëndimore. Migrimi shndërrohet në një proces vetëpërforcues. “Nëse ka ndonjë ‘ligj’ të vetëm për migrimin,” ka argumentuar Myron Weiner-i (Majron Vajner), “ai është se rrjedha e migrimit, pasi nis, sjell rrymën e vet. Emigrantët ua bëjnë të mundur miqve dhe farefisit të tyre që mbeten në vendlindje të shkojnë emigrantë, duke u dhënë

informacionin e nevojshëm sesi të emigrojnë, u sigurojnë lehtësitë për të lëvizur dhe ndihmën për të gjetur punë e banesë.” Me dy fjalë, rezultati është një “krizë globale migrimi.”²¹

Perëndimorët në mënyrë ngulmuese dhe mbizotëruese i janë kundërvënë përhapjes së armëve bërthamore dhe kanë mbështetur demokracinë e të drejtat e njeriut. Pikëpamjet e tyre për migrimin, përkundrazi, kanë qenë të ndryshueshme dhe të dykuptimshme, ndërsa peshorja është luhatur në mënyrë të ndjeshme gjatë dy dhjetëvjeçarëve në shekullin e njëzetë. Deri në vitet 1970 vendet europiane përgjithësisht kanë pasur qëndrim mbështetës për imigrimin dhe, në disa raste, e sidomos Gjermania e Zvicra, e kanë nxitur për të plotësuar mungesat e krahut të punës. Më 1965 Shtetet e Bashkuara i hoqën kuotat me orientim europian, që ishin vendosur prej viteve 1920, dhe i rishikuan thellë ligjet e tyre, duke bërë të mundur një shtim kolosal të emigrantëve dhe të burimeve të reja për ta në vitet 1970 e 1980. Mirëpo nga fundi i viteve 1980 nivelet e larta të papunësisë, shtimi i numrit të imigrantëve dhe përbërja dërrmuese “joeuropiane” shkaktuan ndryshime të forta në qëndrimet dhe politikën europiane. Pak vjet më vonë shqetësime të njëjta sollën një zhvendosje të ngjashme edhe te Shtetet e Bashkuara.

Pjesa më e madhe e emigrantëve dhe e refugjatëve të fundit të shekullit të njëzetë kanë lëvizur nga një shoqëri jo-Perëndimore te një tjetër. Vërshimi i emigrantëve për në shoqëritë Perëndimore, megjithatë, i ka arritur shifrat absolute të shekullit të nëntëmbëdhjetë të emigrimit Perëndimor. Më 1990 në Shtetet e Bashkuara kishte një numër të vlerësuar në 20 milionë imigrantë të brezit të parë, 15,5 milionë në Europë dhe 8 milionë në Australi e Kanada. Përpjesëtimi i imigrantëve

kundrejt popullsisë gjithsej arriti nga 7 deri në 8 për qind të popullsisë më 1994, dyfishin e vitit 1970, dhe përbënte 25 për qind të popullsisë në Kaliforni e 16 për qind në Nju-Jork. Rreth 8,3 milionë njerëz hynë në Shtetet e Bashkuara në vitet 1980 dhe 4,5 milionë në katër vjetët e parë të viteve 1990.

Imigrantët e rinj kanë ardhur në pjesën dërrmuese prej shoqërive jo-Perëndimore. Në Gjermani banorët e huaj turq arrinin 1.675.000 veta më 1990, duke qenë Jugosllavia, Italia dhe Greqia që kishin nxjerrë kontingjentet më të mëdha pas turqve. Në Itali burimet kryesore kanë qenë Maroku, Shtetet e Bashkuara (me sa duket, në pjesën më të madhe italianë të Amerikës që janë kthyer), Tunizia dhe Filipinet. Nga mesi i viteve 1990, afërsisht 4 milionë myslimanë jetonin në Francë dhe deri në 13 milionë në Europën Perëndimore përgjithësisht. Në mes të viteve 1950 dy të tretat e emigrantëve për në Shtetet e Bashkuara vinin nga Europa e Kanadaja; në vitet 1980 afërsisht 35 për qind e numrit më të madh të imigrantëve vinin nga Azia, 45 për qind nga Amerika Latine dhe më pak se 15 për qind nga Europa e Kanadaja. Në Shtetet e Bashkuara shtimi natyror i popullsisë është i ulët, kurse në Europë praktikisht është zero. Migrantët kanë normë të lartë lindshmërie dhe rrjedhimisht do të jenë burimi kryesor i shtimit të popullsisë në të ardhmen në shoqëritë Perëndimore. Si pasojë, Perëndimorët gjithnjë e më tepër kanë frikë “se tashti po pushtohen jo prej ushtrive dhe tankeve, por prej emigrantëve që flasin të tjera gjuhë, u luten të tjerëve zota, u përkasin të tjerave kultura dhe, siç kanë frikë ata, do t’u rrëmbejnë vendet e punës, do t’u marrin tokat, do të përfitojnë nga sistemi i përkrahjes sociale dhe do të kërcënojnë mënyrën e tyre të jetesës.”²² Këto fobi, me rrënjë në rënien demografike përkatëse, siç e ka vënë re Stanley Hoffman (Stanli

Hofman), “mbështeten në përplasjet e mirëfillta dhe shqetësimet kulturore lidhur me identitetin nacional.”²³

Aty nga fillimi i viteve 1990, dy të tretat e migrantëve në Europë ishin myslimanë, prandaj shqetësimi europian lidhur me emigrantët është mbi të gjitha shqetësim me imigrimin mysliman. Sfida është në fushën e demografisë: migrantët llogaritet të arrijnë 10 për qind të lindjeve në Europën Perëndimore, arabët 50 për qind të lindjeve në Bruksel, si dhe në fushën kulturore. Bashkësitë myslimane, qoftë ato turke në Gjermani ose algjeriane në Francë, nuk janë integruar në kulturat pritëse dhe, duke ngjallur shqetësimet e europianëve, shfaqin fare pak shenja se do të integrohen. Më 1991 Jean Marie Domenach (Zhan Mari Domenach) ka thënë, se “po shtohet frika nëpër gjithë Europën se një bashkësi myslimane po i ndërpret linjat europiane, një lloj kombi i trembëdhjetë i Bashkimit Europian.” Lidhur me emigrantët një gazetar amerikan ka bërë këtë koment:

Për çudi, armiqësia e europianëve është përzgjedhëse. Pakkush në Francë merakoset për një vërshim nga Lindja: në fund të fundit, polakët janë europianë dhe katolikë. E në pjesën më të madhe nuk ka ndonjë frikë ose përbuzje për afrikanët joarabë. Armiqësia drejtohet kryesisht ndaj myslimanëve. Fjala ‘immigré’ në të vërtetë është sinonime me islamin, që tashti në Francë është feja e dytë për nga madhësia, dhe pasqyron një racizëm kulturor e etnik me rrënjë të thella në historinë franceze.²⁴

Megjithatë, francezët janë më kulturalistë sesa racistë në çfarëdo kuptimi të përpiktë. Ata i kanë pranuar në legjislaturën e tyre afrikanët zezakë, që flasin me përsosuri frëngjishten, por nuk pranojnë që vajzat myslimane të shkojnë në shkollë me shamitë e tyre të kokës. Më 1990, 76 për qind e publikut francez

mendonte se kishte tepër arabë në Francë, 46 për qind se kishte tepër zezakë, 40 për qind se kishte tepër aziatikë dhe 24 për qind se kishte tepër çifutë. 47 për qind e gjermanëve më 1994 thanë se do të parapëlqenin të mos kishin arabë që të banonin si fqinjë të tyre, 39 për qind nuk donin polakët, 36 për qind turqit dhe 22 për qind çifutët.²⁵ Në Europën Perëndimore antisemitizmi i drejtuar kundër arabëve ka zëvendësuar në pjesën më të madhe antisemitizmin e drejtuar kundër çifutëve.

Kundërshtimi publik ndaj imigrimit dhe armiqësia ndaj imigrantëve janë shfaqur në aktet e skajshme të dhunës kundër bashkësive të imigrantëve dhe individëve, që u bënë problem veçanërisht në Gjermani në fillim të viteve 1990. Më të ndjeshme kanë qenë rritjet e votave për partitë e djathta, nacionaliste, antiimigrante. Megjithatë, këto vota rrallë kanë qenë të shumta. Partia Republikane në Gjermani mori mbi 7 për qind të votave në zgjedhjet europiane më 1989, por vetëm 2,1 për qind në zgjedhjet kombëtare më 1990. Në Francë votat për Frontin Nacional, që më 1981 ishin të papërfillshme, arritën deri 9,6 për qind më 1988 dhe më pas u stabilizuan në 12 për qind e 15 për qind në zgjedhjet parlamentare dhe të pushtetit vendor. Më 1995 dy kandidatët nacionalistë për president mblodhën 19,9 për qind të votave dhe Fronti Nacional arriti të zgjidhte kryetarë bashkie në disa qytete, ndër to edhe në Tulon e Nisë. Në Itali votat për Aleancën Nazionale/MSI po ashtu u rritën nga rreth 5 për qind në vitet 1980 te ndërmjet 10 për qind e 15 për qind në fillim të viteve 1990. Në Belgjikë Fronti Nacional/Blloku Flamand arriti të merrte deri në 9 për qind të zgjedhjeve për pushtetin vendor më 1994, kurse vetë Blloku kapi 28 për qind të votave në Antwerpen. Në Austri votat e zgjedhjeve të përgjithshme u rritën për Partinë e Lirisë

nga më pak se 10 për qind më 1986 deri te mbi 15 për qind më 1990 dhe pothuaj 23 për qind më 1994.²⁶

Këto parti europiane, të cilat e kundërshtojnë imigrimin e myslimanëve, në pjesën më të madhe kanë qenë një shëmbëllim në pasqyrë i partive islamiste në vendet myslimane. Që të dyja palët denoncuan ngrehinën zyrtare të korruptuar dhe partitë e saj, duke shfrytëzuar pakënaqësitë nga ekonomia, në veçanti papunësinë, dhe bënë thirrje etnike e fetare, duke sulmuar ndikimet e huaja në shoqërinë e tyre. Në të dy rastet një fashë ekstremiste ndërmori akte terrorizmi e dhune. Në shumicën e rasteve si partitë nacionaliste europiane, edhe ato islamiste shfaqën prirje që të kishin më shumë sukses në zgjedhjet lokale, sesa në të përgjithshmet. Ngrehinat zyrtare politike myslimane dhe europiane iu përgjigjën këtyre zhvillimeve në mënyrë të ngjashme. Në vendet myslimane, siç e kemi parë, qeveritë përgjithësisht u bënë më islamike në orientimet e tyre, në simbolet, politikat dhe praktikat e tyre. Në Europë partitë e rrymave kryesore përdorën retorikën dhe parashtruan masa të partive të djathta, antiimigrim. Atje ku politika demokratike funksiononte me efektshmëri dhe kishte dy a më shumë parti alternative kundrejt një partie islamiste ose nacionaliste, vota e tyre arriti tavanin prej rreth 20 për qind. Partitë e protestës e çanë këtë tavan vetëm kur nuk ekzistonte asnjë alternativë tjetër kundrejt partisë ose koalicionit në pushtet, siç që rasti në Algjeri, në Austri dhe, në një masë të ndjeshme, në Itali.

Në fillim të viteve 1990 udhëheqësit politikë europianë konkurronin sesi t'i përgjigjeshin ndjenjës kundër imigrimit. Në Francë Jacques Chirac-u (Zhak Shirak) deklaroi më 1990 se "Imigrimi duhet të ndalet plotësisht"; ministri i brendshëm Charles Passqua (Sharl Paskua) kërkonte më 1993 "imigrimin zero", ndërsa

François Mitterrand-i (Fransua Miteran), Edith Cresson-i (Edit Kreson), Valery Giscard d'Estaing (Valeri Zhiskar d'Estenji) dhe politikanë të tjerë kryesorë morën qëndrime kundër imigrimit. Imigrimi ka qenë një nga çështjet kryesore në zgjedhjet parlamentare të vitit 1993 dhe duket se ndihmoi për fitoren e partive konservatore. Gjatë viteve të para 1990 politika e qeverisë franceze ndryshoi dhe e bëri më të vështirë për fëmijët e të huajve që të merrnin shtetësinë, për familjet e të huajve që të imigronin, për të huajt që të kërkonin të drejtën e strehimit politik dhe për algjerianët që të merrnin viza për në Francë. Imigrantët ilegalë u larguan dhe iu dhanë fuqi më të mëdha policisë e autoriteteve të tjera shtetërore për trajtimin e imigrimit.

Në Gjermani kancelari Helmut Kol dhe udhëheqës të tjerë politikë gjithashtu shprehën shqetësime lidhur me imigrimin, kurse qeveria si hapin më të rëndësishëm bëri ndryshimin e Nenit XVI të kushtetutës së Gjermanisë, që u garantonte strehim “njerëzve që përndiqen për shkaqe politike” dhe ua hoqi përfitimet kërkuësve të strehimit politik. Më 1992 në Gjermani erdhën për strehim 438.000 njerëz; më 1994 vetëm 127.000. Më 1980 Britania e shkurtoi rëndë imigrimin deri në 50.000 veta në vit dhe çështja ngjalli më pak ndjenja të forta dhe kundërshtim atje, sesa në kontinent. Mirëpo ndërmjet viteve 1992 e 1994 Britania e uli numrin e kërkuësve të strehimit të lejuar për të qëndruar nga mbi 20.000 te më pak se 10.000. Me rënien e pengesave për lëvizjen brenda Bashkimit Europian, shqetësimet britanike në pjesën më të madhe u përqendruan te rreziqet nga migrimi prej njerëzve joeuropianë që vijnë nga kontinenti. Përgjithësisht në mes të viteve 1990 vendet europiane Perëndimore hynë pa mëshirë në rrugën e pakësimit të minimumit ose

madje të heqjes krejt të imigrimit nga burimet joeuropiane.

Çështja e imigrimit në Shtetet e Bashkuara doli në plan të parë pak më vonë sesa në Europë dhe nuk ngjalli po atë shkallë ndjenjash. Shtetet e Bashkuara kurdoherë kanë qenë një vend emigrantësh, kështu janë formuar dhe historikisht kanë ndjekur një proces të suksesshëm asimilimi të rishardhurve. Veç kësaj, në vitet 1980 e 1990 papunësia ishte ndjeshëm më e ulët në Shtetet e Bashkuara sesa në Europë, kështu që frika për humbjen e vendeve të punës nuk përbënte një faktor vendimtar që përcaktonte qëndrimet ndaj imigrimit. Edhe burimet e imigrimit në Amerikë ishin më të larme se në Europë, kështu frika se mos merrte epërsinë ndonjë grup i vetëm të huajsh ishte më e vogël në shkallë vendi, ndonëse ishte reale në disa vise. Largësia kulturore e dy grupeve më të mëdha të emigrimit kundrejt kulturës vendëse gjithashtu ishte më e vogël sesa në Europë: meksikanët janë katolikë dhe flasin spanjishten; edhe filipinasit janë katolikë e flasin anglisht.

Me gjithë këta faktorë, në çerekshekullin pas miratimit të ligjit të vitit 1965, që lejonte një shtim të madh të imigrimit nga Azia e Amerika Latine, opinioni publik amerikan pësoi një zhvendosje vendimtare. Më 1965 vetëm 33 për qind e publikut kërkonte më pak imigrim. Më 1977 e kërkonin 42 për qind; më 1986 ishin 49 për qind dhe më 1990 e më 1993 ishin 61 për qind. Anketimet e viteve 1990 tregojnë me ngulmim se 60 për qind e më shumë e publikut ishte në të mirë të pakësimit të imigrimit.²⁷ Ndërsa shqetësimet ekonomike dhe kushtet ekonomike prekin qëndrimet kundrejt imigrimit, rritja e vijueshme e kundërshtimit si në kohë të mira dhe në të këqija, na bën të mendojmë se kultura, krimi dhe mënyra e jetesës kanë qenë më të rëndësishme për këtë ndryshim të opinionit. “Shumë, ndoshta shumica e

amerikanëve,” ka bërë një koment më 1994 një vëzhgues, “ende e shohin kombin e tyre si një vend të kolonizuar prej europianësh, ligjet e të cilit janë trashëgimi nga Anglia, gjuha e të cilit është (dhe duhet të mbetet) anglishtja, institucionet e të cilit dhe ndërtesat publike e gjejnë frymëzimin te normat klasike të Perëndimit, feja e të cilit ka rrënjë judaike e të krishtera, dhe madhështia e të cilit e ka zanafillën te etika e punës së protestantëve.” Si pasqyrim i këtyre shqetësimeve, 55 për qind nga një mostër e zgjedhur prej publikut kanë thënë se mendonin, që imigrimi ishte një kërcënim për kulturën amerikane. Ndërsa europianët kërcënimin prej imigrantëve e shohin si mysliman ose arab, amerikanët e shohin edhe si latin-amerikan, edhe si aziatik, por para së gjithash si meksikan. Një mostër e zgjedhur amerikanësh, kur u pyetën më 1990 se prej cilave vende Shtetet e Bashkuara po pranonin më tepër sesa duhet imigrantë, ata e veçuan Meksikën me një përqindje dy herë më të lartë sesa çdo vend tjetër, të ndjekur nga Kuba, Orienti (pa e përcaktuar shtetin), Amerika e Jugut dhe Amerika e Latine (pa e përcaktuar shtetin), Japonia, Vietnami, Kina dhe Koreja.²⁸

Rritja e kundërshtimit nga publiku kundrejt imigrimit në fillim të viteve 1990, ka nxitur një reagim politik të krahasueshëm me atë, që ndodhi në Europë. Duke e ditur natyrën e sistemit politik amerikan, partitë e djathta dhe antiimigrim nuk kanë fituar vota, por publicistët antiimigrim dhe grupet e interesave janë shtuar si numër, janë bërë më aktive dhe e kanë ngritur më shumë zërin. Pjesa më e madhe e pakënaqësisë është përqendruar te 3,5 deri 4 milionë imigrantët ilegalë dhe politikanët kanë dhënë përgjigjen e tyre. Ashtu si në Europë, reagimi më i fuqishëm ka qenë në nivelin e shteteve dhe lokal, që mbajnë mbi kurriz shumicën e shpenzimeve për imigrantët. Si pasojë, më 1994 në

Floridë, të cilën e ndoqën gjashtë a shtatë shtete të tjera, u bë kërkesa që qeveria federale të jepte 884 milionë dollarë në vit për të mbuluar shpenzimet e arsimit, të përkrahjes sociale, të mbajtjes së ligjit dhe për probleme të tjera, që shkaktohen prej imigrantëve të paligjshëm. Në Kaliforni, që është shteti me numrin më të madh të emigrantëve si shifër absolute dhe si përpjesëtim, guvernatori Pete Wilson (Pit Uillson) fitoi mbështetjen e publikut, kur kërkoi që të mos u jepej arsimit publik fëmijëve të imigrantëve të paligjshëm, të mos u jepej shtetësia amerikane fëmijëve të imigrantëve të paligjshëm të lindur në SHBA dhe të ndërpriteshin pagesat nga shteti për kujdesin mjekësor në raste urgjence për imigrantët e paligjshëm. Në nëntor 1994 kalifornianët miratuan me shumicë dërrmuese Propozimin 187, që ua mohonte përfitimet në arsim, shëndetësi e përkrahje sociale të huajve të paligjshëm dhe fëmijëve të tyre.

Po ashtu administrata e Klintonit më 1994, duke e kthyer mbrapsht qëndrimin e mëparshëm, nisi të merrte masa më të forta për të kontrolluar imigrimin, i shtrengoi rregullat për strehimin politik, e zgjeroi Shërbimin për Imigrimin dhe Natyralizimin, e forcoi Patrullimin Kufitar dhe ndërtoi pengesa fizike përgjatë kufirit me Meksikën. Më 1995 Komisioni për Reformën e Imigrimit, me autorizimin nga Kongresi të vitit 1990, rekomandoi pakësimin e imigrimit të ligjshëm vjetor nga 800.000 në 550.000, duke u dhënë përparësi të rinjve dhe nuseve të tyre, por jo familjarëve të tjerë të qytetarëve ekzistues dhe të rezidentëve, një masë kjo që “i ndezi familjet aziatike-amerikane dhe hispanike.”²⁹ Në vitet 1995-96 po ecte në rrugën e tij në Kongres legjislacioni, që i përfshinte shumicën e rekomandimeve të komisionit dhe masat e tjera për kufizimin e imigrimit. Nga mesi i viteve 1990 imigrimi kështu u bë një çështje

kryesore politike në Shtetet e Bashkuara, kurse më 1996 Patrick Buchanan-i (Patrik Bjukanan) e shndërroi kundërshtimin ndaj imigrimit në një nga shtyllat e fushatës së tij për president. Shtetet e Bashkuara po ndjekin Europën në ecurinë për të shkurtuar rëndë hyrjen në shoqërinë e tyre të jo-Perëndimoreve.

A munden Europa ose Shtetet e Bashkuara ta përmbajnë dallgën e migrimit? Franca ka përjetuar një rrymë të ndjeshme pesimizmi demografik, që shtrihet nga romani therës i Jean Raspail-it (Zhan Raspaj) në vitet 1970 deri te analiza shkencore e Jean-Claude Chesnais-së (Zhan Klod Shesne) në vitet 1990, që është përmbledhur më 1991 në komentet e Pierre Lellouche-it (Pjer Lelush): "Historia, afërsia dhe varfëria e bëjnë të sigurtë që Franca dhe Europa janë të paracaktuara të përmbysen prej njerëzve, të ardhur nga shoqëritë e dështuara të jugut. E kaluara e Europës ka qenë me të bardhë dhe judaike-kristiane. E ardhmja nuk do të jetë e tillë."³⁰ E ardhmja, megjithatë, nuk është e përcaktuar në mënyrë të pashmangshme; po ashtu nuk është e përjetshme asnjë e ardhme. Çështja nuk është nëse Europa do të islamizohet apo Shtetet e Bashkuara do të hispanizohen. Çështja është nëse Europa dhe Amerika do të bëhen shoqëri të çara, që përfshijnë dy bashkësi të dallueshme dhe mjaft të shkëputura prej dy qytetërimesh të ndryshme, të cilat nga ana e tyre varen prej numrit të imigrantëve dhe shkallës në të cilën janë asimiluar në kulturat Perëndimore, që mbizotërojnë në Europë e në Amerikë.

Përgjithësisht shoqëritë europiane ose nuk duan t'i asimilojnë imigrantët, ose kanë vështirësi të mëdha për ta bërë këtë, kurse shkalla në të cilën imigrantët myslimanë dhe fëmijët e tyre duan të asimilohen është e paqartë. Si rrjedhim, imigrimi i ndjeshëm e i vazhdueshëm ka gjasa të shkaktojë shfaqjen e vendeve të

ndara në bashkësi të krishtera e myslimane. Ky rrjedhim mund të shmanget në atë masë, që popujt dhe qeveritë europiane kanë vullnetin të mbajnë mbi kurriz kostot e kufizimit të një imigrimi të tillë, në të cilat bëjnë pjesë kostoja e drejtpërdrejtë fiskale për masat antiimigrim, kostoja shoqërore për tëhuajëzimin e mëtejshëm të bashkësive ekzistuese të imigrantëve, dhe kostot e pritshme ekonomike afatgjata për mungesat e krahut të punës dhe normat më të larta të shtimit.

Megjithatë, problemi i vërshimit demografik mysliman ka gjasa që të dobësohet, pasi të arrijë kulmin norma e shtimit të popullsisë në shoqëritë e Afrikës së Veriut dhe të Lindjes së Mesme, siç ka ndodhur tashmë në disa vende, dhe pastaj të nisë rënien.³¹ Për aq sa e nxit imigrimin trysnia demografike, imigrimi mysliman mund të bëhet më i vogël aty nga viti 2025. Por kjo nuk është e vërtetë për Afrikën Nën-Saharane. Nëse do të ketë zhvillim ekonomik dhe do ta nxisë mobilizimin shoqëror në Afrikën Perëndimore e Qendrore, do të shtohen edhe shtysat e aftësitë për imigrim, kurse kërcënimi i “islamizimit” për Europën do të zëvendësohet nga ai i “afrikanizimit”. Përmasat në të cilat ky kërcënim do të materializohet, do të ndikohen gjithashtu në masë të madhe nga shkalla në të cilën popullsitë e Afrikës do të pakësohen nga SIDA e sëmundjet e tjera, si dhe nga shkalla në të cilën Afrika e Jugut i tërheq imigrantët prej vendeve gjetkë në Afrikë.

* Libri i Raspail-it, *Le Camp des Saints*, u botua për herë të parë më 1973 (Paris, Botimet Robert Laffont) dhe doli në botim të ri më 1985, pasi u përforcua në Francë shqetësimi rreth imigrimit. Romani tërhoqi menjëherë vëmendjen e amerikanëve, pasi u shtua shqetësimi në Shtetet e Bashkuara më 1994, kur u botuan artikulli “Must It Be the Rest Against the West?” i Matthew Connelly-t dhe Paul Kennedy-t në *Atlantic Monthly*, V. 274 (dhjet. 1994), f. 61 vij.,

dhe parathënia e Raspail-it për botimin frëngjisht të vitit 1995 në gjuhën angleze në *The Social Contract*, v. (Dimër 1993-94), f. 115-117.


Ndërkohë që myslimanët përbëjnë problemin e drejtpërdrejtë për Europën, meksikanët përbëjnë problem për Shtetet e Bashkuara. Po të pranojmë se do të vijojnë prirjet dhe politikat e sotme, popullsia amerikane, siç e tregojnë shifrat në Tabelën 8.2 më poshtë, do të ndryshojë thellë në gjysmën e parë të shekullit të njëzetënjëtë, duke u bërë pothuaj 50 për qind me të bardhë dhe 25 për qind me hispanikë. Po ashtu si në Europë, ndryshimet në politikën e imigrimit dhe vendosja e efektshme e masave antiimigrim mund t'i ndryshojnë këto parashikime. Edhe po të ndodhë kështu, si çështje qendrore do të mbetet shkalla në të cilën hispanikët asimilohen në shoqërinë amerikane, ashtu siç kanë bërë grupet e mëparshme të imigrantëve. Brezi i dytë dhe i tretë i hispanikëve janë përballë një game të gjerë shtysash e trysnish për ta barë këtë. Nga ana tjetër, emigrimi prej Meksikës ndryshon në mënyrë mjaft të ndjeshme prej imigrimeve të tjera. Së pari, emigrantët nga Europa ose Azia detyrohen të kalojnë oqeanet; meksikanët kalojnë kufirin ose kapërcejnë një lumë. Bashkë me këtë lehtësitë e transportit dhe të komunikimit që janë në rritje, u bëjnë të mundur atyre të mbajnë lidhje të ngushta me bashkësitë e atdheut dhe të ruajnë identitetin. Së dyti, imigrantët meksikanë janë të përqendruar në pjesën jugperëndimore të Shteteve të Bashkuara dhe përbëjnë një pjesë të shoqërisë së vijueshme meksikane, që shtrihet nga Jukatani deri në Kolorado (shih Hartën 8.1). Së treti, disa dëshmi na bëjnë të mendojmë se qëndresa kundër asimilimit është më e fortë mes migrantëve meksikanë, sesa ndër grupet e tjera të imigrantëve, kështu meksikanët priren ta ruajnë identitetin e vet meksikan, siç ka dalë e qartë në luftën

për Propozimin 187 në Kaliforni më 1994. E katërta, zona ku vendosen migrantë meksikanë ka qenë aneksuar nga Shtetet e Bashkuara pas thyerjes së Meksikës në mes të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi ekonomik i Meksikës pothuaj me siguri do të ringjallë ndjenja revanshiste meksikane. Në kohën përkatëse, arritjet e zgjerimit ushtarak të Amerikës në shekullin e nëntëmbëdhjetë mund të rrezikohen dhe të ecin mbrapsht përballë zgjerimit demografik në shekullin XXI.

Harta 8.1:

Shtetet e bashkuara: një vend i çarë?

Përqindja e pritshme e popullsisë që do të jetë zezake, aziatike, vendëse amerikane ose hispanike më 2020, sipas konteve



Burimi: Mbështetur në të dhënat nga Zyra e Regjistrimit e SHBA. Rodger Doyle Copyright 1995 për U.S. News and World Report

Tabela 8.2:
Popullsia e SHBA sipas racës dhe etnisë

(në përqindje)

	1995	2020	2050
		Vler.	Vler.
Të bardhë johispanikë	74%	64%	53%
Hispanikë	10	16	25
Zezakë	12	13	14
Azianë dhe nga ishujt e Paqësorit	3	6	8
Indianë të Amerikës dhe vendës Alaske	<1	<1	1
Gjithsej (milione)	263	323	394

Burimi: Zyra e SHBA e Regjistrimit, *Population Projections of the United States by Age, Sex, Race, and Hispanic Origin: 1995 to 2050* (Washington: U.S. Government Printing Office, 1996), f. 12-13.

Baraspesha e fuqisë që ndryshon ndërmjet qytetërimi-
meve e bën gjithnjë e më të vështirë për Perëndimin që
të arrijë synimet e tij lidhur me përhapjen e armëve, të
drejtat e njeriut, imigrimin dhe çështje të tjera. Që në
këto rrethana t'i pakësojë humbjet e veta, Perëndimit i
duhet që burimet e veta ekonomike t'i përdorë me shka-
thtësi si shkopin e karrotën në marrëdhëniet me shoqë-
ritë e tjera, të forcojë unitetin e vet dhe të bashkërendojë
politikat, në mënyrë që ta bëjë më të vështirë për
shoqëritë e tjera që ta shtyjnë një vend Perëndimor
kundër një tjetri, si dhe të nxisë e të shfrytëzojë dallimet
ndërmjet vendeve jo-Perëndimore. Aftësia e Perëndimit
për t'i ndjekur këto strategji do të formësohet prej
natyrës dhe intensitetit të konflikteve të tij me
qytetërimet sfiduese, nga njëra anë, dhe nga shkalla me
të cilën do të përcaktojë e do të zhvillojë interesa të
përbashkët me qytetërimet e lëkundura, nga ana tjetër.

Kreu 9: Politika globale e qytetërimeve

Shteti bërthamë dhe konfliktet në vijën e shkëputjes

Qytetërimet janë fise njerëzore në gjendjen përfundimtare, kurse përplasja e qytetërimeve është konflikt fisnor në shkallë globale. Në botën që po përftohet shtetet dhe grupet prej dy qytetërimesh të ndryshme mund të formojnë lidhje e koalicione taktike të kufizuara, ad hoc, për të mbështetur interesat e tyre kundër entiteteve prej një qytetërimi tjetër, ose për qëllime të tjera të përbashkëta. Megjithatë, marrëdhëniet ndërmjet grupeve prej qytetërimeve të ndryshme pothuaj asnjëherë nuk do të jenë të afërta, zakonisht do të jenë të ftohta dhe shpesh do të jenë armiqësore. Lidhjet ndërmjet shteteve prej qytetërimesh të ndryshme, të trashëguara prej së kaluarës, si rasti i aleancave ushtarake të kohës së Luftës së ftohtë, ka gjasa të zbehen ose të fshihen. Nuk do të realizohen më shpresat për 'partneritetet' ndërqytetërimore, siç janë ndërtuar dikur prej udhëheqësve të tyre për Rusinë e Amerikën. Marrëdhëniet ndërqytetërimore që po përftohen, si rregull, do të ndryshojnë nga të largëta e

deri te të dhunshme, kurse shumica do të ndodhen midis këtyre skajeve. Në shumë raste ka të ngjarë që të afrohen me një 'paqe të ftohtë', për të cilën ka paralajmëruar Boris Jelcini, se e tillë mund të jetë e ardhmja e marrëdhënieve ndërmjet Rusisë e Perëndimit. Marrëdhënie të tjera ndërqytetërimore mund të afrohen me një gjendje 'luftë të ftohtë'. Termi *la guerra fria* është krijuar prej spanjollëve të shekullit XIII për të përcaktuar 'bashkekzistencën e trazuar' me myslimanët në Mesdhe, kurse në vitet 1990 shumë njerëz e shihnin se do të ndodhte përsëri një 'luftë e ftohtë qytetërimore' ndërmjet islamit dhe Perëndimit.¹ Në një botë qytetërimesh, nuk do të jetë kjo e vetmja marrëdhënie që do të cilësohet me këtë term. Për të përshkruar marrëdhëniet ndërmjet entiteteve prej qytetërimeve të ndryshme, togfjalëshat më të mundshëm do të jenë: paqe e ftohtë, luftë e ftohtë, luftë tregtare, pothuaj luftë, paqe e trazuar, marrëdhënie të turbulluara, rivalitet i dendur, bashkekzistencë në garë, garë armatimesh. Miqësia dhe besimi do të jenë të rralla.

Konflikti ndërqytetërimor merr dy forma. Në nivelin vendor ose në mikronivel, *konfliktet në vijën e shkëputjes* ndodhin ndërmjet shteteve fqinje prej qytetërimesh të ndryshme, ndërmjet grupesh prej qytetërimesh të ndryshme brenda një shteti dhe ndërmjet grupeve që, siç është rasti i ish Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, po orvaten të krijojnë shtete të reja prej rrënojave të të mëparshmeve. Sidomos mbizotërojnë konfliktet në vijën e shkëputjes ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve. Arsyet për këto konflikte dhe natyra e dinamika e tyre janë shqyrtuar në krerët 10 e 11. Në nivelin global ose në makronivel, *konfliktet e shteteve bërthamë* ndodhin ndërmjet shteteve kryesore të qytetërimeve të ndryshme. Çështjet e këtyre

konflikteve janë ato klasike në politikën ndërkombëtare dhe përfshijnë:

1. ndikimin relativ në formësimin e zhvillimeve globale e të veprimeve të organizatave ndërkombëtare, si OKB-ja, FMN-ja dhe Banka Botërore;

2. fuqinë ushtarake relative, e cila shfaqet në mosmarrëveshjet për mospërhapjen dhe kontrollin e armatimeve e në garat e armatimit;

3. fuqinë dhe mirëqenien ekonomike, që shfaqet në debatet për tregtinë, investimet dhe çështje të tjera;

4. njerëzit, duke përfshirë orvatje të një shteti prej një qytetërimi për të mbrojtur farefisin në një qytetërim tjetër, për diskriminimin e njerëzve prej një qytetërimi tjetër ose për të përjashtuar prej territorit të vet njerëzit prej një qytetërimi tjetër;

5. vlerat dhe kulturat, për të cilat konfliktet lindin kur një shtet orvatet të mbështesë ose të imponojë vlerat e veta mbi njerëzit e një qytetërimi tjetër;

6. rastësisht, territorin, në të cilin shtetet bërthamë bëhen pjesëmarrës të vijës së frontit në konfliktet e vijës së shkëputjes.

Natyrisht, këto çështje përbëjnë burimin e konflikteve ndërmjet njerëzve gjatë gjithë historisë. Mirëpo kur ndërlikohen shtete prej qytetërimesh të ndryshme, dallimet kulturore e bëjnë më të mprehtë konfliktin. Në garën midis tyre, shtetet bërthamë orvaten të mbledhin rreth vetes shpura qytetërimore, të gjejnë mbështetje nga shtete të një qytetërimi të tretë, të nxisin përçarjen nga brenda dhe dezertimin nga qytetërimet kundërshtarë dhe të përdorin ndërthurjen e përshtatshme të veprimeve diplomatike, politike, ekonomike e të fshehta, si dhe bindjen me anë të propagandës e shtrëngesën për të arritur objektivat e

tyre. Megjithatë, nuk ka gjasa që shtetet bërthamë të përdorin forcën ushtarake drejtpërdrejt kundër njëritjetrit, me përjashtim të situatave të tilla, si ato që janë krijuar në Lindjen e Mesme dhe në Nënkontinent, ku bashkohen njëri me tjetrin sipas vijës së shkëputjes qytetërimore. Së pari, prej shkallëzimit të konflikteve në vijën e shkëputjes ndërmjet grupeve lokale si grupe në farefisni, duke përfshirë edhe shtetet bërthamë, ato mund të krijojnë grupe për të mbështetur vendet ndërluftuese lokale. Megjithatë, kjo mundësi krijon një shtysë më të madhe për shtetet bërthamë të qytetërimeve në konflikt, që ta kufizojnë ose ta mbyllin konfliktin në vijën e shkëputjes.

Së dyti, lufta e shteteve bërthamë mund të shkaktohet prej ndryshimeve në peshoren globale të fuqisë ndërmjet qytetërimeve. Brenda qytetërimit grek, fuqia në rritje e Athinës, siç e ka treguar Tukididi, shkaktoi Luftën e Peloponezitet. Po ashtu, historia e qytetërimit Perëndimor është histori e 'luftërave për hegjemoni' ndërmjet fuqive në ngritje dhe atyre në rënie. Përmasat, në të cilat faktorë të tillë e nxisin konfliktin ndërmjet shteteve bërthamë në ngritje e në rënie prej qytetërimesh të ndryshme, varen pjesërisht nga fakti, nëse në këto qytetërime parapëlqehet për shtetet rruga e baraspeshimit ose e vajtjes pas qerres së më të fortit, që t'i përshtaten ngritjes së një fuqie të re. Ndërsa vajtja pas më të fortit mund të jetë më karakteristike për qytetërimet aziatike, ngritja e fuqisë kineze mund të ngjallte orvatje baraspeshimi nga shtetet në qytetërimet e tjera, si Shtetet e Bashkuara, India dhe Rusia. E vetmja luftë për hegjemoni, që nuk është bërë në historinë e Perëndimit, është ajo ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara, e ka të ngjarë që kalimi paqësor nga *Pax Britannica* te *Pax Americana* në pjesën më të madhe i detyrohet farefisnisë së afërt kulturore ndërmjet

këtyre dy shoqërive. Mungesa e një farefisnie të tillë në zhvendosjen e peshores së fuqisë ndërmjet Perëndimit dhe Kinës nuk e bën të sigurtë konfliktin e armatosur, por e bën shumë më të mundshëm. Dinamizmi i islamit është burimi veprues i shumë luftërave relativisht të vogla në vijën e shkëputjes; ngritja e Kinës është burimi i mundshëm i një lufte të madhe ndërqytetërimore ndërmjet shteteve bërthamë.

Islami dhe perëndimi

Disa Perëndimorë, ndër ta edhe presidenti Bill Klinton, kanë thënë se Perëndimi nuk ka probleme me islamin, por vetëm me ekstremistët e dhunshëm islamistë. Historia prej një mijë e katërqind vjetësh tregon ndryshe. Marrëdhëniet ndërmjet islamit e krishterimit, si ortodoks edhe Perëndimor, shpesh kanë qenë të trazuara. Secili ka qenë Tjetri për tjetrin. Konflikti i shekullit XX ndërmjet demokracisë liberale dhe marksizëm-leninizmit është vetëm një dukuri historike e përciptë dhe kalimtare, e krahasuar me marrëdhënien e vazhdueshme dhe thellësisht me konflikt ndërmjet islamit e krishterimit. Në disa periudha ka mbizotëruar bashkekzistenca paqësore; më shpesh marrëdhënia ka qenë me rivalitet të ashpër dhe me shkallë të ndryshueshme të luftës së nxehtë. Kjo ‘dinamikë’ historike, siç e ka komentuar Xhon Espozito, “... shpesh i ka futur të dy bashkësitë në garë dhe herë pas here i ka mbërthyer në luftime vdekjeprurëse për pushtet, toka e shpirtra.”² Përgjatë shekujve fatet e të dy feve herë kanë rënë e herë janë ngritur si pasojë e dallgëve, pushimeve dhe kundërdallgëve.

Vërshimi fillestar arab-islamik nga vitet e para të shekullit VII deri në mesin e shekullit VIII solli vendosjen e sundimit mysliman në Afrikën e Veriut, në Iberi, në Lindjen e Mesme, Persi e Indinë veriore. Për dy shekuj afërsisht vijat e ndarjes ndërmjet islamit e krishterimit zunë vend. Pastaj nga fundi i shekullit XI të krishterët e rimorën sundimin e Mesdheut Perëndimor, shtinë në dorë Sicilinë dhe kapën Toledon. Më 1095 krishterimi ndërmoi kryqëzatat dhe për një shekull e gjysmë të fuqishmit e krishterë u orvatën, duke pasur gjithnjë e më pak sukses, që të vendosnin sundimin e krishterë në Tokën e Shenjtë, si dhe në zonat fqinje në Lindjen e Afërt, por më 1291 humbën Akrën, mbështetjen e tyre të fundit atje. Ndërkaq në skenë ishin shfaqur turqit osmanë. Në fillim ata e dobësuan Bizantin dhe pastaj pushtuan pjesën më të madhe të Ballkanit, si edhe Afrikën e Veriut, shtinë në dorë Konstantinopolin më 1453 dhe rrethuan Vjenën më 1529. “Për pothuaj një mijë vjet,” vëren Bernard Ljuisi, “që nga zbarkimi i parë i maurëve në Spanjë e deri te rrethimi i dytë i Vjenës, Europa ka qenë nën kërcënimin e vazhdueshëm prej islamit.”³ Islami është i vetmi qytetërim, i cili e ka vënë në dyshim mbijetesën e Perëndimit dhe e ka bërë këtë të paktën dy herë.

Megjithatë, aty nga shekulli XV batica ktheu drejtim. Pak nga pak të krishterët e rifituan Iberinë dhe e përfunduan detyrën në Granadë më 1492. Ndërkohë, risitë europiane për lundrimin nëpër oqeanë u dhanë mundësinë portugezëve e më pas të tjerëve që t’u binin rrotull tokave në zemër të myslimanëve dhe të depërtonin në Oqeanin Indian e më përtej. Njëkohësisht rusët i dhanë fund sundimit prej dy shekujsh të tartarëve. Më pas osmanët bënë një mësymje të fundit përpara, duke e rrethuar përsëri Vjenën më 1683. Dështimi i tyre atje shënoi fillimin e një tërheqjeje të

gjatë, në të cilën u përfshi edhe lufta e popujve ortodoksë të Ballkanit për t'u çliruar nga sundimi osman, zgjerimi i Perandorisë së Habsburgëve dhe përparimi i shpejtë i rusëve drejt Detit të Zi e Kaukazit. Gjatë një shekulli afërsisht 'kamxhiku i krishterimit' u shndërrua në 'të sëmurin e Europës'.⁴ Me përfundimin e Luftës I Botërore, Britania, Franca dhe Italia i dhanë goditjen e fundit e pastaj vendosën sundimin e tyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mbarë tokat e mbetura osmane, me përjashtim të territorit të Republikës Turke. Aty nga viti 1920 katër vende myslimane: Turqia, Arabia Saudite, Irani dhe Afganistani, kishin mbetur të pavaruara nga ndonjë formë sundimi jomyslimane.

Nga ana e vet, tërheqja e kolonializmit Perëndimor nisi ngadalë në vitet 1920 e 1930, pastaj u përshpejtua befas menjëherë pas Luftës II Botërore. Shembja e Bashkimit Sovjetik u solli pavarësinë edhe një numri tjetër shoqëri myslimane. Sipas një përlogaritjeje, qeveritë jomyslimane kishin arritur të përfitonin rreth nëntëdhjetë e dy territore myslimane ndërmjet viteve 1757 e 1919. Aty nga viti 1995 gjashtëdhjetë e nëntë prej këtyre territoreve ishin përsëri nën sundimin mysliman dhe rreth dyzet e pesë shtete të reja kishin popullsi në shumicën dërrmuese myslimane. Natyra e dhunshme e këtyre marrëdhënieve që ndryshuan, pasqyrohet në faktin se 50 për qind e luftërave, në të cilat ndërmjet viteve 1820 e 1929 janë përfshirë çifte shtetesh të besimeve të ndryshme, kanë qenë luftëra ndërmjet myslimanëve e të krishterëve.⁵

Shkaqet e këtij modeli të vijueshëm konflikti nuk fshihen në dukuri të tilla kalimtare, si pasioni i krishterë i shekullit të dymbëdhjetë ose fundamentalizmi mysliman i shekullit të njëzetë. Ato rrjedhin nga natyra e dy besimeve dhe e qytetërimeve që bazohen në to. Nga njëra anë, konflikti ka qenë produkt i dallimit, në veçanti

i konceptit mysliman të islamit si një mënyrë jetese që i kapërcen dhe i bashkon fenë e politikën, përballë konceptit të krishterë Perëndimor të ndarjes ndërmjet mbretërisë së Zotit dhe mbretërisë së Cezarit. Megjithatë, konflikti e ka burimin edhe te ngjashmëritë e tyre. Që të dyja janë fe monoteiste, të cilat, ndryshe nga besimet politeiste, nuk mund të përthithin me lehtësi hyjni të tjera dhe e shohin botën nga pikëpamja dualiste: ata dhe ne. Që të dyja janë universaliste, mëtojnë se janë i vetmi besim, që duhet të përqafojnë gjithë njerëzit. Që të dyja janë fe misionare, të cilat besojnë se pasuesit e tyre kanë për detyrë t'i kthejnë mosbesimtarët në të vetmen besë të vërtetë. Që në zanafillën e tij islami u zgjerua duke bërë pushtime dhe, kur kishte mundësi, edhe të krishterët po ashtu kanë bërë. Konceptet paralele të 'xhihadit' dhe të 'kryqëzatës' jo vetëm i ngjajnë njëri-tjetrit, por edhe i shquajnë këto dy besime prej feve të tjera të mëdha botërore. Islami e krishterimi, krahas judaizmit, kanë edhe pikëpamje teleologjike për historinë, në kontrast me pikëpamjet ciklike ose statike, që mbizotërojnë në qytetërimet e tjera.

Me kalimin e kohës niveli i konfliktit të dhunshëm ndërmjet islamit e krishterimit ka pësuar edhe ndikimin e rritjes e të rënies demografike, të zhvillimeve ekonomike, të ndryshimeve teknologjike dhe të intensitetit të përkushtimit fetar. Përhapja e islamit në shekullin e shtatë u shoqërua me dyndjet masive të popujve arabë, 'shkalla dhe shpejtësia' e të cilave kanë qenë të papara, në tokat e perandorive Bizantine e Sasanide. Pak shekuj më pas, kryqëzatat në pjesën më të madhe u bënë si produkt i rritjes ekonomike, i zgjerimit të popullsisë dhe i 'ringjalljes Klunaike' në Europën e shekullit të njëmbëdhjetë, që bëri të mundur të mobilizoheshin masa të mëdha kalorësish e fshatarësh për të marshuar në Tokën e Shenjtë. Kur Kryqëzata e

Parë arriti në Konstantinopol, një vëzhgues bizantin ka shkruar se ajo ngjante sikur “gjithë Perëndimi, duke përfshirë gjithë fiset e barabarëve që jetonin përtej Detit Adriatik deri te Shtyllat e Herkulit, kishte nisur një shpërngulje masive dhe ishte vënë në rrugë, duke vërshuar në Azi si një masë solide, me të gjitha rraqet e veta.”⁶ Në shekullin e nëntëmbëdhjetë përsëri shtimi i habitshëm i popullsisë shkaktoi një shpërthim europian, duke përfutur migrimin më të madh në histori, i cili vërshoi si në tokat myslimane, edhe gjetkë.

Një përzierje e krahasueshme faktorësh nga fundi i shekullit të njëzetë e shtoi konfliktin ndërmjet islamit e Perëndimit. Së pari, shtimi i popullsisë myslimane ka përfutur shifra të larta të rinjsh të papunë e të pakënaqur, të cilët rekrutohen për çështjen islamike, ushtrojnë trysni mbi shoqëritë fqinje dhe emigrojnë drejt Perëndimit. Së dyti, Ringjallja islamike u ka dhënë sërish myslimanëve besim të karakteri i dalluar e i çmueshëm i qytetërimit dhe i vlerave të tyre, në krahasim me ato të Perëndimit. Së treti, orvatjet e njëkohshme të Perëndimit për të universalizuar vlerat e institucionet e tij, për të ruajtur epërsinë e vet ushtarake dhe ekonomike, si dhe për të ndërhyrë në konfliktet e botës myslimane, ngjallin pakënaqësi të fortë mes myslimanëve. Së katërti, shembja e komunizmit e hoqi qafe një armik të përbashkët të Perëndimit e të islamit dhe bëri që secili ta perceptonte tjetrin si kërcënimin kryesor. Së pesti, shtimi i kontakteve ndërmjet myslimanëve e të krishterëve dhe përzierja e tyre të secili nxiti një ndjenjë të re të identitetit të vet dhe për ta parë sesa shumë ndryshon prej atij të tjetrit. Ndërveprimi dhe ndërperzierja gjithashtu i acarojnë dallimet lidhur me të drejtat e anëtarëve të njërit qytetërim brenda një vendi, ku mbisundojnë anëtarët e qytetërimit tjetër. Brenda të dy shoqërive,

muslimane e të krishtere, në vitet 1980 e 1990 toleranca për tjetrin ka rënë në mënyrë të mprehtë.

Kështu, shkaqet e konfliktit të përtëritur midis islamit e Perëndimit i kanë rrënjët te çështjet themelore të fuqisë e të kulturës. *Kto? Kovo?* Kush do të sundojë? Kush do të jetë i sunduari? Kjo çështje qendrore e politikës, e përcaktuar prej Leninit, është rrënja e kundërshtimit ndërmjet islamit e Perëndimit. Megjithatë, ka edhe një konflikt shtojcë, të cilin Lenini do ta kishte quajtur të pakuptimtë, ndërmjet dy varianteve se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, si rrjedhim, kush ka të drejtë dhe kush është i gabuar. Për sa kohë islami mbetet Islam (e kështu do të jetë) dhe Perëndimi mbetet Perëndim (por kjo është më e dyshimtë), ky konflikt themelor ndërmjet dy qytetërimeve të mëdha dhe dy mënyrave të jetesës do të vazhdojë të përcaktojë marrëdhëniet e tyre në të ardhmen, madje ashtu siç i ka përcaktuar për katërbëdhjetë shekujt e kaluar.

Këto marrëdhënie i turbullon më tej edhe një numër çështjesh të qenësishme, për të cilat pozitat e tyre dallohen ose janë në konflikt. Historikisht një ndër çështjet kryesore ka qenë sundimi territorial, por sot ky nuk është më me aq peshë. Në mesin e viteve 1990 nëntëmbëdhjetë nga njëzet e tetë konfliktet në vijën e shkëputjes ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve kanë ndodhur mes muslimanëve dhe të krishterëve. Njëmbëdhjetë kanë qenë me të krishterët ortodoksë dhe shtatë me besimtarët e krishterimit Perëndimor në Afrikë e në Azinë juglindore. Vetëm njëri prej këtyre konflikteve të dhunshme ose me potencial të dhunshëm ka ndodhur ndërmjet kroatëve e bosnjakëve drejtpërdrejt në vijën e shkëputjes ndërmjet Perëndimit e islamit. Përfundimi i vërtetë i imperializmit territorial Perëndimor dhe deri më tani fakti, që nuk ka pasur rifillim të zgjerimit territorial nga muslimanët, kanë sjellë

një ndarje gjeografike, kështu që vetëm në pak vende të Ballkanit bashkësitë Perëndimore dhe myslimane janë në kufi të drejtpërdrejtë njëra me tjetrën. Rrjedhimisht, konfliktet ndërmjet Perëndimit dhe islamit përqendrohen më pak te territori, sesa te çështjet e gjera ndërqytetërimore, si: përhapja e armëve, të drejtat e njeriut e demokracia, zotërimi i naftës, migrimi, terrorizmi islamist dhe ndërhyrja e Perëndimit.

Pas mbarimit të Luftës së ftohtë nga pjesëtarët e të dyja bashkësive është pranuar gjerësisht, se intensiteti i këtij antagonizmi historik ka shkuar duke u rritur. Për shembull, më 1991 Barry Buzan gjente shumë arsye, përse një luftë e ftohtë societale po lindte “ndërmjet Perëndimit dhe islamit, në të cilën Europa do të dilte në vijën e frontit.”

Ky zhvillim pjesërisht ka të bëjë me vlerat shekulare përkundrejt vlerave fetare, pjesërisht me xhelozinë për fuqinë e Perëndimit, pjesërisht me pakënaqësitë ndaj sundimit të Perëndimit gjatë strukturimit politik pas periudhës koloniale në Lindjen e Mesme, dhe pjesërisht ka të bëjë me hidhërimin e poshtërimin prej krahasimit ziliqar ndërmjet arritjeve të qytetërimit islamik dhe qytetërimit Perëndimor në dy shekujt e fundit.

Veç kësaj, ai ka vënë re se “një Luftë e ftohtë societale do të shërbente për forcimin e identitetit evropian në tërësi, në një kohë të qenësishme për procesin e bashkimit evropian.” Si rrjedhim, “fare mirë në Perëndim mund të ketë një bashkësi jo të vogël, që është e gatshme jo vetëm ta mbështesë një Luftë të ftohtë societale me islamin, por edhe të ndjekë politika që e nxisin atë.” Më 1990 Bernard Ljuisi, një studies i shquar Perëndimor i islamit, ka shqyrtuar “Rrënjët e zemërimit mysliman” dhe ka ardhur në përfundimin:

Tashmë duhet të jetë bërë e qartë se po përballemi me një qëndrim dhe me një lëvizje që e kapërcen mjaft nivelin e çështjeve e të politikave, si dhe të qeverive që i ndjekin. Kemi të bëjmë jo me gjë tjetër, por me përplasjen e qytetërimeve, me atë reagim ndoshta irracionale por me siguri historik, të një rivali të lashtë kundër trashëgimisë sonë judeo-kristiane, së tashmes sonë shekulare dhe zgjerimit të të dyjave në mbarë botën. Ka rëndësi qenësore që ne, nga ana jonë, të mos biem pre e provokimit të një reagimi po aq historik, por edhe po aq irracionale kundër atij rivali.⁷

Vërejtje të ngjashme janë bërë edhe nga bashkësia islamike. Një gazetar kryesor i Egjiptit, Muhamed Sid-Ahmed, ka thënë më 1994: “Ka shenja të qarta se po zgjerohet përplasia ndërmjet etikës judeo-kristiane të Perëndimit dhe lëvizjes së Ringjalljes islamike, që sot shtrihet nga Atlantiku në perëndim deri te Kina në lindje.” Një mysliman indian i shquar më 1992 ka parashikuar se “ballafaqimi i radhës i Perëndimit me siguri do të jetë me botën myslimane. Lufta për një rend të ri botëror do të nisë në shtrirjen e kombeve islamike nga Magrebi e deri në Pakistan.” Sipas një avokati të rëndësishëm tunizian, tashmë lufta e ka nisur rrugën: “Kolonializmi u orvat t’i deformonte të gjitha traditat kulturore të islamit. Unë nuk jam islamist. Nuk mendoj se ka ndonjë konflikt ndërmjet feve. Këtu kemi një konflikt ndërmjet qytetërimeve.”⁸

Në vitet 1980 e 1990 prirja mbizotëruese në islam ka qenë në drejtimin antiperëndimor. Pjesërisht kjo ka ardhur si pasojë e natyrshme e Ringjalljes Islamike dhe si reagim kundër “*gharbzadegi*” ose helmimit Perëndimor të shoqërive myslimane. “Riafirmimi i islamit, pavarësisht nga forma e posaçme sektare, do të thotë të hidhet poshtë ndikimi evropian dhe amerikan mbi shoqërinë, politikën dhe moralin vendës.”⁹ Me ndonjë rast në të

kaluarën, udhëheqësit myslimanë i kanë thënë popullit të tyre: “Ne duhet të perëndimorizohemi.” Mirëpo nëse ndonjë udhëheqës mysliman e ka thënë këtë gjë në çerekun e fundit të shekullit të njëzetë, ai ka mbetur një figurë e vetmuar. Në të vërtetë, është e vështirë të gjesh çfarëdo pohimesh nga cilido mysliman, qoftë politikan, zyrtar, akademik, biznesmen ose gazetar, që të ketë lëvduar vlerat dhe institucionet Perëndimore. Në vend të kësaj ata theksojnë dallimet ndërmjet qytetërimit të tyre dhe qytetërimit të Perëndimit, epërsinë e kulturës së tyre dhe domosdoshmërinë që ta ruajnë integritetin e kësaj kulture kundër mësymjes Perëndimore. Myslimanët e kanë frikë dhe janë të pakënaqur nga fuqia Perëndimore e nga kërcënimi që ajo paraqet për shoqërinë e besimet e tyre. Kulturën e Perëndimit ata e shohin si materialiste, të korruptuar, dekadente dhe imorale. Gjithashtu e vështrojnë si tunduese, për pasojë, gjithnjë e më shumë theksojnë domosdoshmërinë që t’i bëhet qëndresë ndikimit të saj mbi mënyrën e tyre të jetesës. Përherë e më shumë myslimanët po e sulmojnë Perëndimin jo sepse i përmbahet një feje të papërsosur, të gabuar, e cila megjithatë është një “fe e librit”, por sepse nuk i përmbahet asnjë feje përgjithësisht. Në sytë e myslimanëve shekullarizmi i Perëndimit, pafetaria dhe, rrjedhimisht, pamoralshmëria janë të këqija edhe më të mëdha sesa krishterimi Perëndimor, që i ka pjellë ato. Gjatë Luftës së ftohte Perëndimi e etiketonte kundërshtarin e vet si “komunizmi i paperëndi”; në konfliktin pas Luftës së ftohtë myslimanët e vështrojnë kundërshtarin e tyre si “Perëndimi i paperëndi”.

Këto imazhe për Perëndimin si arrogant, materialist, shtypës, të vrazhdë e dekadent i paraqesin jo vetëm imamët fundamentalistë, por edhe ata, të cilët shumë njerëz në Perëndim do t’i quanin mbështetës e aleatë të tyre të natyrshëm. Fare pak libra të autorëve myslimanë,

të botuar në vitet 1990 në Perëndim, kanë gjetur atë pritje miratuese, që i është bërë librit *Islami dhe demokracia* të autores Fatima Mernissi, i cili përgjithësisht nga Perëndimorët është përshëndetur si pohim i guximshëm nga një grua myslimane moderne, liberale.¹⁰ Mirëpo paraqitja e Perëndimit në atë vëllim vështirë se mund të ishte më sharëse se aq. Perëndimi del ‘militarist’ dhe ‘imperialist’, i ka ‘traumatizuar’ kombet e tjera nëpërmjet ‘terrorit kolonialist’ (f. 3, 9). Tipari shques i kulturës Perëndimore, individualizmi, quhet ‘burimi i gjithë trazirave’ (f. 8). Fuqia e Perëndimit është e frikshme. Vetëm Perëndimi “vendos nëse satelitët do të përdoren për të edukuar arabët, apo për të hedhur bomba mbi ta. ... Ai i shkatërron mundësitë tona dhe na e përmbyt jetën me produktet e importuara prej tij, me filmat televizivë që i kanë pushtuar gjithë valët ajrore... [Ai] është fuqia që na shkatërron, na ka rrethuar tregjet tona dhe sundon mbi burimet, mbi nismat dhe mbi mundësitë tona më të para. Kështu e ndienim se ishte gjendja jonë, kurse perceptimin tonë Lufta e Gjirit e shndërroi në siguri të plotë” (f. 146-147). Perëndimi “e krijon fuqinë e vet nëpërmjet kërkimeve ushtarake” dhe pastaj produktet e këtyre kërkimeve shkencore ua shet vendeve të pazhvilluara, të cilat janë “konsumatore pasive të tyre”. Për t’u çliruar prej këtij nënshtrimi, islami duhet të krijojë inxhinierët dhe shkencëtarët e vet, të ndërtojë armët e veta (qofshin bërthamore ose konvencionale, ajo nuk e përcakton), dhe “ta çlirojë veten nga varësia ushtarake prej Perëndimit” (f. 43-44). Po e përsërisim, këto nuk janë pikëpamjet e një ajatollahu me mjekër e me çallmë.

Pavarësisht nga pikëpamjet politike ose fetare që kanë, myslimanët janë të një mendjeje se ka dallime bazë ndërmjet kulturës së tyre dhe kulturës Perëndimore. Siç e ka shprehur sheiku Ganushi, “Vija fundore është se

shoqëritë tona mbështeten në vlera të ndryshme prej atyre të Perëndimit.” Amerikanët “vijne këtu”, siç ka thënë një zyrtar i qeverisë egjiptiane, “dhe duan që ne të bëhemi si ata. Ata nuk kuptojnë asgjë prej vlerave ose kulturës sonë.” “[Ne] jemi të ndryshëm,” ka pranuar një gazetar egjiptian. “Ne kemi një të kaluar të ndryshme, kemi një histori të ndryshme. Në përputhje me këtë, kemi të drejtën për të ardhme të ndryshme.” Botimet myslimane si popullore, ashtu edhe serioze intelektuale, paraqesin në mënyrë të përsëritur ato që mëtohet se janë plane e komplete të Perëndimit për të nënshtruar, poshtëruar dhe minuar institucionet e kulturën islamike.¹¹

Reagimi kundrejt Perëndimit mund të shihet jo vetëm në vrullin qendror intelektual të Ringjalljes Islamike, por edhe në zhvendosjen që ka ndodhur te qëndrimet e qeverive të vendeve myslimane kundrejt Perëndimit. Qeveritë që u ngritën menjëherë pas shkolonizimit ishin përgjithësisht me orientim Perëndimor në ideologjitë e tyre politike dhe ekonomike, ndërsa në politikën e jashtme ishin properëndimore, me ndonjë përjashtim të pjesshëm, si Algjeria e Indonezia, ku pavarësia u fitua me anë të revolucionit kombëtar. Mirëpo një nga një qeveritë properëndimore ua lanë vendin qeverive që e lidhin më pak veten me Perëndimin, ose që janë haptas antiperëndimore në Irak, Libi, Jemen, Siri, Iran, Liban dhe Afganistan. Ndryshime më pak të thella kanë ndodhur në të njëjtin drejtim te orientimet dhe rreshtimet e shteteve të tjera, si Tunizia, Indonezia dhe Malajzia. Dy aleatët më të patundur ushtarakë myslimanë të kohës së Luftës së ftohtë me Shtetet e Bashkuara, domethënë Turqia dhe Pakistani, kanë trysni të brendshme politike islamiste dhe lidhjet e tyre me Perëndimin kanë pësuar një acarim në rritje.

Më 1995 i vetmi shtet mysliman, i cili ishte qartas më properëndimor, sesa kishte qenë dhjetë vjet më parë, qe Kuvajti. Miqtë më të ngushtë të Perëndimit në botën arabe sot janë ose të tillë si Kuvajti, Arabia Saudite dhe sheikatet e Gjirit, që varen ushtarakisht prej Perëndimit, ose si Egjipti e Algjeria, që varen prej tij ekonomikisht. Në vitet e fundit 1980 regjimet komuniste të Europës Lindore u shembën, kur u bë e qartë se Bashkimi Sovjetik nuk ishte më në gjendje ose nuk do t'u jepte më mbështetje ekonomike e ushtarake. Nëse do të bëhej e qartë se Perëndimi nuk do t'i mbështeste më tutje regjimet satelite të tij, ka të ngjarë që ato të pësonin të njëjtin fat.

Rritja e antiperëndimorizmit mysliman ka ecur paralel me zgjerimin e shqetësimit të Perëndimit për "kërcënimin islamik", të cilin e përbën sidomos ekstremizmi islamist. Islami vështrohet si burim i përhapjes së armëve bërthamore, i terrorizmit dhe, në Europë, i emigrantëve të padëshiruar. Këto shqetësime i kanë të përbashkëta si publiku, edhe udhëheqësit. Kur u pyetën, për shembull, në nëntor 1994, nëse 'ringjallja islamike' përbënte një kërcënim për interesat e SHBA në Lindjen e Mesme, 61 për qind e një mostre prej 35.000 amerikanësh të interesuar për politikën e jashtme, thanë se po, kurse vetëm 28 për qind thanë jo. Një vit më parë, kur u ishte bërë pyetja se cili vend përbënte rrezikun më të madh për Shtetet e Bashkuara, një mostër e zgjedhur rastësisht e publikut nxori në dukje si tre kryesorët Iranin, Kinën dhe Irakun. Po njësoj, kur u pyetën më 1994 që të përcaktonin "kërcënimet kritike" për Shtetet e Bashkuara, 72 për qind të publikut dhe 61 për qind të udhëheqësve politikë thanë se ishte përhapja e armëve bërthamore, kurse 69 për qind të publikut dhe 33 për qind të udhëheqësve thanë se ishte terrorizmi ndërkombëtar, pra, që të dyja çështje të lidhura

gjerësisht me islamin. Për më tepër, 33 për qind e publikut dhe 39 për qind e udhëheqësve e shihnin se përbënte rrezik zgjerimi i mundshëm i fundamentalizmit islamik. Edhe europianët shfaqin qëndrime të ngjashme. Për shembull, në pranverën e vitit 1991 mes publikut francez 51 për qind u shprehën se kërcënimi kryesor për Francën vinte nga Jugu, kurse vetëm 8 për qind thanë se do të vinte nga Lindja. Katër vendet, prej të cilave kishte më shumë frikë publiku francez ishin të gjitha myslimane: Iraku 52 për qind; Irani 35 për qind; Libia 26 për qind dhe Algjeria 22 për qind.¹² Udhëheqësit politikë Perëndimorë, duke përfshirë kancelarin e Gjermanisë dhe kryeministrin francez, kanë shprehur shqetësime të ngjashme, ndërsa sekretari i përgjithshëm i NATO-s ka deklaruar më 1995, se fundamentalizmi islamik ishte “të paktën po aq i rrezikshëm, sa ka qenë komunizmi” për Perëndimin, ndërsa një “anëtar shumë i lartë” i administratës së Klintonit ia ka vënë gishtin islamit si rivali global i Perëndimit.¹³

Me zhdukjen në dukje të kërcënimit ushtarak nga lindja, planifikimi i NATO-s gjithnjë e më tepër po drejtohet kundrejt kërcënimeve të mundshme prej jugut. “Nyja Jugore,” ka vënë në dukje një analist i Ushtrisë së SHBA më 1992, po zëvendëson Frontin Qendror dhe “po bëhet me shpejtësi vija e re e frontit e NATO-s.” Për të përballuar këto kërcënime jugore, anëtarët jugorë të NATO-s: Italia, Franca, Spanja dhe Portugalia, kanë nisur planifikimin dhe operacionet e përbashkëta ushtarake, ndërsa njëkohësisht i kanë përfshirë qeveritë e Magrebit në këshillimet për rrugët me të cilat t’u bëhet ballë ekstremistëve islamistë. Këto kërcënime të perceptuara kanë dhënë po ashtu një arsye të vazhdimit të pranisë së ndjeshme ushtarake të SHBA në Europë. “Ndërkohë që forcat e SHBA në Europë nuk janë ndonjë bar çudibërës për problemet e krijuara prej

islamit fundamentalist,” ka vënë në dukje një zyrtar i mëparshëm i lartë i SHBA, “ato forca hedhin një hije të fuqishme mbi planifikimin ushtarak në mbarë atë zonë. A ju kujtohet zhvendosja me sukses e forcave britanike, franceze dhe të SHBA nga Europa në Luftën e Gjirit më 1990-91? Ato në rajon këtë bëjnë.”¹⁴ Dhe ai mund të kishte shtuar, se e kujtojnë me frikë, me pakënaqësi e urrejtje.

Duke qenë të pranishme këto perceptime të myslimanëve dhe të Perëndimorëve për njëri-tjetrin, plus ngritjen e ekstremizmit islamist, vështirë të çuditemi përse pas Revolucionit të Iranit më 1979 u bë një pothuaj luftë ndërqytetërimore ndërmjet islamit e Perëndimit. Ishte një pothuaj luftë për tri arsye. E para, nuk qe i gjithë islami që po luftonte kundër gjithë Perëndimit. Dy shtete fundamentaliste (Irani, Sudani), tre shtete jofundamentaliste (Iraku, Libia, Siria), plus një gamë e gjerë organizatash islamiste, me mbështetjen financiare prej vendeve të tjera myslimane, si Arabia Saudite, kanë luftuar kundër Sheteteve të Bashkuara dhe, nganjëherë, Britanisë, Francës e shteteve dhe grupeve të tjera Perëndimore, si dhe kundër Izraelit e çifutëve përgjithësisht. E dyta, ishte pothuaj luftë sepse, përveç Luftës së Gjirit të vitit 1990-91, është bërë me mjete të kufizuara: terrorizmi, nga njëra anë, dhe fuqia ajrore, veprimet e fshehta dhe sanksionet, nga ana tjetër. E treta, ishte pothuaj luftë sepse, ndërkohë që dhuna ka vazhduar, edhe nuk ka qenë e vazhdueshme. Ka pasur veprime të herëpashershme nga njëra palë, që shkaktonin përgjigje nga pala tjetër. Megjithatë, një pothuaj luftë përsëri luftë është. Edhe duke i përjashtuar dhjetëra mijëra ushtarët e civilët irakenë, që u vranë nga bombardimet e Perëndimit në janar-shkurt 1991, vdekjet dhe humbjet e tjera arrijnë në mijëra, madje kanë ndodhur në të vërtetë çdo vit pas vitit 1979. Në këtë

pothuaj luftë janë vrarë shumë më tepër Perëndimorë të tjerë, sesa në luftën 'e vërtetë' të Gjirit.

Për më tepër, të dyja palët e kanë pranuar që ky konflikt ka qenë luftë. Në fillim, me të drejtë Khomeini deklaroi se "Irani në fakt është në luftë me Amerikën,"¹⁵ kurse Gedafi herë pas here shpall ndonjë luftë të shenjtë kundër Perëndimit. Me shprehje të ngjashme kanë folur udhëheqësit myslimanë të grupeve të tjera ekstremiste dhe të shteteve të tjera. Nga pala Perëndimore, Shtetet e Bashkuara kanë klasifikuar shtatë vende si "shtete terroriste", pesë prej të cilave janë myslimane (Irani, Iraku, Siria, Libia, Sudani); të tjerat janë Koreja e Veriut dhe Kuba. Në të vërtetë, kjo i përcakton ato si armiq, sepse sulmojnë Shtetet e Bashkuara dhe miqtë e tyre me armët më të fuqishme në duart e tyre, duke e pranuar kështu se ka një gjendje lufte me ta. Zyrtarët e SHBA përherë u referohen këtyre shteteve si "të jashtëligjshme", "të papërgjegjshme" dhe "të shfrenuara", domethënë i vendosin jashtë rendit ndërkombëtar të qytetëruar, prandaj i quajnë si objektiva të ligjshëm për kundërmasat e njëanshme ose të shumanshme. Qeveria e Shteteve të Bashkuara i akuzoi atentatorët kundër Qendrës së Tregtisë Botërore se kishin për qëllim "të shpërthenin një luftë të terrorizmit urban kundër Shteteve të Bashkuara" dhe argumentuan, se komplotistët e ngarkuar me planifikimin e atentateve të tjera në Manhattan ishin "ushtarë" në një përleshje "që sillte luftë" kundër Shteteve të Bashkuara. Nëse myslimanët e akuzojnë Perëndimin se lufton islamin dhe nëse Perëndimorët i akuzojnë grupet islamike se bëjnë luftë kundër Perëndimit, na del e arsyeshme që të arrijmë në përfundimin se po ndodh diçka që i ngjan mjaft luftës.

Në këtë pothuaj luftë, secila palë nxjerr përfitime nga fuqia e vet dhe nga dobësia e palës tjetër. Nga

pikëpamja ushtarake ajo ka qenë kryesisht një luftë e terrorizmit përballë fuqisë ajrore. Militantët e përkushtuar islamikë shfrytëzojnë shoqëritë e hapura të Perëndimit dhe vënë makina-bomba në objektiva të përzgjedhur. Profesionistët ushtarakë Perëndimorë shfrytëzojnë qiejt e hapur të islamit dhe hedhin bomba të mençura mbi objektiva të zgjedhur. Pjesëmarrësit islamikë bëjnë komplete për vrasjen e Perëndimorëve të shquar; Shtetet e Bashkuara bëjnë komplete për të përmbysur regjimet islamike ekstremiste. Gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve ndërmjet vitit 1980 e 1995, sipas Departamentit të mbrojtjes të SHBA, Shtetet e Bashkuara janë përfshirë në shtatëmbëdhjetë operacione ushtarake në Lindjen e Mesme, që të gjitha të drejtuara kundër myslimanëve. Nuk ka ndodhur ndonjë lloj i tillë i ngjashëm operacionesh ushtarake të SHBA kundër popujve të çfarëdo qytetërimi tjetër.

Deri më sot secila palë, me përjashtim të Luftës së Gjirit, ka ruajtur një shkallë dhune në nivele të ulëta të arsyeshme dhe është përmbajtur, që të mos i quajë aktet e dhunshme si akte lufte, të cilat kërkojnë përgjigje të gjithanshme. “Nëse Libia do të urdhëronte njëren nga nëndetëset e veta që të mbyste një anije linje amerikane,” ka vënë në dukje revista *The Economist*, “Shtetet e Bashkuara do ta trajtonin këtë si akt lufte nga ana e një qeverie dhe nuk do të kërkonin ekstradimin e komandantit të nëndetëses. Në parim, atentati me bombë në një aeroplan linje nga ana e shërbimeve sekrete të Libisë nuk ka ndonjë dallim.”¹⁶ Megjithatë, pjesëmarrësit në këtë luftë përdorin taktika shumë më të dhunshme kundër njëri-tjetrit, sesa kanë përdorur Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik drejtpërdrejt kundër njëri-tjetrit gjatë Luftës së ftohtë. Me përjashtime të rralla, asnjëra nga superfuqitë nuk ka vrarë qëllimisht civilë e madje as njerëz të përkatësisë ushtarake të palës

tjetër. Mirëpo kjo po ndodh në mënyrë të përsëritur në pothuaj luftën.

Udhëheqësit amerikanë mëtojnë se myslimanët e përfshirë në pothuaj luftën janë një pakicë e vogël, ndërsa përdorimi i dhunës prej tyre hidhet poshtë nga shumica dërrmuese e myslimanëve të moderuar. Kjo mund të jetë e vërtetë, por mungojnë dëshmitë për ta provuar. Në vendet myslimane nuk ka pasur absolutisht asnjë protestë kundër dhunës antiperëndimore. Qeveritë myslimane, madje edhe qeveritë e bunkerizuara si miq të Perëndimit dhe që varen prej tij, qartas fare nuk e hapin gojën kur vjen puna për të dënuar aktet terroriste kundër Perëndimit. Nga ana tjetër, qeveritë europiane dhe publiku i kanë mbështetur gjerësisht dhe rrallë i kanë kritikuar veprimet e Shteteve të Bashkuara ndaj kundërshtarëve të tyre myslimanë, në kontrast të hapur me kundërshtimin energjik që kishin shprehur shpesh ndaj veprimeve amerikane kundër Bashkimit Sovjetik dhe komunizmit gjatë Luftës së ftohtë. Në konfliktet qytetërimore, ndryshe prej atyre ideologjike, fisi i rri në krah fisit.

Problemi që i del Perëndimit nuk është fundamentalizmi islamik. Është islami, një qytetërim i ndryshëm, popujt e të cilit janë të bindur për epërsinë e kulturës së tyre dhe u ka rënë në kokë puna e inferioritetit për fuqinë e vet. Për islamin problemi nuk janë CIA ose Departamenti i mbrojtjes i SHBA. Është Perëndimi, një qytetërim i ndryshëm, popujt e të cilit janë të bindur për universalizmin e kulturës së tyre dhe besojnë se fuqia e tyre superiore, nëse do të pësojë rënie, u shtron me forcë detyrën për ta shtrirë këtë kulturë në mbarë botën. Këta janë përbërësit themelorë, që e ushqejnë konfliktin ndërmjet islamit dhe Perëndimit.

Azia, Kina dhe Amerika

Kazani i qytetërimeve. Ndryshimet ekonomike në Azi, në veçanti në Azinë Lindore, përbëjnë një ndër zhvillimet më të rëndësishme në botën e gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Aty nga vitet 1990 ky zhvillim ekonomik kishte ngjallur eufori ekonomike mes shumë vëzhguesve, të cilët Azinë Lindore dhe gjithë Buzën e Paqësorit i shihnin të lidhura në rrjete tregtare në zgjerim e sipër, të cilat do të siguronin paqen e harmoninë mes vendeve. Ky optimizëm mbështetej në hamendjen fare të dyshimtë, se ndërshkëmbimet tregtare janë një forcë e pandryshueshme e paqes. Mirëpo puna nuk është kështu. Rritja ekonomike krijon paqëndrueshmëri politike brenda vendeve dhe ndërmjet vendeve, duke e ndryshuar peshoren e fuqisë midis vendeve dhe rajoneve. Këmbimet ekonomike i vënë në lidhje njerëzit, por nuk bëjnë që ata të merren vesh. Historikisht shpesh kanë përftuar një ndërgjegjësim më të thellë lidhur me dallimet ndërmjet popujve dhe kanë ngjallur dyshime të dyanshme. Tregtia ndërmjet vendeve sjell si përfitime, edhe konflikte. Nëse qëndron përvoja e së kaluarës, shkëlqimi ekonomik i Azisë do të përftojë një Azi me hije politike, një Azi me paqëndrueshmëri dhe konflikte.

Zhvillimi ekonomik i Azisë dhe vetëbesimi në rritje i shoqërive aziatike po e prishin politikën ndërkombëtare të paktën në tri mënyra. E para, zhvillimi ekonomik u bën të mundur shteteve aziatike që t'i zgjerojnë aftësitë e tyre ushtarake, nxit pasigurinë lidhur me marrëdhëniet e ardhshme mes këtyre vendeve dhe nxjerr në ballë çështjet e rivalitetet, që ishin ndrydhur gjatë Luftës së ftohtë, duke e shtuar kështu gjasën e konfliktit e të

paqëndrueshmërisë në rajon. E dyta, zhvillimi ekonomik e fuqizon intensitetin e konflikteve ndërmjet shoqërive aziatike dhe Perëndimit, para së gjithash Shteteve të Bashkuara, si dhe e forcon aftësinë e shoqërive aziatike për të arritur epërsi në këto ndeshje. E treta, rritja ekonomike e fuqisë më të madhe të Azisë i shton ndikimin e Kinës në rajon dhe gjasat që Kina të riafirmojë hegjemoninë e vet tradicionale në Azinë Lindore, rrjedhimisht, do t'i detyrojë vendet e tjera ose "të shkojnë pas më të fortit" e t'i përshtaten këtij zhvillimi, ose "ta baraspeshojnë" dhe të orvaten ta frenojnë ndikimin kinez.

Gjatë disa shekujsh të ngritjes së Perëndimit, marrëdhëniet me peshë kanë qenë një lojë e Perëndimit, që e luanin mes tyre fuqitë kryesore të Perëndimit, duke u plotësuar në një farë mase së pari nga Rusia në shekullin e tetëmbëdhjetë, dhe pastaj nga Japonia në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Europa ka qenë arena kryesore e konfliktit dhe e bashkëpunimit të fuqive të mëdha, madje edhe gjatë Luftës së ftohtë vija kryesore e ballafaqimit midis superfuqive ka qenë në zemër të Europës. Për aq sa marrëdhëniet ndërkombëtare me peshë në botën pas Luftës së ftohtë kanë një lëmë parësor, ky lëmë është Azia e në veçanti Azia Lindore. Azia është kazani i qytetërimeve. Azia Lindore e marrë më vete përmban shoqëri që u përkasin gjashtë qytetërimeve: japonez, sinik, ortodoks, budist, mysliman dhe Perëndimor, kurse Azia e Jugut këtyre u shton hinduizmin. Shtetet bërthamë të katër qytetërimeve: Japonia, Kina, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara, janë aktorët më të mëdhenj në Azinë Lindore; Azia e Jugut u shton Indinë, kurse Indonezia është një fuqi myslimane në ngritje e sipër. Veç këtyre, Azia Lindore përmban disa fuqi të nivelit të mesëm, me hov ekonomik në rritje, si Koreja e Jugut, Tajvani dhe Malajzia, plus një Vietnam

në mundësi të fortë. Si rrjedhim, kemi një model mjaft të ndërlikuar të marrëdhënieve ndërkombëtare, nga shumë anë të krahasueshëm me ato që kanë qenë gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë e të nëntëmbëdhjetë në Europë, si dhe të mbarsur me gjithë pasigurinë dhe luhatjet, që i karakterizojnë situatat shumëpolëshe.

Natyra shumëqytetërimore dhe me shumë fuqi e Azisë Lindore e shquan atë prej Europës Perëndimore, ndërsa dallimet ekonomike e politike e përforcojnë këtë kontrast. Të gjitha vendet e Europës Perëndimore janë demokraci të qëndrueshme, kanë ekonomi tregu dhe nivele të larta zhvillimi ekonomik. Në mes të viteve 1990 Azia Lindore përfshinte një demokraci të qëndrueshme, disa demokraci të reja e të paqëndrueshme, katër ose pesë diktatura komuniste të mbetura në botë, plus qeveri ushtarake, diktatura personale dhe sisteme autoritare njëpartiake. Nivelet e zhvillimit ekonomik kishin ndryshime që nga Japonia e Singapori dhe deri te Vietnami e Koreja e Veriut. Ka një prirje të përgjithshme drejt marketizimit dhe hapjes ekonomike, por sistemet ekonomike përshkojnë një hark nga ekonomia e planifikuar e Koresë së Veriut nëpër përzierje të ndryshme të kontrollit nga shteti e sipërmarrjesh private dhe deri te ekonomia liberale e Hong-Kongut.

Një shoqëri ndërkombëtare (në kuptimin britanik të kësaj fjale) nuk ka ekzistuar në Azinë Lindore, ashtu siç ka qenë në Europën Perëndimore.¹⁷ Përyjashtim bën masa në të cilën herë pas here hegjemonia kineze ka sjellë rend të rastit në këtë rajon. Nga fundi i shekullit të njëzetë Europa ishte e lidhur bashkë nga një kompleks jashtëzakonisht i dendur institucionesh ndërkombëtare: Bashkimi Europian, NATO-ja, Bashkimi European Perëndimor, Këshilli i Europës, Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë e të tjera. Azia Lindore

nuk ka pasur asgjë që të krahasohej me këto, me përjashtim të ASEAN-it, i cili nuk përfshin ndonjë fuqi të madhe, përgjithësisht është shmangur prej çështjeve të sigurisë dhe vetëm sa ka nisur të ecë përpara drejt formash më primitive të integritit ekonomik. Në vitet 1990 u krijua një organizatë shumë më e gjerë, APRC, ku hynin pjesa më e madhe e Buzës së Paqësorit, por ajo ishte një klub muhabetesh edhe më e dobët sesa ASEAN-i. Nuk ka asnjë institucion të madh shumëpalësh, në të cilin të bëhen bashkë fuqitë aziatike.

Edhe nga një anë tjetër, në kontrast me Europën Perëndimore, farat e konfliktit mes shteteve janë me bollëk në Azinë Lindore. Dy pika të rrezikshme, të njohura gjerësisht, kanë përfshirë dy Koretë dhe dy Kinat. Megjithatë, këto janë mbetje nga Lufta e ftohtë. Dallimet ideologjike si peshë po bien dhe aty nga viti 1995 janë zgjeruar ndjeshëm marrëdhëniet e dy Kinave, kurse kanë nisur të zhvillohen edhe ndërmjet dy Koreve. Ka gjasa që koreanët të luftojnë kundër koreanëve, por këto janë shumë të pakta; perspektivat që kinezët të luftojnë kundër kinezëve janë më të forta, por përsëri mbeten të kufizuara, veç në rast se tajvanasit do të heqin dorë nga identiteti si kinezë dhe zyrtarisht do të krijojnë një Republikë të Tajvanit të pavarur. Siç e ka cituar me miratim një dokument ushtarak kinez, një gjeneral ka thënë se “midis anëtarëve të familjes duhet të ketë kufizime për përleshjet.”¹⁸ Ndërkohë që dhuna ndërmjet dy Koreve ose dy Kinave mbetet e mundshme, përbashkësitë kulturore ka të ngjarë që ta brejnë këtë mundësi me kalimin e kohës.

Konfliktet e trashëguara nga Lufta e ftohtë në Azinë Lindore po plotësohen dhe janë zëvendësuar nga konflikte të tjera të mundshme, që pasqyrojnë rivalitetet e vjetra dhe marrëdhëniet e reja ekonomike. Analizat e sigurisë në Azinë Lindore të bëra në fillim të viteve

1990, rregullisht e kanë përmendur Azinë Lindore si “fqinjësi të rrezikshme”, si “të pjekur për rivalitet”, si një rajon me “disa luftëra të ftohta”, si “kthim mbrapsht nga e ardhmja”, ku do të mbizotërojnë paqëndrueshmëria dhe lufta.¹⁹ Krejt ndryshe nga Europa Perëndimore, Azia Lindore në vitet 1990 ka grindje territoriale të pazgjidhura, prej të cilave më të rëndësishmet janë ndërmjet Rosisë e Japonisë për ishujt veriorë, ndërsa ndërmjet Kinës, Vietnamit e Filipineve, e në mundësi edhe me shtetet e tjera të Azisë Juglindore lidhur me Detin e Kinës Jugore. Mosmarrëveshjet për kufijtë ndërmjet Kinës, nga njëra anë, dhe Rosisë e Indisë, nga ana tjetër, u pakësuan në mesin e viteve 1990, mirëpo mund të dalin përsëri në sipërfaqe, ashtu si mund të dalin edhe mëtimet e Kinës për Mongolinë. Lëvizjet kryengritëse ose për shkëputje, në pjesën më të madhe të rasteve me mbështetje nga jashtë, janë të pranishme në Mindanao, në Timorin Lindor, Tajlandën Jugore dhe Mianmarin lindor. Veç kësaj, ndonëse në Azinë Lindore në mesin e viteve 1990 ka paqe ndërmjet shteteve, gjatë pesëdhjetë vjetëve të kaluar luftërat më të mëdha kanë ndodhur në Kore e në Vietnam, kurse fuqia qendrore e Azisë, Kina, ka luftuar kundër amerikanëve, plus pothuaj kundër gjithë fqinjëve të saj, ndër ta kundër koreanëve, vietnamezëve, kinezëve nacionalistë, indianëve, tibetasve dhe rusëve. Një analizë e bërë nga ushtarakët kinezë më 1993 përcaktoi tetë pika të rrehta rajonale, që e kërcënonin sigurinë ushtarake të Kinës, kurse Komisioni Ushtarak Qendror i Kinës arriti në përfundimin se përgjithësisht tabloja e sigurisë në Azinë Lindore ishte “mjaft e zymtë”. Pas shekujsh me përleshje, Europa Perëndimore është në paqe dhe as që mendohet për luftë. Kurse në Azinë Lindore nuk është kështu dhe, siç e ka thënë Aaron Friedbergu (Fridberg), e kaluara e Europës mund të bëhej e ardhmja e Azisë.²⁰

Diamizmi ekonomik, grindjet territoriale, rivalitetet e ringjallura dhe pasiguria politike kanë ushqyer shtimin e ndjeshëm të buxhetit ushtarak në vendet e Azisë Lindore, si dhe të aftësive ushtarake gjatë viteve 1980 e 1990. Duke shfrytëzuar pasurinë e re dhe, në mjaft raste, popullsinë me arsim të mirë, qeveritë e Azisë Lindore kanë ndërmarrë hapa për të zëvendësuar ushtritë 'fshatare' të mëdha, por të pajisura keq, me forca ushtarake më të vogla, por më profesioniste, më të stërholluara nga ana teknologjike. Me shtimin e dyshimeve për shkak të zgjerimit të përzjerjes ushtarake të amerikanëve në Azinë Lindore, këto vende kanë vënë si synim të arrijnë të mbështeten në forcat e veta ushtarakisht. Ndërkohë që shtetet e Azisë Lindore kanë vijuar importimin e sasive të mëdha të armëve prej Europës, prej Shteteve të Bashkuara dhe ish Bashkimit Sovjetik, ato kanë parapëlqyer që të importojnë atë teknologji, e cila u bën të mundur të prodhojnë në vend avionë, raketa dhe pajisje elektronike të tipit të fundit. Japonia dhe shtetet sinike: Kina, Tajvani, Singapori dhe Koreja e Jugut, kanë zhvilluar industri të armëve gjithnjë e më stërholluara. Për shkak të tiparit bregdetar në gjeografinë e Azisë Lindore, ato e kanë vënë theksin te projektimi i forcave dhe aftësive detare e ajrore. Si rrjedhim, vende që më parë nuk ishin ushtarakisht të afta të luftonin njëri me tjetrin, tashti janë gjithnjë e më shumë të afta ta bëjnë këtë. Ky zgjerim i aftësive ushtarake është bërë fare pa transparencë dhe prandaj ka nxitur më shumë dyshime e pasiguri.²¹ Në një situatë kur marrëdhëniet e forcës po ndryshojnë, secila qeveri bën domosdoshmërisht dhe ligjërisht këtë pyetje: "Dhjetë vjet që nga e sotmja, kush do të jetë armiku im dhe kush, po ta kem, do të jetë miku im?"

Luftërat e ftohta aziatiko-amerikane. Nga fundi i viteve 1980 dhe fillimi i viteve 1990 marrëdhëniet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe vendeve aziatike, me përjashtim të Vietnamit, gjithnjë e më tepër janë bërë antagoniste, kurse ka shkuar duke rënë aftësia e Shteteve të Bashkuara për të dalë mbizotëruese në këto konflikte. Këto prirje kanë dalë në dukje sidomos me fuqitë më të mëdha në Azinë Lindore, ndërsa marrëdhëniet e Amerikës me Kinën e Japoninë kanë ecur në shtigje paralele. Amerikanët, nga njëra anë, dhe kinezët e japonezët, nga ana tjetër, kanë lëshuar fjalë për fillimin e luftërave të ftohta ndërmjet këtyre vendeve.²² Këto prirje të njëkohshme zunë fill gjatë punës së administratës së Bushit dhe u përshpejtuan me administratën e Klintonit. Nga mesi i viteve 1990 marrëdhëniet e Amerikës me dy fuqitë më të mëdha të Azisë mund të cilësoheshin në rastin më të mirë ‘të tendosura’ dhe dukej se pak perspektiva kishte që të ulej ndopak kjo tendosje.*

* Duhet vënë në dukje se të paktën në Shtetet e Bashkuara haset një pështjellim terminologjik lidhur me marrëdhëniet ndërmjet këtyre vendeve. Marrëdhënie ‘të mira’ mendohet se janë marrëdhënie miqësore, bashkëpunimi; marrëdhënie ‘të këqija’ janë marrëdhëniet armiqësore, antagoniste. Ky përdorim i fjalëve shkrin së bashku dy përmasa krejt të mdryshme: miqësinë kundrejt armiqësisë me të dëshirueshmen kundrejt të padëshirueshmes. Ai pasqyron hamendjen e veçantë amerikane, se harmonia në marrëdhëniet ndërkombëtare gjithnjë është e mirë dhe konflikti gjithnjë është i keq. Mirëpo njëjtësimi i marrëdhënieve të mira me marrëdhëniet miqësore vlen vetëm, nëse konflikti nuk është asnjëherë i dëshirueshëm. Shumica e amerikanëve mendojnë se ka qenë punë ‘e mirë’ që administrata e Bushit i bëri të këqija marrëdhëniet e SHBA me Irakun, kur hyri në luftë për Kuvajtin. Për ta mënjeluar këtë ngatërrim, nëse ‘i mirë’ do të thotë i dëshirueshëm apo i harmonishëm, dhe ‘i keq’ do të thotë i padëshirueshëm ose armiqësor, unë do t’i përdor ‘i mirë’ dhe ‘i keq’ vetëm me kuptimin i dëshirueshëm dhe i padëshirueshëm. Është interesante, ndonëse pështjelluese, që amerikanët e përkrahin

konkurrencën në shoqërinë amerikane ndërmjet opinioneve, grupeve, partive, degëve të qeverisë e të biznesit. Po përse atëherë amerikanët besojnë se konflikti është i mirë brenda shoqërisë së tyre, e megjithatë është i keq ndërmjet shoqërive? Kjo është një pyetje të cilën, me sa di unë, askush nuk e ka studiuar seriozisht.

Në fillim të viteve 1990 marrëdhëniet japono-amerikane u nxehën gjithnjë e më shumë me grindjet për një gamë të gjerë çështjesh, e ndër to roli i Japonisë në Luftën e Gjirit, prania amerikane në Japoni, qëndrimi i japonezëve kundrejt politikës amerikane për të drejtat e njeriut lidhur me Kinën e vende të tjera, pjesëmarrja e Japonisë në misionet paqeruajtëse dhe, ajo që ka më shumë rëndësi, marrëdhëniet ekonomike e në veçanti tregtia.²³ Po bëhen të zakonshme përmendjet e luftërave tregtare. Zyrtarët amerikanë, sidomos në administratën e Klintonit, i kanë kërkuar Japonisë gjithnjë e më shumë kohezion; zyrtarët japonezë i kanë kundërshtuar këto kërkesa gjithnjë e më me forcë. Çdo mosmarrëveshje japono-amerikane është bërë gjithmonë e më e hidhur dhe më e vështirë për ta zgjidhur, sesa tjetra para saj. Për shembull, në mars 1994 presidenti Klinton nënshkroi një urdhër, që e autorizonte të zbatonte sanksione më të rrepta tregtare për Japoninë, të cilat ngjallën protesta jo vetëm nga ana e japonezëve, por edhe nga kreu i GATT-it, organizatës kryesore botërore të tregtisë. Pak kohë më vonë Japonia u kundërpërgjigj me një 'sulm therës' kundër politikës së SHBA, kurse menjëherë pas kësaj Shtetet e Bashkuara 'e akuzuan zyrtarisht Japoninë' se po bënte diskriminime ndaj kompanive të SHBA në rastin e kontratave qeveritare. Në pranverën e vitit 1995 administrata e Klintonit kërcënoi se do të vendoste tarifa 100 për qind për makinat japoneze të luksit, me marrëveshje që paralajmëronte se kjo do të zbatohet pikërisht para se të hynin në fuqi sanksionet. Ndërmjet

këtyre dy vendeve ishte e qartë se po ndodhte diçka e ngjashme me një luftë tregtare. Aty nga mesi i viteve 1990 acarimi kishte arritur në atë pikë, sa figurat udhëheqëse japoneze nisën të shtronin pyetjen për praninë ushtarake të SHBA në Japoni.

Gjatë këtyre viteve publiku në secilin vend gjithnjë e më fort po merrte qëndrim të pafavorshëm kundrejt vendit tjetër. 87 për qind e publikut amerikan më 1985 u shprehën se përgjithësisht kishin qëndrim miqësor ndaj Japonisë. Aty nga viti 1990 kjo kishte rënë në 67 për qind dhe më 1993 vetëm nja 50 për qind e amerikanëve e ndienin se kishin qëndrim të favorshëm ndaj Japonisë, kurse dy të tretat u shprehën se përpiqeshin të mos blinin prodhime japoneze. 73 për qind e japonezëve më 1985 i quanin marrëdhëniet SHBA-Japoni si miqësore; aty nga viti 1993 prej tyre 64 për qind u shprehën se nuk ishin miqësore. Viti 1991 ka shënuar një pikë kthese vendimtare në largimin e opinionit publik prej kallëpit të kohës së Luftës së ftohtë. Për herë të parë amerikanët e renditën Japoninë përpara Bashkimit Sovjetik si kërcënim për sigurinë e Amerikës, kurse për herë të parë japonezët i renditën SHBA përpara Bashkimit Sovjetik si kërcënim për sigurinë e Japonisë.²⁴

Ndryshimet e qëndrimeve të publikut u ndoqën nga perceptimet e elitës. Në Shtetet e Bashkuara u shfaq një grup i rëndësishëm rishikuesish akademikë, intelektualë dhe politikë, që theksonin dallimet kulturore e strukturore ndërmjet dy vendeve dhe nevojën për Shtetet e Bashkuara që të mbanin një qëndrim më të ashpër në trajtimin e çështjeve ekonomike me Japoninë. Imazhet për Japoninë në mediat, në botimet joletrare dhe në romanet popullore u bënë gjithnjë e më shumë përçmuese. Në mënyrë paralele në Japoni u shfaq një brez i ri udhëheqësish politikë, të cilët nuk e kishin përvojën e fuqisë amerikane gjatë Luftës II Botërore dhe

të qëndrimit bamirës pas saj, prandaj mbaheshin me të madh për sukseset ekonomike të Japonisë, rrjedhimisht, kishin mjaft dëshirë që t'i kundërshtonin kërkesat amerikane në një mënyrë, të cilën nuk e kishin bërë prindët e tyre. Këta 'qëndrestarë' japonezë ishin pala përgjegjëse e kundërt e 'rishikuesve' amerikanë dhe në të dyja vendet kandidatët e panë se përkrahja e një vije më të ashpër për çështjet lidhur me marrëdhëniet jazono-amerikane kishte ndikim për mirë te votuesit.

Gjatë fundit të viteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990 marrëdhëniet e Amerikës me Kinën po ashtu u bënë gjithnjë e më antagoniste. Konfliktet ndërmjet këtyre vendeve, siç ka thënë Ten Hsiao Pini në shtator 1991, përfaqësonin "një luftë të re të ftohtë", shprehje kjo që u përsërit rregullisht nga shtypi kinez. Në gusht 1995 agjencia shtetërore e shtypit deklaroi se "Marrëdhëniet kino-amerikane janë në nivelin më të ulët që kur të dy vendet kanë vendosur marrëdhënie diplomatike" më 1979. Zyrtarët kinezë kanë denoncuar vazhdimisht ndërhyrjet e mëtuara në punët e Kinës. "Neve na duhet të vëmë në dukje," theksonte një dokument i brendshëm shtetëror kinez më 1992, "se që nga koha kur Shtetet e Bashkuara u bënë e vetmja superfuqi, janë kapur me rrëmbim pas politikës së fuqisë e të hegjemonizmit, po gjithashtu se forca e tyre po bie relativisht dhe ka kufij për çka mund të bëjnë." Presidenti Jang Zemin ka thënë në gusht 1995: "Forcat armiqësore Perëndimore për asnjë çast nuk kanë hequr dorë nga komploti i tyre për ta perëndimorizuar dhe për ta 'përçarë' vendin tonë." Aty nga viti 1995 njoftohej se kishte një mirëkuptim të gjerë mes udhëheqësve kinezë dhe studiuesve, se Shtetet e Bashkuara po orvateshin "ta përçanin territorin e Kinës, ta minonin nga ana politike, ta frenonin strategjikisht dhe ta ndrydhnin ekonomikisht."²⁵

Ka dëshmi për të gjitha këto akuza. Shtetet e Bashkuara e lejuan presidentin Li të Tajvanit të vinte në Shtetet e Bashkuara, i shitën Tajvanit 150 aeroplanë F-16, e përcaktuan Tibetin si “territor sovran të pushtuar”, e denoncuan Kinën për shkeljet e të drejtave të njeriut, e kundërshtuan Pekinin si vendin e Lojërave Olimpikë për vitin 2000, i normalizuan marrëdhëniet me Vietnamin, e akuzuan Kinën se eksportonte përbërës të armëve kimike në Pakistan dhe e kërcënuan Kinën se do të vendosnin sanksione të tjera për çështjet ekonomike, ndërkohë që i mbanin mbyllur Kinës derën për pranimin në Organizatën Botërore të Tregtisë. Secila palë e akuzonte tjetrën se ishte e pabesë: sipas amerikanëve, Kina kishte shkelur mirëkuptimin për eksportimin e raketave, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe për punën në burgje; Shtetet e Bashkuara, sipas kinezëve, kishin shkelur marrëveshjet, duke e lejuar presidentin Li që të vinte në Shtetet e Bashkuara dhe i kishin shitur Tajvanit avionë gjuajtës të modeleve të përparuara.

Grupi më i rëndësishëm në Kinë me pikëpamje antagoniste kundrejt Shteteve të Bashkuara ishin ushtarakët, të cilët, siç duket, i bënë rregullisht trysni qeverisë që të mbante një vijë më të ashpër me Shtetet e Bashkuara. Në qershorin e vitit 1993 u tha se 100 gjeneralë kinezë i kishin dërguar një letër Tenit, me ankesa për politikën ‘pasive’ të qeverisë kundrejt Shteteve të Bashkuara dhe se ajo kishte dështuar në kundërshtimin ndaj përpjekjeve të SHBA për ‘t’i bërë shantazh’ Kinës. Në vjeshtën e po atij viti një dokument shtetëror kinez konfidencial paraqiste arsyet ushtarake për një konflikt me Shtetet e Bashkuara: “Për shkak se Kina dhe Shtetet e Bashkuara kanë konflikte të vjetra lidhur me ideologjitë e tyre të ndryshme, me sistemet sociale dhe politikën e jashtme, do të dalë e pamundur të përmirësohen rrënjësisht marrëdhëniet kino-amerikane.”

Meqë amerikanët besojnë se Azia Lindore do të bëhet “zemra e ekonomisë botërore ...Shtetet e Bashkuara nuk mund ta tolerojnë një kundërshtar të fuqishëm në Azinë Lindore.”²⁶ Aty nga mesi i viteve 1990 zyrtarët dhe agjencitë kineze i paraqisnin rregullisht Shtetet e Bashkuara si një fuqi armiqësore.

Antagonizmi në rritje ndërmjet Kinës e Shteteve të Bashkuara pjesërisht nxitej prej politikës së brendshme në të dyja vendet. Ashtu si në rastin e Japonisë, opinioni amerikan i mirinformuar ishte i përçarë. Mjaft nga figurat e ngrehinës shtetërore flisnin për një angazhim konstruktiv me Kinën, duke i zgjeruar marrëdhëniet ekonomike dhe duke e tërhequr Kinën që të bënte pjesë në të ashtuquajturën bashkësi të shteteve. Të tjerët e vinin theksin te kërcënimi i mundshëm kinez për interesat amerikanë, argumentonin se lëvizjet pajtuese kundrejt Kinës kishin sjellë rezultate negative dhe kërkonin një politikë frenimi të patundur. Më 1993 publiku amerikan e renditi Kinën të dytën, vetëm pas Iranit, si vendi që përbënte rrezikun më të madh për Shtetet e Bashkuara. Politika amerikane shpesh ka vepruar në atë mënyrë, që përfonte gjeste simbolike, si vizita e Lisë në Kornel dhe takimi i Klintonit me Dalai Lamën, që i tërboi kinezët, ndërsa në të njëjtën kohë e drejtoi administratën që të flijonte të drejtat e njeriut për hir të interesave ekonomike, si në rastin e traktatit të MFN-së. Nga pala kineze, qeveria kishte nevojë për një armik të ri, që t’i fuqizonte thirrjet e saj për nacionalizmin kinez dhe që ta bënte të ligjshëm pushtetin e vet. Por me zgjatjen e luftës për pushtet, ndikimi politik i ushtarakëve u shtua dhe kryetari Ziang e konkurruesit e tjerë për pushtet pas Tenit nuk mund t’ia lejonin vetes që të dukeshin të ligështuar në mbrojtjen e interesave të Kinës.

Gjatë një dhjetëvjeçari, rrjedhimisht, marrëdhëniet e Amerikës 'u përkeqësuan' si me Japoninë, edhe me Kinën. Kjo zhvendosje në marrëdhëniet aziatiko-amerikane ka qenë kaq e gjerë dhe përfshiu kaq shumë lëmenj çështjesh të ndryshme, saqë ka pak gjasa t'i gjejmë shkaqet e saj në konfliktet e veçuara të interesave për pjesët e këmbimit të makinave, për shitjet e kamerave ose për bazat ushtarake, nga njëra anë, ose për burgosjen e disidentëve, transferimet e armëve ose piraterinë intelektuale, nga ana tjetër. Për më tepër, ishte haptas kundër interesave kombëtarë të Amerikës që të lejonte të bëheshin më konfliktuale marrëdhëniet e saj njëkohësisht me të dyja fuqitë më të mëdha të Azisë. Rregullat elementare të diplomacisë e të pushtetit politik do të diktonin që Shtetet e Bashkuara të orvateshin t'i kundërvinin njërën me tjetrën ose të paktën t'i zbusnin marrëdhëniet me njërën, në rast se vinin e bëheshin më konfliktuale me tjetrën. E megjithatë kjo nuk ndodhi. Kanë qenë faktorë më të gjerë, të cilët i nxisnin konfliktet në marrëdhëniet aziatiko-amerikane dhe që e kanë bërë më të vështirë të zgjidhen çështjet e veçanta, të cilat dilnin në ato marrëdhënie. Kjo dukuri e përgjithshme ka edhe shkaqe të përgjithshme.

Së pari, shtimi i ndërveprimit ndërmjet shoqërive aziatike dhe Shteteve të Bashkuara në trajtën e zgjerimit të komunikimeve, tregtisë, investimeve dhe njohjes së dyanshme, i ka shumëfishuar çështjet dhe temat, për të cilat interesat mund dhe në të vërtetë sollën në përplasje. Ky ndërveprim i shtuar i bëri praktikën e veprimit dhe besimet e secilës shoqëri të shfaqeshin si kërcënuese për tjetrën, pasi kur kishin largësi midis tyre, ato dukeshin si diçka ekzotike e padëmshme. Së dyti, kërcënimi i Bashkimit Sovjetik në vitet 1950 kishte sjellë që të bëhej traktati për sigurinë e dyanshme SHBA-Japoni. Kritja e fuqisë sovjetike në vitet 1970 solli vendosjen e

marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shteteve të Bashkuara e Kinës më 1979 dhe bashkëpunimin ad hoc ndërmjet të dy vendeve për të mbështetur interesin e përbashkët që të asnjansohej ai kërcënim. Përfundimi i Luftës së ftohtë e hoqi këtë interes të përbashkët mbizotërues të Shteteve të Bashkuara e të fuqive aziatike dhe nuk la asgjë në vend të tij. Si rrjedhim, dolën në ballë të tjera çështje, për të cilat kishte konflikte të rënda interesash. Së treti, zhvillimi ekonomik i vendeve të Azisë Lindore e lëkundit peshoren e përgjithshme të fuqisë ndërmjet tyre dhe Shteteve të Bashkuara. Siç e kemi parë, aziatikët gjithnjë e më shumë kanë afirmuar vlefshmërinë e institucioneve e të vlerave të tyre, si dhe epërsinë e kulturës së tyre kundrejt kulturës Perëndimore. Nga ana tjetër, amerikanët veçanërisht pas fitores në Luftën e ftohtë, kanë pasur prirjen që t'i paraqesin vlerat dhe institucionet e veta si me peshë universale dhe të tregojnë se ende e kishin forcën për t'u dhënë trajtën politikave të jashtme e të brendshme të shoqërive aziatike.

Ky mjedis ndërkombëtar në ndryshim e sipër nxori në ballë dallimet kulturore themelore ndërmjet qytetërimeve amerikane e aziatike. Në nivelin më të gjerë, etosi konfucian që përshkon shumë shoqëri aziatike ka theksuar vlerat e autoritetit, hierarkinë, nënshtrimin e të drejtave dhe të interesave të individit, rëndësinë e mirëkuptimit, shmangien e ballafaqimit, "ruajtjen e cipës" dhe, përgjithësisht, epërsinë e shtetit mbi shoqërinë dhe të shoqërisë mbi individin. Veç këtyre, aziatikët priren që të mendojnë për evoluimin e shoqërive të tyre nga pikëpamja e qindrvjeçarëve dhe të mijëvjeçarëve, duke ia lënë përparësinë maksimumit të arritjeve në vështrimin afatgjatë. Këto qëndrime janë në kontrast me përparësinë që kanë te besimet e amerikanëve liria, barazia, demokracia dhe

individualizmi, si dhe te animi i amerikanëve që të mos kenë besim te qeveria, ta kundërshtojnë autoritetin, të mbështesin kontrollet e baraspeshimet, të nxisin konkurrencën, të shenjtërojnë të drejtat e njeriut dhe ta harrojnë të kaluarën, ta shpërfillin të ardhmen dhe të përqendrohen te maksimumi i arritjeve të atypëratyshme. Këto burime konfliktesh i kanë rrënjët te dallimet themelore në shoqëri e në kulturë.

Dallimet kanë pasur pasoja të veçanta për marrëdhëniet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe shoqërive më të mëdha aziatike. Diplomatët kanë bërë përpjekje të mëdha që t'i zgjidhin konfliktet e Amerikës me Japoninë lidhur me çështjet ekonomike, sidomos për tepricën tregtare të Japonisë, dhe kundërshtimin nga ana e saj për produktet e investimet amerikane. Bisedimet jazono-amerikane të tregtisë morën mjaft nga tiparet e bisedimeve sovjeto-amerikane të kohës së Luftës së ftohtë për kontrollin e armëve. Deri nga viti 1995 ato të parat madje kishin arritur rezultate edhe më të pakta sesa të dytat, për shkakun se këto konflikte burojnë prej dallimeve themelore ndërmjet dy ekonomive, e sidomos prej natyrës së veçantë të ekonomisë japoneze, që është e vetme ndër ekonomitë e vendeve më të mëdha të industrializuara. Importimet e Japonisë për mallra të fabrikuarra kanë arritur deri 3,1 të PKB në krahasim me një mesatare prej 7,4 për qind për fuqitë e tjera të mëdha të industrializuara. Investimet e huaja të drejtpërdrejta në Japoni kanë qenë një thërmijë prej 0,7 për qind të PPB në krahasim me 28,6 për qind për Shtetet e Bashkuara dhe 38,5 për qind për Europën. E vetmja Japonia ndër vendet e mëdha industriale ka pasur teprica buxhetore në vitet e para 1990.²⁷

Edhe në përgjithësi ekonomia japoneze nuk ka ecur në po atë rrugë, sipas ligjeve të hamendësuarra të diktatit ekonomik Perëndimor. Pranimi me lehtësi nga

ekonomistët Perëndimorë në vitet 1980, se zhvlerësimi i dollarit do ta pakësonte tepricën tregtare japoneze, nuk u vërtetua. Ndërsa marrëveshja e Plaza-s e vitit 1985 e kishte ndrequr deficitin tregtar të Amerikës me Europën, pati ndikim të paktë mbi deficitin me Japoninë. Me vlerësimin e jenit më pak se një për qind kundrejt dollarit, terpica tregtare japoneze mbeti e lartë e madje u shtua. Kështu japonezët qenë në gjendje të mbanin si një monedhë të fortë, ashtu edhe tepricën tregtare. Të menduarit ekonomik Perëndimor ka prirje që ta quajë se një ndërkëmbim midis papunësisë dhe inflacionit, duke e pasur normën e papunësisë shumë më të vogël se 5 për qind, do t'i vinte në veprim trysnitë e inflacionit. E megjithatë, për vite me radhë Japonia e ka pasur papunësinë mesatarisht më pak se 3 për qind dhe inflacionin mesatarisht 1,5 për qind. Aty nga vitet 1990 si ekonomistët amerikanë, ashtu edhe ata japonezë erdhën në përfundimin se duheshin pranuar e kuptuar dallimet themelore ndërmjet këtyre dy sistemeve ekonomike. Niveli i ulët krejt i veçantë japonez për importimin e mallrave të fabrikuara, siç ka ardhur në përfundim një studim i kujdesshëm, “nuk mund të shpjegohet me faktorët ekonomikë standard.” “Ekonomia japoneze nuk ndjek logjikën Perëndimore,” ka thënë një analist tjetër, “çfarëdo që të thonë parashikuesit Perëndimorë, për arsyen e thjeshtë se nuk është ekonomi Perëndimore e tregut të lirë. Japonezët ...kanë shpikur një tip ekonomie, që sillet në mënyrë të atillë, sa i ngatërron aftësitë parashikuese të vëzhguesve Perëndimorë.”²⁸

Çfarë e shpjegon atëherë karakterin e dalluar të ekonomisë japoneze? Mes vendeve më të mëdha të industrializuara, ekonomia e Japonisë zë një vend të vetmuar, sepse shoqëria japoneze është jo-Perëndimore në mënyrë të veçantë. Shoqëria dhe kultura japoneze

dallohen prej shoqërisë e kulturës Perëndimore, e në veçanti amerikane. Këto dallime janë vënë në pah në cilëndo analizë serioze krahasuese të Japonisë me Amerikën.²⁹ Zgjidhja e çështjeve ekonomike ndërmjet Japonisë e Shteteve të Bashkuara varet prej ndryshimeve themelore në natyrën e njërës ose të të dyja ekonomive, që nga ana e saj, varet prej ndryshimeve bazë në shoqërinë dhe në kulturën e njërit apo të të dy vendeve. Ndryshime të tilla nuk janë të pakapërcyeshme. Shoqëritë dhe kulturat pësojnë ndryshime. Kjo mund të ndodhë edhe prej një ngjarjeje të madhe traumatike: thyerja totale në Luftën II Botërore i bëri dy vendet më militariste të botës që të ktheheshin në vendet më paqësore. Megjithatë, duket se nuk ka gjasa që as Shtetet e Bashkuara, as edhe Japonia t'i imponojnë njëra-tjetrës një Hiroshimë ekonomike. Edhe zhvillimi ekonomik mund ta ndryshojë strukturën shoqërore dhe kulturën e një vendi thellësisht, siç ndodhi me Spanjën në fillim të viteve 1950 e deri në fund të viteve 1970, e ndoshta mirëqenia ekonomike do ta bëjë Japoninë një shoqëri më të orientuar nga konsumi, të ngjashme me të Amerikës. Nga fundi i viteve 1980 si në Japoni, ashtu edhe në Amerikë njerëzit diskutonin sesi vendi i tyre do të bëhej më i ngjashëm me vendin tjetër. Në një mënyrë të kufizuar marrëveshja japono-amerikane për Nismat e Pengesave Strukturore u përpilua për të nxitur këtë konvergjencë. Dështimi i kësaj përpjekjeje dhe i të tjerave të ngjashme me të, ka dëshmuar se deri në çfarë përmasash dallimet ekonomike i kanë rrënjët në kulturat e të dy shoqërive.

Ndërkohë që konfliktet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Azisë i kanë burimet te dallimet kulturore, rrjedhimet e konflikteve të tyre pasqyrohen në ndryshimin e marrëdhënieve të fuqisë ndërmjet Shteteve të Bashkuara e Azisë. Shtetet e Bashkuara korrën disa

fitore në këto grindje, por prirja ka qenë në kahun aziatik dhe zhvendosja e peshores së fuqisë i acaroi edhe më tej konfliktet. Shtetet e Bashkuara prisnin që qeveritë aziatike t'i pranonin si udhëheqëse të "bashkësisë ndërkombëtare" dhe të pajtoheshin me zbatimin e parimeve e të vlerave Perëndimore në shoqëritë e tyre. Nga ana tjetër, siç e ka thënë ndihmëssekretari i shtetit Winston Lord (Uinston Lord), aziatikët "gjithnjë e më shumë po bëheshin të vetëdijsëm e krenarë për arritjet e veta," prisnin që të trajtoheshin si të barabartë dhe anonin që t'i vështronin Shtetet e Bashkuara si "dadon ndërkombëtare, në mos po si mujsharin ndërkombëtar". Mirëpo shtysa të thella brenda kulturës amerikane i pengojnë Shtetet e Bashkuara që të jenë të paktën dadot, në mos qofshin mujsharët në punët ndërkombëtare, dhe si rrjedhim, shpresat e amerikanëve gjithnjë e më tepër ishin në mospërputhje me ato të aziatikëve. Për një gamë të gjerë çështjesh, udhëheqësit japonezë dhe të tjerë aziatikë kanë mësuar që t'u thonë jo barasvlerësve të tyre amerikanë, të cilat shpesh me variantet e mirësjellshme aziatike quhet 'largësim'. Ndoshta pika e kthesës simbolike në marrëdhëniet amerikano-aziatike ka qenë ajo, që një zyrtar i lartë japonez e ka quajtur "aksidenti i parë i madhe i trenit" në marrëdhëniet japono-amerikane, i cili ndodhi në shkurt 1994, kur kryeministri Morihiro Hosokava e kundërshtoi prerazi kërkesën e presidentit Klinton për të vënë kuota numerike për importimin nga Japonia të mallrave industriale amerikane. "Ne as do ta kishim përfytyruar diçka të tillë se do të ndodhte qoftë dhe një vit më parë," e ka komentuar një zyrtar tjetër japonez. Një vit më pas ministri i jashtëm i Japonisë e nënvizoi këtë ndryshim, duke pohuar se në epokën e konkurrencës ekonomike ndërmjet vendeve dhe rajoneve, interesi kombëtar i

Japonisë ishte më i rëndësishëm sesa “thjesht identiteti” si anëtare e Perëndimit.³⁰

Përshtatja graduale e amerikanëve ndaj peshores së ndryshuar të fuqisë është pasqyruar në politikën amerikane kundrejt Azisë në vitet 1990. Së pari, duke e pranuar në të vërtetë se u mungonte vullneti dhe/ose aftësia për t’u bërë trysni shoqërive aziatike, Shtetet e Bashkuara i ndanë zonat me probleme ku mund të ushtronin fuqinë e vet, prej zonave me probleme ku kishin konflikte. Ndonëse Klintoni i kishte shpallur të drejtat e njeriut si përparësinë numër një për politikën amerikane kundrejt Kinës, më 1994 trysnisë që vinte nga biznesi i SHBA, Tajvani dhe burime të tjera, ai iu përgjigj duke i shkëputur të drejtat e njeriut prej çështjeve ekonomike dhe hoqi dorë nga orvatjet për ta shfrytëzuar shtrirjen e statusit të kombit më të favorizuar si mjet për të ndikuar mbi qëndrimin e Kinës kundrejt disidentëve politikë. Me një hap tjetër paralel, administrata hapur e shkëputi politikën e sigurisë kundrejt Japonisë, ku kishte gjasa që të ushtronte fuqinë e vet, prej tregtisë dhe çështjeve të tjera ekonomike, në të cilat marrëdhëniet e saj me Japoninë kishin natyrë të fortë konflikti. Kështu Shtetet e Bashkuara hoqën dorë prej armëve, që mund t’i kishin përdorur për të mbështetur të drejtat e njeriut në Kinë dhe për lëshime tregtare nga ana e Japonisë.

Së dyti, Shtetet e Bashkuara disa herë kanë ndjekur kursin e reciprocitetit paraprak me shtetet aziatike, u kanë bërë lëshime duke shpresuar se do të kishin të njëjtën gjë edhe prej aziatikëve. Shpesh ky kurs përligjej duke iu drejtuar nevojës për të mbajtur gjallë “angazhimin konstruktiv” ose “dialogun” me një vend aziatik. Mirëpo shumë dëndur vendi përkatës aziatik e ka interpretuar lëshimin si shenjë të dobësisë së Amerikës e rrjedhimisht ka ecur më tej në rrugën e mospranimit të

kërkesave amerikane. Ky model është vënë re sidomos lidhur me Kinën, e cila iu përgjigj shkëputjes nga SHBA të statusit si vendi më i favorizuar, duke bërë një varg shkeljesh edhe më intensive të të drejtave të njeriut. Për shkak të animit amerikan nga njëjtësimi i marrëdhënieve “të mira” me marrëdhëniet “miqësore”, Shtetet e Bashkuara janë në pozitë shumë të pafavorshme në konkurrencën me shoqëritë aziatike, të cilat marrëdhëniet “e mira” i njëjtësojnë me ato që u sjellin fitore atyre vetë. Për aziatikët lëshimet e amerikanëve nuk ka përse të jenë reciproke, madje ato duhen shfrytëzuar.

Së treti, në konfliktet e përsëritura SHBA-Japoni lidhur me çështjet tregtare, u krijua një model, në të cilin Shtetet e Bashkuara do t'i paraqisnin kërkesa Japonisë dhe do ta kërcënonin me sanksione, nëse nuk do t'i plotësonte. Do të zgjateshin bisedimet dhe në çastin e fundit, para se të viheshin në zbatim sanksionet, do të njoftohej se do të arrihej marrëveshja. Përgjithësisht marrëveshjet kanë qenë formuluar me aq shprehje të dykuptimshme, saqë Shtetet e Bashkuara do të shpreheshin se kishin fituar parimisht, kurse japonezët do ta zbatonin ose nuk do ta zbatonin marrëveshjen, ashtu si ua donte qejfi dhe gjithçka do të vazhdonte si më parë. Në mënyrë të ngjashme, edhe kinezët pajtoheshin me lëkundje për deklaratat lidhur me parimet e përgjithshme për të drejtat e njeriut, për pronësinë intelektuale, ose për përhapjen e armëve, që të lihej shteg për t'i interpretuar në mënyra krejt të ndryshme nga ana e Shteteve të Bashkuara dhe që të vijonin politikat e mëparshme.

Këto dallime në kulturat dhe zhvendosja e peshores së fuqisë ndërmjet Azisë e Amerikës u kanë dhënë zemër shoqërive aziatike që ta mbështesin njëra-tjetrën në konfliktet me Shtetet e Bashkuara. Për shembull, më

1994 në të vërtetë gjithë vendet aziatike, “nga Australia deri në Malajzi e në Korenë e Jugut”, u grupuan pas Japonisë për të kundërshtuar kërkesën e SHBA, që të vendoseshin kuota me shifra për importet. Një grumbullim i njëjtë ndodhi njëkohësisht në të mirë të trajtimit të Kinës si vend i favorizuar, duke dalë në krye kryeministri i Japonisë Hosokava, i cili argumentoi se konceptet e Perëndimit për të drejtat e njeriut nuk mund “të zbatohen verbërisht” për Azinë, kurse Li Kuan Jiu i Singaporit ka paralajmëruar, se po t’i bëhej trysni Kinës “Shtetet e Bashkuara do të mbeteshin të vetmuara në Paqësor.”³¹ Në një rast tjetër për të shfaqur solidaritet, aziatikët, afrikanët dhe të tjerët u rreshtuan prapa japonezëve për të mbështetur rizgjedhjen e japonezit që mbante detyrën e kryetarit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, duke i bërë ballë kundërshtimit të Perëndimit, dhe Japonia nxori një korean të jugut si kryetar të Organizatës Botërore të Tregtisë përballë kandidatit të Amerikës, ish presidentit të Meksikës, Karlos Salinasit. Faktet tregojnë në mënyrë të padiskutueshme, se aty nga vitet 1990 lidhur me çështjet e tej-Paqësorit secili vend në Azinë Lindore e ndiente, që kishte shumë më tepër anë të përbashkëta me vendet e tjera të Azisë Lindore, sesa i kishte të përbashkëta me Shtetet e Bashkuara.

Në këtë mënyrë, fundi i Luftës së ftohtë, shtimi i ndërveprimit midis Azisë e Amerikës dhe rënia relative e fuqisë së Amerikës i nxorën në sipërfaqe përplasjet e kulturave ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Japonisë e shoqërive të tjera aziatike, duke u mundësuar këtyre të fundit që t’u bëjnë qëndresë Shteteve të Bashkuara. Ngritja e Kinës u ka nxjerrë Shteteve të Bashkuara një sfidë edhe më themelore. Konfliktet e SHBA me Kinën mbulojnë një gamë shumë më të gjerë çështjesh sesa ato me Japoninë, duke përfshirë çështje ekonomike, të

drejtat e njeriut, Tibetin, Tajvanin, Detin e Kinës Jugore dhe përhapjen e armëve. Ashtu si me Japoninë, këto konflikte në pjesën më të madhe i kanë pasur rrënjët në kulturat e ndryshme të këtyre dy shoqërive. Megjithatë, konfliktet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kinës kanë përfshirë edhe çështjet themelore të fuqisë. Kina nuk ka dëshirë ta pranojë rolin udhëheqës amerikan ose hegjemoninë amerikane në botë; Shtetet e Bashkuara nuk kanë dëshirë ta pranojnë rolin udhëheqës ose hegjemoninë e Kinës në Azi. Për mbi dyqind vjet Shtetet e Bashkuara janë orvatur ta pengojnë daljen e një fuqie tërësisht mbisunduese në Europë. Për pothuaj njëqind vjet, duke nisur me politikën e 'Dyerve të hapura' kundrejt Kinës, ato janë orvatur të bëjnë të njëjtën gjë edhe në Azinë Lindore. Për t'i arritur këto synime, ato kanë marrë pjesë në dy luftëra botërore dhe në një luftë të ftohtë me Gjermaninë Perandorake, Gjermaninë Naziste, Japoninë Perandorake, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën Komuniste. Këta interesa të amerikanëve mbeten të pandryshuar dhe janë ripohuar nga presidentët Regan e Bush. Ngritja e Kinës si fuqia rajonale mbisunduese në Azinë Lindore, nëse do të vazhdojë, u bën sfidë interesave qendrorë amerikanë. Shkaku i nëndheshëm i konfliktit ndërmjet Kinës e Amerikës është dallimi i tyre themelor lidhur me çështjen, se cila do të jetë peshorja e fuqisë në të ardhmen në Azinë Lindore.

Hegjemonia kineze: baraspeshimi dhe renditja pas më të fortit. Me gjashtë qytetërime, me tetëmbëdhjetë vende, me ekonomi në rritje të shpejtë dhe me dallime të mëdha politike, ekonomike e shoqërore ndërmjet shoqërive të saj, Azia Lindore mund të zhvillohet duke ndjekur në fillimet e shekullit XXI një prej disa modeleve të marrëdhënieve ndërkombëtare. Mund të përfytyrohet se do të përftohet një bashkësi tejet e

ndërlikuar marrëdhëniesh bashkëpunimi e konflikti, që do të përfshijë shumicën e fuqive më të mëdha e të nivelit të mesëm në këtë rajon. Ose mund të përftohet një sistem shumëpolësh ndërkombëtar fuqish të mëdha, me Kinën, Japoninë, Shtetet e Bashkuara, Rusinë dhe ndoshta Indinë, që do të jenë në baraspeshë e në konkurrencë njëra me tjetrën. Anasjelltas, në politikën e Azisë Lindore mund të mbisundojë një rivalitet i qëndrueshëm dypolësh ndërmjet Kinës e Japonisë, ose ndërmjet Kinës e Shteteve të Bashkuara, ndërsa vendet e tjera do të renditen me njërin apo me tjetrën palë, ose do të ndjekin rrugën e mosangazhimit. Mund të përfytyrohet që politika e Azisë Lindore do të kthehet në modelin tradicional njëpolësh, me një hierarki fuqie, duke e pasur qendrën në Pekin. Nëse Kina do t'i ruajë nivelet e larta të rritjes ekonomike gjatë shekullit XXI, do ta mbajë unitetin në periudhën pas Tenit dhe nuk do të shembet prej luftërave për pasardhësit në pushtet, ka gjasa që të orvatet të realizojë të fundit nga këto drejtime. A do t'ia dalë mbanë, kjo varet prej reagimit të lojtarëve të tjerë në lojën politike të fuqisë në Azinë Lindore.

Historia, kultura, traditat, përmasat, dinamizmi ekonomik dhe vetëpërfytyrimi i Kinës, që të gjitha bashkë e shtojnë të marrë një pozitë hegjemoniste në Azinë Lindore. Ky synim është një rrjedhim i natyrshëm i zhvillimit të saj ekonomik të shpejtë. Secila fuqi tjetër e madhe, Britania e Franca, Gjermania e Japonia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik, kanë punuar për zgjerimin e jashtëm, për afirmimin dhe synimet imperialiste, që kanë përkuar ose kanë ndodhur menjëherë pas viteve, në të cilat kanë kaluar përmes industrializimit të shpejtë dhe rritjes ekonomike. Nuk ka arsye që arritja e fuqisë ekonomike e ushtarake nuk do të ketë pasoja të krahasueshme edhe në Kinë. Për dy mijë

vjet Kina ka qenë fuqia mbisunduese në Azinë Lindore. Sot kinezët gjithnjë e më shumë shfaqin qëllimet e tyre për ta rimarrë këtë rol historik dhe për t'i dhënë fund shekullit të stërzgjatur të poshtërimit e nënshtrimit kundrejt Perëndimit e Japonisë, që kishte nisur me imponimin nga ana e britanikëve të Traktatit të Nankingut më 1842.

Në fund të viteve 1980, burimet ekonomike në rritje Kina nisi t'i shndërronte në fuqi ushtarake dhe ndikim politik. Nëse do të vijojë zhvillimi i saj ekonomik, ky proces shndërrimi do të marrë përpjesëtime më të mëdha. Sipas shifrave zyrtare, gjatë pjesës më të madhe të viteve 1980 shpenzimet ushtarake të Kinës kanë pësuar rënie. Mirëpo ndërmjet viteve 1988 e 1993, shpenzimet ushtarake janë dyfishuar me sasi të hollash, kurse me vlera reale janë rritur 50 për qind. Për vitin 1995 u planifikua një rritje prej 21 për qind. Vlerësimet për shpenzimet ushtarake të Kinës për vitin 1993 tregojnë për rreth 22 miliardë dollarë deri në 37 miliardë dollarë sipas kursit të shkëmbimit zyrtar dhe deri në 90 miliardë dollarë sipas paritetit në aftësinë blerëse. Nga fundi i viteve 1980 Kina e rishikoi strategjinë ushtarake, duke kaluar nga mbrojtja kundër një pushtimi prej një lufte të madhe me Bashkimin Sovjetik, te një strategji rajonale, që e vë theksin te fuqia. Në përputhje me këtë zhvendosje, ajo nisi të zhvillonte aftësitë luftarake detare, mori avionë luftarakë modernë të largësive të mëdha, zhvilloi aftësinë për furnizimin me karburant në fluturim dhe vendosi të blinte një aeroplanmbajtëse. Gjithashtu Kina hyri në marrëdhënie me Rusinë për blerjen e armëve me përfitim reciprok.

Kina po ecën në rrugën për t'u bërë fuqia mbisunduese në Azinë Lindore. Zhvillimi ekonomik i Azisë Lindore po bëhet gjithnjë e më tepër i orientuar drejt Kinës, i ushqyer prej rritjes së shpejtë në kontinent

dhe në tri Kinat e tjera, plus roli qendror që kanë luajtur kinezët etnikë në zhvillimin e ekonomive të Tajlandës, Malajzisë, Indonezisë e Filipineve. Ajo që është më kërcënuese vjen nga ngulmimi gjithnjë e më i fuqishëm për mëtimet në Detin e Kinës Jugore: po ngre bazat në Ishujt Paracel, ka luftuar kundër vietnamezëve për një grusht ishujsh më 1988, ka shtuar praninë ushtarake në Sharnajën e Keqe afër brigjeve të Filipineve dhe ka paraqitur mëtime për fushat e gazit pranë Ishullit Natuna të Indonezisë. Gjithashtu Kina i dha fund mbështetjes së nënkuptuar për praninë e vazhdueshme të SHBA në Azinë Lindore dhe ka nisur t'i kundërvihet gjallërisht këtij dislokimi. Po ashtu, ndonëse gjatë Luftës së ftohtë Kina pa zhurmë e kishte shtyrë Japoninë ta shtonte fuqinë ushtarake, në vitet pas Luftës së ftohtë ka shprehur shqetësim në rritje lidhur me ngritjen ushtarake të Japonisë. Duke vepruar sipas modelit klasik të hegjemones rajonale, Kina po orvatet t'i pakësojë pengesat për të arritur epërsinë ushtarake rajonale.

Me ndonjë përjashtim të rrallë, si ndoshta për Detin e Kinës Jugore, hegjemonia e Kinës në Azinë Lindore nuk ka gjasa që të nënkuptojë zgjerimin e sundimit territorial me anë të përdorimit të drejtpërdrejtë të forcës ushtarake. Megjithatë, kjo ka të ngjarë të nënkuptojë, se Kina ka dëshirë që vendet e tjera të Azisë Lindore, në shkallë të ndryshme, të plotësojnë disa ose të gjitha pikat e mëposhtme:

- të mbështesin integritetin tokësor të Kinës, sundimin e kinezëve mbi Tibetin e Ksinkiangun, si dhe integrimin e Hong-Kongut e të Tajvanit me Kinën;
- të pranojnë sovranitetin e Kinës mbi Detin e Kinës Jugore e ndoshta mbi Mongolinë;

- t'i japin mbështetje të përgjithshme Kinës në konfliktet me Perëndimin lidhur me ekonominë, të drejtat e njeriut, përhapjen e armëve dhe çështje të tjera;
- të njohin epërsinë ushtarake kineze në rajon dhe të mos pajisen me armë bërthamore ose me forca konvencionale, që do t'i kundërviheshin kësaj epërsie;
- të zbatojnë politika tregtare e investimesh, që përputhen me interesat kinezë dhe që japin ndihmesë për zhvillimin ekonomik kinez;
- t'ia lënë udhëheqjes së Kinës të merret me problemet rajonale;
- të jenë përgjithësisht të hapura për imigrimin nga Kina;
- të ndalojnë ose të shtypin lëvizjet antikineze e kundër Kinës brenda shoqërive të tyre;
- të respektojnë të drejtat e kinezëve brenda shoqërive të tyre, duke përfshirë të drejtën për të mbajtur lidhje të ngushta me familjarët e tyre dhe me provincat nga e kanë prejardhjen në Kinë;
- të mos pranojnë aleanca ushtarake ose koalicione me fuqi të tjera të drejtuara kundër Kinës;
- të nxisin përdorimin e mandarinishtes kineze si plotësuese dhe përfundimisht si zëvendësuese të anglishtes në rolin e gjuhës për komunikimin më të gjerë në Azinë Lindore.

Ngritjen e Kinës analistët e krahasojnë me ngritjen e Gjermanisë së Vilhelmit si fuqia mbisunduese në Europë nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Kurdoherë ngritja e fuqive të mëdha të reja sjell destabilizim të madh dhe nëse do të ndodhë kështu, dalja e Kinës si fuqi e madhe do ta rrëgojë çfarëdo dukurie tjetër të krahasueshme gjatë gjysmës së fundit të

mijëvjeçarit të dytë. “Përmasat e zhvendosjes që sjell Kina në botë,” ka vënë në dukje Li Kuan Jiu më 1994, “janë të tilla saqë bota duhet të gjejë një baraspeshim të ri brenda 30 ose 40 vjetëve. Nuk mund të mëtohet që për këtë thjesht duhet një lojtar tjetër i madh. Ajo është lojtari më e madhe në historinë e njerëzimit.”³² Nëse zhvillimi ekonomik i Kinës do të vijojë edhe një dhjetëvjeçar tjetër, siç duket plotësisht e mundshme, dhe nëse Kina do ta ruajë unitetin e vet gjatë periudhës së vendosjes së pasardhësve, siç ka gjasa të ndodhë, vendeve të Azisë Lindore dhe botës do t’u duhet t’i gjejnë përgjigje rolit gjithnjë e në rritje të këtij lojtari më të madh në historinë njerëzore.

Në vija të përgjithshme, shtetet mund të reagojnë me njërën ose me një ndërthurje të dy rrugëve kundrejt daljes së një fuqie të re. Vetëm ose së bashku me shtete të tjera, ato mund të orvaten ta arrijnë sigurinë e vet duke e baraspeshuar fuqinë që po ngrihet, duke e përmbajtur dhe, po të jetë e nevojshme, duke bërë luftë për ta thyer. Si zgjedhje alternative, shtetet mund të orvaten të shkojnë pas qerres së fuqisë në ngritje, t’i përshtaten dhe të zënë një pozitë të rendit të dytë ose të nënshtruar në marrëdhëniet me fuqinë në ngritje, duke shpresuar se do të mbrohen interesat e tyre themelorë. Ose, ka mundësi të përfytyrohet që shtetet do të orvaten të bëjnë një farë ndërthurjeje të baraspeshimit me vajtjen pas qerres, ndonëse kjo fsheh rrezikun që edhe të lindë anatgonizmi me fuqinë në ngritje, edhe të mos ketë mbrojtje kundër saj. Sipas teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare të Perëndimit, baraspeshimi zakonisht është një opsion më i dëshirueshëm dhe në fakt atij i janë drejtuar më shpesh, sesa vajtjes pas qerres. Siç e ka shtjelluar Stephen Walt-i (Stiven Uollt):

Përgjithësisht, llogaritë e synimeve duhet t'u japin zemër shteteve që të arrijnë baraspeshimin. Vajtja pas qerres është e rrezikshme, sepse për të kërkohet besimi; dikush e ndihmon një fuqi mbisunduese me shpresën se do të mbajë për të qëndrim dashamirës. Është më e sigurtë të bësh baraspeshimin, për rastin nëse fuqia mbisunduese del agresive. Për më tepër, rreshtimi me palën më të dobët e shton ndikimin e tij brenda koalicionit që përfitohet, sepse pala më e dobët ka nevojë më të madhe për ndihmë.³³

Analiza e Uolltit për formimin e aleancave në Azinë Juglindore ka treguar, se pothuaj kurdoherë shtetet janë orvatur të arrijnë baraspeshimin kundrejt kërcënimeve të jashtme. Gjithashtu përgjithësisht është pranuar se qëndrimi për baraspeshë ka qenë si normë përmes pjesës më të madhe të historisë së kohëve të reja të Europës, ndërsa disa fuqi i kanë zhvendosur aleancat e tyre që të arrinin baraspeshën dhe të frenonin kërcënimet që i shihnin se u vinin nga Filipi II, Luigji XIV, Frederiku i Madh, Napoleoni, Kajzeri dhe Hitleri. Megjithatë, Uollteri e pranon se shtetet “në disa rrethana” mund të zgjedhin të shkojnë pas qerres, kurse siç e ka argumentuar Randall Schweller-i (Shveler), shtetet rishikuese të qëndrimeve ka më shumë gjasa të shkojnë pas qerres së një fuqie në ngritje, sepse janë të pakënaqura dhe kanë shpresa të përfitojnë nga ndryshimi i statukuosë.³⁴ Veç kësaj, siç sugjeron Uollti, vajtja pas qerres nuk kërkon një shkallë besimi në synimet jodashakeqëse të shtetit më të fuqishëm.

Në baraspeshimin e fuqisë shtetet mund të luajnë role ose parësore, ose dytësore. Së pari, një Shtet A mund të orvatet ta baraspeshojë fuqinë kundër Shtetit B, të cilin e percepton se mund të jetë një kundërshtar i mundshëm, duke lidhur aleanca me Shtetet C dhe D, duke zgjeruar fuqinë e vet ushtarake e të natyrës tjetër

(gjë që ka gjasa të çojë në garën e armatimeve), ose duke i ndërthurur njëfarësoj këto mjete. Në këtë situatë Shtetet A dhe B janë baraspeshuesit *parësorë* të njëri-tjetrit. Së dyti, Shteti A mund të mos i perceptojë shtetet e tjera si kundërshtarë të drejtpërdrejtë, por mund të jetë i interesuar që të mbështesë baraspeshën e fuqisë ndërmjet Shteteve B e C, pasi secili prej tyre, nëse do të bëhet tepër i fuqishëm, mund të paraqesë kërcënim për Shtetin A. Në këtë situatë Shteti A vepron si baraspeshues *dytësor* kundrejt Shteteve B e C, të cilat mund të jenë baraspeshues *parësorë* kundrejt njëri-tjetrit.

Si do të reagojnë shtetet ndaj Kinës, nëse ajo nis të dalë si fuqia hegjemonike në Azinë Lindore? Pa dyshim, përgjigjet do të kenë larmi të madhe. Meqë Kina i ka përcaktuar Shtetet e Bashkuara si armikun e vet kryesor, prirja mbizotëruese amerikane do të jetë të veprojnë si baraspeshues *parësorë* dhe ta pengojnë hegjemoninë kineze. Do ta marrim, që ky rol do të ecë në përputhje me shqetësimin tradicional amerikan për të penguar që as Europa dhe as Azia të mos jenë nën mbizotërimin e një fuqie të vetme. Ky synim nuk ka më peshë në Europë, por mund ta ketë në Azi. Një federatë e çlirët në Europën Perëndimore, e lidhur ngushtë me Shtetet e Bashkuara nga ana kulturore, politike dhe ekonomike, nuk do ta kërcënojë sigurinë e Amerikës. Kurse një Kinë e njësuar, e fuqishme, ngulmuese, do ta kërcënonte. A është në interesin e Amerikës që të jetë e gatshme të hyjë në luftë, nëse del e domosdoshme ta pengojë hegjemoninë kineze në Azi? Nëse zhvillimi ekonomik i Kinës do të vazhdojë, kjo do të përbëjë të vetmen çështje më serioze për sigurinë, me të cilën do të përballen hartuesit amerikanë të politikës në fillim të shekullit XXI. Nëse Shtetet e Bashkuara duan ta ndalin sundimin e Azisë Lindore nga Kina, do të kenë nevojë ta

riorientojnë aleancën me Japoninë drejt këtij synimi, të ndërtojnë lidhje të ngushta me shtetet e tjera aziatike dhe të shtojnë praninë e vet ushtarake në Azi, si dhe fuqinë ushtarake që mund ta dërgojnë në Azi. Nëse Shtetet e Bashkuara nuk duan të luftojnë kundër hegjemonisë kineze, do t'u duhet të heqin dorë nga universalizmi i vet, të mësojnë të bashkëjetojnë me atë hegjemoni dhe të pajtohen me një zvogëlim të dukshëm të aftësisë që t'u japin trajtë ngjarjeve në anën e përtejme të Paqësorit. Secili kurs lidhet me shpenzime e rreziqe të mëdha. Rreziku më i madh është se Shtetet e Bashkuara nuk do të bëjnë një zgjedhje të qartë dhe do të bien në një luftë me Kinën, pa e shqyrtuar me kujdes nëse është në interesin e tyre kombëtar dhe pa qenë të përgatitura për ta bërë me efektshmëri këtë luftë.

Teorikisht Shtetet e Bashkuara mund të orvateshin ta përmbanin Kinën, duke luajtur rolin baraspeshues dytësor, nëse ndonjë fuqi tjetër e madhe do të vepronte si baraspeshues parësor i Kinës. E vetmja mundësi e hamendësueshme do të ishte Japonia dhe kjo do të kërkonte ndryshime të mëdha në politikën japoneze: të intensifikohej armatimi i Japonisë, të gjendeshin armë bërthamore dhe të niste rivaliteti i gjallë me Kinën se kush do të gjente mbështetje mes fuqive të tjera aziatike. Ndërsa Japonia mund të kishte dëshirë të merrte pjesë në një koalicion të udhëhequr prej Shteteve të Bashkuara për t'i bërë ballë Kinës, ndonëse edhe kjo nuk është e sigurtë, nuk ka të ngjarë që do të bëhej baraspeshuesja parësore e Kinës. Veç kësaj, Shtetet e Bashkuara nuk kanë treguar ndonjë interesim të madh ose aftësi për të luajtur rolin baraspeshues dytësor. Kur ishin shtet i ri e i vogël, u orvatën ta bënë këtë gjatë epokës së Napoleonit dhe përfunduan duke bërë luftëra si me Britaninë, edhe me Francën Gjatë pjesës së parë të shekullit të njëzetë Shtetet e Bashkuara bënë vetëm

minimumin e përpjekjeve për të mbështetur baraspeshën mes vendeve europiane e aziatike dhe si rrjedhim, hynë në luftërat botërore për të rivendosur baraspeshën që ishte prishur. Gjatë Luftës së ftohtë Shtetet e Bashkuara nuk kishin rrugë tjetër, veç të ishin baraspeshuesi parësor i Bashkimit Sovjetik. Kështu Shtetet e Bashkuara asnjëherë nuk kanë qenë baraspeshues dytësor si fuqi e madhe. Që të bëhet, ne kuptojmë të luajë një rol të hollë, elastik, të dykuptimshëm dhe madje dredharak. Kjo mund të kërkonte zhvendosjen e mbështetjes nga njëra palë te tjetra, duke mos pranuar të mbështesin ose të kundërshtojnë një shtet, që nga pikëpamja e vlerave amerikane do të dukej se ka të drejtë morale, dhe duke mbështetur një shtet i cili moralisht e ka gabim. Edhe sikur Japonia të dilte si baraspeshuesi parësor i Kinës në Azi, aftësia e Shteteve të Bashkuara për ta mbështetur këtë baraspeshë është në pikëpyetje. Shtetet e Bashkuara janë shumë më të afta të mobilizohen drejtpërdrejt kundër një kërcënimi të pranishëm, sesa të baraspeshojnë dy kërcënime të mundshme. Së fundi, ka të ngjarë të ekzistojë një prirje për të ecur pas qerres së më të fortit mes fuqive aziatike, që do ta përjashtonte çfarëdo orvatjeje të SHBA për baraspeshimin dytësor.

Sipas shkallës në të cilën ecja pas qerres së më të fortit varet te besimi, na dalin tre parashikime. I pari, ka më shumë gjasë që ecja pas qerres të ndodhë ndërmjet shteteve që i përkasin të njëjtit qytetërim, ose përndryshe, që kanë të njëjtat përbashkësi kulturore, sesa ndërmjet shteteve, të cilat nuk kanë asnjë përbashkësi kulturore. I dyti, nivelet e besimit ka të ngjarë të luhaten sipas kontekstit. Një djalë më i vogël ecën pas qerres së vëllait më të madh kur përballen me djem të tjerë; ai ka më pak gjasa që t'i zërë besë vëllait më të madh kur janë vetëm në shtëpi. Prej këndeje, ndërveprimet më të dendura midis shteteve me qytetërim të ndryshme e

nxisin më tej ecjen pas qerres brenda qytetërimeve. I treti, ecja pas qerres dhe prirjet për baraspeshim mund të ndryshojnë nga njëri qytetërim te tjetri, për shkak se edhe nivelet e besimit mes anëtarëve të ndryshëm ndryshojnë. Mbizotërimi i baraspeshimit në Lindjen e Mesme, për shembull, ndoshta pasqyron nivelet proverbialisht të ulëta të mirëbesimit në kulturat arabe dhe të tjerat të Lindjes së Mesme.

Përveç këtyre ndikimeve, prirja për të ecur pas qerres së më të fortit ose baraspesha e marrin trajtën sipas shpresave dhe parapëlqimeve lidhur me shpërndarjen e fuqisë. Shoqëritë europiane kanë kaluar përmes një faze absolutizmi, por u janë shmangur perandorive burokratike ose “despotizmit oriental”, që e ka karakterizuar Azinë gjatë pjesë më të madhe të historisë. Feudalizmi jepte një bazë për pluralizëm dhe hamendësimin se ishte si e natyrshme, ashtu edhe e dëshirueshme një farë shpërndarjeje e pushtetit. Prandaj edhe në nivelin ndërkombëtar mendohej si e natyrshme dhe e dëshirueshme një baraspeshë e fuqisë, bashkë me përgjegjësinë e burrave të shtetit për ta mbështetur dhe mbrojtur atë. Rrjedhimisht, kur vihej në rrezik baraspesha, kërkohej një qëndrim baraspeshues për ta rivendosur. Shkurt, modeli european i shoqërisë ndërkombëtare pasqyronte modelin e shoqërisë brenda vendit.

Përkundrazi, perandoritë burokratike aziatike linin pak hapësirë për pluralizëm shoqëror ose politik dhe përndarjen e pushtetit. Brenda Kinës ecja pas qerres së më të fortit duket se ka qenë shumë më rëndësishme, e krahasuar me baraspeshimin që ndeshej në Europë. Gjatë viteve 1920, siç e vë re Lusjen Pai, “zotërit e luftës në fillim kërkonin të mësonin se çfarë do të fitonin duke e njëjtësuar veten me forcën, dhe vetëm pastaj do të shqyrtonin se çfarë mund të paguanin duke u bërë aleat i

të dobët...për zotërit e luftës kinezë, nuk ishte autonomia vlera përfundimtare, siç ka qenë në llogaritë për baraspeshën e fuqisë në traditën europiane; përkundrazi, ata i mbështesnin vendimet të shoqërimi me fuqinë.” Po në të njëjtën rrymë mendimi, Avery Goldstein (Ejveri Goldstain) argumenton, se ecja pas qerres së më të fortit e karakterizonte politikën në Kinën komuniste, kur struktura e autoritetit ka qenë relativisht e qartë nga viti 1949 deri më 1966. Por kur Revolucioni kulturor krijoi një gjendje afër anarkisë dhe pasigurie lidhur me autoritetin, duke kërcënuar mbijetesën e aktorëve politikë, nisi të mbizotëronte qëndrimi për baraspeshim.³⁵ Do të mendojmë se rivendosja e një strukture të përcaktuar më kthjellët të autoritetit pas vitit 1978 gjithashtu e ka rivendosur ecjen sipas qerres si modelin mbizotërues të qëndrimit politik.

Historikisht kinezët nuk kanë bërë ndonjë dallim të prerë ndërmjet punëve të brendshme dhe punëve të jashtme. “Imazhi i tyre për rendin botëror nuk ka qenë gjë tjetër veçse një anë e varur prej rendit të brendshëm kinez dhe kështu përbënte një zgjatim të identitetit qytetërimor kinez.”, i cili “mendohej se do ta riprodhonte veten në një rreth bashkëqendror të zgjerueshëm, si rend kozmik i rregullt.” Ose, siç e ka shprehur MacFarquhar-i (Markfarkuar): “Botëvështrimi kinez tradicional ka qenë pasqyrim i vizionit konfucian për një shoqëri hierarkike të nyjëtuar me kujdes. Monarkët dhe shtetet e huaja mendohej se duhej të ishin haraçpagues të Mbretërisë së Mesme: ‘Në qiell nuk ka dy diej, edhe në tokë nuk mund të ketë dy perandorë.’” Si rrjedhim, kinezët nuk i kanë parë me sy të mirë “konceptet shumëpolëshe e madje shumëpalëshe për sigurinë.” Përgjithësisht azatikët kanë dëshirë “të pranojnë hierarkinë” në marrëdhëniet ndërkombëtare, ndërsa luftërat hegjemonike të tipit europian kanë

munguar në historinë e Azisë Lindore. Për Azinë historikisht ka qenë i huaj një sistem baraspeshe fuqie në veprim, i cili ka qenë tipik për Europën. Deri para ardhjes së fuqive Perëndimore në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, marrëdhëniet ndërkombëtare të Azisë Lindore kanë qenë sinocentrike me shoqëritë e tjera, të rreshtuara në shkallë të ndryshme varësie nga Pekini, bashkëpunimi ose autonomie ndaj tij.³⁶ Natyrisht, ideali konfucian për botën asnjëherë nuk është arritur plotësisht në praktikë. Megjithatë, modeli aziatik i hierarkisë së fuqisë në politikën ndërkombëtare është në kontrast të theksuar me modelin evropian të baraspeshës së fuqisë.

Si pasojë e këtij imazhi për rendin botëror, prirja kineze drejt ecjes pas qerres në politikën e brendshme shfaqet edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Shkalla në të cilën ajo u jep formë politikave të jashtme të secilit shtet luhet sipas shkallës në të cilën kanë të përbashkët kulturën konfuciane dhe sipas marrëdhënieve historike me Kinën. Nga ana kulturore Koreja ka shumë gjëra të përbashkëta me Kinën dhe historikisht ka anuar nga Kina. Për Singaporin gjatë Luftës së ftohtë Kina komuniste ka qenë një armik. Mirëpo në vitet 1980 Singapori nisi ta ndryshonte qëndrimin dhe udhëheqësit e tij argumentonin gjallërisht nevojën që Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera të pajtoheshin me realitetin e fuqisë kineze. Duke pasur popullsi të madhe kineze dhe anësinë antiperëndimore të udhëheqësve të saj, edhe Malajzia ka anuar fort në drejtim të fuqisë së Kinës. Tajlanda e ruajti pavarësinë në shekujt XIX-XX, duke iu përshtatur imperializmit evropian e japonez dhe ka shfaqur gjithë synimin për të bërë të njëjtën gjë edhe me Kinën, një prirje kjo që përforcohet prej kërcënimit të mundshëm për sigurinë që e sheh se i vjen nga Vietnamit.

Indonezia dhe Vietnami janë dy vendet e Azisë Juglindore, që priren më shumë nga baraspeshimi dhe frenimi i Kinës. Indonezia është një vend i madh mysliman dhe larg prej Kinës, por pa ndihmën e të tjerëve nuk mund ta pengojë Kinën që të vendosë kontrollin mbi Detin e Kinës Jugore. Në pranverë të vitit 1995 Indonezia e Australia u lidhën me një marrëveshje sigurie, sipas së cilës duhet të këshillohen njëra me tjetrën në rast se do të ketë “sfida armiqësore” ndaj sigurisë së tyre. Ndonëse të dyja palët e kanë mohuar që kjo ishte një marrëveshje antikineze, e kanë përcaktuar Kinën si burimin më të mundshëm për këto sfida armiqësore.³⁷ Vietnami ka një kulturë të gjerë konfuciane, por historikisht ka pasur marrëdhënie tepër antagoniste me Kinën dhe më 1979 bëri një luftë të shkurtër me Kinën. Si Vietnami, edhe Kina kanë mëtur për sovranitetin mbi gjithë Ishujt Papaline dhe flotat e tyre janë ndeshur me raste në vitet 1970 e 1980. Në fillim të viteve 1990 aftësitë ushtarake të Vietnamit pësuan rënie kundrejt atyre të Kinës. Rrjedhimisht, Vietnami ka më shumë arsye se cilido shtet tjetër i Azisë Lindore që të kërkojë partnerë për të baraspeshuar Kinën. Hyrja e tij në ASEAN dhe normalizimi i marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara më 1995 kanë qenë hapa në këtë drejtim. Porse përçarjet brenda ASEAN-it dhe ngurrimet e kësaj organizate për t'u ballafaquar me Kinën bëjnë që të mos ketë gjasa që ASEAN-i të kthehet në një aleancë antikineze, ose që do t'i japë ndonjë mbështetje të madhe Vietnamit në një ndeshje me Kinën. Shtetet e Bashkuara do të kishin më shumë dëshirë që ta përmbanin Kinën, porse në mesin e viteve 1990 nuk ishte e qartë, sesa larg do të shkonin për të kundërshtuar vendosjen e kontrollit të Kinës mbi Detin e Kinës Jugore. Përfundimisht, për Vietnamin “alternativa më pak e keqe” do të ishte që t'i përshtatej

Kinës dhe të pranonte finlandizimin, i cili ndonëse “do ta lëndonte krenarinë vietnameze ...mund t’i siguronte mbijetesën.”³⁸

Në vitet 1990 faktikisht të gjitha shtetet e Azisë Lindore, me përjashtim të Kinës e Koresë së Veriut, kanë shprehur mbështetje për vijimin e pranisë ushtarake të SHBA në rajon. Porse në praktikë, me përjashtim të Vietnamit, kanë prirje që t’i përshtaten Kinës. Filipinet i hoqën bazat ajrore e detare të SHBA, kurse në ishullin Okinava është shtuar kundërshtimi për praninë e madhe të forcave ushtarake të SHBA. Më 1994 Tajlanda, Malajzia dhe Indonezia i hodhën poshtë kërkesat e SHBA për qëndrimin e gjashtë anijeve furnizuese në ujërat e tyre si bazë lundruese për të lehtësuar ndërhyrjen ushtarake të SHBA në Azinë Juglindore ose Jugperëndimore. Një tjetër shfaqje mosrespektimi ka qenë pranimi i kërkesës së Kinës që të mos përfshihet çështja e Ishujve Papaline në rendin e ditës në mbledhjen e parë të Forumit Rajonal të ASEAN-it, kurse pushtimi nga ana e Kinës i Gumës së Keqe pranë brigjeve të Filipineve më 1995 nuk ngjalli protesta nga asnjë prej vendeve të tjera të ASEAN-it. Kur më 1995-1996 Kina gojarisht e ushtarakisht e kërcënoi Tajvanin, përsëri qeveritë aziatike u përgjigjën duke e bërë veshin të shurdhër. Animi i tyre për të ecur pas qerres është përmbledhur qartë nga Michael Oksenbergu: “Udhëheqësit aziatikë janë të shqetësuar, që baraspesha e fuqisë mund të zhvendoset në të mirë të Kinës, por duke i dalë përpara së ardhmes me ankth, ata nuk duan që të përballen me Pekinin sot” dhe “nuk do të bashkoheshin me Shtetet e Bashkuara për një kryqëzatë antikineze.”³⁹

Ngritja e Kinës do të përbëjë një sfidë të madhe për Japoninë, kurse japonezët do të jenë të përçarë thellë lidhur me strategjinë që do të duhet të ndjekë Japonia. A

duhet të bëjë përpjekje që t'i përshtatet Kinës, ndoshta duke bërë pazar për të njohur mbizotërimin politik-ushtarak të Kinës, në shkëmbim të njohjes së epërsisë së Japonisë në çështjet ekonomike? A do të orvatet t'i japë një kuptim të ri e fuqi të re aleancës japono-amerikane, si bërthama e një koalicioni për të baraspeshuar dhe përmbajtur Kinën? A do të përpiqet ta zhvillojë fuqinë e vet ushtarake për të mbrojtur interesat e saj kundër çfarëdo sulmi nga ana e Kinës? Ndoshta Japonia do ta shmangë sa më gjatë që të jetë e mundur përgjigjen e prerë kundrejt këtyre pyetjeve.

Bërthama e çfarëdo orvatjeje për ta baraspeshuar e përmbajtur Kinën do të jetë aleanca ushtarake amerikano-japoneze. Është e përfytyrueshme që pak nga pak Japonia do t'ia dalë mbanë ta riorientojë aleancën për këtë qëllim. Do të varet nga Japonia për të vepruar kështu, nëse do të ketë besim në: (1) aftësinë e përgjithshme amerikane për të mbajtur veten si e vetmja superfuqi e botës dhe për të ruajtur udhëheqjen aktive në punët e botës; (2) në angazhimin amerikan për ta ruajtur praninë e vet në Azi dhe për të luftuar gjallërisht kundër orvatjeve të Kinës për ta zgjeruar ndikimin e saj; dhe (3) në aftësinë e Shteteve të Bashkuara e të Japonisë për ta përmbajtur Kinën pa kosto të lartë, në kuptimin e burimeve ose të rreziqeve të mëdha nga pikëpamja e luftës.

Nëse Shtetet e Bashkuara nuk do të shfaqin vendosmëri më të madhe e që nuk ka gjasa për këto angazhime, ka të ngjarë që Japonia t'i përshtatet Kinës. Me përjashtim të viteve 1930 e 1940, kur ndoqi politikën e njëanshme për të pushtuar Azinë e Largët me pasoja shkatërrimtare, Japonia historikisht e ka kërkuar sigurinë, duke bërë aleancë me atë fuqi, të cilën e ka vështruar si mbisunduesen më me peshë. Madje edhe në vitet 1930, kur u bashkua me Boshtin, ishte rreshtuar me

atë që i dukej si forca ushtarake-ideologjike më dinamike në politikën globale. Në fillim të shekullit që sapo u mbyll ajo kishte hyrë plotësisht me vetëdije në aleancën anglo-japoneze, sepse Britania e Madhe ishte fuqia udhëheqëse në punët e botës. Po ashtu në vitet 1950 Japonia e lidhi veten me Shtetet e Bashkuara si vendi më i fuqishëm i botës dhe që mund t'i garantonte sigurinë Japonisë. Ashtu si kinezët, edhe japonezët e shohin politikën ndërkombëtare në mënyrë hierarkike, sepse edhe politika e tyre e brendshme është e tillë. Një studiues japonez ka vënë në dukje:

Kur japonezët mendojnë për kombin e tyre në shoqërinë ndërkombëtare, analogjitë shpesh i marrin nga modelet e brendshme të vendit. Japonezët arrijnë ta shohin rendin ndërkombëtar si shprehje të jashtme të modeleve kulturore, që shfaqen brenda shoqërisë japoneze, të cilën e karakterizon pesha e madhe e strukturave të organizuara vertikalisht. Një përfytyrim i tillë për rendin ndërkombëtar është nën ndikimin e përvojës së gjatë të Japonisë me marrëdhëniet paramoderne sino-japoneze (një sistem tributi).

Rrjedhimisht, qëndrimi japonez për aleancat ka qenë “në themel ecje pas qerres së më të fortit dhe jo baraspeshimi”, si dhe “rreshtimi me fuqinë mbisunduese.”⁴⁰ Një përfytyrim, që ka qëndruar për një kohë të gjatë atje, e ka pranuar se japonezët “më shpejt se shumica e të tjerëve përulen para *forcës madhore* dhe bashkëpunojnë me ata që i perceptojnë si moralisht eprorë...dhe janë më të shpejtët për ta ndier pakënaqësinë prej keqtrajtimit nga ana e hegjemonit moralisht të flashkët e në rënie.” Me rënien e rolit të SHBA në Azi dhe me daljen e Kinës si eprorë, politika japoneze do të bëjë përshtatjen përkatëse. E në të vërtetë ka nisur ta bëjë. Çështja kyç në marrëdhëniet

kino-japoneze, siç ka vënë në dukje Kishore Mahbubani, është “Kush është numri një?” Dhe përgjigjja ka nisur të bëhet e qartë. “Nuk do të ketë pohime të shprehura ose mirëkuptim, porse pati domethënie të veçantë fakti që perandori i Japonisë vendosi të shkonte për vizitë më 1992 në Kinë, në një periudhë kur Pekini ende ishte relativisht i izoluar nga ana ndërkombëtare.”⁴¹

Pa dyshim, duke e parë idealisht, udhëheqësit japonezë dhe populli do të parapëlqenin modelin e disa dhjetëvjeçarëve të kaluar dhe të mbeteshin nën krahun strehues të Shteteve të Bashkuara mbisunduese. Mirëpo, meqë ndërhyrja e SHBA në Azi është në rënie, forcat në Japoni që kërkojnë nga Japonia të “ri-aziatizohet”, do të marrin fuqi dhe japonezët më në fund do ta pranojnë si të pashmangshëm mbizotërimin e përtërirë të Kinës në skenën e Azisë Lindore. Për shembull, kur u pyetën më 1994, se cili komb do të kishte ndikimin më të madh në Azi në shekullin njëzet e një, 44 për qind të publikut japonez u shprehën për Kinën, 30 për qind për Shtetet e Bashkuara dhe vetëm 16 për qind përmendën Japoninë.⁴² Siç e kishte parashikuar një zyrtar i lartë japonez më 1995, Japonia do ta ketë “disiplinën” për t’iu përshtatur ngritjes së Kinës. Pas kësaj shtronte pyetjen, se a do ta bënin dot po këtë gjë Shtetet e Bashkuara. Pikënisja e tij fillestare është e besueshme; përgjigjja kundrejt pyejes së tij vijuese është e pasigurtë.

Hegjemonia e Kinës do ta pakësojë paqëndrueshmërinë dhe mundësinë e konfliktit në Azinë Lindore. Gjithashtu do ta zvogëlojë ndikimin e Perëndimit e do t’i detyrojë Shtetet e Bashkuara ta pranojnë diçka, që janë orvatur historikisht ta pengojnë: mbisundimin në një rajon kyç të botës prej një fuqie tjetër. Megjithatë, shkalla në të cilën kjo hegjemoni kërcënon interesat e këtij apo atij vendi tjetër aziatik ose Shtetet e Bashkuara, varet pjesërisht nga çfarë do të

ndodhë në Kinë. Rritja ekonomike sjell fuqinë ushtarake dhe ndikimin politik, por gjithashtu nxit zhvillimin politik dhe lëvizjen drejt një forme të politikës më të hapur, pluraliste dhe me gjasë demokratike. Tashmë këtë e ka treguar ndikimi në Korenë e Jugut dhe në Tajvan. Megjithatë, në të dy këto vende udhëheqësit që kanë qenë më të aktivë për përparimin e demokracisë, kanë qenë të krishterë.

Trashëgimia konfuciane e Kinës, e cila e vë theksin te autoriteti, rendi, hierarkia dhe epërsia e kolektivit mbi individin, krijon pengesa për demokratizimin. E megjithatë, rritja ekonomike në Kinën jugore po krijon nivele të larta pasurie që po rriten, një borgjezi dinamike, grumbullimin e fuqisë ekonomike jashtë kontrollit të shtetit dhe një klasë të mesme duke u zgjeruar me shpejtësi. Veç kësaj, kinezët janë përfshirë thellë në marrëdhëniet me botën e jashtme, domethënë me tregti, investime dhe arsimim. Që të gjitha këto krijojnë bazën shoqërore për lëvizjen drejt pluralizmit politik.

Parakushti për hapjen politike zakonisht është ardhja në fuqi e elementëve reformatorë brenda sistemit autoritar. A do të ndodhë kjo në Kinë? Ndoshta jo në periudhën e parë pas Tenit, por ka gjasë në të dytën. Shekulli i ri mund të jetë dëshmitar i krijimit në Kinën e jugut të grupeve me plane politike, që në fakt, ndonëse jo me emër, do të jenë parti politike në embrion dhe ka të ngjarë të vendosin lidhje të ngushta e të gjejnë mbështetje te kinezët e Tajvanit, Hong-Kongut e Singaporit. Nëse lëvizje të tilla do të dalin në Kinën e jugut dhe nëse fraksioni reformist do ta marrë pushtetin në Pekin, mund të gjejë vend ndonjë formë e tranzicionit politik. Demokratizimi ka mundësi t'u japë zemër politikanëve për të bërë thirrje nacionaliste dhe për t'i shtuar gjasat e luftës, ndonëse në vështrimin afatgjatë një sistem pluralist i qëndrueshëm në Kinë ka

të ngjarë që t'i lehtësojë marrëdhëniet e tij me fuqitë e tjera.

Ndoshta, siç është shprehur Fridbergu, e kaluara e Europës është e ardhmja e Azisë. Ka më shumë të ngjarë që e kaluara e Azisë të bëhet e ardhmja e Azisë. Zgjedhja që mund të bëjë Azia është ndërmjet fuqisë së baraspeshuar, duke paguar koston që do të sillte konfliktit, ose paqja e siguruar me koston e hegjemonisë. Shoqëritë Perëndimore mund të jenë për konfliktin dhe për baraspeshën. Historia, kultura dhe realitetet e fuqisë na bëjnë të kemi bindjen e fortë se Azia do të synojë për paqe e hegjemoni. Epoka që nisi me ndërhyrjet e Perëndimit në vitet 1840 dhe 1850 po merr fund, Kina po e rimerr vendin e saj si hegjemone e rajonit dhe Lindja po vjen në brazdën e vet.

Qytetërimet dhe shtetet bërthamë: rreshtimet që përftohen

Bota pas Luftës së ftohtë: shumëpolëshe, shumëqytetërimore, nuk e ka më atë ndarje mbisunduese, që ekzistonte gjatë Luftës së ftohtë. Megjithatë, për sa kohë të vazhdojnë hovi demografik mysliman dhe hapi ekonomik aziatik, konfliktet ndërmjet Perëndimit dhe qytetërimeve sfiduese do të zënë më tepër vendin qendror në politikën globale, sesa vijat e tjera të ndarjes. Qeveritë e vendeve myslimane ka gjasa ta vazhdojnë rrugën për të pasur qëndrim më pak miqësor kundrejt Perëndimit, ndërsa ndërmjet grupeve islamike dhe shoqërive Perëndimore do të ketë dhunë herë pas here me intensitet të vogël dhe ndonjëherë

ndoshta edhe me intensitet të lartë. Marrëdhëniet ndërmjet Shteteve të Bashkuara, nga njëra anë, dhe Kinës, Japonisë e vendeve të tjera aziatike, do të jenë konfliktuale në shkallë të lartë, kurse mund të shpërthejë një luftë e madhe, nëse Shtetet e Bashkuara do t'i kundërvihen rritjes së Kinës si fuqia hegjemoniste në Azi.

Në këto rrethana, lidhja konfuciane-islamike do të vazhdojë e ndoshta do të thellohet e do të zgjerohet. Pika qendrore për këtë lidhje ka qenë bashkëpunimi i shoqërive myslimane e sinike, duke iu kundërvënë Perëndimit për përhapjen e armëve, të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera. Në bërthamën e saj kanë qenë marrëdhëniet e ngushta ndërmjet Pakistanit, Iranit e Kinës, që u kristalizuan në fillim të viteve 1990 me vizitat e presidentit Jang Shangkun në Iran e në Pakistan dhe të presidentit Rafsanxhani në Pakistan e në Kinë. Këto “nxorën në pah lindjen e një aleance embrionale ndërmjet Pakistanit, Iranit e Kinës.” Rrugës për Kinë, në Islamabad Rafsanxhani deklaroi se ekzistonte një “aleancë strategjike” ndërmjet Iranit e Pakistanit, kurse një sulm kundër Pakistanit do të quhej sulm edhe kundër Iranit. Duke e përforcuar këtë model, Benazir Bhutoja bëri vizita në Iran e në Kinë menjëherë pasi u bë kryeministër në tetor 1993. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre tre vendeve është shoqëruar me shkëmbime të rregullta të zyrtarëve politikë, ushtarakë e burokratikë, si dhe me përpjekje të përbashkëta në një varg fushash ushtarake e civile, duke përfshirë prodhimet për mbrojtjen, krahas transferimeve të armëve nga Kina në shtetet e tjera. Zhvillimi i këtyre marrëdhënieve është mbështetur fort në Pakistan prej krahut që u përket shkollave të mendimit të “pavarësisë” dhe “myslimane” për politikën e jashtme, që e kishin syrin te një “bosht Teheran-Islamabad-Pekin”, ndërsa në Teheran ishte

shprehur mendimi se “natyra e dalluar e botës bashkëkohore” kërkon “bashkëpunimin e ngushtë e të qëndrueshëm” ndërmjet Iranit, Kinës, Pakistanit dhe Kazakistanit. Aty nga mesi i viteve 1990 kishte nisur të ekzistonte një farë aleance de facto ndërmjet tre vendeve, duke i pasur rrënjët te kundërshtimi i Perëndimit, te shqetësimet e sigurisë lidhur me Indinë dhe dëshira për t’iu kundërvënë ndikimit rus e turk në Azinë Qendrore.⁴³

A ka të ngjarë që këto shtete të bëhen bërthama e një grupimi më të gjerë, në të cilin do të përfshiheshin vende të tjera myslimane e aziatike? Siç ka argumentuar Graham Fulleri, një “aleancë konfuciane-islamiste” jo zyrtare “mund të materializohet jo sepse Muhameti dhe Konfuci kanë qenë antiperëndimorë, por sepse këto kultura japin një mjet për të shprehur pakënaqësitë, për të cilat pjesërisht fajësohet Perëndimi: Perëndimi, mbisundimi politik, ushtarak, ekonomik dhe kulturor i të cilit gjithnjë e më shumë ngjall shqetësime në një botë, ku shtetet e ndiejnë se ‘nuk duhet ta pranojnë më.’” Thirrja më e pasionuar për një bashkëpunim të tillë është bërë nga Muammar al Gedafi, i cili në mars 1994 ka deklaruar:

Rendi i ri botëror do të thotë që çifutët e të krishterët të sundojnë myslimanët dhe nëse do ta arrijnë, pas kësaj do të sundojnë konfucianizmin e fetë e tjera në Indi, Kinë e Japoni...

Ja çfarë thonë tashti të krishterët e çifutët: Ne ishim të vendosur për ta shkatërruar komunizmin dhe tashti Perëndimi duhet të shkatërrojë islamin e konfucianizmin. Ne shpresojmë të shohim sot një ballafaqim ndërmjet Kinës, që kryeson kampin konfucianist, dhe Amerikës që kryeson kampin e kryqëzatës së krishterë. Nuk kemi asnjë përlligje që të mos anojmë kundër kryqtarëve. Jemi përkrah konfucianizmit dhe duke lidhur aleancë me të e

duke luftuar përkrah tij në një front ndërkombëtar, do ta eliminojmë kundërshtarin tonë të përbashkët.

Prandaj ne, si myslimanë, do ta mbështesim Kinën në luftën e saj kundër armikut tonë të përbashkët....

I urojmë fitore Kinës....⁴⁴

Megjithatë, entuziazmi për një aleancë të ngushtë ndërmjet shteteve islamike e konfuciane është lënë në heshtje nga pala kineze, ndërsa presidenti Jiang Zemin më 1995 ka deklaruar, se Kina nuk do të krijojë aleancë me asnjë vend tjetër. Ndoshta ky qëndrim pasqyron pikëpamjen klasike kineze se, si Mbretëria e Mesme, si fuqia qendrore, Kina nuk kishte nevojë për aleatë zyrtarë dhe vendet e tjera do ta shihnin se ishte në interesin e tyre që të bashkëpunonin me Kinën. Nga ana tjetër, konfliktet e Kinës me Perëndimin do të sillnin që ajo ta vlerësonte partneritetin me shtetet e tjera anti-Perëndimore, ndër të cilat islami do t'i siguronte numrin më të madh dhe më me ndikim. Veç kësaj, nevojat në rritje të Kinës për naftë ka të ngjarë që ta detyrojnë t'i zgjerojë marrëdhëniet me Iranin, Irakun dhe Arabinë Saudite, si edhe me Kazakistanin e Azerbajxhanin. Një specialist i energjitikës më 1994 ka vërejtur se një bosht i tillë armë për naftë "më nuk do të ishte i detyruar të merrte urdhra nga Londra, Parisi ose Uashingtoni."⁴⁵

Do të ketë një larmi të madhe të marrëdhënieve të qytetërimeve të tjera e të shteteve të tyre bërthamë me Perëndimin dhe me sfiduesit e tij. Qytetërimet Jugore, Amerika Latine dhe Afrika, nuk kanë shtete bërthamë, kanë qenë të varura prej Perëndimit dhe janë relativisht të dobëta nga ana ushtarake e ekonomike (ndonëse kjo po ndryshon me shpejtësi për Amerikën Latine). Në marrëdhëniet me Perëndimin, ndoshta, ato do të ecin në drejtime të kundërta. Amerika Latine është afër me Perëndimin nga ana kulturore. Gjatë viteve 1980 e 1990

sistemet e saj politike dhe ekonomike gjithnjë e më shumë janë bërë më të ngjashme me ato të Perëndimit. Dy shtete të Amerikës Latine, që më parë ndiqnin politikën e prodhimit të armëve bërthamore, kanë hequr dorë nga ato përpjekje. Amerikanolatinët, që kanë nivelet më të ulëta të përpjekjeve të përgjithshme ushtarake në krahasim me cilindo qytetërim tjetër, mund të ndiejnë pakënaqësi nga mbisundimi ushtarak i Shteteve të Bashkuara, por nuk po shfaqin ndonjë synim për t'iu kundërvënë. Rritja e shpejtë e protestantizmit në shumë shoqëri të Amerikës Latine edhe po i bën më të ngjashme me shoqëritë e përziera katolike-protestante të Perëndimit, edhe po i zgjeron lidhjet fetare mes Amerikës Latine e Perëndimit përtej atyre, që kalojnë përmes Romës. Anasjelltas, vërshimi në Shtetet e Bashkuara i meksikanëve, amerikanoqendrorëve dhe karaibasve, si dhe ndikimi hispanik që vjen si rrjedhim mbi shoqërinë amerikane, gjithashtu i japin shtytje konvergjencës kulturore. Çështjet kryesore për konflikte ndërmjet Amerikës Latine e Perëndimit, i cili praktikisht do të thotë Shtetet e Bashkuara, janë imigrimi, droga dhe terrorizmi i lidhur me drogën, si dhe integrimi ekonomik (d.m.th. pranimi i shteteve të Amerikës Latine në NAFTA përballë zgjerimit të grupimeve të Amerikës Latine, si Mercosur dhe Pakti i Andeve). Siç e tregojnë problemet që u krijuan lidhur me hyrjen e Meksikës në NAFTA, martesat e qytetërimeve të Amerikës Latine dhe Perëndimore nuk do të jetë e lehtë, ndoshta do të marrë trajtë ngadalë gjatë pjesës më të madhe të shekullit XXI, e madje asnjëherë mund të mos konsumohet. E përsëri dallimet ndërmjet Perëndimit dhe Amerikës Latine mbeten të vogla, po të krahasohen me ato ndërmjet Perëndimit dhe qytetërimeve të tjera.

Marrëdhëniet e Perëndimit me Afrikën do të sjellin vetëm nivele pakëz më të larta konflikti, para së gjithash

sepse Afrika është shumë e dobët. Sidoqoftë, ka disa çështje me peshë. Ndryshe nga Brazili e Argjentina, Afrika e Jugut nuk hoqi dorë nga programi për të zhvilluar armët bërthamore; ajo i shkatërroi armët bërthamore që tashmë i kishte prodhuar. Ato armë ishin bërë nga një qeveri të bardhësh për të frenuar sulmet nga jashtë mbi aparteidin dhe ajo qeveri nuk dëshoi që t'ia linte trashëgim një qeverie zezakësh, e cila mund t'i përdorte për të tjera qëllime. Mirëpo aftësia për të ndërtuar armë bërthamore nuk mund të shkatërrohet dhe ka mundësi që qeveria pas aparteidit të ndërtojë një arsenal të ri armësh bërthamore, për të siguruar rolin e saj si shtet bërthamë i Afrikës dhe ta frenojë Perëndimin që të mos ndërhyjë në Afrikë. Ndërmjet Afrikës e Perëndimit gjithashtu janë në rend të ditës të drejtat e njeriut, imigrimi, çështjet ekonomike dhe terrorizmi. Me gjithë orvatjet e Francës për të mbajtur lidhje të ngushta me ish kolonitë e saj, duket se në Afrikë po zhvillohet një proces afatgjatë de-Perëndimorëzimi, interesat dhe ndikimi i fuqive të Perëndimit po tërhiqen, kultura vendëse po e ripohon veten, kurse Afrika e Jugut me kohë elementëve afrikanë në kulturën e saj po ua nënshtron elementët afrikanderë-anglezë. Ndërsa Amerika Latine po bëhet më shumë Perëndimore, Afrika po bëhet më pak. Megjithatë, të dy kontinentet vijojnë të mbeten nga anë të ndryshme të varura prej Perëndimit dhe, me përjashtim të votave në OKB, nuk janë në gjendje të ndikojnë në mënyrë vendimtare mbi baraspeshën ndërmjet Perëndimit e sfiduesve të tij.

Është e qartë se nuk po ndodh kështu me tre qytetërimet "luhatëse". Shtetet e tyre bërthamë janë aktorë të mëdhenj në punët e botës dhe ka gjasa që të kenë marrëdhënie të përziera, të dykuptimshme e të lëkundura me Perëndimin dhe me sfiduesit e tij. Edhe ato do të kenë marrëdhënie të ndryshueshme me njëri-

tjetrin. Siç e kemi trajtuar, me kalimin e kohës Japonia me ankth të madh e me dhimbje në shpirt ka të ngjarë që të zhvendoset duke u larguar prej Shteteve të Bashkuara dhe duke ecur në drejtim të Kinës. Ashtu si dhe aleancat e tjera transqytetërimore të kohës së Luftës së ftohtë, lidhjet e Japonisë me Shtetet e Bashkuara për sigurinë do të dobësohen, ndonëse ndoshta asnjëherë nuk do të prishen zyrtarisht. Marrëdhëniet e saj me Rusinë do të mbeten të vështira për aq kohë, sa Rusia nuk pranon kompromis për Ishujt Kurile, që i pushtoi më 1945. Momenti në fund të Luftës së ftohtë, kur kjo çështje mund të ishte zgjidhur, kaloi shpejt me ngritjen e nacionalizmit rus, kështu që nuk ka asnjë arsye për Shtetet e Bashkuara që në të ardhmen ta mbështesin mëtimin e Japonisë, siç kanë bërë në të kaluarën.

Në dhjetëvjeçarët e fundit të Luftës së ftohtë, Kina e lajti me dobi “kartën kineze” kundër Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara. Në botën pas Luftës së ftohtë është Rusia që ka një “kartë ruse” për ta lajtur. Po të bashkohen Rusia dhe Kina, pa dyshim, do ta anonin peshoren euroaziatike kundër Perëndimit dhe do të ngjallnin gjithë shqetësimet, që kanë ekzistuar lidhur me marrëdhëniet kino-sovjetike në vitet 1950. Një Rusi që do të bashkëpunonte ngushtë me Perëndimin, do të sillte një kundërpeshim shtojcë ndaj lidhjes konfuciane-islamike për çështjet globale dhe do ta rizgjonte në Kinë frikën e kohës së Luftës së ftohtë për një sulm nga veriu. Porse Rusia ka edhe probleme me këto dy qytetërimet fqinje. Lidhur me Perëndimin, ato duket se janë me afate të shkurtra; janë pasojë e përfundimit të Luftës së ftohtë dhe e nevojës për ripërcaktimin e baraspeshës ndërmjet Rosisë e Perëndimit, si dhe për marrëveshjen midis dy palëve lidhur me barazinë e tyre themelore e me sferat përkatëse të ndikimit. Në praktikë kjo do të thoshte:

1. Pranimi nga Rusia i zgjerimit të Bashkimit Europian dhe i NATO-s, për të përfshirë shtetet Perëndimore të krishtera të Europës Qendrore e Lindore, si dhe zotimin e Perëndimit për të mos e zgjeruar NATO-n më tej, veç nëse Ukraina ndahet në dy vende;

2. një traktat partneriteti ndërmjet Ruisë e NATO-s që do të vendoste mosulmimin, këshillime të rregullta për çështjet e sigurisë, përpjekje bashkëpunimi për të shmangur garën e armatimeve dhe bisedime për marrëveshjet e kontrollit mbi armët në përputhje me nevojat e tyre të sigurisë pas Luftës së ftohtë;

3. njohja nga Perëndimi e Ruisë si përgjegjësjë e parë për garantimin e sigurisë mes vendeve ortodokse dhe në zonat ku mbizotëron ortodoksia;

4. pranimi nga Perëndimi i problemeve të sigurisë, të sotme e të mundshme, me të cilat ballafaqohet Rusia prej popujve myslimanë nga jugu i saj, si dhe gatishmëria për ta rishikuar traktatin e CFE dhe për të mbajtur qëndrim miratues kundrejt hapave të tjerë që mund të ketë nevoja Rusia të ndërmarrë për të përballuar këto kërcënime;

5. marrëveshje ndërmjet Ruisë e Perëndimit për të bashkëpunuar si të barabartë në trajtimin e çështjeve të tilla, si Bosnja, duke përfshirë së bashku interesat e Perëndimit dhe të ortodoksisë.

Nëse do të arrihej një rregullim sipas këtyre vijave ose të tjerave të ngjashme me to, as Rusia dhe as Perëndimi nuk ka të ngjarë që të përbëjnë ndonjë kërcënim afatgjatë për sigurinë kundrejt njëri-tjetrit. Nga ana demografike Europa dhe Rusia janë shoqëri të pjekura, me lindshmëri të ulët dhe me popullsi që po

plaket; shoqëri të tilla nuk e kanë vrullin rinor për të pasur orientim ekspansionist e ofensiv.

Në periudhën menjëherë pas Luftës së ftohtë marrëdhëniet ruso-kineze u bënë ndjeshëm më bashkëpunuese. U zgjidhën mosmarrëveshjet kufitare; forcat ushtarake nga të dyja palët u pakësuan; u zgjerua tregtia; secila anë hoqi dorë nga drejtimi i raketave bërthamore kundër objektivave të njëra-tjetrës, kurse ministrat e jashtëm shqyrtuan interesat e përbashkët në luftën kundër islamit fundamentalist. Ajo që ka më shumë rëndësi, është se Rusia gjeti te Kina një klient të rëndësishëm e të etur për pajisjet e teknologjinë ushtarake, duke përfshirë tanke, avionë gjuajtës, bombardues me rreze të gjatë dhe raketa tokë-ajër.⁴⁶ Nga pikëpamja ruse, kjo ngrohje e marrëdhënieve përbënte edhe një vendim të vetëdijshëm për të punuar me Kinën si “partnerin” e saj aziatik, në rrethanat e ftohtësisë së pandryshuar të marrëdhënieve me Japoninë, edhe një reagim ndaj konflikteve me Perëndimin lidhur me zgjerimin e NATO-s, reformën ekonomike, kontrollin e armëve, ndihmën ekonomike dhe anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare Perëndimore. Nga ana e saj, Kina që në gjendje t’i tregonte Perëndimit, se nuk ishte e vetmuar në botë dhe mund t’i gjente potencialet e nevojshme ushtarake për të zbatuar strategjinë e saj drejt fuqisë rajonale. Për të dy vendet një lidhje ruso-kineze, ashtu si lidhja konfuciano-islamike, është mjet për të kundërshtuar fuqinë dhe universalizmin Perëndimor.

A do të vijojë në afat të gjatë kjo lidhje, varet shumë së pari, nga shkalla në të cilën marrëdhëniet e Rosisë me Perëndimin do të stabilizohen mbi një bazë të kënaqshme për të dyja palët, dhe së dyti, nga shkalla në të cilën ngritja e Kinës si fuqi hegjemone në Azinë Lindore do t’i kërcënojë interesat e Rosisë nga ana ekonomike, demografike e ushtarake. Dinamizmi

ekonomik i Kinës është derdhur edhe në Siberi dhe kinezët, krahas biznesmenëve koreanë e japonezë, po hetojnë dhe po shfrytëzojnë mundësitë që dalin atje. Rusët e Siberisë gjithnjë e më shumë po e shohin të ardhmen e tyre ekonomike të lidhur me Azinë Lindore e jo me Rusinë europiane. Për Rusinë paraqet rrezik më të madh imigrimi i kinezëve në Siberi, me emigrantë kinezë që thuhet se kishin arritur më 1995 nga tre deri në pesë milionë, krahasuar me popullsinë ruse në Siberinë Lindore që vete deri te 7 milionë. Ministri rus i mbrojtjes, Pavël Graçovi ka paralajmëruar: “Kinezët janë duke bërë një pushtim paqësor të Lindjes së largët ruse.” Zyrтари më i lartë rus për imigrimin u ka bërë jehonë fjalëve të tij, kur tha: “Ne duhet ta kundërshtojmë ekspansionizmin kinez.”⁴⁷ Veç kësaj, zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike të Kinës me republikat e mëparshme sovjetike të Azisë Qendrore mund t’i acarojë marrëdhëniet me Rusinë. Ekspansioni kinez mund të shndërrohet në ushtarak, nëse Kina do të vendoste se duhej të bënte një orvatje për të marrë Mongolinë, të cilën rusët ia shkëputën Kinës pas Luftës I Botërore dhe që për disa dhjetëvjeçarë ka qenë satelit sovjetik. Në një moment të caktuar “hordhitë e verdha”, që e kanë munduar imagjinatën e rusëve prej kohëve të pushtimit mongol, mund të bëhen përsëri realitet.

Marrëdhëniet e Rusisë me islamin e kanë marrë trajtën prej trashëgimisë historike të disa shekujve zgjerimi me anë të luftërave kundër turqve, popujve të Kaukazit verior dhe emirateve të Azisë Qendrore. Sot Rusia bashkëpunon me aleatët ortodoksë: Serbinë e Greqinë, për të kundërshtuar ndikimin turk në Ballkan, si dhe me aleatin e saj ortodoks, Armeninë, për ta kufizuar këtë ndikim në Transkaukaz. Ajo ka bërë orvatje aktive që ta ruajë ndikimin e vet politik, ekonomik e ushtarak mbi republikat e Azisë Qendrore, i

ka përfshirë ato në Bashkësinë e Shteteve të Pavarura dhe në të gjitha ka vendosur forca ushtarake. Për preokupimin rus vendin qendror e zënë rezervat e naftës e të gazit në Detin Kaspik dhe rrugët përmes të cilave këto burime do të kalojnë për në Perëndim e në Azinë Lindore. Gjithashtu Rusia po bën luftë në Kaukazin Verior kundër popullit mysliman të Çeçenisë dhe një luftë të dytë në Tashkistan, ku mbështet qeverinë kundër një lëvizjeje kryengritëse, që përfshin fundamentalistë islamikë. Këto shqetësime për sigurinë sjellin një shtysë tjetër për bashkëpunim me Kinën, që të përmbahet “kërcënimi islamik” në Azinë Qendrore, dhe janë gjithashtu një arsye madhore për afrimin e Rusisë me Iranin. Rusia i ka shitur Iranit nëndetëse, avionë gjuajtës të sofistikuar, gjuajtës-bombardues, raketa tokë-ajër dhe pajisje elektronike luftarake e zbulimi. Veç kësaj, Rusia ka pranuar që të ndërtojë reaktorë bërthamorë me ujë të lehtë në Iran dhe ta furnizojë Iranin me pajisje për pasurimin e uraniumit. Nga ana e vet, Rusia e ka shprehur qartë se pret nga Irani që ta kufizojë përhapjen e fundamentalizmit në Azinë Qendrore dhe ka lënë të nënkuptohet se do të bashkëpunojë për të përballuar përhapjen e ndikimit turk atje e në Kaukaz. Në dhjetëvjeçarët e ardhshëm marrëdhëniet e Rusisë me islamin në mënyrë të prerë do të përcaktohen prej perceptimit lidhur me rreziqet që i vijnë nga shpërthimi i popullsisë myslimane përgjatë periferisë së saj jugore.

Gjatë Luftës së ftohtë India, i treti shtet bërthamë “luhatës”, ka qenë aleat i Bashkimit Sovjetik dhe ka bërë një luftë me Kinën e disa me Pakistanin. Marrëdhëniet e saj me Perëndimin, në veçanti me Shtetet e Bashkuara, kur nuk kanë qenë të acaruar, kanë qenë të larguara. Në botën pas Luftës së ftohtë marrëdhëniet e Indisë me Pakistanin ka të ngjarë të mbeten mjaft konfliktuale

lidhur me Kashmirin, armët bërthamore dhe përgjithësisht për baraspeshën ushtarake në Nënkontinent. Në atë shkallë që Pakistani do të jetë në gjendje të fitojë mbështetjen e vendeve të tjera myslimane, edhe marrëdhëniet e Indisë me islamin përgjithësisht do të jenë të vështira. Për t'i bërë ballë kësaj, ka të ngjarë që India të bëjë përpjekje të posaçme, siç i ka bërë në të kaluarën, që të bindë vende të veçanta myslimane të distancohen prej Pakistanit. Me mbarimin e Luftës së ftohtë, përpjekjet e Kinës për të vendosur marrëdhënie më miqësore me fqinjët u shtrinë edhe për Indinë, kështu që tensioni ndërmjet dy vendeve u zbut. Mirëpo kjo prirje nuk ka të ngjarë që të vazhdojë për shumë kohë. Kina është përfshirë gjallërisht në politikën e Azisë Jugore dhe besohet se do të vazhdojë të ecë në këtë drejtim: do të mbajë marrëdhënie të ngushta me Pakistanin, do t'i forcojë aftësitë ushtarake të Pakistanit me armë konvencionale e bërthamore dhe do t'i vardiset Mianmarit me ndihmë ekonomike, me investime e ndihmë ushtarake, e po të jetë e mundur, do të zhvillojë forcat detare atje. Fuqia e Kinës është duke u zgjeruar tani për tani; fuqia e Indisë mund të rritet ndjeshëm në vitet e para të shekullit XXI. Duket mjaft i mundshëm një konflikt. "Rivaliteti i nëndheshëm për fuqi ndërmjet dy gjigantëve aziatikë dhe vetëpërfytyrimi i tyre si fuqi të mëdha të natyrshme e qendra të qytetërimit e të kulturës," ka vënë në dukje një analist, "do të vazhdojë t'i shtyjë për të mbështetur vende dhe kauza të ndryshme. India do të orvatet të dalë përsipër jo vetëm si një qendër e pavarur fuqie në botën shumëpolëshe, por edhe si kundërpeshë ndaj fuqisë e ndikimit të Kinës."⁴⁸


Duke u ballafaquar me një aleancë kino-pakistaneze, në mos po me një lidhje më të gjerë konfuciane-islamike, është e qartë se India do të jetë e interesuar të ruajë

marrëdhënie të ngushta me Rusinë e të mbetet blerësi më i madh i pajisjeve ushtarake ruse. Në mes të viteve 1990 India ka qenë duke marrë prej Rosisë pothuaj gjithë tipat kryesorë të armëve, duke përfshirë një aeroplanmbajtëse dhe teknologjinë e raketave me të ftohtë, gjë që solli vendosjen e sanksioneve nga ana e SHBA. Përveç përhapjes së armëve, ndër çështjet e tjera midis SHBA dhe Indisë kanë qenë të drejtat e njeriut, Kashmiri dhe liberalizimi ekonomik. Megjithatë, me kalimin e kohës ftohja e marrëdhënieve SHBA-Pakistan dhe interesat e tyre të përbashkët për ta frenuar Kinën ka të ngjarë që t'i afrojnë më shumë Indinë dhe Shtetet e Bashkuara. Zgjerimi i fuqisë së Indisë në Azinë Jugore nuk mund t'i dëmtojë interesat e SHBA dhe madje mund t'u shërbejë atyre.

Marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve e shteteve të tyre bërthamë janë të ndërlikuara, shpesh të dykuptimshme, dhe pësojnë ndryshime. Shumica e vendeve në njërin prej qytetërimeve përgjithësisht do të ndjekin udhëheqjen e shtetit bërthamë për të përcaktuar marrëdhëniet e tyre me vendet e një qytetërimi tjetër. Por nuk do të ndodhë kurdoherë kështu dhe është e qartë, se jo të gjitha vendet e një qytetërimi kanë marrëdhënie të njëjta me të gjitha vendet e një qytetërimi të dytë. Interesat e përbashkët, zakonisht një armik i përbashkët prej një qytetërimi të tretë, mund të përftojë bashkëpunimin ndërmjet vendeve prej qytetërimesh të ndryshme. Është e qartë, që konflikte ndodhin edhe brenda qytetërimeve, veçanërisht brenda islamit. Veç kësaj, marrëdhëniet ndërmjet grupeve përgjatë vijave të shkëputjes mund të kenë dallime të ndjeshme nga marrëdhëniet ndërmjet shteteve bërthamë të po atij qytetërimi. E megjithatë, prirjet në vija të trasha janë të dukshme dhe mund të bëhen përgjithësime të pranueshme, se cilat shihet që janë rreshtimet e

antagonizmat duke u përftuar mes qytetërimeve dhe shteteve bërthamë. Këto janë përmbledhur në Figurën 9.1. Dypolariteti relativisht i thjeshtë i Luftës së ftohtë po ua lë vendin marrëdhënieve shumë më të ndërlikuara të botës shumëpolëshe, shumëqytetërimore.

Figura 9.1:
Politika globale e qytetërimeve: rreshtimet që po përftohen



Kreu 10: Nga luftërat e tranzicionit te luftërat në vijën e shkëputjes

Luftërat e tranzicionit: afganistani dhe gjiri

Studiuesi i shquar maroken, Mahdi Elmanxhra, Luftën e Gjirit, për mënyrën sesi u zhvillua, e ka quajtur “*Lufta e parë qytetërimore*”.¹ Në të vërtetë, ajo ka qenë e dyta. E para ka qenë Lufta sovjeta-afgane më 1979-1989. Që të dyja këto luftëra nisën si pushtime të drejtpërdrejta të një vendi nga një tjetër, por u shndërruan në luftëra qytetërimore dhe në pjesën më të madhe u ripërcaktuan si të tilla. Në fakt, qenë luftëra tranzicioni drejt një epoke, në të cilën mbizotërojnë konflikti etnik dhe luftërat e vijës së shkëputjes ndërmjet grupeve prej qytetërimesh të ndryshme.

Lufta e Afganistanit nisi si orvatje e Bashkimit Sovjetik për të mbështetur një regjim satelit. Ajo u bë luftë e Luftës së ftohtë, kur Shtetet e Bashkuara reagueshëm dhe i organizuan, u dhanë fonde e i pajisën kryengritësit afganë për t’u bërë qëndresë forcave ruse. Për amerikanët, thyerja e sovjetikëve do të ishte për ligjë e doktrinës së Reganit për të përkrahur qëndresën e armatosur kundër regjimeve komuniste dhe për të arritur

një poshtërim të sovjetikëve, të krahasueshëm me atë që pësuan Shtetet e Bashkuara në Vietnam. Do të ishte gjithashtu një disfatë, degëzimet e së cilës do të përhapeshin në gjithë shoqërinë sovjetike e në ngrehinën e saj politike, duke dhënë ndihmesë të ndjeshme për shpërbërjen e perandorisë sovjetike. Për amerikanët dhe përgjithësisht për Perëndimorët, Afganistani ishte fitorja përfundimtare, vendimtare, Waterlooja e Luftës së ftohtë.

Mirëpo për ata që luftonin kundër sovjetikëve, Lufta e Afganistanit qe diçka tjetër. Ajo ishte “e para qëndresë me sukses kundër një fuqie të huaj,” siç ka vërejtur një studiues Perëndimor,² “e cila nuk mbështetej as në parime nacionaliste e as në socialiste”, por në vend të tyre mbështetej në parime islamike, dhe u zhvillua si xhihad, duke i dhënë një mbështetje të jashtëzakonshme vetëbesimit e fuqisë islamike. Në të vërtetë, ndikimi i saj në botën islamike ka qenë i krahasueshëm me ndikimin që pati mbi botën Orientale thyerja e Rusisë nga japonezët më 1905. Atë që Perëndimi e sheh si fitore për Botën e Lirë, myslimanët e shohin se fitore të islamit.

Dollarët dhe raketat amerikane ishin të domosdoshme për t'i thyer sovjetikët. Megjithatë, po ashtu ishte e domosdoshme përpjekja kolektive e islamit, në të cilën hynë në garë njëra me tjetrën një varg qeverish e grupimesh të ndryshme, duke u orvatur t'i mundnin sovjetikët dhe të kornin një fitore, që do t'u shërbente interesave të tyre. Mbështetja financiare myslimane për luftën u dha kryesisht prej Arabisë Saudite. Ndërmjet viteve 1984 e 1986 sauditët dhanë 525 milionë dollarë për qëndresën; më 1989 pranuan që të jepnin 61 për qind të shumës së përgjithshme prej 715 milionësh, ose 436 milionë dollarë, ndërsa pjesa që mbetet vinte nga Shtetet e Bashkuara. Më 1993 ata dhanë 193 milionë dollarë për qeverinë afgane. Shuma e përgjithshme që dhanë gjatë luftës ka qenë të paktën po

aq e madhe e ndoshta edhe më shumë se 3 miliardë deri 3,3 miliardë dollarë, që shpenzuan Shtetet e Bashkuara. Gjatë luftës rreth 25.000 vullnetarë nga vendet e tjera myslimane, kryesisht arabe, morën pjesë në këtë luftë. Këta vullnetarë, të rekrutuar në pjesën më të madhe në Jordani, u stërvitën nga agjencia e Shërbimeve të Brendshme të Zbulimit të Pakistanit. Gjithashtu Pakistani ofroi bazën e jashtme të domosdoshme për qëndresën, si dhe mbështetjen tjetër e logjistike. Veç kësaj, Pakistani që agjenti dhe ndërmjetësi për marrjen e parave amerikane e qëllimisht 75 për qind të këtyre fondeve i përcolli te grupet islamiste më fundamentaliste. Kështu, 50 për qind e gjithë shumës i kaloi fraksionit më ekstremist suni fundamentalist, të udhëhequr prej Gulbudin Hekmatjarit. Ndonëse luftonin kundër sovjetikëve, pjesëmarrësit arabë në luftë në pjesën dërrmuese ishin anti-Perëndimore dhe i kanë denoncuar agjencitë e ndihmës humanitare Perëndimore si të pamoralshme e subversive kundër islamit. Si përfundim, sovjetikët u thyen nga tre faktorë, me të cilët nuk mund të barazoheshin efektivisht dhe as mund t'u bënin ballë: me teknologjinë amerikane, me paratë saudite dhe me zellin e demografisë myslimane.³

Lufta la pas një koalicion të vështirë organizatash islamiste, që synonin të përkrahnin islamin kundër gjithë forcave jomyslimane. Ajo gjithashtu la si trashëgimi luftëtarë të specializuar e me përvojë, kampe, fusha stërvitjeje dhe pajisje logjistike, rrjete të përgatitura tejslamike me marrëdhënie personale e organizative, një sasi të madhe pajisjesh ushtarake, ndër to 300 deri 500 raketa Sting që nuk dihet kush i ka, dhe ajo që është më e rëndësishmja, një ndjenjë mujshare fuqie dhe vetëbesimi për atë që ishte arritur, si dhe një dëshirë nxitëse për të ecur drejt fitoreve të tjera. Një zyrtar i SHBA më 1994 ka thënë se “vërtetimet fetare e politike

të xhihadit” të vullnetarëve në Afganistan “janë të panjolla. Ata mposhtën një nga dy superfuqitë e botës dhe tashti po punojnë për të dytën.”⁴

Lufta e Afganistanit u kthye në luftë qytetërimore, sepse kudo myslimanët e panë pikërisht si të tillë dhe u bashkuan kundër Bashkimit Sovjetik. Lufta e Gjirit u kthye në luftë qytetërimore, sepse Perëndimi ndërhyri ushtarakisht në një konflikt mysliman, Perëndimorët në pjesën dërrmuese e mbështetën atë ndërhyrje, kurse myslimanët në mbarë botën erdhën te mendimi se ajo ndërhyrje ishte një luftë kundër tyre dhe u bashkuan kundër atyre, të cilëve i shinin si një ose disa shembuj të imperializmit Perëndimor.

Qeveritë arabe e myslimane në fillim ishin të përcara lidhur me këtë luftë. Sadam Huseini kishte shkelur shenjtërinë e kufijve dhe në gusht 1990 Lidhja Arabe votoi me një shumicë të dukshme (katërmbëdhjetë pro, dy kundër, pesë abstenime ose që nuk morën pjesë në votim) për ta dënuar veprimin e tij. Egjipti dhe Siria pranuan të jepnin ndihmesë me një numër të madh trupash, kurse Pakistani, Maroku dhe Bangladeshi me një numër më të vogël për koalicionin kundër Irakut, të organizuar prej Shteteve të Bashkuara. Turqia e mbylli naftësjellësin që kalon përmes territorit të saj nga Iraku deri në Detin Mesdhe, si dhe i lejoi koalicionit të përdorte bazat e saj ajrore. Si shkëmbim për këto veprime, Turqia i forcoi mëtimet për të hyrë në Europë; Pakistani dhe Maroku ripohuan marrëdhëniet e tyre të ngushta me Arabinë Saudite; Egjipti fitoi faljen e borxheve dhe Siria mori Libanin. Përkundrazi, qeveritë e Iranit, Jordanisë, Libisë, Mauritanisë, Jemenit, Sudanit dhe Tunizisë, si dhe organizata të tilla, si OÇP-ja, Hamasi e FIS-i, ndonëse kishin marrë mbështetje financiare prej Arabisë Saudite, e mbështetën Irakun dhe e dënuan ndërhyrjen Perëndimore. Qeveri të tjera

muslimane, si e Indonezisë, mbajtën qëndrim kompromisi ose u orvatën të mos mbanin asnjë lloj qëndrimi.

Ndërsa në fillim qeveritë muslimane ishin të përçara, opinioni arab dhe musliman ishte që në fillim kundër Perëndimit në shumicë dërrmuese. “Bota arabe”, ka njoftuar një vëzhgues amerikan, pasi kishte bërë vizita në Jemen, Siri, Egjipt, Jordani e Arabinë Saudite, tri javë pas pushtimit të Kuvajtit, “...po zien nga zemërimi kundër SHBA, që zor se janë në gjendje të ruajnë shkëlqimin përballë perspektivës së një udhëheqësi arab, që ka guximin të sfidojë fuqinë më të madhe mbi tokë.”⁵ Miliona muslimanë që nga Maroku e deri në Kinë i shtrënguan radhët prapa Sadam Huseinit dhe “e brohoritën si hero musliman.”⁶ Paradoksi i demokracisë ishte “paradoksi i madh i këtij konflikti”: mbështetja për Sadam Huseinin ishte “më e përhapur dhe më e zjarrtë” pikërisht në ato vende arabe, ku politika ishte më e hapur dhe liria e fjalës më pak e kufizuar.⁷ Në Marok, Pakistan, Jordani, Indonezi e në vende të tjera demonstratat masive denoncuan Perëndimin e udhëheqësit politikë, si mbretin Hasan, Benazir Bhuton dhe Suharton, të cilët u quajtën shërbëtorë të Perëndimit. Madje në sipërfaqe doli kundërshtimi ndaj koalicionit edhe në Siri, ku “një spektër i gjerë qytetarësh e kundërshtoi praninë e forcave të huaja në Gji.” Shtatëdhjetë e pesë për qind të 100 milionë muslimanëve të Indisë i dënuan Shtetet e Bashkuara për këtë luftë, kurse 171 milionë muslimanët e Indonezisë “pothuaj tërësisht” ishin kundër ndërhyrjes ushtarake të SHBA në Gji. Intelektualët arabë u rreshtuan në të njëjtën mënyrë dhe formuluan arsyetime të ndërlikuara për ta kapërcyer egërsinë e Sadamit dhe për të denoncuar ndërhyrjen e Perëndimit.⁸

Përgjithësisht arabët dhe myslimanët e tjerë ishin të një mendjeje se Sadami mund të ishte tiran i përgjakur, por duke hequr paralele me të menduarit e FDR-së, u shprehën se “ai është tirani ynë i përgjakshëm”. Sipas pikëpamjes së tyre, pushtimi ishte një punë brenda familjes, që do të rregullohej brenda familjes dhe ata që ndërhyjnë në emër të ndonjë teorie të madhe për drejtësinë ndërkombëtare, po e bënin këtë për të mbrojtur interesat e vet egoistë dhe për t’i mbajtur arabët të nënshtroar prej Perëndimit. Siç e ka treguar një studim, intelektualët arabë “e përbuzin regjimin e Irakut dhe e dënojnë egërsinë e despotizmin e tij, por e vështrojnë se përbën një qendër të qëndresës kundër armikut të madh të botës arabe, Perëndimit.” Ata “e përcaktojnë botën arabe në kundërshtim me Perëndimin.” “Ajo që bëri Sadami është e gabuar,” ka thënë një profesor palestinas, “por ne nuk mund ta dënojmë Irakun, sepse i kundërvihet ndërhyrjes ushtarake Perëndimore.” Myslimanët në Perëndim e gjetkë e denoncuan praninë e trupave jomyslimane në Arabinë Saudite dhe “përdhosjen” e vendeve të shenjta myslimane.⁹ Shkurt, pikëpamja mbizotëruese që kjo: Sadami bëri gabim që pushtoi, Perëndimi bëri gabim më të madh që ndërhyri. Rrjedhimisht, Sadami ka të drejtë të luftojë kundër Perëndimit dhe ne kemi të drejtë ta mbështesim.

Ashtu si pjesëmarrësit parësorë në luftërat e tjera në vijën e shkëputjes, edhe Sadam Huseini e njëjtësonte regjimin e tij të mëparshëm shekullar me kauzën, që do të kishte forcën më të madhe tërheqëse: islamin. Meqë identitetet në botën arabe kishin trajtën e shkronjës U, Sadami nuk kishte ndonjë alternativë reale. Siç e ka vënë re një komentator egjiptian, kjo zgjedhje që duhej të bënte islami ose me nacionalizmin arab, ose me anti-Perëndimorizmin e Botës së Tretë, “dëshmon për vlerat

e islamit si ideologji politike për të mobilizuar mbështetjen rreth vetes.”¹⁰ Ndonëse Arabia Saudite është më e rreptë në praktikimin e myslimanizmit, sesa shtetet e tjera myslimane, ndoshta me përjashtim të Iranit e të Sudanit, dhe ndonëse kishte financuar grupet islamiste në mbarë botën, asnjë lëvizje në çfarëdo vendi nuk e mbështeti koalicionin Perëndimor kundër Irakut dhe në fakt të gjithë e kundërshtuan ndërhyrjen e Perëndimit.

Për myslimanët kështu pas pak kohësh kjo luftë u bë një luftë ndërmjet qytetërimeve, në të cilën çështja ishte për paprekshmërinë e islamit. Grupet islamiste fundamentaliste që nga Egjipti, Siria, Jordania, Pakistani, Malajzia, Afganistani, Sudani e gjetkë, e denoncuan si luftë kundër “islamit dhe qytetërimit të tij” nga ana e një aleance “kryqtarësh e zionistësh” dhe shpallën mbështetjen e Irakut përballë “agresionit ushtarak dhe ekonomik kundër popullit të tij.” Në vjeshtën e vitit 1990 dekani i Kolegjit Islamik në Mekë, Safar al-Havali, në një kasetë që qarkulloi gjerësisht në Arabinë Saudite, kishte deklaruar se lufta “nuk bëhet nga bota kundër Irakut. Është Perëndimi kundër islamit”. Me shprehje të ngjashme, mbreti Husein i Jordanisë ka argumentuar se që “një luftë kundër gjithë arabëve dhe gjithë myslimanëve e jo kundër Irakut vetëm”. Veç këtyre, siç e ka vënë në dukje Fatima Mernisi, thirrjet e shpeshta retorike që presidenti Bush i drejtonte Zotit në emër të Shteteve të Bashkuara, e përforcuan perceptimin nga ana e arabëve se ajo ishte “një luftë e shenjtë”, ndërsa thëniet e Bushit binin erë si “sulmet mercenare të llogaritura të hordhive paraislamike të shekullit të shtatë dhe të kryqëzatave të mëvonshme të krishtera.” Nga ana e tyre, argumentimet se lufta ishte një kryqëzatë, e përgatitur nga komploti Perëndimor dhe zionist, e

përligjte madje edhe mobilizimin e kërkuar për një xhihad si përgjigje kundër kësaj luftime.¹¹

Përcaktimi i myslimanëve për këtë luftë si Perëndimi kundër islamit e lehtësoi pakësimin ose pezullimin e antagonizmave brenda botës myslimane. Dallimet e vjetra mes myslimanëve u rrëgjuan nga rëndësia në krahasim me dallimet mbizotëruese mes islamit e Perëndimit. Gjatë luftës qeveritë dhe grupet myslimane ecën si një lëvizje e vazhdueshme largimi prej Perëndimit. Ashtu si paraardhësja e saj afgane, Lufta e Gjirit i bashkoi myslimanët, që më parë shpesh i ngulnin thonjtë në fyt njëri-tjetrit: shekullaristët, nacionalistët dhe fundamentalistët arabë; qeverinë e Jordanisë dhe palestinasit; OÇP-në dhe Hamasin; Iranin dhe Irakun; partitë e opozitës dhe qeveritë përgjithësisht. Siç e ka thënë Safar al-Havali, “Ata baathistët e Irakut janë armiq të tanë për disa orë, kurse Roma është armikja jonë deri në ditën e kiametit.”¹² Lufta gjithashtu vuri në udhë një proces pajtimi ndërmjet Irakut e Iranit. Udhëheqësit shiitë të Iranit e dënuan ndërhyrjen e Perëndimit dhe bënë thirrje për xhihad kundër Perëndimit. Qeveria iraniane u distanca nga masat e drejtuara kundër armikut të saj të mëparshëm dhe lufta u pasua nga përmirësimi gradual i marrëdhënieve ndërmjet dy regjimeve.

Një armik i jashtëm gjithashtu e pakëson gjendjen e konfliktit brenda vendit. Në janar 1991, për shembull, është njoftuar se Pakistani “u përmyt nga polemikat anti-Perëndimore”, të cilat, të paktën për një kohë të shkurtër, e bashkuan këtë vend. “Pakistani asnjëherë tjetër nuk ka qenë kaq i bashkuar. Në provincën jugore të Sindit, ku prej pesë vjetësh vendësit sindi dhe emigrantët nga India po vriteshin me njëri-tjetrin, pati njerëz nga të dyja palët që dolën krah për krah në demonstrata kundër amerikanëve. Në zonat e fiseve

ultrakonservatore të Kufirit Veriperëndimor madje edhe gratë dolën në rrugë për të protestuar, shpesh në vende ku kurrë nuk ishin mbledhur njerëz për asgjë tjetër, veç lutjeve të së premtës.”¹³

Me kohë publiku u bë më i vendosur kundër luftës dhe qeveritë, të cilat në fillim ishin lidhur me koalicionin, bënë hapa prapa ose u përçanë apo u detyruan të përpunonin arsyetime të stërholluara për veprimet e veta. Udhëheqës si Hafiz al-Asadi, që kishin dhënë trupa, tashti e argumentonin, se kjo kishte qenë e domosdoshme për të baraspeshuar e më në fund për t’i zëvendësuar forcat Perëndimore në Arabinë Saudite dhe, për çdo rast, ato do të përdreshin thjesht për qëllime mbrojtëse e për të ruajtur vendet e shenjta. Në Turqi e në Pakistan udhëheqës të lartë ushtarakë e dënuan rreshtimin e qeverive të tyre me koalicionin. Qeveritë e Egjiptit e të Sirisë, që dhanë numrin më të madh të trupave, e kishin të mjaftë kontrollin mbi shoqëritë e tyre dhe ishin në gjendje ta shpërfillnin e ta shtypnin trysninë antiperëndimore. Qeveritë në vendet myslimane disi më të hapura u detyruan të largoheshin prej Perëndimit e të merrnin qëndrime gjithnjë e më tepër antiperëndimore. Në Magreb “shpërthimi i mbështetjes për Irakun” ka qenë “një prej çudive më të mëdha të luftës”. Opinioni publik i Tunizisë mbajti qëndrim të fortë antiperëndimor dhe presidenti Ben Ali u shpejtua që ta dënonte ndërhyrjen e Perëndimit. Qeveria e Marokut në fillim dha 1500 trupa për koalicionin, por kur nisën të mobilizoheshin grupet antiperëndimore, gjithashtu e miratoi grevën e përgjithshme për Irakun. Në Algjeri një demonstratë me pjesëmarrjen e 400.000 vetave e shtyu presidentin Benxhedid, i cili në fillim anonte nga Perëndimi, të ndryshonte qëndrim, të denonconte Perëndimin dhe të deklaronte se “Algjeria do të qëndrojë përkrah vëllait

Irak.”¹⁴ Në gusht 1990 tri qeveri të Magrebit kishin votuar në Lidhjen Arabe për ta dënuar Irakun. Në vjeshtë, duke iu përgjigjur ndjenjave të forta të popujve të vendeve të tyre, ato votuan për një mocion dënimi të ndërhyrjes amerikane.

Përpjekjet ushtarake të Perëndimit gjithashtu gjetën pak mbështetje nga popujt e qytetërimeve joperëndimore dhe jomyslimane. Në janar 1991 ishin kundër luftës 53 për qind e japonezëve, ndërsa 25 për qind e mbështesnin. Hindutë ishin të përçarë barabar si për të dënuar Sadam Huseinin, ashtu edhe Xhorxh Bushin për luftën, ndërsa gazeta *The Times of India* paralajmëroi se kjo mund të çonte “në një ballafaqim shumë më të gjerë ndërmjet botës së fortë e arrogante judeo-kristiane dhe botës së dobët myslimane, të ndezur nga zelli fetar.” Kështu, Lufta e Gjirit nisi si luftë ndërmjet Irakut e Kuvajtit, pastaj u bë luftë ndërmjet Irakut e Perëndimit, më tej ndërmjet islamit e Perëndimit, dhe përfundimisht nga shumë njerëz jo perëndimorë nisi të shihej si luftë e Lindjes ndaj Perëndimit, “një luftë e të bardhëve, një shpërthim i ri i imperializmit të modës së vjetër.”¹⁵

Me përjashtim të kuvajtianëve, asnjë nga popujt islamikë nuk e përshëndeti luftën dhe pjesa dërrmuese iu kundërvu ndërhyrjes së Perëndimit. Kur mbaroi lufta, paradat e fitores në Londër e në Nju-Jork nuk u shoqëruan asgjekundi tjetër. “Përfundimi i luftës,” ka vënë në dukje Sohail H. Hashmi, “nuk dha shkas për ndonjë gëzim” mes arabëve. Në vend të këtij, atmosfera mbizotëruese ishin zhgënjimi i thellë, tmerrri, poshtërimi dhe pakënaqësia. Perëndimi kishte fituar edhe një herë tjetër. I fundit Saladin, që kishte ngjallur shpresat e arabëve, edhe një herë tjetër kishte rënë poshtë i thyer prej fuqisë masive të Perëndimit, që kishte ndërhyrë me forcë në bashkësinë e islamit. “Çfarë mund t’u ndodhte

më keq arabëve, sesa kjo që u sollu lufta,” pyeste Fatima Mernisi, “i gjithë Perëndimi me gjithë teknologjinë e tij, që na hidhte bomba mbi kokë? Ky ishte tmerrri i fundmë.”¹⁶

Pas mbarimit të luftës opinioni arab jashtë Kuvajtit mbajti gjithnjë e më shumë qëndrim kritik kundër pranisë ushtarake të SHBA në Gji. Çlirimi i Kuvajtit e hoqi çfarëdo arsye për ta kundërshtuar Sadamin dhe la pak arsye për praninë e gjerë ushtarake amerikane në Gji. Rrjedhimisht, edhe në vende si Egjipti, opinioni gjithnjë e më tepër nisi të shprehte simpati për Irakun. Qeveritë arabe, që ishin bashkuar me koalicionin, ndryshuan qëndrim.¹⁷ Egjipti e Siria, po ashtu si dhe vende të tjera, e kundërshtuan vendosjen e zonës së ndalimit të fluturimit në Irakun jugor në gusht 1992. Qeveritë arabe e bashkë me to Turqia gjithashtu i kundërshtuan sulmet ajrore në Irak në janar 1993. Meqë fuqia ajrore e Perëndimit u përdorka si përgjigje kundër sulmeve mbi shiitët myslimanë dhe kurdët nga ana e myslimanëve suni, përse nuk u përdorka edhe për t’iu përgjigjur sulmeve mbi myslimanët e Bosnjës nga ana e serbëve ortodoksë? Në janar 1993, kur presidenti Klinton dha urdhër për të bombarduar Bagdadin si ndëshkim për orvatjet e Irakut, që të vriste ish presidentin Bush, reagimi ndërkombëtar u përvijua prerazi sipas ndarjes qytetërimore. Izraeli dhe qeveritë europiane perëndimore e mbështetën plotësisht sulmin; Rusia e pranoi si vetëmbrojtje “të përligjur”; Kina shprehu “shqetësim të thellë”; Arabia Saudite dhe emiratet e Gjirit nuk thanë asgjë; qeveritë e tjera myslimane, duke përfshirë edhe të Egjiptit, e denoncuan si një shembull tjetër të standardeve të dyfishta të Perëndimit, ndërsa Irani e quajti “agresion flagrant”, të drejtuar nga “neoekspansionizmi dhe egoizmi” amerikan¹⁸. U shtrua disa herë pyetja: Përse Shtetet e

Bashkuara dhe “bashkësia ndërkombëtare” (domethënë Perëndimi) nuk reagojnë në të njëjtën mënyrë kundrejt veprimeve të egra të Izraelit e shkeljeve që ai u bën rezolutave të OKB-së?

Lufta e Gjirit ka qenë e para luftë për burimet ndërmjet qytetërimeve pas Luftës së ftohtë. Thelbi ishte nëse thela kryesore e rezervave më të mëdha të botës me naftë do të mbetej nën kontrollin e qeverisë saudite e të emirateve, që varen prej fuqisë ushtarake të Perëndimit për sigurinë e tyre, apo në duart e regjimeve të pavarura antiperëndimore, të cilat do të ishin në gjendje dhe mund të kishin dëshirën për të përdorur armën e naftës kundër Perëndimit. Perëndimi dështoi dhe nuk e rrëzoi Sadam Huseinin, por korri një fitore duke e thelluar varësinë për sigurinë nga Perëndimi të shteteve të Gjirit, si dhe ia arriti të zgjeronte praninë ushtarake në kohë paqeje në Gji. Përpara luftës, Irani, Iraku, Këshilli i Bashkëpunimit të Gjirit dhe Shtetet e Bashkuara kishin luftuar me bërtyla për ndikimin në Gji. Pas luftës Gjiri Persik kishte përfunduar në liqen amerikan.

Karakteristikat e luftërave në vijën e shkëputjes

Luftërat ndërmjet fiseve, klaneve, grupeve etnike, bashkësive fetare e kombeve kanë mbizotëruar në të gjitha epokat dhe në të gjitha qytetërimet, sepse i kanë rrënjët në identitetin e njerëzve. Këto konflikte kanë prirje që të kufizohen si të veçuara, sepse nuk përfshijnë çështje më të gjera ideologjike apo politike me interes të drejtpërdrejtë për ata që nuk marrin pjesë, ndonëse mund të ngjallin shqetësime humanitare në grupet e jashtme. Gjithashtu ato priren të jenë të përgjakshme e

të parregullta, sepse vihen në lojë çështjet themelore të identitetit. Veç kësaj, ato anojnë të jenë të zgjatura; mund të ndërpriten prej armëpushimesh ose marrëveshesh, por këto janë të paracaktuara për t'u shkelur dhe konflikti rifillon. Nga ana tjetër, fitorja vendimtare ushtarake nga njëra palë në një luftë civile identiteti e shton gjasën që të ushtrohet gjenocid.¹⁹

Konfliktet në vijën e shkëputjes janë konflikte bashkësisht ndërmjet shteteve ose grupeve prej qytetërimesh të ndryshme. Luftërat në vijën e shkëputjes janë konflikte që bëhen të dhunshme. Luftëra të tilla mund të shpërthejnë ndërmjet shtetesh, ndërmjet grupesh joshtetërore dhe ndërmjet shteteve e grupeve joshtetërore. Konfliktet në vijën e shkëputjes ndërmjet shteteve mund të përfshijnë grupe, të cilat janë të vendosura kryesisht në zona të dallueshme gjeografikisht dhe në këtë rast grupi, që nuk e ka në dorë qeverinë, si rregull, lufton për pavarësi e mund të jetë ose mund edhe të mos jetë i gatshëm për të pranuar diçka më pak se pavarësia. Konfliktet brenda shtetit në vijën e shkëputjes gjithashtu mund të përfshijnë grupe, të cilat janë të ndërthurura gjeografikisht dhe në këtë rast marrëdhëniet vazhdimisht të acaruar herë pas here shpërthejnë në veprime të dhunshme, siç ndodh ndërmjet hinduve e myslimanëve në Indi dhe myslimanëve e kinezëve në Malajzi, ose mund të zhvillohen luftime të shkallës së gjerë, sidomos kur janë duke u përcaktuar shtete të reja e kufijtë e tyre, dhe si pasojë bëhen orvatje të egra për t'i ndarë popujt me anë të forcës.

Nganjëherë konfliktet në vijën e shkëputjes janë luftëra për të sunduar mbi njerëzit. Por më shpesh puna është për sundimin e një territori. Synimi i të paktën njërit prej pjesëmarrësve është që të fitojë territor dhe ta lirojë prej një populli tjetër, duke e dëbuar ose vrarë,

madje edhe me të dyja mënyrat, domethënë duke zbatuar “spastrimin etnik”. Këto konflikte priren të jenë të shëmtuara e të dhunshme, ndërsa të dyja palët bëjnë masakra, terrorizëm, përdhunime e tortura. Territori, për të cilin luftohet, shpesh për njërin palë ose për të dyja, është një simbol tepër i ngarkuar i historisë e identitetit të tyre, tokë e shenjtë, mbi të cilën e quajnë se kanë të drejtë të pacenueshme: Bregu Perëndimor, Kashmiri, Nagorno-Karabaku, Lugina e Drinës, Kosova.

Luftërat në vijën e shkëputjes i kanë disa, por jo të gjitha, karakteristikat e luftërave mes bashkësive përgjithësisht. Ato janë konflikte të zgjatura. Kur bëhen brenda shtetit, mesatarisht zgjasin gjashtë herë më shumë sesa luftërat ndërmjet shtetesh të ndryshme. Ato përfshijnë çështje themelore të identitetit e të fuqisë së grupit, prandaj janë të vështira të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve e kompromiseve. Kur arrihet ndonjë marrëveshje, shpesh nuk nënshkruhet nga të gjitha palët prej secilit krah dhe zakonisht nuk e ka jetën të gjatë. Luftërat në vijën e shkëputjes janë luftëra të herëpashershme, të cilat mund të ndizen me dhunë masive e pastaj të fashiten, duke vijuar me luftime të intensitetit të ulët ose të armiqësisë së mbuluar, që më pas përsëri të marrin flakë. Zjarret dhe urrejtjet e identitetit të bashkësisë rrallë shuhen plotësisht, me përjashtim të metodës së gjenocidit. Si pasojë e natyrës së tyre të stërzgjatur, ashtu si dhe luftërat e tjera të bashkësive, luftërat e vijës së shkëputjes kanë prirje të shkaktojnë shifra të larta me të vdekur e refugjatë. Vlerësimet për to duan trajtuar me kujdes, por shifrat e pranuar zakonisht për vdekjet në luftërat e vijës së shkëputjes që kanë qenë duke u zhvilluar në fillim të viteve 1990 arrinin: 50.000 në Filipine, 50.000-100.000 në Sri Lankë, 20.000 në Kashmir, 50.000-200.000 në Bosnjë, 30.000-50.000 në Çeçeni, 100.000 në Tibet,

200.000 në Timorin Lindor.²⁰ Në të vërtetë, të gjitha këto konflikte kanë sjellë shifra shumë më të larta për refugjatët.

Mjaft nga këto luftëra bashkëkohore janë thjesht raundi i fundit i një historie të stërzgjatur konfliktesh të përgjakshme, kurse dhuna e viteve të fundit të shekullit XX nuk i ka pranuar orvatjet për t'i dhënë fund dhunës një herë e përgjithmonë. Për shembull, luftimet në Sudan shpërthyen më 1956, vijuan deri më 1972, kur u arrit një marrëveshje që i dha një farë autonomie Sudanit Jugor, por rifilluan përsëri më 1983. Rebelimi tamil në Sri Lankë nisi më 1983; bisedimet për t'i dhënë fund u ndërpre në më 1991 dhe rinisën më 1994 me një marrëveshje për armëpushim në janar 1995. Megjithatë, katër muaj më vonë Tigrat kryengritës e shkelën armëpushimin dhe u tërhoqën nga bisedimet për paqe, kurse lufta rifilloi me dhunë më të fortë. Rebelimi i morove në Filipinet nisi në fillim të viteve 1970 dhe u fashit më 1976 pas një marrëveshjeje, që u jepte autonominë disa zonave të Mindanaos. Mirëpo aty nga viti 1993 dhuna rinisi e u bë e dendur, duke u shtuar gjithnjë e më tepër, pasi grupet kryengritëse i hodhën poshtë orvatjet për paqe. Udhëheqësit rusë e çeçenë arritën një marrëveshje çmilitarizimi në korrik 1995 për t'i dhënë fund dhunës, që kishte nisur dhjetorin e një viti më parë. Lufta u fashit për një farë kohe, por pastaj rinisi me sulmet e çeçenëve kundër udhëheqësve individualë rusë ose pro rusëve, me përgjigjet ruse, me sulmet e çeçenëve në Dagestan në janar 1996 dhe me ofensivën masive ruse në fillim të vitit 1996.

Ndërsa me luftërat e tjera të bashkësive kanë të përbashkët tejzgjatjen, nivelin e lartë të dhunës dhe dykuptimësinë ideologjike, luftërat në vijën e shkëputjes edhe dallohen prej tyre nga dy anë. Së pari, luftërat e bashkësive mund të ndodhin ndërmjet grupeve etnike,

fetare, raciale ose gjuhësore. Mirëpo, meqë feja është tipari kryesor dallues i qytetërimeve, luftërat e vijës së shkëputjes pothuaj gjithmonë bëhen ndërmjet popujve të feve të ndryshme. Disa analistë e zvogëlojnë rëndësinë e këtij faktori. Për shembull, ata vënë në dukje etnicitetin e gjuhën e përbashkët, bashkekzistencën e mëparshme dhe martesat e shumta ndërmjet serbëve e myslimanëve në Bosnjë, kurse e lënë mënjanë faktorin fetar, duke iu drejtuar “narcizmit të dallimeve të vogla” të Frojdit.²¹ Mirëpo ky gjykim i ka rrënjët në miopinë shekullore. Mijëvjeçarët e historisë njerëzore kanë treguar se feja nuk është “një dallim i vogël”, por ka gjasa të jetë dallimi më i thellë që i ndan njerëzit. Denduria, intensiteti e forca e dhunshme e luftërave në vijën e shkëputjes gjejnë mbështetje të madhe te besimet në perëndi të ndryshme.

Së dyti, luftërat e tjera midis bashkësive kanë prirje të jenë të veçuara, dhe relativisht ka pak gjasa të përhapen e të përfshijnë pjesëmarrës të tjerë. Luftërat në vijën e shkëputjes, përkundrazi, nga vetë përcaktimi i tyre ndodhin ndërmjet grupesh, që bëjnë pjesë në tërësi më të mëdha kulturore. Në konfliktin e zakonshëm ndërmjet bashkësive, Grupi A lufton kundër Grupit B, kurse Grupet C, D, dhe E nuk kanë arsye të përfshihen, me përjashtim të rastit kur A ose B i godasin drejtpërdrejt interesat e C, D ose E. Përkundrazi, në luftërat e vijës së shkëputjes, Grupi A1 lufton kundër Grupit B1 dhe secili do të bëjë orvatje ta zgjerojë luftën e të gjejë mbështetje prej grupeve të farefisnisë së qytetërimit: A2, A3, A4 dhe B2, B3 e B4, ndërsa grupet e mësipërme do ta njëjtësojnë veten me farefisnin e tyre në luftë. Zgjerimi i transportit dhe i komunikimeve në botën e sotme e ka lehtësuar vendosjen e këtyre lidhjeve dhe, rrjedhimisht, edhe “ndërkombëtarizimin” e konflikteve në vijën e shkëputjes. Migrimi ka krijuar

diaspora në qytetërimet e treta. Komunikimet e bëjnë më të lehtë që palët ndërluftuese të bëjnë thirrje për ndihmë dhe grupet e tyre me fafifisni e marrin vesh menjëherë fatin e atyre palëve. Ngushtimi i përgjithshëm i botës e bën të mundshme kështu, që grupet fafifisnore t'u japin mbështetje morale, diplomatike, financiare e materiale palëve ndërluftuese, dhe gjithashtu është gjithnjë e më e vështirë të mos ndiqet kjo rrugë. Ndërtohen rrjete ndërkombëtare për ta çuar në vend këtë mbështetje e, nga ana e vet, mbështetja u jep krahë pjesëmarrësve dhe e zgjat konfliktin. Ky "sindrom i vendit fafififisor" sipas shprehjes së H.D.S. Greenway-it (Grinuej), përbën një tipar qendror të luftërave në vijën e shkëputjes për vitet e fundit të shekullit XX.²² Me një vështrim më të përgjithshëm, edhe përmasa të vogla dhune ndërmjet njerëzve të qytetërimeve të ndryshme degëzohen dhe kanë pasoja, të cilat nuk ndeshen në dhunën ndërqytetërimore. Kur sunitë e armatosur vranë tetëmbëdhjetë besimtarë shiitë në një xhami të Karaçit në shkurt 1995, prishën edhe paqen në qytet e krijuan problem për gjithë Pakistanin. Kur pikërisht një vit më parë një kolon çifut kishte vrarë njëzet e nëntë myslimanë, që po luteshin te Shpella e Patriarkëve në Hebron, ai kishte prishur procesin e paqes në Lindjen e Mesme dhe krijoi një problem për mbarë botën.

Denduria: kufijtë e përgjakur të islamit

Konfliktet ndërmjet bashkësive dhe luftërat në vijën e shkëputjes përbëjnë palcën e historisë, ndërsa sipas një llogaritjeje, gjatë Luftës së ftohtë kanë ndodhur nja tridhjetë e dy konflikte etnike, duke përfshirë edhe

luftërat në vijën e shkëputjes ndërmjet arabëve e izraelitëve, indianëve e pakistanezëve, myslimanëve sudanas dhe të krishterëve sudanas, budistëve të Sri Lankës e tamilëve, si dhe shiitëve e maronitëve të Libanit. Luftërat për identitetin përbënin afër gjysmën e gjithë luftërave civile gjatë viteve 1840 e 1950, porse rreth tri të katërtat e luftërave civile gjatë dhjetëvjeçarëve pasues dhe intensiteti i kryengritjeve, në të cilat përfshiheshin grupet etnike, u trefishua ndërmjet fillimit të viteve 1850 dhe fundit të viteve 1980. Megjithatë, duke e ditur praninë e rivalitetit mbisundues ndërmjet superfuqive, me disa përjashtime të shënuara, këto konflikte kanë tërhequr pak vëmendjen dhe shpesh janë parë nëpërmjet prizmit të Luftës së ftohtë. Kur Lufta e ftohtë mori fund, konfliktet ndërmjet bashkësive u bënë më të dukshme dhe, mund të arsyetohet, që dolën mbizotëruese më shumë sesa ishin më parë. Në të vërtetë ndodhi diçka, që i ngjet mjaft një “shpërthimi” të konflikteve etnike.²³

Këto konflikte etnike dhe luftëra në vijën e shkëputjes nuk janë përhapur barabar nëpër qytetërimet e botës. Luftimet më të mëdha në vijën e shkëputjes kanë ndodhur ndërmjet serbëve e kroatëve në ish Jugosllavinë dhe ndërmjet budistëve e hinduve në Sri Lankë, ndërsa konflikte më pak të dhunshme kanë ndodhur ndërmjet grupeve jomyslimane në pak vende të tjera. Shumica dërmuese e konflikteve në vijën e shkëputjes, megjithatë, ka ndodhur përgjatë kufirit që përkrahon Eurazinë e Afrikën, i cili ndan myslimanët nga jomyslimanët. Ndërsa në makronivel ose në nivelin global të politikës botërore përplasja ndërmjet qytetërimeve ndodh ndërmjet Perëndimit e pjesës tjetër, në mikronivel ose në nivelin lokal ajo bëhet ndërmjet islamit e të tjerëve.

Konflikte të dhunshme dhe antagonizma të dendura mbizotërojnë ndërmjet popujve myslimanë e jomyslimanë. Në Bosnjë myslimanët kanë bërë një luftë të përgjakshme e shkatërrimtare me serbët ortodoksë, si dhe janë përfshirë në raste të tjera dhune me kroatët katolikë. Në Kosovë myslimanët shqiptarë kanë fatkeqësinë të vuajnë prej sundimit serb dhe kanë krijuar një qeveri paralele klandestine, ndërsa parashikohet me shumë gjasa se do të ketë dhunë ndërmjet dy grupeve. Qeveritë e Shqipërisë e të Greqisë janë majë më majë për të drejtat e pakicave të tyre në secilin vend. Turqit e grekët historikisht i kanë vënë duart në fyt njëri-tjetrit. Në Qipro turqit myslimanë dhe grekët ortodoksë kanë shtete fqinje në armiqësi. Në Kaukaz Turqia dhe Armenia janë armiq historikë, kurse azerët dhe armenët kanë bërë luftë për sundimin e Nagorno Karabakut. Në Kaukazin Verior gjatë dyqind vjetëve çeçenët, ingushët e popuj të tjerë myslimanë kanë luftuar herë pas here për pavarësinë nga Rusia, një luftë që u rifillua në mënyrë të përgjakshme nga Rusia e Çeçenia më 1994. Gjithashtu janë zhvilluar luftime ndërmjet ingushëve e osetëve ortodoksë. Në pellgun e Vollgës tartarët myslimanë kanë luftuar kundër rusëve në të kaluarën dhe në fillim të viteve 1990 arritën një kompromis të vështirë me Rusinë për sovranitet të kufizuar.

Gjatë gjithë shekullit XIX Rusia hap pas hapi me anë të forcës e shtriu sundimin e vet mbi popujt myslimanë të Azisë Qendrore. Gjatë viteve 1980 afganët dhe rusët bënë një luftë të madhe dhe me tërheqjen e rusëve, ajo vazhdoi në Taxhikistan ndërmjet forcave ruse, që mbështesnin qeverinë në fuqi, dhe kryengritësve në pjesën më të madhe islamistë. Në Ksingiang, uigurët dhe grupet e tjera myslimane luftojnë kundër sinifikimit dhe po ndërtojnë marrëdhënie me farefisën e tyre etnik e fetar në ish republikat sovjetike. Në Nënkontinent

Pakistani dhe India kanë bërë tri luftëra, një lëvizje kryengritëse e myslimanëve kundërshton sundimin e Indisë mbi Kashmirin. Imigrantët myslimanë luftojnë kundër fiseve në Asam, kurse myslimanët dhe hindutë herë pas here përleshën e ushtrojnë dhunë përmes gjithë Indisë dhe këto shpërthime ushqehen nga ngritja e lëvizjeve fundamentaliste në të dyja bashkësitë fetare. Në Bangladesh budistët protestojnë kundër diskriminimit që u bëhet prej shumicës myslimane, ndërsa në Mianmar myslimanët protestojnë kundër diskriminimit që u bën shumica budiste. Në Malajzi e Indonezi periodikisht myslimanët ngrenë krye kundër kinezëve, protestojnë kundër sundimit të tyre në ekonomi. Në Tajlandën e jugut grupet myslimane janë përfshirë herë pas here në kryengritje kundër qeverisë budiste, kurse në Filipinet e jugut një lëvizje kryengritëse lufton për pavarësi nga vendi dhe qeveria katolike. Nga ana tjetër, në Indonezi timorasit lindorë katolikë luftojnë kundër shtypjes prej qeverisë myslimane.

Në Lindjen e Mesme konflikti ndërmjet arabëve e çifutëve në Palestinë ka nisur që me themelimin e atdheut të çifutëve. Janë bërë katër luftëra ndërmjet Izraelit e shteteve arabe, kurse palestinezët kanë nisur *intifadën* kundër sundimit izraelit. Në Liban të krishterët maronitë kanë bërë një betejë të humbur kundër shiitëve dhe myslimanëve të tjerë. Në Etiopi amharët ortodoksë historikisht i kanë shtypur grupet etnike myslimane dhe janë përballur me kryengritjen e oromove myslimanë. Përgjat gungës së Afrikës kanë ndodhur një varg konfliktesh ndërmjet popujve arabë e myslimanë nga veriu dhe popujve zezakë animistë e të krishterë nga jugu. Lufta më e përgjakshme ndërmjet myslimanëve e të krishterëve është zhvilluar në Sudan, ku ka vijuar për dhjetëra vjet dhe ka shkaktuar qindra mijëra të vrarë e të plagosur. Në politikën e Nigerisë ka mbisunduar

konflikti ndërmjet fulani-hausave myslimanë në veri dhe fiseve të krishtera në jug, i shoqëruar me trazira e grushte shteti të shpeshta, si dhe me një luftë të madhe. Në Çad, Kenia e Tanzani kanë ndodhur beteja të krahasueshme ndërmjet grupeve myslimane e të krishtera.

Në të gjitha këto vise marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve dhe popujve të qytetërimeve të tjera: katolikëve, protestantëve, ortodoksëve, hinduve, kinezëve, budistëve e çifutëve kanë qenë përgjithësisht antagoniste; pjesë më e madhe në vitet 1990 qenë të dhunshme. Kudo që të hedhim sytë përgjatë perimetrit të islamit, myslimanët kanë probleme për të jetuar paqësisht me fqinjët e tyre. Lind në mënyrë të natyrshme pyetja, a është ky model i konfliktit në fundin e shekullit XX ndërmjet grupeve myslimane e jomyslimane po aq i vërtetë, sa dhe për marrëdhëniet ndërmjet grupeve prej qytetërimesh të tjera. Në fakt nuk është. Myslimanët përbëjnë rreth një të pestën e popullsisë së botës, por në vitet 1990 kanë qenë shumë më tepër të ngatërruar në dhunë ndërmjet grupeve, sesa cilido popull i qytetërimeve të tjera. Dëshmitë janë jashtë çdo dyshimi.

1. Myslimanët kanë marrë pjesë në njëzet e gjashtë prej pesëdhjetë konflikteve etnopolitike në vitet 1993-1994, të analizuara në thellësi nga Ted Robert Gurri (Tabela 10.1). Njëzet prej këtyre konflikteve janë bërë ndërmjet grupeve prej qytetërimesh të ndryshme, ndër të cilat pesëmbëdhjetë ndërmjet myslimanëve e jomyslimanëve. Shkurt, ka pasur tri herë më shumë konflikte ndërqytetërimore, në të cilat janë ngatërruar myslimanët, sesa ka pasur konflikte ndërmjet gjithë qytetërimeve jomyslimane. Edhe konfliktet brenda islamit kanë qenë më shumë si numër, sesa ato në cilindo qytetërim tjetër, duke përfshirë edhe konfliktet fisnore në Afrikë. Krejt ndryshe nga islami, Perëndimi

është ngatërruar vetëm në dy konflikte brendaqytetërimore dhe në dy ndërqytetërimore. Gjithashtu konfliktet me përfshirje të myslimanëve kanë shfaqur prirjen të kenë më shumë të vrarë e të plagosur. Prej gjashtë luftërave, në të cilat sipas vlerësimit të Gurrit ka pasur 200.000 a më shumë të vrarë, tri (në Sudan, Bosnjë, Timorin Lindor) kanë ndodhur ndërmjet myslimanëve e jomyslimanëve, dy (në Somali e te kurdët e Irakut) qenë ndërmjet myslimanëve dhe vetëm një (në Angolë) përfshiu vetëm jomyslimanë.

2. Gazeta *New York Times* ka përcaktuar dyzet e tetë vise, në të cilat po zhvilloheshin nja pesëdhjetë e nëntë konflikte etnike më 1993. Në gjysmën e këtyre viseve ishin myslimanë që përplaseshin me myslimanë të tjerë ose me jomyslimanë. Tridhjetë e një prej këtyre pesëdhjetë e nëntë konflikteve zhvilloheshin ndërmjet grupeve prej qytetërimesh të ndryshme dhe, duke hequr një paralele me të dhënat e Gurrit, dy të tretat (njëzet e një) nga këto konflikte ndërqytetërimore qenë ndërmjet myslimanëve e të tjerëve (Tabela 10.2).

3. Edhe në një analizë tjetër, Ruth Leger Sivardi ka përcaktuar njëzet e nëntë luftëra (të quajtura si konflikte kur përfshijnë më shumë se 1000 vdekje brenda një viti) që po zhvilloheshin në vitin 1992. Nëntë prej konflikteve ndërqytetërimore bëheshin ndërmjet myslimanëve e jomyslimanëve dhe përsëri myslimanët ishin duke zhvilluar më shumë luftime sesa popujt e cilitdo qytetërim tjetër.²⁴

Tabela 10.1:
Konfliktet etnopolitike, 1993-1994

	Brendaqytetërimore	Ndërqytetërimore	Gjithsej
Islami	11	15	26

Të tjerat	19*	5	24
Gjithsej	30	20	50

Burimi: Ted Robert Gurr, "Peoples Against States: Ethnopolitical Conflict and the Changing World System," *International Studies Quarterly*, Vol. 38 (shtator 1994), f. 347-378. E kam përdorur klasifikimin e Gurrit për konfliktet, me përjashtim të zhvendosjes së konfliktit Kinë-Tibet, të cilin ai e klasifikon si joqytetërimor në kategorinë e ndërqytetërimoreve, sepse është e qartë se kjo është një përplasje ndërmjet kinezëve han konfucianë dhe tibetanëve lamaistë budistë.

Tabela 10.2:
Konfliktet etnike, 1993

	Brendaqytetërimore	Ndërqytetërimore	Gjithsej
Islami	7	21	28
Të tjerat	21†	10	31
Gjithsej	28	31	59

Burimi: *New York Times*, 7 shkurt 1993, f. 1, 14.

Kështu tri përmbledhje të ndryshme të dhënash kanë përfutuar të njëjtin përfundim: Në fillim të viteve 1990 myslimanët ishin të ndërlikuar në dhunën ndërgrupore më shumë sesa jomyslimanët dhe dy të tretat deri në tri të katërtat e luftërave ndërqytetërimore bëheshin ndërmjet myslimanëve e jomyslimanëve.

* Prej tyre 10 qenë konflikte fisnore në Afrikë.

† Prej tyre 10 qenë konflikte fisnore në Afrikë.

Kufijtë e islamit janë të *përgjakur* dhe ashtu janë edhe të brendshmet e tij.*

Kahja myslimane drejt konfliktit të dhunshëm na bëhet e dukshme edhe nga shkalla, në të cilën janë të militarizuara shoqëritë myslimane. Në vitet 1980 vendet myslimane kishin normën e forcës ushtarake (domethënë numrin e personelit ushtarak kundrejt 1000 vetave të popullsisë) dhe tregues të angazhimeve ushtarake (norma e forcës kundrejt pasurisë së vendit) mjaft më të larta sesa të vendeve të tjera. Përkundrazi, vendet e krishtera kishin tregues të normave të forcave dhe të angazhimeve ushtarake mjaft më të ulëta sesa të vendeve të tjera. Norma mesatare e forcave dhe e angazhimeve ushtarake të vendeve myslimane ishin afërsisht dy herë më shumë sesa të vendeve të krishtera (Tabela 10.3). James Payne (Xhejms Pejni) ka ardhur në përfundimin se “Është fare e qartë që ka një lidhje ndërmjet islamit e militarizmit.”²⁵

Tabela 10.3:
Militarizmi i vendeve myslimane e të krishtera

	Norma mesatare e forcave	Norma mesatare e angazhimeve ushtarake
Vendet myslimane (n = 25)	11,8	17,7
Vendet e tjera (n = 112)	7,1	12,7
Vendet e krishtera (n = 57)	5,8	8,2
Vendet e tjera (n = 80)	9,5	16,9

* Asnjë pohim tjetër në artikullin tim, botuar në *Foreign Affairs*, nuk ka ngjallur më shumë komente, sesa ky: “Islami ka kufij të përgjakur.” Unë e kam dhënë këtë gjykim mbi bazën e vëzhgimit të rastësishëm për konfliktet ndërqytetërore. Dëshmitë sasiore nga cilido burim i paanshëm e vërtetojnë përfundimisht se ai qëndron.

Burimi: James L. Payne, *Why Nations Arm* (Oxford: Basil Blackwell, 1989), f. 125, 138-139. Vende myslimane dhe të krishtera janë ato, në të cilat më shumë se 80 për qind e popullsisë i përket fesë përkatëse.

Shtetet myslimane kanë pasur gjithashtu një kahje të lartë për t'iu drejtuar dhunës në rastet e krizave ndërkombëtare dhe e kanë përdorur për zgjidhjen e 76 krizave nga gjithsej 142, në të cilat kanë ndërhyrë ndërmjet viteve 1928 e 1979. Në 25 raste dhuna ka qenë mjeti parësor për trajtimin e krizës; në 51 kriza shtetet myslimane kanë përdorur dhunë krahas mjeteve të tjera. Atëherë kur e kanë përdorur dhunën, shtetet myslimane e kanë përdorur në shkallë të fuqishme, duke iu drejtuar luftës së plotë në 41 për qind të rasteve, kur është përdorur dhuna, dhe kanë ndërhyrë në përplasjet e mëdha në 38 për qind të rasteve të tjera. Ndërsa shtetet myslimane i janë drejtuar dhunës në 53,5 për qind të krizave të tyre, nga Mbretëria e Bashkuar dhunë është përdorur vetëm 11,5 për qind, nga Shtetet e Bashkuara në 17,5 për qind dhe nga Bashkimi Sovjetik në 28,5 për qind të krizave, në të cilat kanë ndërhyrë. Ndër fuqitë e mëdha vetëm kahja e Kinës drejt dhunës e ka kapërcyer atë të shteteve myslimane: ajo ka përdorur dhunën në 76,9 për qind të krizave të saj.²⁶ Qëndrimi luftënxitës e dhuna myslimane janë fakte të periudhës së fundit të shekullit XX, të cilat nuk mund t'i mohojnë as myslimanët, as jomyslimanët.

Shkaqet: historia, demografia, politika

Cila ka qenë arsyeja e hovit të luftërave në vijën e shkëputjes gjatë fundit të shekullit XX dhe e rolit qendror të myslimanëve në këto konflikte? Së pari, këto luftëra i kanë pasur rrënjët në histori. Dhuna e herëpashershme në vijën e shkëputjes ndërmjet grupeve të ndryshme qytetërimore ka pasur vend edhe në të kaluarën dhe ruhet në kujtesën e sotme për të shkuarën, gjë që nga ana e vet ngjall frikë e pasiguri për të dyja palët. Myslimanët e hindutë në Nënkontinent, rusët dhe kaukazianët në Kaukazin Verior, armenët e turqit në Transkaukaz, arabët e çifutët në Palestinë, katolikët, myslimanët dhe ortodoksët në Ballkan, rusët e turqit që nga Ballkani e deri në Azinë Qendrore, sinhalezët e tamilët në Sri Lankë, arabët e zezakët përmes Afrikës: të gjitha këto janë marrëdhënie, të cilat gjatë shekujve kanë parë ndërkëmbimin e bashkjetesës me mosbesim dhe dhunë të ashpër. Është e pranishme një trashëgimi historike konfliktesh, që mund të shfrytëzohet dhe të përdoret nga ata, të cilët gjejnë arsye për të vepruar në këtë drejtim. Në këto marrëdhënie historia është e gjallë, e fortë dhe tmerruese.

Megjithatë, një histori masakrash të herëpashershme nuk e shpjegon në vetvete përse dhuna u rishfaq në fundin e shekullit të njëzetë. Në fund të fundit, siç e kanë vënë në dukje shumë njerëz, serbët, kroatët e myslimanët gjatë disa dhjetëvjeçarëve kanë jetuar në paqe së bashku në Jugosllavi. Po kështu ka ndodhur me myslimanët e hindutë në Indi. Grupet e shumta etnike e fetare në Bashkimin Sovjetik kanë bashkëjetuar, me disa përjashtime të shënuara, që janë shkaktuar prej qeverisë sovjetike. Gjithashtu tamilët e sinhalezët kanë jetuar së


bashku në qetësi në një ishull, të cilin shepsh e kishin paraqitur si parajsë tropikale. Nuk i pengoi historia këto marrëdhënie relativisht paqësore që të kishin epërsi për periudha të rëndësishme kohe; rrjedhimisht, historia në vetvete nuk mund ta shpjegojë prishjen e paqes. Duhet të kenë ndërhyrë faktorë të tjerë në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të njëzetë.

Një nga të tillë faktorë ka qenë baraspesha demografike. Zgjerimi numerik i njërit grup përfton trysni politike, ekonomike e shoqërore mbi grupet e tjera dhe ngjall përgjigje kundërvepruese. Ajo që ka më shumë rëndësi, është se prodhon trysni ushtarake mbi grupet më pak dinamike nga ana demografike. Shembja në fillim të viteve 1970 e rendit kushtetues tridhjetëvjeçar në Liban në pjesën më të madhe ndodhi si pasojë e shtimit të befasishëm të popullsisë shiite kundrejt të krishterëve maronitë. Në Sri Lanka, siç e ka treguar Gary Fulleri, kulmi i kryengritjes nacionaliste sinhaleze më 1970 dhe i kryengritjes tamile nga fundi i viteve 1980 përkuan me përpikëri me vitet, kur “sipëria e të rinjve” pesëmbëdhjetë deri njëzet e katër vjeç në ato grupe e kaloi 20 për qind të popullsisë gjithsej në grup.²⁷ (Shih Grafikun 10.1). Kryengritësit sinhalezë, siç e ka vënë re një diplomat amerikan në Sri Lankë, në të vërtetë ishin që të gjithë të moshës nën njëzet e katër vjeç, kurse është njoftuar se Tigrat e Tamilit kanë qenë “unikalë në mbështetjen te një një ushtri që mund të quhej me kalamanj”, duke “rekrutuar djem e vajza që të moshës njëmbëdhjetë vjeç,” ndërsa ata që janë vrarë në luftime ishin “pa arrirë adoleshencën kur u vranë, vetëm pak ishin mbi tetëmbëdhjetë vjeç.” Siç ka vënë në dukje revista *The Economist*, Tigrat po bënin një “luftë nën moshën përkatëse.”²⁸ Në mënyrë të ngjashme, luftërat në vijën e shkëputjes ndërmjet popujve rusë dhe myslimanë nga jugu ushqeheshin prej dallimeve të

mëdha në rritjen e popullsisë. Në fillim të viteve 1990 lindshmëria e grave në Federatën Ruse ishte 1,5, kurse në republikat e mëparshme sovjetike myslimane të Azisë Qendrore lindshmëria ishte 4,4 për qind, ndërkaq norma e rritjes neto të popullsisë (norma e lindjes bruto minus normën bruto të vdekjeve) nga fundi i viteve 1980 në këto republika ka qenë pesë herë më shumë sesa në Rusi. Çeçenët janë shtuar 26 për qind në vitet 1980 dhe Çeçenia ka qenë një nga trevat me popullsi më të dendur në Rusi, kështu që norma e lartë e lindshmërisë prodhonte emigrantë e luftëtarë. Në të njëjtën mënyrë lindshmëria e lartë e myslimanëve dhe migrimi në Kashmir nga Pakistani e kanë nxitur ringjalljen e qëndresës kundër sundimit nga India.

Grafiku 10.1:

Sri Lanka: sipëria e të rinjve sinhalezë dhe tamilë



Proceset e ndërlikuara që çuan në luftërat ndërqytetërimore në ish Jugosllavinë patën shumë shkaqe dhe shumë pikënisje. Ndoshta faktori më i rëndësishëm i veçantë, që çoi në këto konflikte, megjithatë do të ketë qenë zhvendosja demografike, që ndodhi në Kosovë. Kosova ishte një republikë autonome brenda Republikës Serbe, e cila kishte de facto pushtetin si të gjashta republikat jugosllave, me përjashtim të së drejtës për shkëputje. Më 1961 popullsia

e saj kishte qenë 67 për qind shqiptarë myslimanë dhe 24 për qind serbë ortodoksë. Mirëpo norma e lindshmërisë e shqiptarëve ishte më e larta në Europë dhe Kosova u bë zona me popullsinë më të dendur në Jugosllavi. Aty nga vitet 1980 afërsisht 50 për qind e shqiptarëve ishin të rinj me moshë nën njëzet vjeç. Përballë këtyre shifrave, serbët emigruan prej Kosove, duke kërkuar mundësi për zgjidhje ekonomike në Beograd e gjetkë. Si rrjedhim, më 1991 Kosova kishte 90 për qind myslimanë dhe 10 për qind serbë.³⁰ Megjithatë, serbët e shihnin Kosovën si “tokën e tyre të shenjtë” ose si “Jerusalem-in e tyre”, e ndër të tjera, si fushën e betejës së madhe të 28 qershorit 1389, kur u thyen nga turqit osmanë dhe, si pasojë, ranë nën sundimin osman për pothuaj pesë shekuj.

Aty nga fundi i viteve 1980 zhvendosja e baraspeshës demografike solli që shqiptarët të kërkonin ngritjen e Kosovës në statusin e një republike të Jugosllavisë. Serbët dhe qeveria jugosllave kundërshtuan, duke pasur frikë se, pasi të fitonte Kosova të drejtën e shkëputjes, ajo do ta përdorte dhe ndoshta do të bashkohej me Shqipërinë. Në mars 1981 protestat dhe trazirat e shqiptarëve shpërthyen në mbështetje të kërkesës së tyre për statusin e republikës. Sipas serbëve, pas kësaj u përforcuan diskriminimi, përndjekjet dhe dhuna kundër serbëve. “Në Kosovë që nga fundi i viteve 1970 e më tej,” ka vënë në dukje një protestant kroat, “...kanë ndodhur një varg incidentesh të dhunshme, ndër to dëmtime të pronës, humbje të vendeve të punës, ngacmime, përdhunime, përleshje e vrasje.” Si rrjedhim, “Serbët mëtonin që kërcënimi kundër tyre ishte në përmasat e gjenocidit dhe ata nuk mund ta toleronin më tej.” Ankesat e serbëve të Kosovës gjetën jehonë gjetkë brenda Serbisë dhe më 1986 përftuan prej 200 intelektualësh kryesorë serbë,

figurash politike, udhëheqësish fetarë e oficerësh ushtarakë, ndër ta edhe botuesit e revistës liberale të opozitës *Praxis*, një deklaratë, që i kërkonte qeverisë të merrte masa të forta për t'i dhënë fund gjenocidit kundër serbëve në Kosovë. Po të nisemi nga cilido përkufizim i gjenocidit, kjo akuzë ishte tepër e ekzagjeruar, ndonëse sipas një vëzhguesi të huaj, që mbante anën e shqiptarëve, “gjatë viteve 1980 nacionalistët shqiptarë ishin shkaktarë të një vargu sulmesh të dhunshme kundër serbëve dhe për shkatërrimin e një pjese pronash serbe.”³¹

Të gjitha këto ngjallën nacionalizmin serb dhe Slobodan Millosheviqi e kapi këtë rast. Më 1987 ai mbajti një fjalim të madh në Kosovë, duke u bërë thirrje serbëve të kërkonin tokën dhe historinë e tyre. “Menjëherë një numër i madh serbësh: komunistë, jo komunistë e madje antikomunistë, nisën të grumbulloheshin rreth tij, të vendosur jo vetëm të mbronin pakicën serbe në Kosovë, por edhe të shtypnin shqiptarët e t'i shndërronin në qytetarë të klasit të dytë. Pas pak kohësh Millosheviqi u pranua si udhëheqës kombëtar.”³² Dy vjet më vonë, më 28 qershor 1989, Millosheviqi u rikthye në Kosovë së bashku me 1 deri 2 milionë serbë, për të përkujtuar 600-vjetorin e betejës së madhe, e cila simbolizonte luftën e tyre të vazhduar me myslimanët.

Frika dhe nacionalizmi i serbëve, të provokuara nga rritja e numrit dhe e fuqisë së shqiptarëve, u shtuan më tej nga ndryshimet demografike në Bosnjë. Në vitin 1961 serbët përbënin 43 për qind dhe myslimanët 26 për qind të popullsisë së Bosnjë-Hercegovinës. Aty nga viti 1991 përpjesëtimet pothuaj ishin përmbytur përpikërisht: serbët kishin rënë në 31 për qind dhe myslimanët ishin shtuar në 44 për qind. Gjatë këtyre tridhjetë vjetëve kroatët ranë nga 22 për qind në 17 për

qind. Zgjerimi etnik i njërit grup solli te spastrimi etnik nga grupi tjetër: "Përse i vrasim fëmijët?" ka bërë pyetje një luftëtar serb, kur iu kërkua më 1992, dhe u përgjigj: "Sepse një ditë ata do të rriten dhe neve do të na duhet t'i vrasim atëherë." Në një mënyrë pakëz më të vrazhdë autoritetet kroate në Bosnjë vepruan për të parandaluar, që trevat e tyre të "pushtoheshin demografikisht" nga myslimanët.³³

Zhvendosjet në baraspeshën demografike dhe sipëria e të rinjve me 20 për qind e më shumë janë shkaktaret e shumë prej konflikteve ndërqytetërimore të fundit të shekullit XX. Megjithatë, edhe ato nuk i shpjegojnë të gjitha. Luftimet ndërmjet serbëve e kroatëve, për shembull, nuk mund të lidhen me demografinë dhe, për këtë punë, edhe në histori mbështeten vetëm pjesërisht, sepse këta popuj kanë jetuar bashkë relativisht në paqe deri kur ustashët kroatë masakruan serbët gjatë Luftës II Botërore. Edhe këtu, ashtu si gjetkë, ishte politika një ndër shkaqet e përleshjes. Shembja e perandorive austro-hungareze, osmane dhe ruse në fund të Luftës I Botërore ngjalli konfliktet etnike e qytetërimore ndërmjet popujve dhe shteteve trashëguese të tyre. Edhe shembja e perandorive britanike, franceze e holandeze shkaktoi pasoja të ngjashme pas Luftës II Botërore. Rënia e regjimeve komuniste në Bashkimin Sovjetik e në Jugosllavi bëri të njëjtën gjë në fund të Luftës së ftohtë. Njerëzit nuk mund të përcaktoheshin më si komunistë, qytetarë sovjetikë ose jugosllavë, dhe kishin nevojë të dëshpëruar për të gjetur identitetin e ri. E gjetën atë në arsenalin e vjetër të etnisë e të fesë. Rendi shtypës por paqësor i shteteve, që i përmbaheshin parimit se nuk ka zot, u zëvendësua nga dhuna e popujve, që u besonin perëndive të ndryshme.

Ky proces u rëndua prej nevojës që patën tërësitë politike të rishdala, për të zbatuar procedurat e demokracisë. Kur Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia nisën të shpërbëheshin, elitat në pushtet nuk organizuan zgjedhje të përgjithshme. Po të kishin vepruar me atë rrugë, udhëheqësit politikë do të kishin hyrë në garën për pushtet në qendër dhe ka gjasa se do të ishin orvatur për të përgatitur thirrje shumetnike e shumëqytetërimore drejtuar zgjedhësve, si dhe do të kishin ndërtuar koalicione shumice të ngjashme në parlament. Në vend të kësaj, si në Bashkimin Sovjetik, edhe në Jugosllavi zgjedhjet u organizuan në fillim mbi bazë republike, duke krijuar shtysën e papërmbajtshme që udhëheqësit politikë të bënin fushatë kundër qendrës, t'i bënin thirrje nacionalizmit etnik dhe të mbështesnin pavarësinë e republikave të veta. Madje edhe brenda Bosnjës popullsitë votuan në mënyrë të prerë sipas përkatësive etnike në zgjedhjet e vitit 1990. Partia Reformiste shumetnike dhe partia e mëparshme komuniste morën secila më pak sesa 10 për qind të votave. Votat për Partinë Myslimane të Veprimit Demokratik (34 për qind), për Partinë Demokratike Serbe (30 për qind) dhe për Bashkimin Demokratik Kroat (18 për qind) ishin afërsisht në përputhje me përpjesën e myslimanëve, serbëve dhe kroatëve në atë popullsi. Zgjedhjet e para të bëra me rregull pothuaj në të gjitha republikat e mëparshme sovjetike e jugosllave u fituan nga udhëheqësit politikë, të cilët u drejtoheshin ndjenjave nacionaliste dhe premtorin veprime të vendosura për të mbrojtur kombësinë e tyre kundër grupeve të tjera etnike. Gara zgjedhore u jep zemër thirrjeve nacionaliste dhe me këtë nxit fuqizimin e konflikteve në vijën e shkëputjes, që të shndërrohen në luftëra në vijën e shkëputjes. Sipas shprehjes së Bogdan Deniçit, kur

“etnosi bëhet demosí,”³⁴ rezultati fillestar është *polemosi* ose lufta.

Sidoqoftë, mbetet e ngritur pyetja përse, kur po mbyllet shekulli XX, myslimanët ishin të ndërlikuar në dhunën ndërgrupore shumë më tepër sesa popujt e qytetërimeve të tjera. A ka qenë gjithmonë kështu? Në të kaluarën të krishterët i kanë vrarë vëllezërit e tyre të krishterë dhe njerëzit e tjerë në shifra të mëdha. Që të vlerësohen kahjet e dhunës së qytetërimeve përmes historisë do të nevojiteshin kërkime të gjera, gjë që nuk mund të bëhet këtu. Megjithatë, mund të arrijmë të përcaktojmë shkaqet e mundshme për dhunën në grup të myslimanëve në ditët tona, si brenda ashtu edhe jashtë islamit, e gjithashtu të veçojmë ato shkaqe, që shpjegojnë kahjen më të madhe drejt konfliktit grupor përgjatë historisë, nëse kjo ekziston, prej atyre që shpjegojnë vetëm kahjen aty nga fundi i shekullit XX. Gjashtë shkaqe të mundshme dalin vetvetiu. Tre shpjegojnë vetëm dhunën ndërmjet myslimanëve e jomyslimanëve dhe tre i shpjegojnë të dyja këto dhe dhunën brenda islamit. Këto tre gjithashtu shpjegojnë vetëm kahjen bashkëkohëse myslimane drejt dhunës, ndërsa tre të tjerat shpjegojnë këtë dhe një kahje myslimane historike, nëse ajo ekziston. Megjithatë, në rast se kjo kahje historike nuk ekziston, atëherë nënkupton se ka shkaqe, të cilat nuk mund ta shpjegojnë një kahje historike mosekzistuese, e gjithashtu do të nënkuptohet se nuk shpjegojnë kahjen e vërtetuar myslimane drejt dhunës grupore. Kjo e fundit mund të shpjegohet vetëm me shkaqe të shekullit XX, që nuk ekzistonin në shekujt e mëparshëm (Tabela 10.4).

Tabela 10.4:
Shkaqet e mundshme të kahjes myslimane për konflikt

	Konflikt jashtëmysliman	Konflikt brenda e jashtë
Konflikt historik e bashkëkohës	Fqinjësia Mos-honepsja	Militarizmi
Konflikt bashkëkohës	Statusi i viktimës	Sipëria demografike Mungesa e shtetit bërthamë

E para, paraqitet si argument se që në fillimet e tij islami ka qenë fe e shpatës dhe se i ngre lart virtytet ushtarake. Islami e ka zanafillën mes “fiseve endacake beduine luftarake” dhe “kjo prejardhje e dhunshme është e vulosur në themelet e islamit. Vetë Muhamedi mbahet mend si luftëtar i fortë dhe komandant ushtarak i zoti.”⁵⁵ (Askush nuk mund të thotë po këtë gjë për Krishtin ose Budën). Arsyetohet, se doktrinat e islamit e pranojnë luftën kundër të pabesëve dhe kur vërshoi shtrirja e islamit në fillim, grupet myslimane, në kundërshtim të plotë me doktrinën, luftuan edhe mes tyre. Përpjesa e *fitna* ose e konflikteve të brendshme kundrejt xhihadit u zhvendos fort në të mirë të të parave. Kurani dhe predikimet e tjera të besimeve myslimane përmbajnë pak raste që e ndalojnë dhunën, ndërsa koncepti i mosdhunës mungon në doktrinën dhe praktikën myslimane.

E dyta, që nga lindja në Arabi, përhapja e islamit përmes Afrikës veriore dhe në pjesën më të madhe të Lindjes së Mesme, e më vonë në Azinë qendrore, në Nënkontinent e në Ballkan, i vuri myslimanët në kontakt të drejtpërdrejtë me shumë popuj të ndryshëm, të cilët u pushtuan dhe u kthyen në fenë e re, kështu që trashëgimia e këtij procesi mbetet e gjallë. Me pushtimet osmane në Ballkan sllavët e jugut të qyteteve shpesh u

kthyen në islam, ndërsa fshatarët jo, dhe kjo përftoi dallimin ndërmjet bosnjakëve myslimanë e serbëve ortodoksë. Anasjelltas, zgjerimi i Perandorisë Ruse drejt Detit të Zi, Kaukazit e Azisë Qendrore e futi në konflikt të pandërprerë për disa shekuj me një varg popujsh të ndryshëm myslimanë. Mbështetja e Perëndimit, në kohën e kulmit të fuqisë përballë islamit, për një atdhe të çifutëve në Lindjen e Mesme, hodhi themelet e antagonizmit arabo-izraelit që ende vazhdon. Kështu, zgjerimi i myslimanëve dhe i jomyslimanëve nëpër tokë solli si rrjedhim që myslimanët e jomyslimanët të jetojnë në fqinjësi të ngushtë fizike nëpër gjithë Eurazinë. Përkundrazi, zgjerimi i Perëndimit nëpër det zakonisht nuk i ka çuar popujt perëndimorë që të jetojnë në fqinjësi territoriale me popujt joperëndimorë: këta ose iu nënshtruan sundimit nga Europa ose, me përjashtim të Afrikës së jugut, në të vërtetë u dhjetuan prej kolonëve perëndimorë.

Një burim i tretë i mundshëm konflikti ndërmjet myslimanëve e jomyslimanëve e përbën ai, që një burrë shteti, duke e pasur fjalën për vendin e vet, e ka quajtur “mos-honepsja” e myslimanëve. Mirëpo mos-honepsja vepron në të dyja drejtimet: vendet myslimane me pakicat jomyslimane kanë probleme të krahasueshme me ato që vendet jomyslimane i kanë me pakicat myslimane. Madje edhe më shumë sesa krishterimi, islami është një besim absolutist. Ai i shkrin fenë me politikën dhe heq një vijë të prerë ndërmjet atyre që janë në *Dar al-Islam* dhe atyre në *Dar al-harb*. Si pasojë, konfucianët, budistët, hindutë, të krishterët perëndimorë dhe të krishterët ortodoksë kanë më pak vështirësi për t’u përshtatur dhe për të jetuar me njëri-tjetrin, sesa ka secili prej tyre për t’u përshtatur e për të jetuar me myslimanët. Për shembull, kinezët etnikë janë ekonomikisht pakica mbisunduese në shumicën e vendeve të Azisë

Juglindore. Ata janë përshtatur mjaft mirë në shoqëritë e Tajlandës budiste dhe të Filipineve katolike; në të vërtetë nuk ka raste me peshë të dhunës kundër kinezëve nga ana e grupeve të shumicës në ato vende. Përkundrazi, kanë ndodhur trazira kundër kinezëve dhe/ose dhunë në Indonezinë myslimane e në Malajzinë myslimane, kurse roli i kinezëve në ato shoqëri mbetet i ndjeshëm dhe një çështje me mundësi shpërthimi në atë mënyrë, që nuk ndeshet në Tajlandë e në Filipinet.

Militarizmi, mos-honepsja dhe fqinjësia me grupet jomyslimane janë tipare të qëndrueshme të islamit dhe mund të shpjegojnë kahjen drejt konfliktit të myslimanëve përgjatë gjithë historisë, në rast se do të ishte kështu. Për këtë kahje mund të kenë ndihmuar tre faktorë të tjerë të përkohshëm e të kufizuar gjatë fundit të shekullit të njëzetë. Një shpjegim, që është parashtruar prej myslimanëve, është se imperializmi Perëndimor dhe nënshtrimi i shoqërive myslimane në shekujt XIX e XX ka përfutur imazhin e dobësisë ushtarake dhe ekonomike të myslimanëve, gjë që u ka dhënë zemër grupeve joislamike t'i vështrojnë myslimanët si një objektiv tërheqës. Sipas këtij argumentimi, myslimanët janë viktima të paragjyqimit shumë të përhapur antimysliman, të krahasueshëm me antisemitizmin, që ka mbisunduar historikisht në shoqëritë Perëndimore. Grupe të tilla myslimane, si palestinezët, bosnjakët, kashmirasit dhe çeçenët, sipas pohimit të Akbar Ahmedit, janë si "indianët e kuq, grupe të shtypura, me dinjitet të shkelur, të rrasur nëpër rezervate, që janë tokat e strëgjyshëve të tyre, të kthyera në të tilla."³⁶ Mirëpo, argumenti për myslimanët si viktima nuk i shpjegon konfliktet ndërmjet shumicave myslimane dhe pakicave jomyslimane në vende si Sudani, Egjipti, Irani e Indonezia.

Një faktor më bindës ndoshta i shpjegon si konfliktet brenda, ashtu edhe ato jashtë islamit: mungesa e një ose disa shteteve bërthamë të islamit. Mbrojtësit e islamit shpesh mëtojnë se kritikët e tij Perëndimorë besojnë që ka një forcë qendrore, komplotuese, drejtuese të islamit, e cila mobilizon dhe bashkërendon veprimet e tij kundër Perëndimit e të tjerëve. Nëse kritikët e besojnë këtë, ata e kanë gabim. Islami është një burim paqëndrueshmërie në botë, sepse i mungon një qendër mbisunduese. Shtetet që synojnë të bëhen udhëheqëse të islamit, si Arabia Saudite, Irani, Pakistani, Turqia, dhe në mundësi Indonezia, hahen për ndikimin mbi botën myslimane; asnjëra prej tyre nuk është në pozita të forta për të hyrë si ndërmjetës në konfliktet brenda islamit, kurse asnjëra prej tyre nuk është në gjendje të veprojë me autoritet në emër të islamit në trajtimin e konflikteve ndërmjet grupeve myslimane dhe jomuslimane.

Së fundi, dhe ajo që është më e rëndësishme, shpërthimi demografik në shoqëritë myslimane dhe prania e një numri të madh burrash shpesh të papunë të moshave nga pesëmbëdhjetë deri në tridhjetë vjeç përbën një burim natyror paqëndrueshmërie e dhune si brenda islamit, edhe kundër jomuslimanëve. Cilatdo shkaqe të tjera që të veprojnë, vetëm ky faktor do të arrinte ta shpjegonte më shumë dhunën myslimane në vitet 1980 e 1990. Plakja e këtij brezi të kapërthyer aty nga dhjetëvjeçari i tretë i shekullit XXI dhe zhvillimi ekonomik në shoqëritë myslimane, nëse do të bëhet, mund të sjellin si rrjedhim të pakësimit i ndjeshëm i kahjes drejt dhunës myslimane dhe prej kësaj, të rënia e përgjithshme e dendurisë dhe e intensitetit të luftërave në vijën e shkëputjes.

Kreu 11: Dinamika e luftërave në vijën e shkëputjes

Identiteti: rritja e vetëdijes së qytetërimit

Luftërat në vijën e shkëputjes kalojnë përmes disa proceseve: intensifikimit, zgjerimit, përmbajtjes, ndërprerjes dhe, rrallë, zgjidhjes. Zakonisht këto procese nisin sipas shkallëve, por gjithashtu shpesh ato mbivihen dhe mund të përsëriten. Luftërat në vijën e shkëputjes pasi fillojnë, ashtu si dhe luftërat e tjera ndërmjet bashkësive, kanë prirje të përftojnë jetën e tyre të vet dhe të zhvillohen sipas një modeli veprim-kundërveprim. Ato identitete, që më parë ishin të shumëfishta e të rastit, tashti përqendrohen dhe ngurtësohen; konfliktet ndërmjet bashkësive përafërsisht mund të quhen “luftëra identiteti”.¹ Me shtimin e dhunës, çështjet e ngritura në fillim anojnë drejt ripërcaktimit në mënyrë më përjashtuese, si “ne” kundër “atyre”, dhe nxiten kohezioni e bashkëlidhja e grupit. Udhëheqësit politikë i shtojnë e i thellojnë thirrjet e tyre drejtuar besnikërisë etnike e fetare, kurse vetëdija qytetërimore fuqizohet kundrejt identiteteve të tjera. Përftohet një “dinamikë e urrejtjes”, e krahasueshme me

“dilemën e sigurisë” në marrëdhëniet ndërkombëtare, në të cilën frikërat e dyanshme, mosbesimi dhe urrejtja ushqejnë njëra-tjetrën.² Secila palë e zmadhon dhe e dramatizon dallimin ndërmjet forcave të virtytit dhe forcave të së keqes e më në fund orvatet ta shndërrojë këtë dallim në dallimin përfundimtar ndërmjet të shpejtit e të vdekurit.

Me shtjellimin e mëtejshëm të revolucioneve, të moderuarit, zhirondinët e menshevikët, pësojnë humbje përballë radikalëve, jakobinëve e bolshevikëve. Një proces i ngjashëm ka prirje të ndodhë edhe te luftërat në vijën e shkëputjes. Të moderuarit me synime më të kufizuara, si autonomia e jo pavarësia, nuk i arrijnë qëllimet e tyre përmes bisedimeve, të cilat pothuaj kurdoherë në fillim dështojnë, dhe atëherë plotësohen ose zëvendësohen prej radikalëve, të vendosur për të arritur synime më të skajshme me anë të dhunës. Në konfliktin moro-filipine, grupi kryesor kryengritës, Fronti i Çlirimit Kombëtar Moro, në fillim u plotësua me Frontin e Çlirimit Islamik Moro, i cili mbante qëndrime më të skajshme, pastaj me Abu Sajafin, që ishte edhe më ekstremist dhe i hodhi poshtë armëpushimet e arritura nga grupet e tjera me anë të bisedimeve me qeverinë filipinase. Në Sudan gjatë viteve 1980 qeveria mbajti qëndrime islamiste ekstremiste gjithnjë e në rritje, kurse në fillim të viteve 1990 kryengritja e krishterë u përçua me një grup të ri, Lëvizjen e Pavarësisë së Sudanit Jugor, që përkrahte pavarësinë dhe jo thjesht autonominë. Në konfliktin që po vijon ndërmjet izraelitëve e arabëve, ndërkohë që Organizata për Çlirimin e Palestinës si rryma kryesore nisi të bënte hapa drejt bisedimeve me qeverinë e Izraelit, Hamasi i Vëllezërisë Myslimane iu kundërvu me besnikërinë ndaj palestinezëve. Njëkohësisht përfshirja në bisedimet e qeverisë së Izraelit shkaktoi protesta e dhunë nga grupet

fetare ekstremiste në Izrael. Kur konflikti ndërmjet Ruisë e Çeçenisë u përforcua më 1992-93, në qeverinë e Dudajevit e morën epërsinë “fraksionet më radikale të nacionalistëve çeçenë, që kundërshtonin çfarëdo pajtimi me Moskën, ndërsa forcat më të moderuara u detyruan të kalonin në opozitë.” Një zhvendosje e ngjashme ndodhi në Taxhikistan. “Kur konflikti pati shkallëzim në vitin 1992, grupet taxhike nacionaliste-demokratike pak nga pak u tërhoqën para ndikimit të grupeve islamiste, që patën më shumë sukses në mobilizimin e fshatarëve të varfër dhe të rinjve të pakënaqur të qyteteve. Edhe mesazhi islamist u bë hap pas hapi më radikal, kur dolën udhëheqës më të rinj, që iu kundërvunë hierarkisë fetare më tradicionale dhe më pragmatike.” “Po e mbyll fjalorin e demokracisë,” ka thënë një udhëheqës taxhik. “Po filloj të flas gjuhën e fushës së betejës, e cila është e vetmja gjuhë e përshtatshme në rrethanat e krijuara prej Ruisë në atdheun tim.”³ Në Bosnjë brenda Partisë Myslimane të Veprimit Demokratik (SDA), fraksioni nacionalist më ekstremist, i udhëhequr prej Alija Izetbegoviqit fitoi më shumë ndikim, sesa fraksioni më tolerant, me orientim shumëkulturore, i udhëhequr prej Haris Silajshiqit.⁴

Fitorja e ekstremistëve nuk është doemos e përhershme. Dhuna e skajshme nuk ka më shumë gjasa sesa kompromisi i të moderuarve për t’i dhënë fund një lufte në vijën e shkëputjes. Me shtimin e numrit të të vdekurve dhe me përshkallëzimin e shkatërrimeve, që nuk janë ndonjë pamje e kënaqshme, ka gjasa që nga ana e të dyja palëve të rishfaqen të moderuarit, duke vënë në dukje përsëri se e gjitha kjo “nuk ka kuptim” dhe duke kërkuar të bëhet një orvatje tjetër për t’i dhënë fund me anë të bisedimeve.

Gjatë ecurisë së luftës veniten mjaft identitete dhe merr mbizotërim identiteti më domethënës lidhur me

atë konflikt. Ky identitet pothuaj kurdoherë përcaktohet prej fesë. Nga ana psikologjike feja jep përligjjen më garantuese dhe mbështetëse për luftën kundër forcave “të paperëndi”, që shihen si të tilla, që përbëjnë kërcënim. Praktikisht bashkësia fetare ose qytetërimore është bashkësia më e gjerë, së cilës mund t’i drejtohet për mbështetje grupi vendor i përfshirë në konflikt. Nëse në një luftë lokale ndërmjet dy fiseve afrikane, njëri fis mund ta përcaktojë veten si mysliman dhe tjetri si i krishterë, i pari mund të shpresojë të gjejë mbështetje nga paratë e Arabisë Saudite, nga *muxhabidinët* afganë dhe armët e këshilltarët ushtarakë të Iranit, kurse i dyti mund t’i hedhë sytë nga ndihma ekonomike dhe humanitare e Perëndimit, si dhe nga mbështetja politike e diplomatike e qeverive të Perëndimit. Në rast se një grup nuk vepron ashtu, siç bënë myslimanët bosnjakë që e paraqitën bindshëm veten si viktimë të gjenocidit, e rrjedhimisht ngjallën simpatinë e Perëndimit, ai mund të shpresojë të marrë ndihmë të ndjeshme vetëm prej fafesisit të vet qytetërimor, dhe me përjashtim të rastit të bosnjakëve myslimanë, kështu ka ndodhur. Luftërat në vijën e shkëputjes sipas përkufizimit janë luftëra ndërmjet grupeve lokale, me lidhje më të gjera e, rrjedhimisht, fuqizojnë identitetet qytetërimore mes pjesëmarrësve në to.

Përforcimi i identiteteve qytetërimore ka ndodhur mes pjesëmarrësve të luftërave në vijën e shkëputjes nga qytetërimet të ndryshme, por ka mbizotëruar sidomos mes myslimanëve. Një luftë në vijën e shkëputjes mund ta ketë burimin te konfliktet në familje, në fis ose në klan, por për shkak se identitetet në botën myslimane kanë prirje të marrin trajtën **U**, me përparimin e luftës pjesëmarrësit myslimanë shumë shpejt nisin orvatjet për ta zgjeruar identitetin e vet dhe i bëjnë thirrje gjithë islamit, siç ka ndodhur madje edhe me një shekullarist

antifundamentalist si Saddam Huseini. Po ashtu qeveria e Azerbajxhanit, siç e ka vënë në dukje një vëzhgues Perëndimor, e ka luajtur “kartën islamike”. Në Taxhikistan, gjatë një luftë që nisi si konflikt rajonal brenda Taxhikistanit, kryengritësit gjithnjë e më tepër e përcaktuan çështjen e tyre si kauzë të islamit. Në luftërat e shekullit XIX ndërmjet popujve të Kaukazit verior dhe rusëve, udhëheqësi Shamil e quajti veten si islamist dhe bashkoi duzina grupesh etnike e gjuhësore “mbi bazën e islamit dhe të qëndresës kundër pushtimit rus.” Në vitet 1990 Dudajevi nxori përfitime prej Ringjalljes Islamike, që kishte gjetur vend në Kaukaz në vitet 1980, për të ndjekur një strategji të ngjashme. Ai pati mbështetjen e klerikëve myslimanë dhe të partive islamiste, e bëri betimin e detyrës mbi Kuran (madje ashtu si u bekua nga patriarku ortodoks) dhe më 1994 propozoi që Çeçenia të bëhej shtet islamik, i qeverisur nga *sheriati*. Trupat çeçene mbanin shalla “të zbukuruar me fjalën ‘Gazavat’, që në çeçenishten do të thotë lufta e shenjtë,” dhe thërrisnin “Allahu Eqber”, kur niseshin në fushën e betejës.⁵ Në mënyrë të ngjashme, vetëpërcaktimi i myslimanëve të Kashmirit nga një identitet rajonal, që përfshinte myslimanë, hindu e budistë, ose nga identifikimi me shekullarizmin indian, kaloi te një identitet i tretë, që gjeti pasqyrim në “ngritjen e nacionalizmit mysliman në Kashmir dhe në përhapjen e vlerave fundamentaliste islamike transnacionale, të cilat i bënë myslimanët e Kashmirit ta ndienin veten njëherësh si pjesë të Pakistanit islamik dhe të botës islamike.” Kryengritja e vitit 1989 kundër Indisë në zanafillë udhëhiqej prej një organizate “relativisht shekullare”, të mbështetur prej qeverisë së Pakistanit. Më pas mbështetja e Pakistanit kaloi te grupet islamike fundamentaliste, që morën epërsinë. Këto grupe përfshinin “kryengritës të betuar”, të cilët dukeshin “të

vendosur për ta vazhduar *shihadin* e tyre për hir të tij, pavarësisht nga shpresat dhe arritjet.” Një vëzhgues tjetër ka njoftuar se “Ndjenjat nacionaliste janë ngritur lart prej dallimeve fetare; fuqizimi i përgjithshëm i militantizmit islamik u ka dhënë zemër kryengritësve të Kashmirit dhe e ka gërryer traditën kashmirase të tolerancës mes hinduve e myslimanëve.”⁶

Një ngritje e befasishme e identitetit qytetërimor ndodhi në Bosnjë, sidomos në bashkësinë e saj myslimane. Historikisht identitetet e bashkësive në Bosnjë nuk kishin qenë të forta; serbët, kroatët dhe myslimanët kishin jetuar së bashku paqësisht si fqinjë; kishin qenë të zakonshme martesat mes grupeve; identifikimi me fenë kishte qenë i dobët. Thuhej se myslimanët ishin bosnjakë që nuk shkonin në xhami, kroatët ishin bosnjakë që nuk shkonin në katedrale dhe serbët ishin bosnjakë që nuk shkonin në kishën ortodokse. Mirëpo kur u shemb identiteti më i gjerë jugosllav, këto identitete fetare të rastit morën peshë të re dhe kur nisën luftimet, u fuqizuan. Gjendja me shumë bashkësi të lidhura u avullua dhe secili grup gjithnjë e më shumë e identifikonte veten me bashkësinë kulturore dhe e përcaktonte veten sipas përkatësisë fetare. Serbët bosnjakë u bënë nacionalistë serbë ekstremistë, që e njëjtësonin veten me Serbinë e Madhe, me kishën ortodokse serbe dhe më gjerë me bashkësinë ortodokse. Kroatët bosnjakë u bënë nacionalistët më të zjarrtë kroatë, që e quanin veten qytetarë të Kroacisë, vinin në dukje se ishin katolikë dhe së bashku me kroatët e Kroacisë, edhe njëjtësinë e tyre me Perëndimin katolik.

Edhe më e shënuar ishte zhvendosja e myslimanëve drejt vetëdijes qytetërimore. Deri në kohën kur shpërtheu lufta, myslimanët bosnjakë kishin një botëvështrim mjaft shekullar, e shihnin veten si evropianë dhe ishin përkrahësit më të fortë të një

shoqërie e shteti bosnjak shumëkulturore. Mirëpo kjo nisi të ndryshonte, kur u shpërbë Jugosllavia. Ashtu si dhe kroatët e serbët, në zgjedhjet e vitit 1990 myslimanët u kthyen krahët partive që përfshinin shumë bashkësi dhe votuan në mënyrë dërmuese për Partinë Myslimane të Veprimit Demokratik (SDA), të udhëhequr prej Izetbegoviqit. Ai është mysliman i devotshëm, e kishte burgosur qeveria komuniste për veprimtari islamiste dhe libri i tij, *Deklarata Islamike*, i botuar më 1970, argumentonte “papajtueshmërinë e islamit me sistemet joislamike. Nuk mund të ketë as paqe dhe as bashkekzistencë ndërmjet fesë islame e institucioneve shoqërore e politike joislamike.” Kur lëvizja islamike është mjaft e fortë, duhet të marrë pushtetin dhe të ngrejë një republikë islamike. Në këtë shtet të ri ka rëndësi të veçantë që arsimit e mediat “të jenë në duart e njerëzve që kanë autoritet moral e intelektual islamik të padiskutueshëm.”⁷

Kur Bosnja u bë shtet i pavarur, Izetbegoviqi përkrahu një shtet shumetnik, në të cilin myslimanët do të ishin grupi mbizotërues, ndonëse mund të mos e arrinin shumicën. Mirëpo ai nuk ishte nga ata njerëz, që do ta kundërshtonin islamizimin e vendit, të shkaktuar prej luftës. Ngurrimi i tij për të mos e hedhur poshtë haptas e publikisht *Deklaratën Islamike*, u ngjallte frikë jo-myslimanëve. Me shtjellimin e mëtejshëm të luftës, serbët e kroatët e Bosnjës u shpërngulën prej zonave nën kontrollin e qeverisë bosnjake dhe ata që mbetën e panë veten pak nga pak të përjashtuar prej punëve të kërkuara dhe prej pjesëmarrjes në institucionet shoqërore. “Islami ka fituar rëndësi më të madhe brenda bashkësisë kombëtare myslimane dhe ...një identitet i fortë kombëtar mysliman është bërë pjesë e politikës dhe e fesë.” Nacionalizmi mysliman, në kundërvënie me nacionalizmin bosnjak shumëkulturore, gjeti shprehje

gjithnjë e më të gjerë në mediat. Mësimet fetare u zgjeruan nëpër shkolla dhe tekstet e reja theksonin përfitimet nën sundimin osman. Gjuha bosnjake u paraqit si e ndryshme prej serbokroatishtes e gjithnjë e më shumë në të u përfshinë fjalë turke e arabe. Zyrtarë qeveritarë i godisnin martesat e përziera dhe transmetimin e muzikës “së agresorit” ose të serbëve. Qeveria e nxiste fenë islame dhe u jepte përparësi myslimanëve në paga e për ngritjet në poste. Po ajo që është më e rëndësishmja, ushtria bosnjake u islamizua, myslimanët përbënin mbi 90 për qind të personelit aty nga viti 1995. Gjithnjë e më shumë njësi ushtarake e njëjtësonin veten me islamin, kryenin ritet islamike dhe përdornin simbolet myslimane, kurse njësitë e zgjedhura u bënë më të islamizuara tërësisht e u zgjeruan si numër. Kjo prirej shkaktoi një protestë të pesë anëtarëve (duke përfshirë dy kroatë e dy serbë) në presidencën bosnjake, që iu paraqit Izetbegoviqit, por ai e hodhi poshtë dhe më 1995 dha dorëheqjen kryeministri Haris Silajxhiqi, i cili i përmbahej orientimit shumëkulturore.⁸

Nga ana politike Partia myslimane e Izetbegoviqit, SDF-ja, e shtriu kontrollin e vet mbi gjithë shtetin e shoqërinë e Bosnjës. Nga viti 1995 ajo kishte nën kontroll “ushtarinë, shërbimet civile dhe sipërmarrjet publike.” “Myslmanët që nuk bëjnë pjesë në parti,” siç është njoftuar, “pa përmendur jomyslmanët, e kanë të vështirë të gjejnë punë të përshtatshme.” Kritikët e saj e fajësonin partinë se “ishte bërë një vegël e autoritarizmit islamik, që bartte shenja të shprehive të qeverisë komuniste.”⁹ Përgjithësisht, siç ka njoftuar një vëzhgues tjetër:

Nacionalizmi mysliman po bëhet më ekstremist. Ai tashti nuk ua vë veshin ndjeshmërive kombëtare; ai është prona,

privilegji dhe vegla politike e kombit të ri mysliman mbisundues...

Rezultati kryesor i këtij nacionalizmi të ri mysliman është lëvizja drejt homogjenizimit kombëtar...

Gjithashtu gjithnjë e më shumë fundamentalizmi fetar islamik po fiton epërsinë në përcaktimin e interesave kombëtarë myslimanë.¹⁰

Përforcimi i identitetit fetar, i shkaktuar nga lufta dhe spastrimi etnik, parapëlqimet e udhëheqësve të tij dhe mbështetja e trysnia nga shtetet e tjera myslimane ngadalë por qartas nisën ta shndërronin Bosnjën nga Zvicra e Ballkanit në Iranin e Ballkanit.

Në luftërat e vijës së shkëputjes secila palë ka shtysa jo vetëm për ta nënvizuar identitetin e vet qytetërimor, por edhe atë të palës tjetër. Në luftën e vet lokale, ajo e sheh se jo vetëm po lufton një grup tjetër etnik lokal, por po lufton edhe kundër një qytetërimi tjetër. Kështu kërcënim i zgjerohet e mbështetet nga burimet e një qytetërimi të madh, kurse disfata ka pasoja jo vetëm për atë vetë, por edhe për gjithë qytetërimin e saj. Rrjedhimisht, lind nevoja e ngutshme që në atë konflikt qytetërimi i palës përkatëse të rreshtohet prapa saj. Lufta lokale ripërcaktohet si luftë mes fesh, si përplasje e qytetërimeve, e mbarsur me pasoja për segmente të mëdha të njerëzimit. Në fillim të viteve 1990, ndërkohë që feja ortodokse dhe Kisha ortodokse përsëri u bënë elementë qendrorë në identitetin kombëtar rus, që “i ngushtoi e i dëboi konfesionet e tjera ruse, ndër të cilat islami është më i rëndësishmi,”¹¹ rusët e panë se ishte në interesin e tyre që luftën ndërmjet fiseve e krahinave në Taxhikistan dhe luftën me Çeçeninë t’i përcaktonin si pjesë përbërëse të përplasjes më të madhe, e cila kishte shekuj që po bëhej ndërmjet ortodoksisë e islamit, ndërkohë që kundërshtarët e tyre lokalë tashmë ishin të lidhur me fundamentalizmin islamik, me xhihadin e me

farefisnin e tyre nga Islamabadi, Teherani, Riadi dhe Ankaraja.

Në Jugosllavinë e mëparshme kroatët e shihnin veten si roja kufitare kreshnike të Perëndimit kundër sulmeve të ortodoksisë e të islamit. Serbët i përcaktonin armiqtë e tyre jo si kroatë dhe myslimanë bosnjakë, por si “Vatikani” dhe “fundamentalistët islamikë” e “turqit e pabesë”, që prej shekujsh e kërcënonin krishterimin. Për udhëheqësin serb bosnjak një diplomat Perëndimor ka thënë: “Karaxhiqi e sheh këtë si luftë antiimperialiste në Europë. Ai thotë se ka një mision për të çrrënjosur gjurmët e fundit të Perandorisë Osmane turke në Europë.”¹² Nga ana e tyre, myslimanët bosnjakë e përcaktonin veten si viktimat të gjenocidit, që shpërfillëshin prej Perëndimit për shkak të fesë së tyre, e rrjedhimisht, meritonin të kishin mbështetjen e botës myslimane. Kështu të gjitha palët dhe shumica e vëzhguesve të luftërave në Jugosllavi përfunduan duke i parë si luftëra fetare ose etnofetare. Misha Glenny (Gleni) ka vënë në dukje, se konflikti “gjithnjë e më tepër përthithi tiparet e përleshjes fetare, të përcaktuara prej tri besimeve të mëdha europiane: katolicizmit, ortodoksisë lindore dhe islamit, mbetjet konfesionale të atyre perandorive, kufijtë e të cilave ndesheshin në Bosnjë.”¹³

Perceptimi i luftërave në vijën e shkëputjes si përplasje qytetërimesh gjithashtu e përtëriu teorinë e dominosë, që kishte gjalluar gjatë Luftës së ftohtë. Megjithatë, tashti ishin shtetet e mëdha të qytetërimeve, që e shihnin të nevojshme të mos e lejonin thyerjen në një konflikt lokal, i cili mund të shkaktonte një vargëzim të humbjeve të përshkallëzuara, që do të çonin në katastrofë. Qëndrimi i patundur i qeverisë indiane për Kashmirin në një pjesë të madhe buronte nga frika se mos humbja aty do të nxiste pakicat e tjera etnike e

fetare që të kërkonin pavarësinë dhe kështu do të çonin deri te shpërbërja e Indisë. Nëse Rusia nuk do t'i jepte fund dhunës në Taxhikistan, ka paralajmëruar ministri i jashtëm Kozirev, kishte gjasa që ajo të përhapej në Kirgizstan e në Uzbekistan. Është argumentuar, se kjo pastaj do t'u jepte mbështetje lëvizjeve për shkëputje në republikat islamike të Federatës Ruse, ndërsa disa njerëz ishin shprehur se rezultati përfundimtar do të ishte zbritja e fundamentalizmit islamik në Sheshin e Kuq. Prandaj, siç ka thënë Jelcini, kufiri afgan-taxhik është "në fakt i Ruisë." Nga ana e tyre, europianët kanë shprehur shqetësime se krijimi i një shteti mysliman në ish Jugosllavinë mund të krijonte bazën për përhapjen e imigrantëve myslimanë dhe të fundamentalizmit islamik, duke përforcuar atë, që Zhak Shiraku e ka përmendur si "*les odeurs d'Islam*" në Europë.¹⁴ Kufiri i Kroacisë është në fakt kufiri i Europës.

Me përforcimin e mëtejshëm të luftës në vijën e shkëputjes, secila palë i demonizon kundërshtarët e vet, shpesh i paraqet si nënnerëz, rrjedhimisht, e quan të përligjur vrasjen e tyre. "Qentë e tërbuar duhen vrarë," ka thënë Jelcini duke pasur para sysh gueriljet çeçene. "Këta njerëz të rritur keq duhen qëlluar... dhe ne do t'i qëllojmë," ka thënë gjenerali indonezian Try Sutrisno, duke e pasur fjalën për masakrën në Timorin Lindor më 1991. Djajtë e së kaluarës ringjallen në të sotmen: kroatët bëhen "ustashë"; myslimanët kthehen në "turq" dhe serbët në "çetnikë". Vrasjet masive, torturat, përdhunimet dhe dëbimi i egër i civilëve bëhen të gjitha të përligjura, pasi urrejtja e bashkësisë ushqehet nga urrejtja e bashkësisë. Simbolet dhe shenjat qendrore të kulturës kundërshtarë kthehen në objektiva për t'i qëlluar. Serbët i kanë shkatërruar sistematikisht xhamitë e manastiret françeskane, ndërsa kroatët i kanë hedhur në erë manastiret ortodokse. Si ruajtëse të kulturës, edhe

muzetë e bibliotekat janë objektiva të prekshëm, kështu, forcat e sigurimit të sinhalezëve dogjën bibliotekën publike të Xhafnas, shkatërruan “dokumente letrare e historike të pazëvendësueshme” të lidhura me kulturën tamile, kurse artilierët serbë qëlluan e shkatërruan Muzeun Kombëtar në Sarajevë. Serbët e spastruan qytetin bosnjak të Zvornos nga 40.000 banorët myslimanë dhe ngulën një kryq në vendin e kullës osmane, që sapo e kishin hedhur në erë, e pastaj e zëvendësuan kishën ortodokse, të cilën turqit e kishin rrafshuar me tokën më 1463.¹⁵ Në luftërat ndërmjet kulturave është kultura që humbet.

Grupimi sipas qytetërimit: vendet me afëri dhe diasporat

Gjatë dyzet vjetëve të Luftës së ftohtë konflikti depërtoi teposhtë, ndërkohë që superfuqitë orvateshin të rekrutonin aleatë e ortakë dhe të minonin, të kthenin në anën e vet ose të asnjësonin aleatët e ortakët e superfuqisë tjetër. Natyrisht, rivaliteti që më i madh në Botën e Tretë, ndërsa ndaj shteteve të reja e të dobëta ushtrohej trysni nga superfuqitë, që të përfshiheshin në rivalitetin global. Në botën pas Luftës së ftohtë, konfliktin vetëm ndërmjet superfuqive e kanë zëvendësuar konfliktet e shumëfishta ndërmjet bashkësive. Kur këto konflikte mes bashkësive ngërthejnë grupe prej qytetërimesh të ndryshme, atëherë kanë prirje të zgjerohen e të përshkallëzohen. Krahas intensifikimit të konfliktit, secila palë orvatet të gjejë mbështetje nga vendet e grupet që i përkasin qytetërimit

të saj. Mbështetja në njëren ose në tjetren formë, zyrtare ose jozyrtare, e hapur ose e mbuluar, materiale, njerëzore, diplomatike, financiare, simbolike ose ushtarake, kurdoherë vjen prej njërit ose prej disa grupeve a vendeve të farefisit. Sa më tepër zgjat një konflikt në vijën e shkëputjes, aq më shumë vende të farefisit ka të ngjarë të ndërlikohen në rolet e mbështetjes, shtrëngesës dhe ndërmjetësimit. Si rrjedhim i këtij “sindromi të vendit farefis”, konfliktet në vijën e shkëputjes kanë një potencial shumë më të lartë për shkallëzim, sesa ndodh me konfliktet ndërqytetërimore, e gjithashtu zakonisht kërkojnë bashkëpunimin ndërqytetërimor për t’i përmbajtur dhe për t’u dhënë fund. Krejt ndryshe nga Lufta e ftohtë, konflikti nuk rrjedh teposhtë nga sipër, ai gurgullon që teposhtë.

Shtetet dhe grupet kanë nivele të ndryshme ndërlikimi në luftërat në vijën e shkëputjes. Në nivelin parësor ndodhen ato palë, që janë aktualisht duke u përleshur dhe duke vrarë njëra-tjetren. Këto mund të jenë shtete, si në luftërat ndërmjet Indisë e Pakistanit dhe ndërmjet Izraelit e fqinjëve të tij, por mund të jenë edhe grupe lokale, që nuk janë shtete ose, në rastin më të mirë, janë shtete në embrion, siç qe rasti në Bosnjë dhe me armenët e Nagorno-Karabakut. Këto konflikte po ashtu mund të përfshijnë pjesëmarrës të nivelit të dytë, zakonisht shtete të lidhura drejtpërdrejt me palët parësore, si në rastin e qeverive të Serbisë e të Kroacisë në ish Jugosllavi, dhe të Armenisë e Azerbajxhanit në Kaukaz. Lidhjet me konfliktin i kanë edhe më të largëta shtetet e radhës së tretë, që janë edhe tutje larg nga përleshja aktuale, por që kanë lidhje qytetërimore me pjesëmarrësit, si Gjermania, Rusia e shtetet islamike kundrejt ish Jugosllavisë, e po ashtu Rusia e shtetet islamike kundrejt ish Jugosllavisë, ose Rusia, Turqia dhe Irani në rastin e grindjes mes armenëve e azerëve. Këta

pjesëmarrës të nivelit të tretë shpesh janë shtete bërthamë të qytetërimeve të tyre. Kur ka të tilla, diasporat e pjesëmarrësve të nivelit të parë gjithashtu luajnë rol të luftërat në vijën e shkëputjes. Për shkak të numrit të vogël të njerëzve e të armëve, që zakonisht ndërlikohen në nivelin parësor, edhe përmasa relativisht modeste të ndihmës nga jashtë, në trajtën e parave, armëve ose vullnetarëve, shpesh mund të kenë ndikim të madh në ecurinë e luftës.


Arsyet përse palët e tjera marrin pjesë në konflikt nuk janë të njëjta me ato të pjesëmarrësve të nivelit parësor. Si rregull, mbështetja më e përkushtuar dhe me gjithë zemër për palët e nivelit parësor vjen nga bashkësitë e diasporës, që e njëjtësojnë fort veten me çështjen e farefisit të tyre dhe bëhen “më katolikë se papa”. Interesat e qeverive të nivelit të dytë e të tretë janë më të ngatërruara. Zakonisht ato u japin mbështetje pjesëmarrësve të nivelit parësor. Madje edhe kur nuk veprojnë kështu, nga ana e grupeve kundërshtarë mbi to bien dyshimet se janë duke e bërë këtë gjë, pasi kjo i përlligj këto grupe që t’i japin mbështetje farefisit të vet. Mirëpo, përveç kësaj, qeveritë e nivelit të dytë e të tretë kanë interes që ta kufizojnë përleshjen dhe të mos ndërlikohen vetë drejtpërdrejt. Prej këndeje vjen si rrjedhim, që ndërsa u japin ndihmë pjesëmarrësve të nivelit të parë, gjithashtu orvaten t’i përmbajnë pjesëmarrësit dhe t’i detyrojnë që t’i ulin objektivat e tyre. Gjithashtu ato zakonisht bëjnë përpjekje për të biseduar me kundërpalët e tyre të nivelit të dytë e të tretë nga secila anë e vijës së shkëputjes, duke e penguar kështu luftën lokale, që të mos përshkallëzohet në një luftë më të gjerë, e cila të përfshijë edhe shtete bërthamë. Skica 11.1 paraqet marrëdhëniet e këtyre palëve potenciale kundrejt luftërave në vijën e shkëputjes. Jo të gjitha luftërat e këtilla kanë këtë trupë të plotë aktorësh,

por disa e kanë, duke përfshirë edhe ato në ish Jugosllavi e në Transkaukaz, kurse pothuaj cilado luftë në vijën e shkëputjes mund të zgjerohej e të përfshinte gjithë nivelet e pjesëmarrësve.

Në një mënyrë ose në një tjetër diasporat e vendet farefisnore janë ngatërruar në secilën luftë në vijën e shkëputjes gjatë viteve 1990. Për shkak të rolit parësor të gjerë të grupeve myslimane në luftëra të tilla, qeveritë dhe shoqatat myslimane janë më dendur pjesëmarrësit e dytë e të tretë. Më aktive janë treguar qeveritë e Arabisë Saudite, Pakistanit, Iranit, Turqisë e Libisë, të cilat së bashku, nganjëherë edhe me shtete të tjera myslimane, kanë dhënë ndihmesë në shkallë të ndryshme për të mbështetur myslimanët, që luftojnë kundër jomuslimanëve në Palestinë, Liban, Bosnjë, Çeçeni, Transkaukaz, Taxhikistan, Kashmir, Sudan e Filipine. Përveç mbështetjes qeveritare, mjaft grupe myslimane të nivelit parësor kanë gjetur mbështetje duke u kaluar luftëtarë islamistë ndërkombëtarë nga lufta e Afganistanit, të cilët janë ndërlikuar në konflikte që prej luftës civile në Algjeri deri në Çeçeni e Filipine. Ndërkombëtarët islamistë, siç e ka vënë në dukje një analist, janë ngatërruar me “dërgimin e vullnetarëve me qëllim që të vendosej sundimi islamist në Afganistan, Kashmir e Bosnjë; në luftërat e përbashkëta të propagandës kundër qeverive që kundërshtojnë islamistët e njërit apo tjetrit vend; në ngritjen e qendrave islamike në diasporë, të cilat shërbejnë njëkohësisht edhe si shtabe politike për të gjitha ato palë.”¹⁶ Lidhja Arabe dhe Organizata e Konferencës Islamike gjithashtu kanë dhënë mbështetje dhe kanë bërë orvatje për t’i bashkërenduar përpjekjet e anëtarëve të tyre që të fuqizohen grupet myslimane në konfliktet ndërqytetërimore.

Bashkimi Sovjetik qe pjesëmarrës parësor në Luftën e Afganistanit dhe në vitet pas Luftës së ftohtë Rusia ka qenë pjesëmarrësi parësor në Luftën e Çeçenisë, pjesëmarrësi dytësor në luftimet në Taxhikistan, si dhe pjesëmarrës i tretë në luftërat e ish Jugosllavisë. India bëri një ndërhyrje parësore në Kashmir dhe një dytësore në Sri Lankë. Shtetet kryesore Perëndimore kanë qenë pjesëmarrës të tretë në përleshjet e Jugosllavisë. Diasporat kanë luajtur rol kryesor nga të dyja palët në luftimet e zgjatura ndërmjet izraelitëve e palestinezëve, si edhe për mbështetjen e armenëve, kroatëve e çeçenëve në konfliktet e tyre. Njëpërmjet televizionit, fakseve dhe postës elektronike “përkushtimi i disaporave rifuqizohet e nganjëherë polarizohet prej kontakteve të pandërprera me atdheun e tyre të mëparshëm; ‘i mëparshëm’ nuk e ka më kuptimin e dikurshëm.”¹⁷

Skica 11.1:
Struktura e një lufte të ndërlikuar në vijën e shkëputjes



Në luftën e Kashmirit, Pakistani u dha kryengritësve mbështetje të hapur diplomatike e politike dhe, sipas burimeve ushtarake pakistaneze, i furnizoi me sasi të mëdha parash e armësh, e gjithashtu i stërviti, u dha mbështetje logjistike e vend strehimi. Njëkohësisht u kërkoi përkrahjen në emër të tyre qeverive të tjera myslimane. Aty nga viti 1995, sipas njoftimeve, kryengritësit u përforcuan me të paktën 1200 luftëtarë *muxhabidinë* nga Afganistani, Tashkistani dhe Sudani, të pajisur me raketa Stinger dhe me armë të tjera, të furnizuara prej amerikanëve për luftën e tyre kundër Bashkimit Sovjetik.”¹⁸ Kryengritja e morove në Filipinet për një kohë përfitoi nga fondet e pajisjet prej Malajzie; qeveritë arabe dhanë fonde të tjera; disa mijëra kryengritës u stërvitën në Libi, kurse grupi kryengritës

ekstremist, Abu Sajaf, u organizua prej fundamentalistëve të Pakistanit e të Afganistanit.¹⁹ Në Afrikë Sudani ka ndihmuar rregullisht rebelët myslimanë eritreas që luftonin kundër Etiopisë, kurse si kundërpërgjigje Etiopia i furnizoi me “logjistikë dhe u siguroi strehim” rebelëve të krishterë, që luftonin në Sudan. Këta të fundit gjithashtu morën ndihmë të njëllajtë nga Uganda, duke pasqyruar pjesërisht “lidhjet e forta fetare, raciale dhe etnike me rebelët sudanezë.” Nga ana tjetër, qeveria sudaneze mori 300 milionë dollarë armatime kineze prej Iranit dhe siguroi stërvitjen nga këshilltarët ushtarakë iranianë, duke ia bërë kështu të mundur të ndërmernte një mësymje të madhe kundër rebelëve më 1991. Një varg organizatash të krishtera Perëndimore i furnizuan rebelët e krishterë me ushqime, ilaçe, pajisje dhe, sipas qeverisë së Sudanit, edhe me armë.²⁰

Në luftën ndërmjet kryengritësve tamilë hindu dhe qeverisë sinhaleze budiste në Sri Lankë, qeveria indiane në zanafillë u dha mbështetje të ndjeshme kryengritësve, duke i stërvitur në Indinë jugore dhe duke i furnizuar me armë e me të holla. Më 1987, kur forcat qeveritare të Sri Lankës ishin gati t’i shpartallonin Tigrat Tamilë, opinioni publik indian u ngrit kundër këtij “gjenocidi” dhe qeveria indiane me një urë ajrore u dërgoi ushqime tamilëve “në të vërtetë, duke i dhënë një sinjal [presidentit] Xhajevarden, se India kishte ndër mend ta ndalonte që të mos i shtypte me forcë Tigrat.”²¹ Qeveritë e Indisë e të Sri Lankës atëherë arritën një marrëveshje, sipas së cilës Sri Lanka do t’u jepte një autonomi të gjerë zonave të tamilëve dhe kryengritësit do t’ia dorëzonin armët ushtrisë indiane. India dërgoi 50.000 trupa në ishull për ta vënë në zbatim marrëveshjen, por Tigrat nuk pranuan t’i dorëzonin armët dhe pas pak kohësh ushtarakët indianë e panë

veten të ngatërruar në një luftë me forcat guerile, që i kishin mbështetur vetë më parë. Duke nisur nga viti 1988 forcat indiane nisën të largoheshin. Më 1991 kryeministri indian, Raxhiv Gandhi, u vra, sipas indianëve prej një përkrahësi të kryengritësve tamilë, kurse qëndrimi i qeverisë indiane kundrejt kryengritjes u bë gjithnjë e më tepër armiqësor. Mirëpo qeveria nuk mund ta ndalonte simpatinë dhe mbështetjen për kryengritësit mes 50 milionë tamilëve në Indinë jugore. Duke e pasqyruar këtë opinion, zyrtarët e qeverisë tamile të Nadusë, në kundërshtim me Nju-Delhin, ua lejuan Tigrave Tamilë të vepronin në shtetin e tyre në të vërtetë “me dorë të lirë” në bregdetin e gjatë 500 milje dhe të dërgonin furnizime e armë përmes Ngushticës Palk të vogël për te kryengritësit në Sri Lankë.²²

Që nga viti 1979 e më pas sovjetikët e pastaj rusët janë ngatërruar me fqinjët e tyre nga jugu në tri luftëra të mëdha në vijën e shkëputjes: Lufta e Afganistanit më 1979-89, vijuesja e saj, Lufta e Taxhikistanit që nisi më 1992, dhe Lufta në Çeçeni, që nisi më 1994. Me shembjen e Bashkimit Sovjetik erdhi në fuqi në Taxhikistan një qeveri pasuese komuniste. Kësaj qeverie në pranverën e vitit 1992 iu kundërvu opozita, e përbërë prej grupesh rivale krahinore dhe etnike, që përfshinin si shekullarë, edhe islamistë. Kjo opozitë, me mbështetjen e armëve nga Afganistani, në shtator 1992 e dëboi qeverinë proruse prej kryeqytetit, Dushanbe. Qeveria e Rosisë dhe e Uzbekistanit u përgjigjën fuqishëm, duke paralajmëruar për përhapjen e fundamentalizmit islamik. Divizioni Pushkatar i Motorizuar rus 201, i cili kishte mbetur në Taxhikistan, i furnizoi me armë forcat proqeveritare dhe Rusia dërgoi trupa të tjera për të ruajtur kufirin me Afganistanin. Në nëntor 1992 Rusia, Uzbekistani, Kazakistani dhe Kirgizistani u morën vesh për një ndërhyrje ushtarake ruse dhe uzbeke në dukje

për të ruajtur paqen, por në fakt për të marrë pjesë në luftë. Me këtë mbështetje, si dhe me armët e paratë ruse, forcat e qeverisë së rrëzuar qenë në gjendje ta rimerrnin Dushanbenë dhe të vendosnin pushtetin mbi pjesën më të madhe të vendit. Pas kësaj ndodhi një proces spastrimi etnik, kurse refugjatët dhe trupat e opozitës u tërhoqën në Afganistan.

Qeveritë e vendeve myslimane të Lindjes së Mesme e kundërshtuan ndërhyrjen ushtarake ruse. Irani, Pakistani dhe Afganistani e ndihmuan me para, armë e stërvitje opozitën islamiste në rritje. Është njoftuar se më 1993 mijëra luftëtarë po stërviteshin nga muxhahidinët afganë, kurse në pranverë e në verë të vitit 1993 kryengritësit taxhikë ndërmorën disa sulme, duke kapërcyer kufirin nga Afganistani, dhe vranë një numër rojash kufitare ruse. Rusia u përgjigj duke dërguar më shumë trupa në Taxhikistan dhe duke bërë bombardime "masive me artileri e mortaja" e me sulme ajrore mbi objektivat në Afganistan. Mirëpo qeveritë arabe u dhanë kryengritësve fonde për të blerë raketa Sting për të qëlluar avionët. Aty nga viti 1995 Rusia kishte rreth 25.000 trupa të dislokuara në Taxhikistan dhe jepte mbi gjysmat e fondeve të nevojshme për ta mbështetur qeverinë. Nga ana tjetër, kryengritësit kishin mbështetjen e plotë të qeverisë së Afganistanit dhe të shteteve të tjera myslimane. Siç e ka theksuar Barnett Rubini, meqë agjencitë ndërkombëtare ose Perëndimi nuk ia dolën t'i jepnin ndihmë të ndjeshme Taxhikistanit ose Afganistanit, e bënë të parin tërësisht të varur prej rusëve dhe të dytin të varur prej fërefisit qytetërimor mysliman. "Cilido komandant afgan që ka shpresa për ndihmë të huaj sot, duhet ose të plotësojë dëshirat e financuesve arabë e pakistanezë, që duan ta përhapin xhihadin në Azinë Qendrore, ose të hyjë në tregtinë e drogës."²³

Lufta e tretë antimyslimane e Ruisë, në Kaukazin Verior me çeçenët, e pati prologun në luftimet e vitit 1992-93 ndërmjet osetëve ortodoksë fqinjë dhe ingushëve myslimanë. Këta të dytët, së bashku me çeçenët e popujt e tjerë myslimanë ishin deportuar në Azinë qendrore gjatë Luftës II Botërore. Osetët nuk lëvizën dhe morën pronat e ingushëve. Në vitet 1956-57 popujt e deportuar u lejuan të riktheheshin dhe nisën grindjet lidhur me pronësinë dhe sundimin e territorit. Në nëntor 1992 ingushët ndërmorën sulme nga republika e tyre për të rifituar krahinën Prigorodni, të cilën qeveria sovjetike ua kishte dhënë osetëve. Rusët u përgjigjën me një ndërhyrje masive, duke përfshirë edhe njësi kozakësh, për të mbështetur osetët ortodoksë. Një komentator i jashtëm e ka përshkruar kështu: “Në nëntor 1992 fshatrat ingushe në Oseti u rrethuan dhe u goditën me predha nga tanket ruse. Ata që shpëtuan nga bombardimi u vranë ose u dëbuan. Masakrën e kryen skuadrat osete të OMON-it [policia e posaçme], që patën mbulim nga trupat ruse të dërguara në rajon ‘për të ruajtur paqen’.”²⁴ Siç ka njoftuar *The Economist*, ishte “e vështirë ta kuptoje sesi në më pak ditë se një javë kishin ndodhur shkatërrime kaq të mëdha.” Ky qe “i pari operacion i spastrimit etnik në Federatën Ruse.” Pastaj këtë konflikt Rusia e përdori për të kërcënuar aleatët e çeçenëve ndër ingushët, por kjo nga ana e saj “solli mobilizimin e menjëhershëm të Çeçenisë dhe të Konfederatës [në shumicë dërrmuese] Myslimane të Popujve të Kaukazit (KNK). Nëse rusët nuk do të tërhiqeshin nga territori çeçen, KNK-ja kërcënoi se do të dërgonte 500.000 vullnetarë kundër tyre. Pas një periudhe të acaruar pa rrugëdalje, Moska u tërhoq për të shmangur që shkallëzimi i konfliktit ndërmjet Osetisë Veriore e Ingushetisë të kthehej në një përplasje në shkallë rajonale.”²⁵

Një përleshje më e gjerë dhe më e fuqishme shpërtheu në dhjetor 1994, kur Rusia ndërmori një sulm ushtarak në shkallë të gjerë kundër Çeçenisë. Udhëheqësit e dy republikave ortodokse: Gjeorgjisë e Armenisë, e mbështetën veprimin e rusëve, ndërsa presidenti i Ukrainës u tregua “diplomatikisht i butë, thjesht bëri thirrje për zgjidhjen paqësore të krizës.” Veprimi i rusëve gjeti mbështetje edhe nga qeveria ortodokse e Osetisë veriore dhe nga 55-60 për qind e popullsisë së Osetisë veriore.²⁶ Përkundrazi, myslimanët brenda dhe jashtë Federatës Ruse në shumicë dërrmuese mbajtën anën e çeçenëve. Ndërkombëtarët islamistë menjëherë nxorën luftëtarë nga Azerbajxhani, Afganistani, Pakistani, Sudani e gjetkë. Shtetet myslimane e mbështetën çështjen e çeçenëve dhe është njoftuar se Turqia e Irani u dërguan ndihmë materiale, duke i dhënë shtysa të tjera Ruisë që të orvatej të pajtohej me Iranin. Në Federatën Ruse nisi të rrjedhë një rrymë e padërprerë armësh për çeçenët nga Azerbajxhani, duke e detyruar Rusinë t’i mbyllte kufijtë me këtë vend, rrjedhimisht, duke ndërprerë edhe furnizimet mjekësore e të tjerat për Çeçeninë.²⁷

Myslimanët në Federatën Ruse u rreshtuan pas çeçenëve. Kur thirrjet për një luftë të shenjtë myslimane në mbarë Kaukazin kundër Ruisë nuk dhanë rezultat, udhëheqësit e gjashtë republikave të Vollgës e Uralit i kërkuan Ruisë, që t’u jepte fund veprimeve ushtarake, kurse përfaqësuesit e republikave myslimane të Kaukazit bënë thirrje për një fushatë mosbindjeje civile kundër sundimit rus. Presidenti i Republikës së Çuvashisë ushtarët e shërbimit të detyrueshëm i liroi nga detyrimi për të shërbyer kundër vëllezërve të tyre myslimanë. “Protestat më të fuqishme kundër luftës” u bënë në dy republikat fqinje të Çeçenisë: në Ingusheti e Dagestan. Ingushët i goditën trupat ruse rrugës për në Çeçeni,

duke e detyruar ministrin e mbrojtjes të Ruisë të deklaronte se qeveria ingushe “në fakt i kishte shpallur luftë Ruisë,” e gjithashtu ndodhën sulme kundër forcave ruse në Dagestan. Rusët u përgjigjën duke bombarduar fshatrat ingushe e dagestane.²⁸ Rrafshimi me tokën nga rusët i fshatit Pjervomajskoje, pas sulmit të çeçenëve në qytetin Kizljari në janar 1996, e bëri më të fortë armiqësinë e dagestanasve kundër rusëve.

Çështjen çeçene e ndihmoi edhe diaspora çeçene, e cila në pjesën më të madhe ishte krijuar nga agresioni rus i shekullit XIX kundër popujve malësorë të Kaukazit. Diaspora mblodhi fonde, siguroi armë dhe nxori vullnetarë për forcat çeçene. Ajo ishte e madhe në numër sidomos në Jordani e në Turqi, duke e shtyrë Jordaninë të merrte një qëndrim të fortë kundër rusëve, dhe e përforcoi gatishmërinë e Turqisë për të ndihmuar çeçenët. Në janar 1996, kur lufta u përhap drejt Turqisë, opinioni publik turk shprehu simpati për kapjen e një trageti rus dhe të pengjeve ruse nga anëtarët e diasporës. Me ndihmën e udhëheqësve çeçenë, qeveria turke bisedoi për një rezolutë lidhur me krizën në atë mënyrë, që i keqësoi më tej marrëdhëniet tashmë të acaruar ndërmjet Turqisë e Ruisë.

Sulmi i çeçenëve në Dagestan, përgjigjja ruse dhe rrëmbimi i tragetit në fillim të vitit 1996 nxorën në dritë mundësinë e zgjerimit të konfliktit për t'u kthyer në konflikt të përgjithshëm ndërmjet rusëve dhe popujve malësorë përgjatë vijave të luftës, që ishte zhvilluar prej dhjetëra vjetësh në shekullin e XIX. “Kaukazi i Veriut është një kuti me strall dhe eshkë,” ka paralajmëruar Fiona Hill më 1995, “ku konflikti në njërin republikë ka potencial që të ndezë një përleshje rajonale, e cila do të përhapej përtej kufijve në pjesën tjetër të Federatës Ruse dhe do të nxisë përzierjen e Gjeorgjisë, Azerbajxhanit, Turqisë e Iranit dhe të diasporave të tyre në Kaukazin e

Veriut. Siç e tregon lufta në Çeçeni, konflikti në këtë rajon nuk është e lehtë të përmbahet...dhe luftimet janë përhapur në republikat e territoret fqinje me Çeçeninë.” Një analist rus është pajtuar me këtë, duke arsyetuar se po ndërtoheshin “koalicione jozyrtare” përgjatë vijave qytetërimore. “Gjeorgjia, Armenia, Nagorno-Karabaku dhe Osetia Veriore, të gjitha të krishtera, po rreshtohen kundër Azerbajxhanit, Abhazisë, Çeçenisë dhe Ingushetisë, të gjitha myslimane.” Që në kohën kur luftonte në Tashkistan, Rusia kishte “rrezik të ngatërrohej në një ballafaqim të zgjatur me botën myslimane.”²⁹

Në një luftë tjetër në vijën e shkëputjes ortodokse-myslimane, pjesëmarrësit parësorë kanë qenë armenët e enklavës në Nagorno-Karabak dhe qeveria e populli i Azerbajxhanit, në të cilën të parët luftonin për pavarësi nga të dytët. Qeveria e Armenisë ishte pjesëmarrëse dytësore, kurse Rusia, Turqia dhe Irani i përkisnin pjesëmarrjes së nivelit të tretë. Përveç kësaj, një rol kryesor luante disapora e madhe armene në Europën Perëndimore e në Amerikën e Veriut. Luftimet nisën më 1988 përpara shembjes së Bashkimit Sovjetik, u përforcuan gjatë viteve 1992-1993 dhe patën rënie pas bisedimeve për armëpushim më 1994. Turqit e myslimanët e tjerë mbështetën Azerbajxhanin, ndërsa Rusia përkrahu armenët, por pastaj e përdori ndikimin e vet mbi ta edhe për të kundërshtuar ndikimin turk në Azerbajxhan. Kjo luftë që episodi i fundit si për luftën që bëhej prej shekujsh ndërmjet Perandorisë Ruse e Perandorisë Osmane për të pasur nën kontroll zonën e Detit të Zi e të Kaukazit, ashtu edhe për antagonizmin e fortë ndërmjet armenëve e turqve, që shkon prapa deri te masakrat e shekullit XVIII të bëra nga turqit kundër armenëve.

Në këtë luftë Turqia ishte një mbështetëse e fuqishme i Azerbajxhanit dhe kundërshtarë e armenëve. Njohja e parë nga cilido vend i pavarësisë së një republike sovjetike jobaltike ka qenë njohja e Azerbajxhanit nga Turqia. Gjatë gjithë konfliktit Turqia i dha përkrahje financiare e materiale Azerbajxhanit, si dhe stërviti ushtarët e Azerbajxhanit. Kur dhuna u përforcua më 1991-1992 dhe armenët përparuan në territorin azer, opinioni publik turk u ngrit më këmbë dhe qeveria turke pati trysni për të mbështetur njerëzit e fërfësisit të vet etnik-fetar. Ajo gjithashtu pati frikë se kjo mund ta nxirrte në pah përçarjen mes të krishterëve e myslimanëve, duke shkaktuar që të vërshonte përkrahja e Perëndimit për Armeninë, si dhe të dilte në kundërshtim me aleatët e NATO-s. Prandaj Turqia u përball me trysnitë e kryqëzuara klasike për një pjesëmarrës dytësor në një luftë në vijën e shkëputjes. Megjithatë, qeveria turke e pa se ishte në interesin e saj që ta mbështeste Azerbajxhanin e t'i kundërvihej Armenisë. "Është e pamundur të mos prekesh, kur vriten njerëzit e fisit tënd," ka thënë një zyrtar turk, kurse një tjetër ka shtuar: "Ne ndodhemi nën trysni. Gazetat tona janë plot me foto të masakrave...Ndoshta duhet t'i tregojmë Armenisë se ka një Turqi të madhe në këtë rajon." Presidenti Turgut Ozal ishte i një mendimi, kur tha se Turqia "duhet t'i trembë pakëz armenët." Bashkë me Iranin, Turqia i paralajmëroi armenët se nuk do të miratonte asnjë lloj ndryshimi të kufijve. Ozali i bllokoi të gjitha furnizimet me ushqime dhe gjëra të tjera, që të mos kalonin nëpër Turqi për Armeninë, si rrjedhim i kësaj popullsia e Armenisë u ndodh në prag të urisë gjatë dimrit të viteve 1992-1993. Gjithashtu si rrjedhim i kësaj, mareshali rus Jevgeni Shaposhnikov paralajmëroi se "Nëse njëra palë [d.m.th. Turqia] do të përzihet" në luftë, "ne do të jemi në prag të Luftës III

Botërore.” Një vit më vonë Ozali vijonte të mbante qëndrim luftarak. “Çfarë do të bëjnë armenët,” tha ai me zemërim, “nëse do të ndodhë që të nisim të shtënat...Do të marshojnë kundër Turqisë?” Turqia “do t’u tregojë dhëmbët.”³⁰

Në verën dhe në vjeshtën e vitit 1993 mësymja armene, që po i afrohej kufirit iranian, ngjalli reagime të tjera si nga Turqia, dhe nga Irani, të cilat ishin në garë për ndikimin mbi Azerbajxhanin e shtetet myslimane të Azisë Qendrore. Turqia deklaroi se mësymja e kërcënonte sigurinë e Turqisë, u kërkoi forcave armene që të tërhiqeshin “menjëherë e pa kushte” nga territori i Azerbajxhanit dhe dërgoi përforcime në kufijtë me Armeninë. Është njoftuar se trupat ruse e turke kanë shkëmbyer zjarr përmes atij kufiri. Kryeministria Tansu Çiller e Turqisë deklaroi, se do të kërkonte të shpallej lufta, nëse trupat armene do të hynin në enklavën e Nakhıçevanit në Azerbajxhan, afër Turqisë. Edhe Irani dërgoi forca në drejtim të Azerbajxhanit e brenda tij, nën pretekstin për të ngritur kampe për refugjatët nga mësymja armene. Është njoftuar se veprimi i Iranit bëri që turqit të mendonin se duhej të merrnin masa plotësuese, por pa shkaktuar kundërveprime nga ana e Ruisë, e gjithashtu i nxiti më tej në garën me Iranin për t’i dhënë mbrojtje Azerbajxhanit. Më në fund kriza u zbut nga bisedimet në Moskë midis udhëheqësve të Turqisë, Armenisë e Azerbajxhanit, nga trysnia e amerikanëve mbi qeverinë armene dhe nga trysnia e qeverisë armene mbi armenët e Nagorno-Karabakut.³¹

Armenët, që jetojnë në një vend të vogël, pa dalje në det, me burime të pakta dhe në kufi me popujt armiqësorë turq, historikisht i kanë drejtuar sytë për të gjetur mbrojtje te farefisi i tyre ortodoks, Gjeorgjia e Rusia. Sidomos Rusia është vështruar si vëllai i madh. Mirëpo kur nisi shembja e Bashkimit Sovjetik dhe nisi

veprimtaria për pavarësi e armenëve në Nagorno-Karabak, regjimi i Gorbaçovit i hodhi poshtë kërkesat e tyre dhe dërgoi trupa drejt rajonit për të mbështetur atë, që e vështronin si një qeveri komuniste besnike në Baku. Pas prishjes së Bashkimit Sovjetik, këto arsye ua lanë vendin arsyeve historike e kulturore që ekzistonin prej më shumë kohësh, ndërsa Azerbajxhani e akuzoi “qeverinë ruse se kishte bërë një kthesë prej 180 gradësh” dhe se po e mbështeste gjallërisht Armeninë e krishterë. Në të vërtetë përkrahja ushtarake ruse për armenët kishte nisur që më parë në ushtrinë sovjetike, në të cilën armenët kishin arritur grada të larta dhe ishin caktuar në njësi luftarake shumë më shpesh sesa myslimanët. Pasi nisi lufta, Regjimenti Pushkatar i Motorizuar 366 i ushtrisë Ruse, me bazë në Nagorno-Karabak, luajti rol drejtues në sulmin e ndërmarrë nga armenët kundër qytetit Kodxhali, në të cilin mëtohet se u masakruan deri më 1000 azerë. Më pas trupat ruse *specnac* morën pjesë edhe në luftime. Gjatë dimrit të vitit 1992-1993, kur Armenia nisi të vuante prej embargos turke, “shpëtoi prej katastrofës tërësore ekonomike, sepse vërshuan miliarda rubla kredi nga Rusia.” Atë pranverë trupat ruse u bashkuan me forcat e rregullta armene për të hapur një korridor lidhës nga Armenia në Nagorno-Karabak. Një forcë e koracuar ruse prej dyzet tankesh thuhet se mori pjesë në sulmin e Karabakut gjatë verës së vitit 1993.³² Nga ana e vet Armenia, siç kanë vënë në dukje Hilli dhe Xhuveti (Jewett), nuk kishte rrugë tjetër “përveç se të hynte në aleancë të ngushtë me Rusinë. Ajo varet prej Ruisë për lëndët e para, energjinë dhe furnizimin me ushqime, si dhe për mbrojtjen nga armiqtë historikë në kufijtë e saj, si Azerbajxhani e Turqia. Armenia i ka nënshkruar të gjitha marrëveshjet ekonomike dhe ushtarake të BSHP, u ka lejuar trupave ruse të dislokohen në territorin e saj dhe

ka hequr dorë nga të gjitha mëtimet për pasuritë e mëparshme sovjetike në të mirë të Ruisë.”

Mbështetja e Ruisë për armenët e shtoi ndikimin rus në Azerbajxhan. Në qershor 1993 udhëheqësi nacionalist azerbajxhanas Abulfëz Eijëbeu u rrëzua me një grusht shteti dhe vendin ia zuri komunisti i mëparshëm e, me sa duket, prorus, Gajdar Alijevi. Alijevi e pranoi nevojën që ta merrte me të mirë Ruisë, me qëllim që ta përmbante Armeninë. Ai e përmbysi refuzimin e Azerbajxhanit për të marrë pjesë në Bashkësinë e Shteteve të Pavarura (BSHP) dhe për lejimin e dislokimit të trupave ruse në territorin e saj. Gjithashtu ai i hapi rrugën pjesëmarrjes së Ruisë në një konsorcium ndërkombëtar për nxjerrjen e naftës së Azerbajxhanit. Nga ana e saj, Rusia nisi të stërviste trupat e Azerbajxhanit dhe i bëri trysni Armenisë, që t'i jepte fund mbështetjes për forcat e Karabakut, duke i detyruar të tërhiqeshin nga territori i Azerbajxhanit. Nëpërmjet kalimit të peshës nga njëra anë e peshores te tjetra, Rusia që në gjendje gjithashtu të kishte arritje në Azerbajxhan dhe t'i kundërvijë ndikimit të Iranit e të Turqisë në atë vend. Kështu, mbështetja e Ruisë për Armeninë jo vetëm e fuqizoi aleatin e vet më të ngushtë në Kaukaz, por edhe i dobësoi rivalët kryesorë në atë rajon.

Përveç Ruisë, burimi më i rëndësishëm i mbështetjes për Armeninë ishte diaspora e saj e madhe, e pasur dhe me ndikim në Europën Perëndimore e në Amerikën e Veriut, duke përfshirë afërsisht 1 milion armenë në Shtetet e Bashkuara dhe 450.000 në Francë. Ata dhanë para e furnizime për ta ndihmuar Armeninë që të kapërcente bllokadën e Turqisë, dërguan zyrtarë për qeverinë armene dhe vullnetarë për forcat e armatosura armene. Ndihmesat për të ndihmuar armenët nga bashkësia armene arritën nga 50 milionë

dollarë deri në 75 milionë në vit në mes të viteve 1990. Anëtarët e diasporës gjithashtu ushtruan ndikim të ndjeshëm politik te qeveritë e vendeve pritëse. Bashkësitë më të mëdha armene në Shtetet e Bashkuara janë në shtetet më të rëndësishme, si Kalifornia, Masaçusetsi dhe Nju-Xhersi. Si rrjedhim, Kongresi e ndaloi çfarëdo ndihme të huaj për Azerbajxhanin dhe e bëri Armeninë marrësin e tretë më të madh për frymë të ndihmës së SHBA. Kjo mbështetje nga jashtë pati rol thelbësor për mbijetesën e Armenisë dhe e bëri të fitonte me të drejtë nofkën “Izraeli i Kaukazit.”³⁴ Ashtu si sulmet ruse në shekullin XIX mbi Kaukazin e Veriut bënë të lindte diaspora, që i ndihmoi çeçenët t’u bënin qëndresë rusëve, edhe masakrat e turqve në fillim të shekullit të njëzetë kundër armenëve përftuan një diasporë, e cila ia bëri të mundur Armenisë t’i bënte qëndresë Turqisë dhe të thyente Azerbajxhanin.

Ish Jugosllavia ka qenë teatri i luftërave në vijën e shkëputjes më të ndërlikuara, më të pështjelluara dhe më të plota gjatë viteve të para 1990. Në nivelin parësor, në Kroaci qeveria kroate dhe kroatët luftuan kundër serbëve të Kroacisë, kurse në Bosnjë-Hercegovinë qeveria bosnjake luftoi kundër serbëve bosnjakë dhe kroatëve bosnjakë, të cilët gjithashtu luftuan me njëri-tjetrin. Në nivelin dytësor, qeveria serbe mbështeti “Serbinë e Madhe”, duke ndihmuar serbët e Bosnjës e të Kroacisë, kurse qeveria kroate shfaqti synimet për një “Kroaci të Madhe” dhe i përkrahu kroatët e Bosnjës. Në nivelin e tretë, rreshtimet masive të qytetërimeve përfshinin: Gjermaninë, Austrinë, Vatikanin, vendet dhe grupet e tjera europiane katolike, ndërsa më vonë edhe Shtetet e Bashkuara në krahun e Kroacisë; Rusinë, Greqinë dhe vendet e grupet e tjera ortodokse prapa serbëve; si dhe Iranin, Arabinë Saudite, Turqinë, Libinë dhe ndërkombëtarët islamistë e vendet islamike

përgjithësisht në krahun e myslimanëve bosnjakë. Këta të fundit morën ndihmë edhe nga Shtetet e Bashkuara, si një anomali nga pikëpamja qytetërimore brenda modelit përndryshe universal të fafëfisit që mbështet fafëfisin. Diaspora kroate në Gjermani dhe diaspora bosnjake në Turqi i dolën përkrah atdheut të vet. Në të tria palët u treguan aktive kishat e grupet fetare. Veprimet të paktën të qeverive të Gjermanisë, Turqisë, Rusisë dhe Amerikës u ndikuan ndjeshëm nga grupet e trysnisë dhe nga opinioni publik në shoqëritë e tyre.

Mbështetja e dhënë nga palët e dyta e të treta që thelbësore për mënyrën e zhvillimit të luftës dhe shtrëngesat që imponuan qënë thelbësore për ndalimin e luftës. Qeveritë e Kroacisë e të Serbisë dhanë armë, furnizime, fonde, vende strehimi dhe nganjëherë edhe forca ushtarake për të ndihmuar njerëzit e tyre që luftonin në republikat e tjera. Serbët, kroatët dhe myslimanët - që të gjithë morën ndihmë të rëndësishme prej fafëfisit qytetërimor jashtë ish Jugosllavisë në trajtën e parave, armëve, furnizimeve, vullnetarëve, stërvitjes ushtarake dhe mbështetjes politike e diplomatike. Serbët e kroatët e nivelit të parë por jo qeveritarë, përgjithësisht u treguan ekstremistë më të mëdhenj në nacionalizmin e tyre, më kokëfortë në kërkesat dhe më militantë në ndjekjen e synimeve të veta. Qeveritë kroate e serbe të nivelit të dytë në fillim mbështetën fuqishëm fafëfisin e tyre të nivelit parësor, por interesat e tyre vetjakë më të larmishëm i detyruan më pas që të luanin role më shumë ndërmjetësuese dhe përmbajtëse. Në mënyrë paralele, qeveritë ruse, gjermane dhe amerikane të nivelit të tretë i shtynë qeveritë e nivelit dytësor, të mbështetura prej tyre, që të përmbaheshin e të bënin kompromise.

Copëtimi i Jugosllavisë nisi më 1991, kur Sllovenia dhe Kroacia ecën në rrugën e pavarësisë dhe u kërkuar fuqive europiane Perëndimore t'i mbështesnin.

Përgjigjen e Perëndimit e përcaktoi Gjermania dhe kjo përgjigje gjermane në pjesën më të madhe u përcaktua prej lidhjes katolike. Qeveria e Bonit ra nën trsyninë për të vepruar nga ana e hierarkisë katolike gjermane, që ishte partneri në koalicionin e Partisë së Bashkimit Kristiandemokrat në Bavari, dhe nga ana e gazetës *Frankfurter Allgemeine Zeitung* e të mediave të tjera. Në veçanti mediat bavareze luajtën rol vendimtar në përpunimin e ndjenjës së publikut gjerman për t'ua njohur pavarësinë. Siç e ka vënë re Flora Lewis (Luis), "TV Bavarez, i cili varej mjaft prej qeverisë bavareze shumë konservatore dhe Kishës katolike bavareze, e cila kishte lidhje të ngushta me Kishën në Kroaci, jepte programe televizive për mbarë Gjermaninë kur lufta [me serbët] nisi e plotë. Mbulimi që fare i njëanshëm." Qeveria gjermane ngurroi për ta njohur pavarësinë, por për shkak të trysnisë në shoqërinë gjermane, nuk kishte se çfarë të bënte. "Mbështetja për ta njohur Kroacinë u shty nga opinioni në Gjermani dhe nuk u tërhoq nga qeveria." Gjermania i bëri trysni Bashkimit Europian për ta njohur pavarësinë e Sllovenisë e të Kroacisë dhe pastaj, kur arriti ta kishte të sigurtë këtë, eci më tej me nismën e vet për ta njohur përpara Bashkimit në dhjetor 1991. "Gjatë gjithë konfliktit," ka vënë në dukje një studiues gjerman më 1995, "Boni e quante Kroacinë dhe udhëheqësin e saj, Franjo Tugjmanin, si të përkrahurin e politikës së jashtme gjermane, sjellja me luhatje e të cilit ishte acaruese, por përsëri ai mund të mbështetej në përkrahjen e patundur të Gjermanisë."⁵⁵

Austria dhe Italia menjëherë vepruan për t'i njohur dy shtetet e reja dhe shumë shpejt pastaj u ndoqën nga vendet e tjera të Perëndimit, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara. Edhe Vatikani luajti rol qendror. Papa deklaroi se Kroacia ishte "ledhi mbrojtës i krishterimit [Perëndimor]," dhe u ngut ta bënte njohjen diplomatike

për të dy shtetet përpara se ta bënte Bashkimi European.³⁶ Kështu, Vatikani mori krahun e njërës palë në një konflikt, gjë që pati pasoja më 1994, kur papa planifikoi vizita në të tria republikat. Kundërshtimi i Kishës ortodokse serbe e ndaloi që të shkonte në Beograd dhe mungesa e gatishmërisë nga serbët për të garantuar sigurinë e tij shkaktoi që ta anulonte vizitën në Sarajevë. Megjithatë, vajti në Zagreb, ku i bëri ndere kardinalit Alojzije Stepinacit, i cili kishte pasur lidhje me regjimin fashist të Kroacisë gjatë Luftës II Botërore, që kishte përndjekur e vrarë serbët, arxhinjtë dhe çifutët.

Pasi e siguroi njohjen e pavarësisë nga Perëndimi, Kroacia nisi të ngrinte fuqinë e vet ushtarake, në kundërshtim me embargon e armëve të vendosur nga OKB-ja për të gjitha republikat e ish Jugosllavisë në shtator 1991. Armët vërshuan në Kroaci nga vendet europiane katolike, si Gjermania, Polonia dhe Hungaria, si edhe nga vendet e Amerikës Latine, si Panamaja, Kili e Bolivia. Kur lufta u shkallëzua më 1991, thuhet se eksportet e armëve nga Spanja “në pjesën më të madhe të drejtuara prej Opus dei,” u shtuan gjashtëfish brenda një periudhe të shkurtër kohe, kurse shumica e tyre mendohet se çanë rrugën për Lubljanë e Zagreb. Është njoftuar se më 1993 Kroacia bleu disa Mig-21 nga Gjermania e Polonia, duke qenë në dijeni qeveritë e tyre. Në Forcat e Mbrojtjes Kroate hynë qindra e ndoshta mijëra vullnetarë “nga Europa Perëndimore, nga diaspora kroate dhe nga vendet katolike të Europës Lindore”, që gjakonin të luftonin në “një kryqëzatë të krishterë si kundër komunizmit serb, edhe kundër fundamentalizmit islamik.” Ndihte teknike dhanë specialistë ushtarakë nga vendet Perëndimore. Pjesërisht prej kësaj ndihme nga vendet e farestit, kroatët qenë në gjendje t’i fuqizonin focat e tyre ushtarake dhe të

krijonin trupa për t'i bërë ballë ushtrisë jugosllave, në të cilën mbisundonin serbët.³⁷

Mbështetja Perëndimore për Kroacinë u shfaq edhe në mbylljen e syve përpara spastrimit etnik dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut e të ligjeve të luftës, për të cilat pati rregullisht denoncime kundër serbëve. Perëndimi nuk e hapi gojën, kur më 1995 ushtria e arnuar kroate ndërmoi një mësymje kundër serbëve të Krajinës, të cilët kishin jetuar aty prej shekujsh, dhe i dëbuan qindra mijëra prej tyre për të mërguar në Bosnjë e në Serbi. Kroacia përfitoi edhe nga disapora e saj e madhe. Kroatët e kamur në Europën Perëndimore dhe në Amerikën e Veriut dhanë fonde për armët e pajisjet ushtarake. Shoqatat e kroatëve në Shtetet e Bashkuara ndërhyjnë me lobin e tyre në Kongres e te presidenti në emër të atdheut të vet. Sidomos patën rëndësi dhe ndikuan fort 600.000 kroatët në Gjermani. Duke dërguar qindra vullnetarë për ushtrinë kroate, “bashkësitë kroate në Kanada, në Shtetet e Bashkuara, Australi e Gjermani, u mobilizuan për ta mbrojtur atdheun e tyre që sapo ishte bërë i pavarur.”³⁸

Më 1994 Shtetet e Bashkuara u përfshinë në përkrahjen për rindërtimin e ushtrisë kroate. Duke i shpërfillur shkeljet e shumta nga kroatët të embargos së armëve, të vendosur prej OKB-së, Shtetet e Bashkuara siguruan stërvitje ushtarake për kroatët dhe i lejuan gjeneralët amerikanë të rangjeve më të larta, të dalë në pension, që të punonin si këshilltarë për ta. Qeveria e SHBA dhe e Gjermanisë i hapën dritën e gjelbër mësymjes kroate në Krajinë më 1995. Këshilltarët amerikanë ushtarakë morën pjesë në planëzimin e këtij sulmi të stilit amerikan, ndërsa sipas kroatëve, këta përfituan edhe nga shërbimet e zbulimit të siguruara prej satelitëve spiunë amerikanë. Kroacia ishte bërë “aleati ynë de facto”, ka deklaruar një zyrtar i Departamentit të

shtetit. Është shprehur mendimi, se ky zhvillim pasqyronte “një llogari afatgjatë, sipas së cilës, përfundimisht në këtë pjesë të botës do të mbisundojnë dy fuqi lokale: njëra në Zagreb dhe tjetra në Beograd; njëra e lidhur me Uashingtonin dhe tjetra e përfshirë në një bllok sllav, që do të shtrihet deri në Moskë.”³⁹

Luftërat në Jugosllavi sollën një rreshtim në të vërtetë të njëzëshëm të botës ortodokse pas Serbisë. Nacionalistët rusë, oficerët ushtarakë, parlamentarët dhe udhëheqësit e Kishës ortodokse u shprehën haptazi në mbështetje të Serbisë, folën me përbuzje për “turqit” bosnjakë dhe kritikuan imperializmin Perëndimor e të NATO-s. Nacionalistët rusë e serbë bashkëpunuan për të ngjallur në të dy vendet kundërshtimin ndaj “rendit të ri botëror” Perëndimor. Në një masë të madhe këto ndjenja i kishte edhe turma ruse, për shembull, 60 përqind e moskovitëve ishin kundër sulmeve ajrore të NATO-s në verën e vitit 1995. Grupet nacionaliste ruse patën sukses në rekrutimin e të rinjve rusë në disa qytete kryesore për t’u bashkuar me “çështjen e vëllezërve sllavë”. Është njoftuar se nja një mijë a më shumë rusë, së bashku me vullnetarët nga Rumania e Greqia, hynë në forcat serbe për të luftuar kundër atyre, që ata i quanin “katolikë fashistë” dhe “militantë islamikë”. Më 1992 një repart rus “me uniforma kozakësh” thuhet se vepronte në Bosnjë. Më 1995 kishte rusë që shërbenin në njësitë ushtarake serbe të zgjedhura dhe, sipas një raporti të OKB-së, luftëtarët rusë dhe grekë morën pjesë në sulmin e serbëve kundër zonës së sigurisë të OKB-së në Zepë.⁴⁰

Duke e shkelur embargon e armëve, miqtë ortodoksë e furnizuan Serbinë me armët e pajisjet që i duheshin. Në fillim të vitit 1993 organizatat ushtarake e të zbulimit me sa duket, u kanë shitur serbëve tanke T-55, raketa kundërraketë dhe raketa kundërajrore me

vlerë 300 milionë dollarë. Është njoftuar se specialistët ushtarakë rusë kanë shkuar në Serbi për të vepruar me këto pajisje dhe për t'i stërvitur serbët që t'i përdornin. Serbia bleu armë nga vendet e tjera ortodokse, ndërsa Rumania e Bullgaria qenë furnizuesit “më aktivë” dhe Ukraina një burim tjetër. Përveç kësaj, trupat paqeruajtëse ruse në Sllavoninë Lindore i devijuan furnizimet e OKB-së për t'i marrë serbët, u krijuan lehtësi lëvizjeve ushtarake të serbëve dhe i ndihmuan forcat serbe për të gjetur armë.⁴¹

Me gjithë sanksionet ekonomike, Serbia që në gjendje të mbahej mjaft mirë si rrjedhim i kontrabandës së gjerë me karburante dhe me mallra të tjera nga Timishoara, të organizuar nga zyrtarët qeveritarë të Rumanisë, dhe nga Shqipëria, të organizuar në fillim nga shoqëritë italiane e pastaj greke me lejen e heshtur të qeverisë greke. Dërgesat detare me ushqime, kimikate, kompjuterë e mallra të tjera nga Greqia shkonin në Serbi nëpër Maqedoni dhe sasi të përafërta mallrash serbe të eksportit dilnin me këtë rrugë. Ndërthurja e lakmisë për dollarë dhe e simpatisë për farefisën kulturor i bënë qesharake sanksionet ekonomike të OKB-së kundër Serbisë, po ashtu siç e bënë edhe embargon e armëve të PKB-së kundër gjithë republikave të ish Jugosllavisë.

Gjatë gjithë luftërave në Jugosllavi qeveria greke u distanca nga masat e miratuara prej anëtarëve Perëndimorë të NATO-s, iu kundërvu ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Bosnjë, mbështeti serbët në Kombet e Bashkuara dhe ndërhyri me lobin e vet në qeverinë e SHBA për të hequr sanksionet ekonomike kundër Serbisë. Më 1994 kryeministri grek, Andreas Papandreu, duke theksuar rëndësinë e lidhjeve ortodokse me Serbinë, sulmoi publikisht Vatikanin, Gjermaninë dhe Bashkimin Europian për ngutjen me të

cilën bënë pranimin diplomatik të Sllovenisë e të Kroacisë në fund të vitit 1991.⁴³

Si udhëheqës i një pjesëmarrësi të nivelit të tretë, Boris Jelcini ra nën tryshninë e kryqëzuar të dëshirës, nga njëra anë, për t'i ruajtur marrëdhëniet e mira me Perëndimin, për t'i zgjeruar e përfituar prej tyre, dhe nga ana tjetër, për të ndihmuar serbët e për të çarmatosur opozitën e vet politike, e cila e akuzonte vazhdimisht se i nënshtrohej Perëndimit. Përgjithësisht e mori sipërinë ky shqetësimi i dytë dhe mbështetja diplomatike e Rosisë për serbët që e ndjeshme dhe e dendur. Më 1993 e 1995 qeveria ruse kundërshtoi me forcë, që të mos i viheshin sanksione më të rënda ekonomike Serbisë, kurse parlamenti rus votoi pothuaj njëzëri në të mirë të heqjes së sanksioneve ekzistuese për serbët. Gjithashtu Rusia ngulmoi që të forcohej embargoja e armëve kundër myslimanëve dhe të zbatoheshin sanksione ekonomike kundër Kroacisë. Në dhjetor 1993 Rusia kërkoi zbutjen e sanksioneve ekonomike, që të kishte mundësinë ta furnizonte Serbinë me gaz natyror për periudhën e dimrit, por ky propozim u bllokua prej Shteteve të Bashkuara e Britanisë së Madhe. Më 1994 dhe përsëri më 1995 Rusia kundërshtoi vendosmërisht sulmet ajrore të NATO-s kundër serbëve të Bosnjës. Atë vit të fundit Duma ruse e denoncoi bombardimin me një votim pothuaj të njëzëshëm dhe kërkoi dorëheqjen e ministrit të punëve të jashtme, Andrej Kozirjevit, sepse nuk i kishte mbrojtur mirë interesat kombëtarë rusë në Ballkan. Edhe më 1995 Rusia e akuzoi NATO-n për "gjenocid" kundër serbëve, kurse presidenti Jelcin paralajmëroi se vijimi i bombardimeve do ta prekte rëndë bashkëpunimin e Rosisë me Perëndimin, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e saj në Partneritetin për Paqe me NATO-n. "Si mund të përfundojmë një marrëveshje me NATO-n," pyeti ai, "kur NATO-ja po

bombardon serbët?” Fare haptas Perëndimi po zbatonte një standard të dyfishtë: “Çfarë do të thotë kjo, që kur sulmojnë myslimanët, nuk ndërmerret asnjë veprim kundër tyre? Ose dhe kur sulmojnë kroatët?”⁴⁴ Gjithashtu Rusia kundërshtoi me vendosmëri orvatjet për ta hequr embargon e armëve kundër republikave të ish Jugosllavisë, e cila ushtronte ndikim kryesisht mbi myslimanët e Bosnjës, si dhe u përpoq vazhdimisht që ta forconte këtë embargo.

Në një varg mënyrash të tjera Rusia e shfrytëzoi pozitën e vet në OKB e gjetkë për të mbrojtur interesat e serbëve. Në dhjetor 1994 ajo vuri veton kundër një rezolute të Këshillit të Sigurimit në OKB, të paraqitur prej vendeve myslimane, që do ta pengonte kalimin e karburantit nga Serbia për serbët e Bosnjës dhe të Kroacisë. Në prill 1994 Rusia bllokoi një rezolutë të OKB-së, që dënonte serbët për spastrim etnik. Gjithashtu e pengoi caktimin e cilitdo njeri nga një vend i NATO-s për të qenë hetues i OKB-së për krimet e luftës, sepse i ndruhej anësisë së mundshme kundër serbëve; kundërshtoi nxjerrjen në gjyq të komandantit ushtarak serb Ratko Mlladiq para Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës dhe i dha strehim Mlladiqit në Rusi.⁴⁵ Në shtator 1993 Rusia e pengoi përtëritjen e autorizimit të OKB-së për qëndrimin e 22.000 paqeruajtësve të OKB-së në ish Jugosllavinë. Në verën e vitit 1995 Rusia e kundërshtoi, por nuk vuri veton, për një rezolutë të Këshillit të Sigurimit, që autorizonte dërgimin e 12.000 paqeruajtësve të tjerë të OKB-së dhe kritikoi rëndë si mësymjen kroate kundër serbëve të Krajnës, edhe qeveritë Perëndimore, që nuk ndërmorën veprime kundër asaj mësymjeje.

Rreshtimi më i gjerë dhe më i frytshëm sipas qytetërimit ka qenë ai i botës myslimane në emër të myslimanëve bosnjakë. Çështja bosnjake u bë

universalisht popullore në vendet myslimane; ndihma për bosnjakët vërshoi nga një varg burimesh, publike e private; qeveritë myslimane, në veçanti ajo e Iranit dhe ajo e Arabisë Saudite, hynë në garë për përkrahjen dhe orvatjet që të fitonin ndikimin si rrjedhim prej kësaj. Shoqëritë sunite e shiite, fundamentaliste e shekullare, arabe dhe joarabe që nga Maroku deri në Malajzi u bënë që të gjitha bashkë. Shfaqjet e mbështetjes së myslimanëve për bosnjakët shkonin nga ndihma humanitare (që përfshinte edhe 90 milionë dollarë të mbledhur më 1995 në Arabinë Saudite), përmes mbështetjes diplomatike dhe ndihmës masive ushtarake, deri te aktet e dhunës, si vrasja e dymbëdhjetë kroatëve në Algjeri më 1993 nga ekstremistët islamistë “si përgjigje kundër masakrës ndaj bashkëbesimtarëve tanë myslimanë, të cilëve ua prenë kokat në Bosnjë.”⁴⁶ Rreshtimi pati ndikim të madh mbi ecurinë e luftës. Ai që thelbësor për mbijetesën e shtetit bosnjak dhe për suksesin që pati në rifitim të territorit, pas fitoreve shpartalluese të serbëve. I dha shtysa të mëdha islamizimit të shoqërisë bosnjake dhe njëjtësimin të myslimanëve bosnjakë me bashkësinë islamike globale. Gjithashtu shërbeu si shtysë që Shtetet e Bashkuara të mbanin qëndrim pozitiv për nevojat e Bosnjës.

Qeveritë myslimane veç e veç dhe së bashku shprehën herë pas here solidaritetin me bashkëbesimtarët bosnjakë. Irani doli në krye më 1992, kur e përcaktoi atë luftë si konflikt fetar me serbët e krishterë, që kishin nisur gjenocidin kundër myslimanëve bosnjakë. Duke u bërë kështu kryesues, siç ka vërejtur Fuad Axhami, Irani ia “shpërbleu mirënjohjen shtetit bosnjak” dhe përcaktoi një model e dha një shtysë për fuqitë e tjera myslimane, si Turqia e Arabia Saudite, që ta ndiqnin si shembull. Me nxitjen e Iranit, Organizata e Konferencës Islamike (OKI) e ngriti këtë çështje dhe

krijoi një grup për të përkrahur çështjen e Bosnjës në Kombet e Bashkuara. Në gusht 1992 përfaqësuesit islamikë denoncuan gjenocidin e mëtuar në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së dhe në emër të OKI-së Turqia paraqiti një rezolutë, e cila kërkonte ndërhyrjen ushtarake sipas Nenit 7 të Kartës së OKB-së. Vendet myslimane përcaktuan një afat në fillim të vitit 1993, që Perëndimi të ndërmernte veprime për të mbrojtur bosnjakët, kurse pas kësaj date ato do ta quanin veten të lira për ta furnizuar Bosnjën me armë. Në maj 1993 OKI-ja denoncoi planin e hartuar nga vendet Perëndimore dhe Rusia për të caktuar zona të sigurta për myslimanët e për të mbikëqyrur kufijtë me Serbinë, por njëkohësisht të parandalohet çfarëdo ndërhyrje ushtarake. Ajo kërkonte që t'i jepej fund embargos së armëve, të përdorej forca kundër armëve të rënda serbe, të bëhej patrullimi i rreptë në kufirin serb dhe të përfshiheshin trupa nga vendet myslimane në forcat paqeruajtëse. Muajin pasues OKI-ja, pas kundërshtimeve të Perëndimit e të Rosisë, ia arriti që Konferenca e OKB-së për të Drejtat e Njeriut të miratonte një rezolutë, e cila dënonte agresionin serb e kroat dhe bënte thirrje t'i jepej fund embargos së armëve. Në korrik 1993, në një farë mënyre duke e vënë në pozitë të vështirë Perëndimin, OKI-ja shprehu gatishmërinë për të dhënë 18.000 trupa paqeruajtëse për OKB-në, me ushtarë që do të merreshin nga Irani, Turqia, Malajzia, Tunizia, Pakistani dhe Bangladeshi. Shtetet e Bashkuara vunë veton për Iranin, kurse serbët kundërshtuan fort për trupat turke. Këto të fundit megjithatë erdhën në Bosnjë në verën e vitit 1994 dhe aty nga viti 1995 Forca Mbrojtëse e OKB-së prej 25.000 trupash përfshinte 7000 veta nga Turqia, Pakistani, Malajzia, Indonezia dhe Bangladeshi. Në gusht 1993 një delegacion i OKI-së, i kryesuar nga ministri i punëve të

jashtme i Turqisë, ndërhyri pranë Butros Butros-Galit dhe Uorren Kristoferit për të mbështetur menjëherë goditjet ajrore të NATO-s që të mbroheshin bosnjakët nga sulmet e serbëve. Është njoftuar se kur Perëndimi nuk e ndërmori këtë veprim, krijoi acarime të rënda ndërmjet Turqisë dhe aleatëve të saj në NATO.⁴⁷

Më pas kryeministrat e Turqisë e të Pakistanit bënë një vizitë në Sarajevë, së cilës iu bë publicitet i madh, për ta vënë në dukje shqetësimin e myslimanëve, dhe OKI-ja përsëri i parashtrroi kërkesat që t'u jepej bosnjakëve ndihmë ushtarake. Në verën e vitit 1995, kur Perëndimi nuk arriti t'i mbronte zonat e sigurisë nga sulmet e serbëve, Turqia miratoi ndihmën ushtarake për Bosnjën dhe stërvitjen e trupave bosnjake, Malajzia u angazhua t'u shiste armë, duke shkelur embargon e OKB-së, dhe Emiratet e Bashkuara Arabe pranuan që të jepnin fonde për qëllime humanitare e ushtarake. Në gusht 1995 ministrat e punëve të jashtme të nëntë vendeve të OKI-së e deklaruan të pavlefshme embargon e armëve të OKB-së dhe në shtator pesëdhjetë e dy anëtarë të OKI-së miratuan ndihmën ekonomike e ushtarake për bosnjakët.

Ndërkohë që asnjë çështje tjetër nuk ka përfutur mbështetje më të njëzëshme në mbarë islamin, gjendja e rëndë e myslimanëve bosnjakë pati jehonë të veçantë në Turqi. Bosnja ka qenë pjesë e Perandorisë Osmane praktikisht deri më 1878 dhe teorikisht deri më 1908, kurse emigrantët dhe refugjatët bosnjakë përbëjnë afërsisht 5 për qind të popullsisë së Turqisë. Simpatia për çështjen bosnjake dhe zemërimi për Perëndimin që nuk arriti ta mbronte, u përhapën në mbarë popullsinë turke, kurse Partia Islamiste e Mirëqenies e shfrytëzoi këtë çështje kundër qeverisë. Nga ana e tyre, zyrtarët qeveritarë vunë në dukje përgjegjësinë e posaçme të Turqisë ndaj gjithë myslimanëve të Ballkanit, kurse

qeveria bëri kërkesa të njëpasnjëshme për ndërhyrjen ushtarake të OKB-së, që të shpëtoheshin myslimanët bosnjakë.⁴⁸

Ndihma më e rëndësishme që *umajati* u dha myslimanëve bosnjakë qe mbështetja ushtarake: armët, paratë për të blerë armë, stërvitja ushtarake dhe vullnetarët. Menjëherë sapo filloi lufta, qeveria bosnjake ftoi të vinin muxhahidinët dhe është njoftuar se numri i përgjithshëm i vullnetarëve arriti rreth 4.000, më shumë sesa të huajt që luftuan si për kroatët, edhe për serbët. Ndër ta kishte njësi prej Gardës Republikane të Iranit e shumë njerëz, që kishin luftuar në Afganistan. Mes tyre kishte vendës nga Pakistani, Turqia, Irani, Algjeria, Arabia Saudite, Egjipti e Sudani, plus punëtorët emigrantë shqiptarë e turq nga Gjermania, Austria e Zvicra. Organizatat fetare saudite dhanë mjetet për shumë vullnetarë; dy duzina sauditësh u vranë që në muajt e parë të luftës më 1992, kurse Asambleja Botërore e Rinisë Myslimane i tërhoqi luftëtarët e plagosur në Xhedah për mjekim. Në vjeshtën e vitit 1992 erdhën gueriljerë nga Hezbollahu shiit i Libanit për të stërvitur ushtrinë bosnjake, pastaj këtë stërvitje e morën përsipër në pjesën më të madhe njerëzit e Gardës Republikane të Iranit. Në pranverën e vitit 1994 zbulimi Perëndimor njoftoi se një njësi e Gardës Republikane të Iranit prej 400 vetash po organizonte gueriljet ekstremiste dhe njësitet terroriste. "Iranianët," ka thënë një zyrtar i SHBA, "e shohin këtë si një rrugë për t'iu futur në brinjë Europës." Sipas Kombeve të Bashkuara, muxhahidinët stërvitën 3000-5000 bosnjakë për brigadat e posaçme islamiste. Qeveria bosnjake i përdori muxhahidinët për "veprimtari terroriste, ilegale dhe për njësite goditëse", ndonëse këto njësite shpesh e shqetësuan popullsinë vendore dhe i shkaktuan qeverisë probleme të tjera. Marrëveshjet e Dejtonit kërkonin që

të largoheshin nga Bosnja të gjithë luftëtarët e huaj, porse qeveria bosnjake i ndihmoi disa luftëtarë të qëndronin, duke u dhënë shtetësinë bosnjake dhe njerëzit e Gardës Republikane të Iranit i përfshiu si punonjës të organizatave të ndihmave. “Qeveria bosnjake u detyrohet shumë këtyre grupeve, e sidomos iranianeve,” ka paralajmëruar një zyrtar amerikan në fillim të vitit 1996. “Qeveria u tregua e paaftë që të përballej me ta. Brenda 12 muajve ne do të kemi ikur, porse muxhahidinët kanë ndër mend të qëndrojnë.”⁴⁹

Shtetet e pasura të umajatit, të kryesuara nga Arabia Saudite e Irani, kanë dhënë sasi të jashtëzakonshme parash për të ngritur fuqinë ushtarake të Bosnjës. Në muajt e parë të luftës më 1992, qeveria saudite dhe burimet private dhanë 150 milionë dollarë si ndihmë për bosnjakët, në pamje të jashtme për qëllime humanitare, por dihet fare mirë se në pjesën më të madhe ato u përdorën për qëllime ushtarake. Është njoftuar se bosnjakët kanë marrë armë me vlerë 160 milionë dollarë gjatë dy vjetëve të parë të luftës. Në periudhën 1993-1995 bosnjakët kanë marrë edhe 300 milionë dollarë për armë nga sauditët, plus 500 milionë dollarë si ndihmë kinse humanitare. Edhe Irani ka qenë një burim i madh ndihme ushtarake, kurse sipas zyrtarëve amerikanë, shpenzoi qindra miliona dollarë në vit për armët e caktuara për bosnjakët. Sipas një njoftimi tjetër, 80 deri 90 për qind e shumës së përgjithshme prej 2 miliardë dollarësh për armët, që hynë në Bosnjë gjatë viteve të para të luftimeve, u vajtën myslimanëve. Si rrjedhim i kësaj ndihme financiare, bosnjakët qenë në gjendje të blinin mijëra ton armë. Dërgesat e kapura me anije përfshinin në rastin e parë 4000 pushkë dhe një milion copë fishekë, e dyta 11.000 pushkë, 30 mortaja dhe 750.000 predha, kurse e treta kishte raketa tokë-tokë, municione, makina ushtarake dhe pistoleta. Të gjitha

këto dërgesa ishin nisur nga Irani, i cili ishte burimi kryesor për armët, por edhe Turqia e Malajzia qenë furnizues të rëndësishëm të armëve. Disa armë vajtën drejt e në Bosnjë, por shumica kaluan nëpër Kroaci, ose me vijë ajrore për Zagreb e pastaj nëpër tokë, ose me det deri në Split a në porte të tjera kroate e pastaj nëpër tokë. Si shpërblim për lejën që dhanë, kroatët përvetësuan një pjesë, sipas njoftimeve një të tretën, të armëve, dhe duke mbajtur ndër mend se edhe vetë në të ardhmen mund të luftonin kundër Bosnjës, e ndaluan transportimin e tankeve e të artillerisë së rëndë nëpër territorin e tyre.⁵⁰

Paratë, njerëzit, stërvitja dhe armët nga Irani, Arabia Saudite, Turqia dhe vendet e tjera myslimane u dhanë mundësinë bosnjakëve që atë ushtri, të cilën të gjithë e quanin “prej krundesh”, ta shndërronin në një forcë ushtarake të pajisur mirë e kompetente në një masë modeste. Aty nga dimri i vitit 1994 vëzhguesit e jashtëm njoftuan për një rritje të befasishme të kompaktësimit organizativ dhe të efektshmërisë luftarake të saj.⁵¹ Kur e vunë në veprim forcën e tyre të re ushtarake, bosnjakët e prishën armëpushimin dhe ndërморën një mësymje të suksesshme së pari kundër milicisë kroate, e më vonë në pranverë kundër serbëve. Në vjeshtën e vitit 1994 Korpusi i Pestë bosnjak doli nga zonat e sigurisë të OKB-së në Bihaç dhe i dëboi forcat serbe, duke korrur fitoren më të madhe të bosnjakëve deri atëherë, ndërsa rifitoi një pjesë të madhe territori nga serbët, të cilët po pengoheshin nga embargoja për ndihmë që u kishte vënë presidenti Millosheviq. Në mars 1995 ushtria bosnjake sërish e shkeli armëpushimin dhe nisi një përparim të madh afër Tuzlës, që u pasua prej një mësymjeje në qershor rreth Sarajevës. Mbështetja nga farefisi mysliman që një faktor i domosdoshëm dhe

vendimtar, që ia mundësoi qeverisë bosnjake të bënte këto ndryshime në baraspeshën ushtarake në Bosnjë.

Lufta në Bosnjë qe një luftë qytetërimesh. Tre pjesëmarrësit parësorë vinin nga qytetërime të ndryshme dhe u përkisnin feve të ndryshme. Me një përjashtim të pjesshëm, pjesëmarrja e aktorëve dytësorë e të tretë ndiqte me përpikëri modelin qytetërimor. Shtetet dhe organizatat myslimane pa asnjë përjashtim u rreshtuan prapa myslimanëve bosnjakë dhe iu kundërvunë kroatëve e serbëve. Vendet dhe organizatat ortodokse pa asnjë përjashtim mbështetën serbët dhe kundërshtuan kroatët e myslimanët. Qeveritë dhe elitat Perëndimore mbështetën kroatët, dënuan ashpër serbët dhe përgjithësisht u treguan indiferente kundrejt myslimanëve, ose i trembën. Me vazhdimin e luftës, urrejtja e përçarjet mes grupeve u thelluan dhe identitetet e tyre fetare e qytetërimore u përforcuan, sidomos mes myslimanëve. Përgjithësisht mësimet që dalin nga lufta në Bosnjë janë: e para, pjesëmarrësit parësorë në një luftë në vijën e shkëputjes mund t'i vënë shpresat te ndihma, e cila mund të jetë e rëndësishme, që do ta marrin nga farefisi i tyre qytetërimor; e dyta, kjo ndihmë mund të ndikojë ndjeshëm në ecurinë e luftës, dhe e treta, qeveritë e popujt e një qytetërimi nuk derdhin gjak ose para për të ndihmuar njerëzit e një qytetërimi tjetër, që të luftojnë në një luftë në vijën e shkëputjes.

I vetmi përjashtim i pjesshëm nga ky model qytetërimor kanë qenë Shtetet e Bashkuara, udhëheqësit e të cilave me fjalë përkrahnin myslimanët. Mirëpo në praktikë mbështetja amerikane ka qenë e kufizuar. Administrata e Klintonit e miratoi përdorimin e forcës ajrore amerikane, por nuk pranoi që trupat tokësore të mbronin zonat e sigurisë të OKB-së dhe përkrahu heqjen e embargos së armëve. Ajo nuk u bëri trysni

seriozisht aleatëve për t'i ndihmuar myslimanët, por bëri një sy të verbër si për dërgesat e armëve nga Irani për bosnjakët, edhe për financimin nga sauditët për blerjen e armëve bosnjake, kurse më 1994 hoqi dorë nga zbatimi i embargos.⁵² Duke bërë këto gjëra, Shtetet e Bashkuara ranë në kundërshtim me aleatët e tyre dhe i dhanë shkas asaj, që u pa gjerësisht si një krizë e madhe në NATO. Pasi u nënshkruan marrëveshjet e Dejtonit, Shtetet e Bashkuara pranuan të bashkëpunonin me Arabinë Saudite e shtetet e tjera myslimane për stërvitjen dhe pajisjen e forcave bosnjake. Prandaj çështja del kështu: Përse gjatë dhe pas luftës Shtetet e Bashkuara qenë i vetmi vend, që e theu kallëpin qytetërimor dhe u bënë i vetmi vend jomysliman, i cili përkrahu interesat e myslimanëve bosnjakë e punoi me vendet myslimane në emër të tyre? Çfarë e shpjegon këtë anomali amerikane?

Një nga mundësitë është që realisht kjo të mos ketë qenë një anomali, po më tepër një realpolitikë qytetërimore e llogaritur me kujdes. Duke dalë në krah të bosnjakëve dhe duke propozuar, por pa sukses, që t'i jepej fund embargos, Shtetet e Bashkuara u orvatën të zvogëlonin ndikimin e vendeve myslimane fundamentaliste, si Irani e Arabia Saudite, mbi bosnjakët, që më parë kishin qenë shekullarë e me orientim nga Europa. Mirëpo, nëse ky kishte qenë motivi, përse Shtetet e Bashkuara e pranuan ndihmën e Iranit e të Arabisë Saudite dhe përse nuk ngulmuan më me forcë për t'i dhënë fund embargos, e cila do ta kishte bërë të ligjshme ndihmën e Perëndimit? Përse zyrtarët amerikanë nuk u shprehën botërisht për rrezikun e fundamentalizmit islamist në Ballkan? Një shpjegim tjetër i mundshëm për sjelljen e Amerikës është se qeveria e SHBA ishte nën tryshninë e miqve të saj në botën myslimane, e sidomos të Turqisë e të Arabisë Saudite, prandaj u bëri lëshime dëshirave të tyre, me

qëllim që të ruante marrëdhëniet e mira me ta. Megjithatë, këto marrëdhënie i kishin rrënjët në përkimin e interesave të palidhur me Bosnjën dhe nuk kishte gjasa, që të dëmtoheshin rëndë nëse Amerika nuk do ta ndihmonte Bosnjën. Veç kësaj, ky shpjegim nuk do të vlente për të parë përse Shtetet e Bashkuara e lanë të nëkuptohej, që i miratonin sasisë e mëdha të armëve të Iranit të hynin në Bosnjë, në një kohë kur ishin duke e kundërshtuar rregullisht Iranin në frontet e tjera dhe Arabia Saudite ishte në garë me Iranin për ndikimin në Bosnjë.

Arsyet e realpolitikës qytetërimore mund të kenë luajtur një farë roli për t'i formësuar qëndrimet amerikane, por duket se ka pasur faktorë të tjerë me forcë më ndikuese. Në çfarëdo konflikti të huaj amerikanët duan të përcaktojnë forcat e së mirës dhe të së keqes, që pastaj të rreshtohen me të parat. Mizoritë e serbëve në fillim të luftës shkaktuan që të paraqiteshin si “djemtë e këqij”, të cilët vrisnin njerëz të pafajshëm dhe bënë gjenocid, kurse bosnjakët qenë në gjendje të paraqisnin për vete imazhin si viktimat të pambrojtura. Gjatë gjithë luftës shtypi amerikan pak vëmendje i kushtoi spastrimit etnik prej kroatëve e myslimanëve, si dhe krimeve të luftës ose shkeljeve të zonave të sigurisë të OKB-së e të armëpushimeve nga ana e forcave bosnjake. Sipas shprehjes së Rebeka Uestit, bosnjakët u bënë për amerikanët “njerëzit e përkëdhelur të Ballkanit, që zunë vend në zemrat e tyre si të përvuajtur e të pafajshëm, përjetësisht të masakruar dhe asnjëherë masakruar të tjerëve.”⁵³

Elitat amerikane gjithashtu mbajtën qëndrim në të mirë të bosnjakëve, sepse u pëlqente ideja e një vendi shumëkulturore, kurse në fazat e para të luftës qeveria bosnjake ia doli ta paraqiste me sukses këtë imazh. Gjatë gjithë luftës politika amerikane mbeti me kokëfortësi e

përkushtuar ndaj një Bosnje shumetnike, në kundërshtim me faktin, që serbët bosnjakë dhe kroatët bosnjakë në shumicë dërrmuese e hidhnin poshtë. Ndonëse dukej qartë se nuk ishte i mundur krijimi i një shteti shumetnik nëse, siç e besonin gjithashtu ata, një grup etnik po ushtronte gjenocid kundër tjetrit, përsëri në mendjet e tyre elitat amerikane i ndërthurnin këto imazhe kontradiktore për të përftuar simpatinë e përhapur gjerësisht për çështjen bosnjake. Kështu, idealizmi, moralizmi, instinktet humanitare, naiviteti dhe padija amerikane lidhur me Ballkanin i bënë që të ishin probosnjakë dhe antiserbë. Njëkohësisht, ngaqë nuk kishte as interesa të rëndësishëm për sigurinë amerikane në Bosnjë dhe as ndonjë lidhje kulturore, qeveria e SHBA nuk kishte asnjë arsye për të bërë shumë gjëra, që t'i ndihmonte bosnjakët, me përjashtim të faktit që i lejoi iranianët dhe sauditët t'i armatosnin. Duke mos e pranuar luftën të atillë siç ishte, qeveria amerikane u largua prej aleatëve, shkaktoi zgjatjen e luftimeve dhe dha ndihmë që në Ballkan të krijohej një shtet mysliman me ndikim të fortë nga Irani. Në fund bosnjakët ndien një shije të hidhur të thellë kundrejt Shteteve të Bashkuara, që kishin folur fjalë të mëdha, por që dhanë pak gjëra, si dhe u mbushën me mirënjohje të thellë për farefisin e tyre mysliman, të cilët u kishin ardhur në ndihmë me para e armë, të domosdoshme që të mbijetonin e të korrnin fitore ushtarake.

“Bosnja është Spanja jonë,” ka vënë në dukje Bernard-Henri Levi, kurse një botues saudit është pajtuar me të: “Lufta në Bosnjë e Hercegovinë është bërë barasvlerësja e luftës kundër fashizmit gjatë Luftës Civile të Spanjës. Ata që u vranë atje vështrohen si dëshmorë, që u përpoqën të shpëtonin vëllezërit e tyre myslimanë.”⁵⁴ Ky krahasim është i përshtatshëm. Në epokën e qytetërimeve Bosnja për cilindo është Spanja.

Lufta Civile e Spanjës qe një luftë ndërmjet sistemeve politike dhe ideologjive, Lufta në Bosnjë qe një luftë ndërmjet qytetërimeve e feve. Demokratët, komunistët e fashistët vajtën në Spanjë për të luftuar përkrah vëllezërve të tyre ideologjikë, kurse qeveritë demokratike, komuniste dhe, në mënyrën më aktive qeveritë fashiste, u dhanë ndihmë. Në luftërat jugosllave u pa i njëjti mobilizim masiv i mbështetjes së jashtme nga ana e të krishterëve Perëndimorë, të krishterëve ortodoksë dhe myslimanëve në emër të farefisit të tyre qytetërimor. Fuqitë kryesore të ortodoksisë, islamit e të Perëndimit u përziën thellë në të. Pas katër vjetësh Lufta Civile në Spanjë arriti një përfundim të plotë me fitoren e forcave të Frankos. Luftërat ndërmjet bashkësive fetare në Ballkan mund të frenohen e madje të ndalen përkohësisht, por askush nuk ka gjasa të arrijë fitoren vendimtare dhe kur nuk ka një fitore, kjo do të thotë se nuk ka as përfundim. Lufta Civile në Spanjë ishte prologu i Luftës II Botërore. Lufta në Bosnjë është një episod tjetër i përgjakshëm i përplasjes që vazhdon ndërmjet qytetërimeve.

Ndërprerja e luftërave në vijën e shkëputjes

“Çdo luftë duhet të ketë një fund.” Kështu thotë urtësia e zakonshme. A është e vërtetë kjo për luftërat në vijën e shkëputjes? Edhe po, edhe jo. Dhuna në vijën e shkëputjes mund të ndalet tërësisht për një periudhë kohe, por rrallë mbaron përgjithnjë. Luftërat në vijën e shkëputjes kanë si tipar që shoqërohen shpesh me ndërprerje, armëpushime, pushime zjarri, por jo nga traktate të gjithanshme paqeje, që i zgjidhin çështjet

qendrore politike. Ato e kanë këtë cilësi të shuarjes e ndezjes së herëpashershme, sepse i kanë rrënjët në konfliktet e thella të vijës së shkëputjes, që lidhen me marrëdhënie antagoniste të qëndrueshme ndërmjet grupeve prej qytetërimeve të ndryshme. Nga ana e tyre, konfliktet rrjedhin prej afërsisë gjeografike, prej feve e kulturave të ndryshme, prej strukturave shoqërore të veçanta dhe prej kujtesave historike të dy shoqërive. Gjatë shekujve këto mund të evoluojnë dhe të avullohet konflikti që është nënshtresa e tyre. Ose konflikti mund të zhduket shpejt e egërsisht, kur njëri grup e shfaros tjetrin. Nëse kjo nuk ndodh asnjëherë, atëherë konflikti vijon dhe po kështu përsëriten periudhat e dhunës. Luftërat në vijën e shkëputjes janë të herëpashershme; konfliktet në vijën e shkëputjes janë të pafund.

Zakonisht që të arrihet një ndërprerje qoftë edhe e përkohshme e një lufte në vijën e shkëputjes, varet nga dy dukuri. E para është të rraskapiten pjesëmarrësit parësorë. Në një farë pike, kur të vrrarët e të plagosurit arrijnë në dhjetëra mijëra, kur refugjatët bëhen qindra mijëra, kurse qytetet: Bejruti, Grozni, Vukovari, shndërrohen në hi, njerëzit nisin të bërtasin “Çmenduri, kjo është çmenduri, mjaft më!”, radikalët e të dyja palëve nuk janë më në gjendje të mobilizojnë zemërimin popullor, rigjallërohen bisedimet, që janë zvarritur pa fryt për disa vjet, dhe të moderuarit e rimarrin veten, duke arritur ndonjë lloj marrëveshjeje për ndërprerjen e kasaphanës. Aty nga vitit 1994 lufta gjashtëvjeçare për Nagorno-Karabakun i kishte “rraskapitur” si armenët, edhe azerbajxhanasit, rrjedhimisht, ata u pajtuan të bënin armëpushim. Në vjeshtën e vitit 1995 është njoftuar po njësoj për Bosnjën se “Të gjitha palët janë të rraskapitura,” dhe u arritën marrëveshjet e Dejtonit.⁵⁵ Mirëpo ndërpreje të tilla janë të vetëkufizuara. Ato u japin të dyja palëve mundësinë të pushojnë e të

rimbushin burimet e veta. Pastaj kur njëra palë e sheh se ka mundësi për të fituar, lufta rinis.

Edhe që të arrihet një pushim i përkohshëm kërkohet një faktor i dytë: të përfshihen pjesëmarrësit jo të nivelit parësor, që kanë interes dhe peshë për t'i ulur ndërluftuesit së bashku. Luftërat në vijën e shkëputjes pothuaj asnjëherë nuk ndërpriten me anë të bisedimeve të drejtpërdrejta vetëm midis palëve parësore dhe vetëm rrallë ndodh nëpërmjet ndërmjetësimit të palëve të painteresuara. Largësia kulturore, urrejtja e thellë dhe dhuna e dyanshme që kanë ushtruar, e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë, që palët parësore të ulen bashkë dhe t'u hyjnë diskutimeve të frytshme, duke synuar për ndonjë formë të ndalimit të zjarrit. Çështjet politike që përbëjnë nënshtresën, se kush e sundon atë territor dhe njerëzit e tij e me çfarë kushtesh, dalin në sipërfaqe dhe e pengojnë marrëveshjen për çështje më të kufizuara.

Nganjëherë konfliktet ndërmjet vendeve ose grupeve me kulturë të përbashkët mund të zgjidhen nëpërmjet ndërmjetësimit prej një pale të tretë të painteresuar, e cila e ka të përbashkët atë kulturë me to, pranohet si e ligjshme brenda asaj kulture dhe, rrjedhimisht, mund të ketë besimin e të dyja palëve se mund të gjejë një zgjidhje, që do t'i ketë rrënjët në vlerat e asaj kulture. Papa do të kishte sukses për të hyrë si ndërmjetës në grindjen mes Argjentinës e Kilit për kufirin. Mirëpo në konfliktet ndërmjet grupeve prej qytetërimeve të ndryshme nuk ka palë të painteresuara. Është jashtëzakonisht e vështirë të gjendet një individ, një institucion ose shtet, të cilin të dyja palët do ta quanin se e meriton besimin. Secili ndërmjetës i mundshëm i përket njërit prej qytetërimeve në konflikt, ose një qytetërimi të tretë, i cili ka edhe kulturë tjetër e interesa të tjerë, që nuk ngjallin besim te asnjëra palë në

konflikt. Papën nuk do ta thërrisnin çeçenët e rusët ose tamilët dhe sinhalezët. Zakonisht organizatat ndërkombëtare dështojnë, sepse u mungon aftësia për t'u imponuar një kosto të madhe ose për t'u ofruar përfitime të ndjeshme palëve përkatëse.

Luftërat në vijën e shkëputjes nuk marrin fund me anë të individëve, grupeve ose organizatave të painteresuara, por nëpërmjet palëve të dyta e të treta të interesuara, të cilat janë rreshtuar për të mbështetur farefisën e tyre dhe e kanë aftësinë për të biseduar lidhur me marrëveshjet me kundërpalën e tyre, nga njëra anë, e për ta detyruar farefisën e tyre që t'i pranojë ato marrëveshje, nga ana tjetër. Ndërsa rreshtimi e përforcon dhe e zgjat luftën, përgjithësisht ai është edhe një kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm, për ta kufizuar dhe për ta ndërprerë luftën. Të rreshtuarit e nivelit të dytë e të tretë zakonisht nuk duan të shndërrohen në luftëtarë të nivelit parësor dhe, për pasojë, orvaten ta mbajnë luftën nën kontroll. Gjithashtu, ata kanë interesa më të ndryshëm nga pjesëmarrësit parësorë, të cilët janë pa përjashtim të përqendruar te lufta, si edhe kujdesen për të tjera çështje në marrëdhëniet njëri-tjetrit. Prandaj në një farë pike ata ka të ngjarë që ta shohin, se është në interesin e tyre që të ndërpriten luftimet. Për shkak se janë rreshtuar prapa farefisit të tyre, ata kanë në dorë fuqi për të vepruar mbi farefisën e tyre. Në këtë mënyrë, të rreshtuarit bëhen kufizues e ndërprerës.

Luftërat pa palë dytësore e të treta ka më pak gjasa sesa të tjerat që të zgjerohen, por është më e vështirë që të ndërpriten, sepse janë luftëra ndërmjet grupesh prej qytetërimesh, të cilave u mungojnë shtetet bërthamë. Luftërat në vijën e shkëputjes, në të cilat përfshihet një kryengritje brenda një shteti të qëndrueshëm dhe të cilave u mungon një rreshtim i rëndësishëm, po ashtu

shtrojnë probleme të posaçme. Nëse lufta vazhdon për një farë kohe, kërkesat e kryengritësve kanë prirje që të shkallëzohen nga një farë forme e autonomisë deri te pavarësia e plotë, të cilën qeveritë e hedhin poshtë. Zakonisht qeveritë kërkojnë që kryengritësit të dorëzojnë armët si hapi i parë drejt ndërprerjes së luftimeve, porse kryengritësit këtë nuk e pranojnë. Është krejt e natyrshme gjithashtu, që qeveritë ta kundërshtojnë përzierjen e të jashtëmëve në atë, që e quajnë një problem thjesht të brendshëm, në të cilin janë ngatërruar "elementë kriminalë". Përcaktimi që i bëjnë si punë e brendshme u jep edhe shteteve të tjera një përligje përse nuk ngatërrohen në të, siç ndodhi në rastin e fuqive Perëndimore me Çeçeninë.

Këto probleme ndërlikohen, kur qytetërimet e përziëra në to nuk kanë shtete bërthamë. Lufta në Sudan, për shembull, e cila nisi më 1956, arriti të ndalej më 1972, kur palët ishin rraskapitur dhe Këshilli Botëror i Kishave e Këshilli Mbarafrikan i Kishave, me një arritje që faktikisht ka qenë unike për organizatat ndërkombëtare joqeveritare, ia dolën mbanë të bënin bisedime për marrëveshjen e Adis Abebës, e cila i dha autonominë Sudanit jugor. Mirëpo një dhjetëvjeçar më vonë, qeveria e shfuqizoi marrëveshjen, lufta rinisi, synimet e kryengritësve u përshkallëzuan, qëndrimi i qeverisë u bë më i ashpër dhe orvatjet për të arritur një ndërprerje tjetër me anë të bisedimeve dështuan. As bota arabe dhe as Afrika nuk kishin shtete bërthamë, të interesuara dhe me peshë, që t'u bënin trysni palëve pjesëmarrëse. Përpjekjet për ndërmjetësim nga Xhimi Karteri dhe disa udhëheqës të tjerë afrikanë nuk patën sukses, e po ashtu dështuan orvatjet e një komisioni të shteteve të Afrikës Lindore, të përbërë nga Kenia, Eritrea, Uganda e Etiopia. Shtetet e Bashkuara, që kishin marrëdhënie me kontradikta të thella me Sudanin e nuk

mund të vepronin drejtpërdrejt; po ashtu nuk mund t'u kërkonin Iranit, Irakut ose Libisë, të cilat kishin marrëdhënie të ngushta me Sudanin, që të luanin role të dobishme; për pasojë, puna përfundoi që të ngarkohej Arabia Saudite, por edhe ndikimi i Arabisë mbi Sudanin gjithashtu ishte i kufizuar.

Përgjithësisht, bisedimet për ndërprerjen e zjarrit mund të ecin deri në atë masë, sa mund të përfshihen relativisht në mënyrë paralele e të barabartë palët dytësore e të treta nga të dyja krahët. Mirëpo në disa rrethana një shtet i vetëm bërthamë mund të jetë aq i fuqishëm, sa ta bëjë ai që të ndërpritet lufta. Më 1992 Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE) u përpoq të ndërmjetësonte në luftën mes Armenisë e Azerbajxhanit. U krijua një komision, Grupi i Minskut, në të cilin përfshiheshin palët parësore, dytësore e të treta përkatëse të konfliktit (armenët e Nagorno-Karabakut, Armenia, Azerbajxhani, Rusia, Turqia), plus Franca, Gjermania, Italia, Suedia, Republika Çeke, Bjellorusia dhe Shtetet e Bashkuara. Përveç Shteteve të Bashkuara e Francës, në të cilat ka disapora të mëdha armenësh, vendet e tjera nuk kishin ndonjë interes për të arritur të bënin që të mbaronte lufta dhe nuk kishin ndonjë aftësi ose e kishin fare të paktë për ta arritur. Kur dy palë të treta, Rusia e Turqia, plus Shtetet e Bashkuara merreshin vesh për një plan, ai hidhej poshtë nga armenët e Nagorno-Karabakut. Megjithatë, Rusia në mënyrë të pavarur përkrahu një varg të gjatë bisedimesh në Moskë ndërmjet Armenisë e Azerbajxhanit, të cilat "krijuan një rrugë alternative kundrejt Grupit të Minskut dhe...kështu e zhvlerësuan përpjekjen e bashkësisë ndërkombëtare."⁵⁷ Më në fund, pasi pjesëmarrësit parësorë në konflikt u raskapitën dhe rusët kishin siguruar mbështetjen e Iranit për bisedimet, përpjekjet e rusëve ia dolën në krye që të bëhej një

marrëveshje armëpushimi. Si palë dytësore, Rusia e Irani bashkëpunuan edhe në orvatjet e herëpashershme e me sukses për të rregulluar një pushim zjarri në Tashkistan.

Rusia do të ketë një prani të vazhdueshme në Transkaukaz dhe do ta ketë aftësinë për të imponuar pushimin e zjarrit, që mbështeti, për aq kohë sa do të ketë interes të veprorë kështu. Kjo është krejt e kundërta me gjendjen e Shteteve të Bashkuara kundrejt Bosnjës. Marrëveshjet e Dejtonit u ndërtuan mbi bazën e propozimeve të përpunuara prej Grupit të Kontaktit të shteteve bërthamë të interesuara (Gjermania, Britania, Franca, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara), porse asnjë prej palëve të treta nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt në hartimin e marrëveshjes përfundimtare, kurse dy palët parësore në luftë mbetën anash bisedimeve. Zbatimi i marrëveshjes i mbetet forcës së NATO-s, në të cilën mbisundojnë amerikanët. Nëse Shtetet e Bashkuara i tërheqin trupat nga Bosnja, as fuqitë europiane dhe as Rusia nuk do të kenë ndonjë shtysë për ta vazhduar zbatimin e marrëveshjes, kurse qeveria e Bosnjës, serbët e kroatët do të kenë të gjitha arsyet për t'i rifilluar luftimet, sapo të jenë mëkëmbur, ndërkohë qeveria serbe e kroate do të joshen nga mundësia për të realizuar ëndrrat e tyre për një Serbi të Madhe dhe një Kroaci të Madhe.

Robert Putnami e ka vënë në dukje shkallën në të cilën bisedimet ndërmjet shteteve janë "lojëra në dy nivele", ku diplomatët zhvillojnë njëkohësisht bisedime me zonat elektorale brenda vendit të tyre dhe me kundërpalët prej një vendi tjetër. Në një analizë paralele me këtë, Hantingtoni ka treguar sesi reformatorët në një qeveri autoritare, ndërsa bëjnë bisedime për të kaluar në demokraci me të moderuarit e opozitës, duhet gjithashtu të bëjnë bisedime me përfaqësuesit e vijës së ashpër ose kundër tyre brenda vetë qeverisë, e njëkohësisht të

moderuarit duhet të bëjnë të njëjtën gjë me radikalët e opozitës.⁵⁸ Këto lojëra në dy nivele përfshijnë të paktën katër palë dhe të paktën tri ose katër marrëdhënie ndërmjet tyre. Megjithatë, një luftë e ndërlikuar në vijën e shkëputjes është një lojë në tri nivele me të paktën gjashtë palë dhe të paktën shtatë marrëdhënie ndërmjet tyre. (Shih Skicën 11.1). Marrëdhëniet horizontale përmes vijave të shkëputjes ekzistojnë ndërmjet palëve parësore, dytësore dhe të treta. Marrëdhëniet vertikale ekzistojnë ndërmjet palëve në nivele të ndryshme brenda secilit qytetërim. Rrjedhimisht, që të arrihet ndërprerja e luftimeve në një luftë të “modelit të plotë”, ka të ngjarë që të kërkohet:

- përfshirja aktive e palëve të dyta e të treta;
- zhvillimi i bisedimeve nga palët e treta për kushtet e përgjithshme të ndërprerjes së luftimeve;
- të përdoret nga palët e treta politika e shkopit dhe e karrotës që të detyrohen palët e dyta t’i pranojnë këto kushte dhe të bëjnë trysni mbi palët parësore që t’i pranojnë;
 - t’u hiqet mbështetja dhe, në të vërtetë të tradhtohen palët parësore nga ana e palëve dytësore; dhe
 - si rrjedhim i kësaj trysnie, të pranohen kushtet nga palët parësore, të cilat, natyrisht, do t’i hedhin poshtë ato, kur ta shohin se është në interesin e tyre.

Në procesin e paqes për Bosnjën ishin të pranishëm të gjithë këta elementë. Dukej qartë se nuk dilnin me sukses orvatjet për të arritur një marrëveshje nga ana e aktorëve individualë: Shtetet e Bashkuara, Rusia, Bashkimi Europian. Fuqitë Perëndimore ngurrnin që ta përfshinin Rusinë si partner të plotë në këtë proces. Rusët e kundërshtuan me forcë përjashtimin, duke

argumentuar se kishin lidhje historike me serbët, kurse në Ballkan interesa edhe më të drejtpërdrejtë, sesa cilado fuqi tjetër e madhe. Rusia këmbëngulte që të ishte lojtar i plotë në përpjekjet për të zgjidhur konfliktet dhe denoncoi me forcë “prirjen nga ana e Shteteve të Bashkuara për të diktuar kushtet e tyre.” Në shkurt 1994 u bë e qartë nevoja që të përfshiheshin edhe rusët. Pa u këshilluar me Rusinë, NATO-ja u paraqiti një ultimatum serbëve të Bosnjës që të tërhiqnin armët e rënda të vendosura rreth Sarajevës, përndryshe do të përballeshin me sulme ajrore. Serbët e kundërshtuan këtë kërkesë dhe u duk se do të kishte një përplasje të dhunshme me NATO-n. Jelcini bëri paralajmërimin, se “Disa po përpiqen ta zgjidhin çështjen e Bosnjës pa pjesëmarrjen e Ruisë”, porse “Ne nuk do ta lejojmë këtë gjë.” Atëherë qeveria ruse mori iniciativën në duar dhe i bindi serbët t’i tërhiqnin armët, në rast se Rusia do të vendoste trupa paqeruajtëse në zonën e Sarajevës. Ky grusht shteti diplomatik e parandaloi shkallëzimin e dhunës, i tregoi Perëndimit dorën e fortë që kishte Rusia mbi serbët dhe i solli trupat ruse në zemër të zonës së përleshjes ndërmjet myslimanëve bosnjakë dhe serbëve.⁵⁹ Nëpërmjet kësaj manovre Rusia në fakt i konfirmoi mëtimet për “partneritet të barabartë” me Perëndimin në trajtimin e Bosnjës.

Mirëpo në prill NATO-ja përsëri e dha autorizimin për të bombarduar pozicionet serbe pa u këshilluar me Rusinë. Kjo shkaktoi reagime jashtëzakonisht të mëdha negative në gjithë spektrin politik rus dhe e fuqizoi opozitën nacionaliste kundër Jelcinit e Kozirevit. Menjëherë më pas fuqitë e treta me peshë: Britania, Franca, Gjermani, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara formuan Grupin e Kontaktit për të hartuar planin e zgjidhjes. Në qershor 1994 grupi përgatiti një plan, në të cilin 51 për qind e Bosnjës i jepej një federate

muslimane-kroate e 49 për qind serbëve të Bosnjës, dhe ai shërbeu si baza për marrëveshjen e mëvonshme të Dejtonit. Pas një viti doli e nevojshme të përpunoheshin rregullat për pjesëmarrjen e trupave ruse në zbatimin e detyrueshëm të marrëveshjeve të Dejtonit.

Marrëveshjet ndërmjet palëve të treta duhet t'u shiten aktorëve parësorë e dytësorë. Siç është shprehur diplomati rus Vitali Çurkin, amerikanët duhet të ushtrojnë trysni mbi bosnjakët, gjermanët mbi kroatët dhe rusët mbi serbët.⁶⁰ Në fazat e para të luftërave në Jugosllavi Rusia pati bërë një lëshim të rastit, kur u pajtua me sanksionet ekonomike kundër Serbisë. Si një vend farefis, të cilit serbët mund t'i besonin, nganjëherë Rusia që në gjendje gjithashtu t'u impononte disa shtrëngesa serbëve dhe t'u bënte trysni që të pranonin kompromise, të cilat përndryshe këta do t'i kishin hedhur poshtë. Për shembull, më 1995 Rusia, së bashku me Greqinë, ndërhynte te serbët e Bosnjës që të arrinin lirin e paqeruajtësve holandezë, të cilët i mbanin peng. Megjithatë, në ndonjë rast serbët e Bosnjës i kanë hedhur poshtë marrëveshjet e bëra nën trysinë ruse dhe, rrjedhimisht, e kanë vënë Rusinë në pozitë të vështirë, sepse nuk ishte në gjendje të përmbante farefisin e vet. Për shembull, në prill 1994 rusët u shkëputën marrëveshjen serbëve të Bosnjës që t'i jepnin fund sulmit mbi Gorazhden, mirëpo serbët pastaj e shkelën marrëveshjen. Rusët u tërbuan: një diplomat rus deklaroi se serbët e Bosnjës "ishin marrosur pas luftës", Jelcini këmbënguli që "udhëheqësit serbë duhet t'u përmbahen detyrimeve të marra përpara Ruisë," dhe Rusia i tërhoqi kundërshtimet për goditjet ajrore të NATO-s.⁶¹

Ndërsa e mbështetën dhe e fuqizuan Kroacinë, Gjermania e shtetet e tjera Perëndimore gjithashtu qenë në gjendje ta përmbanin sjelljen e kroatëve. Presidenti

Tugjman ishte shumë i shqetësuar, që vendi i tij katolik të njihej si vend evropian dhe të pranohej në organizatat evropiane. Fuqitë Perëndimore e shfrytëzuan si mbështetjen diplomatike, ekonomike e ushtarake që i dhanë Kroacisë, ashtu dhe dëshirën e Kroacisë për t'u pranuar në "klub", që ta shtynin Tugjmanin të bënte kompromise për shumë çështje. Në mars të vitit 1995 Tugjmanit iu parashtrua çështja, që nëse dëshironte të bëhej pjesë e Perëndimit, duhej ta lejonte Forcën Mbrojtëse të OKB-së të qëndronte në Krajinë. "Për Tugjmanin ka shumë rëndësi," ka thënë një diplomat evropian, "të hyjë në Perëndim. Ai nuk dëshiron të mbetet i vetëm me serbët e me rusët." E paralajmëruan gjithashtu, që ta përmbante spastrimin etnik, kur trupat e tij pushtuan territorin e Krajinës dhe gjetkë ku kishte serbë, si dhe të mos e shtrinte mësymjen në Sllavoninë Lindore. Për një çështje tjetër kroatëve iu tha, që nëse nuk hynin në federatë me myslimanët, "dera për në Perëndim do t'u mbyllej përgjithmonë," siç e ka shprehur një zyrtar i SHBA.⁶² Duke qenë burimi kryesor i jashtëm i Kroacisë për përkrahjen financiare, Gjermania kishte një pozitë veçanërisht të fortë për të ndikuar mbi qëndrimin e Kroacisë. Marrëdhëniet e ngushta që Shtetet e Bashkuara ndërtuan me Kroacinë gjithashtu ndihmuan për të parandaluar Tugjmanin, të paktën gjatë vitit 1995, që të mos e vinte në jetë dëshirën e shprehur shpesh, që ta ndante Bosnjë-Hercegovinën ndërmjet Kroacisë e Serbisë.

Ndryshe nga Rusia e Gjermania, Shtetet e Bashkuara nuk kishin përbashkësi kulturore me klientin e tyre bosnjak, rrjedhimisht, ishin në pozitë të dobët e nuk mund t'u bënin trysni myslimanëve për kompromis. Përveç kësaj, po të lihet mënjanë retorika, Shtetet e Bashkuara i ndihmuan bosnjakët vetëm duke bërë një sy të verbër lidhur me shkeljen e embargos së armëve nga

Irani e shtetet e tjera myslimane. Si pasojë, myslimanët e Bosnjës gjithnjë e më shumë e ndien veten mirënjohës kundrejt bashkësisë më të gjerë islamike dhe e njëjtësuan veten gjithnjë e më shumë me të. Njëkohësisht i denoncuan Shtetet e Bashkuara se po ndiqnin një “standard të dyfishtë” dhe nuk po e zbrapsnin agresionin kundër tyre, siç kishin bërë me Kuvajtin. Duke e paraqitur veten me petkun e viktimës, ata e bënë edhe më të vështirë për Shtetet e Bashkuara që t’u bënin trysni për t’u treguar elastikë. Kështu qenë në gjendje t’i hidhnin poshtë propozimet për paqe, e fuqizuan forcën ushtarake me ndihmë nga miqtë myslimanë dhe në fund e morën nismën e rifituan një pjesë të madhe të territoreve që kishin humbur.

Ndërmjet palëve parësore është shumë i fuqishëm kundërshtimi për kompromiset. Në Luftën e Transkaukazit, Federata Revolucionare Armene ultranacionaliste (Dashnak), e cila ishte shumë e fortë në diasporën amerikane, e vuri në dorë bashkësinë e Nagorno-Karabakut, hodhi poshtë propozimet turko-ruso-amerikane për paqe të majit 1993, që ishin pranuar prej qeverive të Azerbajxhanit e të Armenisë, ndërmori mësymje ushtarake që shkaktuan shpërthime të spastrimit etnik, e shtoi mundësinë për një luftë më të gjerë dhe i rëndoi marrëdhëniet me qeverinë armene më të moderuar. Suksesi i mësymjes së Nagorno-Karabakut i shkaktoi probleme Armenisë, e cila ishte në ankth për të përmirësuar marrëdhëniet me Turqinë e Iranin, në mënyrë që të lehtësonte mungesat e rënda të ushqimeve e të energjisë si pasojë e luftës dhe e bllokadës turke. “Sa më mirë shkojnë punët në Karabak, aq më të vështirë e ka Erevani,” e ka komentuar një diplomat Perëndimor. Presidenti Levon Ter-Oterosjan i Armenisë, ashtu si presidenti Jelcin, duhej të baraspeshonte trysnitë nga nacionalistët në organin e tij ligjvënës kundrejt

interesave më të gjerë të politikës së jashtme për t'iu përshtatur shteteve të tjera, kurse nga fundi i vitit 1994 qeveria e tij e ndaloi me ligj partinë Dashnak në Armeni.

Ashtu si armenët e Nagorno-Karabakut, edhe serbët e Bosnjës e kroatët mbajtën qëndrime të vijës së ashpër. Si pasojë, qeveritë e Kroacisë e të Serbisë u ndodhën nën trysni për t'i dhënë ndihmë procesit të paqes, lindën probleme në marrëdhëniet e tyre me faqefisin bosnjak. Me kroatët këto qenë më pak të rënda, pasi kroatët e Bosnjës u pajtuan formalisht, ndonëse jo praktikisht, për të hyrë në një federatë me myslimanët. Përkundrazi, konflikti ndërmjet presidentit Millosheviq dhe udhëheqësit të serbëve bosnjakë Radovan Karaxhiq, i nxitur edhe prej antagonizmit të tyre personal, u bë publik e më i fortë. Në gusht 1994 Karaxhiqi e hodhi poshtë planin e paqes të miratuar prej Millosheviqit. Qeveria serbe, që ishte e shqetësuar për t'u dhënë fund sanksioneve, shpalli se po e ndërpriste gjithë tregtinë me serbët e Bosnjës, me përjashtim të ushqimeve e ilaçeve. Nga ana e vet OKB-ja i lehtësoi sanksionet kundër Serbisë. Vitin pasues Millosheviqi e lejoji ushtrinë kroate që t'i dëbonte serbët nga Krajina dhe forcat kroate e myslimane t'i zbrapsnin në Bosnjën veriperëndimore. Ai gjithashtu u mor vesh me Tugjmanin që të lejohej kthimi shkallë-shkallë nën pushtetin e Kroacisë i Sllavonisë Lindore, të pushtuar prej serbëve. Me miratimin e fuqive të mëdha, më pas ai në fakt "i çoi" serbët e Bosnjës në bisedimet e Dejtonit, duke i përfshirë në delegacionin e vet.

Veprimet e Millosheviqit u dhanë fund sanksioneve të OKB-së kundër Serbisë. Ato gjithashtu i sollën një miratim të përmbajtur nga bashkësia ndërkombëtare pakëz e befasuar. Luftënxitësi i vitit 1992 nacionalist, agresiv, përkrahësi i spastrimit etnik dhe i Serbisë së Madhe, na u bë paqebërësi i vitit 1995. Mirëpo për

shumë serbë ai ishte bërë tradhtar. Nacionalistët serbë dhe udhëheqësit e kishës ortodokse e denoncuan në Beograd, ndërsa serbët e Krajnës e të Bosnjës e akuzuan rëndë për tradhti. Natyrisht, me këtë ata përsëritën akuzat e kolonëve të Bregut Perëndimor kundër qeverisë së Izraelit për marrëveshjen e saj me OÇP-në. Në luftërat e vijës së shkëputjes çmimi i paqes është tradhtia për farefisin.

Rraskapitja nga lufta dhe shtysat e trysnitë nga palët e treta sjellin ndryshime te palët dytësore e të treta. Ose të moderuarit u zënë vendin ekstremistëve në pushtet, ose ekstremistët, si Millosheviqi, e shohin se është në interes të tyre të bëhen të moderuar. Megjithatë, ata veprojnë kështu duke rrezikuar disi. Ata që perceptohen si tradhtarë ngjallin një urrejtje më të fuqishme, sesa vetë armiqtë. Udhëheqësit e myslimanëve të Kashmirit, çeçenët dhe sinhlazët e Sri Lankës kanë pësuar fatin e Sadatit e të Rabinit, sepse e tradhtuan çështjen dhe u orvatën të gjenin zgjidhje kompromisi me armikun e kahershëm. Më 1914 një nacionalist serb vrau një arkidukë austriak. Pas marrëveshjeve të Dejtonit objektivi i tij ka më shumë gjasa se do të ishte Slllobodan Millosheviqi.

Një marrëveshje për ta ndërprerë një luftë në vijën e shkëputjes do të kishte sukses, qoftë edhe vetëm përkohësisht, në atë shkallë që do të pasqyronte baraspeshën lokale të fuqisë ndërmjet palëve parësore dhe interesave të palëve dytësore e të treta. Ndarja e Bosnjës në 51 për qind dhe 49 për qind nuk ishte e përfytyrueshme më 1994, kur serbët kishin nën kontroll 70 për qind të vendit; kjo u bë e mundur kur mësymjet e kroatëve e të myslimanëve e zvogëluan pushtimin e serbëve pothuaj përgjysmë. Procesin e paqes e ndihmoi gjithashtu spastrimi etnik që ndodhi, i cili i zvogëloi serbët në më pak se 3 për qind të popullsisë në Kroaci

dhe anëtarët e të tre grupeve u ndanë me dhunë ose vullnetarisht në Bosnjë. Veç kësaj, palët dytësore e të treta, këto të fundit shpesh shtete bërthamë të qytetërimeve, duhet të kenë interesa realë të bashkësisë ose të sigurisë në një luftë, që të përkrahin një zgjidhje të zbatueshme. Pjesëmarrësit parësorë vetëm vetë nuk mund t'i ndërpresin luftërat në vijën e shkëputjes. Ndërprerja e tyre dhe parandalimi që të mos shkallëzohen si luftëra globale varen në radhë të parë nga interesat dhe veprimet e shteteve bërthamë të qytetërimeve kryesore të botës. Luftërat në vijën e shkëputjes gurgullojnë lart që nga poshtë, paqet në vijën e shkëputjes pikojnë poshtë që nga lart.

V.
E ardhmja e
qytetërimeve

Kreu 12: Perëndimi, qytetërimet dhe qytetërimi

Përtëritja e perëndimit?

Gjatë historisë së cilitdo qytetërim historia të paktën një herë merr fund e, rastësisht, edhe disa herë. Me daljen e shtetit universal të qytetërimit, njerëzit e tij verbohen nga ajo, që Toynbi e ka quajtur “mirazhi i pavdekësisë”, dhe fitojnë bindjen se forma e tyre është e fundit formë e shoqërisë njerëzore. Kështu ka ndodhur me Perandorinë Romake, me Kalifatin Abasid, me Perandorinë Mogule dhe me Perandorinë Osmane. Qytetarët e shteteve të tilla universale “në kundërshtim me faktet e qarta të dukshme... janë të prirur ta shohin jo si një strehim nate në mes të një vendi të egër, por si Tokën e Premtuar, si pikësynimin e gjithë përpjekjeve njerëzore.” E njëjta gjë ka qenë e vërtetë në kulmin e Pax Britannica-s. Për klasën e mesme angleze më 1897, “ashtu siç e shihnin ata, historia për ta kishte mbaruar... Dhe kishin të gjitha arsyet për ta uruar veten lidhur me atë gjendje të përhershme lumturie, që ua kishte dhuruar ky mbarim i historisë.”¹ Mirëpo shoqëritë, që kujtojnë se historia e tyre ka marrë fund,

zakonisht janë shoqëri, historia e të cilave ka nisur rrugën e rënies.

A përbën Perëndimi ndonjë përjashtim nga ky model? Melkoja ka parashtruar mjaft mirë dy pyetje kyç:

E para, a është qytetërimi Perëndimor një lloj i ri, një klasë në vetvete, në mënyrë të pakrahasueshme i ndryshëm nga të gjitha qytetërimet e tjera, që kanë ekzistuar kurdo qoftë?

E dyta, përhapja e tij në mbarë botën a përbën një kërcënim (ose një premtim) për t'i dhënë fund mundësisë së zhvillimit të gjithë qytetërimeve të tjera?²

Natyrisht, prirja e gjithë Perëndimorëve është t'u përgjigjen në mënyrë pohuese të dyja pyetjeve. E ndoshta kanë të drejtë. Megjithatë, në të kaluarën popujt e qytetërimeve të tjera kanë pasur të njëjtin mendim dhe e kanë pasur mendim të gabuar.

Është e qartë se Perëndimi dallohet prej gjithë qytetërimeve të tjera që kanë ekzistuar ndonjë herë, sepse ka pasur një ndikim mbizotërues mbi gjithë qytetërimet e tjera, të cilat kanë ekzistuar qysh prej vitit 1500. Gjithashtu ai i hapi proceset e modernizimit e të industrializimit, që janë bërë botërore, kurse si rrjedhim, shoqëritë në të gjitha qytetërimet e tjera janë orvatur që ta arrijnë Perëndimin nga ana e pasurisë dhe e modernitetit. Mirëpo këto karakteristika të Perëndimit a duan të thonë se evoluimi dhe dinamika si qytetërim janë në themel të ndryshme nga modelet, që kanë mbizotëruar në të gjitha qytetërimet e tjera? Dëshmitë e historisë dhe gjykimet e studiuesve të historisë së krahasuar të qytetërimeve na shtyjnë drejt një mendimi tjetër. Zhvillimi i Perëndimit deri më sot nuk është shmangur ndjeshëm nga modelet e evoluimit, të përbashkëta për qytetërimet gjatë gjithë historisë. Ringjallja Islamike dhe dinamizmi ekonomik i Azisë

tregojnë se qytetërimet e tjera janë të gjalla, janë shëndoshë e mirë dhe të paktën si mundësi e kërcënojnë Perëndimin. Nuk është e pashmangshme një luftë, në të cilën të përfshihen Perëndimi dhe shtetet bërthamë të qytetërimeve të tjera, por edhe mund të ndodhë. Anasjelltas, rënia e parregullt dhe pak nga pak e Perëndimit, e cila ka nisur në fillim të shekullit të njëzetë, mund të vijojë për dhjetëra vjet e ndoshta edhe për shekuj në të ardhmen. Ose Perëndimi mund të përshkojë një periudhë ringjalljeje, të përmbysjes së rënies së tij nga pikëpamja e ndikimit në punët e botës, dhe ta rimarrë pozitën si udhëheqësi, të cilin e ndjekin dhe e imitojnë qytetërimet e tjera.

Karrol Kuigli, i cili ka bërë periodizimin ndoshta më të dobishëm të evoluimit të qytetërimeve historike, ka përcaktuar një model të përbashkët prej shtatë fazash.³ (Shih më sipër, f. 44). Sipas arsytimit të tij, qytetërimi Perëndimor nisi pak nga pak të merrte trajtë ndërmjet viteve 370 e.r.e dhe 750, nëpërmjet përzierjes së kulturave klasike, semitike, saracene e barbare. Periudha e tij embrionale zgjati nga mesi i shekullit të tetë deri në shekullin e dhjetë dhe pastaj u ndoq nga një lëvizje përparimesh e prapakthimesh të pazakonshme ndër qytetërimet, ndërmjet fazave të zgjerimit dhe fazave të konflikteve. Sipas autorit, po edhe sipas studiuesve të qytetërimeve të tjera, Perëndimi sot duket se po del prej fazës së vet të konflikteve. Qytetërimi Perëndimor është bërë një zonë sigurie; me përjashtim të Luftës së ftohtë, që ishte e rastit, luftërat ndërmjet vendeve Perëndimore në të vërtetë as që mund të mendohen. Siç e vërtetëojmë në kreun 2, Perëndimi po përpunon barasvlerësin e vet si një perandori universale në trajtën e një sistemi të ndërlikuar konfederatash, federatash, regjimesh e tipash të tjerë institucionesh të bashkëpunimit, që në nivelin qytetërimor mishërojnë përkushtimin e tij ndaj politikës

demokratike e pluraliste. Shkurt, Perëndimi është bërë një shoqëri e pjekur, që po hyn në atë, të cilën brezat e ardhshëm, sipas modeleve të përsëritshme të qytetërimeve, do ta vështrojnë si “epoka e artë,” një periudhë paqeje, që erdhi si rrjedhim, sipas përcaktimit të Kuiglit, nga “mungesa e çfarëdo njësisë në konkurrencë brenda zonës së vetë qytetërimit, dhe nga perspektiva e largët ose mungesa fare e luftërave me shoqëritë e tjera nga jashtë.” Kjo është gjithashtu një periudhë lulëzimi, e cila vjen prej “marrjes fund të shkatërrimit luftënxitës të brendshëm, zvogëlimit të barrierave të tregtisë së brendshme, ngritjes së një sistemi të përbashkët të peshave, masave e monedhave, si dhe nga sistemi i gjerë i shpenzimeve qeveritare, të lidhura me ngritjen e një perandorie universale.”

Në qytetërimet e mëparshme kjo fazë e epokës së artë të lumtur, me vegimin e vet të pavdekësisë, ka përfunduar ose shpejt e në mënyrë dramatike me fitoren e një shoqërie të jashtme, ose dalngadalë po njësoj dhimbshëm prej shpërbërjes së brendshme. Ajo që ndodh brenda një qytetërimi është po aq thelbësore për të përballuar shkatërrimin nga burimet e jashtme, sa është edhe për ta përmbajtur kalbëzimin nga brenda. Më 1961 Kuigli ka argumentuar, se qytetërimet rriten, pasi kanë një “vegël zgjerimi”, domethënë kanë një organizim ushtarak, fetar, politik ose ekonomik, i cili i grumbullon tepricat dhe i investon në risitë e veta prodhuese. Qytetërimet nisën rënien, kur e ndërpresin “përdorimin e tepricave për rrugë të reja të prodhimit të sendeve. Me termat e sotëm ne themi se bie norma e investimeve.” Kjo ndodh sepse grupet shoqërore, që kanë në duar tepricat, kanë interes të vetin për t’i përdorur për “qëllime joprodhuese, por për të kënaqur egon...të cilat i kalojnë tepricat për konsum, por nuk krijojnë më metoda të frytshme prodhimi.” Njerëzit

jetojnë në kurriz të kapitalit të vet dhe qytetërimi kalon prej fazës së shtetit universal te faza e rënies. Kjo është një periudhë e depresionit të mprehtë ekonomik, e rënies së standardeve të jetesës, e luftërave civile ndërmjet interesave të ndryshëm vetjakë dhe e analfabetizmit në rritje. Shoqëria bëhet gjithnjë e më e dobët. Bëhen orvatje të kota për ta ndalur kalbëzimin me anë të ligjeve. Por rënia vijon. Nivelet fetare, intelektuale, shoqërore e politike të shoqërisë nisin ta humbasin mbështetjen e masave në shkallë të gjerë. Nisin të mbijnë në mbarë shoqërinë lëvizje të reja fetare. Shfaqet një ngurrim në rritje e sipër për të mos luftuar për shoqërinë, e madje për të mos e mbështetur duke paguar taksat.

Atëherë rënia kalon në fazën e pushtimeve, “kur qytetërimi, që nuk është më *i aftë* për ta mbrojtur veten për shkak se nuk është më *i gatshëm* për ta mbrojtur veten, mbetet i hapur më dy kanatash përballë ‘pushtuesve barbarë’,” të cilët shpesh vijnë prej “një qytetërimi tjetër më të ri, më të fuqishëm.”⁴

Megjithatë, mësimi kryesor nga historia e qytetërimeve është se shumë gjëra janë të mundshme, por asgjë nuk është e pashmangshme. Qytetërimet e kanë si mundësi dhe e kanë përtërirë e reformuar veten. Çështja qendrore për Perëndimin është nëse, pa asnjë lidhje me ndonjë sfidë të jashtme, ai do të jetë në gjendje t’i ndalojë e t’i kthejë mbrapsht proceset e brendshme të kalbëzimit. A mund ta përtërijë veten Perëndimi, apo kalbëzimi i brendshëm i vazhduar thjesht do t’ia shpejtojë fundin dhe/ose rënien nën varësinë e

qytetërimeve të tjera më dinamike nga ana ekonomike e demografike?*

Në mes të viteve 1990 Perëndimi kishte shumë tipare, të cilat Kuigli i ka përcaktuar si karakteristika të një qytetërimi të pjekur në buzë të rënies. Ekonomikisht Perëndimi ishte shumë më i pasur se cilido qytetërim tjetër, por gjithashtu kishte norma të ulëta të rritjes, të kursimeve dhe të investimeve, në veçanti po të krahasoheshin me shoqëritë e Azisë Lindore. Konsumi individual dhe kolektiv kishte epërsinë mbi krijimin e aftësive për fuqinë e ardhshme ekonomike e ushtarake. Rritja natyrore e popullsisë ishte e ulët, sidomos po të krahasohej me të vendeve islamike. Megjithatë, asnjë prej këtyre problemeve nuk duhej të kishte pasoja katastrofike në mënyrë të pashmangshme. Ekonomitë Perëndimore ende po rriteshin; popujt Perëndimorë në tërësi po jetonin më mirë, kurse Perëndimi ende ishte udhëheqës në kërkimet shkencore dhe në përtëritjen teknologjike. Normat e ulëta të lindshmërisë nuk dukej se do të prekeshin nga ana e qeverive (përpjekjet e të cilave për ta bërë këtë përgjithësisht kanë më pak sukses, madje sesa orvatjet e tyre për ta pakësuar shtimin e popullsisë). Megjithatë, imigrimi ishte burim i mundshëm i një force të re dhe kapitali njerëzor, me kusht që të plotësoheshin dy gjëra: e para, t'u jepej

* Në një parashikim, i cili mund të jetë i drejtë, por nuk mbështetet realisht prej analizës së tij teorike dhe empirike, Quigley arrin në përfundimin: "Qytetërimi Perëndimor nuk ekzistonte rreth vitit 500 e.re; ai ishte në lulëzim të plotë rreth vitit 1500 dhe me siguri do të pushojë së ekzistuarit në një moment në të ardhmen, ndoshta para vitit 2500." Ai thotë se qytetërimet e reja në Kinë e në Indi, që do të zëvendësojnë ato të shkatërtuara prej Perëndimit, atëherë do të kalojnë në fazat e tyre të zgjerimit dhe do të kërcënojnë si qytetërimin Perëndimor, ashtu edhe atë ortodoks. Carrol Quigley, *The Evolution of Civilizations: An Introduction to Historical Analysis* (Indianapolis: Liberty Press, 1979; botuar për herë të parë nga Macmillan më 1961), f. 127, 164-66.

përparësia njerëzve të aftë, të kualifikuar, energjikë, me talent e njohuri profesionale të nevojshme për vendin pritës; e dyta, nëse migrantë e rinj dhe fëmijët e tyre do të asimiloheshin në kulturat e vendit e të Perëndimit. Shtetet e Bashkuara kishte gjasa të ndesheshin me probleme për të plotësuar kushtin e parë, kurse vendet europiane për të plotësuar të dytin. E megjithatë përcaktimi i politikave për të qeverisur nivelet, burimet, karakteristikat dhe asimilimin e imigrantëve janë fare mirë të përballueshme me përvojën dhe kompetencat e qeverive Perëndimore.

Shumë më tepër rëndësi sesa ekonomia dhe demografia kanë problemet e rënies morale, të vetëvrasjes kulturore dhe të përçarjes politike në Perëndim. Ndër shfaqjet që shpesh vihen në dukje të rënies morale janë:

1. shtimi i sjelljeve antishoqërore, si krimet, përdorimi i drogave dhe përgjithësisht dhuna;

2. rënia e familjes, që përfshin edhe normën e lartë të divorceve, shtimin e lindjeve jashtë martese, e shtatzënisë në moshën e adoleshencës dhe të familjeve me një prind;

3. të paktën në Shtetet e Bashkuara, rënia e “kapitalit shoqëror”, domethënë e anëtarësisë në shoqatat vullnetare dhe e besimit ndërpersonal, të lidhur me këtë anëtarësi;

4. dobësimi i përgjithshëm i “etikës së punës” dhe ngritja e kultit të zemërbutësisë personale;

5. pakësimi i përkushtimit për të mësuar dhe për veprimtarinë intelektuale, që në Shtetet e Bashkuara shfaqet te nivelet më të ulëta në arritjet shkollore.

Shëndeti i ardhshëm i Perëndimit dhe ndikimi i tij mbi shoqëritë e tjera varet në një masë të madhe prej

suksesit që do të ketë në përballimin e këtyre prirjeve, të cilat, natyrisht, do të japin shkas për të pohuar epërsinë morale të myslimanëve e të aziatikëve.

Kultura Perëndimore ndodhet përballë problemesh edhe me grupet brenda shoqërive Perëndimore. Një problem i tillë vjen prej imigrantëve nga qytetërimet e tjera, të cilët nuk e pranojnë asimilimin dhe vijnë t'u përmbahen e t'i përhapin vlerat, zakonet dhe kulturat e shoqërive të vendeve amtare. Kjo dukuri vihet re sidomos mes myslimanëve në Europë, të cilët megjithatë përbëjnë një pakicë të vogël. Në një shkallë më të vogël ajo shfaqet mes hispanikëve në Shtetet e Bashkuara, të cilët përbëjnë një pakicë të shumtë në numër. Nëse në këtë rast nuk do të arrihet asimilimi, Shtetet e Bashkuara do të bëhen një vend i çarë, me të gjitha shkaqet për konfliktet e brendshme dhe me përçarjet që ato përmbajnë. Edhe në Europë qytetërimi Perëndimor mund të minohet nga brenda prej dobësimit të përbërësit të vet qendror: krishterimit. Përpjesa e europeanëve që predikojnë besimet fetare, që ndjekin ritet fetare dhe marrin pjesë në veprimtaritë fetare, po shkon në rënie.⁵ Kjo prirje pasqyron jo aq shumë armiqësinë kundrejt fesë, sesa indiferencën ndaj saj. Sidoqoftë, qytetërimin european e përshkojnë konceptet, vlerat dhe ritet e krishtera. "Suedezët ndoshta janë populli më jofetar në Europë," ka vënë në dukje një prej tyre, "por nuk mund ta kuptoni këtë vend aspak, nëse nuk e rrokni që institucionet, praktikat shoqërore, familjet, politika dhe mënyra jonë e jetesës në themel janë të formësuara prej trashëgimisë sonë luterane." Krejt ndryshe nga europeanët, amerikanët në shumicë dërrmuese besojnë te Zoti, e përfytyrojnë veten se janë njerëz fetarë dhe shkojnë në kishë me shumicë. Deri në mesin e viteve 1980 nuk kishte ndonjë dëshmi për ringjalljen e fesë në Amerikë, por në dhjetëvjeçarin

pasues duket se pati një fuqizim të veprimtarisë fetare.⁶ Gërryerja e krishterimit mes Perëndimorëve ka gjasa të përkeqësohet vetëm si një kërcënim afatgjatë për shëndetin e qytetërimit Perëndimor.

Në Shtetet e Bashkuara ka një problem më të afërt dhe më të rrezikshëm. Historikisht identiteti kombëtar amerikan është përcaktuar kulturalisht prej trashëgimisë së qytetërimit Perëndimor dhe politikisht prej parimeve të Kredos Amerikane, me të cilën amerikanët pajtohen në shumicë dërrmuese: liri, demokraci, individualizëm, barazi përpara ligjit, kushtetutshmëri, pronë private. Nga fundi i shekulli XX që të dy përbërësit e identitetit amerikan kanë rënë nën sulmet e përqendruara e të pandërprera prej një numri të vogël, por me ndikim, intelektualësh e publicistësh. Në emër të shumëkulturalizmit, ata e kanë sulmuar njëjtësimin e Shteteve të Bashkuara me qytetërimin Perëndimor, e kanë mohuar ekzistencën e një kulture të përbashkët amerikane dhe kanë mbështetur identitetet e grupimet raciale, etnike e të tjera kulturore nënkombëtare. Sipas fjalëve të njërit prej raporteve të tyre, kanë denoncuar “anshmërinë sistematike ndaj kulturës europiane dhe rrjedhimeve prej saj” në arsim, si dhe “mbisundimin e vështrimit njëkulturore europian-amerikan.” Siç e ka thënë Arthur M. Schlesinger i Riu (Shlesinger), multikulturalistët janë “mjaft shpesh separatistë etnocentrikë, të cilët nuk shohin ndonjë gjë të madhe në trashëgiminë Perëndimore, përveç krimeve të Perëndimit.” “Qëndrimi i tyre është të zhvishen amerikanët nga trashëgimia mëkatore europiane dhe të kërkohen prurje shëlbuese nga kulturat joperëndimore.”⁷

Prirja shumëkulturore është shfaqur gjithashtu në një varg ligjesh, që kanë pasuar aktet për të drejtat civile pas viteve 1960, kurse në vitet 1990 administrata e Klintonit nxitjen e larmisë së kulturave e bëri një prej

qëllimeve kryesore të vetat. Kontrasti me të kaluarën është mbresëlënës. Etërit Themelues e shihnin larminë si realitet dhe si problem: prej këndeje ka dalë parulla kombëtare *e pluribus unum*, e zgjedhur prej një komisioni të Kongresit kontinental, që përbëhej nga Benjamin Franklini, Tomas Xhefersoni dhe Xhon Adamsi. Udhëheqësit e mëvonshëm politikë, të cilët po ashtu kishin frikë nga rreziqet e larmisë raciale, lokale, etnike, ekonomike e kulturore (e cila në të vërtetë shkaktoi luftën më të madhe të shekullit ndërmjet viteve 1815-1914), iu përgjigjën thirrjes “Na bashkoni” dhe e quajtën si detyrën e tyre qendrore mbështetjen e unitetit kombëtar. “E vetmja mënyrë e sigurtë për ta çuar këtë vend drejt rrënimit, për të prishur çdo mundësi që të vazhdojë të jetë një komb përgjithësisht,” ka paralajmëruar Teodor Rusvelti, “do të ishte të lejohej që të kthehej në një lëmsh kombësish duke u grindur.”⁸ Mirëpo në vitet 1990 udhëheqësit e Shteteve të Bashkuara jo vetëm e lejuan, por edhe mbështetën me zell larminë e jo unitetin e njerëzve që qeverisnin.

Siç e kemi parë, udhëheqësit e vendeve të tjera nganjëherë janë orvatur ta hedhin poshtë trashëgiminë e tyre kulturore e ta kapërcejnë identitetin e vendit të tyre prej një qytetërimi te një tjetër. Sot për sot nuk ia kanë dalë mbanë në asnjë rast dhe në vend të kësaj kanë krijuar vende të përçara skizofrenike. Po ashtu shumëkulturalistët amerikanë e hedhin poshtë trashëgiminë kulturore të vendit. Mirëpo, në vend që të orvaten t’i njëjtësojnë Shtetet e Bashkuara me një qytetërim tjetër, ata dëshirojnë që të krijojnë një vend me shumë qytetërimë, domethënë një vend që nuk i përket një qytetërimi dhe që nuk ka një bërthamë kulturore. Historia na tregon se asnjë vend i ndërtuar në këtë mënyrë nuk mund të zgjatë si shoqëri koherente. Shtetet e Bashkuara shumëqytetërimore nuk do të jenë

më Shtetet e Bashkuara; ato do të jenë Kombet e Bashkuara.

Shumëkulturalistët gjithashtu e kanë vënë në pikëpyetje një element qendror të Kredos Amerikane, duke i zëvendësuar të drejtat e individëve me të drejtat e grupeve, që në vija të përgjithshme përcaktohen sipas racës, etnisë, seksit dhe parapëlqimeve seksuale. Siç ka thënë Gunnar Myrdali në vitet 1940, duke i përforcuar komentet e vëzhguesve të huaj, që vijnë nga koha e Hector St. John de Crèvecoeur (Hektor Shën Gjon de Krevëkori) dhe Alexis de Tocqueville (Aleksis de Tokëvili), Kredoja ka qenë “çimentoja në strukturën e këtij kombi të madh e shumëllojsh.” “Ky ka qenë fati ynë si komb,” është pajtuar me të Richard Hofstadter, “të mos kemi shumë ideologji, por të jemi një.”⁹ Çfarë do të ndodhte me Shtetet e Bashkuara, nëse ajo ideologji do të hidhej poshtë nga një pjesë e madhe e qytetarëve të tyre? Fati i Bashkimit Sovjetik, i vendit tjetër të madh, uniteti i të cilit edhe më shumë sesa uniteti i Shteteve të Bashkuara, përcaktohej nga pikëpamja ideologjike, është një shembull kthjellues për amerikanët. “Dështimi i plotë i marksizmit...dhe shpërbërja dramatike e Bashkimit Sovjetik,” ka thënë filozofi japonez Takeshi Umehara, “janë vetëm paraardhëse të shembjes së liberalizmit Perëndimor, rrymës kryesore të modernitetit. Duke mos qenë aspak një alternativë kundrejt marksizmit dhe ideologji mbretëruese në fund të historisë, liberalizmi do të jetë guri i dominosë i radhës që do të rrëzohet.”¹⁰ Në një epokë kur gjithkund popujt e përcaktojnë veten nga pikëpamja kulturore, çfarë vendi mbetet për një shoqëri pa një bërthamë kulturore dhe të përcaktuar vetëm nga një kredo politike? Parimet politike janë një themel i paqëndrueshëm, mbi të cilin nuk mund të ndërtohet një bashkësi jetëgjatë. Në botën shumëqytetërimore, në të cilën ka peshë kultura, Shtetet

e Bashkuara thjesht mund të ishin e vetmja mbetje si anomali nga bota Perëndimore në shuarje, ku kishte peshë ideologjia.

Flakja e Kredos dhe e qytetërimit Perëndimor do të thotë fundi i Shteteve të Bashkuara ashtu siç i kemi njohur ne. Kjo do të thotë në të vërtetë edhe fundi i qytetërimit Perëndimor. Nëse Shtetet e Bashkuara do të shperëndimorizohen, Perëndimi do të rrëgjohet te Europa dhe pak vende me popullsi jo të madhe prej të ardhurish evropianë. Pa Shtetet e Bashkuara, Perëndimi shndërrohet në një pjesë të vockël e në rënie të popullsisë botërore në një gadishull të vogël e të pavazhdueshëm në një cep të masës kontinentale euraziatike.

Përplasja ndërmjet multikulturalistëve dhe mbrojtësve të qytetërimit Perëndimor e të Kredos Amerikane, sipas shprehjes së James Kurth-it (Xhejms Kurthit), është “përplasja *realë*” brenda segmentit amerikan të qytetërimit Perëndimor.¹¹ Amerikanët nuk mund t’i bishtojnë kësaj çështjeje: A jemi një popull Perëndimor, apo jemi diçka tjetër? E ardhmja e Shteteve të Bashkuara dhe e Perëndimit varen prej faktit, nëse amerikanët do ta ripohojnë përkushtimin ndaj qytetërimit Perëndimor. Nga pikëpamja e brendshme, kjo do të thotë të hidhen poshtë thirrjet përçarëse të sirenave të shumëkulturalizmit. Nga ana ndërkombëtare, kjo do të thotë të hidhen poshtë thirrjet e mjegullta e të trilluara për t’i njëjtësuar Shtetet e Bashkuara me Azinë. Çfarëdo lidhjesh ekonomike të kenë mes tyre, hendeku themelor kulturor ndërmjet shoqërive amerikane e aziatike e përjashton mundësinë e bashkimit të tyre në një shtëpi të përbashkët. Nga ana kulturore amerikanët janë pjesë e familjes Perëndimore; multikulturalistët mund ta dëmtojnë e madje ta shkatërrojnë këtë marrëdhënie, por ata nuk mund ta zëvendësojnë atë.

Kur amerikanët i kërkojnë rrënjët e tyre kulturore, i gjejnë në Europë.

Në mes të viteve 1990 u hap një diskutim i ri për natyrën dhe të ardhmen e Perëndimit, u përftua një njohje e përtërirë se ka ekzistuar një realitet i tillë dhe u shtua shqetësimi se çfarë do ta bënte të pasigurtë vazhdimin e ekzistencës së tij. Nga ana e vet, kjo mugulloi prej nevojës që u ndie për të zgjeruar institucionin parësor Perëndimor, NATO-n, me qëllim që të futeshin vendet Perëndimore nga lindja, si dhe prej përçarjeve të rënda që u shfaqën brenda Perëndimit lidhur me mënyrën sesi i duhej dhënë përgjigje shpërbërjes së Jugosllavisë. Gjithashtu kjo pasyqroi më gjerësisht ankthin lidhur me unitetin e ardhshëm të Perëndimit, tashmë që nuk ekzistonte kërcënimi sovjetik e në veçanti, çfarë do të thoshte kjo lidhur me përkushtimin e Shteteve të Bashkuara ndaj Europës. Me shtimin e ndërveprimit të vendeve Perëndimore me shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më të fuqishme, të parat bëhen gjithnjë e më shumë të vetëdijshe për bërthamën e tyre të përbashkët kulturore Perëndimore, që i lidh së bashku. Udhëheqësit e të dy brigjeve të Atlantikut e kanë theksuar nevojën që të përtërihet bashkësia atlantike. Nga fundi i vitit 1994 dhe fillimi i vitit 1995 ministrat e mbrojtjes të Gjermanisë e të Britanisë, ministrat e jashtëm të Francës e të Amerikës, Henri Kisingeri dhe figura të tjera kryesore – që të gjithë e kanë përqafuar këtë çështje. Qëndrimi i tyre është përmbledhur nga ministri britanik i mbrojtjes, Malcolm Rifkind, i cili në nëntor 1994 ka argumentuar nevojën për “një Bashkim Atlantik”, që do të mbështetej në katër shtylla: mbrojtja dhe siguria të mishëruara të NATO-ja; “besimi i përbashkët të shteti ligjor dhe demokracia parlamentare”; “kapitalizmi liberal e tregtia e lirë” dhe “trashëgimia e përbashkët kulturore europiane, që vjen

prej Greqisë e Romës përmes Rilindjes deri te vlerat, besimet e përbashkëta dhe qytetërimi i përbashkët i shekullit tonë.”¹² Më 1995 Komisioni European paraqiti një projekt për të “përtërirë” marrëdhëniet transatlantike, i cili çoi te nënshkrimi i një pakti të gjerë ndërmjet Bashkimit dhe Shteteve të Bashkuara. Njëkohësisht mjaft nga udhëheqësit politikë europianë dhe të biznesit mbështetën krijimin e një zone të tregtisë së lirë transatlantike. Ndonëse AFL-CIO iu kundërvu masave të NAFTA-s dhe masave të tjera për liberalizimin e tregtisë, kryetari i saj e mbështeti në mënyrë të fortë një marrëveshje të tillë të tregtisë së lirë, që nuk do t’i kërcënonte vendet e punës të Amerikës me konkurrencën nga vendet me paga të ulëta. Ajo gjeti përkrahje edhe nga konservatorët si në Europë (Margaret Thatcher), edhe në Amerikë (Newt Gingrich), si edhe nga udhëheqësit e tjerë të Kanadasë e të Britanisë.

Siç e kemi treguar në kreun 2, Perëndimi ka kaluar përmes një faze të parë europiane zhvillimi e zgjerimi, e cila zgjati disa shekuj, pastaj në një fazë të dytë amerikane në shekullin e njëzetë. Nëse Amerika e Veriut dhe Europa do ta përtërijnë jetën e tyre morale, do të mbështeten te përbashkësia e tyre kulturore dhe zhvillojnë forma të integritit të ngushtë ekonomik e politik si plotësim për bashkëpunimin e tyre për sigurinë në NATO, ato do t’i jepnin jetë një faze të tretë euroamerikane të lulëzimit ekonomik dhe të ndikimit politik të Perëndimit. Integrimi politik me qëllime të përcaktuara në një farë mënyre do ta përballonte rënien relative në përpjesën e Perëndimit kundrejt popullsisë, produktit ekonomik dhe aftësive ushtarake botërore, si dhe do të rigjallëronte fuqinë e Perëndimit në sytë e udhëheqësve të qytetërimeve të tjera. “Me peshën e tyre tregtare,” i ka paralajmëruar aziatikët kryeministri

Mahathir, "federata BE-NAFTA do t'i diktonte kushtet pjesës tjetër të botës."¹³ Megjithatë, a do të bashkohet Perëndimi politikisht dhe ekonomikisht, varet kryesisht nga fakti, nëse Shtetet e Bashkuara do ta ripohojnë identitetin e tyre si një komb Perëndimor dhe do ta përcaktojnë rolin e tyre si udhëheqës të qytetërimit Perëndimor.

Perëndimi në botë

Një botë, në të cilën identitetet kulturore: etnike, kombëtare, fetare, qytetërimore, janë me rol qendror dhe afërsitë e dallimet kulturore janë ato që u japin trajtë aleancave, antagonizmave e politikave të shteteve, një botë e tillë bart tre ndërlikime të gjera për Perëndimin përgjithësisht dhe për Shtetet e Bashkuara në veçanti.

E para, burrat e shtetit mund ta ndryshojnë realitetin në mënyrë konstruktive vetëm nëse e pranojnë dhe e kuptojnë atë. Politikat e kulturës që po përftohen, rritja e fuqisë së qytetërimeve joperëndimore dhe shtimi i ngulmimit kulturor të këtyre shoqërive janë pranuar gjerësisht në botën joperëndimore. Udhëheqësit europianë e kanë drejtuar vëmendjen te forcat kulturore, që i bashkojnë dhe që i përçajnë njerëzit. Përkundrazi, elitat amerikane me ngadalësi i kanë pranuar dhe kanë nisur të merren me këto realitete që po përftohen. Administrata e Bushit dhe e Klintonit kanë mbështetur unitetin shumëqytetërimor të Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë, Bosnjës e Ruisë, në një përpjekje të kotë për të ndalur forcat e fuqishme etnike e kulturore, që shtynin drejt shpërbërjes. Ata mbështetën planet e integritimit ekonomik shumëqytetërimor, që janë pa

kuptim, si në rastin e APEC-ut, ose kanë kosto të madhe ekonomike e politike të paparashikuar, si në rastin e NAFTA-s e të Meksikës. Ata u orvatën të vendosnin marrëdhënie të ngushta me shtetet bërthamë të qytetërimeve të tjera në formën e “partneritetit global” me Rusinë, ose të “anagzimit konstruktiv” me Kinën, përballë konflikteve të natyrshme të interesave ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe atyre vendeve. Njëkohësisht administrata e Klintonit nuk ia doli ta përfshinte me gjithë zemër Rusinë në orvatjet për të arritur paqen në Bosnjë, me gjithë interesin e madh që kishte Rusia në atë luftë, si shtet bërthamë i ortodoksisë. Administrata e Klintonit, duke ndjekur fantazmën e vendit shumëqytetërimor, ua mohoi vetëvendosjen e pakicave serbe e kroate dhe ndihmoi që në Ballkan të ngrihej më këmbë një partner islamist njëpartiak i Iranit. Në të njëjtën mënyrë qeveria e SHBA gjithashtu mbështeti nënshkrimin e myslimanëve nën sundimin ortodoks, duke iu përmbajtur mendimit se “Pa asnjë dyshim Çeçenia është pjesë e Federatës Ruse.”¹⁴

Ndonëse europianët përgjithësisht e pranojnë peshën themelore të vijës ndarëse ndërmjet krishterimit Perëndimor, nga njëra anë, dhe ortodoksisë e islamit, nga ana tjetër, siç e ka thënë sekretari i shtetit i Shteteve të Bashkuara, këto “nuk do të njohin asnjë ndarje themelore ndërmjet pjesëve katolike, ortodokse dhe islamike të Europës.” Ata që nuk i pranojnë ndarjet themelore, megjithatë, janë të paracaktuar për të pësuar ndrydhje prej tyre. Në fillim administrata e Klintonit nuk ishte e vetëdijshme për zhvendosjen e baraspeshës së fuqisë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe shoqërive të Azisë Lindore, prandaj herë pas here shpallte synime lidhur me tregtinë, të drejtat njerëzore, përhapjen e armëve bërthamore dhe çështje të tjera, që nuk ishte në gjendje t’i plotësonte. Përgjithësisht qeveria e SHBA pati

vështirësi të jashtëzakonshme për t'iu përshtatur një epoke, në të cilën politika globale merr trajtë prej lidhjeve kulturore e qytetërimore.

E dyta, mënyra e të menduarit në politikën e jashtme amerikane vunatë edhe prej ngurrimeve për ta braktisur, ndryshuar e ndonjë herë madje për ta rishikuar politikën e ndjekur për t'i përballuar nevojat e Luftës së ftohtë. Te disa kjo mori formën e qëndrimit, që ende e shihet Bashkimin Sovjetik të ringjallur si kërcënim të mundshëm. Por përgjithësisht njerëzit kishin prirje t'i shenjtëronin aleancat e kohës së Luftës së ftohtë dhe marrëveshjet për kontrollin e armatimeve. NATO-ja duhej mbajtur siç kishte qenë gjatë Luftës së ftohtë. Traktati Japono-amerikan i Sigurisë mbetet me vend qëndror për sigurinë në Azinë Lindore. Traktati ABM është i paprekshëm. Traktati CFE duhet të respektohet. Është e qartë se asnjë prej këtyre trashëgimive të Luftës së ftohtë ose dhe të tjera nuk duhen hedhur mënjandë me lehtësi. Megjithatë, po ashtu nuk është domosdoshmërisht në interes të Shteteve të Bashkuara ose të Perëndimit, që ato të vazhdojnë në formën e kohës së Luftës së ftohtë. Realiteti i botës shumëqytetërimore shtyn drejt mendimit se NATO-ja duhet të zgjerohet për të përfshirë të tjera shoqëri Perëndimore, që dëshirojnë të hyjnë në të, dhe duhet të pranohet se në thelb nuk ka kuptim që të bëhen anëtare dy shtete, prej të cilave njëri është armiku më i betuar dhe që të dyve u mungon afërsia kulturore me anëtarët e tjerë. Traktati ABM, i hartuar për të përballuar nevojat e lindura prej Luftës së ftohtë që të garantohej reciprokisht paprekshmëria e shoqërisë sovjetike e amerikane, domethënë për të shmangur një luftë bërthamore sovjeto-amerikane, fare mirë mund ta pengojë aftësinë e Shteteve të Bashkuara e të shoqërive të tjera për të mbrojtur veten kundër kërcënimeve

bërthamore të paparashikueshme, ose prej sulmeve nga ana e lëvizjeve terroriste dhe nga diktatorët e pamend. Traktati i sigurisë SHBA-Japoni ndihmoi që ta përmbante agresionin sovjetik kundër Japonisë. Po cilit qëllim do t'i shërbejë në epokën pas Luftës së ftohtë? Të përmbajë e të ndalojë Kinën? Të ngadalësojë përshtatjen e Japonisë me Kinën në ngritje? Të parandalojë militarizimin e mëtejshëm të Japonisë? Gjithnjë e më shumë po shtohen në Japoni dyshimet rreth pranisë ushtarake të amerikanëve, kurse në Shtetet e Bashkuara lidhur me nevojën për një përkushtim, që nuk është i dyanshëm, për të mbrojtur Japoninë. Marrëveshja për Forcat Konvencionale në Europë ishte hartuar për të zbutur ballafaqimin ndërmjet NATO-s e Traktatit të Varshavës në Europën Qendrore, por ky ballafaqim është zhdukur. Forca vepruese kryesore e kësaj marrëveshjeje sot është të krijojë vështirësi për Rusinë në trajtimin e atyre problemeve, që ndihen si kërcënime për sigurinë nga popujt myslimanë në jug të saj.

E treta, larmia kulturore e qytetërimore krijon vështirësi për besimin e Perëndimorëve e në veçanti të amerikanëve, që kanë te pësia universale të kulturës Perëndimore. Ky besim gjen shprehje edhe si përcaktim, edhe nga ana normative. Si përcaktim ai pohon, se popujt në të gjitha shoqëritë dëshirojnë të pranojnë vlerat, institucionet dhe mënyrat Perëndimore të veprimit. Nëse ata duken që nuk e kanë këtë dëshirë dhe janë të përkushtuar ndaj kulturave të veta tradicionale, atëherë janë viktima të “vetëdijes së rreme”, që mund të krahasohet me atë, të cilën marksistët e gjenin te proletarët, që mbështesnin kapitalizmin. Nga ana normative, besimi Perëndimor përcakton që njerëzit në mbarë botën duhet të përqafojnë vlerat, institucionet e kulturën Perëndimore, sepse këto mishërojnë të menduarit e njerëzimit më të lartë, më të ndriçuar, më

liberal, më të arsyeshëm, më modern dhe më të qytetëruar.

Në botën që po del me konflikte etnike dhe përplasje qytetërimore, besimi Perëndimor te universalizmi i kulturës Perëndimore vuan prej tre problemeve: është i rremë, është imoral dhe është i rrezikshëm. Që është i rremë, këtë e ka pasur si tezë qendrore ky libër, tezë që është përmbledhur mjaft mirë nga Majkëll Hauardi: “pohimi i zakonshëm Perëndimor se larmia kulturore është një kureshti historike, të cilën e ka gërryer me shpejtësi rritja e kulturës anglofone të përbashkët me orientim Perëndimor, që i formëson vlerat tona themelore...thjesht nuk është e vërtetë.”¹⁵ Lexuesi që deri këtu nuk është bindur për urtësinë e vërejtjes së Sër Majkllit, jeton në një botë shumë larg prej asaj që është paraqitur në këtë libër.

Besimi se popujt joperëndimorë duhet të pranojnë vlerat, institucionet dhe kulturën Perëndimore është i pamoralshëm, për shkak të gjërave që duhen për ta bërë këtë. Shtrirja pothuaj universale e fuqisë europiane nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe mbisundimi global i Shteteve të Bashkuara nga fundi i shekullit të njëzetë e përhapën pjesën më të madhe të qytetërimit Perëndimor në mbarë botën. Mirëpo nuk ka më globalizëm europian. Hegjemonia amerikane është në tërheqje, vetëm ngase nuk nevojitet më për të mbrojtur Shtetet e Bashkuara kundër një kërcënimi ushtarak sovjetik të tipit të kohës së Luftës së ftohtë. Siç e kemi argumentuar, kultura ndjek fuqinë. Nëse shoqëritë joperëndimore do të formësohen sërish prej kulturës Perëndimore, kjo do të ndodhë vetëm si rrjedhim i zgjerimit, vendosjes dhe veprimit të fuqisë Perëndimore. Imperializmi është pasoja logjike e domosdoshme e universalizmit. Përveç kësaj, si një qytetërim duke u pjekur, Perëndimi nuk e ka më atë dinamizmin

ekonomik ose demografik, që kërkohen për të imponuar vullnetin e tij mbi shoqëritë e tjera, dhe cilado orvatje për ta bërë këtë është gjithashtu në kundërshtim me vlerat Perëndimore të vetëvendosjes e të demokracisë. Ndërsa qytetërimet aziatike e myslimane do të nisin gjithnjë e më shumë të pohojnë peshën universale të kulturave të tyre, Perëndimorët do nisin gjithnjë e më shumë ta vlerësojnë lidhjen ndërmjet universalizmit e imperializmit.

Universalizmi Perëndimor është i rrezikshëm për botën, sepse mund të çonte në një luftë të madhe ndërqytetëimore ndërmjet shteteve bërthamë, e gjithashtu është i rrezikshëm për Perëndimin, sepse mund të çonte te disfata e Perëndimit. Me shembjen e Bashkimit Sovjetik, Perëndimorët e shohin qytetërimin e vet se ka arritur një mbizotërim të pashoq, porse njëkohësisht shoqëritë më të dobëta aziatike, myslimane e të tjera po nisin të marrin forcë. Rrjedhimisht, ato mund të shtyhen të zbatojnë logjikën e njohur e të fuqishme të Brutit:

Që legjionet tona janë krejt të plota,
Që çështja jonë është e arrirë.
Armiku ynë rritet dita-ditës;
Ne në majë nisemi e zbresim.
Në punët njerëzore ka një majë,
E kape, kur u ngrit, je i fituar;
E le, dhe udhëtim' i tërë jetës
Fundos në cekësi e në mjerime.
Mbi det të kolmë po plevasim sot,
A vemi sipas rrjedhës kur na ndih,
A mbytemi me gjith' anijen bashkë.

Mirëpo kjo logjikë solli te mundja e Brutit në Filipi, prandaj ecja e kujdesshme e Perëndimit nuk duhet të

orvatet ta ndalë zhvendosjen e baraspeshës së fuqisë, por të mësojë sesi të lundrojë përmes cekëtinave, të durojë mjerimet, të zbutë peripecitë dhe të mbrojë kulturën.

Të gjitha qytetërimet kalojnë përmes proceseve të ngjashme të lindjes, ngritjes dhe rënies. Perëndimi ndryshon prej qytetërimeve të tjera jo nga rruga në të cilën është zhvilluar, por nga karakteri i dallueshëm i vlerave dhe i institucioneve të tij. Ndër më të rëndësishmet prej tyre janë krishterimi, pluralizmi, individualizmi dhe shteti ligjor, që ia kanë bërë të mundur Perëndimit të shpikë modernitetin, të shtrihet në mbarë botën dhe ta kenë smirë shoqëritë e tjera. Në tërësinë e tyre këto karakteristika janë të veçanta për Perëndimin. Siç e ka thënë Artur M. Schlesingeri i Ri, Europa është “burimi – *i vetmi* burim” për “idetë e lirisë individuale, demokracisë politike, shtetit ligjor, të drejtave të njeriut dhe lirisë kulturore...Këto janë ide *europiane*, nuk janë as aziatike, as afrikane, as të Lindjes së Mesme, me përjashtim të rasti kur i kanë përvetësuar.”¹⁶ Ato e bëjnë qytetërimin Perëndimor unikal, ndërsa qytetërimi Perëndimor është i vlefshëm jo sepse është universal, por sepse është unikal. Rrjedhimisht, përgjegjësia kryesore e udhëheqësve Perëndimorë nuk është që të riformësojnë qytetërimet e tjera sipas shëmbëllimit të Perëndimit, i cili është përtej fuqisë së tyre në rënie, por të ruajnë, të mbrojnë dhe të përtërijnë cilësitë unike të qytetërimin Perëndimor. Për shkak se janë vendi më i fuqishëm Perëndimor, kjo përgjegjësi bie në radhë të parë mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ruajtja e qytetërimin Perëndimor përballë fuqisë në rënie të Perëndimit është në interes të Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve europiane:

- për të arritur integrimin më të madh politik, ekonomik e ushtarak dhe për të bashkërenduar politikat e tyre, në mënyrë që të mos u jepet rasti shteteve prej qytetërimeve të tjera të shfrytëzojnë dallimet ndërmjet tyre;

- për të përfshirë në Bashkimin Europian dhe në NATO shtetet Perëndimore të Europës Qendrore, domethënë vendet e Vishegradit, republikat baltike, Slloveninë dhe Kroacinë;

- për të nxitur “perëndimorizimin” e Amerikës Latine dhe, me aq sa të jetë e mundur, rreshtimin e ngushtë të vendeve të Amerikës Latine me Perëndimin;

- për të kufizuar zhvillimin e fuqisë ushtarake konvencionale dhe jokonvencionale të vendeve islamike e sinike;

- për të ngadalësuar largimin e Japonisë prej Perëndimit dhe kalimin drejt përshtatjes me Kinën;

- për ta pranuar Rusinë si shtetin bërthamë të ortodoksisë dhe si fuqinë më të madhe rajonale me interesa të ligjshëm në sigurimin e kufijve të vet jugorë;

- për ta mbajtur epërsinë teknologjike e ushtarake të Perëndimit mbi qytetërimet e tjera;

- dhe, ajo që është më e rëndësishmja, për ta pranuar se ndërhyrja Perëndimore në punët e qytetërimeve të tjera ndoshta është i vetmi burim më i rrezikshëm për paqëndrueshmërinë dhe konfliktin e mundshëm global në botën shumëqytetërimore.

Pas mbarimit të Luftës së ftohtë në Shtetet e Bashkuara pati një vërshim të diskutimeve masive lidhur me kursin e nevojshëm të politikës së jashtme amerikane. Mirëpo në epokën e tanishme, Shtetet e Bashkuara as nuk mund ta sundojnë botën dhe as nuk mund të shpëtojnë prej saj. E po ashtu as

internacionalizmi ose izolacionizmi, as shumanësia dhe as njëanësia nuk mund t'u shërbejnë më së miri interesave të tyre. Ato mund të shkojnë mbarë më mirë duke iu shmangur këtyre skajeve të kundërta dhe në vend të tyre të zbatojnë një politikë atlantike të bashkëpunimit të ngushtë me partnerët europianë për të mbrojtur dhe për të çuar përpara interesat e vlerat e qytetërimit unikal, të cilin e kanë të përbashkët.

Lufta qytetërimore dhe rendi

Ka shumë pak gjasa që të shpërthejë një luftë globale, në të cilën të përfshihen shtetet bërthamë të qytetërimeve më të mëdha të botës, por edhe nuk është e pamundur. Siç e kemi parashtruar, një luftë e tillë mund të shkaktohet prej shkallëzimit të luftërave në vijën e shkëputjes ndërmjet grupeve prej qytetërimeve të ndryshme dhe ka më shumë gjasa ndërmjet myslimanëve, nga njëra anë, dhe jomyslimanëve, nga ana tjetër. Shkallëzimi ka më shumë gjasa të ndodhë nëse shtetet që synojnë të bëhen bërthamë e shteteve myslimane do të hyjnë në garë për t'u dhënë ndihmë bashkëbesimtarëve të përfshirë në betejë. Ajo ka më pak mundësi të ngjasë prej interesave, që mund të kenë vendet farefis dytësoire e të treta për të mos u ngatërruar thellë vetë në luftë. Një burim më i rrezikshëm për një luftë globale ndërqytetërimore është zhvendosja e baraspeshës së fuqisë ndërmjet qytetërimeve dhe shteteve të tyre bërthamë. Nëse do të vazhdojë, ngritja e Kinës dhe shtimi i ngulmimit të këtij "lojtari më të madh në historinë e njeriut" do të ushtrojë trysni të tmerrshme mbi qëndrueshmërinë ndërkombëtare në fillim të

shekullit XXI. Dalja e Kinës si fuqia mbizotëruese në Azinë Lindore e Juglindore do të jetë në kundërshtim me interesat amerikanë, ashtu siç janë ndërtuar historikisht.¹⁷

Duke qenë ky interes në mes, si mund të zhvillohej një luftë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kinës? Ta zëmë se jemi në vitin 2010. Trupat amerikane janë larguar nga Koreja, e cila është ribashkuar, dhe Shtetet e Bashkuara e kanë pakësuar ndjeshëm praninë ushtarake në Japoni. Tajvani dhe Kina kontinentale kanë arritur një rregullim, sipas të cilit Tajvani vazhdon ta ruajë pjesën më të madhe të pavarësisë de facto, por e pranon hapur suzerenitetin e Pekinit dhe me mbështetjen e Kinës ka arritur të pranohet në Kombet e Bashkuara sipas modelit të Ukrainës e Bjellorusisë më 1946. Ka ecur me shpejtësi shfrytëzimi i burimeve të naftës në Detin e Kinës Jugore, kryesisht nën kontrollin e Kinës, por nën kontrollin e Vietnamit në disa zona, në të cilat kanë punuar kompanitë amerikane. Me mbështetjen te aftësitë e lidhura me fuqinë e saj në rritje, Kina e ka shtuar vetëbesimin dhe shpall se do ta shtrijë kontrollin e saj të plotë mbi gjithë detin, të cilin gjithmonë ka mëtuar ta ketë nën sovranitetin e vet. Vietnamezët e kundërshtojnë dhe ndodhin përleshje ndërmjet anijeve kuftarake kineze e vietnameze. Kinezët, që gjakojnë të marrin hakun për poshtërimin e vitit 1979, sulmojnë Vietnamin. Vietnamezët i bëjnë thirrje Amerikës për ndihmë. Kinezët i paralajmërojnë Shtetet e Bashkuara që qëndrojnë larg. Japonia dhe shtetet e tjera në Azi janë në mëdyshje. Shtetet e Bashkuara shprehen se nuk mund ta pranojnë pushtimin e Vietnamit nga Kina, bëjnë thirrje për sanksione ekonomike kundër Kinës dhe dërgojnë një nga forcat e pakta të koracatave që u kanë mbetur në Detin e Kinës Jugore. Kinezët e denoncojnë këtë si shkelje të ujërave territoriale kineze dhe ndërmarrin

goditje ajrore kundër forcës së dërguar me detyrë. Orvatjet nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së dhe të kryeministrit japonez për të arritur bisedime për ndërprerjen e zjarrit dështojnë dhe luftimet përhapen gjithandej në Azinë Lindore. Japonia e ndalon përdorimin e bazave të SHBA në Japoni për veprime kundër Kinës, Shtetet e Bashkuara nuk e marrin para sysh këtë ndalim dhe Japonia shpall asnjësinë e vendos karantinën për bazat. Nëndetëset dhe aeroplanët e Kinës me bazë në tokë veprojnë nga Tajvani dhe nga kontinenti, duke u sjellë dëme të rënda anijeve të SHBA dhe instalimeve të tyre në Azinë Lindore. Ndërkaq forcat tokësore kineze hyjnë në Hanoi dhe pushtojnë pjesë të mëdha të Vietnamit.

Meqë edhe Kina, edhe Shtetet e Bashkuara kanë raketa të afta për të hedhur armë bërthamore në territoret e njëra-tjetrës, vërehet një vetëpërmbajtje e nënkuptuar dhe këto armë nuk përdoren në fazat e para të luftës. Mirëpo frika nga sulme të tilla është e gjallë në të dyja shoqëritë dhe sidomos është e fortë në Shtetet e Bashkuara. Kjo i shtyn shumë prej amerikanëve të nisnin të bëjnë pyetjen, se për ç'arsye po ballafaqohen me një rrezik të tillë? E çfarë ndryshimi ka, nëse Kina shtie nën sundim Detin e Kinës Jugore, Vietnamin apo madje gjithë Azinë Juglindore? Kundërshtimi i luftës bëhet shumë i fortë sidomos në shtetet ku mbizotërojnë hispanikët në pjesën jugperëndimore të Shteteve të Bashkuara, banorët dhe qeveritë e të cilave shprehen "kjo nuk është lufta jonë" dhe orvaten të ndjekin modelin e Anglisë së Re gjatë Luftës së vitit 1812. Pasi kinezët i përforcojnë fitoret fillestare në Azinë Lindore, opinioni amerikan nis të lëvizë në atë drejtim, që e shpresonte Japonia se do të ndodhte më 1942: kostoja për ta thyer këtë ngulmim të kohëve të fundit për fuqi hegjemonike është shumë e madhe; le të ulemi për të

zhvilluar bisedime që të marrin fund luftimet sporadike ose “lufta e shtirur”, që po bëhet në Paqësorin Perëndimor.

Mirëpo ndërkaq lufta ka nisur të ushtrojë ndikim mbi shtetet kryesore të qytetërimeve të tjera. India e rrok rastin, që i jepet nga Kina e lidhur për këmbësh poshtë në Azinë Lindore, dhe ndërmerri një sulm rrënimtar mbi Pakistanin, me qëllim që t’ia shkatërrojë tërësisht aftësitë ushtarake konvencionale e bërthamore. Në fillim ka sukses, por aleanca ushtarake ndërmjet Pakistanit e Iranit dhe Kinës vihet në veprim e Irani i vjen në ndihmë Pakistanit me forca ushtarake moderne e me mjete të sofistikuar. India gjunjëzohet në luftimet me trupat iraniane dhe me gueriljet e Pakistanit prej disa grupeve të ndryshme etnike. Si Pakistani, edhe India u bëjnë thirrje shteteve arabe për ndihmë: India duke i paralajmëruar për rrezikun e mbisundimit të Iranit në Azinë Jugperëndimore, porse sukseset fillestare të Kinës kundër Shteteve të Bashkuara kanë nxitur lëvizjet antiperëndimore më të mëdha në shoqëritë myslimane. Një pas një ato pak qeveri properëndimore që kanë mbetur në vendet arabe dhe Turqia mposhten prej lëvizjeve myslimane, që kanë marrë fuqi prej kohortave të fundit të sipërisë së rinisë myslimane. Shtimi i antiperëndimorizmit, të nxitur prej dobësisë së Perëndimit, sjell sulme masive arabe mbi Izraelin, të cilat nuk është në gjendje t’i ndalojë Flota e Shtatë e SHBA e zvogëluar mjaft.

Kina dhe Shtetet e Bashkuara orvaten të sigurojnë mbështetjen e shteteve të tjera kyç. Kina korr fitore ushtarake dhe Japonia e nervozuar lidhet pas qerres së Kinës, duke e ndryshuar qëndrimin nga asnjënjësia formale te asnjënjësia pozitive prokineze, dhe pastaj u nënshtrohet kërkesave të Kinës e shndërrohet në pjesëmarrës lufte. Forcat japoneze pushtojnë bazat

amerikane të mbetura në Japoni dhe Shtetet e Bashkuara i largojnë me ngut trupat e veta. Shtetet e Bashkuara shpallin bllokadën kundër Japonisë dhe anijet japoneze e amerikane bien në dyluftime të rastësishme në Paqësorin Perëndimor. Në fillim të luftës Kina propozon një pakt sigurie reciproke me Rusinë (i cili nga larg të kujton paktin Hitler-Stalin). Mirëpo sukseset e Kinës kanë mbi Rusinë veprim pikërisht të kundërt me atë që patën mbi Japoninë. Mundësia e fitores së Kinës dhe mbisundimi total i Kinës në Azinë Lindore e tmerron Moskën. Ndërsa Rusia nis të lëvizë në drejtimin antikinez dhe fillon t'i fuqizojë trupat në Siberi, një numër i madh kinezësh të vendosur në Siberi ndërhyjnë në këto lëvizje. Atëherë Kina ndërhyt ushtarakisht për të mbrojtur bashkatdhetarët dhe pushton Vladivostokun, luginën e lumit Amur dhe pjesë të tjera kyç të Siberisë lindore. Ndërsa luftimet përhapen ndërmjet trupave ruse dhe kineze në Siberinë qendrore, ndodh një kryengritje në Mongoli, të cilën Kina më parë e kishte vënë nën "protektorat".

Për të gjithë ndërluftuesit me rëndësi qendrore është zotërimi dhe mundësia për të kapur burimet e naftës. Me gjithë investimet e mëdha për energjinë bërthamore, Japonia ende varet shumë nga importimi i naftës dhe kjo e fuqizon animin për t'iu përshtatur Kinës dhe për të siguruar ardhjen e naftës prej Gjirit Persik, Indonezisë e Detit të Kinës Jugore. Gjatë zhvillimit të luftës, ndërsa vendet arabe bien nën sundimin e militantëve islamikë, furnizimet me naftë nga Gjiri Persik për Perëndimin pakësohen sa mbeten me pika dhe, rrjedhimisht, Perëndimi gjithnjë e më shumë bie në varësinë e burimeve ruse, kaukaziane e të Azisë Qendrore. Kjo e detyron Perëndimin të forcojë përpjekjet për ta renditur Rusinë nga krahu i vet dhe për ta ndihmuar Rusinë, që ta

shtrijë sundimin mbi vendet myslimane të pasura me naftë në jug të saj.

Ndërkaq Shtetet e Bashkuara janë duke u orvatur me zjarr për të mobilizuar mbështetjen e plotë të aleatëve europianë. Këta, ndërsa e zgjerojnë mbështetjen diplomatike dhe ekonomike, ngurrojnë të përfshihen ushtarakisht në luftë. Mirëpo Kina dhe Irani kanë frikë se mos vendet Perëndimore më në fund do të rreshtohen prapa Shteteve të Bashkuara, madje edhe pavarësisht se Shtetet e Bashkuara në të vërtetë u kishin ardhur në ndihmë Britanisë e Francës në dy luftërat botërore. Për t'i dalë përpara kësaj, Kina e Irani vendosin fshehurazi në Bosnjë e në Algjeri raketa me rreze të mesme, të afta për të bartur mbushje bërthamore, dhe i paralajmërojnë fuqitë europiane, se duhet të qëndrojnë jashtë lufte. Por ashtu siç ka ndodhur gjithmonë me orvatjet e Kinës për të trembur vendet e tjera, me përjashtim të Japonisë, ky veprim ka pasoja krejt të kundërta me ato që synonte Kina. Shërbimet e zbulimit të SHBA e kapin dhe e njoftojnë vendosjen e raketave, kurse Këshilli i NATO-s deklaron, se raketat duhet të largohen menjëherë. Mirëpo përpara sesa NATO-ja të veprojë, Serbia, nga dëshira për ta rikujtuar rolin e vet historik si mbrojtëse e krishterimit kundër turqve, e pushton Bosnjën, i kap raketat dhe vijon orvatjet për ta përfunduar spastrimin etnik, që kishte qenë e detyruar ta ndërpriste në vitet 1990. Shqipëria dhe Turqia përpiqen t'u japin ndihmë bosnjakëve; Greqia dhe Bullgaria nisin pushtimin e Turqisë Europiane dhe në Stamboll shpërthen paniku, ndërsa turqit ua mbathin nëpër Bosfor. Ndërkaq një raketë me mbushje bërthamore, e lëshuar nga Algjeria, shpërthen jashtë Marsejës, kurse NATO-ja kundërpërgjigjet duke bërë goditje ajrore shkatërrimtare kundër objektivave në Afrikën e Veriut.

Shtetet e Bashkuara, Europa, Rusia e India kështu përfshihen në një luftë të vërtetë globale kundër Kinës, Japonisë dhe pjesës më të madhe të islamit. Si do të përfundonte një luftë e tillë? Të dyja palët kanë aftësi të mëdha bërthamore dhe është e qartë se po të viheshin në veprim pak mbi nivelin minimal, vendet kryesore nga të dy krahët do të shkatërroheshin në përmasa të mëdha. Nëse aftësia frenuese e dyanshme do të kishte efekt, rraskapitja e dyanshme mund të çonte te një armëpushim nëpërmjet bisedimeve, por që megjithatë nuk do ta zgjidhte problemin themelor të hegjemonisë kineze në Azinë Lindore. Përndryshe, Perëndimi mund të bënte një përpjekje për ta shkatërruar Kinën duke përdorur fuqinë ushtarake konvencionale. Mirëpo rreshtimi i Japonisë me Kinën i siguron Kinës një kordon sanitar mbrojtës ishullor, që i pengon Shtetet e Bashkuara të përdorin fuqinë detare kundër qendrave të popullsisë dhe industrisë kineze përgjatë brigjeve të saj. Zgjidhja tjetër do të ishte t'i afrohej Kinës nga perëndimi. Luftimet ndërmjet Rosisë e Kinës e shtyjnë NATO-n ta mirëpresë Rusinë si anëtare dhe të bashkëpunojë me Rusinë për të përballuar sulmet kineze në Siberi, të mbahet kontrolli i Rosisë mbi vendet myslimane me rezerva gazi e naftë në Azinë Qendrore, të nxiten kundër sundimit kinez kryengritje nga tibetianët, ujugurët e mongolët, dhe pak nga pak të mobilizohen e të dislokohen forcat ruse e Perëndimore drejt lindjes nëpër Siberi për sulmin përfundimtar përmes Murit të Madh deri në Pekin, Mançuri e në zemër të Hanëve.

Pavarësisht se cili do të ishte përfundimi i kësaj lufte qytetërimore globale: shkatërrimi i dyanshëm bërthamor, një ndërprerje me bisedime si rrjedhim i rraskapitjes së dynashme, ose më në fund marshimi i forcave ruse dhe Perëndimore në Sheshin Tienanmen, si rezultat afatgjatë

pothuaj në mënyrë të pashmangshme do të dilte rënia e rëndë e fuqisë ekonomike, demografike dhe ushtarake e të gjithë pjesëmarrësve kryesorë të luftës. Si pasojë, fuqia globale, që ishte zhvendosur gjatë shekujve nga Lindja në Perëndim e pastaj kishte nisur të zhvendosej mbrapsht nga Perëndimi drejt Lindjes, tashmë do të zhvendosej nga Veriu në Jug. Ata që do të përfitonin më shumë prej një lufte qytetërimesh do të ishin qytetërimet, të cilat nuk do të kishin marrë pjesë. Me shkatërrimin në përmasa të ndryshme të Perëndimit, Rosisë, Kinës e Japonisë, rruga do të hapej për Indinë, nëse ajo do t'i kishte shpëtuar këtij shkatërrimi, ndonëse kishte qenë pjesëmarrëse, për të bërë një orvatje që ta ndryshonte botën sipas mënyrës si hinduve. Segmente të gjera të publikut amerikan do t'i fajësonin Shtetet e Bashkuara për dobësimin e rëndë për shkak të orientimit të ngushtë Perëndimor të elitave të WASP, kurse udhëheqësit hispanikë do të vinin në pushtet me mbështetjen nga premtimet për një plan të tipit Marshall të gjerë, nga ana e vendeve të Amerikës Latine që do të lulëzonin, pasi kishin qëndruar jashtë luftës. Nga ana tjetër, Afrika pak gjë do të kishte për të dhënë që të rindërtohej Europa e në vend të kësaj do të prodhonte hordhi të papërmbajtshme njerëzish shoqërisht të mobilizuar për të rënë mbi prenë nga mbeturinat. Në Azi nëse Kina, Japonia dhe Koreja shkretohen prej luftës, fuqia po ashtu do të zhvendosej drejt jugut, kurse Indonezia, që kishte mbetur asnjënjëse, do të bëhej shteti mbisundues dhe, duke u udhëhequr nga këshilltarët australianë, do të vepronte për t'i dhënë drejtimin ecurisë së ngjarjeve nga Zelanda e Re deri në lindje të Mianmarit e të Sri Lankës në perëndim, si dhe të Vietnamit në veri. Të gjitha këto shtojnë drejt konfliktit të ardhshëm me Indinë dhe me Kinën, e cila do ta marrë

veten. Çfarëdo që të ndodhë, qendra e politikës botërore do të lëvizë drejt jugut.

Nëse ky skenar lexuesit i duket një fantazi e shthurur e pamundshme, aq më mirë. Le të shpresojmë se asnjë tjetër skenar i luftës qytetërimore globale nuk do të ketë më shuma gjasa. Por ajo që ka më shumë gjasa dhe, rrjedhimisht është më shqetësuese lidhur me këtë skenar, sidoqoftë është shkaku i luftës: ndërhyrja e një shteti bërthamë të një qytetërimi (Shtetet e Bashkuara) në një grindje ndërmjet shtetit bërthamë të një qytetërimt tjetër (Kina) dhe një shteti anëtar të atij qytetërimi (Vietnami). Për Shtetet e Bashkuara një ndërhyrje e tillë do të ishte e domosdoshme për të mbrojtur të drejtën ndërkombëtare, për të zbrapsur agresionin, për të mbrojtur lirinë e lundrimit në dete, për të mbajtur të hapur rrugën deri te nafta e Detit të Kinës Jugore dhe për të parandaluar mbisundimin në Azi prej një fuqie të vetme. Për Kinën kjo ndërhyrje do të kishte qenë një orvatje tërësisht e papranueshme, por tipike arrogante prej një shteti kryesor Perëndimor për të poshtëruar dhe për t'i kërcëlyer dhëmbët Kinës, për të ngjallur kundërshtime ndaj Kinës brenda sferës së saj të ligjshme të ndikimit dhe për t'i mohuar Kinës rolin që i përket në punët e botës.

Shkurt, në epokën që po troket, shmangia e luftërave të mëdha ndërqytetërimore u kërkon shteteve bërthamë që të përmbahen nga ndërhyrja në konfliktet e qytetërimëve të tjera. Kjo është një e vërtetë, të cilën disa shtete, e në veçanti Shtetet e Bashkuara pa dyshim, do ta shohin si të vështirë për ta pranuar. Ky *regull i abstenimit*, sipas të cilit shtetet bërthamë abstenojnë të ndërhyjnë në konfliktet e qytetërimëve të tjera, është kërkesa e parë për paqen në një botë shumëqytetërimore e shumëpolëshe. Kërkesa e dytë është *regulli i ndërmjetësimit të përbashkët*, që shtetet bërthamë të bëjnë

bisedime me njëri-tjetrin për të përmbajtur ose për t'i ndërprerë luftërat në vijën e shkëputjes ndërmjet shteteve ose grupeve prej qytetërimeve të tyre.

Pranimi i këtyre rregullave dhe i një bote me barazi më të madhe ndërmjet qytetërimeve nuk do të jetë i lehtë për Perëndimin ose për ato qytetërime, të cilat synojnë të zëvendësojnë ose të bashkëplotësojnë Perëndimin në rolin e tij mbisundues. Në një botë të tillë shtetet bërthamë, për shembull, fare mirë mund ta quajnë se është prerogativë e tyre që të zotërojnë armë bërthamore dhe t'ua mohojnë të tilla armë anëtarëve të tjerë të qytetërimit të tyre. Duke u hedhur një vështrim prapa përpjekjeve të veta që të ndërtonte një "aftësi të plotë bërthamore" për Pakistanin, Zylfikar Ali Bhutoja i ka përligjur ato përpjekje: "Ne e dimë se Izraeli dhe Afrika e Jugut kanë aftësi të plota bërthamore. Qytetërimet e krishtera, çifute e hindu e kanë këtë aftësi. Vetëm qytetërimi islamik nuk e kishte, por kjo gjendje duhej të ndryshonte."¹⁸ Gara për udhëheqjen brenda qytetërimeve, të cilave u mungon shteti i vetëm bërthamë, mundet gjithashtu të nxisë garën për armë bërthamore. Edhe pse ka marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi me Pakistanin, është e qartë se Irani ka nevojë për armët bërthamore po aq sa edhe Pakistani. Nga ana tjetër, Brazili dhe Argjentina hoqën dorë nga programet të drejtuara nga ky qëllim dhe Afrika e Jugut i shkatërroi armët bërthamore, ndonëse fare mirë përsëri mund të ketë dëshirë t'i ndërtojë, nëse Nigeri do të nisë ta krijojë këtë aftësi. Ndërkohë që përhapja e armëve bërthamore duket qartë se sjell rreziqe, siç e kanë vënë në dukje Scott Sagan dhe të tjerë, një botë në të cilën dy ose tre shtete bërthamë në secilin qytetërim kryesor kanë armë bërthamore, kurse të tjerat nuk kanë, mund të ishte një botë e qëndrueshme në shkallë të arsyeshme.

Pjesa më e madhe e institucioneve ndërkombëtare kryesore janë themeluar pak kohë pas Luftës II Botërore dhe e kanë marrë trajtën sipas interesave, vlerave e praktikave Perëndimore. Me rënien e fuqisë së Perëndimit kundrejt asaj të qytetërimeve të tjera, do të përftohen trysni për t'i riorganizuar këto institucione që t'u përshtaten interesave të atyre qytetërimeve. Çështja më e qartë, më e rëndësishme dhe ndoshta më kontradiktore lidhet me anëtarësimin e përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Anëtarë kanë qenë fuqitë e mëdha fitimtare të Luftës II Botërore dhe tashmë, me realitetin e fuqisë në botë, ka një mospërputhje që po zmadhohet. Në perspektivë më të gjatë ose do të bëhen ndryshime në anëtarësinë e tij, ose ka gjasa të përpunohen procedura më pak formale për të trajtuar çështjet e sigurisë, madje po ashtu mbledhjet e grupit G-7 janë marrë me çështjet ekonomike globale. Në një botë shumëqytetërore secili qytetërim i madh duhet të ketë të paktën një vend të përhershëm në Këshillin e Sigurimit. Në kohën e sotme e kanë vetëm tre. Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar të jenë anëtare Gjermania dhe Japonia, por është e qartë se ato do të bëhen anëtare të përhershme vetëm nëse po kjo do të ndodhë me shtete të tjera. Brazili ka propozuar pesë anëtarë të tjerë të përhershëm, ndonëse pa të drejtën e vetos: Gjermaninë, Japoninë, Indinë, Nigerinë dhe veten. Mirëpo kjo do t'i linte 1 miliardë myslimanët e botës të papërfaqësuar, veç nëse Nigeria mund ta merrte atë përgjegjësi. Nga pikëpamja qytetërore, është e qartë se Japonia dhe India duhet të jenë anëtare të përhershme, kurse Afrika, Amerika Latine dhe bota myslimane duhet të kenë vende të përhershme, që mund të mbaheshin sipas parimit të qarkullimit prej shteteve kryesore të atyre qytetërimeve, ndërsa përzgjedhjen mund ta bënin Organizata e Konferencës Islamike,

Organizata për Unitetin Afrikan dhe Organizata e Shteteve Amerikane (duke abstenuar Shtetet e Bashkuara). Gjithashtu do të ishte e përshtatshme që të bashkoheshin vendet e anëtarësisë të Britanisë e të Francës në një vend të vetëm të Bashkimit Europian, kurse mbajtësi i vendit me sistem qarkullimi do të përzgjidhej nga Bashkimi. Në këtë mënyrë shtatë qytetërime do të kishin nga një vend të përhershëm dhe Perëndimi do të kishte dy, një përbërje që do të përfaqësonte në vija të përgjithshme shpërndarjen e njerëzve, pasurisë dhe të fuqisë në botë.

Përbashkësitë e qytetërimeve

Disa amerikanë e kanë mbështetur multikulturalizmin brenda vendit; disa e kanë mbështetur universalizmin jashtë vendit dhe disa i kanë bërë që të dyja. Multikulturalizmi brenda vendit i kërcënon Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimin; universalizmi jashtë vendit kërcënon Perëndimin dhe botën. Që të dy e mohojnë karakterin unikal të kulturës Perëndimore. Monokulturalistët globalë duan ta bëjnë gjithë botën si Amerika. Multikulturalistët brenda vendit duan ta bëjnë Amerikën si gjithë bota. Një Amerikë shumëkulturore është e pamundur, sepse një Amerikë joperëndimore nuk është amerikane. Një botë shumëkulturore është e pashmangshme, sepse perandoria globale është e pamundur. Mbajtja e Shteteve të Bashkuara dhe e Perëndimit kërkon përtëritjen e identitetit Perëndimor. Siguria e botës kërkon pranimin e karakterit shumëkulturore.

Dallimi ndërmjet zbrazëtisë së universalizmit Perëndimor dhe realitetit të larmisë kulturore globale a sjell në mënyrë të pashmangshme dhe të pakthyeshme te relativizmi moral e kulturor? Përsëri përgjigjja për këto pyetje është edhe po, edhe jo. Kultura është relative; moraliteti është absolut. Siç e ka treguar Michael Walzeri, kulturat janë “të trasha”; ato paracaktojnë institucionet dhe modelet e sjelljes që i udhëheqin njerëzit në rrugët e drejta në një shoqëri të veçantë. Mirëpo përsipër, përtej dhe duke dalë prej këtij moraliteti maksimalist, ka një moral minimalist “të hollë”, i cili mishëron “tiparet e përsëritura të moraliteteve të veçanta të trasha ose maksimale.” Nocionet minimale morale të së vërtetës e të drejtësisë gjenden në të gjitha moralitetet e trasha dhe nuk mund të shkëputen prej tyre. Ka gjithashtu “urdhërime negative, e ndoshta më shumë rregulla kundër vrasjes, mashtrimit, torturës, shtypjes e tiranisë” morale minimale. Ajo që e kanë njerëzit të përbashkët është “më shumë një ndjenjë e armikut të përbashkët [ose së keqes së përbashkët], sesa përkushtimi ndaj një kulture të përbashkët.” Shoqëria njerëzore është “universale, sepse është njerëzore, e në veçanti sepse është një shoqëri.” Nganjëherë ne ecim së bashku me të tjerët; në shumicën e rasteve ne ecim vetëm.¹⁹ E megjithatë një moral minimal “i hollë” rrjedh prej kushteve të përbashkëta njerëzore dhe në të gjitha kulturat ndeshen “dispozita universale”.²⁰ Në vend që të përkrahen tiparet e hamendësuara si universale të një qytetërimi, kërkesat për bashkëzistencën kulturore e bëjnë të nevojshme që të shihet se çfarë është e përbashkët për shumicën e qytetërimeve. Në një botë shumëqytetërimore, ecuria konstruktive kërkon që të hiqet dorë nga universalizmi, të pranohet larmia dhe të kërkohen anët e përbashkëta.

Një përpjekje me peshë për të përcaktuar këto përbashkësi në një vend fare të vogël është bërë në Singapor në fillim të viteve 1990. Banorët e Singaporit në vija të përgjithshme janë 76 për qind kinezë, 15 për qind malajas e myslimanë dhe 6 për qind indianë hindu e sikhë. Në të kaluarën qeveria është përpjekur të përhapë e të mbështesë “vlerat konfuciane” mes shtetasve të saj, por edhe ka këmbëngulur që secili të arsimohej e të fliste rrjedhshëm anglishten. Në janar 1989 presidenti Wee Kim Wee, në fjalën e mbajtur për hapjen e parlamentit vuri në dukje ekspozimin e madh të 2,7 milionë singaporasve përballë ndikimeve kulturore të jashtme nga Perëndimi, të cilat i kishin “vënë në kontakt të ngushtë me idetë dhe teknologjitë e reja nga jashtë”, por gjithashtu i kishin “lënë zbuluar” kundrejt “vlerave dhe mënyrave të jetesës të huaja.” Ai paralajmëroi se “Idetë tradicionale aziatike të moralit, detyrës e shoqërisë, që na kanë mbajtur në të kaluarën, po ia lëshojnë vendin një botëvështrimi më të perëndimorizuar, individualist dhe të përqendruar te vetvetja.” Ai argumentoi se është e domosdoshme që të përcaktohen vlerat bërthamë, të cilat i kanë të përbashkëta bashkësitë e ndryshme etnike dhe fetare të Singaporit, dhe të cilat “rrokin thelbin e të qenit singaporas.”

Presidenti Wee si vlera të tilla përmendi: “të vihet shoqëria mbi veten, të mbështetet familja si guri themeltar i shoqërisë, të zgjidhen çështjet kryesore nëpërmjet konsensusit e jo kundërvënies dhe të theksohen toleranca raciale e fetare dhe harmonia.” Fjala e tij ngjalli diskutime të mëdha për vlerat singaporase dhe dy vjet më vonë doli një Letër e Bardhë, që përcaktonte pozitën e qeverisë. Letra e Bardhë i përmendte të katër vlerat e parashtruara prej presidentit, por shtonte edhe një të pestë për mbështetjen e individit, kryesisht për arsyen se nevojitej të theksohej

përparësia e meritave individuale në shoqërinë singaporase kundrejt vlerave konfuciane të hierarkisë e të familjes, të cilat mund të çonin në nepotizëm. Letra e Bardhë i përcaktonte kështu “Vlerat e Përbashkëta” të singaporasve:

Kombi përpara bashkësisë [etnike] dhe shoqëria mbi veten;

Familja si njësi bazë e shoqërisë;

Kujdesi dhe mbështetja e bashkësisë për individin;

Konsensusi në vend të kundërvënies;

Harmonia raciale e fetare.

Ndërkohë që citoheshin përkushtimi i Singaporit ndaj demokracisë parlamentare dhe suksesit në qeverisje, deklarata e Vlerave të Përbashkëta haptas i përjashtonte vlerat politike prej pikësynimeve të saj. Qeveria nënvizonte se Singapori ishte “një shoqëri aziatike nga pikëpamja thelbësore” dhe duhej të mbetej i tillë. “Singaporasit nuk janë amerikanë ose anglosaksonë, ndonëse ata mund të flasin anglisht e të mbajnë veshje Perëndimore. Nëse për një afat të gjatë singaporasit do të bëheshin të padallueshëm prej amerikanëve, britanikëve ose australianëve, ose dhe më keq, do të bëheshin një imitim i keq i tyre [d.m.th. një vend i përçarë], ne do ta humbisnim epërsinë që kemi mbi këto shoqëri Perëndimore, e cila na mundëson të mbahemi vetë në shkallë ndërkombëtare.”²¹

Projekti i Singaporit ishte një përpjekje ambicioze dhe e ndriçuar për të përcaktuar identitetin kulturor singaporas, të cilin e kishin të përbashkët bashkësitë etnike e fetare të tij dhe që i dallonte prej Perëndimit. Natyrisht, një deklaratë me vlerat Perëndimore e sidomos amerikane do t’u jepte shumë më tepër peshë të drejtave të individit kundrejt atyre të bashkësisë, lirisë së

shprehjes dhe së vërtetës që del prej konkurrencës së ideve, pjesëmarrjes dhe garës politike, si dhe sundimit të ligjit përballë sundimit të qeveritarëve specialistë, të mençur e të përgjegjshëm. Por edhe kështu, nëse ato do të mund t'i plotësonin vlerat singaporase e t'u jepnin përparësi më të ulët, do të kishte pak Perëndimorë që do t'i hidhnin poshtë ato vlera si të padobishme. Të paktën në nivelin themelor "të hollë" të moraliteti, ka disa gjëra të përbashkëta ndërmjet Azisë dhe Perëndimit. Për më tepër, siç e kanë vënë në dukje mjaft veta, pavarësisht nga shkalla në të cilën e ndajnë njerëzimin, fetë më të mëdha të botës: krishterimi perëndimor, ortodoksia, hinduizmi, budizmi, islami, konfucianizmi, taoizmi, judaizmi, gjithashtu kanë edhe vlera kyç të përbashkëta. Nëse ndonjëherë njerëzit do të arrijnë të zhvillojnë një qytetërim universal, ai do të përftohet pak nga pak nëpërmjet hulumtimit dhe zgjerimit të këtyre përbashkësive. Kështu, përveç rregullit të abstenimit dhe rregullit të ndërmjetësimit të përbashkët, një rregull i tretë për paqen në një botë shumëqytetërimore është *rregulli i përbashkësive*: popujt në të gjitha qytetërimet duhet të kërkojnë dhe të përpiqen të zgjerojnë vlerat, institucionet e praktikat, që i kanë të përbashkëta me popujt e qytetërimeve të tjera.

Kjo përpjekje do të jepte ndihmesë jo vetëm për ta kufizuar përplasjen e qytetërimeve, po gjithashtu edhe për të përforcuar Qytetërimin në numrin njëjës (më poshtë do ta japim me shkronjë të madhe për qartësi). Qytetërimi në numrin njëjës mendohet se përbën një përzierje të ndërlikuar të niveleve të larta të moralit, fesë, dijes, artit, filozofisë, teknologjisë, mirëqenies materiale e, ndoshta, edhe të gjërave të tjera. Është e qartë se këto nuk ndryshojnë doemos së bashku. E megjithatë studiuesit me lehtësi i përcaktojnë pikat më të larta e më të ulëta në nivelin e Qytetërimit në historitë e

qytetërimeve. Atëhere pyetja shtrohet kështu: Si mund t'i paraqesim ngritjet dhe rëniet e zhvillimit njerëzor të Qytetërimit? A ka ndonjë prirje të përgjithsme, shekulare, që i kapërcen qytetërimet e veçanta, drejt niveleve më të larta të Qytetërimit? Nëse ka ndonjë prirje të tillë, a është ajo produkt i proceseve të modernizimit, të cilat e rrisin sundimin e njerëzve mbi mjedisin e tyre e, rrjedhimisht, përftojnë nivele gjithnjë e më të larta të përparimit teknologjik e të mirëqenies materiale? Në epokën bashkëkohëse, a është kështu një nivel më i lartë i modernitetit parakushti për një nivel më të lartë të Qytetërimit? Apo niveli i Qytetërimit në radhë të parë ndryshon brenda historisë së qytetërimeve të veçanta?

Kjo përbën një shfaqje tjetër të diskutimit lidhur me natyrën vijëzore ose ciklike të historisë. Mund të përfytyrohet që modernizimi dhe zhvillimi moral njerëzor, të përftuar prej rritjes së arsimit, ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit e shoqërisë njerëzore e të mjedisit të tij natyror, sjellin një ecje të pandërprerë drejt niveleve gjithnjë e më të larta të Qytetërimit. Anasjelltas, nivelet e Qytetërimit thjesht mund të pasqyrojnë fazat në evoluimin e qytetërimeve. Kur dalin për herë të parë qytetërimet, njerëzit e tyre zakonisht janë të fuqishëm, dinamikë, të ashpër, të lëvizshëm dhe me frymë ekspansioniste. Relativisht janë të paqytetëruar. Me evoluimin e qytetërimit, ai merr natyrë më të ngulitur dhe përpunon metoda e shprehi, që e bëjnë më të Qytetëruar. Kur konkurrenca ndërmjet elementëve të tij përbëres shkon drejt shuarjes dhe shfaqet një shtet universal, qytetërimi arrin pikën më të lartë të Qytetërimit, “epokën e artë” të tij, kur lulëzojnë morali, artet, letërsia, filozofia, teknologjia dhe mjeshhtëria ushtarake, ekonomike e politike. Kur merr rrugën drejt rënies si qytetërim, niveli i tij i Qytetërimit

po ashtu merr tatëpjetën, derisa zhduket nga goditjet e një qytetërimi tjetër që po lind, me një nivel Qytetërimi më të ulët.

Përgjithësisht modernizimi e ka ngritur nivelin e Qytetërimin në mbarë botën. Po a i ka ngritur po ashtu përmasat morale dhe kulturore të Qytetërimin? Nga disa anë duket se kështu ka ndodhur. Në botën e sotme janë bërë gjithnjë e më pak të pranueshme skllavëria, tortura, shfrytëzimi i mbrapshtë i individëve. Mirëpo a janë këto thjesht rrjedhojë e ndikimit të qytetërimin Perëndimor mbi kulturat e tjera dhe, si pasojë, a do të ketë një prapakthim me rënien e fuqisë së Perëndimit? Ka shumë dëshmi në vitet 1990 për peshën e paradigmës së “kaosit të tatëpjetë” në punët e botës: ka një prishje globale të ligjit e të rendit, në shumë vende të botës ka shtete të dështuara dhe anarki në rritje; vërehet një valë krimi, mafiesh transnacionale e kartelesh të drogës, është shtuar përdorimi i drogave në shumë shoqëri, ka një dobësim të përgjithshëm të familjes, një rënie të besimit të solidariteti shoqëror në shumë vende, kurse dhuna etnike, fetare e qytetërimore dhe sundimi i grykës së armës janë bërë mbizotëruese në pjesën më të madhe të botës. Krimi duket se po arrin kulmin dhe elementët bazë të Qytetërimin po shuhën në njërin qytet pas tjetrit: në Moskë, Rio de Zhaneiro, Bangkok, Shanghai, Londër, Romë, Varshavë, Tokio, Johanesburg, Delhi, Karaçi, Kajro, Bogota, Uashington. Njerëzit flasin për krizën globale të qeverisjes. Ngritja e korporatave transnacionale, që prodhojnë mallra ekonomie gjithnjë e më tepër, po shoqërohet nga shtimi i mafieve kriminale transnacionale, i karteleve të drogës dhe i grupeve të gangsterëve terroristë, që e godasin dhunshëm Qytetërimin. Parakushti i parë për Qytetërimin janë ligji dhe rendi, kurse në pjesën më të madhe të botës: në Afrikë, në Amerikën Latine, në ish Bashkimin Sovjetik,

në Azinë Jugore, në Lindjen e Mesme, ato duket se po avullojnë, ndërsa ndodhen nën goditje të rënda në Kinë, në Japoni dhe në Perëndim. Në përmasa mbarëbotërore Qytetërimi nga shumë anë duket se po i lëshon udhë barbarizmit, duke përfutur shëmbëllimin e një dukurie të pashoqe më parë: Mesjetës së Errët globale, që ndoshta po pllakos mbi njerëzimin.

Në vitet 1950 Lester Pearson-i kishte paralajmëruar, se njerëzit po shkonin drejt “një epoke, kur qytetërimet e ndryshme do të mësojnë të jetojnë krah për krah në një ndërshkëmbim paqësor, duke mësuar prej njëri-tjetrit, duke studiuar historinë e njëri-tjetrit dhe idealet e artin e kulturën, duke i pasuaruar reciprokisht jetët e njëri-tjetrit. Në këtë botë të vogël të mbipopulluar zgjidhja tjetër do të ishte moskuptimi, acarimi, përplasja dhe katastrofa.”²² E ardhmja si e paqes, edhe e Qytetërimet, varet nga mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ndërmjet udhëheqësve politikë, shpirtërorë e intelektualë të qytetërimeve më të mëdha të botës. Në përplasjen e qytetërimeve, Europa dhe Amerika do të mbahen së bashku ose do të mbahen veç e veç. Në përplasjen më të madhe, në “përplasjen *reale*” globale ndërmjet Qytetërimet e barbarizmit, qytetërimet më të mëdha të botës, me arritjet e tyre të pasura në besime, arte, letërsi, filozofi, shkencë, teknologji, moral e ndjenja, gjithashtu do të mbahen së bashku ose do të mbahen veç e veç. Në epokën që po përftohet, përplasjet e qytetërimeve janë kërcënimi më i madh për paqen botërore dhe një rend ndërkombëtar, i mbështetur në qytetërimet, është garancia më e sigurtë kundër luftës botërore.

Shënimet

Kreu 1

1. Henry A. Kissinger, *Diplomacy* (New York: Simon & Schuster, 1994), f. 23-24.
2. Shprehje e H.D.S. Greenway, *Boston Globe*, 3 dhjetor 1992, f. 19.
3. Vaclav Havel, "The New Measure of Man," *New York Times*, 8 korrik 1994, f. A27; Jacques Delors, "Questions Concerning European Security," Fjalim, International Institute for Strategic Studies, Brussels, 10 shtator 1993, f. 2.
4. Thomas S. Kuhn, *The Structure of Scientific Revolutions*, (Chicago: University of Chicago Press, 1962), f. 17-18.
5. John Lewis Gaddis, "Toward the Post-Cold War World". *Foreign Affairs*, 70 (pranverë 1991), 101; Judith Goldstein dhe Robert O. Keohane, "Ideas and Foreign Policy: An Analytical Framework", në Goldstein dhe Keohane, red., *Ideas and Foreign Policy: Beliefs, Institutions, and Political Change* (Ithaca: Cornell University Press, 1993), f. 8-17.
6. Francis Fukuyama, "The End of History", *The National Interest*, 16 (verë 1989), 4, 18.
7. "Address to the Congress Reporting on the Yalta Conference," 1 mars 1945, në Samuel I. Rosenman, red., *Public Papers and Addresses of*

Franklin D. Roosevelt (New York: Russell and Russell, 1969), XIII, 586.

8. Shih Max Singer dhe Aaron Wildavsky, *The Real World Order: Zones of Peace, Zones of Turmoil* (Chatham, NJ: Chatham House, 1993); Robert O. Keohane dhe Joseph S. Nye, "Introduction: The End of the Cold War in Europe", në Keohane, Nye, dhe Stanley Hoffmann, red., *After the Cold War: International Institutions and State Strategies in Europe, 1989-1991* (Cambridge: Harvard University Press, 1993), f.6; dhe James M. Goldgeier dhe Michael McFaul, "A Tale of Two Worlds: Core and Periphery in the Post-Cold War Era", *International Organization*, 46 (pranverë 1992), 467-491.

9. Shih F.S.C. Northrop, *The Meeting of East and West: An Inquiry Concerning World Understanding* (New York: Macmillan, 1946).

10. Edward W. Said, *Orientalism* (New York: Pantheon Books, 1978), f. 43-44.

11. Shih Kenneth N. Waltz, "The Emerging Structure of International Politics," *International Security*, 18 (vjeshtë 1993), 44-79; John J. Mearsheimer, "Back to the Future: Instability in Europe after the Cold War," *International Security*, 15 (verë 1990), 5-56.

12. Stephen D. Krasner e vë në pikëpyetje rëndësinë e Vestfalisë si pikë ndarëse. Shih prej tij "Westphalia and All That," në Goldstein dhe Keohane, red., *Ideas and Foreign Policy*, f. 235-264.

13. Zbigniew Brzezinski, *Out of Control: Global Turmoil on the Eve of the Twenty-first Century* (New York: Scribner, 1993); Daniel Patrick Moynihan, *Pandaemonium: Ethnicity in International Politics* (Oxford: Oxford University Press, 1993);

shih edhe Robert Kaplan, "The Coming Anarchy", *Atlantic Monthly*, 273 (shkurt 1994), 44-76.

14. Shih *New York Times*, 7 shkurt 1993, f. 1, 14; dhe Gabriel Schoenfeld. "Outer Limits", *Post-Soviet Prospects*, 17 (jan. 1993), 3, që citon shifrat nga Ministria e mbrojtjes e Rusisë.

15. Shih Gaddis, "Toward the Post-Cold War World", Benjamin R. Barber, "Jihad vs. McWorld," *Atlantic Monthly*, 269 (mars 1992), 53-63, dhe *Jihad vs. McWorld* (New York: Times Books, 1995); Hans Mark, "After Victory in the Cold War: The Global Village or Tribal Warfare," në J.J. Lee dhe Walter Korter, red., *Europe In Transition: Political, Economic, and Security Prospects for the 1990s* (LBJ School of Public Affairs, University of Texas at Austin, mars 1990), f. 19-27.

16. John J. Mearsheimer, "The Case for a Nuclear Deterrent," *Foreign Affairs*, 72 (verë 1993), 54.

17. Lester B. Pearson, *Democracy in World Politics* (Princeton: Princeton University Press, 1955), f. 82-83.

18. Në mënyrë krejt të pavarur Johan Galtung ka bërë një analizë, e cila ecën paralelisht shumë afër me atë nga ana ime për peshën e madhe në politikën botërore të shtatë ose tetë qyteterimeve më të mëdha dhe të shteteve të tyre bërthamë. Shih prej tij "The Emerging Conflict Formations," në Katharine dhe Majid Tehranian, red., *Restructuring for World Peace: On the Threshold of the Twenty-First Century* (Cresskill NJ: Hampton Press, 1992), f. 23-24. Galtungu dallon shtatë grupime rajonale-kulturore që po përftohen me dominimin e hegjemonëve: Shtetet e Bashkuara, Komuniteti European, Japonia, Kina, Rusia, India dhe një "Bërthamë Islamike".

Ndër autorët e tjerë, të cilët në fillim të viteve 1990 kanë paraqitur argumente të ngjashme lidhur me qytetërimet, bëjnë pjesë: Michael Lind, "American as an Ordinary Country", *American Enterprise*, 1 (shtat./tet. 1990), 19-23; Barry Buzan, "New Patterns of Global Security in the Twenty-first Century," *International Affairs*, 67 (1991), 441, 448-449; Robert Gilpin, "The Cycle of Great Powers: Has It Finally Been Broken?" (Princeton University, artikull i pabotuar, 19 maj 1993) f. 6 vij.; William S. Lind, "North-South Relations: Returning to a World of Cultures in Conflict," *Current World Leaders*, 35 (dhjet. 1992), 1073-1080, dhe "Defending Western Culture," *Foreign Policy*, 84 (vjeshtë 1994), 40-50; "Looking Back from 2992: A World History, kap. 13: The Disastrous 21st Century," *Economist*, 26 dhjetor 1992-8 janar 1993, f. 17-19; "The New World Order: Back to the Future," *Economist*, 8 janar 1994, 21-23; "A Survey of Defence and the Democracies," *Economist*, 1 shtator 1990; Zsolt Rostovanyi, "Clash of Civilizations and Cultures: Unity and Disunity of World Order," (artikull i pabotuar, 29 mars 1993); Michael Vlahos, "Culture and Foreign Policy," *Foreign Policy*, 82 (pranverë 1991), 59-78; Donald J. Puchala, "The History of the Future of International Relations," *Ethics and International Affairs*, 8 (1994), 177-202; Mahdi Elmandjra, "Cultural Diversity: Key to Survival in the Future," (kumtesë e paraqitur në Kongresin e Parë Meksikan për Studimet e së ardhmes, Mexico City, shtator 1994). Më 1991 Elmandjra botoi arabisht një libër, i cili doli frëngjisht një vit më pas me titullin *Premiere Guerre Civilisationnelle* (Casablanca: Ed. Toubkal, 1982, 1994).

19. Fernand Braudel, *On History* (Chicago: University of Chicago Press, 1980), f. 210-211.

Kreu 2

1. "World history is the history of large cultures." Oswald Spengler, *Decline of the West* (New York: A.A. Knopf, 1926-1928), II, 1970. Ndër veprat kryesore të këtyre studiuesve, që analizojnë natyrën dhe dinamikën e qytetërimeve, bëjnë pjesë: Max Weber, *The Sociology of Religion* (Boston: Beacon Press, përkth. Ephraim Fischhoff, 1968); Emile Durkheim dhe Marcel Mauss, "Note on the Notion of Civilization," *Social Research*, 38 (1971), 808-813; Oswald Spengler, *Decline of the West*; Pitirim Sorokin, *Social and Cultural Dynamics* (New York: American Book Co., 4 vëll., 1937-1985); Arnold Toynbee, *A Study of History* (London: Oxford University Press, 12 vëll., 1934-1961); Alfred Weber, *Kulturgeschichte als Kulturosoziologie* (Leiden: A. W. Sijthoff's Uitgerversmaatschappij N. V., 1935); A. L. Kroeber, *Configurations of Culture Growth* (Berkeley: University of California Press, 1994), dhe *Style and Civilizations* (Westport, CT: Greenwood Press, 1973); Philip Bagby, *Culture and History: Prolegomena to the Comparative Study of Civilizations* (London: Longmans, Green, 1958); Carroll Quigley, *The Evolution of Civilizations: An Introduction to Historical Analysis* (New York: Macmillan, 1961); Rushton Coulborn, *The Origin of Civilized Societies* (Princeton: Princeton University Press, 1959); S. N. Eisenstadt, "Cultural Traditions and Political Dynamics: The Origins and Modes of Ideological Politics," *British Journal of Sociology*, 32 (qershor 1981), 155-181; Fernand Braudel, *History of Civilizations* (New York: Allen Lane – Penguin Press, 1994) dhe *On History*

(Chicago: University of Chicago Press, 1980); William H. McNeill, *The Rise of the West: A History of the Human Community* (Chicago: University of Chicago Press, 1963); Adda B. Bozeman, "Civilizations Under Stress," *Virginia Quarterly Review*, 51 (dimër 1975), 1-18, *Strategic Intelligence and Statecraft* (Washington: Brassey's (US), 1992), dhe *Politics and Culture in International History: From the Ancient Near East to the Opening of the Modern Age* (New Brunswick, NJ: Transaction Publishers, 1994); Chistopher Dawson, *Dynamics of World History* (LaSalle, IL: Sherwood Sugden Co., 1978), dhe *The Movement of World Revolution* (New York: Sheed e Ward, 1959); Immanuel Wallerstein, *Geopolitics and Geoculture: Essays on the Changing World-system* (Cambridge: Cambridge University Press, 1992); Felipe Fernández-Armesto, *Millennium: A History of the Last Thousand Years* (New York: Scribners, 1995). Këtyre veprave mund t'u shtohet vepra e fundit e lidhur me një tragjedi, e Louis Hartz, *A Synthesis of World History* (Zurich: Humanity Press, 1993), e cila "me një fuqi parashikuese të shquar," siç e ka komentuar Samuel Beer, "parashikon një ndarje të njerëzimit shumë të ngjashme me modelin e sotëm të botës pas Luftës së ftohtë" në pesë "zona kulturore" të mëdha: e krishterë, myslimane, hindu, konfuciane dhe afrikane. Memorial Minute, Louis Hartz, *Harvard University Gazette*, 89 (27 maj, 1994). Një vështrim i domosdoshëm përmbledhës dhe hyrje për analizën e qytetërimeve është Matthew Melko, *The Nature of Civilizations* (Boston: Porter Sargent, 1969). Falënderoj gjithashtu për vërejtjet e dobishme lidhur me artikullin tim kritik në *Foreign Affairs*, Hayward W. Alkerin e Ri, "If Not Huntington's 'Civilizations,' Then Whose?" (artikull

i pabotuar, Massachusetts Institute of Technology, 25 mars 1994)

2. Braudel, *On History*, f. 177-181, 212-214, dhe *History of Civilizations*, f. 4-5; Gerrit W. Gong, *The Standard of "Civilization" in International Society* (Oxford: Clarendon Press, 1984), 81 vij., 97-100; Wallerstein, *Geopolitics and Geoculture*, f. 160 vij. dhe 215 vij.; Arnold J. Toynbee, *Study of History*, X, 274-275, dhe *Civilization on Trial* (New York: Oxford University Press, 1948), f. 24.

3. Braudel, *On History*, f. 205. Për një vështrim të gjerë rreth përkufizimeve të kulturës e të qytetërimit, sidomos për dallimin gjerman, shih A.L. Kroeber and Clyde Kluckhohn, *Culture: A Critical Review of Concepts and Definitions* (Cambridge: Papers of the Peabody Museum of American Archaeology and Ethnology, Harvard University, Vol. XLVII, No.1, 1952), në vijim, po sidomos f. 15-19.

4. Bozeman, "Civilizations Under Stress," f. 1.

5. Durkheim dhe Mauss, "Notion of Civilization," f. 811; Braudel, *On History*, f. 177, 202; Melko, *Nature of Civilizations*, f. 8; Wallerstein, *Geopolitics and Geoculture*, f. 215; Dawson, *Dynamics of World History*, f. 51, 402; Spengler, *Decline of the West*, I, f. 31. Është interesante që *International Encyclopedia of the Social Sciences* (New York: Macmillan and Free Press, red. David L. Sills, 17 vëll., 1968) nuk përmban asnjë artikull kryesor për "qytetërimin" ose "qytetërimet." "Koncepti i qytetërimit" (në numrin njëjës) trajtohet në një nënndarje të artikullit "Revolucioni Urban," ndërsa qytetërimet (shumës) përmenden shkarazi në një artikull me titullin "Kultura."

6. Herodotus, *The Persian Wars* (Harmondsworth, England: Penguin Books, 1972), f. 543-544.

7. Edward A. Tiryakian, "Reflections on the Sociology of Civilizations," *Sociological Analysis*, 35 (Verë 1974), 125.

8. Toynbee, *Study of History*, I, 455, cituar në Melko, *Nature of Civilizations*, f. 8-9; dhe Braudel, *On History*, f. 202.

9. Braudel, *History of Civilizations*, f. 35, dhe *On History*, f. 209-210.

10. Bozeman, *Strategic Intelligence and Statecraft*, f. 26.

11. Quigley, *Evolution of Civilizations*, f. 146vij.; Melko, *Nature of Civilizations*, f. 101vij. Shih D. C. Somervell, "Argument" në shkurtimin e tij të Arnold J. Toynbee, *A Study of History*, vëll. I-VI (Oxford: Oxford University Press, 1946), f. 569vij.

12. Lucian W. Pye, "China: Erratic State, Frustrated Society," *Foreign Affairs*, 69 (Vjeshtë 1990), 58.

13. Shih Quigley, *Evolution of Civilizations*, kap. 3, veç. f. 77, 84; Max Weber, "The Social Psychology of the World Religions," në *From Max Weber: Essays in Sociology* (London: Routledge, përkth. e red. H. H. Gerth dhe C. Wright Mills, 1991), f. 267; Bagdy, *Culture and History*, f. 165-174; Spengler, *Decline of the West*, II, 31vij.; Toynbee, *Study of History*, I, 133; XII, 546-547; Braudel, *History of Civilizations*, passim; McNeill, *The Rise of the West*, passim. dhe Rostovanyi, "Clash of Civilizations," f. 8-9.

14. Melko, *Nature of Civilizations*, f. 133.

15. Braudel, *On History*, f. 226.

16. Për shtesat kryesore të viteve 1990 kësaj literature, prej një autori që i njeh mirë të dyja

kulturat, shih Claudio Veliz, *The New World of the Gothic Fox* (Berkeley: University of California Press, 1994).

17. Shih Charles A. dhe Mary R. Beard, *The Rise of American Civilization* (New York: Macmillan, 2 vëll., 1927) dhe Max Lerner, *America as a Civilization* (New York: Simon & Schuster, 1957). Me zjarr atdhetar, Lerner argumenton “Për të mirë a për të keq, Amerika është ajo që është - një kulturë më vete, me shumë vija karakteristike të fuqisë dhe të kuptimit më vete, që renditet me Greqinë e Romën si një qytetërim i madh i dalluar i historisë.” Mirëpo ai gjithashtu e pranon se “Pothuaj pa asnjë përjashtim teoritë e mëdha të historisë nuk gjejnë vend për ndonjë koncept lidhur me Amerikën si një qytetërim më vete” (f. 58-59).

18. Mbi rolin e fragmenteve të qytetërimit europian në krijimin e qytetërimeve të reja në Amerikën e Veriut, Amerikën Latine, Afrikën e Jugut dhe Australi, shih Louis Hartz, *The Founding of New Societies: Studies in the History of the United States, Latin America, South Africa, Canada and Australia* (New York: Harcourt, Brace & World, 1964).

19. Dawson, *Dynamics of World History*, f. 128. Shih edhe Mary C. Bateson, “Beyond Sovereignty: An Emerging Global Civilization,” në R. B. J. Walker dhe Saul H. Mendlovitz, red., *Contending Sovereignities: Redefining Political Community* (Boulder: Lynne Rienner, 1990), f. 148-149.

20. Toynbee si Therevadën edhe Budizmin Lamaist i klasifikon si qytetërimë fosile, *Study of History*, I, 35, 91-92.

21. Shih, për shembull, Bernard Lewis, *Islam and the West* (New York: Oxford University Press, 1993); Toynbee, *Study of History*, kap. IX, “Contacts

between Civilizations in Space (Encounters between Contemporaries),” VIII, 88vij.; Benjamin Nelson, “Civilizational Complexes and Intercivilizational Encounters,” *Sociological Analysis*, 34 (Verë 1973), 79-105.

22. S. N. Eisenstadt, “Cultural Traditions and Political Dynamics: The Origins and Modes of Ideological Politics,” *British Journal of Sociology*, 32 (Qershor 1981), 157, dhe “The Axial Age: The Emergence of Transcendental Visions and the Rise of Clerics,” *Archives Europeennes de Sociologie*, 22 (No. 1, 1982), 298. Shih edhe Benjamin I. Schwartz, “The Age of Transcendence in Wisdom, Revolution, and Doubt: Perspectives on the First Millennium B. C.,” *Daedalus*, 104 (Pranverë 1975), 3. Koncepti i Epokës Boshtore vjen prej librit të Karl Jaspers, *Vom Ursprung und Ziel der Geschichte* (Zurich: Artemisverlag, 1949).

23. Toynbee, *Civilization on Trial*, f. 69. Khs. William H. McNeill, *The Rise of the West*, f. 295-298, i cili thekson përmasat në të cilat me ardhjen e epokës së krishterë, “Rrugët tregtare të organizuara, me det e me tokë,.... nisën të lidhnin katër kulturat e mëdha të kontinentit.”

24. Braudel, *On History*, f. 14: “.... ndikimi kulturor erdhi me doza të vogla, i vonuar për shkak të gjatësisë dhe të ngadalësisë së udhëtimeve që ndërmermjin. Nëse do t’u besojmë historianëve, moda kineze e periudhës Tang [618-907] ka udhëtuar aq ngadalë, saqë deri në shekullin e pesëmbëdhjetë nuk kishte arritur në ishullin e Qipros dhe në oborrin e shkëlqyer Lusinjan. Prej andej u përhap me shpejtësinë më të madhe të tregtisë mesdhetare drejt Francës dhe oborrit të pazakontë të Karlit VI, ku u bënë shumë popullore

kënaja dhe këpucët me maja të holla të gjata, një trashëgimi e një bote të shuar prej shumë kohësh, që i ngjet mjaft dritës, e cila na vjen ende prej yjesh tashmë të shuara.”

25. Shih Toynbee, *Study of History*, VIII, 347-348.

26. McNeill, *Rise of the West*, f. 547.

27. D. K. Fieldhouse, *Economics and Empire, 1830-1914* (London: Macmillan 1984), f. 3; F. J. C. Hearnshaw, *Sea Power and Empire* (London: George Harrap and Co, 1940), f. 179.

28. Geoffrey Parker, *The Military Revolution: Military Innovation and the Rise of the West* (Cambridge: Cambridge University Press, 1988), f. 4; Michael Howard, “The Military Factor in European Expansion,” në Hedley Bull dhe Adam Watson, red., *The Expansion of International Society* (Oxford: Clarendon Press, 1984, f. 33vij.

29. G. Kenwood dhe A. L. Loughheed, *The Growth of the International Economy 1820-1990* (London: Routledge, 1992), f. 78-79; Angus Maddison, *Dynamic Forces in Capitalist Development* (New York: Oxford University Press, 1991), f. 326-27; Alan S. Blinder, njoftuar në *New York Times*, 12 mars 1995, f. 5E. Shih edhe Simon Kuznets, “Quantitative Aspects of the Economic Growth of Nations – X. Level and Structure of Foreign Trade: Long-term Trends,” *Economic Development and Cultural Change*, 15 (Jan. 1967, pj. II), f. 2-10.

30. Charles Tilly, “Reflections on the History of European State-making,” në Tilly, red., *The Formation of National States in Western Europe* (Princeton: Princeton University Press, 1975), f. 18.

